



Mehmet Akif Ersoy
FLETËT
Vepra poetike e plotë

SAFAHAT

E përgatiti për botim:
Adnan ISMAILI





BOTUES:

Prof. Dr. Numan KURTULMUŞ

Kryetar i Kuvendit të Madh Popullor të Turqisë

PËRGATITI PËR BOTIM:

Adnan ISMAILI

KOORDINATOR I BOTIMIT:

Talip UZUN

Sekretar i Përgjithshëm

PËRGJEGJËS I BOTIMIT:

Yahya COŞKUN

Kryetar i Departamentit të Marrëdhënieve me Shtypin,
Mediat dhe Publikun

DIZAJNI GRAFIK:

Müge İMİR BALCI, Yeşim SEL

PËRGJEGJËS PËR DIZAJNIN NË SHQIP:

Demet ÇINAR

ISBN: 978-625-6871-19-9

NUMRI I KOPJEVE

2000

MEHMET AKİF ERSOY

SAFAHAT

-Fletët-



LOGOS·A

Organizimi i projektit për përkthimin,
redaktimin profesional, redaktimin gjuhësor
të veprës “SAFAHAT” në gjuhën shqipe
është bërë nga SHB “Logos-A” - Shkup,
nën mbikëqyrjen e Adnan Ismailit.

E përktheu nga turqishtja:

Mithat Hoxha

Titulli i origjinalit:

Mehmet Akif Ersoy, Safahat
Hazırlayan: M. Ertuğrul DÜZDAĞ
İstanbul, 2000

Redaktorë dhe krahasues me origjinalin:


Metin Izeti & Ali Pajaziti

Redaktor teknik:

Halil Berisha

Edicioni 1: 2024

© Tekstet, fotografitë dhe vizatimet në libër nuk
mund të botohen, të plota ose të pjesshme, optikisht,
elektronikisht ose mekanikisht.







HIMNI I PAVARËSISË

Mos u tremb! Nuk shuhet flamuri i kuq all që në agime valon
Pa u shuar oxhaku i fundit që mbi vendin tim tymon;
Do të ndriçojë, ai është yll i kombit tim,
Ai është imi, ai është vetëm i kombit tim!

Mos u ngrys o hënë e re nazemadhe, t'u bëfsha fli!
Pa buzëqeshi kombit tim hero... Pse kaq mundime, pse kjo ashpërsi?
Se pastaj s'të bëhet gjaku ynë i derdhur, hallall, assesi!
Hak e ka kombi im që Hakkun adhuron, këtë pavarësi!

I lirë jetoj, i lirë kam qenë që në pafillimësi
Ç'i marrë mund të më lidhë me zinxhirë mua? Çudi!
Si vërshim gjëmues jam, shtratin e shemb, e bëj hi,
Çaj male, fushat e gjera s'më nxënë, s'njoh kufi!

N'sa horizontet e Perëndimit me mure të çeliksa janë rrethuar,
Gjoksin tim plot besim si fortifikatë kam vënduar!
Le të ulërijë, mos ki frikë! Kurrë s'ka për ta shuar një të tillë besim
Kuçedra me një dhëmb në gojë q'i thua qytetërim,

Mik! Mos i lër të poshtërit të kalojnë nëpër këtë vatan
Bëje trupin mburojë, ky sulm i paturpshëm të ndalojë, aman!
Do të agojnë për ty ditët që Zoti t'i ka premtuar..
Kush e di? Mbase nesër, mbase më herët kanë për të aguar!

Tokës që shkel mos i thuaj dhé, njihe, thjesht mos e kalo!
Për mijëra të paqefinë që shtrihen nën të mendo!
Ti je bir shehidi, është turp ta fyesh tët baba,
Mos e jep këtë xhenet vatan, edhe n'të dhënçin shumë të tilla si kjo dynja!

E kush për këtë xhenet vatan nuk bëhet fli?
Shehidë shpërthejnë, po ta shtrydhësh, nga kjo tokë, po si!
Edhe në m'i marrtë Zoti gjithë ç'kam, xhan e xhanan
Të mos më lërë të ndarë në këtë botë nga ky i vetmi vatan!

Shpirti në ty ka o Zot vetëm një shpresë:
Në gjoks të xhamisë sime të mos prekë dora e të pafesë!
Këto ezane, shehadeti i tyre themel i fesë
Jehonë e tyre mbi tokën e atdheut tim përjetë të mbesë!

Atëherë guri i varrit, në paça, mijra herë në sexhde, në dalldí;
O Zot, nga çdo plagë më kullon si gjak loti
Nga dheu kufoma më shpërthen si një shpirt i ri;
Atëherë, ndoshta, koka ma prek Arshin, ç'krenari!

Valëzo si agimet edhe ti, o gjysmëhënë me nam!
Hallall t'u bëftë gjaku ynë i derdhur edhe në s'jam!
Për ty, për kombin tim që s'do ta shohë më robërinë !
E ka hak, flamuri im që i lirë jetoj, lirinë!
Hak e ka, kombi im që Hakkun adhuron, pavarësinë!

MEHMET AKÍF ERSOY





İSTİKLÂL MARŞI

Korkma, sönmez bu şafaklarda yüzen al sancak;
Sönmeden yurdumun üstünde tüten en son ocak.
O benim milletimin yıldızıdır, parlayacak;
O benimdir, o benim milletimindir ancak.

Çatma, kurban olayım çehreni ey nazlı hilâl!
Kahraman ırkıma bir gül... ne bu şiddet bu celâl?
Sana olmaz dökülen kanlarımız sonra helâl,
Hakkıdır, Hakk'a tapan, milletimin istiklâl.

Ben ezelden beridir hür yaşadım, hür yaşarım.
Hangi çılgın bana zincir vuracakmış? Şaşarım!
Kükremiş sel gibiyim; bendimi çiğner, aşarım;
Yırtarım dağları, enginlere sığmam, taşarım.

Garb'ın âfâkını sarmışsa çelik zırhlı duvar;
Benim iman dolu göğsüm gibi serhaddim var.
Ulusun, korkma! Nasıl böyle bir imânı boğar,
"Medeniyet!" dediğin tek dişi kalmış canavar?

Arkadaş! Yurduma alçakları uğratma sakın;
Siper et gövdeni, dursun bu hayâsızca akın.
Doğacaktır sana va'dettiği günler Hakk'ın...
Kim bilir, belki yarın... belki yarından da yakın.

Bastığın yerleri "toprak!" diyerek geçme, tanı!
Düşün altındaki binlerce kefensiz yatanı.
Sen şehîd oğlusun, incitme, yazıktır atanı;
Verme, dünyâları alsan da, bu cennet vatanı.

Kim bu cennet vatanın uğruna olmaz ki fedâ?
Şühedâ fışkıracak, toprağı sıksan şühedâ!
Cânı, cânânı, bütün varımı alsın da Hudâ,
Etmesin tek vatanımdan beni dünyâda cüdâ.

Ruhumun senden, İlahî, şudur ancak emeli:
Değmesin ma'bedimin göğsüne nâ-mahrem eli!
Bu ezanlar-ki şehâdetleri dînin temeli
Ebedî yurdumun üstünde benim inlemeli


O zaman vecd ile bin secde eder -varsa- taşım;
Her cerâhamdan, İlahî, boşanıp kanlı yaşım,
Fışkırır rûh-i mücerred gibi yerden na'sım;
O zaman yükselerek Arş'a değer, belki başım.

Dalgalan sen de şafaklar gibi ey şanlı hilâl;
Olsun artık dökülen kanlarımın hepsi helâl.
Ebediyen sana yok, ırkıma yok izmihlâl:
Hakkıdır, hür yaşamış bayrağımın hürriyet;
Hakkıdır, Hakk'a tapan milletimin istiklâl!

MEHMET AKİF ERSOY



Prezantim Takdim



Prezantim

Prof. Dr. Numan KURTULMUŞ

Poeti ynë kombëtar, Mehmed Akif Ersoy, një njeri i mendimit, i veprimit dhe i kauzës, është një emër unik dhe i jashtëzakonshëm që ka fituar dashurinë e përbashkët të kombit tonë të dashur, me poezinë e tij si dhe me oratorinë, prozën dhe rolin patriotik që mori në ditët e luftës kombëtare.

Ai është një person që ka thurur rrugën e urtësisë për reformën morale e arsimore për hir të “brezit të Asimit”, për të cilën dha jetën, në dritën e vlerave që krijuan kombin tonë, me artikujt, vjershat dhe predikimet e tij, pa as më të voglën kontradiktë mes jetës dhe veprave të tij. Sa i vlefshëm është fjalimi i tij ku i drejtohet brezit të Asimit:

“Ti, që je brezi i Asimit, mos e nëpërkëmb nderin

Hidhe nga vetja makthin e frikës dhe pakujdesinë

Nëse ndezin zjarr si Nemrudi, dhe të flakin ty

Mos, të lutem, mos e braktis besimin dhe fenë tënde”.

Sipas fjalëve të historianëve tanë të letërsisë, emri Asim, të cilin Akifi e prezantoi si model për të rinjtë, vjen nga emri i sahabit (shokut të Pejgamberit a.s.) Asim b. Thabit. Ai sahabe i madh njihet për faktin se, në ditën e Uhudit, kur të gjithë shqetësoheshin për plaçkën, nuk u largua kurrë nga afërsia e Pejgamberit a.s.. I riu që Akifi e idealizon si Asim është personi që do të mbrojë besimin, kombin, vendin, fenë dhe nderin e tij me shpirtin e tij luftarak pa cenuar të vërtetën. Ai është simboli i një rinie të pastër, e cila është e pajisur me njohuri dhe shkencë botërore dhe është besnik ndaj botës së vlerave të tij.

Ky është Asimi...

Akifi, si një poet i madh që mbart në vargjet e tij përgjërime, veprim, zgjim, vendosmëri për luftë dhe shpresë për shpëtim, pasqyron jetën e kombit dhe të shtetit me një stil shoqëror-realist në librin e tij me poezi shtatëpjesëshe të quajtur *Safahat*.

Ai e përshkroi qartë gjendjen e rënies në të cilën ndodhej shteti dhe situatën e vështirë të kombit, herë në injorancë e herë në dëshpërim dhe zbuloi zgjidhjet me ringjalljen, zgjimin dhe pastërtinë e një besimtari të sinqertë.

Ndërsa kundërshtonte pushtimin e imperializmit në botën islame, ai theksoi rëndësinë e të pasurit shkencë dhe teknologji. Sipas tij, Islami nuk është pengesë për përparimin, përkundrazi është pengesë për injorancën, ndarjen dhe prapambetjen.

Mehmed Akifi dëshiron që të rinjtë, në personin e Asimit, të ecin drejt së ardhmes me vendosmëri, të frymëzuar nga e kaluara jonë krenare me Ibn Sinanë, Ibn Rushdin, Gazaliun dhe Mevlanain, në mënyrë që e ardhmja të jetë më e mirë se e kaluara. Çdo fjalë që ai thotë me sinqeritet, dhimbje dhe emocione nuk është gjë tjetër veçse shprehje harmonike e shpresave të tij të tejmbushura për këtë qëllim.

Nga fillimi deri në fund të *Safahatit*, mbizotëron një qëndrim Akifian dhe një ideal Asimian. Poezitë e Mehmed Akifit janë udhërrëfyese për vetëdijen e unitetit dhe respektimit të ligjit të vëllazërisë. Nuk ka ëndrra të vrazhda në fjalët e tij... Meqenëse është një njeri i ditur dhe i mençur, arti dhe poezia e tij janë vetëm një mjet solid dhe i pastër i kauzës së tij...



Mehmed Akifi është një ushtar pararoje që kaloi të gjitha llojet e vuajtjeve në kohët më të vështira të historisë sonë, por nuk u dorëzua, nuk u spraps dhe vrapoi pa u lodhur për hir të vlerave të madhërishe. Ai është një monument morali që kërkon të humburën aty ku gjendet, kupton kohën e tij dhe tërheq vëmendjen ndaj pashmangshmërisë së ripërtëritjes që të mos humbet e ardhmja. Vepra e tij është një Asimname (Manifest Asimian) që përbëhet nga morali, vlerat, idealet dhe e ardhmja e një bote të ndriçuar nga besimi...

Safahat, si hartë kuptimore e botës gjithëpërfshirëse së cilës i përket Mehmed Akifi, e ruan ende aktualitetin dhe vlefshmërinë e saj.

Kuvendi i Madh Kombëtar i Turqisë e konsideron detyrë të mbrojtë trashëgiminë e Akifit, i cili ishte edhe deputet i respektuar i Kuvendit heroik dhe ta mbajë të gjallë emrin e tij me vepra të reja. Siç thotë një shprehje e vjetër: “Bilbili ka dyzet këngë, të dyzetat për trëndafilin”. Dyzet nga dyzet këngët tona kanë të bëjnë me atdheun, kombin, shtetin, vlerat, moralin e mirë, karakterin e lartë dhe Turqinë... Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për kauzën e ekzistencës që Akifi dhe të gjithë ne i ndjekim.

Përderisa e përkujtoj me mëshirë, respekt dhe mirënjohje studiuesin, të urtin, të virtytshmin dhe poetin e madh Mehmed Akif, dua t'i falënderoj miqtë e Akifit, të cilët janë dashamirës të Turqisë dhe që kontribuan për takimin e veprës së Akifit me lexuesit.

Prof. dr. Numan KURTULMUŞ

Kryetar i Kuvendit të Madh Popullor të Republikës së Turqisë

takdim

Prof. Dr. Numan KURTULMUŞ

Milli şairimiz; düşünce, aksiyon ve dava insanı Mehmed Âkif Ersoy, aziz milletimizin müşterek sevgisini kazanmış, şiiriyle olduğu kadar hatipliği, düz yazıları ve millî mücadele günlerinde üstlendiği vatanperver rol ile kendine has, müstesna bir isimdir.

Hayatı ile eserleri arasında en küçük bir tenakuz olmadan, yazdığı makaleleri, şiirleri ve vaazları ile milletimizi var eden değerlerin aydınlığında, ömrünü verdiği “Âsım’ın nesli” uğruna ahlak ve eğitim inkılabı için irfan yolunu ilmek ilmek örmüş bir şahsiyettir. Asım’ın nesline seslenişi ne kadar değerlidir:

“Sen ki Âsım’ın neslisin, çiğnetme namusunu.

At üstünden korkunun ve gafletin kâbusunu.

Ateşler yakıp Nemrut misali, atsalar seni.

Sakin hâ! Terk etmiyesin imanını, dinini.”

Edebiyat tarihçilerimizin ifadesiyle; Akif’in gençliğe rol model olarak sunduğu Asım’ın ismi, sahabelerden Âsım b. Sâbit’ten gelmektedir. O büyük sahabe, Uhut gününde herkes ganimet derdine düştüğünde, Hz. Resulullah’ın yanından asla ayrılmamış olmakla bilinir. Akif’in, Asım olarak idealize ettiği genç, hakikatten asla taviz vermeden mücadelecî ruhuyla inancını, milletini, memleketini, dinini, namusunu koruyacak kişidir. Hem dünyevi anlamıyla ilim ve fenle donanmış hem de kendi değerle dünyasına sadık, tertemiz bir gençliğin simgesidir. Asım...

Akif; atılımı, aksiyonu, uyanışı, mücadele azmini ve kurtuluş umudunu mısralarında taşıyan bir büyük şair olarak Safahat adını verdiği yedi kısımdan mürekkep şiir kitabında, toplumcu-gerçekçi bir üslupla milletin ve devletin hayatına ayna tutmuştur.

Devletin içinde bulunduğu inkıraz durumunu, milletin kâh cehalet, kâh umutsuzluk içerisindeki zor durumunu olanca netliği ile tasvir edip çareleri de inanmış samimi bir mü’minin dirilişi, uyanışı ve safiyetiyle gözler önüne sermiştir.

Emperyalizmin İslam alemine yönelik tasallutuna karşı çıkarken ilim ve tekniğe sahip olunmasının önemine vurgu yapmıştır. Onun nazarında Müslümanlık, terakkiye değil, cehalete, bölünmeye ve geriliğe engeldir.

Mehmed Âkif, yarınların dünden daha güzel olması için Âsım’ın şahsında gençlerin, İbn-i Sinâ’ların, İbn-i Rüşd’lerin, Gazali’lerin, Mevlânâ’ların var olduğu iftihar dolu geçmişimizden ilham alarak kararlılıkla geleceğe yürümesini istemektedir. Samimiyet, ıstırap ve heyecanla söylediği her söz, bu gaye uğruna taşan umutlarının ahenkle dile gelmesinden başka bir şey değildir.

Safahat’ın başından sonuna kadar Akif’çe bir duruş, Âsım’ca bir ideal hâkimdir. Mehmed Âkif şiirleri, birlik şuuru ve kardeşlik hukukuna riayet uğrunda yol göstericidir. Ham hayaller bulunmaz onun sözlerinde... Alim ve arif bir zat olmasından dolayı, sanatı ve şiiri, davasının sağlam ve pak aracıdır sadece...



Mehmed Âkif, tarihimizin en zor zamanlarında çilenin her türlüşünü yaşayan fakat yılmayan, pes edip vazgeçmeyen ve yüce değerler uğruna yorulmak bilmeden koşan bir akıncıdır. Yitiği koybulduğu yerde arayan, çağını anlayan, yenilenmenin, yok olmamız için kaçınılmazlığına dikkat çeken bir ahlak abidesidir. Eseri de imanın aydınlattığı bir dünyaya ait ahlak, değer, ideal ve gelecekte ibaret bir Âsımname'dir...

Mehmed Âkif'in ait olduğu cihanşümül âlemin anlam haritası olarak Safahat, hâlen gerçekliğini ve geçerliliğini korumaktadır.

TBMM, aynı zamanda Gazi Meclisin muhterem bir mensubu olan aziz Âkif'e dair yeni çalışmalarla onun mirasına sahip çıkmayı ve ismini ihtiramla ölümsüzleştirmeyi bir vazife telakki eder. Eskiler derler ya: "Bülbülün kırk türküsü var, kırkı da gül üstüne." Bizim kırk türkümüzün kırkı da vatan, millet, devlet, değerler, güzel ahlak, yüksek karakter ve Türkiye üstünedir... Yani Âkif'in ve hepimizin peşinde gittiği varoluş davası üstünedir.

Alim, arif, fazıl ve büyük şair Mehmed Âkif'i rahmet, hürmet ve minnetle anarken eserin okuyucu ile buluşmasında emeği geçen Türkiye sevdalısı Âkif dostlarına teşekkür ediyorum.

Prof. Dr. Numan KURTULMUŞ
Türkiye Büyük Millet Meclisi Başkanı

Përmbajtja

PREZANTIM..... IX	KRONOLOGJIA JETËSORE
TAKDIM..... XI	E MEHMET AKIF ERSOJIT XXVII
MEHMET AKIF ERSOJI: SHEHID/SHAHID I KOHËS XIX	PARATHËNIE XXXIII
DY FJALË RRETH PËRKTHIMIT SHQIP TË "SAFAHATIT" ...XXIII	MEHMET AKIF ERSOJ JETA DHE VEPRAT XXXV

Libri i parë

FLETËT

FLETËT.....1	ATDHEU I TË DASHURIT86
XHAMIA FATIH..... 5	ELEGJI.....88
I SËMURI 8	DIRVASI91
BESIM NË NJË ZOT APO KLITHMË 12	KAFENEJA E MËHALLËS.....95
KOFINI17	IMAMI QOSE104
TË MOS NDALEMI!.....21	PIKTORI KA TË DREJTË?.....110
RROGOZI24	ISHTË SHKRUAR MBI NJË GURË VARRI111
TELASHËT E MBIJETESËS26	SHKRUAR PAS NJË FOTOGRAFIE.....112
MEJHANIA29	KRITIKU PËRBALLË POETIT113
VARREZA34	EDHE KJO ISHTË SHKRUAR PËR NJË GURË VARRI 114
BAJRAMI.....38	TRËNDAFILI DHE BILBILI115
HALLQARJE.....41	PËRKTHIM116
SELMA.....44	PËRKTHIM117
I NDJERI IBRAHIM BEJ.....47	DISFATA E QARTË.....118
ZELLI53	RRUGA PËR AHIRET119
SEJFI BABAI55	DALLDË E PËRSHPIRTSHME.....123
NJERIU.....59	SHPURA E AMIN-IT125
NEJZENI QORR.....62	HALLQARJE.....127
SHAHU PERSIAN.....64	KUKULLA OSE HAKK-I KARAR.....129
DESPOTIZËM.....68	PEMËSHITËSI PLAK132
LIRIA.....74	POHIM133
GRUAJA PLAKË DHE OMERI.....76	
EZANET.....83	

Libri i dytë

NË QYRSINË E SULEJMANIJES

NË QYRSINË E SULEJMANIJES135	NË QYRSINË E SULEJMANIJES137
------------------------------------	------------------------------------

Libri i tretë

ZËRAT E HAKKUT

ZËRAT E HAKKUT..... 171	NJË NATË MEVLUDI SHUMË E ZYMTË 193
-------------------------	--



Libri i katërt NË QYRSINË E FATIHUT

NË QYRSINË E FATIHUT	197	VAIZI NË QYRSI.....	211
DY SHOKË NË RRUGË TË FATIHUT	200		

Libri i pestë KUJTIMET

KUJTIMET	257	NË LUKSOR.....	274
ZGJOHU!	262	KUJTIME BERLINI.....	278
		NGA SHKRETËTIRAT E NEXHDIT NË MEDINE	301

Libri i gjashtë ASIMI

ASIMI	309
-------------	-----

Libri i shtatë HIJET

HIJET	393	SEXHDE.....	431
DISFATA	396	HOXHË HYSAM EFENDIU	433
LINDJA.....	397	MËSIM NGA RRËFIMI	434
BALLET DUHET TË DJERSIJNË	399	PORTRETIT TIM.....	435
A TA MERRTE MENDJA?.....	401	PORTRETIT TIM.....	436
MEHMET ALIUT	403	URIM.....	437
A ENDE TË PËRFYTEM!?	404	URIM.....	438
JO PESIMIZËM!.....	406	PËR "SAFAHATIN"	439
PAS ZELLIT, NËNSHTRIM.....	408	PORTRETIT TIM.....	440
SULEJMAN NAZIFIT	410	PËRKTHIM NGA SADIU.....	441
BILBILI	412	MEVLUDI.....	442
LEJLA	414	FËMIJËVE	443
ME FARAONIN SY MË SY.....	416	NJË LETËR.....	444
PËR PËRMENDOREN E SHEHIDËVE	424	NJË NATË	446
UNITET.....	425	AS VEPËR, AS SAMAR!.....	447
NATË.....	427	DERVISH AHMETI	448
VUAJTJE TË NDARJES	429		

IMAMI SAID PASHA.....	451	KU JE?.....	460
PORTRETIT TIM.....	456	E VËRTETA E VETME.....	461
UNI TËRHEQËS.....	457	SHOKUT TIM TË JETËS.....	462
GJASHTËDHJETËVJEÇ.....	458	ARTISTI.....	463
NEVRUZIT.....	459		

SHTOJCA 1

POEZITË JASHTË SAFAHATIT	473	KUSH S'E KA MIZËN NËN KËSULË, TË MOS KRUHET! ...	513
HIMNI I PAVARËSISË	474	KUJTIMET E BERLINIT.....	515
ME LEJEN TUAJ.....	476	"NJERIU JETON NË RAPORT ME AQ SA NDJEN!"	519
GAZEL	477	LUTJA E USHTRISË	521
TERKIB-I BEND.....	478	ARTISTIT GJENIAL TË LINDJES!	522
KUR'ANIT	483	LETRA E DYTË.....	524
E DREJTA FITON!.....	485	FRAGMENTE POETIKE.....	527
SAADIU.....	487	NATA E MEVLUDIT	531
FAHREDIN RAZIU	489	NATA E MEVLUDIT	533
QIRIU DHE FLUTURA.....	493	URIM.....	535
ARIF HIKMET HERCEGOVASI.....	495	VILA ME TRËNDAFILA.....	537
BISEDË ZEMRE.....	503	PAS FOTOGRAFISË SIME	538
HALLQARJE.....	505	PORTRETIT TIM.....	539
KËNGA E LUFTËS.....	511		

SHTOJCA 2

FOTOALBUM	543
------------------------	-----

MEHMET AKIF ERSOJI: SHEHID/SHAHID I KOHËS

“Allahu mos e dhëntë që këtij populli
t’i shkruhet edhe një herë Himni Kombëtar.”

(M. A. Ersoy)

Të përsiasësh për jetën dhe veprën personale është e vështirë dhe e rrezikshme. Akoma më e vështirë dhe më e rrezikshme, edhe pse për arsye të tjera, është të përsiasësh për jetën dhe veprën e “tjetrit”. Kjo që ne, megjithatë, i futemi rrezikut për të përsiatur për jetën dhe veprën e Mehmet Akif Ersojit, është më tepër çështje e nënshtrimit ndaj rrethanave të rastësishme, sesa e guximit të vetëdijshëm. Rrethanat e rastësishme nuk janë në fuqinë tonë, por në fuqinë e Kohës, në të cilën na është dhënë të përsiasim për jetën dhe veprën që kanë ndodhur në emër të urtësisë dhe për urtësinë në hapësirën “tonë”.

Mendimtari niset nga empirikja dhe arrin deri te ligjshmëria, por Mehmet Akif Ersoji me poezinë e tij depërton dhe zhytet më thellë nga gjendja faktike e jashtme, për të prekur arsyet njerëzore, individuale dhe klasore, respektivisht fetare dhe rajonale, territoriale apo shtetërore të komplotit dhe zgjidhjes në skenën botërore. Historia nuk mund të kuptohet pa përdorimin e abstraksionit, pa nocionet integrale, ndaj edhe Mehmet Akif Ersoji ka ndriçuar disa pika kyçe me raportet dhe interesat objektive, të cilat në të kaluarën janë dëshmuar dhe interpretuar nga tekstet e shenjta, e në veçanti ndodhitë nga koha e Pejgamberit a.s.

Çdo mendimtar e pranon me guxim rrezikun që e implikon ekzistenca, i nënshtrohet me vetëdije imperativit kategorik që jeta t’i bëhet mendim dhe mendimi jetë, në unitetin e jetës së menduar dhe kuptimplotë. Akoma më i vështirë është, kuptohet, detyrimi i mendimtarit autentik që ta plotësojë këtë, ashtu që mendimi ta ketë mendimin e kohës, *logosin* e kohës. Ishte kjo ëndërr edhe e Mehmet Akifit. Mirëpo, *logosi* i kohëve në të cilat atij i ishte caktuar të jetonte dhe të vepronte, e dërrmoi atë megjithëse, me sa duket, nuk arriti t’ia dërrmonte ëndrrën. Edhe pse jeta dhe vepra e Mehmet Akif Ersojit nuk u bënë shenjë, simbol i mendimit “absolut”, që sipas përkufizimit



është logos energjik i kohës, apo më mirë shenjë e kohës, megjithatë ato, d.m.th. jeta dhe vepra e tij, janë shenjë e kohës, apo shenja dhe dëshmi të kohërave, të denja për t'ia deshifruar kuptimin: në mënyrë imanente, pra në vete dhe për veten, e pastaj edhe për ne, pjesëmarrës ndoshta jo të së njëjtës kohë, por të realitetit thuajse të njëjtë.

Në kërkim të parimit të interpretimit, ekspozimit të kuptimit të jetës dhe veprës së Mehmet Akif Ersojit, ne u përcaktuam për atë parim të interpretimit që edhe vetë Mehmet Akif Ersoj, si mendimtar dhe poet, e praktikonte në zbulimin e kuptimit të urtësisë hyjnore. Atë kuptim ai orvatej ta gjente nga koha e dhënë në të cilën si përgjigje ndaj sfidës së (pa) kuptimit energjik ishte paraqitur mendësia e uljes me “prapanicë mbi taht (fron), ndërsa me mend dhe shpirt diku larg”. Përpjekja jonë për ta përsiatur jetën dhe veprën e Mehmet Akif Ersojit hasi në hamendjen metodologjike vijuese: ose nga jashtë t'i analizojmë situatat e jetës (faktet biografike) dhe t'i analizojmë njësitë bibliografike, pra në mënyrë doksografike, dhe ashtu të bëjmë paraqitjen bio-bibliografike të jetës dhe veprës së tij, ose të përpiqemi të bëjmë diçka tjetër: ta gjejmë nga brenda *logosin* e vetëm të jetës dhe veprës së tij. Jemi të ndërgjegjshëm se kjo është një ndërmarrje e rrezikshme, por po ashtu edhe sfiduese.

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë, periudhë e luftërave dhe e asgjësimit, e dhunës, gjenocidit, revolucioneve, sistemeve totalitare, periudhë në të cilën përpiloheshin rishtazi hartat gjeografike, krijoheshin dhe shpërbëheshin shtete dhe kufijtë e tyre, periudhë e migrimeve masive, shkrimtarët vërtet nuk e kanë të drejtën e autorit për temën e dëbimit. Mirëpo, edhe pse përkundër të gjitha statistikave shkrimtarët ndoshta konsiderohen si dëshmitarët më të pabesueshëm dhe më të parëndësishëm, ata janë ndër emigrantët që në hartën kulturore të botës lënë pas vetes gjurmët e gishtërinjve. I tillë ishte edhe Mehmet Akif Ersoj, që i përjetoi personalisht të gjitha këto vuajtje dhe turbullira.

Para syve të Mehmet Akifit ishte fotografia e shpërnguljeve, djegieve të fshatrave dhe qyteteve, rrënimi i xhamive dhe teqeve, që nuk ishin vetëm ngjarje të një çasti, por diçka që ndodhte me vite të tëra. Faktikisht, e tërë jeta e tij, që nga lindja deri në vdekje, ishte e këtillë. Kjo ishte edhe ajo që Mehmet Akifit nuk i lejoi të bëhej as historian, as filozof, e assesi politikan, por të bëhej poet mendimtar i frymëzuar nga “lartë”, sepse poezia e tij ishte si “plumbi/rrufeja” që godiste në zemrën e lexuesit. Poezia e Mehmet Akifit është e fuqishme dhe e përhershme, sepse mbështetjen e kishte mbi shtyllat më të forta: ai nuk i lejoi asnjëherë shejtanit t'i afrohej në poezinë e tij, prandaj duke lexuar poezinë e tij nuk përjetoni urrejtje, nuk e dëgjoni zërin

helmues të shkatërrimit dhe të fitnes, por të kritikës dhe vetëkritikës. Ai në mënyrë të fuqishme e paraqet dhimbjen e padrejtësisë që iu bë Perandorisë Osmane në emër të “drejtësisë”; fesë në emër të pafesisë; njerëzisë në emër të jo-njerëzisë. Çdo strofë e poezisë së tij është nën hijen e frymëzimit të Shpalljes hyjnore dhe dëshmi për historinë, thujtje e ka parë kijametin me sy dhe e ka përjetuar me shpirt.

Këtu do ta bëj një parafrazim në formën e asaj se çka më “tha” në ëndërr Mehmet Akifi: “Shiko çka janë duke bërë: edhe ata që thonë se besojnë – mashtrojnë, ata që ‘ekzistencën’ e tyre politike-ekonomike e mbështesin në post dhe që kanë bërë nam pa fare mëshire dhe përgjegjësie, ata që thonë se: ‘jemi shumë keq, ekonomia dita-ditës ngrihet dhe bie’. Pra, flas për ata që janë dushmanë dhe që me vite të tëra kanë mashtruar dhe kanë vjedhur, kanë shkatërruar dhe kanë shitur toka/prona, gjuha e tyre ka shkuar aq larg sa që nuk ka mundësi të jetojnë pa mashtrim, pa shkatërrim, e lëre më me shtet, kulturë e fe; ata janë në gjendje që vetëm për hir të një kafeje në një vend “modern” ta ndajnë dhe shesin shtetin në parcela, apo që të shkruajë një gazetë e Perëndimit, gënjejnë, dhe kur e bëjnë këtë gënjejnë imanisht; nuk kanë fare nder dhe dashuri për tokë e vatan e nga ana tjetër e konsiderojnë dhe e mbajnë veten se kanë dashuri për vatan dhe iman; ata më shqetësojnë, ‘mjerimi’, ‘varfëria’ e tyre më shqetëson, demokracia e tyre më brengos; besnikëria e tyre më tmerron. Si munden të mos e kuptojnë shtetin, pushtetin, kërkesën e kohës dhe frikën shkatërruese mbizotëruese sot?!...”

Edhe pse Mehmet Akif Ersoji nuk është i pranishëm fizikisht, koha të cilën e ka përjetuar ai është e njëjta me tonën; kjo është edhe arsyeja që e prezantova Mehmet Akifin pa cituar burime të shkruara. Ai jetoi në kohën kur Perandoria Osmane për çdo ditë humbiste pjesë territoriale të saj, madje edhe kontinentet ku mbisundonte. Ajo e humbi edhe Ballkanin, nga vinte edhe vetë Mehmet Akifi. Këtë humbje ai e përjetonte si dhimbje fizike dhe shpirtërore, që si poet edhe e shprehte në poezinë e tij. Besoj se për ne shqiptarët nuk ka nevojë të dëshmohet copëtimi ynë dhe vonesa jonë në gjithçka: në histori, në kulturë, në shkencë dhe në shtet. Mehmet Akifi po të kishte qenë sot në mesin tonë, me siguri do të na thoshte: a nuk ju mjaftoi ajo kohë e gjatë që ishit nën Perandorinë Osmane, e ju vazhdoni të kërkonit aleatë të fuqishëm në botë, sa në Lindje aq në Perëndim; në mënyrë paradoksale e luftoni njëri-tjetrin; e shisni të shenjtën për profanen, profanen për të shenjtën; askush nuk ju merr seriozisht.

Me keqardhje e them se për herë të parë emrin e Mehmet Akif Ersojit e dëgjova shumë vonë, dhe më pas mësova edhe më shumë për të. I prekuri nga poezitë e tij, në një ligjëratë në xhaminë e Jahja Pashës në Shkup më 1981



recitova një varg të tij: “O Zot, a s’ka mëngjes për këtë natë ogurzezë”?!? Kjo ishte si përgjigje ndaj kohës që e përjetoja, kohë e padrejtësive të mëdha që i bëheshin Zotit dhe fesë, dhe mashtrimit të madh të mendjes së njeriut “të mençur”, i cili merrte pjesë në atë, apo në këtë kohë ogurzezë, e ajo ishte lufta kundër fesë. Këtë poezi të tij e përsëritja shpesh, sa që me disa shokë e kisha bërë si refren përshëndetjeje. Mehmet Akifi ishte poet, në rend të parë njeri e pastaj bir shqiptar.

Pra, flas për kohën të cilën ne e kemi kaluar/përjetuar, dhe ajo është koha kur vendosëm që në mënyrë formale të botojmë libra me përmbajtje fetare, kulturore e filozofike nën emrin e Bibliotekës “Mehmet Akif Ersoj”, që ishte pararendëse e Shtëpisë Botuese “Logos-A”. Shpirti i Mehmet Akif Ersojit është në librat, në shkronjat e kësaj shtëpie botuese. Pse deshëm të botonim fillimisht nën emrin e Mehmet Akifit? Me sa më kujtohet në atë kohë kur ne e donim Mehmet Akifin tonë, pamë se “mendësia” dhe politika shqiptare nuk kishte urdhër/leje nga jashtë t’i pranonte mendimtarët e kalibrit të tij, me sa duket duke pritur shpëtim nga forca të tjera, post-osmane. Dhe kështu vendosëm në mënyrë paksa sarkastike ta emërojmë shtëpinë botuese “Logos”, që ka të bëjë me Zotin, por që “pranohej” nga mendësia e politikës së momentumit.

E Mehmet Akif Ersoj pse vazhdon të jetë i gjallë? Sepse ishte shëhid/martir, e shëhidët nuk vdesin. Rahmetullahi alejh/Allahu e mëshiroftë.

Prof. dr. Ismail BARDHI

Dhjetor, 2023

DY FJALË RRETH PËRKTHIMIT SHQIP TË “SAFAHATIT”

Shumë shqiptarë, si pjesë e pandashme e Shtetit Osman, gjatë pesë shekujve derdhën mundin dhe djersën e tyre në shumë fusha të dijes e të artit, ngritën dhe krijuan vlera që sot bota i ruan e i kultivon me xhelozi, por që ne shqiptarët për arsye të ndryshme vetëm së fundmi kemi filluar t'i njohim. Figura të tilla gjatë atyre shekujve ka thujse në të gjitha fushat e dijes e të artit, të pushtetit e të fesë, andaj mbetet mision i yni, i pasardhësve të këtyre figurave, që veprat dhe figurat e tilla t'ia bëjmë të njohura opinionit shqiptar.

Njerëzit e mëdhenj bëjnë vepra të mëdha, me të cilat lënë gjurmë pas vetes e bëhen të pavdekshëm. Cilësi e tyre është që ndonëse kanë elementin natyror kohor dhe hapësinor, i tejkalojnë përmasat e kufizimeve të tilla dhe arrijnë të zgjaten ndër breza e gjeografi të ndryshme. I tillë është edhe i madhi Mehmet Akif Ersoj (Pejani), një poet me frymë artistike e filozofike, që ka krijuar vargje e shkrime të mbrujtura me mesazh të dendur prosocial, etik, vizionplotë.

Emri i Mehmet Akif Ersojit, i përfolur gjatë gjithë shekullit që shkoi në opinionin turk, jo vetëm si shkrimtar e mendimtar i madh por dhe si hartues i himnit kombëtar turk “Istiklal marshi”, ndonëse ka bërë bujë të madhe në opinionin turk më shumë se një shekull qëndron sfidë edhe për shumë artistë, kritikë, mendimtarë e filozofë. Megjithëse i lindur në Turqi (nga nëna turke nga Buharaja dhe babai shqiptar nga f. Shushicë i Pejës, Kosovë), ai me krenari ka pohuar se i përket një familjeje kosovare, duke krijuar kështu një urë lidhjeje ndërmjet asaj që ishte për nga origjina dhe asaj që ai i përkiste për nga vepra. Se ishte dhe mbeti bir i këtij trualli ai e dëshmon edhe me penën e tij në vargjet që ia kushtoi atdheut të tij të përvuajtur, Kosovës.

Edhe pse jetoi në atë kohë kur në Stamboll vepronin edhe një mori tjetër veprimtarësh të rilindjes kombëtare, në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, dhe për nga madhështia e tij artistike dhe ideore mund të krahasohet vetëm me të madhin Sami Frashëri, për opinionin tonë ai ka mbetur i panjohur pikërisht nga se shkroi në gjuhën osmane dhe mbase për shkak të bindjeve të tij ideologjike. Megjithatë, ngado që ta marrësh, Mehmet Akifi për kulturën shqiptare mund të merret vetëm si një simbol i gjithë asaj



plejade shkrimtarësh shqiptarë që i dhanë vepra madhore kulturës osmane, por që akoma presin ta zënë vendin e tyre edhe në kulturën e tyre amë, në atë shqiptare. Jemi të mendimit se shqiptarët e neglizhojnë deri në harresë atë hise të madhe të artit e të shkencës që për aq shekuj ia dhuruan botës përmes një perandorie botërore, dhe pikërisht për këtë arsye kujtojmë se kjo hise jo vetëm që do ta pasuronte kulturën tonë, por edhe do të dëshmonte për arritjet tona. Madje kjo do të na jepte edhe një mundësi më shumë të krenohemi me atë që kemi qenë, që s'do mend se është kusht për atë që synojmë të jemi. Kjo njëherazi do të ishte dëshmi se fama e asaj perandorie, në një masë të madhe ishte meritë edhe e shqiptarëve.

Në kryeveprën e tij që keni para jush, *Safahat*, ai me një mjeshtëri ta pashembullt ia del që duke ligjëruar për aktualitetet e kohës së tij, të atyre periudhave të turbulencave të forta, të mos mbetet në dimensionin e një vjershëtari të zakonshëm, por duke sfiduar veten dhe shoqërinë, të ofrojë zgjidhje që janë të natyrës referenciale tejkohore. Vepra *Safahat* që merret me periudhat krizologjike të Shtetit Osman të përjetuara dhe përjetësuar nga autori, është ndërtuar nga frymëzimi që autori ka marrë nga tekstet e shenja islame (Kur'ani dhe tradita konstituive pejgamberike), nga shpirti pjellor dhe iluminist i Lindjes, që më së miri është trajtësuar në devizën *Ex Oriente Lux*. Kjo përmbledhje gëlon me vargje ku poezia na del si ushqim i shoqërisë, si diagnozë dhe konstrukcion social. Vetë Pejani në tekstet e tij rrëfen se është kundër idesë *l'art pour l'art*, se mbështet pikëpamjen se e bukura dhe arti duhet të jenë për njeriun dhe shoqërinë (*l'art pour l'homme*). Diskursi dhe *habitusi* poetik Akifian niset nga principi se letërsia gjithnjë duhet t'i bartë në vatrën e saj vlerat morale, virtytet dhe ngritjen shpirtërore të komunitetit, dijekërkimin dhe formimin e personalitetit të njeriut që kërkon *plotësinë*.

Të vënit e Pejanit në komunikim me lexuesin shqiptar përmes eksegjezës sociale poetike të pagëzuar *Safahat* është e rëndësisë jetike, sepse duke e bërë atë të hyjë në dialog përmes gjuhës së të atit universalet aksiologjike e estetike të tij tregojnë potencë ta shtyjnë edhe lexuesin tonë të mendojë thellë për rrjedhat e kohës, të dijë t'i kuptojë dhe interpretojë fenomenet, duke i lidhur ato me botën e *numen-it*. *Safahatin* duhet shënuar e lexuar edhe si një pasqyrë e filozofisë së historisë politike shqiptare të fillimshkullit XX, si një sociologji letrare dhe përshkrim të përimituar psikologjik të brengës së shqiptarit musliman në kohë të vuajtjeve kur ballkanoidi tregoi fytyrën e tij të errët. Kujtojmë se leximi i *Safahatit* është detyrim i ndërgjegjes jo vetëm për njerëzit e fushës, pra letrarët, por edhe për çdo intelektual e person që synon një vizion pak më sublim, tejhedonist e tejpragmaticist.

Përkundër punës së frytshme dhe shumë të mundimshme që kishte bërë përkthyesi i saj, i ndjeri dr. Mithat Hoxha, duke qenë një vepër që është shkruar në kapërcyell të kthesës së letërsisë osmane në atë turke, s’do mend se kjo kishte prodhuar edhe një varg problemesh, gjuhësore e teknike, por edhe të tjera që kishin ardhur si pasojë e kuptimeve ekuivoke semantike të fjalëve, shprehjeve e vargjeve. Për këtë qëllim njohësit e mirë të turqishtes, por edhe të shqipes e të osmanishtes, prof. Metin Izeti dhe prof. Ali Pajaziti, iu rrekën krahasimit të kësaj vepre fjalë për fjale, duke kërkuar nëpër fjalorë e leksikonë kuptimet më të drejta të vargjeve të kësaj vepre. Kjo, natyrisht, nuk kaloi pa telashe. Madje, këto probleme filluan që nga titulli i saj, duke pasur shumë interpretime, e deri në shpjegimet e shumta të fjalëve, të cilat duhej zgjidhur. Prandaj, sipas rekomandimit të dy redaktorëve, u vendos që titulli i këtij botimi të mos jetë më *Fletët*, siç ishte në botimin e parë, por të jetë *Safahat*, ndërsa titulli *Fletët* në këtë botim do të shërbejë vetëm si nëntitull ose shpjegim i Safahatit. Arsyeja e kësaj është interpretimi shumëdimensional i fjalës *safahat* nëpër fjalorë të ndryshëm dhe hezitimi nëse e kemi qëlluar kuptimin që e ka pasur në mend autori kur e ka titulluar veprën asisoj. Që nga: *fletët*, *faqet*, *shtatë librat*, *fazat*, *periudhat*, *rrjedhat*, të gjitha janë kuptime që lidhen me fjalën *safahat* dhe, për t’iu shmangur gjykimit arbitrar, vendosëm që atë ta lëmë në kuptimin e saj origjinal. Vetëm ashtu jemi të sigurt se nuk kemi gabuar. Në të vërtetë kjo dëshmon edhe pamundësinë e përkthimit të saktë të një vepre poetike enciklopedike, siç është *Safahati*, dhe të një autori kaq të pakapshëm, siç është Mehmet Akif Ersoji.

Megjithëse është bërë një punë e madhe, gjithsesi nuk pretendojmë se ia kemi dalë deri në fund që këtë vepër ta sjellim në gjuhën shqipe ashtu siç tingëllon dhe funksionon ajo në gjuhën turke. Por, kësaj radhe jemi pak më të qetë se, falë kësaj pune, mund të besojmë se tash lexuesi shqiptar do të mund ta nuhasë më mirë aromën e kësaj vepre madhore, e cila konsiderohet kryevepra e kulturës poetike turke.

E nxitur nga çka u tha më sipër, Shtëpia Botuese “Logos-A” nga Shkupi, ka vite që me delikatesë synon të bëjë vjeljen e këtyre vlerave dhe ato t’ia prezantojë kulturës shqiptare. Si rrjedhojë e këtij koncepti kjo shtëpi botuese e ka botuar veprën *Safahat* në gjuhën shqipe si dhe shumë vepra nga autorë të tjerë që i përkasin proviniençës osmane dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë qasje në kulturën shqiptare.

Ardhja e Mehmet e Akifit në gjuhën shqipe nuk paraqet vetëm një shqipërim të tij në këtë gjuhë, por për më tepër një kërkesë dhe sfidë për kritikën letrare shqiptare që këtë varg madhështor të artistëve shqiptarë



ta vendosë në hallkën e gjatë të kulturës shqiptare, në mesin e atyre shkrimtarëve shqiptarë të shekullit që shkoi, qoftë kjo edhe duke hapur një faqe të re në letërsinë shqipe. Vepra e Mehmet Akifit, *Safahat*, synon të dëshmojë se, edhe përkundër vetëdijes tonë të amullt rreth zhvillimit tonë historik kulturor, lidhjet kulturore shqiptare sa janë të fuqishme me Oksidentin, mbase po aq janë të lidhura edhe me Orientin, me të cilin ka bashkëjetuar më shumë se pesë shekuj.

Ky botim i *Safahatit* e prezanton Pejanin në frymën e tij, duke e bërë atë të flasë shqip me gjithë tharmin dhe tërheqjen e vet origjinale që e gjen refleksionin te populli të cilit i drejtohet, me hallet e të cilit identifikohet gjithnjë, në gjuhë e në të shkruar. Kujtojmë se kjo vepër duhet të shndërrohet në objekt studimi të profileve të ndryshme shkencore, në veçanti të atyre letrare e sociologjike, gjithnjë në shërbim të bartjes sa më cilësore të mesazhit të saj në gjuhën tonë, duke synuar shoqërimin pozitiv, pra të mirën e të gjithëve.

Në fund e ndjejmë të nevojshme t'i shprehim mirënjohje të përzemërt prof. dr. Numan Kurtullmush, Kryetar i Kuvendit të Madh Popullor të Republikës së Turqisë, që e bëri të mundur realizimin e këtij projekti madhor.

Në emër të Logos-A

Adnan Ismaili

Janar 2024

Kronologjia



KRONOLOGJIA JETËSORE E MEHMET AKIF ERSOJIT

- **20 dhjetor 1873:** Lindi në mëhallën Sarëgyzel të lagjes Fatih. Babai i tij i vë emrin “Ragëjf” që tregon ditëlindjen e tij sipas përlllogaritjes ebxhed.
- **Shkurt 1878:** Në moshën katër vjeçare, nis të mësojë në shkollën Emir Buhari në lagjen Fatih.
- **1879:** Nis mësimet në shkollën fillore të lagjes Fatih. Në të njëjtën kohë, nga babai i tij merr mësimet të gjuhës arabe.
- **1882:** Regjistrohet në shkollën qendrore *ryshdije* të lagjes Fatih. Nis të marrë mësimet të *Mesnevisë* nga Dede Esati. Po ashtu fillon të lexojë veprën *Lejla dhe Mexhnuni* të Fuzuliut.
- **1885:** Futet në Shkollën *Mylkije*.
- **1888:** Ndërron jetë babai i tij Tahir Efendiu.
- **13 maj 1889:** Shtëpia në Sarëgyzel ku ai banon merr flakë dhe digjet. Ai i kryen tre vitet e liceut të shkollës *Mylkije* dhe kalon në pjesën e arsimit të lartë të kësaj shkolle. Me diplomimin e tij në fund të vitit 1889 ai regjistrohet në Shkollën e Veterinarisë e cila u hap po atë vit, me mendimin se mund të gjejë më lehtë një punë.
- **22 dhjetor 1893:** E kryen me rezultate shumë të mira Shkollën e Veterinarisë.
- **28 dhjetor 1893:** Boton poezinë e tij të parë në revistën *Hazine-i Fünûn*.
- **1894-1898:** Gjatë këtyre katër viteve punon në rajone të ndryshme të Rumelisë, Anadollit dhe Arabisë.
- **1 shtator 1898:** Martohet me zonjën Ismet, vajzën e Mehmed Emin beut, arkëtari i Fabrikës së Armëve.
- **17 tetor 1906:** Emërohet si mësues i shkrimeve zyrtare në Fakultetin e Veterinarisë.
- **25 gusht 1907:** Emërohet si mësues i gjuhës turke në Shkollën e Makinistëve të Fermave.

- **1 gusht 1908:** Regjistrohet në Komitetin e Bashkimit dhe Progresit (Ittihat ve Terakki Cemiyeti). E refuzon tekstin e betimit të këtij komiteti.
- **27 gusht 1908:** Botohet revista *Siratimustakim*. Pronarët e revistës janë Ebulula Zejnelabidin (Mardin) dhe Eshref Edip (Fergan). Pas datës 8 mars 1912, kjo revistë nis të botohet me emrin *Sebilürreşad* duke qenë vetëm nën pronësinë e Eshref Edipit.
- **24 nëntor 1908:** Emërohet profesor i letërsisë osmane në Universitet.
- **1910:** E dërgon në Haxh nënën e tij, zonjën Emine Sherife.
- **Prill 1911:** Botohet libri i parë (*Safahat*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **Shtator 1912:** Botohet libri i dytë (*Süleymaniye Kürsüsünde*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **11 maj 1913:** Jep dorëheqjen nga detyra si ndihmësdrejtor i Zyrës së Veterinerisë në shenjë proteste ndaj largimit pa të drejtë nga puna të drejtorit të kësaj zyre, z. Abdullah. Në fund të po këtij viti jep dorëheqjen si profesor në Universitet për shkak se revista *Sebilürreşad* ku ai shkruante përmbante shkrime kundër qeverisë së Komitetit për Bashkimit dhe Progres (Ittihat ve Terakki).
- **Qershor 1913:** Botohet libri i tretë (*Hakkın Sesleri*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **3 janar 1914:** Nis udhëtimin e tij në Egjipt. Itinerari i këtij udhëtimi është Stamboll-Bejrut-Kajro-Luksor-Kajro-Medine-Damask-Stamboll.
- **Mars 1914:** Kthehet nga udhëtimi i Egjiptit; vazhdon të shkruajë në revistën *Sebilürreşad*.
- **Gusht 1914:** Botohet libri i katërt (*Fatih Kürsüsünde*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **Shtator 1914:** Nis të ligjërojë lëndët e gjuhës turke dhe letërsisë në medresenë *Dar’ul Hilafeti’l Alijje*.
- **Mars 1915:** Dërgohet me punë në Berlin. Në vitin 1915, në fillim të muajit mars, kthehet në Stamboll.



- **Maj 1915:** Për shkak të marrëveshjes së Sherif Hysejinit me anglezët, shkon në Rijad me delegacionin e kryesuar nga Eshref Senxher Kushçubashë për t'u takuar me Shejh Ibnurreshidin i cili i kishte qëndruar besnik Shtetit Osman. Viziton për herë të dytë qytetin e Medines.
- **Tetor 1915:** Kthehet në Stamboll pasi përfundon udhëtimin e tij në Arabi.
- **25 nëntor 1915 -**
 - **11 maj 1916:** Revista *Sebilürreşad* nuk botohet për një periudhë gjashtëmuajore. Shkaku për këtë është mungesa e letrës dhe e parave.
- **26 tetor 1916 -**
 - **4 korrik 1918:** Revista *Sebilürreşad* nuk botohet për njëzet muaj me radhë. Qeveria nuk lejon daljen në treg të revistës dhe e mbyll atë.
- **1917:** Botohet libri i pestë (*Hatıralar*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **31 maj 1918:** Shtëpia e tij në Sarëgyzel digjet për herë të dytë. Familja e tij e kalon dimrin e atij viti në Hejbeliada.
- **1919:** Në muajt e verës kalon nga Hejbeliada në Çengelkej.
- **Janar 1920:** Nga fundi i muajit janar niset për në Ballëkesir së bashku me Eshref Edipin. Me anë të predikimit që mban në Xhaminë e Zaganos pashait, ai e thërret popullin t'i bashkohet Luftës Çlirimtare kundër armikut.
- **10 prill 1920:** Në fillim të muajit prill niset për në Ankara për t'iu bashkuar Luftës Çlirimtare së bashku me djalin e tij dymbëdhjetë vjeçar Eminin dhe Z. Ali Shykry (deputet i qytetit të Trabzonit). Deri në Adapazar shkojnë me kuaj dhe më pas mbërrijnë në Ankara me tren. Sapo zbresin nga treni nisen menjëherë drejt Parlamentit. Mustafa Kemal Ataturku të cilin e takojnë përpara Parlamentit i thotë Mehmet Akif Ersojit: "*Po ju prisja zotëri. Keni ardhur në kohën e duhur. Tani nuk kam mundësi të takohemi e të bisedojmë, por do të vij vetë që t'ju takoj...*".

- **30 prill 1920:** Me anë të predikimit të ditës së Premte që mban në Xhaminë e Haxhi Bajramit në Ankara, ai e thërret popullin t'i bashkohet Luftës Çlirimtare kundër armikut.
- **5 qershor 1920:** E merr në dorë procesverbalin që e njofton se është përzgjedhur deputet i Burdurit. Shkon në qytetet: Eskishehir, Burdur, Sandëklle, Dinar, Afjon, Antalja, Konia dhe Kastamonu si deputet i Burdurit për t'i siguruar mbështetje Luftës Çlirimtare kundër armikut.
- **Tetor 1920:** Predikimi që mbajti në Xhaminë e Nasrullah Kadiut në Kastamonu pati një jehonë të madhe në të gjithë vendin. Komandanti Nihad pashai, duke e botuar këtë predikim në shtypshkronjën e Dijarbakirit, e shpërndan atë në të gjithë frontet e luftës në vilajetet e: Elazigut, Dijarbakërit, Bitlisit dhe Vanit.
- **7 nëntor 1920:** Kthehet në Ankara nga Kastamonu së bashku me Eshref Edipin.
- **Dhjetor 1920:** Ministria e Arsimit hap konkursin për Himnin e Pavarësisë.
- **1 mars 1921:** Mehmet Akif Ersoj e lexon në Parlament Himnin e Pavarësisë që ai vetë e ka shkruar.
- **12 mars 1921:** Himni i Pavarësisë i shkruar nga Mehmet Akif Ersoji pranohet zyrtarisht në Parlament si "Himni Kombëtar" i vendit.
- **Maj 1923:** Pas fitores së Luftës Çlirimtare, Mehmet Akif Ersoji kthehet në Stamboll së bashku me familjen e tij, e cila vendoset në një shtëpi në mëhallën Çakalltepe në Bejlerbej.
- **Tetor 1923:** Shkon në Egjipt së bashku me Abbas Halim pashain. Dimrat e viteve 1923 dhe 1924 i kalon në Egjipt. Në pranverë kthehet në Stamboll së bashku me Abbas Halim pashain.
- **Gusht 1924:** Botohet libri i gjashtë (*Âsım*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **Fundi i vitit 1925:** Me këmbënguljen e Ahmet Hamdi Aksekilisë pranon që të përgatisë nisjen e përkthimit të Kur'anit. Më pas shkon në Egjipt dhe qëndron atje deri në vitin 1936.




- **Fillimi i vitit 1926:** Nis përkthimin e Kur'anit.
- **1926:** Nëna e tij zonja Emine Sherif ndërron jetë në moshën nëntëdhjetë vjeçare.
- **Dhjetor 1929:** Në Universitetin e Kajros nis punën si profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Turke.
- **Dhjetor 1929:** Përfundon dorëshkrimin e përkthimit të Kur'anit.
- **Dhjetor 1931:** Për shkak të përpjekjeve që Kur'ani të lexohej në gjuhën turke (gjatë namazit), vendos të heqë dorë nga përkthimi i Kur'anit dhe të drejtat që ai kishte nga ky përkthim.
- **1932:** Me anë të përfaqësuesit të tij i dërgon Bashkësisë Islame Turke (Dijanetit) dokumentin ku njoftohej dorëheqja e tij nga përkthimi i Kur'anit si dhe njëmijë lirat që ai pati marrë më parë për këtë punë.
- **Dhjetor 1933:** Botohet libri i shtatë (*Gölgeler*) i veprës *Fletët (Safahat)*.
- **1934:** Ndërron jetë Abbas Halim pashai, miku i Mehmet Akif Ersojit.
- **1935:** Udhëton për në Liban dhe Antakja.
- **Qershor 1936:** Mehmet Akif Ersoj, sëmundja e të cilit po përparonte, nis për në Stamboll me anije. Pasi marrjes së një trajtimi mjekësor për njëzet ditë në Spitalin e Shishlit, ai kthehet në apartamentin e tij në lagjen Bejollu. Gjatë kthimit në Stamboll nuk e kishte marrë me vete përkthimin e Kur'anit.
- **27 dhjetor 1936:** Mbrëmjen e së dielës në orën 19:45 ndërron jetë në moshën 63 vjeç.
- **28 dhjetor 1936:** Ditën e hënë trupi i tij i pajetë që përcillet nga Xhamia e Bejazitit pas namazit të ylesë duke u mbajtur në duart e studentëve të tij të Universitetit, varroset në Varrezat e Edirnekapësë. Në vitin 1960 varri tij transferohet në Varrezat e Dëshmorëve të Edirnekapësë.



PARATHËNIE





MEHMET AKIF ERSOJ JETA DHE VEPRAT

Jeta

Lindi në fund të vitit 1873 në Stamboll, në shtëpinë e familjes së tij që ndodhej në lagjen Sarëgyzel të zonës Fatih. Data sipas kalendarit hixhri, shevval 1290, rastis mes datave 22 nëntor – 20 dhjetor 1873.

I ati i vuri emrin Ragëjf i cili, sipas vlerës shkronjore dhe sistemit të numërimit me kronograme, tregonte vitin e lindjes. Mirëpo, të afërmit dhe njerëzit e mëhallës që s'u mësuan dot me shqiptimin e këtij emri të padëgjuar, filluan ta thërrisnin Akif (Aqif) dhe kështu i mbeti, por i vetmi që deri para se të vdesë i ishte drejtuar me emrin e tij, ishte babai i tij.

Vitet e fëmijërisë dhe shkollës

I ati i tij ishte Tahir Efendi (1826-1888), myderris në medresenë Fatih; kurse e ëma, Emine Sherife Hanëm (1836-1926). I ati pati ardhur në Stamboll në moshë të vogël nga fshati Shushicë i kazasë së Pejës (Kosovë) për të marrë arsim.

Në fillim të muajit shkurt 1878, kur ishte rreth katër vjeç e gjysmë, sipas traditës, Mehmet Akifin e regjistruan në shkollën Emir Buhari të mëhallës.

Pas afro dy vjet mësimesh në këtë shkollë, në fund të vitit 1879, Mehmet Akifi kaloi në Iptidajen e Fatihut, në shkollën fillore. Po këtë vit, i ati filloi t'ia mësonte arabishten.

I ati i Mehmet Akifit, Tahir Efendiu, ishte, në të njëjtën kohë, mësues privat i familjes së Myhyrdar Emin Pashait (vd. 1908). Ai u jepte mësim djemve të Emin Pashait, *Ibnulemin** Mahmud Kemal (1870-1956) dhe Ahmed Tevfik si dhe fëmijëve të tjerë të familjes. Këto mësimë zhvilloheshin dimrit

* Ibnulemin: të bijtë e Emin Pashait – Shqipëruesi.
Shumica e shënimeve janë të autorit të kësaj parathënieje, ndërsa disa nga shënimet i ka bërë dhe i ka përshtatur shqipëruesi. (shënim i botuesit)



në Konakun Emin Pasha në zonën Bakërzhëllar dhe verës, në Qoshkun (vilën) në Jakaxhëk. Me këtë pretekst, verës, Tahir Efendiu bartej me gjithë familjen në dhomat e vilës së Jakaxhëkut. Mehmet Akifi merrte pjesë në seancat mësimore të vëllezërve Ibnulemin dhe, për t'i shoqëruar ata gjatë verës, shkonte dhe rrinte në Jakaxhëk.

Pasi mbaroi shkollën fillore trevjeçare, në vitin 1882, Mehmet Akifi filloi mësimet në ryshdijen (uniken) e qendrës të Fatihut. Ndërkaq, mësimet arabishte me të atin vazhdonin. Veç kësaj, ndiqte edhe mësimet e persishtes dhe të veprave *Gylistan* (Saadi) dhe *Mesnevi* (Xh. Rumi) që jepte Esat Dedei në xhaminë Fatih. Mehmet Akifi i cili ishte shumë para moshatarëve në turqisht dhe në frëngjisht, tregonte se ishte i talentuar në përvetësimin e gjuhëve.

Në vitet e ryshdijes, M. Akifi iu zgjua kureshtja për poezi dhe ai nisi të lexonte libra me poezi. Ai tregon vetë se libri i parë poetik që lexoi, qe *Lejlaja dhe Mexhnuni* i Fuzuliu. Bashkë me shokun e klasës, Ibnulemin Mahmud Kemal, përpiquej të shkruante vjersha. Më 1885, pasi M. Akifi e mbaroi ryshdijen trevjeçare, i ati e la të lirë në zgjedhjen e profesionit. Atëherë, M. Akifi zgjodhi Shkollën Mylkije^{*} dhe u fut në liceun civil mylkije idadisi që ishte hapur si shkollë përgatitore për Mylkijen, ku studioi deri në vitin 1889.

Hoxhë (Mësuesi) Tahir Efendiu nga Peja

I ati i M. Akifit, Tahir Efendiu vdiq në fund të vitit 1887 ose në fillim të vitit 1888. Vdekja e këtij personi të cilin nxënësi i tij, Ibnulemin, e cilësonte si njeri të mirë e të pastër, të virtytshëm, besëtar, bujar, me dinjitet, altruist, mjeshtër i përkryer i orientuar në rrugë të drejtë,^{**} e dëmtoi rëndë familjen shpirtërisht, moralisht dhe materialisht. Dihet se Tahir Efendiu i cili qe martuar në moshën dyzetepesëvjeçare dhe, pas Akifit, pati edhe një vajzë, sillej me shumë dhembshuri ndaj familjes.^{***} Nga fjalët e shkruara nga M. Akifi dyzetvjeçar për të atin kuptohet se sa qe kujdesur Tahir Efendiu për të birin Akifin dhe se sa e pati dashur atë: "... Ai qe edhe babai, edhe hoxha (mësuesi) im. Çfarëdo që di, prej tij e kam mësuar..."^{****}

Në pranverën e vitit 1889 kur familja e Emin Pashait shkoi në vilën verore të Jakaxhëkut, ashtu si më parë, edhe kësaj radhe i morën me vete edhe fëmijët e hidhëruar të të ndjerit Tahir Efendi. Por ditën e parë të ramazanit

* Mektebi Mylkije: Shkolla e Lartë e Administratës.

** Në origjinal: Sâlih, Fâdil, vefî, sahî, âlîcenab, mürüvvetkâr, müstakîm bir üstâd-ı kâmil.

*** E ëma e M. Akifit e kishte martesë të dytë këtë me Tahir Efendiun. Asaj i patën vdekur tre fëmijët me burrin e parë. Edhe shtëpia në Sarëgëzël ku banonte familja, ishte e saj e mbetur nga burri i parë.

**** *Fletët*, libri i tretë, Zërat e së Vërtetës, poshtëshënimi f. 281. Poeti bën fjalë për të atin në poezinë "Xhamia Fatih" dhe në disa vende të poezisë "Asimi", veçanërisht në hyrje.

(13 maj 1889), u erdhi lajmi se shtëpia në Sarëgyzel ishte djegur. Familja pa baba kishte mbetur edhe pa shtëpi!

Por, ish nxënësi besnik i Tahir Efendiut, Mustafa Sidki Efendiu, nxitoi në ndihmë të familjes së ish mësuesit, ndërtoi për ta një shtëpi të vogël mbi truallin e shtëpisë së djegur dhe e shpëtoi familjen e mbetur pa shtëpi.

Atë vit, M. Akifi e kreu idadijen dhe kaloi në pjesën e lartë të mylkijes. Ndërkaq, kishte shumë nxënës që e kishin kryer këtë shkollë, dhe jo vetëm që e kishin të vështirë të gjenin punë, por edhe rrogën e kishin të ulët.

M. Akifi, familja e të cilit ndodhej në gjendje të vështirë ekonomike, duke e menduar këtë, vendosi të kalonte në shkollën e veterinarisë që sapo ishte hapur dhe i kishte filluar mësimet në fund të atij viti. Nxënësve që e kryenin këtë shkollë të parë të veterinarisë civile, do t'iu jepej punë menjëherë.

Shkolla katërvjeçare veterinare u hap në shkollën mjekësore civile në Ahërkapë. Nxënësit e parë të shkollës veterinare që mësuan dy vitet e para këtu si nxënës ditorë, në vitin 1891 kaluan në ndërtesën e re të shkollës në Hallkallë ku i vazhduan dy vitet e tjera si konviktorë.

Poet dhe sportist

Gjatë mësimeve katërvjeçare në shkollën e veterinarisë, M. Akifi mori mbresa pozitive nga mësuesit, shumica e të cilëve ishin mjekë dhe teologë, dhe shkoi me të njëjtën dëshirë si në laborator, ashtu dhe në xhaminë e shkollës.

M. Akifi u mor shumë me poezi veçanërisht në dy vitet e fundit të shkollës. Ai filloi të shkruante shumë poezi duke imituar letërsinë e *Divanit* dhe u shkroi shokëve letra të gjata në vargje. Më vonë, duke mos i pëlqyer shkrimet e këtyre viteve, i asgjësoi të gjitha.

Në po ato vite, M. Akifi u mor shumë edhe me sport dhe nisi të mernte pjesë në mundjet popullore (pehlivan) në fshatrat përreth zonës ku ndodhej shkolla. Ai pati dalë gjithmonë i pari ndër moshatarët në vrapimet e gjata e të shkurtra, në hedhjen e gjyles dhe në not. Këtë pasion për sportin ai e vazhdoi edhe në vitet pas shkollës. Ai e pati kaluar Bosforin me not dhe kishte bërë vrap nga mëngjesi deri në darkë. Dihet se në Ankara, edhe pse ishte pesëdhjetëvjeçar, vazhdonte të bënte sport. Në të njëjtën kohë, M. Akifi ishte edhe një kalorës i mirë. Ne mendojmë se interesimi i madh i M. Akifit për sportet ishte rezultat i vetëdijes së tij fetare sipas së cilës meshkujt muslimanë duhet të jenë gjithmonë të gatshëm fizikisht dhe praktikisht për luftë.



Vitet e para të veterinarisë dhe botimet e para

Më 22 dhjetor 1893, M. Akifi e kreu fakultetin e veterinarisë duke zënë vendin e parë. Pastaj, më 26 dhjetor, bashkë me shokun e klasës, Simonin, i cili kishte dalë i dyti, u emërua ndihmësinsektor veteriner.

Më 28 dhjetor 1893, M. Akifi botoi një gazel në revistën *Hazine-i Funun* (“Thesari i shkencave”). Ky gazel mbetet ende vepra e parë e botuar e M. Akifit.

Ndërsa qendrën e punës e kishte në Stamboll, gjatë katër vjetëve deri më 1898, M. Akifi udhëtoi si inspektor në zona të ndryshme të shtetit osman, si në: Rumeli, Anadoll dhe Arabi, duke qëndruar për një kohë të shkurtër a të gjatë në qendra të ndryshme. Gjatë kësaj kohe, punoi si inspektor veterinarie në Edrene dhe si veteriner vilajeti në Adana. Kuptohet se duke e pasur qendrën në këto dy qytete, ai ka udhëtuar dhe ka kryer detyra edhe në zonat përreth. Në maj të vitit 1896 shkoi në Damask me detyrë zoolog.

Ata që e kanë njohur nga afër, kujtojnë se në vitin 1894, M. Akifi e kreu hifzin pranë Hafiz Isa Efendiut në medresenë Tabhane, prej të cilit mori edhe mësimë arabishteje dhe, më në fund, mori diplomë me notë të plotë. Gjithashtu, mori edhe mësimë private në frëngjishte.

Gjithashtu, dihet se mësimin e arabishtes dhe frëngjishtes e vazhdoi edhe më vonë përkatësisht me miqtë e afërt Ahmed Naim dhe Mehmet Shevket, me të cilët stërviteshin në leximin e teksteve të vështira arabishte, dhe me Haki dhe Bajtar Ibrahimin.

M. Akifi botoi edhe një gazel tjetër në numrin e datës 18 tetor 1894 të revistës *Hazine-i Funun*. Ka shumë mundësi që edhe në revista të tjera të asaj kohe të ketë botime të tij ende të panjohura.

Disa poezi dhe një kompozim poetik të quajtur *terkipibend* të shkruara gjatë kohës së qëndrimit në Edrene janë gjetur në fletoren e një merakliu poezie nga Edreneja.

Poezitë dhe përkthimet

Në revistën *Mektep* (“Shkolla”) të datës 14 mars 1895, u botua poezia me titull *Kur’an’a Hitap* (“T’i drejtohesh Kur’anit”). Po atë vit, në revistën *Gayret* (“Zelli”) që botohej në Filipopolis (Plovdiv), u botuan disa poezi dhe një terkipibend.

Pandehet se i M. Akifit është edhe vargu i shkrimeve të përkthyer me titull *Mebahis-i İlm-i Servet* (“Mbi ekonominë politike”) të mbetura pas

botimit të shtatë pjesëve të tyre me nënshkrimin Sa'di në numrat maj-gusht 1895 të revistës *Maarif* (“Edukimi publik”).

Poezitë e M. Akifit nisën të dalin në *Resimli Gazete* (“Gazeta e Ilustruar”) pas numrit të saj të 61-të të datës 10 shkurt 1898. Pas këtij numri, ky organ vazhdoi të nxirrej nga një ekip letrarësh, mes të cilëve ishin Ibnulemin Kemal, i vëllai dhe M. Akifi. Është vlerësuar se në këtë gazetë kanë dalë deri më njëzet e pesë poezi të tij. Këto poezi nuk janë futur prej tij në *Safahat*.

Vepra *Uranie* e Camille Flammarion-it e përkthyer nga M. Akifi u botua në seri në numrat gusht-dhjetor 1898 të “Gazetës së Ilustruar”.

Në tre numra të revistës *Serveti Fünun* të dalë në nëntor-dhjetor 1898 u botuan tre shkrime të M. Akifit nën titullin e përbashkët *Bedayi’ül-Acem*. Në këto shkrime kishte përkthime pjesësh në prozë e poezi nga Sadiu të bëra prej tij.

Jeta martesore

M. Akifi u martua më 1 shtator 1898 kur ishte njëzetepesë vjeç, kurse nusja Ismet Hanëm, e bija e veznedarit (arkëtarit) të Tophane-i Amire, Mehmed Emin Bej, ishte njëzet vjeçe.

M. Akifi pati shtatë fëmijë, nga të cilët tre të parët ishin vajza. Fëmija i katërt i vdiq një vjeç e gjysmë. Sipas radhës, emrat e fëmijëve të tij janë: Xhemile, Feride, Suad, Ibrahim, Naim, Emin, Tahir.

Pas dasmës, çifti i porsamartuar qëndruan afro një muaj në *konakun* e *veznedarit*, pastaj shkuan në shtëpinë e nënës së M. Akifit dhe më pas, pasi u lindi fëmija i parë, dolën në shtëpi me qira. Dihet se ata i ndërruan shpesh shtëpitë me qira dhe se këtë ndërrim disa herë e bënë për të qenë pranë miqve të M. Akifit.

Në moshën 28-29 vjeçe, M. Akifi lëshoi mjekër.

Më 17 tetor 1906, M. Akifi u emërua mësues i turqishtes zyrtare.

Më 25 gusht 1907 u emërua mësues i gjuhës turke në Shkollën e Mekanikës Bujqësore (Çiftçilik Makinist Mektebi).

Kushtetuta dhe lëvizja Ittihad ve Terakki

Kur më 23 korrik 1908, në shtetin osman u shpall Kushtetuta e Dytë, M. Akif Ersoji ndodhej me punë në Stamboll si ndihmësdrejtor i Zyrës së Veterinarisë (Umûr-Baytariye Dairesi).



Shoqata *Bashkim e Përparim* (“Ittihad ve Terakki”) që punonte prej vitesh si një organizatë revolucionare e fshehtë kundër pushtetit të Sulltanit, pas shpalljes së Kushtetutës së Dytë filloi të bënte anëtarësime të hapura. Kjo shoqatë premtoi se do t’i sillte vendit një liri legjitime (hürriyet-i meşrua), se do ta shpëtonte vatanin që po rrokullisej në fatkeqësi, se do t’i reformonte ushtrinë dhe administratën, arsimin dhe medresetë. Megjithëse kësaj shoqate ende nuk i njiheshin forcat dhe mundësitë, përballë gjendjes shumë të keqe të vendit, bashkë me pothuaj të gjithë intelektualët, atë e shihnin si një shpresë dhe e mbështesnin edhe teologët dhe shejhët e teqeve.

Ndërkaq, M. Akifi i cili nuk qe interesuar për këtë shoqatë sa kohë që ajo ndodhej në ilegalitet, pranoi të bëhej anëtar, siç kuptohet, me dëshirën për të marrë pjesë në veprimtaritë e saj edukative-arsimore që do të ishin të dobishme për popullin. Dihet se, menjëherë pas anëtarësimit, M. Akifi filloi të jepte mësimë arabishteje në një klub të shoqatës dhe se mësimet e metodës së përkthimit të sjella prej tij u pëlqyen shumë nga studentët e medresesë dhe të universitetit që filluan t’i ndiqnin ato.*

Në ditën e dhjetë të shpalljes së Kushtetutës, M. Akif dhe një grup shokësh të tij u regjistruan në shoqatë nga ana e Fatin Gökmenit (1878-1954).

Siç tregon Fatin Gökmen i cili ishte një ittihatçi i vjetër, M. Akifi, pasi kishte dëgjuar prej tij sqarimet e nevojshme për shoqatën dhe kishte pranuar të anëtarësohej, nuk kishte pranuar që, në ceremoninë e anëtarësimit, të bënte “betimin” e kërkuar. Duke mos e pranuar shprehjen e “bindjes pa kushte ndaj urdhrave të shoqatës”, M. Akifi kishte thënë: “Unë u bindem vetëm urdhrave të shoqatës për të mirë”. Unë nuk mundem të pretoj bindje absolute!”

Fatin Bej i cili e njihnte që më parë M. Akifin nga poezitë e tij që kalonin dorë më dorë, e ndryshoi me mendjen e vet formulën e betimit siç donte M. Akifi, gjë që në fillim shkaktoi një thashetheme të gjerë mes shoqatës, e më pas u bë shkak për ndryshimin zyrtar të betimit.

* Deri më tani nuk dihet që M. Akifi të ketë marrë pjesë në ndonjë veprimtari tjetër të shoqatës *Bashkim e Përparim*, veç këtyre veprimtarive kulturore. Dhe nuk duhet harruar se M. Akifi u bë anëtar i shoqatës dhe jo i fraksionit politik që do të krijohet më vonë. Pasi shoqata u kthye në parti politike dhe dolën sheshit veprimtaritë e properëndimorëve, fraksionistëve dhe interesaxhinjve në gjirin e saj, M. Akifi me shokë kaluan në opozitë. Fakti që *Sebilurreshad* u mbyll disa herë prej tyre, është argument i kësaj.

** Në origjinal është shprehja *emr-i ma'ruf* që do të thotë “e mirë dhe e drejtë për Zotin dhe njeriun”.

Revista Siratimustakim

Më 27 gusht 1908 filloi të botohej revista *Siratimustakim* (“Ruga e Drejtë”). Drejtuesit e kësaj reviste javore e cila njihet më shumë me emrin e mëvonshëm të saj, *Sebilur’reshad*, kanë qenë Ebulula Zejnelabidin (prof. Ebulula Mardin, 1881-1957) dhe diplomanti jurist Hafiz Eshref Edib (Fergan, 1883-1971). Revista merrej me: fe, filozofi, letërsi, drejtësi dhe shkencë teorike.

Duke filluar nga numri i 183-të i saj (8 mars 1912), kjo revistë ku ishin mbledhur intelektualët muslimanë, filloi të botohej vetëm nga Eshref Edib me titullin *Sebilur’reshad*.

Në vitet e Luftës për Shpëtimin Kombëtar, revista vazhdoi të botohej në Ankara, Kastamonu dhe Kajseri dhe në vitin 1925, në numrin 641, u mbyll. Revista ridoli më 1948 dhe, pasi u botuan edhe 362 numra të saj, në shkurt të vitit 1966 botimi i saj u ndërpre.

M. Akif ishte autori kryesor dhe kryeredaktori i revistës. Aty janë botuar pothuajse të gjitha poezitë dhe shkrimet e tij. Në disa poezi dhe shkrime ai përdori pseudonimin Sadi, kurse disa poezi të tij kanë dalë pa nënshkrim. Ka shumë mundësi që një pjesë me rëndësi e shkrimeve anonime të revistës të jenë bërë nga M. Akifi.

Në numrin e parë të revistës ndodhej poezia Xhamia Fatih. Gjatë vitit 1908, pothuaj në çdo numër, doli njëra prej poezive të tij të pabotuara por të njohura si të tij nga dashamirët dhe amatorët e poezisë. Mes këtyre ndodheshin poezitë I sëmuri, Kofini, Rrogozi, Mejhanja dhe Sejfi Babai.

Nga ana tjetër, M. Akifi bënte përkthime. Në shtatëmbëdhjetë numra të revistës mes datave 10 shtator-31 dhjetor, ai botoi të përkthyer poezinë *Femra muslimane* të Ferid Vexhdi-ut.

Më 24 nëntor 1908, M. Akifi u emërua pedagog i letërsisë osmane në kursin e parë të Katedrës së Letërsisë të Akademisë së Shkencave.**

Pas poezive dhe përkthimeve, më 18 nëntor u botua shkrimi i parë me emrin e tij, me titull: “Një sihariq me rëndësi për studentin e Akademisë së Shkencave”***.

* Edhe kjo fjalë ka pothuaj të njëjtin kuptim.

** Në origjinal: *Dârülfünûn*, Universitet ose Akademi e Shkencave.

*** Në origjinal: *Dârülfünûn Talebesine Mühim Bir Tebşir*.



NGJARJA E 31 MARSIT

M. Akifi vazhdoi të botonte poezi edhe në vitin 1909. Këtë vit dolën poezitë “Njeriu”, “Despotizëm”, “Liria”, “Atdheu i të dashurës”, “Arif Hikmet Hercegovasi”, “Djaloshi Dirvas” dhe “Piktori ka të drejtë”.

Gjatë vitit 1909 u botuan edhe përkthimet e artikujve të ndryshëm të Abduhut, *Hanoto dhe Islami* që doli në seri në pesëmbëdhjetë numra dhe përkthimi po ashtu në seri në njëzet e një numra i *Hadikai Fikrije* të Ferid Vexhdiut.

Gjatë këtij viti hasim përsëri në një artikull me nënshkrimin e M. Akifit, me titull “Nuk dimë as të imitojmë”.

Gjatë kryengritjes së 31 marsit (13 prill 1909), *Siratimustakim* nuk doli dot për njëzet e pesë ditë.

Artikujt

Gjatë vitit 1910 kur u botuan poezitë e njohura të tij, si “Gruaja plakë dhe Omeri”, “Kafeneja e mëhallës” dhe “Imami Qose”, M. Akifi shkroi më se njëzet e pesë artikuj me tema letrare dhe shoqërore.

Po atë vit, botoi përkthimin e disa artikujve nga Muhamed Abduhu dhe Azmzade Refik si dhe veprën e njohur të Abduhut, *Komenti i sures Asr* që e përktheu po atë vit.

Në vitin 1911 nuk botoi poezi tjetër veç një poezie të gjatë me nënshkrimin “Sadi” dhe dy poezive të shkurtra pa nënshkrim. Këto nuk i futi më pas në *Safahat*.

Të njëjtin vit dolën tre artikuj origjinalë dhe një përkthim i gjatë. Vepra *Müslümanlıkta Medeniyet* (“Qytetërimi në fenë islame”) që e përktheu nga Ferid Vexhdi, u botua në seri në tridhjetë numra.

Safahati i parë

Vëllimi i parë i përmbledhjes së tij poetike, *Safahat*, që përmbante dyzet e dy poezi të botuara më parë në *Siratimustakim* bashkë me një poezi prej dhjetë rreshtash në vend të parathënies, u botua brenda muajit prill 1911. (*Safahat, birinci kitap, İstanbul 1329, 272 sayfa, Siratimustakim matbaası*)

Meqë një pjesë e poezive të librit, ku qenë botuar më parë në revistë, mbanin titullin e përgjithshëm *Safahat-ı Hayattan* (“Nga periudhat e jetës”).

Në qyrsinë* e Sulejmanijes

Në gjysmën e parë të vitit 1912, poezia *Në qyrsinë e Sulejmanijes* prej 1.002 vargjesh u botua në seri në shtatë pjesë, kurse si libër u botua në muajin shtator. (*Istanbul, Ramazan 1330, 61 sayfa, Sebilurreshad Kütüphanesi:1*)

Dy poezi që i shkroi atë vit nuk i futi në *Safahat*.

Në krye të vitit 1912, Ebulula (Mardin), njëri prej pronarëve të revistës *Siratimustakim* u largua nga revista. I mbetur vetëm, Eshref Edibi e ndërroi emrin e revistës në *Sebilurreshad*.

M. Akifi që vazhdoi të shkruajë gjatë tërë këtij viti, shkroi dhjetë artikuj, nga të cilët, nëntë me temë nga letërsia. Shkrimet e shkruara si përgjigje për librin Corci Zeydan (Xhorxhi Zejdani) të Shejh Shibli en-Numani, i përktheu me titullin *Medeniyet-i İslamiye Tarihi'nin Hataları* ("Gabimet e historisë së qytetërimit islam") dhe i botoi në dhjetë numra.

Tefsiret ose komentet

Duke filluar nga numri i 183-të kur revista mori emrin *Sebilurreshad*, M. Akifi shkroi tefsire të shkurtra me titull *Tefsir-i Şerif*, ku ajetet dhe hadithet i ka trajtuar dhe shpjeguar lidhur me problemet e kohës. Numri i komenteve rreth ajeteve kur'anore që shkroi gjatë vitit 1912 është tridhjetë e dy.

Në pjesën e parë të librit *Mevaiz-i Diniye* ("Ligjërata fetare") të botuar në muajin shtator 1912 nga ana e "İttihad ve Terakki Cemiyeti Şehzadebaşı Kulübü Hey'et-i İlmiyesi", doli edhe një shkrim i M. Akifit me titull: "*İttihad Yaşatır Yükseltir, Tefrika Yakar Öldürür*" ("Bashkimi jep jetë e lartëson, përçarja djeg e vdes"). Ka shumë mundësi që ky shkrim të jetë teksti i një fjalimi të mbajtur prej tij më parë në klub.

M. Akifi i cili vazhdoi të shkruante komente edhe në vitin 1913, shkroi edhe pesëmbëdhjetë shkrime të tjera si këto, nga të cilat, dymbëdhjetë në vargje. Këto dhe tefsiret në vargje që i shkroi më vonë, i përmblodhi në *Zërat e së Vërtetës* dhe *Kujtimet*.

Më 1913 shkroi pesë artikuj dhe filloi botimin e poezisë *Në qyrsinë e Fatihut* me plot 1.692 vargje. Kjo vepër u nda për botim në njëzet e tetë pjesë, nga të cilat, gjashtëmbëdhjetë pjesët e para u botuan brenda atij viti. Pjesa e mbetur u plotësua gjatë vitit 1914, pasi M. Akifi shkoi në Egjipt dhe u kthye që andej.

* Qyrsi: katedër nga ku ligjëron vaizi.



Në muajt e parë të vitit 1913 dhe gjatë ditëve fatkeqe të humbjes së Luftës Ballkanike, M. Akifi ligjëroi para popullit të Stambollit në tre xhamitë më të mëdha të Stambollit. Tekstet e këtyre predikimeve të mbajtura në xhamitë Bajazit, Fatih dhe Sulejmaniye, janë botuar në *Sebilurreshad*.

Më 11 maj 1913 e la detyrën e veterinerit ku pati punuar për njëzet vjet me radhë. Në këtë çast, ai ndodhej me detyrën e ndihmës drejtorit të Zyrës Veterinare. Shkaku i dorëheqjes ishte pushimi i padrejtë nga puna i drejtorit Abdullah Bej.

Në fund të vitit 1913, M. Akifi mbeti i detyruar të jepte dorëheqjen edhe nga detyra në Akademinë e Shkencave. Meqë *Sebilurreshadi* bënte botime në opozitë me pikëpamjet dhe politikën e qeverisë së partisë Bashkim e Përparim, anëtarët e partisë nuk donin që M. Akifi të ligjëronte në fakultet.

Zërat e së Vërtetës

Në fillim të muajit qershor 1913, u botua Libri i tretë i *Safahatit: Zërat e të vërtetës*. (Istanbul, Selanik matbaası, Receb 1331, 64 sayfa, Sebilurreshad Kütüphanesi Neşriyatı: 7)

Hanoto'nun Hücumuna Karşı Şeyh Muhammed Abduh'un İslam'ı Müdafaası e përkthyer nga M. Akifi dhe e botuar në seri në revistë në fund të vitit 1909, u botua si libër gjatë vitit 1913. (Istanbul 1331, 80 sayfa, Sebilurreshad Kütüphanesi Neşriyatı: 8)

Edhe leksionet që kishte dhënë në katedrën e Letërsisë së Akademisë së Shkencave të Stambollit, filluan të botohen në vitin 1913 nën titullin *Kavaid-i Ebediye* dhe u botua formati i tyre i parë. (Istanbul 1329, 16 sayfa, Siratimustakim matbaası, Darülfünun Dersleri.)

Udhëtim për në el-Uksur (Luksor)

Në ditën e tretë të janarit 1914, M. Akifi u nis për në udhëtimin e Egjiptit i cili do të vazhdonte dy muaj. Deri në fillim të marsit, ai përshkoi itinerarin Stamboll-Bejrut-Luksor-Kajro-Medine-Damask-Stamboll.

Mbresat dhe ndjenjat që i la ky udhëtim, M. Akifi i shprehu në poezinë “Në Luksor” që mban datën 28 janar 1914 dhe që u botua një vit më pas, më 11 shkurt 1915.

Në fillim të marsit 1914, pas kthimit nga udhëtimi i Egjiptit, M. Akifi vazhdoi të shkruajë poezi dhe shkrime të tjera në *Sebilurreshad*; ai botoi pjesët e mbetura të poezisë *Në qyrsinë e Fatihut*. Veç kësaj, dolën nga

botimi një përkthim i bërë nga Ferid Vexhdi dhe gjashtë tekste komentesh të verseteve kur'anore. Tre shkrime në vargje nga këto komente u futën më vonë në librin *Kujtimet*.

M. Akifi që marrë vesh me *Islimjeli Hasan Tahsin Beun*, të cilin e kishte pasur shok klase në shkollën e veterinarisë dhe e donte shumë, që, atij që do të vdiste i pari, i mbeturi gjellë do t'i kujdesej për familjen.

I pari vdiq Hasan Beu në vitin 1910 kur ishte inspektor veterinar në Edrene dhe M. Akifi, i cili ishte gjithmonë besnik, e mori përsipër kujdesin dhe mirërritjen e tre fëmijëve që i la miku. Djalin e madh, Xhevdetin, e futi në shkollën e veterinarisë. Djali vdiq në fillim të majit 1914 kur ndodhej në klasën e tretë. Ai kishte qenë një fëmijë shumë i zgjuar i cili në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç kishte shkruar artikuj shkencorë dhe mbi higjienën e shëndetit në *Sebilurreshad* me nënshkrimin “Müntesibîn-i Tıbdan Ahmed Cevdet” (“Kandidati për mjek Ahmed Xhevdet”).

Në qyrsinë e Fatihut

Në fillim të gushtit 1914 u botua libri i katërt i *Safahatit: Në qyrsinë e Fatihut*. (*Istanbul, Ramazan 1331, 102 sayfa, Tevsî-i Tıbâat matbaası, Sebilürreşâd Kütüphânesi Neşriyâtı, aded: 23.*)

Gjatë vitit 1914 u bë edhe botimi i dytë i këtij libri. Në botimin e dytë, në dallim nga i pari, është vetëm shënimi “botimi i dytë”.

Në fund të muajit shtator 1914 u bë botimi i dytë i librit të dytë, *Në qyrsinë e Sulejmanijes*.

Gjithashtu, në shtator 1914, pasi filloi të zbatohet programi i “reformës së medreseve”, M. Akifi filloi të ligjëronte nga dy orë mësim të letërsisë turke në javë në klasat e gjashta e të shtata të medresesë Dâr'ül-Hilâfeti'l-Aliyye.

Në fund të vitit 1914, M. Akifi mori pjesë në një ekip të dërguar nga shteti me detyrë në Berlin, nga ku, pasi qëndroi rreth tre muaj, u kthye në Stamboll në gjysmën e parë të marsit 1915.

Udhëtimi në Berlin

Gjermanët që ishin aleatë të turqve, kishin mbledhur në kampe të posaçme robërit muslimanë të luftës që kishin marrë pjesë në ushtritë franceze, ruse dhe angleze dhe kishin rënë rob tek ta. Robërit e mbledhur në këto kampe trajtoheshin mirë, madje, për ta ishte ndërtuar një xhami.



Duke u treguar osmanëve që ishin lideri i muslimanëve, në sjelljen e tyre të mirë ndaj robërve, gjermanët kishin dashur edhe të bënin një gjest ndaj Halifit (sulltanit), dhe të tregonin besnikërinë ndaj aleancës me ta.

Me këto qëllime ishte ftuar nga gjermanët ekipi (delegacioni) ku merrte pjesë edhe M. Akifi.

Një koment në vargje (“O Zot, që ke shumë kohë që po na jep mësim”) dhe poezia *Uyan* (“Zgjohu”) që M. Akifi i shkroi në Berlin dhe i dërgoi që andej, u botuan në *Sebilurreshad* përkatësisht në datat 14 janar dhe 18 shkurt 1915. Edhe poezia *Në el-Uksur* që e shkroi nën frymëzimin e udhëtimit një vit më parë në Egjipt, doli në numrin e revistës të datës 11 shkurt.

Dy përkthime të bëra nga Abdylaziz Xhavish, u botuan në tre numra në muajt prill dhe maj 1915.

Kujtimet e Berlinit

Poezia prej 796 vargjesh *Kujtime Berlinit* që M. Akifi i shkroi nën frymëzimin e udhëtimit në Berlin, filloi të botohej duke filluar nga 8 prilli 1915 në *Sebilurreshad*. Në këtë poezi të rëndësishme të botuar në dhjetë pjesë seriale, M. Akifi, pasi tregon për padrejtësitë e shteteve kolonialiste përëndimore ndaj kombeve muslimane dhe për qëndrimin indiferent dhe soditës të Europës e cila përdorte dy standarde vlerësimi, si dhe pasi numëron të këqijat e tyre, përcakton shkaqet ideore e shoqërore të gjermanëve që përpiqeshin e punonin të bashkuar për t’u fuqizuar dhe parashtron sëmundjet shkaktare të dobësisë, çorientimit dhe copëtimit të shoqërisë osmane ku sundonte një vlerësim dhe trajtim i gjërave krejt në kundërshtim me ç’ndodhte në Gjermani.

Gjashtë pjesët e para të *Kujtimeve të Berlinit* u botuan në vitin 1915, një pjesë, më 1916 dhe tri pjesët e fundit, në vitin 1918. Në pjesën e nëntë (29 gusht 1918) ku bëhet fjalë për dëmet e shkaktuara shoqërisë nga letërsia e keqe, M. Akifi atakon snobët properëndimore antifetarë dhe shkrimtarin dhe ideologun Tefvik Fikret.

Çështja Akif-Fikret

Ndërsa tri pjesët e fundit të *Kujtimeve të Berlinit* nuk qenë botuar në revistën *Sebilurreshad* për shkak se qeveria e partisë Bashkim e Përparim e pati mbyllur për njëzet muaj me radhë revistën mes viteve 1916-1918,

* Në shqip, kjo poezi mban titullin “O Zot, mos na ngarko me sa s’mund të mbajmë!”

botimi i parë i librit *Kujtimet* që bërë, por, siç u tha më lart, pjesa e nëntë që stigmatizonte snobët dhe Tevfik Fikretin, s'që futur në të.

Në vitin 1918 kur *Sebilurreshad* rifilloi së botuari, këto pjesë u botuan me radhë dhe teksti i *Kujtimeve të Berlinit* në revistë u plotësua. Ja, këtë herë u botua edhe satira prej 98 vargjesh e *Kujtimeve*, e pafutur këtu as në botimin e dytë, me atë që vendi i saj ishte lënë bosh me një vijë të pikëzuar dhe me një poshtëshënim.

Po të vërehet me kujdes, kjo satirë e pafutur në botimet e *Kujtimeve* të datave shtator 1917 dhe mars 1918, pas ridaljes së *Sebilurreshadit*, u botua në numrin e saj të 29 gushtit 1918. Kjo situatë përgënjeshton pretendimin se M. Akifi nuk e kishte futur satirën-përgjigje prej 98 vargjesh i penduar që e kishte shkruar.

Mendimi ynë mbi këtë çështje është se këto 98 vargje nuk u futën në dy botimet e para të veprës nga frika se mos ittihatçinjtë properëndimorë dhe përkrahës ideologjikë të Fikretit, të cilët ishin në pushtet, do ta mblidhnin edhe librin megjithëse ky ishte aq i nevojshëm si mbështetje morale për popullin që ndodhej në luftë. Ky rrezik u hoq në korrik 1928 dhe poezia u botua në revistë. Kurse shkaku pse këto vargje nuk u futën në botimin e vitit 1918 të *Kujtimeve*, është i qartë, sepse qeveria e asaj kohe e cila ishte më fanatike se ittihatçinjtë në përkrahjen e Fikretit dhe në antifetarizmin e saj, bënte çmos për ta mësuar popullin turk me atë lloj jete të cilën M. Akifi e stigmatizonte në satirën e tij. Ndërkaq, poezia “Tarihi Kadim” (“Histori e vjetër”) e T. Fikretit ishte si një përmbledhje e sistemit “besimor” të regjimit të ri!

Pasi paraqitëm përmbledhtazi çështjen e quajtur “Çështja Akif-Fikret” në këtë kontekst ngjarjesh, në radhitjen e të cilave shpesh bëhet gabim, le ta shohim shkurt ecurinë e konfliktit mes këtyre dy poetëve.

Tevfik Fikret dhe “Tarihi Kadim”

Siç dihet, T. Fikret, poezinë e tij “Tarihi Kadim” (“Histori e vjetër”) prej dyqind e dymbëdhjetë vargjesh e shkroi më 28 prill 1905. I përshkuar gjithandej nga një ndjenjë neverie dhe pesimizmi të thellë, ai sulmon çdo gjë duke filluar nga historia e deri te gjërat e konsideruara të larta e të shenjta nga njerëzit dhe e mbyll poezinë e tij duke e mohuar ekzistencën e Zotit. Si rezultat i propagandës së zhvilluar dinakërisht nga disa mjedise ateiste dhe fytyra të fshehta të cilit e dinin mirë se si duhet të përfitonin nga T. Fikreti nëpërmjet popullaritetit të tij dhe ndikimit të fuqishëm të poezisë së tij të shkruar me mjeshtëri, ky “traktat blasfemie” la mbresa të thella mbi



intelektualët dhe të rinjtë e asaj kohe që e lexonin. M. Akifi e shpreh këtë fakt me vargun “Sabîlerin yûreğinden kopardı îmânî” (“e këputi besimin nga zemra e foshnjave”)!

Tarihi Kadim, që në vitet para Kushtetutës njihej vetëm nga të afërmit e autorit të saj Tevfik Fikret, pas 1908-ës, më saktë, pas 1910-ës kur ka mundësi të jetë botuar, u bë shkak për polemika të shumta. E botuar si broshurë e vogël 16-faqesh, mbi të nuk shënohet as vendi i botimit, as data e botimit, as dhe emri i autorit. Thuhet se botimin e ka bërë – në kundërshtim me dëshirën e autorit – një person i cili e ka marrë poezinë nga Riza Tevfik, i cili e ka përgatitur kopjen për botim.

M. Akifi qe njohur me Tevfik Fikretin, të cilit ia kishte pëlqyer poezitë më parë, më 1908 në Fakultetin për Letërsi ku punonin të dy si pedagogë. Por nuk e dimë se kur e pati parë M. Akifi poezinë e tij, “Tarihi Kadim”.

Kur vaizi në qyrsinë e Sulejmanijes, duke radhitur hallet e vendit, e sjell fjalën te letërsia dhe letrarët, thotë: “... Letrarët tuaj, sidomos, qenie mjaft të ulëta...”. Pastaj, me shprehje të figurshme, thotë se, ndërsa poetët e vjetër, duke imituar letërsinë e Iranit, u këndonin verës dhe djemve homoseksualë, poetët e rinj, duke imituar poetët e perëndimit, u këndojnë birrës dhe kurvave. Dhe vazhdon:

Endacakë: askush s’ka profesion, as botëvështrim;

Të gjithë filozofë, por shumica s’kanë as shkollë!

Tani shan Allahun... Pastaj, jepi pak pará,

Protestantëve u bëhet kambanar!

Këto vargje të dala nga shtypi më 22 gusht 1912 e akuzonin Tevfik Fikretin i cili kishte mohuar historinë, traditat dhe, më në fund, Allahun, për mungesë sinqeriteti sepse punonte në Kolegjin Robert, një institucion ky misionar që përfaqësonte dhe përpiquej të përhapte një fe dhe traditë konservatore, e akuzonin jo si një ateist parimor dhe me ide të lira, por vetëm si një “hutaq të paturpshëm”, armik të Islamit dhe vlerave të kombit të vet!

Tevfik Fikret u dha përgjigje këtyre vargjeve dy vjet më pas, në fund të vitit 1914, me një poezi prej tetëdhjetë vargjesh me titull “Târîh-i Kadîm’e Zeyl” (“Shtojcë për Historinë e vjetër”). Nën titull ndodhej dedikimi “Molla Sırat’a” (Molla Sırat-it)*. Tevfik Fikret i cili vdiq më 19 gusht 1915, nëntë muaj pas shkrimit të kësaj shtojce, shprehte të njëjtat ide të vetat por këtu me një forcë dhe ashpërsi më të madhe, si dhe e pohonte hapur mosbesimin

* Me këtë dedikim ironik, autori e quan M. Akifin mulla, hoxhë me shkollë, por pa ndonjë vlerë. Ky ngjyrim nënvleftësues i qe dhënë, me kohë, kësaj fjale si në mjedisin turk, ashtu dhe atë ballkanik.

ose ateizmin e tij. Siç ndodhi me poezinë e parë, edhe kjo poezi-shtojcë la mbresa të thella mbi intelektualët properëndimorë dhe ateistë. Që të dyja poezitë janë ribotuar më vonë shumë herë me radhë nga individë dhe grupe që kanë dashur të përhapin ide antifetare duke përfitur nga ndikimi i Tevfik Fikretit mbi rininë që ia këndonte poezitë. Nuk është i rastit fakti që *Histori e vjetër* e Tevfik Fikretit është ndër librat e parë që u botuan pas reformës së alfabetit më 1928.

Përgjigja e M. Akifit

Ja, pra, pikërisht për shkak të efekteve të dëmshme të poezisë së parë dhe shtojcës që M. Akifi, pas katër vargjeve që shkroi më 1912, duke thënë, brenda *Kujtimeve të Berlinit*, se letërsia turke e vjetër dhe e re nuk i solli dobi popullit, i dha vend të gjerë *Historisë së vjetër*, duke shkruar, këtë radhë, një kritikë të gjatë e të ashpër në formën e një satire therëse:

Por të poshtrit që e kanë nxjerrë nderin në tellall,

Nuk e kanë gjetur ende gati mjedisin për ndyrësi;

Forma letrare e kodoshllëkut s'bëri punë

.....

*Thanë e iu drejtuan për ndihmë kambanarit.**

Ky fragment prej nëntëdhjetë e tetë vargjesh i *Kujtimeve të Berlinit* u botua në revistën *Sebilurreshad* të datës 29 gusht 1918. Ky fragment është pjesa e nëntë e kësaj poezie dhe ka dalë tre vjet pas vdekjes së Tevfik Fikretit. Në fund të poezisë qëndron data 18 mars 1915, por ne, duke parë se botimi i pjesës së parë është bërë më 8 prill 1915, nuk pandehim se *Kujtimet e Berlinit* ka qenë mbaruar që më parë dhe, duke kaluar dorë më dorë, ka mundësi të jetë parë nga Tevfik Fikreti, sepse gjatë udhëtimit të M. Akifit në Nexhd, botimi serial i poezisë, nga e cila qenë botuar deri atëherë pesë pjesë, qe ndërprerë. Po të kishte qenë mbaruar, botimi i saj do të vazhdohej. Kurse T. Fikreti vdiq kur M. Akifi ndodhej në udhëtim.

Andryshoi mendimi i M. Akifit?

Siç kuptohet, M. Akifi iu përgjigj me katër vargje *Historisë së vjetër* prej dyqind e dymbëdhjetë vargjesh të T. Fikretit dhe, për katër vargjet, mori një përgjigje prej tetëdhjetë vargjesh. Kurse nëntëdhjetë e tetë vargje që i botoi më vonë, i shkroi për të turpëruar, më shumë se personin e T. Fikretit,

* Këto vargje janë jashtë *Safahatit*.



mendësinë e tij si dhe ata që i merrnin dhe i shpërndanin me një etje të madhe shkrimet e tij:

U jap të drejtë të rinjve... sepse tri lopë pa tru

E shkruan dhe e shpërndanë

Atë manifest të mallkuar kryengritjeje...

Thuhet se M. Akifi u pendua për vargjet ku e quante T. Fikretin kambanar^{*} dhe për përgjigjen e gjatë të mëpastajme, madje, për këtë shkak, përgjigjen e gjatë nuk e futi në botimet e *Kujtimeve* si libër më vete. Më sipër treguam se këto thënie nuk kishin të bënin me të vërtetën. Rreshtat e mëposhtëm do të tregojnë se ato nuk kishin të bënin as me besimin, idetë dhe karakterin, të njohura këto, të M. Akifit.

Siç dihet, vargjet ku përdorej fjala *kambanar* janë te poezia *Në qyrsinë e Sulejmanijes* dhe këtë vepër M. Akifi ia ka dedikuar Fatin Hoxhës. Në lidhje me këtë çështje, Fatin Gökmen Bej thotë kështu: *“U përpoqa shumë për ta nxjerrë vargun e shkruar kundër T. Fikretit në predikimin me titull “Në qyrsinë e Sulejmanijes” që M. Akifi ma kishte dedikuar mua. Më në fund, ai më tha: “Po deshe, të ta heq emrin dhe të shkruaj ‘një miku’!”*

Udhëtimi për në Nexhd

Në mesin e muajit maj të vitit 1915, M. Akifi mori pjesë përsëri me detyrë zyrtare në një delegacion të drejtuar nga Kushçubashë Eshref Bej, kryetar i Shërbimit Sekret. Synimi i këtij udhëtimi prej katër muaj e gjysmë në zonën Nexhd të Arabisë ishte Rijadi. Pasi u kuptua se Sherif Hysejni ishte marrë vesh me anglezët dhe se po bënte përgatitje për kryengritje, do të bëhej një takim mbi këtë çështje në qendrën shtetërore Rijad me Ibnurreshidin i cili i kishte mbetur besnik shtetit.

M. Akifi i cili pati mundësinë ta vizitonte Medinën për të dytën herë, me frymëzimin e kësaj vizite e shkroi poezinë *Nga shkretëtirat e Nexhdit në Medinë*, një nga veprat e tij poetike më të shquara. Por kjo poezi mundi të botohej në revistë vetëm më 4 korrik 1918. Ndërkaq, kjo poezi ishte futur në botimin e dytë të *Kujtimeve* tre muaj para kësaj date, kur revista ishte e mbyllur.

Në kthim, M. Akifi vizitoi edhe Damaskun me Bejrutin dhe, në fillim të tetorit 1915, arriti në Stamboll.

^{*} Në original: zangoç.

Mbyllja e Sebilurreshadit

Viti 1916 u bë një vit i vështirë për revistën *Sebilurreshad* dhe autorët e saj. Pas numrit të saj të 352-të të datës 25 nëntor 1915 të botuar pas kthimit të M. Akifit nga udhëtimi i Nexhdit, kur doli pjesa e gjashtë e *Kujtimeve të Berlinit*, e deri më 11 maj 1916, revista e pezulloi veprimtarinë për gjashtë muaj. Kjo gjendje u shpjegua në numrin e 353-të me krizë letre dhe mungesë mundësish financiare.

Kur botimi i revistës *Sebilurreshad* që zbriti në tetë faqe dhe përpiquej të dilte herë pas here, arriti në një numër në javë, në numrin e 360-të me datë 26 tetor 1916 u pezullua krejtësisht dhe nuk u botua fare për njëzet muaj, deri më 4 korrik 1918. Por kur ridoli, shkaku i kësaj ndërprerjeje nuk u shpjegua. Vetëm u shkrua se nuk doli “sepse u pezullua” dhe se mundi të dilte përsëri “pas heqjes së censurës”. *Sebilurreshad* ishte mbyllur për shkak të ideve që mbronte.

Në numrin e tetë të revistës që mundi të dilte gjatë vitit 1916, u botuan një poezi e M. Akifit (pjesa e shtatë e *Kujtimeve të Berlinit*) dhe përkthimet e tij të shkrimeve “Hilafet-i İslamiye” (“Hilafeti Islam”) dhe “Alem-i İslam’ın Hastalıkları ve Çareleri” (“Sëmundjet dhe rrugëzgjdhjet e botës islame”) të Abdylaziz Xhavishit.

Pse u mbyll revista?

Po të kihet parasysh se qeveria ushtronte presion të ashpër mbi opozitarët me anë të një administrimi arbitrar, se, ndërsa vendi përpëlitej në papasje e varfëri që bënte kërdrinë gjithandej, ajo mbyllte sytë ndaj agjentëve të tregut të zi dhe se pasanikët e luftës, përkrahës të partisë Ittihad ve Terakki (Bashkim e Përparim) në pushtet qenë bërë të padurueshëm, mund të merret me mend lehtësisht se, në këto kushte, qeveria nuk do të mund të pajtohej me një revistë që i bënte dhe do t’i bënte opozitë për të gjitha këto çështje, për më tepër, me një revistë me ndikim të madh. Megjithëkëtë, shkaku i vërtetë të mbylljes së revistës e kishte qenë mosmarrëveshja mes lëvizjes ideore islamike të përfaqësuar nga M. Akifi me shokë, dhe grupit të intelektualëve racistë-properëndimorë të cilët ishin ata që e përcaktonin ideologjinë dhe botëkuptimin e lëvizjes Bashkim e Përparim.

Në këtë mes, ideja e turqizmit (ose turanizmit) e parashtruar nga Zija Gokalp, i cili bënte pjesë në komitetin drejtues të shoqatës Bashkim e Përparim, dhe shokët e tij, u përvetësua nga qeveria në fuqi e cila, gjithashtu, ishte e lëvizjes Bashkim e Përparim, dhe u kthye në një lëvizje politike.



Kurse M. Akifi me shokë dolën me forcë kundër asaj që nacionalizmi të cilin mbështesnin ata si një lëvizje kulturore për lartësimin e çdo popullsie muslimane nga vetë intelektualët e saj, të merrte formën e një “racizmi” që do t’i përcante dhe copëtonte muslimanët.

Veç kësaj, shihej se një sërë autorësh properëndimorë nxirrnin botime kundër Islamit dhe në favor të “oksidentalizmit” dhe, madje, ateizmit.

Dihej, gjithashtu, se autorët në fjalë ose ishin anëtarë të grupeve masone si dhe të grupeve çifute të konvertuara në Islam për sy e faqe* që kishin ndikim të madh mbi shoqatën Bashkim e Përparim, ose merrnin mbështetje të madhe prej tyre.

Vetëm në numrin e revistës të datës 30 tetor të vitit 1924, Eshref Edib i solli një qartësim kësaj mbylljeje të revistës të vitit 1916 në një shkrim të tij ku bënte llogarinë e viteve të kaluara. Pasi shkruan se disa intelektualë ndër ittihadçinjtë kërkonin të bënin reformë në fe, por që në atë kohë ata vetëm sa i diskutonin mes tyre nëpër mbledhje këto gjëra pa i nxjerrë ende sheshit, thotë:

“... Ne i merrnim vesh që në atë kohë këto vendime, por a ishte e mundur të diskutohesh për to? Në atë kohë, me justifikimin sipas të cilit “nuk mund të flitet për fe në shekullin e njëzetë”, iu vunë prangat për dy vjet “Sebilurreshadit”...”

Mehmet Akifi dhe ittihadçinjtë

Disa ngjarje që ndodhën mes M. Akifit dhe titullarëve të qeverisë së lëvizjes Bashkim e Përparim gjatë situatës së luftës, para dhe pas mbylljes së revistës, jo vetëm nxjerrin në shesh marrëdhëniet e tij me politikanë dhe njerëz të mendimit të kësaj lëvizjeje,** por edhe tregojnë moralin dhe karakterin e njohur të tij.

Një ditë, ndërsa po rrinte në zyrat e revistës dhe po hante fasulen e sjellë nga shtëpia, te M. Akifi shkoi një person i ngarkuar me detyrë nga ministria e brendshme, i cili i solli këtë mesazh: “Ke të fala nga ministri, i cili të lutet të mos shkosh aq larg në shkrimet e tua!” Dhe M. Akifi i ktheu këtë përgjigje: “Thuaji ministrit tënd ta rregullojnë veten! Po vazhdoi kështu, nuk mund të na heshtin ne! Pasi të pranohet të ha fasule, unë s’frikësohem nga askush!”

* Në origjinal: *dönme, të kthyer*, çifutë të konvertuar në Islam në shek. XVII.

** Në origjinal përdoret më shpesh cilësimi i shkurtër *ittihadçi* që po e përdorim edhe ne aty-këtu.

Nuk duhet harruar se kjo përgjigje përkon me atë kohë kur titullarët e partisë dhe qeverisë së lëvizjes Bashkim e Përparim sillnin me anije luftime nga Stambolli akullore në gostitë e shtruara në ishullin Byjykada!

M. Akifi nuk e shihte me vend zhvillimin para syve të popullit të polemikës me Zija Gokalpin si pasojë e ideve dhe mendimeve të parashtruara prej tij. Ai nuk dëshironte që opinioni publik në konfuzion dhe i shqetësuar për shkak të luftës të tronditej më tej nga një polemikë e tillë. Me këtë mendim, M. Akifi shkroi një letër ku propozonte që *palët të mblihdeshin në një sallon të gjerë për t'i diskutuar çështjet mes tyre njëkohësisht duke u regjistruar diskutimet*. Këtë propozim të nënshkruar edhe nga disa prej autorëve të revistës *Sebilurreshad*, M. Akifi ia dërgoi Zija Gokalpit, por nuk mori përgjigje.

Pas mbylljes së *Sebilurreshadit*, një ditë, Talat Pasha i ftoi M. Akifin dhe Eshref Edibin në ministri. Duke e pasur fjalën për Zija Gokalpin dhe të pranishmit e tjerë, i tha kështu M. Akifit: “Akif Bej, a s'bën të merresh vesh me këta të Qendrës?” M. Akifi u ngrit me hov nga vendi, vuri dorën mbi tavolinën e ministrit dhe i tha me ashpërsi: “Për këtë na paske thirrur? Ç'do të thotë të merremi vesh? A mos kemi ne ndonjë qëllim personal? A mos na pandehe komisionerë tregtarë ne? Më vjen keq!” Dhe doli jashtë pa e përshëndetur.

Eshref Edib që e tregon ngjarjen, thotë se Talat Pasha e ndoqi nga pas me shikim të ngrirë M. Akifin, kurse Midhat Xhemali tha: “Po ai Akifi që njoha në Edrene, nuk paska ndryshuar fare!”

Libri “Kujtimet”

Në vitin 1917, revista *Sebilurreshad* nuk doli. Si libër, u botua libri i pestë i *Safahatit: Hatıralar* (“Kujtimet”). (*İstanbul, Zilhicce 1335, Necm-i İstikbâl matbaası, 78 sayfa*)

Poezia *Nga shkretëtirat e Nexhdit në Medine* që hyri në këtë libër më pas në botimin e dytë, në këtë botim nuk ndodhej. Kurse pjesët e fundit të *Kujtimeve të Berlinit* u futën në libër pa dalë në revistë meqë ajo ishte e mbyllur.

Pasi sulltan Vahdeddini hipi në fron dhe u hoq censura, revista që kishte njëzet muaj që qëndronte mbyllur, rifilloi nga botimi me numrin e saj të 361-të të datës 4 korrik 1918.

Në numrin e parë u botua e plotë poezia *Nga shkretëtirat e Nexhdit në Medine*, kurse deri në fund të vitit, nga M. Akifi dolën tri pjesët e fundit të *Kujtimeve të Berlinit* të padala në revistë dhe një koment ajeti në vargje. Veç



këtyre, M. Akifi shkroi dy artikuj dhe bëri katër përkthime nga Abdylaziz Xhavishi dhe një përkthim nga Ferid Vexhdi. Ndërkaq, në katër numrat e periudhës 15 nëntor-5 dhjetor, M. Akifi botoi të përkthyer nga frëngjishtja veprën e njohur të Said Halim Pashait, *Islâmlaşmak* ("Islamizimi").

Në korrik 1918, me ftesë të guvernatorit të Mekës, Sherif Hajdar Pasha, i cili në atë kohë banonte në Liban, M. Akifi shkoi bashkë me Izmirli Ismail Hakiun (1870-1946) si mik te pashai ku qëndruan një muaj.

Në Këshillin e Lartë Islam

Në këtë mes, në Stamboll u ngrit një institucion i quajtur Dârü'l-Hikmeti'l-Islâmiyye. Ky institucion i hapur më 12 gusht 1918, ishte një Këshill i Lartë Islam që mblidhte dijetarët dhe mendimtarët islamë të njohur të kohës.

M. Akifi ndodhej te pashai kur u emërua kryesekretar i Këshillit të Lartë Islam dhe, kur u kthye, filloi me punë. Pastaj, më 23 janar 1920, krahas detyrës si kryesekretar, u emërua anëtar i Këshillit. M. Akifi u shkarkua nga funksionet e Këshillit më 3 maj 1920 sepse ishte larguar pa leje. Ai i ishte futur Luftës për Shpëtimin Kombëtar dhe më 30 prill 1920, ditën e xhuma, kishte mbajtur *vaz* (predikim) në xhaminë Haxhi Bajram ku e kishte ftuar popullin në luftë.

Gjatë vitit 1918 u ribotuan disa nga librat e serisë së *Safahat: Zërat e të Vërtetës* dhe *Kujtime* dilnin me botimin e dytë, kurse *Në qyrsinë e Sulejmanijes* dhe *Në qyrsinë e Fatihut*, me botimin e tretë të tyre.

Zjarri i Fatihut

Për shkak të vështirësive ekonomike, për të mos dhënë qira, M. Akifi kishte pak kohë që banonte në shtëpinë e vogël të nënës në Sarëgyzel. Gjatë zjarrit të madh të zonës Xhibali-Fatih të vitit 1918, bashkë me shtatë mijë e pesëqind shtëpi, u dogj për së dyti edhe shtëpia e vogël në Sarëgyzel, nga e cila mbeti vetëm trualli. Pas kësaj, pasi e kaluan edhe dimrin 1918-1919 në ishullin Hejbealiada ku patën shkuar për verim, në verë u bartën në zonën Çengelkoj. Këtu banonte M. Akifi në fillim të prillit 1920 kur doli në rrugë për të marrë pjesë në Luftën për Shpëtimin Kombëtar. Pastaj, kur mbaroi lufta, u shpërnda Mexhlisi (Kuvendi) dhe ai u kthye në Stamboll në mars 1923, u bart në Bejlerbej dhe, prej aty, shkoi në Egjipt.

Viti 1919, si për të gjithë muslimanët, u bë një vit vuajtjesh edhe për M. Akifin me shokë që banonin në Stamboll. Kur Anadolli Perëndimor dhe pjesë të ndryshme të vatanit hynë nën pushtimin dhe dhunën e armikut, revista

Sebilurreshad u përpoq me të gjitha shkrimet e saj të krijonte në popull durim, shpresë dhe guxim. Ndodhte që, për shkak të censurës së fuqive pushtuese, disa faqe të revistës të dilnin gjysmë për gjysmë të bardha.

Botimi serial i “Asimit”

Duke filluar nga 18 shtatori 1919, M. Akifi filloi nga botimi i veprës më të madhe e më të rëndësishme të tij, poezia *Asimi*. Gjatë këtij viti u botuan dhjetë fragmente të poezisë. Në shtatëmbëdhjetë fragmente të dala me ndërprerje gjatë viteve 1919-1924, u botua pjesa prej 1.086 vargjesh e poezisë, kurse pjesa prej 1.206 vargjesh hyri në botimin e librit në vitin 1924. E tërë poezia përbëhet prej 2.292 vargjesh. Shkrimi i *Asimit* vazhdoi gjatë gjithë viteve 1919-1924. Këtë vepër poetike të cilën M. Akifi e pëlqente dhe e vlerësonte edhe vetë, ua pati lexuar disa herë me radhë miqve gjatë ditëve të Ankarasë.

Në shkrimin e vetëm të nënshkruar të dalë më 10 prill 1919, M. Akifi bëri prezantimin e veprës *Islamizimi* të Said Halim Pashait të botuar si libër. Në këtë mes, Said Halim Pasha, i quajtur “fajtor luftime dhe evakuimi”, ndodhej i arrestuar bashkë me ish ministra, oficerë dhe burra shteti të tjerë. Pashai u gjykua në Gjykatën e Luftës të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe më 20 maj u internua nga anglezët në ishullin e Maltës.

Predikim në Ballëkesir

Viti 1920 u bë viti i fillimit të veprimtarisë për shpëtimin kombëtar në Anadoll. Në Ajvallëk dhe Ballëkesir të Anadollit Perëndimor u hap fronti i parë kundër forcave pushtuese greke që përparonin.

M. Akifi që ndodhej në Stambollin e pushtuar, në fund të janarit, bashkë me Eshref Edibin shkoi në Ballëkesir. Aty, në xhaminë Zaganoz Pasha, mbajti një predikim ku e ftonte popullin të ngrihej në luftë dhe t'i ndihmonte ata që luftonin. Teksti i këtij predikimi u botua në revistën *Sebilurreshad* të datës 12 shkurt.

Gjatë qëndrimit në Ballëkesir, M. Akifi u takua me ata që përkrahnin qëndresën dhe luftën, si dhe me parinë e qytetit. M. Akifi shkoi për vizitë edhe në Dârümuallimîn (Shkolla e Mësuesisë) bashkë me mikpritësin e tij, Hasan Basri Çantaj. Duke biseduar me nxënësit që e pyesnin se ç'mendim kishte për artin, M. Akifi u tha: “*Parimi i artit për art ka vdekur! Arti që nuk i vlen shoqërisë dhe jetës, u fundostë në fund të dheut!..*”



Qysh nga fillimi i vitit 1920, administrata e revistës *Sebilurreshad* u bë qendër e atyre që shkonin në Anadoll për të marrë pjesë në luftën për shpëtimin kombëtar, qendër e ndërlihdjes mes atyre që shkonin në Ankara dhe të afërmeve të tyre në Stamboll, si dhe e informimit sekret. Gazetat dhe letrat shkonin e vinin nga Anadoll në Stamboll nëpërmjet revistës. Disa vepra që mbështesnin luftën kombëtare shtypeshin fshehtas në shtypshkronjën e revistës dhe dërgoheshin në Anadoll.

M. Akifi shkon në Ankara

Duke marrë, më në fund, vendim për të shkuar në Ankara në fillim të prillit 1920, M. Akifi u largua nga Stambolli duke lajmëruar për këtë vetëm Eshref Edipin dhe dhëndrin Omer Riza. Fjalët që i tha Eshref Edipit para se të nisej, të japin përshtypjen se kjo vajtje në Ankara bëhej me kërkesën dhe ftesën e atyre që ndodheshin në udhëheqje të Luftës për Shpëtimin Kombëtar:

“Tashmë nuk është koha për të ndenjur këtu, por për të shkuar e punuar. Paska nevojë për ne, na thërrasin që ta sqarojmë popullin. Na thërrasin. Pa tjetër duhet të shkojmë! Unë nesër nisem për Ankara. Askush të mos e marrë vesh! Ti mbliidhi punët e administratës, merr klisenë e ‘Sebilurreshadit’ dhe eja pas meje...”

Siç tregon në kujtimet e veta i biri Emin që e shoqëroi në Ankara, sapo kishin zbritur nga treni në Ankara, kishin shkuar në Kuvend dhe atje, para hyrjes së Kuvendit, kishin takuar Mustafa Qemal Pashanë që po dilte për të shkuar diku. Fjalët që i kishte thënë Mustafa Qemal Pasha, M. Akifit, e mbështesnin shprehjen e tij “paskan nevojë për ne, na thërrasin...”:

“Ju ju prisja, zotëri, erdhët tamam në kohë, por tani nuk do të jetë e mundur të bisedojmë, unë do të vij tek ju!”

Sapo shkoi në Ankara, më 30 prill 1920, M. Akifi doli në predikim ditën e xhuma më 30 prill 1920 në xhaminë Haxhi Bajram. Pastaj, duke shëtitur të gjithë qytetet që mund të ndihmonin luftën kombëtare, me atributet e një burri më të besueshëm të Islamit në ato ditë, i tregoi popullit se Lufta për Shpëtimin Kombëtar nuk ishte një lëvizje e ittihadçinjve, se po ta humbnin edhe atë vatan që u kishte mbetur, nuk do t’u mbetej vend ku të shkonin, se ajo luftë nuk bëhej si tradhti ndaj fesë dhe padishahut, por ishte xhihad, luftë e shenjtë dhe fetarisht farz, detyrim, ua fshiu dyshimet njerëzve, i heshti revoltat dhe i ndezi zemrat.

Udhëtimi

Le ta përmbledhim udhëtimin e M. Akifit në Ankara duke u mbështetur në tregimet e të birit, Eminit:

Në mëngjesin e datës 10 prill 1920, pas namazit, M. Akifi u përshëndet me familjen, duke e marrë me vete të birin dymbëdhjetëvjeçar Eminin, doli nga shtëpia në Çengelkoj dhe u nis në këmbë për në varrezën Karaxhaahmed në Yskydar ku i priste me një pajton Ali Shukri Beu (deputeti i Trabzonit i cili më vonë ra dëshmor, 1884-1923). Me pajton, duke kaluar nëpër Kësëklle, shkuan në Alemdag. Aty hipën në kuaj në një çiflig ku ishin mbledhur luftëtarë të çështjes kombëtare dhe vazhduan rrugën nën shoqërimin e një kalorësi. Pasi e kaluan natën në një fshat, të nesërmen u nisën sërish në rrugë dhe, në zonën mes Izmitit dhe Adapazarit, takuan një karvan që shpinte armë për luftëtarët dhe u bashkuan me të. Në afërsi të Gejves hasën në Kushçubashë Eshref Beun dhe Jenibahçeli Shykry Beun. Më tej, së bashku me këta të dy u ndanë nga karvani dhe, si një grup prej pesë vetash, shkuan me dekovil në Eskishehir dhe, prej aty, me tren, në Ankara. Dihet se M. Akifi arriti në Ankara në javën e fundit të prillit. Për shkak se shkoi në Anadoll, u pushua nga detyra në Këshillin e Lartë Islamik më 3 maj 1920 me motivacionin “se ishte larguar nga detyra pa leje dhe ishte zhdukur”.

Deputet i Burdurit

Më 5 qershor 1920, M. Akifit mori mandatin e deputetit të Burdurit dhe u pranua në Mexhlis (Kuvend). Më 3 korrik i erdhi lajmi se ishte zgjedhur deputet edhe i Biga-s. Edhe ky mandat u pranua nga Mexhlisi, por M. Akifi që kishte shkuar më parë në Burdur dhe ishte takuar me popullin, më 18 korrik dha dorëheqjen nga mandati i Bigas duke zgjedhur mandatin e Burdurit.

Pas vajtjes në Ankara, M. Akifi shkoi në disa vende për ta orientuar popullin dhe, duke u takuar me parinë, për të siguruar mbështetjen dhe pjesëmarrjen e tyre materialisht dhe shpirtërisht në luftën kombëtare. Vendet ku dihet se ka qenë, janë: Eskishehir, Burdur, Sandëklle, Dinar, Antalja, Afjon, Konja, Kastamonu.

Në Kastamonu

M. Akifi kishte shkuar në Konja pasi kishte marrë lajm se atje po zhvillohej veprimtari kundër luftës kombëtare, ishte takuar me parinë e vendit dhe, në kthim, shkoi në Kastamonu.



Revista *Sebilurreshad* e cila nxori nga botimi numrin e 463-të të saj kur M. Akifi kaloi në Anadoll, pasi drejtuesi i saj mori pjesë në Luftën për Shpëtimin Kombëtar, i pati dhënë fund botimit të saj në Stamboll.

M. Akifi arriti në Kastamonu në mes të tetorit 1920 dhe u takua me Eshref Edibin që kishte ardhur aty disa muaj më parë. Në fakt, shkaku bazë i vajtjes së M. Akifit në Kastamonu ishte reflektimi në Mexhlis i një mosmarrëveshjeje të krijuar mes Eshref Edibit që kishte shkuar aty pranë të vjehrrit dhe drejtuesve të qytetit. M. Akifi u dërgua në Kastamonu me dëshirë të vet dhe i ngarkuar me detyrë nga Mexhlisi. M. Akifi qëndroi aty një muaj. Gjatë kësaj kohe, ai zhvilloi takime të shpeshta e të ngushta me popullin e qytetit, shëtiti edhe shumicën e kasabave dhe fshatrave përreth duke u shpjeguar njerëzve rëndësinë e lëvizjes së filluar kundër armikut.

Pas një ndërprerjeje prej shtatë muajsh, *Sebilurreshad* doli në Kastamonu me numrin e saj të 464-të më 25 nëntor 1920. Në Kastamonu dolën edhe dy numra të tjerë të revistës. Në revistë u botuan lajme dhe shkrime mbi bisedat dhe fjalimet mbi Luftën për Shpëtimin Kombëtar të mbajtura nga M. Akifi në qytet dhe rrethina. Në numrin e 464-të u botua predikimi i njohur i M. Akifit në *xhaminë Nasrullah*. Teksti i predikimit që zinte njëmbëdhjetë faqe të revistës, është dokumenti më i rëndësishëm që tregon se në ç'gjendje shpirtërore zhvillohej Lufta për Shpëtimin Kombëtar. Kurse në numrat e 465-të dhe 466-të u botuan përmbledhjet e bisedave të zhvilluara në kazatë e Kastamonusë.

Si rrjedhojë e botimit në të të fjalimit të Kastamonusë, numri i 464-të i revistës *Sebilurreshad* u ribotua disa herë dhe u shpërnda në Anadoll dhe nëpër fronte. Veç kësaj, teksti i predikimit u botua si material më vete në shtypshkronjën e vilajetit Diarbekir nga komandanti i el-Xhezires, Nihad Pasha dhe iu shpërnda popullit dhe të gjitha fronteve të vilajeteve Elaziz, Diarbekir, Bitlis, Van.

Në numrin e 468-të të revistës të botuar në Ankara u përmbledhën teksti i telegramit me falënderimet dhe lutjet e Nihad Pashait për M. Akifin si dhe përgjigjja e M. Akifit për pashain. Përgjigjja e M. Akifit ishte kjo:

“Me gjithë të drejtën time të varfër, marr guximin të falënderoj nga zemra Shkëlqesinë Tuaj të lartë! Miratimi dhe përkrahja juaj për kumtimin në xhaminë Nasrullah të këshillës drejtuar të gjithë vëllezërve tanë të fesë në atë zonë e në atë front janë seriozisht të denja për mirënjohje! I Madhi Zot i dhëntë fitore pas fitoreje ushtrisë sonë heroike, një shtyllë mjaft e çmuar e së cilës jeni ju, dhe e zgjeroftë dhe e fuqizoftë zgjimin që ka filluar të duket në bashkësinë islame! Amin, ashtu qoftë!” 16 shkurt 1337 (1921)

Në tre numrat e revistës të dalë në Kastamonu (25 nëntor, 3 dhjetor, 13 dhjetor) u botuan edhe pjesët 11-13 të *Asim-it*.

M. Akifi u kthye në Ankara bashkë me Eshref Edibin në fund të dhjetorit 1920.

Siç shkruan Eshref Edibi, pas kthimit nga Kastamonu, Mustafa Qemal Pasha i kishte ftuar atë bashkë me M. Akifin, kishte biseduar me ta, u kishte thënë se kishte dijeni për shërbimet që i bënë Luftës për Shpëtimin Kombëtar, kurse për fjalimet e M. Akifit në Kastamonu kishte thënë:

“Asnjë gazetë sa ‘Sebilurreshadi’ nuk mundi t’ia bëjë të qartë popullit se ç’vendim vrasës është për vendin tonë traktati i Sevrit! ‘Sebilurreshadi’ i ka bërë shërbim të madh fuqizimit të frontit tonë shpirtëror! Të dyve ju falënderoj posaçërisht!”

Himni i Pavarësisë

Revista *Sebilurreshad* filloi të dalë në Ankara me numrin e saj të 467-të të datës 3 shkurt 1921. Me përjashtim të numrit të 490-të (24 shtator 1921) të botuar në Kajseri, numrat 467-527 janë botuar në Ankara.

Në numrin e parë të dalë në Ankara u botua shkrimi i fundit si përmbledhje e fjalimeve dhe bisedave të bëra në zonën e Kastamonusë, kurse në numrin e 468-të u shtyp teksti i *Himnit të Pavarësisë*.

Me kërkesë të ushtarakëve, Ministria e Kulturës u dha gazetave të datës 7 nëntor një njoftim ku bëhej e ditur se: “shpallej një konkurs për Marshin e Pavarësisë dhe se për fituesin e tekstit dhe melodisë do të jepej nga një shpërblim prej 500 lirash”. Me një qarkore të veçantë, konkursi iu njoftua të gjitha shkollave.

Në qendrën e konkursit u paraqitën mbi shtatëqind tekste, por mes tyre nuk ishte ajo poezi që do të mund ta zgjonte ndikimin e dëshiruar. Atëherë, ministri i kulturës, Hamdullah Suphi me shokë iu drejtuan M. Akifit. Kurse M. Akifi, duke thënë se *nuk shkruante poezi me para*, i kthente mbrapsht propozimet. Kur i premtuan se nuk do t’i jepnin shpërblim edhe po të fitonte, M. Akifi e shkroi tekstin.

İstiklal Marşı (“Himni i Pavarësisë”) u lexua në TBMM (Kuvendi i Madh Popullor i Turqisë) më 1 mars 1921 dhe më 12 mars u pranua zyrtarisht. Himni u botua në gazeta, u shtyp mbi kartëpostale dhe fletëpalosje dhe u shpërnda në të gjithë vendin. Botimi i tij i parë është ai i revistës *Sebilurreshad* i datës 17 shkurt 1337 (1921).



Pasi zyra e llogarisë e parlamentit e njoftoi se shuma e shpërblimit ishte nxjerrë dhe e ftoi ta merrte e të bënte ç'të donte me të, M. Akifi i mori pesëqind lirat dhe ia dhuroi institucionit të bamirësisë, Dârü'l-Mesâi ("Shtëpia e Punës"), i ngritur "për t'u mësuar dhe dhënë punë grave dhe fëmijëve të varfër muslimanë me qëllim që t'i jepet fund mjerimit të tyre".

Bolshevizmi

Në vitin 1921 u botuan dy poezi të reja të M. Akifit: *Sulejman Nazifit* (15 prill) dhe *Bilbili* (13 maj). Ndërkaq, tetë fragmente poetike të zgjedhura nga shkrimet e vjetra sipas kohës u rishtypën në numra të ndryshëm të revistës.

Përveç përkthimit të *Esrâr-ı Kur'ân* ("E fshehta e Kur'anit") që ndodhej në vazhdim, në vitin 1921, shkrimi i vetëm me nënshkrimin e tij i M. Akifit është përgjigjja që i jepte ai një lexuesi i cili e pyeste mbi bolshevizmin që e kishte shtënë në dorë Rusinë me anë të revolucionit. Pyetje: "Ka që thonë se bolshevizmi është i njëjtë me muslimanizmin, se muslimanët duhet të bëhen patjetër bolshevikë. A është e drejtë kjo?" Përgjigjja: "... Muslimanizmi është tjetër, bolshevizmi, tjetër. Ata që pretendojnë se janë të njëjtë, ose nuk i kanë kuptuar dot parimet e Islamit, ose nuk e kanë parë të nevojshme ta analizojnë bolshevizmin. Nuk mund të mendohet që, duke pasur Kur'anin dhe Hadithin, muslimanët të pranojnë parimet rajonale të bolshevizmit. Sa për formën që ka për të marrë në të ardhmen kjo shkollë e re, nuk mund të themi asgjë, sepse e ardhmja është një e panjohur e tillë që askush përveç Allahut nuk mundet ta zgjidhë!"

Sebilurreshad në Kajseri

Gjatë luftës së Sakarjas, pasi armiku iu afrua Ankarasë, familjet e deputetëve dhe disa institucione u dërguan në Kajseri, ndërkaq që u bisedua edhe bartja e parlamentit. Mes atyre që dilnin kundër kësaj bartjeje duke u nisur nga mendimi se mbrapsja e qendrës së luftës për shpëtimin kombëtar do të ndikonte shumë keq mbi popullin dhe ushtarët dhe do të bëhej shkak disfate, ndodhej edhe M. Akifi i cili ndikoi efektshëm mbi qëndrimin e Mexhlisit në Ankara. Ai e dërgoi familjen në Kajseri shoqëruar nga Ali Shykry Beu me familje, por të birin Eminin e mbajti pranë duke thënë: "Atje ku të vdes unë, të vdesë edhe im bir!"

* Në librin e vet, Eshref Edib, duke përcjellë kujtimet e tij për M. Akifin, shënon nën titullin "Nuk mund të shkohet kundër natyrës!" një bisedë të zhvilluar në administratën e revistës *Sebilurreshad* kur ajo ndodhej në Ankara: "Siç dihet, në atë kohë, çështja e bolshevizmit debatohej shumë. Një herë, në zyrat e revistës, katër-pesë shokë po bisedonin mbi këtë temë. Njëri nga shokët pretendoi se bolshevikët do të kenë sukses. Mjeshtri i cili nuk po përzihej në debatet, më në fund, nuk duroi. Ai tha: "Jo, o bir, nuk ka mundësi! Një gjë e tillë kundër natyrës njerëzore nuk ecën!" Shtatëdhjetë vjet pas thënies së këtyre fjalëve, brezat e sotëm e shohin se si u shemb komunizmi antagonist i natyrës njerëzore.

Eshref Edibi shkruan se, në këtë mes, M. Akifi ndodhej me delegacionin që kalonte nëpër fronte duke u dhënë kurajë dhe guxim ushtarëve.

Kurse Eshref Edibi i cili shkoi në Kajseri bashkë me punonjësit e revistës dhe familjet e tyre, në fillim, në bazë të kërkesës së administratorëve, botoi më 1 shtator një deklaratë në emër të revistës *Sebilurreshad* dhe e qetësoi popullin, pastaj e botoi aty numrin e 490-të të revistës.

Këtë numër të dalë në Kajseri më 24 shtator 1921, e plotëson ligjërata me rëndësi e deputetit të Trabzonit, Ali Shykry Bej në Xhaminë e Madhe të Kajserit, “Lufta e madhe dhe e shenjtë e Anadollit”.

Pas ndërprerjes të veprimeve luftarake, Eshref Edib Beu u kthye në Ankara ku e vazhdoi nxjerrjen e revistës me numrin e saj të 491-të të datës 10 dhjetor.

M. Akifi në front

Në muajt shkurt-maj të vitit 1922, vepra e fundit e Said Halim Pashait, *Organizimi politik në Islam*, e shkruar prej tij në frëngjisht gjatë internimit në ishullin e Maltës, u përkthye nga M. Akifi dhe u botua në seri në numrat 493-501 të revistës *Sebilurreshad*. Pasi u kthye nga Malta, Said Halim Pasha nuk u lejua nga qeveria e Tefvik Pashait të vendosej në Stamboll duke e quajtur të pajustificueshme këtë gjë, prandaj u vendos me banim në Romë. Aty, më 6 dhjetor 1921, u vra nga një armen.

Poezia *Lejla* u botua në *Sebilurreshad* në numrin 631 të datës 8 prill 1922. Në këtë vepër të bukur e cila është poezia e fundit e shkruar nga M. Akifi në Turqi, autori bënte fjalë për *qëllimin e madh të Islamit*, për *shpëtimin e muslimanëve* dhe *unitetin islam* duke shprehur ndjenjat e mallit dhe pasionit që ndjente për to.

Në datat 1-16 gusht 1922, M. Akifi mori pjesë në një delegacion deputetësh të formuar nën kryesinë e Ali Fuad Pashait për të shëtitur frontet dhe kishte zhvilluar biseda inkurajuese me ushtarët para betejës së madhe që do të fillonte në fund të muajit.

Kurse në ditët kur *sulmi i madh* u kurorëzua me fitore dhe armiku u ndoq drejt Izmirit, M. Akifi, i emocionuar dhe i entuziazmuar, nuk qëndroi dot në Ankara, por, duke e marrë edhe të birin Eminin me vete, kaloi nëpër fushat e luftës plot kufoma, barti ujë për shuarjen e zjarreve të lëna nga armiku e, kështu, arriti deri në Bilexhik.

Gjatë këtij viti, nga *Asimi* u botua vetëm një fragment (3 gusht 1922).



Në fillim të shtatorit 1922, M. Akifi u zgjodh anëtar i *Akademisë së Studimeve Islame* të themeluar sipas vendimeve të TBMM dhe të vënë nën vartësi të Ministrisë së Fesë. Në krye të kësaj akademie, në krye të vitit 1923 u vendos Abdylaziz Xhavish që kishte ardhur nga Egjipti. Ky person që ishte një dijetar dhe mendimtar aktiv, pati qëndruar në Stamboll edhe në vitet 1912 dhe 1918 dhe kishte nxjerrë revista.

M. Akifi e përktheu në turqishte veprën *Të çarat e shkaktuara nga alkooli në jetën e njeriut* dhe e botoi në numrat e fundit të revistës që dolën në Ankara (janar-prill). Brenda atij viti, ky përkthim u botua edhe si libër.

Ali Shykry Beu vritet

Zhdukja në ditët e fundit të marsit e deputetit të Trabzonit, kolonelit të marinës në lirim, Ali Shykry Bej, është bërë një pikëkthesë në historinë e Mexlisit të Parë. Ali Shykry Beu, kufoma e mbytur e të cilit u gjet disa ditë më vonë, ishte udhëheqësi dhe zëdhënësi i deputetëve të opozitës në Kuvend. Ai kishte ngritur një shtypshkronjë në Ankara dhe nxirrte një gazetë të përditshme me titullin *Tan* (“Agimi”).

Opozitarët që pretendonin se qeveria kishte vepruar gabim në bisedimet e Lozanës, se nuk kishte vepruar në përputhje me Misâk-ı Millî (Besëlidhja Kombëtare), se e kishte lëshuar nga dora Musulin dhe shumë çështje të tjera, i bënë presion të madh qeverisë.

Ali Shykry Beu ishte mik i ngushtë i M. Akifit. Ata kishin shkuar së bashku nga Stambolli në Ankara. M. Akifi e kishte dërguar familjen në Kajseri bashkë me Shykry Beun dhe familjen e tij. Shtëpitë në Ankara i kishin pranë e pranë.

I biri Emini thotë se M. Akifi që u dëshpëruar shumë nga kjo ngjarje, pas saj u ftoh shumë nga Kuvendi.

Në fakt, Mexhlisi i Parë që mori më 1 prill vendim për zgjedhje të reja, më 21 maj u mblodh për herë të fundit dhe u shpërnda.

E marrim me mend se kjo strofë pa nënshkrim nën titullin e gazetës së Ali Shykry Beut është e M. Akifit.

Perëndimi ka treqind vjet që i është kthyer nata në ditë,

Kurse ti, o Lindje, ke që në atë kohë në gjumë...

Të tjera ujëra janë nxirë, zgjohu, tani e ke radhën ti,

Po lind dita që ke pritur: është koha për agim!

Në Stamboll

Në fillim të majit 1923, M. Akifi u kthye në Stamboll bashkë me familjen.

Me numrin 528 të 16 majit 1923, *Sebilurreshad* vazhdoi botimin e saj në Stamboll. Në numrat e revistës të dalë pas kësaj gjatë vitit 1923, dolën tre shkrime të përkthyer nga Abdylaziz Xhavishi: “Ç’i fali muslimanizmi mendimit dhe jetës?”, “E drejta juridike e femrës në Islam” dhe “Përgjigje kishës anglikane”. Botimi serial i përkthimit të fundit që vazhdoi gjatë njëzet e tetë numrave, përfundoi më 1924 dhe u shtyp si libër. (*İstanbul, Efkafl-ı İslamiye matbaası, 1340 (1924), 290.*)

Në Egjipt

Në muajin tetor 1923, M. Akifi shkoi në Egjipt bashkë me Abbas Halim Pashain dhe si i ftuar i tij.

Si i ftuar i Pashait, M. Akifi shkoi në Egjipt në fund të viteve 1923 dhe 1924 dhe i kaloi dimrat atje, pastaj, bashkë me Pashain, u kthyen në Stamboll në pranverën e viteve 1924 dhe 1925. Pastaj, pas vajtjes së fundit më 1925, nuk u kthye deri më 1936. M. Akifi banoi dy vjet në një vilë të vogël të caktuar për të që ndodhej përballë sarajit të Abbas Halim Pashait në kasabanë Hilvan jashtë Kajros, kurse pasi e pati sjellë familjen, pati marrë me qira një shtëpi të vogël në një skaj të Hilvanit.

Siç dihet, M. Akifi ushqente shpresën se Turqia e cila ishte i vetmi shtet islam që nuk e kishte dhënë pavarësinë dhe kishte mbetur i lirë, do të përpiquej, pas kësaj, për t’i zgjuar kombet e tjerë muslimanë të rënë në robëri. Mirëpo fakti që shteti i porsaformuar, duke u kthyer krejtësisht nga Europa, e kishte braktisur botën islame, nuk ishte diçka që mund ta pranonte M. Akifi. Prandaj, duke e braktisur vatanin për besnikërinë ndaj të cilit kishte bërë titur me zë të lartë të Himni i Pavarësisë, ishte tërhequr në pasivitet.

Asimi

Në muajt korrik dhe gusht 1924 u botuan tri pjesë nga fundi i *Asimit*. Pjesa e njohur si *Dëshmorët e Çanakalasë* doli në numrin 608, 10 korrik 1924.

Kurse botimi i *Asimit* si libër u bë në mesin e muajit gusht. (*İstanbul, Gündoğdu matbaası, h. 1347 (1928), 139 sayfa*). Ndërkaq, Sulejman Nazifi, veprat e të cilit qenë botuar në pjesë gjatë vitit 1919 në revistën *Serveti Funun*, duke bërë disa ndryshime dhe duke shtuar në fund një artikull me titull “Një poezi mrekulli” kushtuar *Asimit* të porsabotuar, në fund të vitit



1924 botoi shkrimin “Disa të dhëna dhe analiza mbi M. Akifin, individualitetin poetik dhe veprat” (*İstanbul, Amidi matbaası, 106 sayfa*).

Poezia me titull “Sy më sy me Faraonin” që M. Akifi e shkroi në el-Uksur përballë një mali plot me varret e faraonëve, doli në revistën *Sebilurreshad* të datës 25 dhjetor 1924. Në këtë kohë, vetë ndodhej në Egjipt.

Sebilurreshad mbyllet

Në numrat e muajit janar 1925 të *Sebilurreshad* u botuan *Gece* (“Nata”) dhe *Vahdet* (“Njëshmëria”) nga vjershat që pati shkruar në Hilvan.

Poezia “Njëshmëria” që doli më 22 janar, është vepra e fundit e M. Akifit e botuar në *Sebilurreshad*.

Duke e marrë për pretekst revoltën e Shejh Saidit të filluar më 13 shkurt 1925, qeveria nxori ligjin *Takrîr-i Sükûn*, mbylli partinë e parë opozitare Terakkîpver Cumhuriyet Fırkası (Fraksioni Republikan Përparimtar) dhe shumë gazeta, shumë gazetarë i arrestoi, burgosi dhe i dërgoi në gjykatat *İstiklal* (Gjykatat e Luftës) që i ngriti rishtas.

Edhe *Sebilurreshad* ishte mes gazetave të mbyllura me vendim të Këshillit të Ministrave të datës 6 mars 1925. Kështu, jeta botuese e revistës, e nisur më 27 gusht 1908, do të merrte fund më 5 mars 1925 me numrin e saj të 641-të. *Sebilurreshad* doli përsëri njëzet e dy vjet më vonë në maj të vitit 1948 nga Eshref Edib Beu dhe, pas botimit edhe të 362 numrave të tjerë, i dha fund botimit në muajin shkurt 1966. Eshref Edib Beu, i cili e nxori revistën *me dyzet vëllime dhe një mijë e tre numra*, vdiq më 1971.

Eshref Edib u arrestua në muajin maj të vitit 1925, u gjykua në gjykatën e luftës të Ankarasë dhe fitoi pafajësinë, mirëpo nuk u lirua, por u dërgua edhe një herë për rigjykim në gjykatën e luftës të Dijarbakërit, ku, disa muaj më vonë mori fitoi pafajësinë dhe u la i lirë më 13 shtator 1925.

M. Akifi i cili në fillim të vitit 1925 shkroi në Hilvan poezitë *Hicran* (“Ndarje”) dhe *Hüsam Efendi Hoca* (“Hysam Efendi Hoxha”), në fund të majit arriti me det nga Aleksandria në Stamboll.

Pasi qëndroi disa muaj në Turqi, në fillim të nëntorit 1925 u kthye në Hilvan dhe s’u kthye më deri më 1936.

Çështja e përkthimit të Kur’anit

Kryesia e Punëve Fetare (Departamenti i Fesë) donte të bënte një përkthim me koment të Kur’anit dhe përkthim të veprës *Texhrid-i Sarih*. Tefsiri i ishte dhënë porosi Elmallëllë Hamdi Efendiut, kurse përkthimi i

Texhrid-it, Ahmed Naim Beut. Ndërkaq, për përkthimin e Kur'anit të gjithë e kishin parasysh M. Akifin.

M. Akifi e hodhi poshtë për një kohë të gjatë propozimin për përkthimin e Kur'anit. Por pas këmbënguljeve të Aksekili Ahmed Hamdi Efendiut të dërguar te M. Akifi me detyrë nga ana e Departamentit të Fesë dhe ndërhyrjes së miqve që M. Akifi i donte dhe i respektonte, u detyrua të pranonte.

Në fund të vitit 1925, M. Akifi bëri marrëveshje me Departamentin e Fesë për përkthimin e Kur'anit, por, pas njëfarë kohe, nuk deshë ta jepte përkthimin, i ktheu një mijë lirat që i ishin dhënë si paradhënie, kurse të drejtat, ia kaloi Hamdi Efendiut.

Shkaku që M. Akifi nuk donte ta dërgonte përkthimin, ishte se kishte marrë vesh se po përgatitej një reformë fetare në kuadër të së cilës, ajetet e Kur'anit që recitohen në namaz, aty e tutje do të recitoheshin jo arabisht, por të përkthyer turqisht.

Në vitin 1936, M. Akifi u sëmur dhe u kthye në atdhe. Përkthimin e Kur'anit ia la mikut muderris Ihsan Efendiut me porosinë: "po të kthehem, e marr, po të mos kthehem, digje!"

Sexhde

Në muajin janar 1926, M. Akifi shkroi poezinë *Sexhde*. Në letrat që u dërgoi miqve, ua dërgoi edhe poezinë.

Gjatë vitit 1926, M. Akifit i vdiq e ëma Emine Sherife Hanëm në moshën nëntëdhjetëvjeçare.

Në tri poezi të shkruara nga M. Akifi në Egjipt pas tërheqjes në vetmi, duket një botë ndjenjash e pashfaqur në veprat e mëparshme. Një besim i lartë, një kulturë shpirtërore e thellë, një ego e pjekur në ankthe me një ndjenjë dorëzimi të plotë, e kishin kthyer M. Akifin tek zemra dhe tek Zoti i vet!

Hasan Basri Beu i cili në fund e vitit 1925 e dëgjon nga vetë autori poezinë *Hixhran* ("Ndarje"), i thotë:

"Mjeshtë, më duket se po ndryshoni synimin..." M. Akifi i përgjigjet aty për aty:

"Jo, vëlla, jo! Ky është synimi im i vërtetë! Botimet e mia janë poezitë e mia të shkruara për shoqërinë njerëzore!"



Me të vërtetë, kjo frymë dhe ndjeshmëri është e pranishme në poezitë e shkruara nga M. Akifi para se mbi brezin e tyre të pllakosnin luftëra dhe fatkeqësi. Ngjashmëria mes poezive *Dalldi* (libri i parë) dhe *Natë* (libri i shtatë) mund të vërehet menjëherë.

Botimet e fundit të *Safahatit* me alfabetin e vjetër

Në vitin 1928, para se shkronjat latine të pranoheshin zyrtarisht, nga gjashtë libra të *Safahatit*, pesë prej tyre (me përjashtim të librit të katërt) u ribotuan.

Në letrën e tij të datës 5 janar 1927, M. Akifi shkruante se, “pasi Eshref Edibi i kishte thënë se do ta shtypte librin e parë të *Safahatit*, kishte bërë korrektime në libër dhe se do t’i lexonte edhe të tjerët nëse i shtypte”.

Siç do të shihet në *botimin e redaktuar* të *Safahatit* që kemi në dorë, të gjitha botimet e fundit të këtyre pesë librave janë korrektuar. Nga letra në fjalë kuptohet se korrekturat janë bërë nga M. Akifi. Edhe botimi i fundit i librit të katërt të bërë më 1924 është korrektuar në të njëjtën mënyrë.

Poezitë e fundit

M. Akifi i cili ia pati kushtuar tërë kohën dhe mendjen punës për përkthimin e Kur’anit, në vitet e mëpasme nuk ka shkruar shumë poezi. Ato janë pak, por janë poezi të shkruara me një gjuhë dhe metrikë jashtëzakonisht të bukur. *Një natë* më 1928; *Një gabim* më 1929; *As vepër, as samar, Dervish Ahmeti* dhe *Gjeniut të vetëm të Lindjes* më 1930; *Imami Said Pasha* më 1931; kurse, në fund të gushtit 1933, *Artisti*, kryevepra e fundit e *Safahatit*, një përmbledhje e jetës subjektive të vet dhe një klithmë e dalë në frymën e fundit...

Veç këtyre, një vepër tjetër e rëndësishme e tij është *Gabimi i dytë* i shkruar më 1932.

Si poezia *Një gabim** të *Hijet*, si poezia *Gabimi i dytë*, janë dy vepra të një zgjuarsie të lartë dhe shumë të bukura që përshkruajnë me një gjuhë satire të hidhur varfërinë dhe vuajtjet që jetoi poeti në kurbetin e Egjiptit, në formën e letrave-kërkesë drejtuar Abbas Halim Pashait.

Si mësues në Egjipt

Gjatë një pjese të jetës së tij në Egjipt, M. Akifi ka punuar si mësimehdhënës i turqishtes në Universitetin e Egjiptit.

* Ne e kemi shqipëruar nën titullin *Një letër*.

Në fillim të muajit dhjetor 1929, kur M. Akifi filloi si mësues ndërsa sapo e kishte përfunduar variantin e parë të përkthimit të Kur'anit, u fut në leksionet e letërsisë së kurseve të tretë e të katërt. Këtë punë si mësues e pedagog e vazhdoi gjersa u rikthye në atdhe.

Hijet

Në fund të vitit 1933, M. Akifi botoi librin e shtatë dhe të fundit të *Safahatit: Hijet*. Libri u botua me alfabetin e vjetër në Shtypshkronjën Rinia të Kajros. M. Akifi i cili u lodh shumë me korrekturat e vështira, ka thënë: *“Kjo shtypshkronja e rinisë më mplaku mua!”*

Abbas Halim Pasha

Në fillim të vitit 1935 vdiq Abbas Halim Pasha. Ky është personi që e kuptonte më mirë M. Akifin, që e donte më shumë dhe që e ndihmonte më shumë. Për sa kohë që të jetojë emri i M. Akifit, edhe Abbas Halim Pasha do të kujtohet me dashuri dhe ndjesë.

Në një letër, M. Akifi ka shkruar kështu: *“Kur e mora lajmin e vdekjes së Ahmed Naimit, m'u bë sikur u shemb një mur mbi mua. Kurse mungesa e të ndjerit pasha ma bëri ta shijoj përsëdyti shijen e hidhur të mbetjes jetim në katërmbëdhjetë vjeç...”*

Në Antakja

M. Akifi u sëmur dhe, për të ndryshuar klimën, në muajin korrik 1935 shkoi në Liban, pastaj, në fillim të gushtit, shkoi në Antakja. Në atë kohë, Antakja ndodhej ende nën administrimin francez. Duke shëtitur rreth lumit me të rinjtë, iu përgjigj kështu pyetjes së tyre se si e kishte gjetur qytetin: *“Në ajër ka një rëndesë... U ktheva te kukuvajkat që mbajnë zi në gërmadha!..”*

Në Stamboll

M. Akifi të cilit i përparonte sëmundja, më në fund, në qershor të vitit 1936 doli për rrugë në drejtim të kthimit për në atdhe. Pranë poetit që nisi të qajë kur i pa minaret e Stambollit ndërsa vapori po kalonte nëpër Çanakala, ndodhej e shoqja Ismet Hanëm.

Në portin e Stambollit, M. Akifin e pritën të afërmit, disa miq dhe bija e Abbas Halim Pashait, zonja Emine Abbas Halim Pasha. Me këmbënguljen e saj, në fillim M. Akifi bujti në shtëpinë e saj në Maçka. Pas disa ditësh, për



t'u mbajtur nën observacion mjekësor, u shtrua në *Shtëpinë e Shëndetit në Shishli* dhe, pasi qëndroi aty njëzet ditë, u vendos në një hyrje të përgatitur për të në Apartamentin e Egjiptit, pronë e familjes së Pashait, dhe iu vu në shërbim një sanitar.

Pas disa javësh, biri i të ndjerit Said Halim Pasha, Halim Beu, pasi mori masa të duhura me qëllim që M. Akifi të ndjehej i qetë, e ftoi poetin në çifligun e familjes, Balltaxhë, në Alemdag. M. Akifi i cili qëndroi tre muaj në çiflig, duke përdorur automobilin e Halim Beut, shkante për mjekim në apartamentin në Stamboll ku qëndronte disa ditë, dhe kthehej prapë në çiflig. Duke treguar çifligun e madh dhe shërbyesit që i ishin vënë në dispozicion, thoshte duke qeshur me zë:

“Unë i pata thënë gjithmonë gruas se Allahu ka për të më dhënë, më në fund, një pasuri e begati! Ja, ja, u bë!”

Në ditët e fundit në Stamboll, të gjithë miqtë dhe të njohurit si dhe persona nga të gjitha klasat dhe profesionet e patën vizituar vazhdimisht, kurse hafizët që i donte, i këndonin Kur'an sa të donte!

Vdekja

Më në fund, M. Akifi që ishte vendosur në Apartamentin e Egjiptit pas thellimit të gjendjes së plogështisë dhe ftohjes së kohës, vdiq ditën e diel të datës 27 dhjetor 1936 në ora 19.45 të darkës.

Ditën e hënë më 28 dhjetor 1936, pasi iu fal namazi i xhenazes, pas namazit të drekës, në xhaminë Bajazit, u bart në duart e një mase të madhe përcjellësish, shumicën e të cilëve e përbënin të rinjtë universitarë, deri në varrezën përballë Varrezës së Dëshmorëve Edirnekapë dhe u varros pranë Ahmed Naim Beut. Gurët e varrit iu përgatitën me paratë e mbledhura nga të rinjtë universitarë.

Qarqet zyrtare të kohës nuk treguan asnjë interesim për funeralin dhe varrimin e M. Akifit.

Varri

Më 1960, për shkak të punimeve rrugore, varri i M. Akifit u bart në Varrezën e Dëshmorëve Edirnekapë, pastaj, në fund të vitit 1986, me rastin e pesëdhjetëvjetorit të vdekjes, u rindërtua, këtë radhë, me dorën e shtetit. Në të dy anët e varrit të M. Akifit ndodhen varret e Ahmed Naimit dhe Sulejman Nazifit.

ARTI, MORALI DHE IDETË

Botëkuptimi letrar dhe artistik

Me artikullin “Edebiyat” (“Letërsia”) që e botoi në *Sebilurreshad* më 8 mars 1912, Mehmet Akifi ka parashtruar botëkuptimin e tij letrar-artistik dhe rrugën që do të ndiqte revista. Artikullin po e citojmë tekstualisht më poshtë duke i shtuar vetëm disa nëntituj.

Letërsia është ushqim për ne

Gjithsesi, shkrimet tona të dala deri tani e kanë treguar se si e kemi konsideruar letërsinë dhe se ç’vijë dëshirojmë të zëmë. Ka që thonë për letërsinë “stoli”, “fara kungulli për të kaluar kohën”. Kjo fjalë është ndoshta e drejtë për kombet me barkun plot dhe shpinën të ngrohtë, por kombeve si ne, të uritur e të zhveshur, para stolive dhe farave të kungullit, u duhet veshmbathje dhe ushqim. Prandaj, sado e stolisur dhe sado e ëmbël që të jetë, letërsia që nuk e kryen detyrën e veshjes dhe ushqimit, neve s’na thotë dot asgjë!

Ata që i japin imoralitetit formë filozofie

Pa le teoritë e larta, si: “arti për art”; “arti është për artin”; “qëllimi final në art është përsëri arti”; “të kërkojsh në letërsi qëllim tjetër final veç letërsisë, do të thotë ta kufizosh dhe kushtëzosh artin”; këto teori të larta, pra, janë mjaft mbi aftësinë tonë të të kuptuarit! Fundja, këto lloj teorish vihen në rend të ditës dhe pretendohen me qëllim për t’u dhënë lejkalimi dhe popullaritet pornografive të paraqitura si vepra artistike nga ana e një sërë njerëzish mediokër e dashakeqë, të cilët i japin imoralitetit formë filozofike dhe, në emër të letërsisë, sulmojnë: nderin, jetën dhe ekzistencën e kombit!

Jemi edhe ne që besojmë se letërsia ka vatan. Nga ky shkak, nuk duam që letërsinë e asnjë vendi ta kopjojmë në vendin tonë!

Ne do t’i zhvillojmë dhe përpunojmë ndjenjat dhe idetë tona

Si në çdo gjë tjetër, njerëzit e lindjes janë mjaft prapa edhe në letërsi, kurse njerëzit e perëndimit, si në çdo tjetër, janë mjaft përpara edhe në letërsi. Nga letërsia e tyre ne do të kërkojmë të përfitojmë vetëm në aspektin



teknik artistik dhe s'kemi ndërmend ta shesim mallin e huaj për kapital të vendit. Ky lloj sekserizmi, jo vetëm që është mashtrim, por edhe duke e penguar përpunimin dhe zhvillimin deri në kiamet të botës sonë afektive, të botës sonë mendore e ideore, përgjithësisht, të vetë jetës sonë, bëhet shkak që të gjitha këto të mbeten në nivelin e mallit të papërpunuar ose, e thënë ndryshe, të lëndës së parë, gjë që është edhe turp, edhe mëkat!

Osmanët që po e mësojnë se si nxirren nafta dhe hidrokarburet dhe si barten ato, duhet të përpiqen të vënë në punë dhe shfrytëzojnë burimet minerare në Erzurum dhe Irak. Ndryshe, po qe se shteti osman do ta bartë me teneqe vajgurin nga Amerika, nga Rusia dhe Rumania dhe pastaj do të na e mbushë mendjen neve se është prodhim vendi, ne s'kemi për të marrë vesh gjë nga politika e tij minerare!

Le të mos zemërohen, le të mos preken, ama shumë prej atyre që i hodhën në shesh si artistë, ne i gjetëm si nga një sekser mediokër! Po shtojmë edhe cilësimin "mediokër", sepse nuk tregojnë dot aftësi qoftë edhe që të mos u dallohen arnat!

Aty ku fillon paturpësia, letërsia merr fund!

Veprat që do të duken në *Sebilurreshad*, do të jenë pa cilësi, pa finesë, por do të jenë mall vendi, në asnjë anë të tyre s'do të ndodhet vula që të tregojë se janë produkte të një vendi tjetër. Gjithashtu, do të sigurojnë njëfarë dobie. Po qe se s'do të sigurojnë asnjë dobi morale-shoqërore, të paktën nuk do të bëjnë dëm, gjë që, sipas një ideje, do të thotë dobi.

Shkrimet tona shkruhen që të mund të lexohen mes familjeve më të ndershme. Fundja, sipas opinionit tonë, aty ku fillon paturpësia, letërsia merr fund.

Kritikë jo ndaj kombit dhe popullit tonë, por ndaj të metave tona

Do të shkruajmë për çdo temë që do ta shohim si të përshtatshme. Sidomos nuk do të druemi fare për t'i derdhur hallet tona shoqërore, për t'i hapur dhe treguar plagët tona. Synimi ynë në këtë drejtim nuk do të jetë, siç pandehin ose siç nxiten të pandehin një sërë mjeranësh, ta diskreditojmë kombin dhe popullin ndaj të huajve, ndaj armiqve. Synimi ynë është e do të jetë ta diskreditojmë jo veten, por të palarat tona gjersa, si rezultat konfidence dhe afiniteti të vetvetishëm, t'i braktisim dalëngadalë një sërë të këqijash që s'mërzitemi aspak, që s'ndejmë aspak dëshpërim pse i bëjmë ditë për ditë, dhe, duke i dhënë dorën njëri-tjetrit, të hedhim një hap drejt njerëzores!

Do të shkruajmë për popullin

Shihet se ne presim shumë nga letërsia. Sigurisht, po qe se bijtë e vendit me mendtë në kokë nuk na shohin vëngër, por na ndihmojnë, pse të mos krijohet një letërsi kombëtare, realiste dhe njerëzore e osmanëve?

Si në tematikën, si në stilin e shkrimeve tona, para së gjithash do të mendojmë vetëm osmanët, domethënë, me sa të jetë e mundur, do të nxjerrim në shesh vepra që t'i flasin popullit. Ndryshe, nuk jemi të shushatur në atë gradë sa të priremi për të shkruar shkrime për elitën. Fundja, pse kemi gjashtëqind vjet e këtej që mendojmë vetëm elitën, jemi vulgarizuar e kemi marrë fund!

Si duhet të jetë gjuha?

Esenciale për ne është që të shkruajmë thjesht. Sa herë që jemi ndarë nga ky parim esencial, absolutisht kemi mbetur në pozitë të vështirë. Ndërkaq, në thjeshtësi s'kemi për të shkruar aq përpara sa, bie fjala, të mos e pëlqejmë fjalën "xhennet" e të përdorim fjalën "uçmak" (parajsë); sa ta lëmë fjalën "xhehennem" (ferr) e të themi "tamu"!

Sidomos pasurinë shprehëse të gjuhës sonë nuk do të lejojmë ta shkelë asnjë këmbë e huaj, n'daç të jetë e shkruar me çizme Napoleoni, n'daç të ketë mbathur çorape anglezi. Në këtë specifikë do të tregojmë fanatizmin dhe konservatorizmin më të mundshëm. Po, kemi për t'i sulmuar me të gjitha forcat shkrimet e kaluara më pas në turqishte pasi, siç bënin të parët, të jenë menduar më parë arabisht e persisht ose, siç bëjnë të rinjtë e sotëm, të jenë kompozuar më parë frëngjisht apo gjermanisht! Sepse i kemi besuar mirë kësaj të vërtete se ashtu si kombi pa gjuhë, edhe gjuha pa mjetet e veta shprehëse nuk jeton dot. Ashtu si çdo vend përparon brenda kufirit të vet të natyrshëm, edhe çdo gjuhë zhvillohet e përparon në kuadrin e mjeteve të veta shprehëse të natyrshme.

Veprat që nuk i përmbahen stilit dhe mjeteve shprehëse të gjuhës, jetojnë për njëfarë kohe mes një shtrese të kufizuar, pastaj vdesin e shkojnë.

Si shkruhet poezia?

Njëmbëdhjetë nga artikujt e Mehmet Akifit u kushtohen temave letrare, mënyrës se si do të planifikohen dhe shkruhen shkrimet poetike dhe prozaike. M. Akifi jo vetëm i ka parashtruar dhe shpjeguar në këta artikuj idetë e tij, por edhe në një bisedë ka treguar kështu se si shkruante vetë poezi:



Frymëzimi në poezi ndodh shumë rrallë. Poezia bëhet me punë dhe përpjekje. Pandehin se poeti qëndron përballë natyrës, mbledh frymëzimet, pastaj merr menjëherë kalemin dhe shkruan vjersha. Mirëpo, s'është aspak kështu! Ai do të mbyllet në dhomë, do të derdhë djersë, do të mendohet, do të lodhet, do të përpiqet. Një dyvargësh del në shesh duke derdhur djersë njëqind herë. Unë i sjell peizazhet në dhomën time, atje e vras mendjen, derdh djersë dhe e shkruaj poezinë time brenda katër muresh!

Unë mendoj shumë para se të shkruaj vjershë. Krejt si një inxhinier, si një arkitekt! Ashtu si arkitekti që, para se të fillojë ngritjen e ndërtesës, së pari mendohet, pastaj bën një plan, pastaj vizaton projektin e zbatimit dhe vetëm pastaj fillon nga ndërtimi. Edhe unë kështu jam...

Para se të shkruaj një vepër, i përgatis të gjitha premiset. Si do të hyj në vepër, në ç'përfundim do të arrij... Të gjitha këto i ngre në imagjinatë. Pastaj filloj të shkruaj. Dhe arrij në përfundimin që dua.

Një evidentim që tregon se si punonte me korrektësi M. Akifi mbi veprën dhe që i mbështet fjalët e tij të cituara më sipër, e gjejmë edhe në kujtimet e Mahir Iz Beut (1895-1974):

Një ditë kisha shkuar t'i sillja kafënë sade. Në kthim pashë se po shihte një faqe që s'i kishte mbetur vend i bardhë nga korrigjimet. Pasi ia dhashë kafënë, edhe unë e pashë fletën me vëmendje. Po ç'të shihja? Një faqe korrigjimi e *Asimit!* U shtanga nga habia! Kur e lexonim *Safahatin*, neve ashtu na vinte se mjeshtri i hidhte ato që i lindnin ndërmend pa i rregulluar fare në faqet e veprës, sepse shprehjet ishin aq të natyrshme e të goditura, sa kurrë nuk do të na shkonte ndërmend që vargjet e tij të ishin një produkt mendimi e shqyrtimi. Kur ia thamë këtë çështje, na u përgjigj kështu: "Po ç'thoni kështu! Ka ndodhur që për një fjalë të mendohem një javë!"

Një poet nuk mund të bëhet poet në çdo vepër të tij!

Në shkrimin e tij me titull "Intikad" ("Kritika") të botuar më 14 mars 1912, Mehmet Akifi shpjegon se mbi ç'kriterë duhet të vlerësohet një vepër letrare dhe me fjalët e tij mbi poezinë, aludon mbi një pikë të rëndësishme. Dy paragrafë të shkrimit janë cituar tekstualisht:

Poeti nuk mund të bëhet poet në çdo vepër të tij, domethënë, çdo vepër e shkruar nga njeriu nuk mund të ngjitet në gradën e poezisë. Poetët më të mëdhenj kanë stonatura të tilla që nuk mund të dalin as nga poetët më të vegjël! Po kështu, te ata që bëhen të famshëm për thënie nonsensesh herë-herë shihen fjalë të tilla që nuk mund t'u atribuohen personaliteteve të tyre. Prandaj, po qe se veprën mbi të cilën do të bëni vlerësim, e lexoni

pa e abstraguar nga ideja që bartni se është e aksh poeti, gjithmonë do të zhgënjeheni!

Sipas ç'gjëje duhet bërë kritika?

Çdo vepër kritikohet në shtratin e saj; të gjitha kritikohen sipas tematikës, pastaj, sipas përfundimit të kërkuar për t'u nxjerrë nga ajo temë. Nuk mund të ruhet i njëjti pikëvështrim për vepra të ndryshme. Ashtu siç është mjaft e natyrshme që retorika e tematikave të veçanta të jetë e veçantë, në shumë raste puriteti i shprehjes madje, është krejt tjetër. Këto janë momente që do ta çorodisnin rregullin poetik, që do t'ia dobësonin veprimin dhe do ta bënë të heshtte. Më saktë, shumica e parimeve në letërsi janë si rregullat e drejtësisë ndërkombëtare: zbatohen vetëm mbi shkrimtarët e mjerë! Ndryshe, ai që i beson penës së vet, e gris atë rregull, kalon në anën tjetër dhe askush s'mund ta nxjerrë as zërin, madje!

Mbi poezinë dhe artin e M. Akifit

Janë shkruar shumë artikuj mbi artin e Mehmet Akifit, mbi poetikën e tij dhe mbi *Safahatin*. Nga këta, paraqesin rëndësi shkrimet e Hakkiut nga Sparta dhe të Mid'had Xhemalit (Kuntaj), debatet e Hamdullah Suphiut dhe Xhelal Sahirit në revistën *Servetifunun*, shkrimet e Ali Ekrem (Bolajir) të dalë nën titullin e përgjithshëm *Sahâif-i Tenkîd*, seria e shkrimeve dhe libri i Sulejman Nazifit, më vonë, vepra me titull *Mehmet Akif*, përsëri e Mid'had Xhemalit.

Në këtë pjesë do të bëhen citime të shkurtra nga shkrimet e letrarëve të njohur mbi artin dhe poezinë e Mehmet Akifit.

Omer Sejjeddin:

Tregimtari, shkrimtari dhe poeti i njohur Omer Sejjeddin (1884-1920), në një artikull që shkroi më 1919 në shtojcën letrare të gazetës *İfham* ("Informuesi"), duke shprehur idenë se "vepra letrare e bukur s'mund të jetë e re ose e vjetër, e rëndësishme është të jetë e bukur", tregon si shembull Mehmet Akifin dhe thotë:

"Poet është ai që ka në shpirt një zjarr hyjnor, një pasion. Poezia duhet të na pushtojë, duhet të na shartojë neve një fuqi, një ndjeshmëri që s'na ndodhet në shpirt..." Për ata që e kuptojnë poezinë kështu, Mehmet Akifi është poeti më i madh i sotëm ndër ata që shkruajnë me metrikën arud; "në *Safahat* shohim reflektimet e një shpirti si oqean që herë dallgëzohet, herë është i qetë, por që qëndron tejet i shkëlqyer. Poezia *Në qyrsinë* e



Sulejmanijes është një kryevepër e pakundërshtueshme. Megjithëse unë s'jam një nationalist përkrahës i Aleancës Islamike, sa herë që ta lexoj këtë kryevepër, emocionet më ndryshojnë dhe bëhem në çast një utopist përkrahës i Bashkimit Islam. Ky poet është tejet i singertë në pasionin hyjnor; tek ai s'ka asnjë lloj artificialiteti!" (30 shtator 1919).

Xhenab Shehabeddin:

Mjeshtri i poezisë dhe prozës i Letërsisë Servet-i Fünûn, Xhenab Shehabeddin (1870-1934), në një artikull të tij të shkruar më 1921, bën fjalë mbi poetikën e Mehmet Akifit dhe vendin e *Safahatit* në letërsinë tonë:

"Po që se e kemi fjalën për poezi proverbiale mbi ceremonialin dhe traditën e racës sonë të quajtur 'poezi kombëtare', në avangardën e saj shoh një gjeni poetik para të cilit do të ulnim kokën: Mehmet Akif... Askush nuk e ka ekspozuar perspektivën e kombit përmes një kristali shprehjeje aq të kulluar e transparent. Shpirti turk dhe islam u bënë embrioni i frymëzimit të *Safahatit*. Historia e letërsisë nuk njeh tani për tani poet islam dhe turk më të madh se Akifi!" (*Peyam*, 11 gusht 1921).

Në traktatin si vepër më vete me titull "*Safahat Mübdii*" ("Krijuesi i *Safahatit*") që e shkroi pas botimit si libër të *Asimit* më 1924 dhe që doli në revistën *Servetifunun*, Xhenab Shehabeddin i ka parashtruar më gjerë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse mendimet e veta mbi artin e Akifit. Xhenab Shehabeddin i cili në këtë shkrim analizon edhe personalitetin e Mehmet Akifit, shkruan se synimi i kërkuar prej tij për t'u arritur në art ka gjetur "*sehl-i mümteni*"-në, "stilistikën e thjeshtësisë së paarritshme", domethënë "*bukuri maksimale në thjeshtësi maksimale*", se ai duket sikur i ka arritur pa asnjë mundim artin dhe bukurinë më të larta, se: "*në këtë rrugën më të ngushtë e të vështirë të artit*" ia ka arritur synimit me sukses duke ecur pa iu penguar këmba, bën të ditur se pjesa që flet për "*shehidët*", dëshmorët, është "*vepër gjenialiteti poetik*" dhe thotë:

"A njihni një vepër tjetër artistike me mundimin kaq të fshehtë dhe forcën kaq të bukur? A nuk është detyrimi i parë i ndjenjës së vlerësimit të përulesh e t'i puthësh ato duar që e kanë krijuar këtë?"

Edhe opinionin e tij mbi *Asimin*, Xhenab Shehabeddin e shpreh kështu: "... Përmbledhja *Safahat* është një sajim i suksesshëm. Librin e gjashtë të kësaj përmbledhjeje të cilin autori e ka titulluar *Asim*, nuk ngurroj ta njoh si një monument të pashoq në letërsinë tonë..." (*Servet-i Fünûn*, nr. 1479, 18 dhjetor 1924)

Sulejman Nazif:

Poeti dhe prozatori, letrari i njohur Sulejman Nazif (1870-1927) i cili ka shkruar veprën e parë më vete mbi Mehmet Akifin, për poezinë “Nga shkretëtirat Nexhd në Medine” ka shkruar fjalët e mëposhtme të cilat, meqë i ka shprehur ai, fitojnë veçanërisht në peshë:

“Pohoj me krenari dhe shije se, në gjuhët e lindjes dhe perëndimit që njoh unë, dhe në këtë fushë, qoftë si origjinal, qoftë si përkthim, nuk kam lexuar ndonjë poezi kaq të bukur e të patëmetë! Për ta shkruar këtë poezi nuk mjafton vetëm të jesh poet sa Mehmet Akifi, por është e nevojshme edhe të jesh fetar sa Mehmet Akifi! Poeti i cili nuk i bashkon dot në egon e tij me të njëjtën forcë dhe begati këto dy domosdoshmëri krijuese, n’daç të jetë lindor, n’daç të jetë perëndimor, nuk mund të krijojë një poezi proverbiale si kjo. Pasioni dhe besimi i poetit është derdhur nga zemra e tij, në penë dhe nga pena, në letër!” (Stamboll, 1924)

Ismail Habib Sevuk:

Historiani i letërsisë Ismail Habib Sevuk (1892-1954), në veprën e tij *Novatorizmi ynë letrar*, në pjesën kushtuar Akifit, i trajton nga të gjitha anët poezitë e tij dhe, pasi e mbaron shqyrtimin e Asimit, e përfundon shkrimin e tij me këto fjalë:

“Edhe Mehmet Akifi që është një poet me emocione dhe ekstazë kulmore, në atë libër, veçanërisht në faqet kushtuar përshkrimeve të luftës së Çanakalasë, në monumentin mbresëlënës që i bën tyrbes së ushtarit turk, na ka dhënë neve jo vetëm kulmin e fundit të poezisë së tij, por, në të njëjtën kohë, njërën nga lartësitë më me rëndësi të letërsisë sonë. Te *Asimi* është i tëri Mehmet Akifi! Edhe personi që ka në dorë një vëllim të tillë, mund të hyjë brenda tempullit të poezisë në çdo kohë, si të hynte në shtëpinë e vet!” (Stamboll, 1932, vëll. 2)

Ibrahim Alaeddin Govsa:

Shkrimtari, poeti, leksikografi dhe historiani i letërsisë, Ibrahim Alaeddin Govsa (1899-1949), në shkrimin e tij nekrologjik me rastin e vdekjes së Mehmet Akifit, bën këtë konkluzion:

“Jo vetëm nuk ka si ai që ta përdorë gjuhën popullore turke në mënyrë aq të familjarizuar dhe të natyrshme, por dhe nuk kemi patur një poet që ta bëjë të flasë zemrën e popullit turk drejt dhe sinqerisht në gradën e tij. Më



duket se *Safahati* do të mbetet një kryevepër candidate për t'iu dallgëzuar për shekuj reflektimet në horizontet e Lindjes!" (*Yedigün*, 6 janar 1937)

Hakki Suha Gezgin

Mësimdhënësi i njohur i letërsisë, shkrimtari dhe apologjeti i muzikës sonë kombëtare, Hakki Suha Gezgin (1895-1963), në serinë e shkrimeve "Portrete letrare" të shkruar për revistën *Yeni Mecmua* në vitin 1939, në artikullin kushtuar Mehmet Akifit, bën këto përcaktime:

"U përballëm me Bilbilin, kurse në poezitë e *Sexhdes*, me më të rrëmbyerat furtuna që mund të shpërthejnë në zemrën e një njeriu. Edhe sikur Akifi të ishte vetëm autori i këtyre dy poezive, prapë, në famën e tij nuk do të kishte asnjë mungesë. Në këto poezi e pamë me të gjithë shkëlqimin se ç'qenie me flatra të gjera është shpirti i një poeti!"

"Mehmet Akifi ishte si kometat që lindin një herë në shekull, por një fatlum që e mbushte i vetëm tërë një horizont! Edhe sikur të gjitha shpifjet me elmas të artit të përpiqen për ta njollosur për gjëra të pakuptueshme, brezat e së nesërme do ta duartrokasnin atë si një triumfator të botës së zemrës! (13 tetor 1939)

MORALI, MËNYRA E JETESËS DHE MENDIMET

Pronari i revistës *Sebilurreshad* dhe ai që e ka njohur më nga afër Mehmet Akifin, Eshref Edib Beu, i përmbledh kështu mbresat që pati mbledhur dhe opinionet që pati formuar për të:

Burrë edhe i idesë, edhe i shoqërisë

Akifi ishte zotëruesi i një karakteri dhe bindjeje të jashtëzakonshme. Ai nuk zvarritej pas ngjarjeve spontane. Ai kishte bindje dhe kriteret e caktuara e origjinale. Bindjet i kishte ngritur mbi këtë formulë sociale: Feja = moral + atdhedashuri + dituri.

Akifi nuk ishte një poet që vetëm tërhiqej në një qoshe dhe mjaftohej të shkruante ato që mendonte dhe dëgjonte. Në të njëjtën kohë, ai ishte një njeri i shoqërisë që përpiquej të bënte ato gjëra që i shihte të drejta, që përpiquej t'i përputhte veprimet me ndjenjat e tij të sinqerta. Ai qe përpjekur vazhdimisht të kryente detyrat që i binin përsipër në profesionin e nëpunësit, në punët e shoqatës dhe në punët e atdheut.

I vendosur, besnik, modest, serioz

Ishte shumë i vendosur. Po të vendoste një herë për një gjë, më tej, kryerja e asaj pune s'përbënte më çështje për të!

Besnikëria e tij ishte përjashtimore. Miqësisë së tij i besohej në mënyrë të padiskutueshme. Në vështrimin e tij, pabesia ishte paburrëria më e madhe! Ai ishte besnik jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj Zotit të tij, peygamberit të tij, kombit të tij dhe vatanit të tij!

Ishte shumë i thjeshtë, modest. Nuk e pëlqente aspak dukjen. Po të mos ishte vendi, as diturinë e vet nuk e nxirrte në shesh!

Ai kishte një respekt të madh për vetveten. Gjatë gjithë jetës, nuk pati treguar asnjë herë dhe ndaj askujt përbuzjen më të vogël! Ndërkaq, ai nuk mund të tregonte durimin dhe lëshimin më të vogël ndaj një fjale më të vogël, një trajtimi më të vogël, madje, ndaj një vështrimi më të vogël që do t'ia cenonte dinjitetin, respektin për vetveten! Sa qe gjallë, kurrë nuk pati lejuar t'i hidhej pluhur nderit dhe dinjitetit të tij!



Iguximshëm, trim, i turpshëm, i qëndrueshëm

Kishte një qëndrueshmëri të madhe. Nuk dinte ç'është frika dhe pesimizmi. E ruante gjakftohtësinë përballë ndjenjave.

Ishte burrë shumë trim. Ishte i dhënë që në fëmijëri pas trimërisë. Hakmarrjen nga njeriu i rënë në pozitë të dobët e shihte të papajtueshme me trimërinë.

Ishte dashamirës ndaj të gjithëve. Veçanërisht ndjente kënaqësi të madhe kur i shihte shokët në gjendje të mirë!

Fjalës i jepte vlerë të madhe, fjalën e dhënë e çonte në vend pa diskutim, vetëm nëse do ta pengonte vdekja ose një pengesë tjetër e afërt me të! Ata që s'e mbanin fjalën s'i shihte si njerëz!

Ai s'dinte ç'ishte gënjeshtria. Çdo fjalë e tij ishte e drejtë. Gjatë gjithë jetës së tij, askush nuk e pati vënë re qoftë edhe një herë të vetme të gënjente! Ai nxehej shumë me ata që gënjenin!

Ishte i turpshëm dhe i ndrojtur. Po të fliste dikush në prani të tij për vlerat e tij, skuqej dhe shihte në anë tjetër.

Ai qeshte për mundimet e jetës. Sipas tij, barra më e rëndë në jetë kategorikisht e padurueshme ishte detyrimi i mirënjohjes. Ai përpiqej t'i përgjigjej të keqes me të mirë dhe nga kjo ndjente kënaqësi.

Miqësia e tij ishte e vështirë

Qoftë edhe një herë në jetë nuk iu përul forcës. Njerëzit e fuqishëm e të pushtetshëm e patën parë para vetes atë gjithmonë të ashpër. Nuk kishte asnjë durim ndaj padrejtësisë, menjëherë kundërvepronte me forcë e me ashpërsi! Ishte kundërshtar i ashpër i despotizmit. Kur nxehej, fytyra i merrte një madhështi mbresëlënëse të frikshme, si forca mbresëlënëse e poezive të tij të rënda.

Interesohej për vuajtjet e popullit. Ai bëhej armik i tmerrshëm i atyre që notonin në kënaqësi e dëfrime ndërsa populli vuante.

Miqësia e tij, si të ishte një mall shumë i shtrenjtë, fitohej duke marrë parasysh shumë privime. Pastaj, për të mos e humbur, do t'ju duhej të dridheshit mbi këtë gjë tejet të shtrenjtë! Ishte njeri me shprehje të vështira. Nuk ishte e lehtë të bëheshe mik me të. Po qe se do të mund ta kuptonit, ishte gati ta sakrifikoje edhe jetën për ju!

Në çdo gjë ishte i plotë. Edhe në interesim, edhe në indiferentizëm. Atë që e donte, e donte me të vërtetë. Por nuk tregonte as interesimin më të vogël për njerëzit ndaj të cilëve nuk i ngrohej shpirti, por as fillonte të ushqente urrejtje për ta!

Nuk ngopeshit dot me bisedën e tij. Edhe heshtja e tij ishte kënaqësi ndjellëse. Disa herë i flisnin vetëm sytë. Nuk mund ta hapnit gojën për gjërat që donte dhe besonte, se nuk duronte dot. Ndërkaq, kishte respekt për bindjet e tjetrit. Edhe tjetri ishte i detyruar t'i respektonte bindjet e tij!

Ishte indiferent ndaj punëve të veta kurse tregonte interesim për çdo punë të njerëzve që donte. Me njerëzit e dashur sillej butësisht e me humor.

I vetëm dhe meditues

Gjëja që donte më shumë, ishte të mbetej vetëm e të meditonte. Mërzitej nga rrëmeti i qytetit dhe gjithmonë përfytyronte të ndodhej në vende të largëta dhe të vetmuara, të kishte ndonjë vend si teqetë. Në ato vende dëshironte të mbetej larg nga njerëzit, kokë më kokë me natyrën.

Ishte njeri i përgjigjes së shpejtë. Disa herë, kur jepte përgjigje, e kërkonte anekdotën e duhur e cila i vinte menjëherë ndërmend, dhe e thoshte. Anekdotën që i pëlqente, le të ishte poezi apo diçka tjetër, kënaqej ta përsëriste. Në qoftë se i pëlqente një kuvend, merrte pjesë me shumë dëshirë në diskutim dhe hapej. Por kur në kuvend përzihej ndonjë i huaj, i ikte gëzimi. Idenë apo mendimin e thoshte shkurt si të ishte përmbajtja e një shpalljeje të një vendimi gjyqësor. Kur kishte shumë njerëz, bëhej i heshtur sa mund të thuhet se s'e hapte gojën fare! Nuk i donte aspak njerëzit e papërcaktuar, pa ngjyrë, pa karakter.

Gjithmonë lexonte, mësonte dhe jepte mësim

Kënaqësia më e madhe e tij ishte të jepte mësim dhe të shkruante. I kushtonte rëndësi mësimin që jepte. Atë që dinte, e dinte mirë. Por nuk përzihej aspak në atë që s'dinte. Kujtesën e kishte shumë të fortë. Sasia e gjërave që mësonte përmendësh nuk binte më poshtë se dhjetë mijë dyvargësh, kuplete.

Ishte i pasionuar pas kulturës dhe denjësisë. I donte me shpirt forcën mendore dhe virtytet. Çdokënd që e shihte të aftë dhe kapacitet, e nxiste të punonte në rrugën e shërbimit ndaj popullit dhe kombit.



Armik ndaj fanatizmit, injorancës dhe deviacionit

Ishte armik i tmerrshëm i fanatizmit injorant. Ndaj të vjetrës nuk ishte i lidhur pa kushte. As ishte përkrahës verbërisht i së resë. Parimi i tij ishte ky: “E vjetra nuk hidhet pse është e vjetër, por atëherë kur është e keqe. E reja nuk merret pse është e re, por në qoftë se është e mirë!”

Ai ishte edhe poet, edhe dijetar. Vetitë morale, cilësitë njerëzore të tij qëndronin më lart edhe se poezia e tij, edhe se njohuritë që zotëronte. Ishte armik i injorancës. Kishte opinionin se shoqëria nuk mund të jetonte pa dituri dhe kulturë. U jepte rëndësi domosdoshmërive të shekullit, rinisë dhe së ardhmes. Ishte armik i tmerrshëm ndaj poetëve, letrarëve dhe shkrimtarëve që i çonin popujt dhe kombet në rrugë të shtrembra. Këta i quante fatkeqësi për kombet. Kritikën dhe denigrimin nuk i donte. Sipas tij, njeriu duhet të bënte jo kritikën e të tjerëve por të vetes!

Larg nga politika

Ai mbështetej te Allahu nga politika. Ndodhi siç ndodhi dhe u fut në Bashkim e Përparim (Ittihad ve Terakki) pas shpalljes së Kushtetutës, por nuk merrej me politikë. Edhe hyrja në Bashkim e Përparim qe një ngjarje më vete. Kur i propozuan të betohej, pati thënë se: nuk do t’u bindej pa kushte urdhrave të shoqatës, por do të mund t’i mbetej besnik urdhrin për të mirën! Ky karakter i pakompromis i tij qe bërë shkak për ndërrimin e mënyrës së formulimit të betimit.

Ishte shumë i lirë e i pavarur në mendime dhe tolerant. Ai mendonte gjerë. Ishte vetëm një gjë që s’e toleronte ai: Feja...! Thjesht këtu e kishte burimin zemërimi i tij ndaj Fikretit, të cilin më parë e respektonte dhe e vlerësonte.

E donte shumë muzikën dhe i binte nejt.^{*} Ishte ruajtësi i shumë këngëve të rënda, kompozimeve, dhe ilahive. I pëlqente shumë mevludi. Ndjente kënaqësi të madhe nga dëgjimi i këndimit të Kur’anit me zë të bukur.

Ngrihej herët. S’e kishte zakon të rrinte në shtrat i zgjuar.

Nuk i përzihej askujt në çështjet e posaçme dhe personale. Por ndërhynte në cilësitë shoqërore. Nxehej me atë që tregohej ndryshe nga ç’ishte, zemërohej me njerëzit dyfytirësh.

Përgjithësisht, aq sa ishte një poet i lartë, ishte edhe një njeri i përkryer me kuptimin e plotë të fjalës!

* Vegël muzikore e ngjashme me flautën, e bërë nga kallami, që përdoret në veçanti në muzikën mevlite.

E meta e vetme: Të bëhej njeri i kauzës

I ndjeri Senijuddin Bashak Beu (1867-1963) që e pati njohur Mehmet Akif Beun nga afër, shkakun që Akif Beu pati mbetur gjatë gjithë jetës i vetëm dhe shkakun e vuajtjeve që pati hequr, e shpjegon me një “të metë” të tij (një e metë e tillë, në kokë të miqve!):

“Sipas meje, vetitë morale dhe cilësitë njerëzore të Akifit qëndronin më lart edhe se poezia e tij, edhe se njohuritë e tij. Akifi kishte një të metë, një të keqe për kryen e vet, e cila ishte thjesht të bëhej apo quhej burri i idealit të vet! Ja, pra, pikërisht për këtë arsye ai nuk qe strehuar dot në asnjë vend! Po qe se ai nuk do të rastiste në dikë që do t’ia pranonte këtë dobësi si meritë, ose që do t’ia shihte me sy të mirë këtë të metë, ose nuk do t’ia merrte parasysh këtë të metë nisur nga përputhja e ideve me të dhe që, si rrjedhojë e të gjitha këtyre, nuk shihte ndonjë të keqe për t’i dalë në mbrojtje, fundi i tij do të ishte edhe më i hidhur. Sepse njerëzit asnjë përfaqësues ideje nuk e kanë pranuar dhe miratuar dot si të tillë qysh në të gjallë. Mirëpo ç’dobi ka ai nga tatanatë dhe cilësimet diferencuese e superlative pasi të ketë vdekur?”

Qëllimi final

Cila ishte kauza e Mehmet Akifit? Synimi final i tij, sipas shprehjes së Senijuddin Beut - “ideali”, “Lejlaja” e tij për të cilën ai jetoi pa bërë lëshime dhe në rrugën e së cilës flijoi çdo gjë të vetën, për të cilën vuajti, mbeti vetëm dhe, më në fund, humbi edhe vatanin?

Nevzad Ajas (1888-1966) që e ka studiuar këtë dhe që i ka parashtruar konkluzionet përkatëse në trajtesën e tij, *Akif ve İslamcılık* (“Akifi dhe islamizmi”), pasi shkruan se qëllimi final i Akifit ishte “islamizmi”, e shtjellon kështu se ç’kuptonin Akifi me shokë me këtë fjalë:

Muslimanizëm formal dhe real

Islamizëm është njëra prej shprehjeve që filluan të përdoren tek ne pas Kushtetutës. Në një shoqëri muslimane nuk është e lehtë të kuptohet se ç’kërkohet të thuhet me “islamizëm”. Sepse, në fakt, duhet që koncepti “islamizëm” të përmbahet brenda konceptit “muslimanizëm”.

Edhe nëse aspekti teorik i çështjes është i tillë, po të shohim nga dukuritë, nuk mund të pretendojmë se çdo shoqëri muslimane dhe çdo musliman është islamist, domethënë, se është i pajisur me bindje në përshtatje me frymën e fesë islame dhe, gjithashtu, se është i përforcuar me urdhra që kjo



fe kërkon për praktikimin e saj. Ky dallim midis muslimanllëkut verbal ose formal dhe muslimanllëkut praktik ose real bie në sy edhe në bindjet, edhe në praktikë edhe, veçanërisht, në jetën moralo-etike.

Në fakt, në shekujt e fundit, siç ka ndodhur në të gjitha shoqëritë islame, edhe tek ne, elementet dinamike të muslimanizmit dhe parimet e shëndosha të tij që funksionojnë si një fuqi motivuese, janë lënë mënjanë duke u lidhur vetëm pas elementeve pasivë që i përkasin formës. Edhe kuptimet dhe vlerat moralo-etike të adhurimeve, shenjave dhe mjediseve të kultit, që të gjitha këto, të aspektit formal, janë nënvleftësuar.

Distancimi i muslimanëve nga Islami

Prandaj, duke u menduar mbi çështjen e diminucës së shoqërive islame, veçanërisht ndër europianët filluan të pretendohen edhe ide, sipas të cilave “feja ishte shkak që muslimanët kishin mbetur pas në civilizim”. Krahas kësaj, mes autorëve perëndimorë janë dukur të tillë që kanë shkruar se mes muslimanizmit dhe mënyrës së jetesës së muslimanëve të sotëm ka ndryshime të mëdha.

Me kalimin e kohës, kjo çështje është bërë temë debatesh edhe mes muslimanëve. Njëri prej rezultateve si produkte të këtyre insinuatave dhe debateve, është se muslimanët kanë mbetur të detyruar të mendohen thellë mbi marrëdhëniet mes mendësisë dhe mënyrës së jetesës së tyre, nga njëra anë, dhe parimeve të fesë së tyre, nga ana tjetër. Ata që janë menduar thellë, nuk janë vonuar të kuptojnë se në bindje dhe praktikë, muslimanët janë larguar shumë nga fryma e Islamit. Edhe ata që kanë përvetësuar konkluzionin se “muslimanllëku është pengesë për përparimin”, janë ftohur nga feja ose kanë mbetur indiferentë ndaj temave fetare dhe kulturës fetare.

T’ua shpjegosh muslimanëve Islamin

Ata që kanë besuar se rënia në botën islame është shkaktuar jo nga përmbajtja dhe natyra e fesë islame, por nga ecja në rrugë të gabuara në shpjegimin dhe praktikimin e konkluzioneve dhe urdhrave parimore të bindjes dhe praktikës të kësaj feje, formuan opinionin se esenciale është t’u shpjegohet muslimanëve se ç’është muslimanizmi. Në një shoqëri muslimane, pikërisht kjo ide duhet të jetë pikëlëvizja gjatë përpjekjes për të kuptuar se ç’është islamizmi.

Disa nga mendimtarët tanë që ecnin sipas idesë së islamizimit të muslimanëve, i mbajtën më të gjerë kufijtë e qëllimit të islamizimit. Më në fund, filloi të përdorej shprehja “islamizëm”.

“Islamizmi”

Në këto kushte, “Islamizëm”, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është përpjekja që, duke i shpëtuar shoqëritë islame nga besëtytnitë, t’u shpjegohet fryma e Islamit, të bëhen ata muslimanë të vërtetë në besim (bindje) dhe praktikë; në kuptimin e gjerë të fjalës, është që, duke e çuar këtë përpjekje më tej, të punohet në botën islame, në shoqërinë islame, për sigurimin e solidaritetit material dhe moralo-shpirtëror që imponon uniteti i lindur nga vëllazëria fetare.*

“Mendësia e shekullit” dhe reformizmi

Mehmet Akif Beu i cili u përshtatej plotësisht urdhrave të Kur’anit dhe sunnetit, traditës së Pejgamberit Muhammed (a.s.), si dhe që e shihte në këtë rrugë çdo lloj shpëtimi të muslimanëve, ishte një dijetar sunnit me besim të plotë, i sinqertë dhe parimor, poet dhe mendimtar.

Shkaqet që muslimanët kishin mbetur prapa dhe shtypeshin nga armiqtë e tyre, i shihte në faktin që, gjatë treqind vjetëve të fundit, muslimanët e kanë nënvleftësuar dhe lënë pas dore, nuk e kanë kuptuar dhe zbatuar siç duhet rregullsinë hyjnore të Islamit, përfshirë këtu plotësisht këtë botë dhe ahiretin, jetën e pastajme, e cila i bën të lumtur besimtarët. Prandaj, muslimanët që i njuh për vëllezër, i kritikon dhe ua thotë të metat si një mik që i digjet zemra.

Ata që kanë dashur t’i poshtërojnë muslimanët duke i përdorur armiqtësisht të njëjtat të meta për ta diskredituar Islamit, duke përfituar nga ky moment, janë përpjekur ta bëjnë Akifin mbështetës të tyre. Ata janë përpjekur ta tregojnë atë sikur ka dashur novatorizëm dhe reformë në fe!

Ndërkaq, vihet re se edhe disa autorë fetarë të mbetur nën ndikim për shkak të shqetësimeve shpirtërore, të cilët, duke u dhënë rëndësi personaliteteve të errëta dhe ideve të dëmshme të personave të tillë, kanë rënë në këtë kurth.

* Shkaqet e mbetjes prapa të shoqërive islame, dallimi midis muslimanizmit dhe jetesës së muslimanëve të sotëm, islamizimi i muslimanëve të larguar nga Islami, islamizmi dhe një informacion i gjerë dhe i drejtë mbi strukturën shtetërore të Islamit, të gjitha këto, gjenden në veprën prej tetë broshurash, të përgatitur prej nesh për botim, të Said Halim Pashait me të cilin Mehmet Akifi pati të njëjtat mendime dhe dy nga librat e të cilit i përktheu nga frëngjishtja: Said Halim Pasha, *Buhranlarımız ve Son Eserleri*, 3. baski, *Istanbul 1988*, 48+335 sayfa, *İz Yayınları*.

Këta, vargun me kuptim krejt të qartë të Mehmet Akifit, “... duhet ta themi Islamit sipas mendësisë së shekullit...”, që do të thotë “... të përpiqemi për t’i kuptuar më mirë Islamit, të vërtetat e përjetshme të Kur’anit, me ndihmën e njohurive që zbulohen një e nga një çdo ditë...” e kanë shtrembëruar në formën e lëshimit pe përballë Perëndimit dhe pretendojnë se ka bërë gabim. Këta janë njerëz mendjengushtë të pasionuar për të treguar se “edhe një musliman si Akifi ka mbetur pas prej tyre”!

Injorantë që s’kanë turp!..

Edhe Ahmed Agaogllu, një nga prijësit e novatorëve jashtislamë në Turqi, me origjinë shiite, në artikullin e tij të shkruar pas vdekjes së Mehmet Akifit, duke rrëshqitur në të njëjtën dredhi “për ta bërë mbështetës”, shkruan për Akifin se: “*ishte një mendimtar që kërkonte të bënte ndryshime të thella në fe*”. Eshref Edib Beu që e mori këtë shkrim në librin e tij, ka bërë këtë shënim:

“Ne as që kemi dëgjuar ndonjë fjalë nga Akifi se ‘dëshironte të bënte ndryshime në fe’, e as që kemi parë ndonjë shkrim të tij me këtë ide. I detë dhe poezitë e tij në këtë rrugë ishin për zgjimin e Islamit (muslimanëve)...”.

Në poezitë dhe shkrimet e Mehmet Akifit ka shumë vende që tregojnë për personalitetin e tij të vërtetë dhe të sinqertë, të moderuar dhe sunnit. Janë të njohura këto vargje dhe vazhdimi i tyre që i diskreditojnë reformistët:

Shihni ç’ditë që erdhën për ne: pesë a gjashtë kopukë

Së bashku me përkrahësit e tyre, që të gjithë ca bishtrrjepur,

Dalin paturpësisht e tentojnë të japin opinion, të të tregojnë rrugë!

Është me të vërtetë e vështirë të jesh i durueshëm para kësaj!

Vendi i shenjtë i shariatit s’është ahur... Hiqur që aty

Dhe kërkoni për vete ndonjë vend tjetër, o injorant me brirë!

Novatorë me ide të prishura

Rreshtat e mëposhtëm që po i citojmë tekstualisht nga një artikull i tij i shkruar në fund të vitit 1912 dhe ku i parashtrori dhe shtjelloi njohuritë e tij mbi këtë temë, do të jetë e mjaftueshme për t’ua mbyllur gojën edhe kundërshtarëve të qëllimshëm, edhe miqve indiferentë e naivë:

“Kohët e fundit u prodhuan ata që kërkojnë ose eliminimin e plotë të muslimanizmit, ose duke e lënë të vjetrën, të realizojnë një novatorizëm në

shariat. Ne i dëgjuam thëniet e këtyre burrave, ua lexuam shkrimet. Dhe, më në fund, u bindëm se ata që thonë 'të eliminohet feja', s'marrin vesh fare nga kjo botë, kurse ata që ushqejnë idenë e 'realizimit të një novatorizmi', s'marrin vesh fare nga feja!

Sigurisht, po qe se këta burra nuk do të tregoheshin indiferentë aq sa të mos e shihnin frymën eternale që sundon sentimentet dhe veprimet e miliona njerëzve, nuk do ta përfytyronin dot as nevojën, as dhe mundësinë e eliminimit të fesë!

Po si kjo, nëse do të merrnin pakëz informacion mbi natyrën autentike të shariatit, do të shihnin me sytë e vet se, jo vetëm nuk do të mund të bëhej fjalë për futjen e 'së resë' në fe, përkundrazi, do të ishte nevojë e paevitueshme për t'u kthyer në formën e saj më të vjetër, domethënë, në formën e saj autentike!

... Më në fund, le të heqim dorë nga këshillimi i këtij ummeti, i kësaj bashkësie, që të vishet me moralin e kombeve gjermanë, anglezë dhe francezë, dhe të përpiqemi që t'ia mësojmë kuptimin e Islamit...". (Sebilurreshad, vëll. 9, nr. 223, f. 261, 19 dhjetor 1912)



VEPRAT

Veprat e Mehmet Akif Ersojit mund të klasifikohen kryesisht në dy grupe të mëdha: në *vepra të shkruara në vargje ose, shkurt, poetike*, dhe në *vepra të shkruara në prozë ose, shkurt, prozaike*.

- I. Veprat poetike:
 1. *Safahat*
 2. Poezitë e mbetura jashtë *Safahatit*
- II. Veprat prozaike:
 1. Komente ajetesh kur'anore
 2. Vazet ose predikimet
 3. Artikujt
 4. Përkthimet
 5. Veprat ose shkrimet e tjera
 6. Letrat

Safahat

Safahat është emërtimi i përgjithshëm i përmbledhjes poetike të Mehmet Akif Ersojit.

Kjo është një përmbledhje librash poetikë me emërtime të veçanta. Libri i parë titullohet *Safahat*. Kurse librat e tjerë kanë tituj të tjerë. Librat që e përbëjnë këtë përmbledhje, janë shtypur në kohë të ndryshme si vëllime më vete. Të gjitha botimet e gjashtë librave të parë janë bërë në Stamboll, kurse libri i shtatë është shtypur në Kajro.

Të dhënat mbi numrin e vargjeve, poezive dhe botimeve të të shtatë librave janë si më poshtë:

Safahat: 44 poezi, 3.084 vargje; tre botime: 1911, 1918, 1928.

Në qyrsinë e Sulejmanijes: 1 poezi, 1.002 vargje;; katër botime: 1912, 1914, 1918, 1928.

Zërat e të Vërtetës: 10 poezi, 482 vargje; tre botime: 1913, 1918, 1928.

Në qyrsinë e Fatihut: 1 poezi, 1.692 vargje; katër botime: 1914 (dy botime), 1918, 1924.

Kujtimet: 10 poezi, 1.314 vargje; tre botime: 1917, 1918, 1928.

Asimi: 1 poezi, 2.292 vargje; dy botime: 1924, 1928.

Hijet: 41 poezi, 1.374 vargje; një botim: 1933.

Safahat do të thotë: *etapat, fazat, periudhat* dhe, me një kuptim më të gjerë, *dukjet, pamjet*.

Të gjitha poezitë e kësaj vepre janë shkruar në origjinal me metrikën prozodike *arud*. Forma dhe madhësia e poezive fillon nga një strofë e shkon deri te një monokolonë prej 2.292 vargjesh siç është poezia *Asimi*.

Libri i parë: Safahat

Në këto poezi trajtohen çështje njerëzore e shoqërore. Duke tërhequr vëmendjen e lexuesit, kërkohet të mendohet mbi to dhe, si përfundim, të gjendet zgjidhja e duhur. Krahas: *varfërisë, sëmundjes, dobësisë*, tregohet edhe rruga e: *ndihmës, bamirësisë dhe shpresës. Injoranca, despotizmi dhe vesi i pijes* përshkruhen me hollësi që shkaktojnë neveri dhe urrejtje. Përballë dobësisë dhe vështirësive të jetesës, poeti fton për *punë dhe vendosmëri*. Në vepër shprehet *mahnitja dhe admirimi ndaj forcës ngushëlluese dhe qetësuese të besimit dhe ndaj të fshehtave të botës hyjnore*.

Libri i dytë: Në qyrsinë e Sulejmanijes

Liria kushtetuese e pritur erdhi, por duket se, jo ashtu siç mendohej, ka për ta shpëtuar vendin. Në të gjithë vendin përjetohet një *anarki* nga moskuptimi i lirisë së fjalës dhe mendimit. Duke filluar me gazetën, *çdo njeri shan tjetrin*, partitë dhe nacionalizmi po e copëtojnë vendin. *Intelektualët* kërkojnë të shkojnë pas Europës duke lënë mënjanë fenë dhe çdo gjë kombëtare, kurse *populli* del kundër çdo të reje edhe sikur të jetë e mirë dhe me vend. Ndërsa *intelektualët* e kuptojnë fenë gabimisht dhe përpiqen ta eliminojnë, *populli*, duke e lënë fenë e vërtetë, merret me besëtytni dhe besime të kota. *Letërsia*, ndërsa duhet ta shtyjë popullin te e mira dhe e bukura, e nxit për te prostitucioni.

Poezia zhvillohet në formën e një predikimi në xhaminë Sulejmanije.

Libri i tretë: Zërat e së Vërtetës

Pasojat e rënda të paralajmëruara nga M. Akifi nga *Qyrsia e Sulejmanijes* erdhën një nga një. Lufta Ballkanike, copëtimi kombëtar, anarkia e brendshme duket se po e çojnë vendin drejt shkatërrimit të plotë.



Duke parë se të gjitha këto fatkeqësi vijnë nga injoranca, nga moskundërshtimi i të keqes dhe dembelizmi, poeti u drejtohet burimeve ideale ku gjendet e vërteta dhe orientimi. Nga dhjetë poezi prej të cilave përbëhet ky libër, tetë janë frymëzuar nga ajetet e Kur'anit, një poezi është frymëzuar nga një porosi profetike, kurse e fundit është një poezi mjaft e hidhur e cila i bën thirrje Pejgamberit për ndihmë.

Libri i katërt: Në qyrsinë e Fatihut

Përbëhet prej dy pjesësh me titull “Dy shokë në rrugë të Fatihut” dhe “Vaizi në qyrsi”.

Pjesa e parë prej 322 vargjesh përbëhet nga biseda mes dy shokëve që zbresin nga vapori në urën e Gallatës dhe shkojnë në xhaminë Fatih. Çështjet e shoqërisë dhe kulturës që bisedojnë shokët janë dhënë me një stil të mprehtë ideor e të këndshëm në shprehje.

Biseda që bën vaizi në pjesën e dytë, i ngjan bisedës që pati bërë poeti vetë gjatë ditëve të Luftës Ballkanike nga qyrsia e kësaj xhamie. Në fillim trajtohet *rregullsia hyjnore* në gjithësi. Në qiej e në tokë, çdo gjë funksionon brenda një rregullsie të përsosur dhe pa u ndalur. Sikur një copë e vogël të mos e kryejë detyrën, kjo mund të shkaktojë përmbysjen e gjithësisë. Edhe njerëzit i nënshtrohen të njëjtit ligj. Ja *Perëndimi punëtor* që komandon në qiej e në tokë dhe ja *Lindja dembele* në mjerim, së cilës, më në fund, do t'ia hedhin kërmën në një gropë!

Libri i pestë: Kujtimet

Fatkeqësitë si pasojë e *Luftës së Parë Botërore* të ardhur menjëherë pas Luftës Ballkanike, e bëjnë poetin të shkruajë përsëri poezi si tek *Zërat e së Vërtetës*. Të tilla janë shtatë poezi që ndodhen në krye të librit dhe që janë botuar mes korrikut 1913 dhe shkurtit 1915.

Poezia e tetë prej 126 vargjesh, e titulluar *Në el-Uksur*, është shkruar e frymëzuar nga përshtypjet e M. Akifit prej gërmadhavë të el-Uksurit (Luksorit) që pa ai gjatë udhëtimit në Egjipt në fillim të vitit 1914. Duke përshkruar mjedisin, poeti, me anë të një asociacioni të krijuar në mendjen e tij pasi ratis në një grup udhëtarësh, rikthehet përsëri te çështjet e Islamit.

Pjesën më të madhe të librit e zënë *Kujtimet e Berlinit* prej 608 vargjesh. M. Akifi që ndodhej në fund të vitit 1914 dhe në fillim të vitit 1915 në Berlin, e shkroi këtë poezi e cila është një vepër ideale me rëndësi si produkt i vëzhgimeve dhe meditimeve të tij në atë vend.

M. Akifi kishte hetuar dhe studiuar shkaqet e përparimit dhe lartësimit të shoqërisë gjermane dhe kishte arritur në konkluzionin se *shpirti me lëndën* dhe *feja me botën materiale* duhet të shkojnë dorë për dorë, ndërsa në vendin e tij ndodhte krejt e kundërta! Në vendin e tij, *sistemi arsimor-kulturor* i përgatiste të rinjtë larg jetës, vetëm si *konsumatorë*; *letërsia e vjetër ia kishte mpirë mendjen popullit*, kurse *letërsia e re përhapte imoralitetin*; etj.

Pjesa e fundit e *Kujtimeve* është poezia *Nga shkretëtirat e Nexhdit në Medine* me 204 vargje.

Një vend të veçantë në këtë poezi zënë mbresat e fuqishme të poetit nga vizita e varrit të Pejgamberit, ku spikatin *dashuria dhe malli për të Dërguarin e Madh!*

Libri i gjashtë: Asimi

Kjo poezi prej 2292 vargjesh të cilën Sulejman Nazifi e ka cilësuar si *mrekulli poetike*, është vepra mbi të cilën M. Akifi ka punuar më shumë. Idetë, ndjenjat dhe emocionet e poetizuara pjesë-pjesë në veprat e mëparshme, këtu janë përmbledhur duke u rishprehur me një gjuhë shumë të bukur dhe një shprehje të mrekullueshme.

Kjo vepër mund të shqyrtohet në dy pjesë:

a) *Biseda mes Imamit Qose dhe Hoxhazadesë*. Kjo përbën pjesën më të madhe të veprës. Këtu debatohen pothuajse të gjitha çështjet njerëzore individuale dhe shoqërore duke filluar nga ato të mjedisit më të afërt. Ndërkaq që të dy janë besimtarë dhe përkrahës të lirisë dhe së resë, imami Qose është më konservator dhe kritikues, kurse Hoxhazade më novator dhe tolerant. Hoxhazade vihet në mbrojtje të brezit të ri përballë imamit plak Qose.

b) *Biseda mes Hoxhazadesë dhe Asimit*. Në këtë pjesë, Hoxhazade, pasi i tregon Asimit se pse ka mbetur pas shoqëria e tyre dhe se cilët janë faktorët që e ngrenë lart shoqërinë, i thotë se ajo që pritet prej tyre atë ditë nuk është grushti, por arsimimi. Ai i thekson se zhvillimet materiale nuk e bëjnë dot të lumtur shoqërinë të vetme, mirëpo edhe popujt që s'janë të fortë materialisht, nuk mundën t'i ruajnë moralin dhe vlerat e tyre. Vepra merr fund me nisjen e Asimit, i cili ia dëgjon fjalën poetit, bashkë me shokë për në Gjermani për të studiuar.

Heroi i veprës është *Imami Qose*, miku i dashur i M. Akifit, Ali Shevki Hoxha, kurse *Asimi* është krejtësisht një *hero i imagjinuar*.



Libri i shtatë: Hijet

Ky libër është shtypur më 1933 në Kajro. Poezia e fundit e këtij libri dhe e gjithë përmbledhjes është poezia *Artisti* prej 208 vargjesh e shkruar më 1933.

Kjo poezi, pjesa e dytë e së cilës fillon me vargun, “*lumturi; ashtu, ë?..*”, është një nga poezitë më të bukura, më të larta e më prekëse të *Safahatit*. Në këtë poezi, nëpërmjet gojës së *Artistit*, M. Akifi ka shprehur poetikisht me një gjuhë shumë prekëse dhe me një qëndrim të nënshtruar ndaj fatit, por të hidhur, jetën e vet të kaluar me zhgënjime dhe hidhërimë, botën e vet të ndjenjave dhe jetën plot vuajtje e dëshpërime të botës islame.

Poeti i madh, i cili e filloi veprën e vet poetike me poezinë ku thoshte, “*qaj, por s’e bëj dot kënd të qajë, ndjej e s’e them dot*”, e mbaron me këto vargje që të kujtojnë një lamtumirë:

*Kur zbres në thellësitë e zemrës, dridhem sepse
Shenja në krye të emrit tim është shenjë fundosjeje.
Po, shenja e fundosjes, por e thellë sa mosqenia
E diejve të mi të fundosur,
Lindja e të cilëve ka mbetur për në ringjallje.
Po emocionit yt, pse? Loti në fytyrën tënde ç’është?
Mos e ngacmo në fund udhëtarin, ej, shok udhe i mirë!
Zoti e di se zemra nuk duron dhe në qoftë gur,
Të derdhet ai rrebesh që përcillet në sytë e tu!
Jo, Më djeg mua të dal i njohur me hallin tim,
Lërmë të qaj, ti hiqmu mënjënë!
A mos më mbeti pa parë në këtë botë shqetësim?
Lërmë, të shkoj të paktën këto lot pa i parë!*

M. Ertugrull Dyzdag



Libri i parë
FLETËT



*Kujtimet të tim biri,
Mehmed Ali, ia kushtoj!***

* Mehmet Ali: Biri i Myshir Ratip Pashës, nxënës i zgjedhur dhe i dashur i poetit.
(Të gjitha përkthimet e ajeteve të Kur'anit në këtë vepër janë marrë nga përkthimi i H. Sherif Ahmetit - Botuesi)



Pyetmë, lexues i dashur, të të them
Ç'identitet kanë këto poezi që të rrinë karshi:
Një mal me fjalë, që vleftën e kanë te singëriteti;
S'di të bëj art, pasi nuk jam artist!
Lot syri - thonë për poezinë; s'e di; vetëm se
Lot i pamundësisë sime janë veprat e mia!
Qaj, s'ju bëj dot që të qani; e ndjej por s'mund ta derdh në fjalë;
Zemra s'më ka gjuhë, pra jam i shqetësuar!
Lexo, nëse ke nevojë për një zemër që ndjen,
Lexo se këtë shkrova, dy fjalë në paça shkruar...

XHAMIA FATIH

Me ateizëm janë ringjallur mendimet e mjera ,
 Kjo përmendore dëshmie çau nëpër kohë e u lartësua.
 Kohët e shkuara, si re të zeza devijimi rreth kësaj
 Largohen e ikin menjëherë, madje, pa qëndruar fare.
 E ardhmja është në agimin e dritës së të vërtetës,
 Vjen e derdh mbi të dritëra që s'kanë të shuar.
 Fanarët kanë hapur krahët me guxim e shpresë,
 Bukurinë e botës hyjnore për ta përçafuar.
 Ato dritare të kredhura në bukurinë hyjnore larg dukjes,
 Janë sy para të cilëve gjithë enigmat janë zbuluar.
 Mbi këtë faltore të shenjtë shkëlqejnë shpirta tufë-tufë,
 Nën këtë kube të lartë dritëra valë-valë të entuziazmuar.
 Sikur të jetë trupëzuar shpirti i mëngjesit të përgjumshëm
 Ose bukuria hyjnore, si në Siná, mbi tokë të jetë shtruar. N'sa
 natyra është kredhur në gjumë mbuluar me errësirën,
 Si të ishte zemra dritësore e natës së gjatë, ajo pret zgjuar.
 Po, zemër është ajo, zemra entuziaste e një ashiku,
 Nga brenda së cilës lartësohen pa pra zikre të zëshme.
 Kuptimi i lartë i gjoksit të islamit duket në ballë të saj;
 Ajo si një masiv gurësh me frymën e gjoksit të frymëzuar,
 Është ngritur, është lartësuar si simbol i dritës!
 E si të mos bëhej kur, edhe pse kanë kaluar shekuj,
 Këto mure të heshtur ende i tregojnë gjoksin çdo sulmi
 Të blasfemisë dhe një çast të vetëm pa u dobësuar?
 Kjo s'është pamje, por karvani i shikimeve në fytyrën
 e të Dashurit!
 Kjo s'është faltore, por adhurim madhështor për të Adhuruarin!
 S'ka zbritur nga qielli, por, pa dyshim, është qiellore,
 Një shfaqje tejfizike, sublime, e frymëzuar!

* * *



Një shpërthim dëlirësie është, agimin shumë e dua;
Të dashur e shpirt e kam, është më e mira kohë për mua.
Dora e qiellit mbulesën e natës ende s'e kish zbuluar
Dhe flladi i mëngjesit nga gjumi i qetë ende s'ishte zgjuar,
Kur zëri i përgjumur i myezinit si salá plot hidhërim
Jehoi valë-valë në kupën qiellore të shpirtit tim.
Pa pritur dot ezanin, në ekstazë të plotë nëpër sokakët
E mbështjellë nga errësira përshkova
Dhe para një shesh m'u shfaq: në xhaminë Fatih isha, e kuptova
Dhe, si u afrova edhe pak, pashë se xhamia priste zgjuar;
Dhe u kredha, më në fund, në gjoksin e saj të ndriçuar
Dhe u ula në radhët e para në një prej mahfileve* të veçuar...

Kandilët si yje në hapësirën e kubesë,
Vargun e dritave vezulluese të varur në qiellin e faltores
Me t'i parë, kohët e fëmijërisë se ç'kujtova;
Eh, sikur ta dinit, pastaj, aty atë orë ç'mendova!..

Isha në të tetat. Vinte babai e na thoshte:
“Sikur të shkonim, o fëmijë, në xhami herët sonte!
Ejani, po të doni, veçse urtë të rrini!
Po erdhët për prapësi, shtëpinë ja ku e kenil!”
Dhe na merrte, pastaj, mua e tim vëlla me gaz
E shkonim; pastaj, sa të drejtohej ai në namaz,
E të kridhej e, më në fund, unë të mbetesha i lirë,
Eh, ç'bridhja atëherë me dashuri mbi rrogozë!
Imagjinata më çoi tridhjetë vjet më parë;
Nisa, atëherë, pranë vetes duke parë
Një burrë të pastër, pesëdhjetëepesëvjeçar, të fortë,
Por mjaft të thinjur e me sarëk të bardhë,
Fytyrëndritur, që falte namaz me mjaft edukatë,
Me një çupëz dhe një djalë pranë mjaft të prapë.
Burri falej. Djali me sarëk jeshil e pa xhufkë

* *Mahfil*: lozhë, e ndarë për qëllime të caktuara në xhami.

Në ballë. Mbështjellja e jeshiltë herë i prishej,
 Herë i mblidhej e herë i valëvitej si flamur në erë.
 Kështu vërtitej përreth djali gjersa thuhej “amin”
 E namazi merrte fund; e atëherë ai plak fytyrëndritur
 Ngrihej, i merrte fëmijët e shkonin: djali me fener
 Në dorë u printe e, kur arrinin në shtëpi, djali
 Binte i lodhur në një gjumë të thellë...

Ndërkaq, këto kujtime t'ëmbra

U tërhoqën në origjinë dhe, më në fund, para
 Nisi të bënte naze fytyra e plotë e të vërtetës;
 Fundja, dhe kohë më s'kish mbetur t'i vë vesh imagjinatës!
 Ndërsa djathtas e majtas, para e pas vendi më ish mbushur
 Me hije të njerëzve të përkushtuar e të mahnitur.
 Një thirrje e lartë e tundi nga vendi atë botë përlulësie
 Duke e kthyer mjedisin në ditë ringjalljeje
 Dhe radhët ngritur në këmbë qenë si vargmale gjëmuese,
 Nga gjoksi i të cilëve ngrihej një vaj lutjeje
 E një përgjërëm i dhimbshëm që, pa dyshim,
 Zemrën e mëshirës e ngashëreu dhe ato vargmale
 U dukën një herë në një përkulje të thellë para Madhështisë,
 E, pastaj, të rënë në truallin e devocionit dhe përlulësisë!
 Dhe, kur Udhëzuesi me vigjilencën e Tij e ngriti në këmbë secilin,
 I hapën duart drejt qiellit ato male në lutje plot përgjërëm;
 Atë çast nga zemrat u këput një klithmë e tillë
 Që shpirti ka për të ma kujtuar atë tmerr gjer në amshim.
 Dhe, për një farë kohe, zëri rënkues u pre...

Ç'u bë ajo qarje zemërpërvëltonjëse e ngjitur gjer në qiej,
 Ai besimi brenda n'ngazëllim?

Po, ja tek vrapoi mëshira hyjnore
 Dhe fryu mbi zemra nga kubeja një frymë:

Fryma e qetësisë shpirtërore!



I SËMURI

Kjo ngjarje ka ndodhur në Shkollën Bujqësore Hallkallë

- Unë them, doktor, zhvisheni e dëgjojeni
Se sëmudjen s'e ka dhe aq pa rëndësi.
Vetëm një ftohje gjoksi? Ku ta gjesh!
Gjendja e djalit u keqësua këto të fundit ditë.
Dhjetë ditë më parë, kur klasa dilte në praktikë,
A s'doli dhe ky? I thashë: "Kush të tha, o bir, të vish dhe ti?
Njeriu me ethe duhet t'i ruhet lodhjes;
Eja, o bir, dëgjoma fjalën e shtrihu një çikë!"
Ka qysh atëherë që dobësia i përparon.
Duket tepër e vështirë të ngrihet dhe një herë!
Gjumë s'paska; natën gjithë u kollitka; zjarrmi
S'paska, i paska rënë pak...

- Fundja, unë, një muaj më parë

E dija se sa me rrezik qe puna e tij...
Ç'vlerë ka se m'i thoni mua këto tani?
Prapëseprapë, le ta shohim sërish me kujdes:
Të marrim një vendim të prerë; s'duhet lënë të presë.
- Thirreni të sëmurin të vijë!

- Një djalë shtatgjatë

Hapi perden e derës dhe hyri duke rregulluar festen...
Ish një figurë, një figurë e tillë e brishtë
Që kurrë s'kam për ta harruar:
Me fytyrë të çngjyrosur, me sytë të futur thellë,
Me mollëzat të dala në të dy anët para.
Tëmthat duke shtegtuar, e kishin ngjeshur kafkën,
Balli i ish hedhur para bashkë me damarë!
Çehrja si hi i ish bërë nuri i rinisë duke i fluturuar,
Ato faqe si trëndafil i fishkur, pa gjallëri!
Buzët i ishin nxirë, lëkura u ish holluar,
Secili prej qerpikëve zgjatur si flok i lëshuar!

Koka, si një peshë e rëndë, mbi qafë kish rënduar,
 Dy supet si dy shkopinj ishin zgjatur sipër e drejtuar!
 - Ulu, o bir, të të dëgjoj me kujdes...

Por më parë zhvishu.

- S'kam fuqi, zhvishmëni ju!

E zhveshën të pashpresin dy-tre vetë bashkë, atëherë
 Doli në shesh një statujë mjerimi lakuriq!

Ky skelet eshtrash s'kishte gjë për t'i dëgjuar,
 Megjithatë, m'u duk se mëshira e mjekut bëri krye

E ai, duke menduar se mos e rëndonte më keq

Të sëmurin duke mos e parë, iu afrua gjoksit:

- Kollitu, bir, ... merr frymë, ... mos merr frymë, ...

Në rregull, vishu! Pa të ta shohim pulsin! Shumë mirë!

Po të shkruaj kodeinë ... ke kollë ... kodeina ta pushon...

Merr dhe arsenik, i them unë farmacistit;

Shko, tani dhe ki kujdes, ë! Shihe veten!..

- Ç'thua, doktor?

- Ç'mund të thuhet? Djali është nisur për atë botë!

Mushkëria e majtë i është tharë krejt:

Janë shenjat e periudhës së tretë të sëmundjes së mallkuar,

Të gjitha shenjat, të plota, asnjëra nuk mungon,

Si në frymëmarrje, edhe në frymënxjerrje...

- Mjaft!

Çehrja e të sëmurit është sheshit! Ai ka nevojë

Për ndryshim të klimës, po si ta dërgojmë? Na vdes në rrugë;

Katër-pesë ditë i kanë mbetur në këtë botë...

Edhe po t'i themi shko, është mundim!

Po edhe të mos e dërgojmë, tjetër mundësi s'dimë!

Kujt t'ia qajmë hallin? Na gjej dikë që të na kuptojë!

- Drejt po thua, zoti drejtor, s'kemi ç'bëjmë,

E vetmja zgjidhje, djali duhet të shkojë: një javë jetë ka

Dhe sëmundja është ngjitëse, pra edhe shkolla

Është e justifikuar një të sëmurë të tillë duke e dërguar...

- Thirrni një kujdestar!



- Urdhëroni, zotëri!

- Pa shih këtu:

Siç duket, largimi i të sëmurit do të jetë me domosdo!
Merrja mendjen: “Doktori të ka këshilluar ndryshim klime,
Shëtitja të lehtëson...” Po të tha se s’do,
Përpiqu ta bindësh; kush e di,
i mjeri djalë s’ka kuptuar gjë ende tanimë!

* * *

- A klima më paska mbetur më në fund?
Ç’më duhet klima mua?
Lërmëni në hallin tim, të vdes i qetë!
Tre vjet e gjysëm më pranoi kjo shkollë, a bëhet kiamet
Po të më durojë edhe tri ditë?
Dhe pse duhem përzënë unë nga një vend
Që më ka strehuar për vite, duke më thënë
“Do të vdesësh”? Kjo është përzënie! Unë jam fëmijë
I panjeri, ku mund të shkoj e të gjej vend për t’u strehuar?
Mosni, se do të mbetem të përsillem pastaj nëpër sokakë!
Nëna më ka vdekur, tim eti as fytyrën s’ia kam parë!
Një vëlla kam, kurse ai m’i ka ngulur sytë
Sikur mirëqenia ime e supozuar e së ardhmes, me kohë
Ka për ta nxjerrë nga dështimet ku llokoçitet!
O vëlla! Vdekja po t’i përmbys shpresat që ke sajuar,
Pra, groposmë mua në gropën e harresës: unë kam mbaruar!
S’e di për cilën vuajtje timen të qaj, mos t’ju duken shumë
Lotët që kam derdhur: jam viktimë!
A ky është fundi i mjerë i përpjekjeve fisnike?
Po të ma kish thënë këtë dikush qysh në fillim,
S’do ta kisha humbur marrëzisht jetën duke u përpjekur,
Të shkuarën për këtë të ardhme s’do ta kisha flijuar!
Shih, o Zot, këta njerëz që s’kanë mëshirë:
Si të isha një lypës shëtitës më përzejnë!
- S’po të përze kush, këto fjalë s’i ke me të drejtë!

Po s'deshe të shkosh, rri, vetëm se je i sëmurë...

- Dhe jam verem! Thuaje, ç'ka për ta mbajtur fshehtë?

- Jo, ç'thua, s'është ashtu!..

- A të trashë i quani të tjerët?

A më lënë, vallë, sikur të mos shkoj?

Duhet të shkoj... e drejtë... vrap një karrocë!

Dhe doli ai i pashpresi në rrugën e mjerimit

I mbajtur për krahësh nga dy shokë të ndërgjegjshëm

Të klasës së fundit, duke hedhur pas një vështrim

Të hidhur. Dhe iu afrua veremi pajtonit

Që do ta çonte në amshim!

E kapën dhe e hipën djemtë duke e mbajtur me kujdes,

E puthën duke derdhur nga sytë lot për zi!

- Nisu e çoje drejt e në stacion!..

- Jo, jo, më çoj gjer në Stamboll

E lërmë diku në një vend se të vetmuarit e braktisur,

Kur askush s'ua vë veshin, më gjejnë atje

Një shilte për t'u shtrirë e për të vdekur!..



BESIM NË NJË ZOT APO KLITHMË*

O botë-hije të Dritës Hyjnore, hija juaj, madje,
E errët si sekreti i shfaqjes suaj në dukje!
Madhështi e fronit Tënd, ndaj të cilit toka e qiejt
Janë sa një pikë e horizonteve të pafundësisë
Perceptimi yt huton shpresën e njohjes së të Madhit
O Zot, ç'tmerr, o Zot, ç'madhështi!
Sikur të mos i mjaftonte madhërisë Tënde gjerësi e botëve,
Imagjinata ime endacake, disa herë, për të të gjetur Ty,
Kërkon me ngazëllim të ngjitet gjer në hyjnitet!
Mirë, po si mund të arrijë të miraxhit lartësi?
Ndërsa lloqocitet ende në botën e dukshme,
Një dorë e gjithëfuqishme mbështetet në gjoks prore
E ulet imagjinata ashtu e mjerë, ashtu e poshtëruar:
Ende vazhdon të ngrihet toke pluhuri i asaj rënieje të
pamundësisë..
Vetëm imagjinata ime? Një mijë ide të larta për qiellin ka në tokë,
Nga kërkimi të rrëzuara pa fuqi rënkojnë me ah!
Afërsia jote do të përsillet deri në përngjasim?
Kur shpirtrat vetë vuajnë tmerrin e “thumme radednah”,**
Thellimi në enigmën e krijimit të tyre, për ne është i ndaluar?
E si të mos jetë kur veprat e artit më tej mbeten fshehtësi?
E si kërkojnë të dijnë për Diellin që s'ka fillim
Idetë që s'përkapin as dhe nga një grimcë?
O Ti i paanë e i pakufi, çdo gjë që ekziston,
Prej qerthullit të kaderit*** Tënd është e kufizuar!
Kreun e vetive të Tua largësitë s'e nxënë,
Vargun e të mirave të Tua shifrat dot s'i nxënë!
Nga një dallgë e oqeanit të veprave të Tua, shekujt;

* Në origjinal: *Tevhid yâhud feryad*. *Tevhidi është besimi monoteist islam mbi Allahun si një Zot i vetëm me attribute të përshkruara në kreun Ihlas të Kur'anit.*

** ... e *thumme radednah*, e rënies në shkallën më të ulët, e poshtërimit më të madh; pjesë e postulatit kur'anor, *thumme radednahu esfele safilin, Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve!* (Kur'ani, et-Tin: 5)

*** Kaderi: në islam, paracaktimi hyjnor.

Dhe çdo dallgë, një det veprash që s'i njihen brigjet!
 Pafillimi e pambarimi, të nënshtruarit e fermanit Tënd,
 O mbret i fronit të zgjedhur të të Vetëmjaftueshmit!
 Arti Yt i pashoq, i përfaqësuar në gjithësi.
 Edhe sikur të ketë mijra duar shkatërruese,
 As dhe një grimcë njeriu s'ka fuqi për të shkatërruar!
 O Zot, ç'është kjo botë e mbushur plot çudi?!
 I pafillimtë është kufiri i Gjithëfuqisë ,
 Në pafundësi ngjitet bota e detyrëdhënies hyjnore!
 Pushteti Yt, të cilin s'e sundon gjë,
 Në një çast e përshkon boshllëkun që s'di të mbarojë!
 Shih: pa ditur gjë, në kohë të kufizova,
 O Krijuesi Absolut, dhe ja se si gabova!
 Sado të ruhet njeriu të mos ta përngjasojë Krijuesin e Amshuar,
 Meqë është i vdekshëm, e bën Atë të ngjashëm me veten!
 E si mund të gjesh rrugë drejt absolute, o mendim,
 Kur, duke menduar Shpirtin, hijet ke përfytyruar?

* * *

O ti, shpirt, udhëtar i rëndë i hapësirës intime të afërsisë,
 O ti, folës gjuhështangur i të fshehtës së madhështisë,
 Nëse njohja jote është qëllimi i këtij krijimi,
 Thua ka njeri që ka arritur këtë qëllim mrekullues?
 A mos vallë një skenë është kjo gjithësi në vrojtimin tënd?
 Një skenë me miliarda lojra mbi të!
 Një skenë ku çdo perde është jetësim i vullnetit hyjnor!
 Dhe individët, lojë në dorë të fuqisë Sate?
 Ti je ai që i hedh katilë e kriminelë në skenën e krimit;
 Prapë prej Teje buron guximi i katilit e kriminelit!
 Tjetërkush jo, Ti je që krijon dritën dhe errësirën vetë;
 Ti je që frymëzon devocion e imoralitet!
 Nga buron prirja e mizorit për dhunë e padrejtësi?
 Dhe pse i urren dhunën dhe mizorinë i vuajturi?



Nga e dalloi i mençuri këtë veprim serioz?
Dhe pse injoranti s'e mësoi dot edukatën e jetës?
Gjithçka kam parë, bëhet me shtytjen e një fuqie;
Nuk jam determinist;* dhe në jam, o Zot, ç'faj del soje?

* * *

Pra, t'i thuash gjithësisë skenë, gjithsesi është e drejtë,
Vetëm se çdo ngjarje që shihet, është e vërtetë!
Dhe ç'ngjarje, që soditja e saj të jep dëshpërim,
Kurse harmoni e saj rënkim e hidhërim!
Sepse, ndërsa mijra të mjerë klithin në fatkeqësi,
Gjoksi i hapësirës gjëmon me rënkimin e tyre në thellësi!
O Zot, a s'do të heshtë ky zë në zemra një ditë?
Një urdhër rehatimi prej Teje a s'ka për të zbritë?
Çdo çast na tmerron ne me ashpërsinë,**
T'u bëfsha fli, ku ndodhet, ku e ke bukurinë?***
Të gjitha ç'heqim, prej Teje në na vijnë,
Na thuaj, o Zot, prej kujt, kujt t'i qahemi?
Njëmijë pyetje n'u bëfshin fli për "Allahut s'i bëhet pyetje...!"****
Njeriu s'shpëton së pari me tmerr këto mistere!
Mos vallë robërimin ndaj një njeriu një popull i madh
Duke u gënjyer nën emrin tënd e kujton pushtet?
Mos vallë një shpatë përdhune me urdhrin tënd shemb,
Nën emrin tënd, vallë, kështu vret e pret?
Aq zemër u dha mizorëve ndëshkimi yt ndaj nesh,
Sa do të thonë ndërgjegjet me shpresëthyerje, "s'ka të Drejtë
Absolut!"

* Në origjinal: xhebrí, determinist. Sipas fraksionit xhebri (determinist), njeriu është krejtësisht i nënshtuar vullnetit hyjnor; ai s'ka asnjë lloj lirije veprimi dhe nuk mund të ndikojë në rrjedhën e jetës së vet. Ky lloj konceptualiteti është fatalist dhe e çliron njeriun nga çdo lloj përgjegjësie për aktet e veta. Në shumë shprehje të poetit duket sikur edhe ai është determinist, por s'është kështu. Sipas konceptualitetit islam të kaderit të mbështetur në Kur'an, pavarësisht nga paracaktimi hyjnor eternal, njeriut i është dhënë arsye për të zgjedhur, dëshirë për të dëshiruar dhe vullnet për të vepruar, prandaj njeriu përgjigjet gjer më një për të gjitha veprimet e tij.

** Në origjinal: xhelal, i ashpër, i rreptë, ndëshkues; një nga emrat e Allahut.

*** Në origjinal: xhemal: i bukur, i butë; një nga emrat e Allahut.

**** Aludim për postulatën kur'anor, *la jus'elu ammá jef'alu ve hum jus'elun, Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten!* (Kur'ani, el-Enbija: 23)

Nga toka në qiej ngjitet njëmijë ahe të përvëluara,
 Dhe qiejt e kthejnë prapë jehonën e drithëruar!
 Digjen mijra vatra të rinjsh në një anë,
 Shuhen miliona pishtarë zgjuarsie në tjetrën anë!
 Një nënë fatkeqe me duart në ije rri e sheh:
 Rënkon për birin e mbuluar nën të ziun dhé!
 Po qan qëkuri një turmë e tërë e rënë në fatkeqësi:
 Qan se ka shitur nderin për një copë bukë në uri!
 Me qafa përkulur mijra jetimë atje,
 Këtej familjet pa vatër kërkojnë për kryet një strehë!
 Viktima ankohet, s'pranon të pendohet;
 Në gjakun e viktimës i larë krimineli kullon!
 Famë ka marrë bota duke nxjerrë në skenën e saj
 Të sëmurë, viktima fatkeqësie, të zhveshur e të mjerë,
 Invalidë, argatë, të këputur, rënkimtarë,
 Zemërngurtë, të munduar, robër e të dënuar,
 Ah, s'u gjendet fundi me të numëruar!
 A s'vjen te Ti, o Zot, ndonjë pamje e përgjakur?

* * *

Mirëpo te disa prej këtyre njerëzve të mjerë ka shpresë,
 Një shpresë që në zemër si një yll u ndrit:
 Margaritari i besimit është, sa i madh, o Zot!
 Por zemra e ndryshkur pa besim, ngarkesë në kraharor!
 E di besimtari se, përtej kësaj bote disaditëshe,
 Janë botët e një mëngjesi të pambarim!
 Prandaj, dhe në e bëftë atë çdo sekondë e jetës
 Të heqë një mijë e një mundime, e heq çdo mundim
 Kënaqësitë e jetës tjetër duke i menduar,
 I pranon dhimbjet e kësaj jete i bindur e i shpresuar!
 Po një që s'beson, vallë, kush do ta qetësojë?
 S'e nxë horizonti i tij shpërblimin e së nesërmes!
 Për të, tokë e qiej, zbrazëtirë skaj më skaj,



A ka ndonjë vesh bujar ta dëgjojë këtë vaj?
Vetë, në këtë botë të zbrazët, ka rënë rastësisht,
Përreth i janë mbledhur mijra fatkeqësish...
Jeta i kalon çdo çast në përfytyje
Një gjë plangprishëse për të: Vdekja!
Pjesa e tij nga ekzistenca: të vdesë duke rënkuar,
Ja, këta janë ndër njerëz të vetmit më të mjerë!
Shkoiu në ndihmë besimtarëve me mëshirë, o Zot!
Por ateistët i mëshiro më fort!
Të verbër janë, të kredhur n'errësirë,
S'kanë një yll shprese t'u prijë, kanë humbur në prapësisirë!
Ti je që i shtyn ata në këtë natë të zezë, pa dyshim,
Prej Teje do të lindë në pastë për të lindur për ta agim përudhjeje!
Ateisti është i Yti, zemra e monoteistit, po ashtu,
Ç'janë ateizmi me besimin në një Zot? Të të njëjtit burim!
Atëherë pse kjo ndarje? Ky veçim ç'është kështu?
Ç'është shkaku i kundërshtimit të njerëzimit në mendim?
O Zot, a do të vijë një ditë që kjo e fshehtë të dalë në dritë,
Apo do të mbetet si një natë e errët pa agim?
Ndërsa harmoni e madhështisë Sate në çdo atom ndihet,
Ndërsa në çdo melodi të saj mijra gjuhë fliten,
Si mbetet n'errësirë e fshehta e lojës Tënde prore,
O botëra, hije të dritës hyjnore?

KOFINI

Siç më qe bërë zakon, pesë a dhjetë ditë qenë bërë
 Që pata dalë prej shtëpie herët më të gdhirë.
 Mëhalla jonë do të thotë periferi e Stambollit
 Sokakëve s'kalohet po nuk dite not!
 Në çdo hap dallgëzohet një gjol i thellë;
 Sapo ujrat nxihen, kush vjen këtu, ngel.
 Në një dorë të duhet një kandil, në tjetrën, një matës thellësie!
 Në daç të shpëtosh, rrugë tjetër s'ke!
 Në dorë një goxha shkop, rrugën hetoja,
 Në kisha para tokë, shkilja, në kisha ujë, kapërceja.
 -Njeriu përpiqet të qëndrojë në këmbë me sa ka mundësi,
 Por me zemër e di se do të bjerë me siguri!
 Duke shkuar, ashtu, i mbrojtur nën strehët
 E atyre shtëpive gjermadhë, papritmas këmbët
 E prijësit tim* në një gjë të madhe zunë:
 Para një kofin i gjerë shtrihej dhe i vjetër shumë!
 Ish një kofin hamalli... i kujt të qe, vallë?
 Ndërkaq, nja trembëdhjetë vjeç erdhi që matanë një djalë,
 Mori hov dhe i dha kofinit një shqelm me tërbim
 Që u rrokullis i shkreti gjer tej me rrapëllimë!
 - Im atë vdiq nën barrën tënde, kurse ti
 Ende më shtrihesh në mes të sokakut me krenari!
 Atë çast nga shtëpia përballë u duk një grua
 E moshës së mesme:
 - Mos, o bir, eja, mos e copëto!
 Me kofinin ç'ke? S'ka gojë, s'di të thotë një fjalë!
 Yt atë tetë vjet e përdori... dhe thoshte:
 "Një kosh shumë i mbarë, s'mbeta kurrë pa barrë!"
 Po koshi, tani që iku yt atë, mbeti bonjak;
 Me të do të ushqesh vëllanë dhe tët ëmë në prak!

* Këmbët e prijësit tim: poeti shprehet me shpoti për shkopin që i prin për të gjetur rrugën.



S'je dhe i vogël, s'mësove ende ç'punë të pret?

Atëherë dhe unë i fola:

- O ti, dëgjoja fjalën nënës!

Mirëpo djali më bërtiti me fytyrë të thartuar:

- Mjekrosh, a s'ke punë tjetër, në djall s'ke shkuar?

Ç'na rri e dërdëllit aty pa gdhirë mirë?

Mua më digjet zemra: im atë sa një mal, më la!

- Ç'i thua burrit q'e ke si baba? - E ëma i tha.

- Pa shih, i shkreti po të flet me gjithë zemër dhe...

- Lëre, zonjë, është fëmijë, s'ia vë re...

Si e ke emrin, o bir?

- Hasan!

- Hasan, dëgjo:

Ti ke për të dalë i humbur nga ky rrëmbim!

Edhe mua m'u dogj zemra kur jua kuptova hallin...

Por yt atë iku pasi familjen ta la porosi!

Shumë e shumë vite punoi ai e me djersën e ballit

Të rriti ty. Dhe sot duhet të punosh ti,

Ta ushqesh tët vëlla e ta rritësh e jo ta lësh jetim...

- Me kofin? Kështu thua ti?

- Po si, ç'është kjo fjalë?

Mos është turp të punosh, mëkat vallë, barrë të ngarkosh?

Turp është, kur të të punojnë duar e këmbë,

Të shtrish dorën për të lypur, lëmoshë të kërkosh!

- Sa drejt foli! Puthja dorën, o bir, mikut!

- Si, paske harruar, nënë, ditën e bajramit

Fjalët që më tha nusja e komshiut?

"Hasan, daja im është epror në një shkollë-konvikt;

Ti je i zgjuar... Sikur t'i thoshim...

Të të bënte vënd, të mësoje, të bëheshe i shkolluar...

Prit, do t'i them...!" A t'u kujtuan, nënë?

Kurse ti s'do që të mësoj, do që të më bësh hamall

E mora vesh se kjo fjalë do të vazhdonte gjatë,

Kurse unë kisha shumë punë për të bërë...
 I lashë ata e shkova në një rrugë përpjetë.
 Ç'u bë, vallë, tani, i mjeri Hasan?

Vajzës sime të vogël, të prapë, s'i rrihet në shtëpi...
 S'ka shumë ditë që dolëm në Fatih, ishte pasiqindi.
 Kur hymë nga porta e qymyrxhinjve, vajzën
 E tërhoqën devetë; vajza qëndroi e po i sodiste
 Ata trupa me gunga, qafë e këmbë të gjata, vajza u mahniste...
 Ndërsa xhufka nga pas, bishti vetë i saj!
 Ktheva sytë pas: Vërtet, është gjë që duhet parë, kujtova
 Dikush me një shall të gjerë në bel, në kokë abanî*
 Shtatmesatar, fytyrëqeshur, tërë dritë e lumturi;
 I shkonte pranë një çun, ngarkuar një kofin të madh...
 Po vinin ngadalë-ngadalë... Pa shih ç'rastësi:
 Ai jetimi i vogël që pata parë atë ditë në mugëti,
 Vetëm se më i dobët se atë ditë, i rënë në mjerim!
 Këmbët e holla nën gjunjë e poshtë zbuluar
 Nën një këmishë të hollë dridhet, do të ngrijë,
 Këmbët z bathur, kryet zbuluar; ashtu bredh
 Në ballë lidhur një napë e thjeshtë, e holluar,
 S'janë frymë ç'merr e ç'nxjerr, por një rënkim i prerë,
 S'janë shikime andej nga sheh, janë sy që luten të lotuar...

Një mjerim që ecën, këmbëzbathur e kryezbuluar,
 Një ballë trembëdhjetëvjeçar i rrudhur, sa mjerë!

Atë çast nga shkolla e mesme dolën në grup
 Rreth pesëdhjetë fëmijë të prapë që, duke kaluar,
 Qëndronin ku të donin... Dhe, me Hasanin kur dolën përballë,
 U bë një skenë dëshpërimi:
 Të gjithë këta fëmijë mes hareshë rinore
 Vraponin drejt një çerdheje q'i priste e ndriçuar.
 Pastaj do të lozin, sa mirë, ç'bukuri,

* Abanî: copë e mëndafshtë e bardhë me vija të verdha.



Kurse Hasani nën kofinin e pistë që ia la i ati
E që deshi ta bënte copë-copë atë ditë,
Nën shtrëngesën e nevojës do të vuajë për jetë!
Ai s'është thjesht një barrë, por një ndëshkim i fatit ndaj të
pafajshmit;
Sa keq për këtë të dënuar që s'di se ç'faj ka bërë!

TË MOS NDALEMI!

Sadiu* tregon: “Një natë, me një karvan duke shkuar,
 Rruga na ra në një shkretëtirë;
 Rrugëtarët e flajuan pushimin e natës
 Për t’i dalë sa më shpejt mbanë të egrës shkretëtirës!
 Kurse unë që s’kisha më fuqi të ecja e më kish rënduar gjumi,
 Kisha rënë aty, mbi rërë pa kuptuar.
 A e pret karvani një këmbësor të vetmuar?
 Gjersa të arrijë në konak, karvani ecën pa pushuar!
 Mbi krye dëgjova devexhiun të më flasë:
 “Çohu, o rrugëtar i mjerë, karvani të është larguar!”
 Edhe mua po më flihet, po a bëhet pushim në shkretëtirë
 Ku të përgjojnë një mijë rreziqe e një frikë e pakuptuar?
 Arrin atje për ku është nisur, ai që ecën pa pushuar,
 Ska shpresë shpëtimi shkretëtirën pa kaluar
 Mjer kush bie të flejë këtu, mbetet i vetmuar,
 Të tjerët shkojnë në rrugë të vet pa pritur e pa ndaluar!”

“Kjo është e sajuar”, do të thuash, mund të kesh të drejtë,
 Por pak mendo, a ka gjë më të urtë se kjo sot?
 Po qe se kërkon të arrish cakun, thotë Sadiu,
 Edhe sikur rruga të mos ketë të mbaruar,
 Ngarko barrën e ec e ruaju të mos ngelesh në rrugë!
 Ç’janë largësia e afërsia për atë që është i vendosur për të shkuar?
 Për të vendosurin s’ka vështirësi që të mos bëhet e lehtë,
 S’ka tmerr që nga njeriu frikë të mos ketë!
 Shih e merr mësim prej gjurmëve të pararendësve,
 As malet s’u bëjnë dot ballë fshehtësive mal-lëkundëse të të
 ndriturve!
 S’janë nina-nana ç’po dëgjon, dridhjet e entuziazmit njerëzor,
 Dallgë-dallgë rrjedh njerëzia drejt së ardhmes pa pushuar.

* Saadiu: poeti i famshëm persian Saadi (1213-1292), vepra e të cilit, *Gjylistani dhe Bostani* është shqipëruar nga Vexhi Buharaja. M.A.Ersoj ka qenë ndikuar shumë prej Saadiut.



Po s'e gjeti harmoninë rrjedha e universit me atë të njerëzimit,
S'shpëtohet dot pa rënë e pa u mbytur në vorbullën e tërbuar.
Po s'u zgjove, s'ke për të arritur dot atje ku ke qëllimin,
Shih, a gjen në rrugë të mbetur nga ata që rrinë zgjuar?
E ardhmja është kryecaku, dhe vendi i prehjes;
Karvan janë popujt; shkretëtira, e shkuara; përtacia, pengesat.
E shkuara është një gjembishte për tmerr, mos rri!
Ec, se e ardhmja është një tokë pa frikë dhe e bekuar!
E drejtë: shumë vështirësi duhet përjetuar!
Udhëtarin e pavendosur e të vetmuar, rrugët e frikësojnë!
Frika duhet për ta forcuar këmbënguljen!
Shpëton nëse ke ecur dhe ke bërrë rrugë me vendosmëri!
Meqë ke rënë në shkretëtirën e jetës, të duhet të ecësh
Gjersa të arrish në konakun e bekuar!
S'e ke pasë në dorë të mos bjesh këtu, o i mjerë,
Të të bëhet varr thua shkretëtira para se të vdesësh!
Nëse mendon se ndalimi dhe mosvazhdimi rrugës është vetëvrasje
Do të thotë se pret të të zbresë një engjëll nga qielli një shtrat
refref!
N'sa Zoti thotë,
"Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar"*,
S'e kuptoj, ç'pret ende më nga qëndrimi duarkryq?
Ngrihu e vrapo pas karvanit se, ç'pret?
Shkatërrohesh po qëndrove ashtu edhe një çast kot!
Ata që kanë marrë udhën më të lodhur se ti e të pafuqi,
Por mund dhe të mos jenë; Si i përfytyron ti? Pa shih:
Nëse për një çast të shfaqet ekzpozita e krijimtarisë,
Aktiviteti i paprerë është ligj i gjithësisë
Për tokën e për qiejt e për gjithë ç'ekziston,
S'ka shpëtim veç punës e përparimit
Toka të përpiqet, qielli të përpiqet, kurse ti, në mos u mërzitsh, rri!
A mund të justifikohesh para tyre? Ndal!
Lëre gjithësinë, as Krijuesi, madje, s'rri kot,

* Kur'ani, Nexhm, 39.

Por shfaqet në një mijë trajta e shfaqje pa mbarim!
O ti që shtrihesh n'sa gjithë bota dhe çka në të është në këmbë,
Ç'ke që s'trazohesh vendit, cofëtirë mos je? Të paktën, nga Zoti të
kesh turp!



RROGOZI

Para do kohe, me rastin e një shëtitjeje të vogël në Jajlla
Të Stambollit, desha të shkoj te një shitës barërash, nga miqtë
Tanë të vjetër, që më ftonte për herë t'i shkoja në dyqan.
Pasi biseduam pak shoqërisht, ia behën myshterinjtë:
- Më jep dhjetë pará xhenxhefil, muskat, piper;
Bashkë me pesë pará borxh të shkuara, u bënë pesëmbëdhjetë!
- Kjo njëzetëshe është e fshirë, s'e marr...
 - Mos e zgjat, më mbaro punë!
- Shpejt, o djalë, më sill ca bar... Shih, të jetë i kënduar!
Djali ynë është bërë verem kocke që i humbtë emri!...
 - Si?
Fytyra i është zverdhur e fryrë!
 - I mjeri ai!
Zonjë, kalon, kërko ta fryjnë.
 - Kalon, thua? Inshallah!
- Një paketë njëzetëshe, po ai i mëngjesit që pluhur krejt...
- O ti, vetëm pluhur jemi duke pirë, nga ai duhani i vjetër s'ka!
- Zotëri, xhaxha, më jep një çamçakiz... edhe pak dyllë më pri!
- Bija ime, është me pará! Shih, çdokush me pará në dorë rri!
Nga pesë e nga dhjetë, paratë hynë në një të çarë
E që aty rrëshqitën në një arkë të kyçur mirë e mirë.
Pas një kohe të gjatë kështu, erdhi një tjetër njeri:
- A ju ndodhet një rrogos i gjerë? Dhe sa të bëjë, zotëri!
Duhet për të mbështjellë një të vdekur, mos më druaj!
Ajo gruaja e sëmurë e mëhallës sonë që shtrihej pesë muaj,
Sot në të gdhirë nga kjo botë kish shkuar.
- Ç'hall! Në një ditë të tillë e paska pasë të shkruar?
- S'i qenka ndodhur asnjë njeri pranë... Lëre, ç'e nget...
Kur të vijë vdekja, n'daç të ketë, n'daç të mos ketë!
- Nëntë kurush bën rrogozi, jep tetë ti,
Për një kurush të mos bëjmë pazarllëk tani!...

Rrogozi u mblodh, u hodh në sup e u kredh në një sokak,
 Pastaj u fut në kush e di ç'buxhak...
 U hap për ta fshehur në gjoks një të vdekur aty pari:
 E u mbyll pastaj e çoi në sferë të hiçësisë!
 U bënë pesë a dhjetë të varfër dhe barrën mundimsjellë,
 Kënaqësinë e heshtjes pa ua prishur ndonjë vajtim,
 Në qetësi të plotë e larguan nga miqtë e vet.
 Pasi kaluan muret e qytetit, u zgjatën nga bota e selvive
 Një mijë krahë të papërthyer për ta ndaluar udhëtarin e panjeri!
 Rrogozi nga krahët zbriti se s'kishte më rrugë për të bërë
 Dhe u afrua, më në fund, buzë varrit me ndihmën
 E duarve indiferente si lopatë të varrëmihësit.
 Gruaja e mjerë me jetën si një mal dhimbjesh prej sulmesh
 Të njëpasnjëshme mundimdhënëse të kësaj bote mizorisht,
 Zbriti nga vrima e ëndrrës prej mbulese rrogozi...
 Edhe shpirti rënkonjës, u qetësua, më në fund, përjetësisht!

Me të më nisur në zemër ankthi nga këto kujtime,
 S'desha më të rri ndenjor, pra u ngrita në këmbë në çast,
 - Me mallkim në sy ndaj botës, me dëshirë për vdekje në shpirt,
 Para sysh, fytyra e vërtetë e kësaj kohe: një mal me padrejtësi;
 Dhe u largova prej asaj mëhalle tërë kasavet!
 A mori fund kjo skenë? Sa keq: nuk u desh më shumë se një hap
 Që shpirtin të mos ma copëtojnë një mijë si kjo fatkeqësi!
 Kjo periudhë vuajtjesh në emër të jetës ç'është, o Zot?



TELASHET E MBIJETESËS

Erdhëm në fund të jetës me siklete duke e shpenzuar

Dimrit për t'u veshur, verës, për t'u ushqyer...

Sadiu

A ky është, o Zot, qëllimi i një jete nëntëdhjetë vjet?
S'e di ç'botë është kjo me përpjekjen për një kafshatë goje!
Ç'tmerr është t'i dëgjosh këto të vërteta, vërtet
Nga një model virtyti i përhershëm si Sadiu vetë!
Po qe se Sadiu me filozofinë, me mjeshtërinë,
Me lirinë e tij mbinjerëzore të mendimit,
Detyrohet të hyjë në telashet e mbijetesës,
Askush të mos e përmend emrin e lirisë!
Jeta e njeriut si përsëritje fatkeqësish gjer në plakje,
Qysh nga koha kur doli në skenën e ekzistencës
Nga pas perdes së fshehtësisë së mosekzistencës,
Ç'mundime tretëse i dënuar për t'i kapërcyer!
Mos pandeh se vdekja të sulmon vetëm një herë;
Një mijë herë në ditë bie e ngrihesh me mundim!
Pasi njeriu i shkretë mbi faqe të tokës të bjerë,
Dhe përreth t'i mblidhen mijra fatkeqësi,
A mos gjen ai mundësi për të parë qetësi?
Fillon i shkreti me ato krahë të dobët me botën të luftojë!
Zjarri i diellit i bje në majë të kokës,
Borërat ngrijnë e bëhen akull mbi trupin e pambrojtë!
Me t'iu fryrë e shkumbëzuar detrat në pamjen e tmerruar,
Me t'iu përplasur gjithë dallgët me radhë në tru,
Sikur të ikja sish nga bregu - thotë e kapërcen me vrik,
Pa ditur se largësitë janë më përdhunuese, më me rrezik:
Me malet e vënë në varg në atë pafundësi,
Me pyjet që e shtrëngojnë botën me gjëmim e lemeri,
Me mirazhet valë-valë në shkretëtirat plot egërsi!
Çdo hap i vendosur i del një shkak për pashpresi!

Lart, ata trupa të qiejve tërë madhështi,
 Poshtë, ato pamje shembëlltyra të tokës plot çudi,
 Të mjerin në çdo frymëmarrje duke e tmerruar
 Të detyruar e lënë në pasionin për t'u asgjësuar!

Por ky pasion mundet nga një pasion tjetër:
 Njeriu, i rrëmbyer nga lakmia e natyrshme për të jetuar.
 Dhe sikur çdo periudhë e jetës t'i jetë fatkeqësi
 Me vdekjen prapë nuk pajtohet kurrsesi!
 Dhe sikur çdo gjë në jetë ta paguajë rëndë,
 Njeriu përsëri i kënaqur është me jetën, përsëri!
 Së fundi, pas ç'gjëje t'i jetë i lidhur sigurimi i vazhdimësisë,
 Vetëm për atë gjë i shpenzon forcat e lira;
 S'rri, po përfytet pavarësisht nga shumë goditje,
 Ajo shpata q'i thonë përpjekje, nga dora s'i bjé.
 I zhveshur është, të ngrohet kërkon nën të ftohtë,
 Të ngrejë një çati, të strehohet nën të çdo natë.
 Kërkon gjë për të ngrënë, për të veshur, për të djegur,
 Një mijë nevoja janë pas këtyre një pas një.
 Ja, pra, njeriu endacak në këtë pazarin e botës së tij,
 Çdo ditë sillet rrotull për një të punë të re, fitim të ri!
 Qëllimi, një jetesë nën një pështjellim të tillë...
 E ç'qëllim tjetër mund të fshihet nën këtë qëllim?
 Hej, për ta kuptuar këtë, s'ka kohë për fantazi,
 Të gjitha frymët kushtuar grindjes për jetë!
 Njeriu, i cili vetëm në saje të shpirtit mbetet njeri,
 I bëhet përherë shërbëtor dëshirave të trupit të vet!
 Po t'i vinte radha lartësimit të shpirtit,
 Do ta kuptonte, ndoshta, qëllimin në jetë!
 Në pastë gjë që kam kuptuar, është kjo: që krijimi
 Të mbetet një enigmë, Zoti i ka lëshuar njerëzit
 Pas luftës për jetë; të gjitha aftësitë për të kuptuar
 Në një kahje krejt tjetër i ka drejtuar!
 Jeta që të kalon qysh në krye si rrufe,



Nevoja e pakufi, e pallogari, për të jetuar
Tregojnë ç'është qëllimi i Krijuesit për këtë botë...
Dhe ne jemi të hutuar: prej kujt, kujt i duhet ankuar?

MEJHANIA

Fryn erë e inferioritetit nga anët e saj e nga thellësitë,*
 Ikën frymë e lartësisë nga mjedis i saj intim, nga fshehtësitë;
 Mijëra rënkime pesimizmi dalin nga toka që lëndon,
 Zbresin mijë errësira varri nga hapësira që net i reshon.
 Klithma të fshehta dëgjohen nga gurishtja tek rënkon!
 Sikur nga varret kanë dalë vatrat familjare të shembura
 Me gojët e mallëzuara hapur nga muret e plasura!
 Ngrihet një tym zije nga kandili i mekur i drithëruar,
 Mes pluhurave të shkatërrimit sikur lartësohen oxhakë të shuar!
 Pendohet nga jeta e kësaj bote ai që hyn në të një herë,
 Ai që del, i shkatërruar del nga përpjekja e pambaruar!

Nderi i klientëve të saj, i rënë poshtë si verë e derdhur, e tepruar,
 Shpresat, si një gotë vere e thyer në kosh të plehrave e lëshuar...
 Eshtë mbytur shpirti njerëzor mes dallgëve të mëdha të verës,
 Kurse mallkim lexohet në surratin e sakiut të shëmtuar.
 Shihe këtë pijanec, as për të shkuarën, as për të ardhmen di...
 Me helmin djegës që ka zënë me duart e pafuqi,
 Pret t'i soset jeta mu në moshën më të re!
 Hidhësi e jetës është mbresuar thellë në ballin e dëshpëruar,
 E ka zverdhuar ballin me vuajtje plot rrudha të thella atje!
 S'është tjetër veçse qartësisht e pakuptimtë një e shkruar në ballë**
 Dhe një harresë e përjetshme në shikimin e ngurosur e të pafjalë!
 Mbrëmë, i mërzhitur, sokak më sokak shëtita,
 Më në fund qëllova në një vend që më parë s'e dita.
 Një radhë shtëpish ngjitur, pastaj dhe një gjërmadhë,
 Një mejhane me pamjen e një hani më doli përballë.
 Me tavan të ulët, në errësirë, një dyqan i mjerë;
 Brenda një tavolinë ose një gjë prej dërrasa tabutesh bërë;

* Në këto dy fragmentet e para përshkruhet bota e ulët dhe e zymtë e mejhanes.

** ... një e shkruar në ballë: një fat i paracaktuar, por, në fakt, i caktuar, i vetëcaktuar, prandaj edhe i pakuptimtë, sepse është një vetëvrasje e vetëdijshme!

- Ulu pak ta tokim, de...
- Dhimitër, ej, mos pandeh se erdhi pa pará, ja!
- E mora vesh...
- Dridhe, o shok, një cigare...
- Ama Arifi ynë po e pika pa e holluar!
- Më duket se e ka një hall...
- Plakush, të satën gotë e ke? S'do të të mbajnë më këmbët!
- Po s'e mbajtën, shtrihet këtu për qejf; sikur e ka për herë të parë!..

Ngadalë-ngadalë kokat, çaçkat qenë nxehur,
 Gojët, hundët, sidomos zërat krejt qenë trazuar;
 Ndërkaq pashë të ngulet mu në derën e hapur
 Një burrë me fener në dorë, pranë, një grua;
 Pasi u menduan pesë a dhjetë minuta,
 Edhe gruaja hyri në atë errësirë-këngë të pështirë
 Në fytyrë: të kuqtë turpi; në sy: re dhimbjeje të ndjerë,
 Trupi me dridhjet e papërmbajtura, nën dëshpërim i rrënuar;
 Duke iu drejtuar Babait të ardhur së fundi, i tha:

- Domethënë duhet të bartemi me gra e fëmijë këtu tani!
 O ti, ç'është kjo që po bën? Pak turp të të vijë!
 Dhe jot ëmë, dhe unë, dhe vocërrakët të pangrënë!
 As punë, as ndonjë dobi, vetëm ditë e natë dremit e pi!
 As që pyet në kanë fëmijët për të ngrënë në shtëpi!
 Po, kurse unë zvarritu në derë të botës, në s'paça punë,
 E silli këtij sarhoshi të pijë, në paça lekë shumë!
 E mjera unë, laj rroba, laj dërrasa, kjo punë për ditë,
 Prapëseprapë para s'kemi, rrimë me duar në gji!
 Edhe ato rroba e dërrasa shkuan, s'kam më fuqi,
 S'mbahem më dot në këmbë, Zoti e di!
 S'punove vetë, vite me radhë më vure mua në punë,
 Fëmijët na i mësove zhveshur, të mjerë...
 Mëhalla e di se, kur më more mua,



Im atë ta pati mbushur e stolisur shtëpinë!
Ku është tani gjithë ajo plaçkë? I shite e në kumar i le!
Po, po, në kumar, në Bregun Përballë atje!*

Vajza t'u rrit, s'e merr kush; e si ta marrë?
Pyesin njerëzit: "Mos është bijë e sarhoshit kjo lffet?
Lëre, aman!" E drejtë, thonë gratë, dhe heqin dorë.
Eh, sikur ta dish sa e prek kjo fjalë vajzën e gjorë!
Moj engjëllushja ime, si s'paske fare fat:
Jot ëmë s'di nga t'ia mbajë, sarhosh - yt atë!
Edhe Nexhipi erdhi nga shkolla me stolin nën sqetull...
Kallfa i paska thënë: "Tetë muaj u bënë që s'marr
As rrogë në javë, as në muaj... Yt atë kumarxhi
Të shpenzojë më pak e t'i marrë të birit shërbëtor!"
"Më përzunë, nënë!" - thotë e qan i mjeri djalë!
Ç't'i bëjë nëna, s'di ku të mbështetet, kujt t'i thotë!
Djali të paktën të bëhej njeri, të mos mbetej injorant!
Kështu pata thënë, po s'u bë... se mos ka djali faj!
Çdo mëngjes e këndonte xhuzin** me zell e ditë për ditë,
Me libër në dorë djali, s'ia hiqte librit sytë!
Ke tri netë që s'vjen në shtëpi. Nexhipi pyet:
"Ku është babai? Dua babanë!" Shih se ç'hall tani!
Ujrat u nxinë, a shëtit rrugëve gruaja në këtë orë?
Dhe i thashë djalit: "Ai është sarhosh, o bir,
Sokak më sokak duhet kërkuar, a e gjen dot, i vogli im?"
Po djali nuk qetësohej. E pashë se duhej dalë
Dhe mora komshiun Hysen Aganë
Dhe në kohë jacie po e shëtis dynjanë!
Më mirë të mos kish lindur nëna fëmijë si unë,
Më mirë t'i kisha mbyllur sytë pa i parë këto ditë!
I poshtër, shihma hallin e ki pak mëshirë,
Hiq dorë nga ai helm, mjaft sa ke pirë!
Zotërinj, jepini dhe ju një këshillë, ndoshta

* Vende dhe lokale të njohura pijeje e dëfrimi në zonat Gallata dhe Bejogllu të bregut europian të Stambollit.

** Një nga tridhjetë pjesët e Kur'anit.

Keni dhe ju fëmijë...

- Ç'the ti, Hasan?

- Lëre qenen, ama ç'grua llafazane paska qenë!

- E imja pati qenë më keq se kjo, or ti!

- Mos, more!

- Posi, posi!

Prandaj dhe e ndava. A s'e ke marrë vesh ti, Halim?

- Se mos më hyjnë lloqet e grave në vesh mua!

Gruaja është si këpuca: përdoret ca kohë

E pastaj ndërrohet.

Gruaja këto fjalë s'i dëgjonte, veç qahej e ankonte,

Kurse i shoqi, sikur të ish gur varri, vetëm e dëgjonte!

Më në fund, iu hap goja, të mos i hapej më mirë do të ishte

Dhe iu derdhën prej goje këto fjalë të mallkuara:

- Në djall të vesh, dosë orospi, qërohu, të kam ndarë!

- Unë e mora vesh, komshi, ti je dehur keq pothua;

Silleni në vete, këtë, more!

- Mos e prekni!

- Lëreni!

S'e di ç'u bë me burrin, por gruas i ra të fikët e u rrëzua!



VARREZA

Vetëm skenën tmerruese të varrezës mos vështro
Rri pak dhe vëri veshin rënkimit të heshtjes së saj
A i ngjan zemra fytyrës së saj lemeritëse?
Kush ka rënë në rrjedhën entuziaste të jetës,
Një ditë, i lodhur, e lëshon zemrën në prehrin e varrit!

O varrezë, ç'botë që je, ç'natyrë të lartë që ke!
Tek ti rri fshehur biri më i zgjedhur i njerëzisë*
Prej teje kërkon ndihmë klithma e frikës dhe dëshpërimit!
Një grumbull dritë sysh je ose tharmi yt - i mbrujtur
Me lotët e rrjedhur nga shpirti i pastër i kombit!

Një histori e famshme je: e shkuara e popullit është tek ti.
Në pastë shembull për të marrë, tek ti, dhe urtësia, tek ti.
Kohët e lartësimit në kujtesën tënde janë, fatmirësia, tek ti.
Sepse trimëria dhe liria janë tek ti, përpjekja është tek ti.
Pra, të jetosh tani, është gjë e ulët, nderi, dinjiteti janë tek ti!

O klimë paqeje, gur kufiri mes qenies e mosqenies!
Ku do ta gjejnë të vetmuarit prehjen po të mos u jesh
Mbi krye një hije e përjetshme, një krah plot dhembshuri?
Nën hijen tënde që zgjatet e shkon, një lumturi e qetë ndihet.
Natës tënde që s'ka mbarim, mijra agime iu bëfshin fli!

Substancë jotja s'është toka, është tjetër gjë.
Ah, s'e dinë duke kaluar sipër teje se çdo grimcë
E dheut tënd është esencë e mijra truve!
Aq i begatë, o sfondi i njohjes, është tharmi yt,
Saqë çdo trup, kur del nga hija jote, bëhet shpirt!

O varrezë, mijra fytyrëhënë fshehur në dendësitë e tua,
Nga dheu yt i kalbur mijra dritë sysh shpërthejnë!

* Biri më i zgjedhur i njerëzisë: profeti Muhammed.

Çdo bari yt është shenjë e trupave plot naze e bukuri...
 Selvitë e tua, nga një ah i thellë drejtuar kah Zoti,
 Gropat e tua, shtretërit më të sigurtë të zbritur prej Tij!

O dhomë nate, o mosqenie, o perde-perde madhështi!
 Shpresëmëdhenjtë janë tek ti, prej teje lind agimi i përjetshëm.
 Çdo gur varri reciton mijra poezi me harmoni transhendentale,
 Çdo himn yti e miqëson shpirtin me pavdekësinë!
 O dhé qiellor, mijra përshëndetje paqeje prej meje ty!

* * *

Me të ma shtrënguar shpirtin, disa herë, jeta me kërkesat e saj,
 Mëhalla e të vdekurve më bëhet vend i vetëm ku shkoj e shëtis.
 Në mjedisin zhurmëmadh të të gjallëve
 Nuk gjendet pushimi i përhershëm i jetës së dytë.
 As fëlliqësi e ambicjes dhe poshtërsisë në truallin tënd të pastër,
 As përpjekje për t'u ushqyer në dheun tënd intim.
 Hapësirën e pazë të kësaj bote prehjeje me ta parë,
 Hidhësinë e jetës sime të shkretë
 E hedh nga përfytyrimi qoftë dhe për një çast
 Dhe largohem prej kësaj bote me gjithçka .
 Pa u këputur krejt lidhjet me këtë botë,
 Shpirti për asnjë çast nuk gjen qetësi.
 Por, për t'u këputur, kërkon një truall të tillë..
 Jo vetëm truall, por edhe zemër hekur të fortë!
 Ishte mëngjes dje kur kah Ejubi* pata dalë.
 Pasi kapërceva muret e qytetit dhe hodha disa hapa,
 Horizonti ndërroi, bota e vjetër m'u largua sysh
 Dhe para m'u shfaq një varrezë e gjerë
 Por që, në të vërtetë, një det i madh përjetësie qe,
 Me gurët e varreve-dallgë të ngrira të tij.
 Nuk ndenja në breg por hyra në vendin më të thellë

* Ejubi: lagje e Stambollit.



Dhe e mbështeta shpinën në një prej gurëve.
Majtas dhe djathtas anët qenë mbuluar me heshtje kënaqësie.
Pemët, të lumtura; trualli, në qetësi.
Gjithë ato dallgë të lartësuar, gjithë ai det i pafund
Qenë kredhur në një gjumë të thellë, çdo anë e pazë.
Perdeja e vendtakimit u hap dalngadalë,
Intimitetin e shpirtit tim ma gëloi madhështi e hapësirës.

Por nga reflektohet ky kompozicion transhendental
Që thotë: "... Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën"?*
Ç'është kjo klithmë mu në mes të heshtjes diskrete?
Fjalët janë të Zotit, por kush i reciton?
Kohë më kohë refreni lartësohej duke u përshpejtuar,
Papritmas nisi të rënkonte gjithësia e heshtur.
Selvitë u bënë xhemaat i lartë i entuziazmuar,
Nga secili prej tyre u dëgjua e njëjta thirrje.
Varreza rënkoi, gurët u bënë nga një gjuhë më vete,
Edhe epitafet u shprehën po me të njëjtën gjuhë.
Me ta parë të gjallë gjithë mahsherin** e përfytyruar,
Frymën e dëlirë hyjnore që i jep shpirt varrezës,
U zhyta në përfytyrim; ajo varrezë e gjerë
Iu duk botë ringjalljeje syrit tim të tmerruar!
Dhe sodita se si të parët tanë trupa të amshueshëm
Sikur në këtë mes të vënë në karvan
Me qefinet hedhur krahëve, kaluan para audiencës hyjnore
Sodita pafuqinë e qëndrimit në postin e mahnitjes...
Të trupave të arritur nga mjedisi i frikës dhe shpresës,
Ç'tmerr paska qenë të shohësh sexhden e krijesave
Para audiencës së Krijuesit!

Më në fund u duk dhe hatibi i gjithësisë së lartë
Që sundon mbi këtë shembëlltyrë kiameti të ngatërruar:

* Originali arabisht: ... *el'ledhi halaka'l-mevte ve'l-hajate...* (Kur'ani, Mulk: 2, fragment)

** Vendtubimi i Ditës së Gjykimit.

Syri më zuri atje tej një grua me një fëmijë
Të ulur në këmbë të një varri për vizitë. Pastaj, me t'u afruar,
U shfaqën qartë: Fëmija po e këndonte përmendësh
“Tebareke”-në* krejt i ekzaltuar,
Kurse e ëma pranë po e dëgjonte duke lotuar.
Ndërsa truallin po e dridhte ajo melodi hyjnore ,
Ç’pamje kishte marrë, o Zot, ajo varrezë e mahnitur!
Fëmija, pamja e jetës, kurse varreza, e vdekjes.
Vështroje këtë pamje plot shpirt dhe kundërtinë shih në mes!

* * *

Pas pak, ato zëra heshtën krejt,
Grumbullimi i gjallë i qëparmë u shua.
Gruaja me fëmijën u tërhoqën në botën e vet,
Varreza u gropos në heshtjen e saj të amshuar...

* Tebareke: Një kaptinë e Kur’anit që fillon me këtë term.



BAJRAMI

Horizonti i tërë qesh, bota, tjetër botë;
Bajrami, ç'kohë e këndshme, ç'kohë e gëzuar është!
Në bajram qesh fytyra e fëmijës së pafajshme,
Në pamjen e dëlirë të fëmijës shpresa e qartë është!
Në çdo ballë një dritë e padukshme në shkëlqim,
Gjithkohë në çdo sy një shpirt kah përsillet është!
Trupi i përkulur dysh prej vuajtjeve të jetës
Nën ndikimin e begatisë së tij, i qetë e i gjallë është!
Bajrami, një kohë qetësie e prehjeje pas një viti përpjekjesh,
Për zemrën e rënë në pesimizëm, shpresë dhe jetë është!
Në pastë çast kur klithma e frikshme në përpjekjen
Për ushqim të heshtë, ky çast është!
A gjen dot bukuri të tillë në mëngjes të beharit?
Çehren e tokës shih: sa e hareshme, sa rinore është!
Në çdo gjoks një zemër është kah rreh me hare,
Në çdo zemër, një botë pasionesh e fshehur është!
Njerëz të çdo race me harenë e festimit dëfrejnë,
Sikur i gjithë gjoksi i rruzullit tokësor tejet i ekzaltuar është!
Gjithë qeniet i entuziazmon begatia e shpërndarë
O Zot, ç'shpirit i gjallë i gjithë botëve është!
Ç'kujtime të këndshme na vijnë në bajram
S'këmbehen më njëmijë jetë, aq me peshë janë!
E kam gjithmonë parasysh peizazhin bujar të bajramit:
Kujtimi fytyrëqeshur i të kaluarës sime fëminore është!

* * *

Të parën ditë, koha ishte pak e papërshtatshme,
Ditën e dytë u hap dhe vazhdoi ashtu, e bukur, e këndshme.
Dhe thashë: Sikur të dilja në Fatih ngadalë,
Të rrija ta vështroja atë botë nga mënjanë
E pastaj t'i vizitoja miqtë e të njohurit... mirë do të qe.
Të rrish gjithë ditën në shtëpi është e kotë, s'ke pse.

Me të m'u shfaqur kjo dëshirë për të shëtitur e gëzuar,
A mund të prisja më? U hodha jashtë nga shtëpia pa ngurruar!

Ejani e bajramin soditeni në Fatih;
S'e nxë përfytyrimi atë rrëmujë e kënaqësi!
Zëreni nga foshnjat që shëtiten në krahët amësorë,
Deri te brezat me lloj-lloj bastunësh shekullorë
Mbetur nga kohët e gjyshërve,
Të mëdhenj e të vegjël, gjithë qytetin atje e ke!
Në çdo hap ngritur lëkundëse-djep,
Brenda, darabukë, defe, raketake me zile.
Ecni pak: një çadër e stërmadhe; para saj n'oborr
Fëmijë plot me nga një dhjetshe në dorë
Presin të hyjnë. Brenda saj ç'ka, vallë?
Nga Japonia, një lugat me fytyrë si njeri!
Kaloni. Çadra me radhë. Para secilës syresh
Dikush thotë: "Kush ka për të hyrë, të mos rrijë!"
Një lajmërim me dy këmbë me zërin e çjerrë;
Ngado thirrja e tij: "Ballë, sy, këtij i thonë..."
Qejfi i elektrikistëve s'ka të sharë:
Kush kalon andej, te teli do të ngecë pa derman.
Peshoret nuk mbeten lirë, pa njeri,
Sapo të zbresë njëri, hipën të peshohet tjetri
Se "ky kandar peshon me okë, jo si shpikja e frëngut
Me gram. Dirhemët katërqind, s'ka gabim në llogari!"
- Muhalebia ime si kajmak!
- Kjo pastë të shëron!
Apo simite deshe?
- Lëre, s'kam dhjetëshe!
Në atë skaj: dyldylë me rripin e vitheve këputur;
Në këtë skaj: bylbylë me palldëmin rënë.*
Ballonxhinj, mjeshtra lojrash për fëmijë, palaço
Gjela sheqeri, lojra që si zogj pule cicërojnë...

* Dyldyl: mushkë; bylbyl: kalë; emërtime popullore përkëdhelëse për kuajt e karrocës.



Në të djathtë ringishpili, në të majtë pajtonë
Përpara karrocë-tezgjah, mbi kokë çiftkollan
Deve qymyrbartëse grupe-grupe të shtrira përdhe.
Që qetë-qetë ripëtrypin ushqimin
Duke shëtitur mes asaj bote të gëzuar
Që shëtiste, bridhte, rrinte, recitonte,
Valëzonte me dauille e zurna, bërtiste e vraponte,
Pashë se dëfrim më shumë në anën e fëmijëve kishte.
Me foshnjat tërë bukuri si lule
Të zbukuruar bukur nga dora nazemadhe e nënave,
Festës së dallgëzuar të bajramit tjetër jetë i vinte...
Lëvizja që pashë, e gjitha gëzim e hare qe.
Lëkundeshin pak me nga dhjetë pará... pastaj
Veç kur ia nisnin këngët me thirrjen “u dogj!” me gaz.
- Or ti, sapo “u dogjën” ca më parë! Hë, more, dhe ti...
- Mirë, moj bijë, edhe unë ca si shumë e zgjas.

S'bën pa dallgë deti,
S'bën zemra pa dashuri,
Kush ka dashnore të bukur,
I bje kokës fatkeqësi!
Hajde mini mini mashallah,
Do bashkohemi inshallah...

Mirëpo, në kundërshtim me këtë pamje plot hare
Ja tek nën sjetullën e një gruaje shumë plakë
Qan një vajzë vetullplotë, e bukur e flokëgjatë!
Kush vjen e kush shkon, pyet: Kjo vajzë pse qan?
- Jetime, or ti, fëmija e fëmijës, dhimbje për këtë të ngratë!
Pse, a s'është fëmijë dhe ajo? “Lëkundëse” - thotë...

- O ti me lëkundësen,
Të hipë pak dhe kjo... bëji një të mirë...
Kush e gëzon jetimin, jeton gjatë...

- Posi, posi, le të vijë!
Hipi jetimja në lëkundësen e njeriut bujar,
U bashkua dhe ajo me gëzimin e vajzave që nuk qajnë!

HALLQARJE

O bilbili i njohjes thellësinore, fjalëshpejtë,
 Ndërgjegjja me këngët e tua magjepset.
 Ata tinguj që janë dëlirësi shpirtërore,
 Me t'u bërë në intimitet të zemrës mik,
 Gjithë botët më shkelen me këmbë,
 Përfytyrimi më ngjitet gjer në hyjnësi.
 Horizontet e dëshirave m'u vijnë ngushtë,
 Kontemplimi më zbulon hapësira.
 O dritë e çiltër e të Madhit,
 A s'mund të më bëhet gjoksi qielli yt?
 Qiejt, vendqëndrimi yt i gjithë?
 Rruga a s'të bie hiç në tokë?
 Ej, fluturues nazemadh që ndalon në Sidre*,
 Në zemrën time të bëje fole!
 Një tjetër këngë do të dëgjoje,
 Si shpirti im dhe ti gufoje.
 Nga poetika jote që rri në kujtimin tim,
 Vazhdimisht i ekzaltuar jam unë.
 Me t'm'i dhënë vetes ekstazë ajo harmoni,
 E vogël, e vogël bëhet bota në sytë e mi.
 I çliruari prej të gjitha lidhjeve,
 Një poezi qiell-tokë kënga jote.
 Një poezi rrjedhëse, që, me begatinë
 E ujit rrjedhës, vazhdon tërë beharin e jetës.
 Një thirrje që është shpirt, metafizikë,
 Si Kur'ani, është për dijethellët.
 Një zë, shtytje për njohje
 I rrethuar me thirrjen "má-arafnák!"**
 O ti, poet që të është frymëzuar e fshehta,
 Edhe në s'jam intim me të fshehtën, adhuroj plotësinë tënde;

* Sidre: Në Islam, sidre është hapësirë në qiellin e shtatë.

** *má arafnák*: nuk të njohëm; fragment i hadithit "Nuk të njohëm dot ashtu siç duhet, o Zot!"



Thuhet se fjala jote është fjala e Zotit!
O ti, mëngjes i paraqenë, ballë i kulluar,
Nuri yt nuk mund të eklipsohet.
Mosqenia e gjatë njerëzimin në e marrtë,
Gjithë trupat në errësirë në u zhytshin,
Ende duket ai shpirti i shpirtrave
I zhytur brenda një hapësire të ndritshme!
O shenjë e dritës në faqe të fytyrës,
Brenda, zbërthimin e gjithësisë ke të fshehur;
Në syrin tënd, dritë e amëshimit;
Nuk shuhet kurrë kandili i fuqisë hyjnore,
Shikimi yt mik me botën hyjnore,
Trupat, dëshmitarë të zgjimit tënd.
Çdo kohë shkëlqen ajo dritë syri,
Dhe fokusi i saj, entuziazmi i yjeve!

Çdo mëngjes vjen flladi që të fiton zemrën
Në përfytyrimin e flokut nazemadh aromëmirë.
E stolis sërish universin
Me një të fryrë më bën të lumtur!
Gjithë njollat e errta të zemrës bëhen dashuri,
Pothuajse hapet mbulesa e Lejlasë.
Në djepin e gjuhës begati shprese
Zgjohet dhe i jep forcë thirrjes plot vaj.
Për ta heshtur atë fëmijë që qan,
Ngrihem e i kërkoj ato netë të freskëta.
O natë, shembull i mburrjes së tij,
Ose zemërimi i tij ndaj meje!
Në kohën kur errësira mbulon gjithçka,
Kur nën të e shtrirë bota e përgjumur,
Kur përreth s'mbetet anjë njeri
Dhe bashkudhëtar më bëhet hija netshëtisë,
Ngrihem e shëtis i vetëm e i qetë,
Gjej një vend heshtjestolisëse.

Mbi mua, qielli i mbushur plot yje,
 Para, e zgjatur, mbulesa e natës,
 Në kujtesë, poezitë e përsosmërisë tënde,
 Përballë, përytyrimi skaj më skaj.
 I lirë prej kufijve të botës fizike
 Nga frika dhe shpresa e pakasavet,
 Ndërgjegjja hap një kuvend fitoreje
 Që shpirti bëhet dashuri kënaqësiplote.
 Ajo kënaqësi s'përshkruhet,
 Madje as mund të përfytyrohet!

O Zot, ç'begati e hareshme në hare ajo!
 O Zot, ç'natë e mbuluar në dritë ajo!
 O Zot, ç'dritë ledhatuese ajo!
 O Zot, ç'fytirë rreze-rreze ajo!
 O Zot, ç'kuvend, ç'botë ajo!
 O Zot, ç'mahfil madhështor ajo!
 O natë, të mos kishe ditë pas...
 O dehje, të mos kishe dhimbje koke pas!
 Jashtë teje, o botë, duke qenë, të mos zgjohesha,
 Se ka botë, të mos besoja!

O dashnor, besëzgjedhur i shpirtit im,
 Në të pastë dhënë mërzitje legjenda ime,
 Me pëlqimin tënd të zakonshëm
 Mos e hesht këtë qarje shpirti, po e ndjë!
 Edhe nëse gjithë lufta për jetën hesht,
 Nuk bie në pesimizëm ky shpirt i shkretë.
 Dhe po s'i ardhën vendi e koha për shtat
 Klithmës tënde, qielli i vjen për shtat!
 Ma thuaj dhe ti, ç'hall ke
 Pa e vrarë mendjen për të ardhmen!
 Eja të bisedojmë e të qajmë hallet!
 Periudhat e jetës perde-perde,
 Allahu e di se ç'ka më tej për ne!



SELMA

*Ime mbesë.
Vdiq më katër vjeç.*

“Ja, gjithë ditën u kacafyta, shpirti m’u mërzit. Mjaft me kaq tani!
A nuk do të merrem edhe nesër me të njëjtat shqetësime?
Atëherë, tani për tani më duhet të mendoj në qetësi
Dhe trupin të mos e lodh: jeta është përpjekje për ushqim,
Kurse bota, shesh lufte. Dhe heshtjet kohë më kohë
Janë armëpushime.” - Kështu thashë me veten time
Dhe u shtriva pak të rri. Por sa rëndë është të gjesh atë prehje!
Nuk kaluan çaste nga ky pushimi im,
Kur erdhi një komshi e më tha: “Nëna jote të përshëndet,
E sëmura u bë keq, të mos vonohet mbrëmanet!”
Në çast u ngrita e u drejtova kah ajo fole e shkretë!

Me të hyrë brenda, nëna m’u hodh në qafë.
Me të qarë më tha: Mos e shih fëmijën, o Aqif!
S’të digjen vetëm ty mushkëritë, por edhe shtatë brezve të huaj;
Sikur ta shihje vogëlushen në shtratin e vdekjes!
Shyqyr, sot është pak më ndryshe - thoshim dje...
Sot ato faqe trëndafilí iu bënë si gëlqere!

Filan doktor - na thanë. Erdhi, e pa dhe nuk kuptoi.
Jo, filani kupton dhe një herë më shumë - na thanë.
Por dhe këtij hutaqi i paska dalë më kot emri!
Po dhe sikur të kuptojnë, ç’del? A ka shpëtim?
Ilaçet e doktorëve, o bir, sa për të na ngushëlluar janë.
Të pish ilaçin e të gjesh shërimin, është punë e Zotit!
Jot motër e preu tani të ngrënë e të pirë;
Fjalë s’dëgjon, e shkatërroi veten, s’është mirë.
Më shumë se e sëmura, ajo ka nevojë për mëshirë...
Më thotë: “Nënë, prijë shpresën nga fëmija, po shkon, e di!..”

Dhe unë,e shqetësuar vij e shkoj pa ditur se ç'duhet bërë
Po qe se nuk na vjen në ndihmë ajo zonja komshi...

- Po motra, ku është, pse s'duket? Të vijë!
Sido që të jetë, fjala ime është tjetër. Ndoshta
Gjen pak qetësi...

- Si do t'i thuash?

A do të bëjnë punë fjalët? A dëgjon ajo tani?
Mos është e lehtë? A e di se ç'është nëna, o djalë?
Në atë gjendje siç është fëmija, a dëgjon nëna fjalë?

E sata fatkeqësi kjo? E pesta! O Zot!
Vajza do të shohë vdekje për të pestën herë!
Këtë e ka të fundit shpresë. Po qe se i ikën si katër të parat,
Pa i ardhur koha do ta vdesë veten vajz' e mjerë!
Dil dhe një herë Selmanë tani e shiko,
Shko e shih atë fytyrë fati në ç'gjendje e ka sjellë!

Në mëngjes pashë se i trashej pak gjuha...
Bijëza ime tani të sheh me ata sy të mjeruar!
Ç'sëmundje mizore! Merret me një fëmijë...
Sikur të isha sëmurur unë në vend të saj!
S'dua të ankojem, po durimi më është mbaruar...
Po hyj në gjynah! Kam bërë durim, e shih tani ç'ndodhi!

* * *

Ç'pamje! Ai engjëll që si zog kish fluturuar,
Tani rri shtrirë, nuk luan as këmbë e as duar;
I dridhet në sy drit' e syve, në çast do të shuhet,
Fjala në buzë i ka ngrirë, veshi s'i kupton ç'i thuhet!
Balli i argjendtë ngjyrë dheu i ka marrë;
Hidhërsirë vdekjeje ndjeva kur i putha buzët...

E ëma te kryet i rri e hutuar; zija është trupëzuar
E mishëruar në formën e një gruaje...



Pranë, gratë komshie gati për t'ia dhënë një kuje;
Një heshtje e frikshme vërtitet përreth si hije...
Kur hyra në dhomë, gratë u ngritën në këmbë,
Te shtrati gozhduar rrinin nënë e bijë...

I thashë: Ç'është kjo që po bën ti, pa mendohu pak!
Lëre të sëmurën, më në fund, vetë për vetë.
Ç'mund të bësh? Kaderi do ta bëjë të vetën, sido që të jetë!
Ç'dobi ke të bëhesh kështu si kufomë?
Kjo që bën ti, është të ngresh krye kundër Zotit;
Kush duron në fatkeqësi është njeri i vërtetë!..

I shpenguar në të dukur, i nisur në këtë vijë,
Vazhdoja unë në përpjekje paprerë...
S'e mora vesh ç'i ndodhi të sëmurës në atë qetësi...
Nga e ëma, e zhytur në hutim, me një forcë të papritur
U këput kjo e bërtitur e dhimbshme që më tingëllon ende në
kujtesë:
"Ç'zemërgur që qenke!... Ah, më shkoi ime bijë!..."

I NDJERI IBRAHIM BEJ

(I ndjeri Ibrahim Bej është ndër mjekët veterinerë, një prej njerëzve të rrallë të ditur e të virtytshëm të përgatitur nga dheu i pastër i Lindjes. Ata që e kanë njohur nga afër të ndjerin, nuk lëkunden ta pranojnë se vdekja e tij fatkeqe katër vjet më parë ka qenë për popullin një humbje e dhimbshme dhe, për qeverinë, një turp i madh! Ai pati njohur dhe përvetësuar shkencat dhe teknologjinë e Lindjes e të Perëndimit dhe, me analizat dhe të gjykuarit e tij, e pati zgjeruar diapazonin dituror në mënyrë të mahnitshme. Ai pati shëtitur disa herë të gjitha anët e Lindjes, pati shëtitur dhe njohur vendet më të qytetëruara të Perëndimit. Po që se ky njeri i madh që i njihte gjuhët e Lindjes në mënyrë letrare, që i pati mësuar saktë frëngjishten dhe rusishten, sikur të mos ishte nga natyra mik i thjeshtësisë dhe armik i famës, jam i sigurtë se nuk do të vdiste në spitalet e të varfërve për shkak të atyre nëpunësve recidivistë të një qeverie recidiviste dhe se, një shkencëtar i tillë, për t'u njohur, nuk do të kishte pasur nevojë për dëshminë e një nxënësi si unë fakiri!)

Para syve tek më përsillet, figura yte harmonike është;
 Gjithë përfytyrimi im, ajo vlera jote e tejpërfytyrueshme është.
 Shpresa e rënë në errësirën e hutimit, duke dalë, zhytet;
 Para saj përfytyrimi yt, është pishtari im.
 Si i zgjedhur i qiellit shkove, o dritë hyjnore;
 Pas teje tek kalon tashmë, hija jote është.
 Kjo gjithësi, e mbushur me kujtimin tënd gjer në grykë;
 Toka, koha, për mua, kujtimbartës i bukurisë tënde është.
 Përngjasimi yt është gjithë anëve tek u reflektohet;
 Eteri, sikur pasqyrë e madhështisë tënde është!
 Yjet dritërrrezatues, shkrepëtima të njohjes tënde të thellë;
 Netët janë plotëni e jote që i rrethon gjërat.
 Agimi, nga ai ballë një shenjë e begatisë qiellore,
 Ngjyra që dallgëzon në mëngjes, është lartësia jote.
 Qielli që m'ia përshkruan cilësinë tënde të lartë shikimit
 Me të gjitha shfaqjet e mundshme, një shembulli yt është.
 Malet, monumente të seriozitetit dhe vendosmërisë tënde është,
 Shkëmbi, cilësi e kundërshtimit tënd ndaj punëve t'lehta.



Reja, kujtim perlashpërndarës i bujarisë tënde është,
Dielli, flakërimi i meditim tënd të çdokohshëm është.
Lindja e diellit, pamja e buzëqeshur e ngjyrës tënde është,
Perëndimi, koha e shpërthimit të mërziqjes tënde është.
Në ajër dallgëzohen gjërat e tua të shenjta që më vijnë ndërmend,
Era, fjala yte që ma çon shpirtin peshë është.
Në blerim lojra bën fytyra yte pranverore,
Flladi, sihariqi shpresëdhënës i bashkimit me ty.
Dimri, shenjë e kiametit të madh që vjen me nxitim,
Pranvera, kujtimi poetik i pashuar i yti është.
Shkurt, para vështrimit tim të bindur, bota,
Fytyrë e personalitetit tënd, kuptimi yt është.

Përfytyrimi yt i brishtë, o i dashur, që, kur, një kohë,
Më zgjonte një mijë dëshira në natën-shpirt,
E krahasoja me mëngjesin e zbardhur të së ardhmes,
Sot rri nën re e nuk lëviz!
Për sytë e mi që shohin imtësitë, mëngjesi i pranverës
Duket i vetmuar, i zyrtë sa mbrëmja e të vetmuarve!
Kurse pemët lozonjare që kanë veshur rrobën jeshile të jetës,
Më bëhen si skeletë të frikshëm me mbulesën zbuluar!
I gjithë ky rrafsh i blertë, ky blerim i mbirë rishmi,
Nën një mbulesë jeshile, një varr i thellë!
N'sa këngëve ua thotë bilbili mbi degë të njoma,
Në shpirt njëmijë zëra nga bota e përtejvarrit më vijnë.
N'sa në sy të dallgëzohet vesa e dritës,
Duket sikur lulet në lulishte qajnë.
Ndërsa fizionomia jote, kuptimi yt,
Gjurmët tua të pasqyruara në botën e bukurive,
Shpirtin ma entuziazmojnë thellë, ma trazojnë,
Poezitë që rënkojnë në prehrin e atij krijimi sot!
Tani bota, është errësirë e perëndimit;
Ato mëngjese nazemadhe nuk lindin më sot!
Ti, o dritë e amshuar që ndriçon qiejt,

Le pas këtë botë të zhytur në errësirë!
 U ngrit një perde e amshuar në trurin tonë,
 U hap para gjithëfuqisë tënde fytyra e gjithësisë.
 Hapësirën hyjnore je kah e shëtit botë për botë,
 Ashtu si kujtimi yt i dhimbshëm shëtit vend më vend!
 Në ka jetë, është jeta jote e amshuar,
 Kurse kjo jetë e zhurmshme është mundim.
 Ku e gjen qetësinë, ah, zemra ime e shpërngulur?
 Në thelb të gjoksit, një rrëmujë e vazhduar e hutim!

Domethënë, nuk do të të shoh më përgjithmonë,
 Domethënë, je larg prej meje, o i dashur fjalënjomë!
 Ndërsa më pate lidhur keq pas vetes në jetë,
 Thuamë, si mund të jetoj tani unë pa ty, i shkretë?
 “Një ditë prej ditësh ti vjen dhe botët e vjetra
 Vazhdojnë me ty bashkë ashtu plot gëzim, hare,
 Dhe heqim ne dorë nga kjo luftë për të ngrënë e pirë
 Dhe kërkojmë me ty në gji të vetmisë një strehë të fshehtë...
 Nuk përzihemi fare në ç’ka e s’ka të kësaj bote,
 Ashtu siç, fundja, kaq kohë s’jemi përzjerë!
 Le të vazhdojë të reflektohet larg ajo grindje e frikshme...
 Në qetësi ne, o mik, si një trup e shpirt i vetëm
 Vazhdojmë e shkojmë në të njëjtën harmoni si përherë;
 Rrotullohet mbi ne gjithë ajo melodi mbi mjedisin tonë...
 Me shprehjen tënde një-zbërthyesë, çështjet e pakuptueshme
 Dalngadalë zbulohen e dalin në dritë.
 Pëlqimi Yt fshehet pas perdes së fuqisë Tënde,
 Frymëzimi i sqarimit Tënd hap një mijë deriçka
 Dhe para nesh, atëherë, bota e shpirtit del në shesh,
 Gjithë pengesat trupore bien e na zhduken sysh!
 Poetikën tënde prej këngësh frymëzuese
 Me plot ekstazë përsëri jam duke e dëgjuar...”
 Duke thënë kështu, të gjitha dëshirat m’u përmbysën sot...
 Askush s’paska për të ardhur, askush për të shkuar!



S'paskan për t'u hapur, më në fund, përjetësisht,
Ato nyja, ajo gojë, ajo e vërtetë fletë-fletë!
Sa keq që ato gjëra të reja rreze-rreze duke u lartësuar,
Mbetën në lindjen e vet... Dhe shumë herët!
Pse perëndove shpejt ti, o yll i Lindjes,
Përsosmërinë pa e kuptuar ende vatani i shkretë?

Nuk e qëlloi Lindjen, Ibrahim, këto kohët e fundit,
Një humbje kaq e dhimbshme sa kjo e jotja!
Para teje, pesë a dhjetë humbje të mëdha patën ndodhur,
Pesë a dhjetë figura të përsosura, shpresë e kombit,
Një nga një para teje, patën shkuar...
Por pas teje, mijra shpresa mbetën shterpë!
Shih kah kandilat e begatë të ndezur në gjysmë shekulli:
Në një çast u shuan e u bënë gjë e kalbur e mbuluar nën tokë!
Nuk mund ta kuptoja se si mund të ndalej papritur
Ajo zemër e dhembshur që rrihte për të mirën tonë;
Nuk mund ta përfytyroja se do ta ndalonte ecjen
Ai mendim i urtë që përsillej në mjedisin e Lindjes.
Nën mbulesë dheu u mbulove ti, o kandil i edukatës,
Por kurrë nuk shuhet ai shkëlqim që e kam në kujtesë!
Kur reja të qëndron mbi varr e vajton,
Kur shpirti i erës vjen e mbi krye të rënkon;
Kur engjëjt e mëshirës nga bota e lartë mbi varr të zbresin
Dhe vazhdimisht e përnderojnë odën e varrit tënd;
Kur vjen pranvera dhe kujtimi i frymës tënde mbi lulet
Mbi shpirt mijra aroma të këndshme më krijojnë;
O mik i vjetër, në skajet më të thella të përfytyrimit
Silueta jote e bukur kthehet e qëndron!
Mos vallë e goditur vetëm familja yte është? Jo!
Mijra vatra le të shkreta le pas!
Me favorin tënd qetësues, bëheshin, për një çast,
Të qeshura fytyrat që notonin në lot;
Begatia jote bujari e mëshirëtreguese, si të ish thesar,

U ndahej gjithë të varfërve në nevojë.
Një botë virtytësh që ai dhe iku e mbaroi...
Ç'është, o Zot, kjo përmbysje e madhe, pse?

O kujtim i zgjedhur i nderuar,
Në shpirtin tim je i jetuar;
O tufë rrezesh frymëzim,
Madhështi e mëngjesit të pafillim;
Kur të erdhi ngushtë bota njerëzore,
la hapi së mirës tënde gjoksin bota hyjnore!

Shpirti yt s'shihte kah kjo botë me shtrëngim,
Të kërkonte me afsh lartësim;
Më në fund, o qiellore dritë,
Në lartësi të Zotit je ngjitur...
Koha tani për ty, kohë e lumturisë,
Shpirtrat, shokë kuvendi të fisnikërisë.

Përkushtimi, bashkudhëtar yti,
E kapërceve menjëherë këtë errësi

Gjersa u zgjove në agimin e amshueshmërisë...
Allah, Allah, akoma po shkon?
A s'ke për të ndaluar të pushosh,
O ti që në trëndafilishten hyjnore fluturon?
Çdo rrënjë trëndafili, varr i ëndrrave tua,
Çdo gonxhe, për ty, epitaf i përsosur;
Në çdo vend, bukuria yte e fshehur,
Në çdo vend, kuptimi yt i shfaqur;
Nuk dukesh në një vend të caktuar,
Por bukuria jote e pashoqe duket kudo zbuluar!

O ti që u bëre i afërti i intimitetit hyjnor
Dhe kjo botë t'u bë e huaj,



S'e di, a ke për të më kujtuar?
Ky burg i zi që i thonë dynja,
Eshtë vend prove ende për mua...
S'ia dola të shpëtoj, ja, tani është koha!

O i dashur i shtrenjtë, shoku im i vuajtjeve,
Zoti e di, durimi m'u lëkund,
Vendosmëria m'u shkatërrua;
Shpirti im që vajton pas teje, i hidhëruar!
Më le pa njeri e shkove,
Më dogje, me mallin tënd më përvëllove!

ZELLI

Sadiu, ai shpirti i përsosur i Lindjes sonë,
Na jep një mësim të vërtetë e ja se ç'thotë:

“Një herë, pesë a dhjetë karvane u nisëm në shkretëtirë,
Ditën ecëm, natën pushuam ku kishim arrirë.
Nuk shkoi shumë, pashë një burrë të hutuar e të trembur
Që vraponte andej-këtej... Të birin e paskej humbur!
I shkreti paska shkuar çadër më çadër e paska pyetur,
Çdo gur i gjetur, shenjë e të birit i ish dukur.
“I vetmuari atë, ku do ta gjejë”, duke menduar prore,
E shoh tek vjen me të birin e shtrenjtë zënë për dore;
I mbushur me hare vjen drejt nesh,
Gëzimi i ka shpërthyer, i rrjedh prej sysh!
Iu afrua devexhiut e i tha menjëherë:
“E gjeta tim bir... po si? Sikur ta dije...
Ç'të më dilte para, thosha është ai; kurrë s'u ktheva.
Dhe sikur të më gënjenin mijra fantazi,
Pata besim, s'u lëkundam në vendosmëri.
Meqë ish në botë, patjetër do ta gjeja...
Notova rërave, u zhyta errësirave,
Shpirt kudo u bëra, s'u mbyta, s'u rrëzova.
Mbështetja hyjnore, më në fund, më erdhi në ndihmë
E pashë para vetes përsëri dritën e syve të mi!”
Sadiu ne na tregon udhën e urtësisë:
E kuptojmë çdo gjë po e pamë me besim!
Po qe se njeriu që vrapon pas një qëllimi,
E mban vendosmërinë të fortë e pa u lëkundur,
Sigurisht, herët a vonë, ç'kërkon ka për ta gjetur.
Sepse, për daljen në shesh të së vërtetës,
Suksesi e do kërkimin, vendosmërinë
Dhe kërkimi e vendosmëria, suksesin.
Dhe vendosmëria, s'bën dot pa qëllimin!



Dhe kur qëllimi, vendosmëria e kërkimi të bëhen bashkë,
A mund të ndodhë që të mos ketë sukses?
Disa herë, dy-tri vështirësi e pengojnë shpresën;
Atëherë njeriu duhet ta forcojë vendosmërinë.
Humbja e shpresës është rrugë pa krye:
Një herë po re në të, mbetesh në humbje përgjithmonë!
Ashtu dhe ati i dënuar me humbjen e të birit,
Po të kish hequr dorë nga kërkimi i tij
Në netët e errta, a kishte për ta gjetur?
I biri do të kish humbur jetën, i ati, të birin!

SEJFI BABAI

Mbrëmë, kur erdha në shtëpi, më thanë:

- Sejfi Babai

Qenka sëmurë, qenka shtrirë.

- Ç'kishte, vallë?

- S'e dimë; duke kaluar këtë mëngjes, i biri na la fjalë.

- Eh, sikur të isha ndodhur unë në shtëpi!.. Ah!

A s'ka ndonjë fener? Jepmani! Shkopin ku e kam?

Moj vajzë, nxito... Po u vonova, mos më prisni

Se rruga është e gjatë dhe krejt baltë...

- Më mirë rrini!

Ka ardhur tezja juaj, vetëm s'jemi.

Shkopi në dorë të djathtë, feneri xhamthyer, në të majtë;

Balta gjer në bel, shiu të hyn në palcë.

Po qe se gurët e kalldrëmit të varrosur qëkuri, s'do të ngjallen

E ta ftojnë "eja!", njeriu ka për t'u fundosur.

Duke u hedhur si laraskat nga njëri gur në tjetrin,

I mbytja të shkretit edhe pse të vdekur!

Mos ma pyesni hallin, gurët s'kanë të sosur,

Na ra ne të notojmë ndër gjole të përbaltur.

Stërkalat i binin fenerit në të katër anë,

Me dy varka lundronim, ai mënjanë, unë mënjanë!

A shumë notuam? S'e di; por zumë dhé

Dhe feneri nisi të dallojë ndonjë gjë përreth.

E drejta, edhe unë u lodha, por ai më shumë...

E shihja, i vinte me të vërtetë për gjumë:

Këtej, si qorr, përplasej me një mur të pasuvatuar,

Binte mbi varrezë andej drita e tij e vdekur;

Këtej vraponte nën një shtëpi me çatinë rrëzuar,

Andej kapërcente sipër një faltoreje të shembur!

Ndodh që, në vende të rrëpira kandili im sillet

Se si përsillen mijra njerëz të varfër pa plang e pa shtëpi,



Lakuriq tek kanë hequr mbulesën e natës që zgjatet e shkon
E duket sikur flenë të strukur nën një strehë,
E përplasen pa drojë me njerëzit më të frikshëm ai;
Fole të heshtura, shtëpi shtrirë për tokë,
Një tufë gra të mjera të ndara nga burri,
Pinjollë të hallakatur të asaj lidhjeje të këputur;
Grumbuj plehrash vende-vende ngrenë krye nën errësirë,
Familje që shëtisin nëpër sokakë me shtëpinë mbi shpinë!
Natën të pret udhën njeriu, në mëngjes e sheh dorën tek të shtrin,
lypsar!

Endacakë, të vetmuar, të pafismë, punëkëqinj, katilë!
Sa pamje të tilla të shihte imi qorr kandil,
Duhej të m'i tregonte dhe mua një herë... Përse? Kush e di;
Po sikur edhe kandili që ka pirë ujë shiu,
Të japë frymën e fundit e të më lërë në terr?
Atëherë do të kthehesha në qorr që ecën duke prekur
E duke vënë veshin: oh, ç'tmerr!
Kështu, shkopi m'u bë edhe sy, edhe këmbë, edhe dorë,
Pse të gënjej, zemra m'u mbush me frikë menjëherë!

Mirë, po ja tek, shyqyr Zotit, shoh para tre fenerë;
Po qe se ecin drejt pa u shmangur,
Do t'i ndjek pas... Tani dhe rrugën e kam gjetur.
E gjeta, them! Po ja ku kam arritur!
Ja, përballë, shtëpia e mikut tonë të vjetër!
Ta shohim, a ka dritë? Apo ka rënë për të fjetur.
Në mes të derës do të ketë një rrip varur;
Sikur ta gjej dhe ta tërheq; po dera qenka hapur!
Siç duket, dikush ka dalë... Fundja, ç'rëndësi ka,

Po hy, them me vete, dhe e gjej veten brenda,
I heq këmbësh llastikat dhe hyj në shtëpi.
Kthehem më të djathtë, ca më tej katër-pesë shkallare
Pak të vështira për t'u bërë përpjetë!

Kthehem më të majtë, perden e vjetër prej shajaku
Të derës hap dhe më zë veshi zërin e të fakirit vetë:

- Ku mbete? S'më ke rënë mbas, o bir!
Oh, po, unë kam faj që s'të çova fjalë, ke të drejtë!
E di, ke punë shumë, pastaj, rruga jonë, e gjatë...
Pusho pak, dukesh se je lodhur shumë.
Pastë bereqet, komshika qëpari vuri pak zjarr...
Nëse mërdhin, trazoje mangallin e ngrohu pak.

Pashë se gjysmerrësira e dhomës jep kasavet;
Një kuti shkrepsë provova t'i jap fenerit dritë.
Fija e fundit ndezi dhe drita e tij e zbehtë
Ra mbi sytë e verbër të qiriut sikur t'ia kish larë!
Atëherë, sapo perdja e errësirës u hap përgjysmë, përnjëherë
Shikimi pa një skenë rrëqethëse mjerimi
Që edhe po të jem poet, i pamundur pëshkrimi,
Sepse ai shkatërrim ishte tej çdo përfytyrimi!

Duke tërhequr mbi gju një gunë të vjetër,
U tërhoq zvarrë e iu afrua mangallit yni Sejfi Baba.
- Lule bliri më dha qëparë komshiu... Sikur ta gjenim...
- Ti rri, e kërkoj unë...

- Do të pinim, është e mirë...

Hë, e gjeta, mos e kërko, mos shko, o bir...
E mora unë xhezven e gjerë dhe e vura të zjejë
Dhe t'ia jap plakut filxhan-filxhan
Që nisi t'ia qarkullojë sërish gjakun ndër dejë...
- Na trego, tani, ç'që kjo e sëmurë?
Më duket se të ra rrufa se ky dimër kështu e ka zënë.
- Shtëpia e Mehmet Agës pikoka dhe, për t'ia zënë pikën,
Hipat në çati ku mora të ftohtë... U bënë pesë a gjashtë ditë.
Thuamë: "Ç'punë ke në çati, o i marrë?"
S'e di, o bir, pleqëri është, a ç'është, s'po e marr vesh këtë vit!



Ja s'po hip... Po kush më jep për të ngrënë?
A më mirë të rri si qorr e t'i zgjas dorën të poshtërve?
Kush nuk fiton në këtë botë pará sa për bukë,
Turpërohet para dushmanit e mikun e bën me turp!
Mirëpo plaku mbi të shtatëdhjetë e pestat dot s'punon.
Puna e vetme e tij: Të marrë abdest e të falë pesë vakte namaz
U sëmura, njeri s'kam që të më shohë. Osmani
Vrapon ditë e natë sikur punon, por s'e di
Se kur ka për t'i zënë dora bukë. Ja, tri orë pas perëndimit,
E sheh, ende s'di të vijë... Vetmia qenka shumë e vështirë,
Disa herë ndodh që një javë askush të mos vijë për të më parë;
Më ka prekur keq vetmia këtë herë!
- Sonte do të të mbuloj që të djersish;
Po djersite shumë, do të bëhesh mirë.

N'sa plaku djersinte i groposur nën jorgan,
U mbështolla edhe unë me një batanije, mangalli pranë
Dhe nisa ta kërkoj gjumin, por më kot!
Më në fund, i lodhur, qeshë kredhur një copë...
Dita kishte zbardhur, u zgjova. Dhe thashë të shkoj,
Por në fillim ta kënaq këtë njeri të gjorë.
Mirë, por kur pashë në qese, asnjë dhjetshe s'kisha,
Vetëm vula me qafë përkulur rrinte e vetmuar!
Atëherë m'u këput nga shpirti kjo thirrje e përjetë:
O të isha pa dinjitet, o të kisha para!

NJERIU

*Ve tez'umu enneke xheremun sagirun
ve fike'n-tave'l-âlemu'l-ekber!*

*"Ti pandeh se je një gjë e vogël, por një botë
e madhe rri e fshehur brenda teje!"*

Imam Ali

O njeri që për veten tënde ende gjë nuk di;
 "Një gjë e pavlefshme jam" po thua, po sikur ta dije ti,
 Thelbi yt dhe prej engjëjve t'është më e lartë,
 Tek ti rri fshehur gjithësia, me vete ti botën bart.
 N'sa frymëzimet hyjnore gufojnë nga toka e nga qiejt,
 Zemra të bëhet vendshfaqja e ndritshme e Zotit vetë.
 I vogël në shtat, por qëllimi i krijimit hyjnor je,
 Prandaj s'të gjindet fundi dhe fund nuk ke!
 Ti - m'i bukuri varg i poezisë së Fuqisë Hyjnore,
 Ti - enigmë e pazbërthyer e krijimit të Dorës Mjeshtërore.
 Natyra - robi yt, gjithë sendet i ke shtirë në dorë, pothua,
 N'sa bota - me qafë përkulur, i burgosuri i urdhrave të tua!
 Dituria jote rrëmbyese rrufe gjuan ndër re,
 Aftësia jote njohëse nën tokë minerale gjen.
 Detet ke për shtrat, dallgët, djepi yt nazemadh;
 Ç'janë malet! Flatrat e tua masin qiejt, tokën!
 Ajri, bartës i urdhrit tënd në të katër anët; kështu,
 Thirrja jote dëgjohet në të njëjtën kohë në të gjithë botën!
 Pengesat, kundërvëniet nuk mund t'i qëndrojnë përparimit tënd,
 Sulmuesit ikin kur i merr punët me vendosmëri.
 Mendimi yt i urtë qiri të bëhet kur ecën n'errësisirë;
 Çdo shkëlqim i tij një dritë e amshuar!
 Në shkretëtirat pa ujë, prijës, frymëzimin e përpjekjes tënde ke,
 Që në çdo hap, oaze plot hije të tregon.
 As errësitat të bëhen pengesë, as greminat, as humbëtirat;
 Ti ecën dhe sikur rrugën duar të hekurta të ta zënë!



Si të ishe ndëshkimi i zbritur nga qiejt e fatit,
Masat që merr, shembin çdo dhunë e tirani.
Gjoja je vërtetim i caktimit të zbritur nga qielli;
S'bezdisesh nga përparimi, ngjitesh lart e më lart.
Sa më lart ngjitesh, aq më lart kërkon të hidhesh;
Në ditët më të shquara, në çastet më të lumtura, madje,
Një perspektivë e largët ndodhet në përfytyrimin tënd.
Në atë perspektivë është kënaqësia jote, ashku i ndërgjegjes,
Shpirti yt, i dashuruari i pasionuar i atij gëzimi të shenjtë.
Ajo kënaqësi është që të shtyn të ecësh para;
Frymë jotja me motiv përparimi, dosmodshmëri.
Gjithë të fshehtë e krijimit kërkon ta mësoh;
Nga kjo botë e panjohur e boshe kërkon të shpëtosh.
E ardhmja, fillimi, e tashmja, tre të panjohura të mëdha,
Të rrinë karshi ashtu si periudhat e së ardhmes.
Kah vrapon je pa prâ me sevdanë për t'i njohur këto;
Nga e vërteta edhe nëse s'nuhat gjë, s'je i qetë fare.
Le të fshihen, po të duan, enigmat pas perdes së errësirës;
Nata e izolimit ku ke rënë, s'ta rrëzon shpirtin në pashpresim.
Nëse qëllimi si një pishtar të ndriçon para e të prin,
Nuk druhesh të zhytesh në errësirën më të thellë.
Po qe se vjen një ditë e të shfaqet natyra e të gjitha veprave,
A e lë ti kërkimin, a ulesh e rri? Kurrsesi!
Atëherë i vjen radha njohjes së thelbit të Krijuesit
Dhe madhështia e Tij ta prish qetësinë!
Fundja, për ty s'ka për asnjë çast të ndenjtur e pushim;
I detyruar je të ecësh, s'pajtohesh me të tashmen e as kënaqesh
me të ardhmen !
Dhe kur para një hapësirë përparimi e tillë të ri,
Si mund ta quash veten një krijesë të dobët ti?
Një madhështi më të lartë se engjëjt ke merituar;
I ngarkuar me amanetin hyjnor, një element i veçantë je.
N' jetën tënde sa mijra vështirësi të ndjekin në njërën anë,
Vdekjet dhe frikërat të sulmojnë në tjetrën anë,

Nuk rri, por i pranon ato me një të madh durim
Dhe ecën para në rrugën tënde me vrull e pa pushim!
Një ekzemplar i lartë i krijimit je, më në fund u pa:
Mendo, atëherë, ç'duhet bërë, pra!
Nëse vlera jote m'e shtrenjtë se engjëjt është, vepro,
Zëre vëndin tënd, me kafshët mos u barazo!



NEJZENI QORR

Në dorë, një kallam të vjetër me një tingull zemërpërvëlues
Sa rënkimi mortar; nën sqetull, një shtatëvrimësh.
Shihja se kur lypsari qorr niste të qante ngjirur,
Kalimtarët që ndaleshin të dëgjonin për mëshirë,
Hidhnin në poçen e mjerë mbi të cilën kish përkulur qafën,
Të paktën pesë pará në mos një dhjetëshe të tërë.

Duke klithur herë pas here me veglën e thyer,
I vinin në vesh, me tringëllimën e dhjetësheve,
Një lajm miqësor, një sihariq i vyer;
Tinguj që, duke mos iu përzjerë rënkimeve
Gjokspërvëluese, vetëm sikur i mbanin ritmin atij!
Ky zë, kjo pamje mua më vinte mjaft e hidhur!

Rreth tij, gjithë net që zgjaten pandërprerë...
Për horizontet e jetës së tij nuk ka mëngjes!
Në fytyrën e tij nuk duket ndonjë dritë e mirë
Buzëqeshjeje shprese! Ajo fytyrë e mjeruar,
Tërë dhimbje, e gjitha nën një re të dendur e mbuluar...
Koha e kaluar, errësirë; e ardhmja, errësirë!

Ç'është e vërteta e një nate të gjatë të pambarim? Për jetën, shko
e pyete atë:

Vështrimet e tij botën e shohin kat-kat errësirë!
Të keqen s'e sheh, se vetëm të keqe përjeton
Përsa të vazhdojë të jetojë në këtë botë sterrë!
Në këtë natë të pafund ku ndodhet, kërkon
Një rrugëdalje për në mëngjesin e shpresës, i mjerë!

Përballë vështirësive të punës ditore, në sup,
Një gunëz me detyrë mbrojtëse, copë-copë.
Por atë mbulesë të paqëndrueshme ia hap
Në çdo të fryrë era me inat e, më në fund,

Trupi lakuriq i qorrit që kërkon ta fshehë, del jashtë
Dhe dallgëve të borës dhe shiut u vë gjoks!

Një ditë, kur dola nga tregu, lypsarin pashë
Tek rënkonte i shtrirë gurëve të përbaltuar.
Nën vete, një hasër dhe mjaft i vjetëruar shtrihej,
Po të mos ish çatia e shatërvanit,* s'do të kish mbulesë.
Nga larg tashmë as zëri i nejit s'ndihej;
Vetëm nga afër e dëgjova atë frymë të sosur!

A vetëm për vete i bie ai, apo rënkon?
As dëgjues ka, s'ia vë veshin kush... Çdokush sheh e kalon.
A ka kush e dëgjon zërin vajtues që jehon nga varri?
O i shkretë, shih të vdesësh, lëre rënkimin e ankesës!
Por, pritni... Ja ku në poçe një tingull metalik përsëri...
Ah sa i ëmbël është gëzimi i shpresës!..

Streha e shatërvanit që mbronte nën vete qorrin,
Ishte shpuar dhe shiu që binte nga reja me vrik,
Pashë se zbriste poshtë si çurg nga ajo vrimë
Dhe godiste mbi poçen e mjerë si me kamxhik...
Me të dëgjuar, qorri e kujtoi vërshim mëshire
Dhe u zgjat drejt poçes, por, ah, që u mashtrua:
Prekja e duarve të nxira doli bosh, vetëm u lag!

* Shatërvan: Në traditën islame të ndërtimit publik, strehë e gjerë e çezmave publike, veçanërisht e çezmave pranë xhamive, ku merrej abdest.



SHAHU PERSIAN*

*Edhe për sundimin mbi gjithë këtë tokë
Nuk e vlen të derdhet një pikë gjaku mbi tokë!
Saadiu*

O ti, ballëpërgjakur, topuzin e rëndë vrasës
Vare në murin e larë me flori, si zbukurim!
Me qefin të përgjakur ngjyrë alle çadrën shtroje,
Me jetë njerëzish ndize pishtarin e strehës mortore!
Gojët e errëta të gropave të varreve,
Kockat që u përngajnë dhëmbëve të skërmitura,
Mizoritë e tua i kujtofshin përjetësisht,
O ti që ballin e ke epitaf të mijëra varreve të përgjakura
O ti që flijon një mijë të vërteta për një iluzion,
O ti që duke hapur varrin e popullit me dorë të hekurt,
Horizontet e dritës jetësore të tij i shkatërron,
O ti që errësirën e dendur të netëve shpirtrave ua përzjen!
O ti që dritën e të vërtetës së mendimit e shtrin për tokë
Dhe, si kocka të vdekurish, e copëton dhe e shkapërdhen!
O ti që shemb vatrat e familjeve në zi!
Mos vallë kurora shtetërore që ke mbi krye, është
Trëndafil i çelur mbi varret e atyre që i ke vënë nën këmbë?
Dhe nëse fama botën e mendimit ta ka zënë,
Mos pandeh se e ke në saje të pushtetit të kurorës...
Në saje të varreve të bleruar të njerëzve si Sadiu e ke!
Varret e Sadinjve, po, një grusht dheu janë,
Kurse froni yt, sipas teje, një botë që s'e nxënë as qiejt!
Por, sipas meje, atij varri, froni dhe kurora yte t'i bëhen fli!
Pushteti yt zhurmëmadh s'e vlen për klithmën e fundit të atyre
Që e kanë mbyllur gojën të tërhequr në heshtjen e varreve...
Qesharak më duket mua pushteti yt i frikshëm!

* Këtë poezi, M.Akif e ka shkruar së bashku me mikun e tij, Mithat Xhemal. Fragmenti i parë është i M. Xhemalit, i dyti, i M. Akif Ersojit. Kjo poezi është një portret i shahut persian, Muhammed Ali Shah që ka sunduar në vitet 1907-1909. Është bërë i njohur për despotizmin dhe se ka anuluar kushtetutën e shpallur më 1906 dhe e ka gjuajtur parlamentin me top.

Kthetrat e fatit që asgjësojnë njëmijë kombe e njëmijë pushtete,
Pa dyshim që s'duhet ta bëjnë të pavdekshëm një individ!
Ja, e kaluara është atje, përtej varreve,
Tyrbeja e pavizitorë është e popujve!
Po qe se e hedh shikimin në thellësi të erësirave,
Popujt ke për të parë në pamjen e kufomave!
Flokët e ngatërruar në ballë të sundimtarëve,
Eshtrat, varret e shembura të të parëve
Shembull merr dhe pa mendo...
Shumë është kaq dhunë për një copë tokë!
Napoleoni i madh që pushtoi kontinente,
Më në fund ç'fitoi? Vetëm një gropë!
Froni i tij i fundit, varri i zi
Dhe shokë të tij akrepat, e miq gjarpërinjt!
Shih e turpërohu: për sarajin tënd madhështor s'ka më vend,
Toka e vatanit, me saraje mortore mbushur plot!
Ndërsa gojët e të parëve të tu
Që botën e patën vënë nën urdhër, sot,
Të mbushura me dhé, as të bërtasin s'kanë mundësi,
Ç'është kjo zhurma jote sot për madhështi e krenari?



*S'kanë fare të drejtë shtetin ta drejtojnë
Mizorët, për të cilët populli lutet: Zot, hiqnai qafe, aman le të shkojnë!*
Sadiu

Mos pandeh se krekosja jote zhurmë tmerri
Ka për ta bërë Iranin të rënkojë pa fund!
Të gjitha zërat që thonë “je fitimtar”, janë tradhtarë, mos u gënje!
Mendo: mbi kë ke dalë fitimtar? Mbi popullin tënd?
A quhet fitore vrasja e një populli që do drejtësi?
A s'ke fare, qoftë dhe një copë njerëzi?
Vajtimi që ngrihet lart nga zemra e popullit,
Vallë si nuk të bën përshtypje?
Të jesh i sigurtë se rënkimin e lartësuar nga zemra e të vuajturve
Një ditë mallkimi hyjnor ta lëshon mbi krye!
Sarajin e dhunës dhe tiranisë ku ndodhesh, të sigurtë
E pandeh... Por sa e sa strehime të sigurta në dukje
Me tokën u rrafshuan në një çast nga Ndëshkuesi Absolut!
Pallati që ngrite duke kthyer shumë vende në gërmadhë,
A s'do të shembet? Gjithë Irani është kthyer në varrezë!
Po, Iranin e ktheve në varrezë, e bërë dhé, shpresën
E popullit të shkretë e shqyeve, e ktheve në qefin!
“Për botën dhe një pikë gjak është tepër” - thonë, kurse ti
Si lumë bërë të rrjedhë gjaku i pastër i popullit të pafajshëm!
Më në fund e hoqe nga fytyra vellon e kthjellësisë dhe e hodhe tej
Dhe ia tregove botës se ç'natyrë, ç'karakter ke dhe se sa vlen!
Kur qëllimi i islamit është flamuri i lëvdimit të lirisë,
Një flamur të tillë të shenjtë e vure nën këmbë!
Kazakë nga Rusia solle e fisnikërinë fetare e shtype,

U lartësoftë shpirti i Jezidit!* Ti e lartësove!
Despotizëm tregove e mijra shtëpi të Zotit shkele,
Pate guximin e shumë evlija vare!
As nga Allahu u turpërove, as nga Pejgamberi u skuqe,

* Jezid: Biri i halifit Muavije. Në kohën e Jezidit pati ndodhur ngjarja e Qerbelasë.

Qaben e lartë të fesë e shembe e për tokë e shtrove!
 Tribunët e popullit një nga një i kape e i vrave,
 Gjithë Lindjen e bëre të qajë, gjithë Perëndimin e gëzove!
 Jo, askush nuk qesh, edhe ndërgjegjja e Perëndimit vuan
 Kur e sheh tokën iraniane ekspozitë kufomash të pafajshme!
 Toka iraniane që ka rritur atë Saadi, Hafizi,* Firdeusi,** Razi,***
 Gazali,**** Kutbuddini,***** Saduddini,***** Kaadi,***** Orfi,*****
 Që ka marë dritë nga shumë diej diturie,
 Sot është në duar të një çete hajdutësh!
 S'e di cili është sekreti i Zotit në këtë ndodhi!
 Jo, s'ka kuptim që këto t'i ngarkohen Zotit,
 Se Zoti nuk i jep ndihmë kriminelit kurrsesi!
 O shah i vetëmadhëruar! Kjo kohë nuk duron dot padrejtësi;
 Gabohesh nëse mendon se askush s'të thotë gjë ty!Jepi fund kësaj
 tiranie se, e ardhmja është errësirë vërtetë,
 Por duket sheshit se shkatërrimi yt do të jetë!

* Hafizi: poeti persian Hafiz Shirazi (1325-1390).

** Firdeusi: poeti persian Firdeusi (934-1020).

*** Razi: dijetari i shquar islam, Fahrudin Razi (1149-1209).

**** Gazali: dijetari i shquar islam, imam Gazaliu (1058-1111)

***** Kutbuddini: dijetari i shquar islam, Kutbuddin Shirazi (1236-1311).

***** Sa'duddini: dijetari i shquar islam, Sa'duddin Taftazani (1322-1394).

***** Kaadi: juristi dhe teologu i shquar islam, Kadi Bejdavi (vd. 1291)

***** Orfi: poeti persian, Orfi (1555-1591)



DESPOTIZËM

*Kushtuar vëlla Mit'hat Xhemalit**

U shembe e shkove, o periudhë e despotizmit të ndyrë,
Por në zemrën e popullit le një kujtim të pafshirë, të ndyrë!
Etërit na bëjnë zë prej varreve: “O nipa të mjerë,
Pse kur vriteshin mijra të pafajshëm nga çdo xhelat që vinte,
Ju mallkoj! Gojëra që s’nxirrnit asnjë ankim as në pashpresí?”

Tridhjetë milion popull, i dënuar i tre piratëve të tillë,
Të heqë, në emër të shtetit, një barrë ndjellakeqe të tillë?
Kur mizorin me viktimën i barazonin, a s’ju vinte turp?
O ju të privuarit në botë të aftësisë për t’u bërë njeri,
Një hije iluzive e mbajtët më të lartë se qiejt!”

Nga një fis në çadra, ai popull një shtet botëror pat nxjerrë
Dhe një kohë e pat bërë të dridhet një botë të tërë;
Vjen koha dhe ky popull sheh një mjerim të tillë,
I bie në kokë fatkeqësia dhe tridhjetë vjet nuk di të bjerë...
Ky, një shembull mësimdhënës është, por të mos bëheshim ne!

Ndërsa flamurët tanë valviteshin qiejve, na zure e na poshtërove;
Të birin që duhet të krenohej me të atin, e turpërove;
Ç’popull i lartë qemë; ajme, ti erdhe e na mjerove;
Gjithë shpresat për të ardhmen, i shembe, i asgjësove;
U bëmë rezil...; o ti, makth i përgjakur, ti na turpërove!
Te kush pe një ballë të pastër që tregon dinjitet,
E quajte kriminel, e syrgjynose ose e hodhe në qeli.
Ia ngjite spiunimin çdo ndërgjegjeje, çdo ndjenje,
Birin më heroik të popullit e rrëzove në pashpresí...
Sa i mallkuar je! Na detyrove t’kërkojmë mëshirë për shpirtin e djallit

* Mid'hat Xhemal (1885-1956), poet dhe prozator, një prej miqve më të afërt të autorit.

Iku, më në fund, kohë e makthit, kohë zgjimi është tani.
Eja, o liri nazemadhe, rruga me shpirtra të është shtruar!
Vendin e ke të sigurtë: ndërgjegjet më të pastra ke strehim!
Shteti Osman i shtrirë përtoke, froni yt i garantuar!
Kalorës popullin ke: bëhu shtrat i ideve të ardhmërisë!

* * *

- Një ditë më parë -

*Veriu s'e zë mëhallën tonë as dimrit;
Sa të vijë pranvera, te ne shkrin e bëhet baltë!
Pranverë s'shohim, por thonë bukur do të jetë...
Pemët çelkan lule, toka u mbuloka me bar të blertë.
Domethënë, po mbiu bar në këtë arë, do të jetë pranverë...
Pse duhet kaluar koha në majë të malit Jakaxhëk?
Sokaket tona s'i bëjnë katër stinë;
Këmbët tona dy stinë njohin vetëm: baltë dhe thatësisirë!
Kalendari i vjetër i astrologëve, pastë bereqet,
Na tregon neve ç'stinë është në qytet!*

*Ishte një natë e nxehtë, po tepër e nxehtë; pashë
Se në shtëpi ishte më keq se vdekja dhe thashë
Të dal jashtë e të shëtis, ndoshta mbushem pak me frymë;
I lodhur shumë jam, por kthehem pastaj bie në pushim.
Sheshi ynë i lojrave është kodrinë e Jajlla-së,
Dhe larg po të fryjë veriu, kap, verës është mirë.
Duke mbathur këmbët e dalë jashtë, dhe shkopi më arriti...
Nuk jam i sigurtë të eci po s'u bëmë dorë për dorë.
Ai është mbështetja ime, në paça, në këtë botë;
Serioz, burrëror, besëtar; e kam provuar mjaft.
Për sokakët tanë mendoni pak e thoni: pus!
Lind dielli në qytet e sa minarja ngjitet lart,
Kurse llamba ime përballë ende më shkel sy;
Dielli perëndon pa ardhur iqindia, netët s'kanë fund!
Sidoqoftë, shikimi ergjëndor atë natë i hënës pesëmbëdhjetë*



U ngul mu në kulm të qiellit blu
Sikur të donte të vëzhgonte brenda shtëpitë!
O Zot, ç'abazhur i këndshëm për shtëpitë pa tavan!
Rri, o fener i përjetshëm atje ku je,
Ta përkëdhelin ca rrezet e tua këtë skenë në errësi.
Jetë është prekja jote nxitëse për ballët e përvëlur
Nën rrezet goditëse të ditës, të diellit të nxehtë!
Dritaret hapur; nga çdo shtëpi në të djathtë e në të majtë
Vinin zëra lloj-lloj: diku të hidhur, diku të gëzuar.

- Shih, nënë, shih hënën!

- Ama, mashallah,

Sa një tepsi...

- Pusho, Aishe, është gjynah, Rri!

- O Zot, je e çuditshme, teze, gjynah pse të jetë?

- Gjynah, të thashë një herë, mjaft tani...

- Eja dhe ti, je matufosur!

- Matufosur mos më thuaj, për Zotin kam për të të qëlluar!

Ah, ju, që ju kanë fluturuar mendtë! Mos vallë kohë e fundit

Ka afruar?

Në njërën prej shtëpive tingëllon bukur zëri i udit,*

Në tjetrën, një zë daudian** që të bën për vete,

Këndon Kur'an; kurse kalimtarët, të ekzaltuar,

Në këmbë nga ai zë, të rrëqethur

Por, pas pak, dëgjohet një zë tjetër, dhimbjemadh .

Vallë, ç'të ketë? Të gjithë në fillim vrapojnë kureshtarë,

Por, ç'të shoh? Të gjithë kanë ngritur thembrat e janë shpërndarë

Shtëpi më shtëpi! Kaq është dhembshuria e treguar!

Të gjithë qirinjtë në shtëpitë përballë u mpakën,

Sikur u mpak fryma e një mëhallës tërë!

U pre tingulli kur'anor, u pre tingulli i udit,

Dëgjohet vetëm herë-herë një zë vaji i hollë.

* Vegël muzikore orientale e ngjashme me lahutën dhe çiftelinë, gjashtëçifttelëshe të cilës i bihet me penzë.

** Zë daudian: zë lirik e prekës si i profetit Davud.

Pse u fshehën njerëzia, ç'të ketë, o Zot?
Afrohem dhe e kuptoj ç'është shkaku dalngadalë.

Ç'pamje qe, o Zot, ajo skenë që pashë!
Pesë a dhjetë burra i janë ngjitur një të varfëri për duarsh
Dhe e heqin zvarrë; një grua u thërret që përtej:

- Lëreni!

Ç'ka bërë burri im? Ç'është faji i burrit të pafaj?
Të mjerit, djali i madh i vdiq ushtar,
Kurse i dyti, i syrgjynosur në Jemen, se ku, s'e di!
Është i sëmurë nga gjoksi, mos e lëndoni!
Gjynah është, o bir, është turp, mosni!
Kush është efendi? Ku ta dijë ai? Ç'del dhe nëse e di?
Me qilarxhiun bie fis pak larg. Ca ditë më parë
Paska parë komshiun dhe i paska thënë "bëji selam!"*
Domethënë, as selami i Zotit përgjigje s'do të marrë!
A zvarritet njeriu si të ishte qen, zvarrë?
- Grua, hiq, të rashë, ë! Mos u afro, zhduku që këtej!
- O njeri, lëre, po të them... Shih, fryma iu pre.
- Ç'na dërdëllit kjo? Bëjeni të pushojë kjo qelbësirë!
A nuk ju them përherë unë juve, "veproni pa poterë"?
Kurse ju s'kuptoni fjalë, si gomerë!

Gruaja: - Pashai im, ç'bën?

Pasha? Ç'pasha?

Ky njeri që qëndron drejt si dordolec, është pasha?
Përfytyro: Një trung i gjatë dy hostenë!
Sill dhe vëri sipër një kafkë me kokore.
Bëj një mjekër në formë fshese dhe vërja si fytyrë
Këtij të pafytyri duke i thënë: "ja fytyra jote!"
Fshesa e oxhakut, siç dihet, nuk fshin, por shemb,
Kufoma dalin prej atje ku mbin ajo në atë vend!
Gërryey dhe një çift vrimash pak nën ballë
Dhe mbushi me diçka që të duket si kokërdhok.

* Bëji selam: përshëndete, lutu për të për mëshirë e paqe.



A e di se nën gëmusha ka vrima të fshehta?
Gjarpëri del në mëngjes dhe hyn në mbrëmje me kujdes.
Mustaqet, gjembishte të rritura në atë djerrinë,
Kurse goja, si vrimë e fshehtë, e mbyllur s'bie në sy.
Mendoje një herë këtë trajtë të frikshme kështu
Dhe dije se burri që i thanë "pasha" është lugat!
Në bel, shpata "besnike", në dorë, kamxhik;
Lugati që pashë nën dekorata, o Zot,
Brenda dritës së hënës së plotë
Rrinte si nyjë e futur në gjoksin e besimit!
N'sa qielli, toka tërë qenë dritë, ajo hije e ndyrë
Ç'njollë e pashlyeshme në ballë të natës ballëlarë!
- Ç'pasha je, o bir, a s'e sheh? Burrin
Po ma heqin pa pushim zvarrë...
- Zhduku, grua,
Se, po i rashë, e vrava, s'bëj shaka!
- Hiq, zonjë! Pashai s'ka durim, vret e pret.

E njeh atë? Eshtë shërbëtori i parë
I Sullatnit tonë...
- Hej, shushunja, që mos arriftë!
- Hiqeni zvarrë, u paska thënë, urdhër i Padishahut është!
- Zvarrë-zvarrë zvarrituni, të poshtë, sa më shpejt!
Po ti, pasha-fantazmë me pamje të rojës së ferrit,
I Madhi Zot! Kryet si poçe të të vinte në gur të mprehtë!
Shëmtirë me shikim gjarpëri; shiheni këtë në sy!
Ki turp nga trupi si hu... i poshtë, fytyrës tënde ptu!
Mos lini asnjë mashkull në mëhallë, merrini;
S'thanë numër, ashtu, pjesë-pjesë zvarritini!
Shihni këtë hajdut: ka ndenjor e thotë të ma shembin shtëpinë!
Nipërit të mbeten pa ngrënë e të lypin, o njeri?
As nga mëhalla s'ndihet zë; ç'ndodhi me komshinjtë?
Mos u thotë mendja se me të heshtur kanë për të shpëtuar?
O njerëz, nesër dhe vatra juaj ka për t'u shuar...

Pse fshiheni tani si minj nëpër shtëpi?
 Turp për meshkuj si ju që dukeni meshkuj...
 - Të arriti zhurma që bëre, grua, hiqni në shtëpi!
 Hidhjeni këtë horre, të shkojë, futeni brenda menjëherë!
 Pasha, gruaja u mpak.

- Ato hile s'i di.

Domethënë të presim sa t'i vijë botës qejfi...
 Ora vajti tre, u vonuam, hidhjeni në sup atë njeri.

Ndërsa shoku i jetës shkonte si kufomë,
 U shtri e mbeti gruaja në folenë pa zë.
 Edhe durimi im, më në fund, mbaroi, fuqia e duruar;
 M'u zbraz çurgu i lotëve, nervat m'u çtendosën.
 U turpërova duke qarë, qava duke mos u turpëruar!
 Sikur po më fliste ajo e shkretë nga përballë:

- I poshtër,

Qëparë duhej dinjitet! Ç'do të thotë të qarë?
 Dhe gruaja po të qajë, burri vrapon ta marrë me të mirë!

U ktheva në shtëpi; të gjitha ato tragjedi
 Më ndenjën përballë gjer në mëngjes.
 Mijra iluzione të dhimbshme m'u kthyen në sy,
 Mijra klithma jetimësh më jehuan në tru!
 Të qajë e të rënkojë një i shtypur
 Dhe unë të jem i dënuar vetëm për ta parë!
 Por a vetëm unë jam kriminel?
 Kush pati dalë e pati thënë "mosni!"?
 Gjithkush pushoi kur dëgjoi ankimin,
 Edhe një njeri i vetëm nga vendi nuk luajti.
 Madje dhe zëri i Kur'anit u mek
 Si të kish heshtur zëri i Zotit!
 Mbylle gojën! Ai s'hesht: Thirrja kërcënuese
 Shih se nga jehoi:
 Topat që gjëmojnë në Shqipëri,
 Po vijnë, ja, gjer në kryeqytet tani!



LIRIA

- Dy ditë më pas -

Vajza me fustanin borë të bardhë
E zbritur nga xhenneti si bijë hyrije;
Ose është copë agimi që fluturon,
Në shpinën nazemadhe, një re-nur.
Ngjeshur një brez lirie
E shëtit botën gjatë e gjerë!
Me ta rrethuar hënën agimi me brerore,
E këndshme mund të bëhet vetëm kaq!

Po ky djalë, ky lozonjar topolak
Që gëzimit i vijnë ngushtë dhe qiejt,
Bart sikur të mos ia nxënte trupi;
Në dorë ka një flamur më të madh se ai vetë!
Kaloj ajo periudhë dhimbjesh q'i thonë e shkuar,
Eja, çliroje: e ardhmja është e jote!

Motër e vëlla vrapojnë dorë për dorë;
Njëri duhet t'i ketë pesë, tjetri, gjashtë.
Shohin pas vetes mbështetur në shkop
Një burrë mjaft të rënduar:
- Moj vajzë, re prapë?
Të thashë njëmijë herë mos vrapo, ec ngadalë!
Ngrehu, mos qaj... Si s'dëgjon pak fjalë!
Shkundia rrobat, Ahmet, shih të mos qajë.
- Nuk qaj, babagysh...
- Mjaft tani, mos luani!

Pashë që menjëherë u shkëput një grup fëmijësh atje tej;
Të shohësh ç'shpurë gëzimi, ç'dëfrim!
Çdo fëmijë ka marrë një flamur e vijnë,

Thirrjet “rroftë!” ngjiten lart gjer në qiej!
 S’e kanë për t’u dukur, sa të natyrshëm janë!
 Shih sa të prapë, sikur janë të lirë qysh në amshim!
 - Thirrni, fëmijë!...
 - Të rrojë liria!

Brohoritje... pastaj një pas një
 O Kënga e Vatinit, o diçka si ajo
 Këndohet dhe çdo qoshe ting-ting kumbon!
 Ndërsa shtrihej si varrezë i palëvizshëm gjer dje,
 Shihe shpirtin se si dallgëzohet sot nëpër sokakë!
 - Sikur të shkonim edhe ne, babagjysh, atje?
 - Shkoni,
 Por mos djersisni shumë! Aman, kini kujdes!

Motër e vëlla u zhytën në valën fëminore menjëherë
 Si të notonin dy të pafajshëm margaritarë...
 Plaku që i vrojtonte vogëlushët e bukur nga pas,
 U kthye menjëherë me sytë në të qarë.
 Pse qau plaku? S’e di. Vetëm kaq dëgjova:
 - Ah, sikur një herë t’ju kish ardhur ati juaj nga Jemeni e t’ju kish
 parë!...



GRUAJA PLAKË DHE OMERI*

*Mësuesit tim fisnik, Ali Ekrem Bej!***

A ka kush që s'e di se kush qe Abasi?***
Dëgjojeni tani atë sahabi!****

“Ish një natë e errët dhe mjaft thëllim...”
Ibni Hattabin pak për ta takuar
Dola nga shtëpia kur në rrugët asgjë s'pipëtin;
Vërtet, unë isha i vetmi kalimtar!
Ndërkaq shumë kohë s'kish kaluar
Kur diku para meje u shfaq
Si një nyjë në gjoks të errësirës
Papritmas, si përmendore, një beduin
Tmerrues brenda një mbulese krejt të bardhë,
Hap pas hapi pa u ndalur duke ardhë.
Unë bëra para, ai erdhi, u afruam,
Ballëpërballë, pa u ndalur u përshëndetëm.
N'sa po mendoja zërin e tij,
Ajo hije u zgjat e më zuri në duar.
Kur, ç'të shoh, Omeri paskësh qenë ai!
- O Omer, ç'punë ke në këtë orë kaq të vonë?
- Dola të bëj një kontroll nëpër lagje.
Eja bëj katër-pesë hapa dhe ti me mua!

* * *

As zë, as dikush nëpër rrugë, i zgjuar,
Mjedisi kredhur në një qetësi të amshuar.

* Është fjala për halifin e dytë, Omer Ibnu'l-Hattab.

** Është fjala për poetin e rrymës “Serveti Funun”, Ali Ekrem Bolajir (1867-1937), nga i cili, M.Akifi qe ndikuar shumë.

*** ¹ Është fjala për të ungjin e profetit Muhammed.

**** ² Sahabi: shok i profetit Muhammed.

Omeri, mbrojtësi i të Drejtës,* në këmbë...
 Ja, ç'qetësi për këtë qytet që fle i patrazuar!
 Ai ballë i lartësuar sa qiejt
 Duke i lëshuar nga gjoksi horizontit dritë,
 Një kohë, me shikimin e tij të pashuar,
 Si një brerore rreth yllit që rri zgjuar!
 Qëndron Omeri para çdo shtëpie
 Dhe dëgjon; njerëzit brenda s'dinë gjë.
 As dhe një gërmadhë s'kaluam pa përgjuar,
 Kontrolluam në të djathtë e në të majtë çdo shtëpi.
 Erdhëm, më në fund, jashtë Medines;
 Omeri pa një çadër dhe u ndal përsëri.

* * *

Në krye të oxhakut, një grua e moshuar.
 Duke përzier gjellën që piqej e gatuar
 Ndërsa fëmijët klithnin "Të uritur jemi", pa pushuar,
 U fliste me zërin përzier me lotët e gëlltitur:
 -Duroni, o bij, ja, zëre se është pjekur...
 Mirëpo, për çudi, kjo punë s'kish të mbaruar!
 Dhe fëmijët nisën sërish duke bërtitur...
 Omeri përshëndeti dhe, më në fund, hyri.
 Plaka e pranoi përshëndetjen me një fytyrë tejet të vvarë.
 - Pse qajnë këta vogëlushë, teze, pa më thuaj!
 - Sot është e dyta ditë pa shtëinë gjë në gojë...
 - Atëherë, pse nuk u shtie gjellë?
 - Gjellë po thua? Këtë enë
 A mos e pandeh ti me ushqim? Brenda ka vetëm ujë
 Ku zjen çakëll pa pushuar!
 Po ç'e do! Ndofta i gënjej, thashë, dhe pushojnë...
 - Mirë, po yt shoq, yt bir, a vëllai, a daja, ku janë?
 A s'ka asnjë mashkull kjo shtëpi?

* Me drejtësinë e jashtëzakonshme me të cilën e pati drejtuar shtetin islam, Omer Ibn Hattabi që bërë simbol i drejtësisë. Edhe në këtë poezi tregohet një fragment nga drejtësia e halifit Omer.



- Të gjithë më vdiqën... S'kam asnjë njeri!
- Të tutë janë këta fëmijë?
- Nipërit e mi.
- Dhe një mori!
Po pse s'ke shkuar te Emiri t'ia qash hallin?
- Ah! Emiri?!
Allahu e shoftë sa më shpejt!
Flamuri i mbarësisë iu shtriftë përdhe!
Omeri e gjettë belanë që në këtë botë!
- Ç'të ka bërë Omeri, teze, që e mallkon kaq rëndë?
- Si, a mund të flejë Omeri kur unë gënjej fëmijët e pangrënë?
Ne jemi nënshtetasit e tij, nga Allahu amanet;
A s'bën të vijë e të pyesë një herë ç'bën njeriu i shkretë?
- Ke të drejtë,
Vetëm se i shkreti ka punë shumë, s'vjen dot vetë,
Po s'shkove t'ia thuash, s'e di hallin tuaj!
- Po pse e ka pranuar hilafetin, pa më thuaj!
Më në fund, kush e pranon këtë justifikim të pavlerë?
I mjeri, na paska punë shumë!... Ç'është, luftë?
Mos dëgjo rënkimet e dhimbjeve përreth,
Medinasit lëri lakuriq e shko Egjiptit vërdallë
Grabiti njerëzit në emër të fitores e eja e ndaj këtu trofe!

Kur fëmijët filluan këtë herë sërish duke bërë titur,
Zemërimi i plakës u kthye në çmenduri:
- Këto thirrje, Omer, që shkojnë gjer në re,
U bëfshin rrufe mallkuese e të rënçin mbi krye!
Rënkimin e jetimit lutje shiu mos e pandeh!
Është urtësia hyjnore që të bën pluhur e dhé!
"Duam bukë, duam bukë, na jep për të ngrënë!..."
"Pushoni, o bij, ja, tani, kam për t'jua vënë!..."
Të shkoj e t'i them, ë? Nuk bëj dot lypsar!
E kush është Omeri? Im atë qe shumë më bujar se ai!

Vdes dhe kalifit tuaj s'i bie ndër këmbë!..
 Omerin e goditën këto fjalë shumë rëndë...
 Teze, ke të drejtë!
 Gënjeji fëmijët, unë vij tani shpejt!

* * *

Kalifi Omer para, fajtor, i prekur, i penduar, i dërrmuar,
 Unë pas, i shushatur, dolëm nga çadra për të shkuar.
 Ish në të gdhirë, errësira ish pakëz rralluar.
 Qentë na sulmojnë si kuçedra, na e presin rrugën,
 Po kush ua vë re? Ne ecim pa u ndaluar.
 Të zhytur në sokakët e shtrembër të Medines,
 Më në fund arritëm te depoja e ushqimeve.
 Kalifi hyri brenda, unë pas, me urdhër të tij.
 E kontrolloi rrethepërqark depon me qiri.
 - Ja një thes me miell, a e pe? Eja, ma ngarko!
 Kjo shtambë është plot me vaj, atë merre ti.
 Dolëm nga depoja, unë me shtambë në dorë,
 Kalifi me miell mbi shpinë; dhe u nisëm nga kishim ardhë.
 Rruga ish e gjatë, ngarkesa e rëndë, Omeri me plagë.
 Dhe i thashë:

- A s'ma jep thesin ta mbaj unë pak?

- Jo! Jo sikur të lodhem, por dhe sikur të vdes
 Të mos më japësh ndihmë:

Omer ibni Hattabi e mban vetë fajin e vet mbi shpinë!

Ç'tha gruaja, Abas, a s'e dëgjove qëparë?

Nesër, para Zotit, askush me Omerin ndëshkim s'ka për të ndarë

Edhe në më ndihmofsh sot! Mirë tha gruaja,

Me kohë hilafetin përsipër të mos e kish marrë!

Dhe sikur ujku të presë një dele në breg të Tigrit,

Drejtësia hyjnore vjen dhe i kërkon llogari Omerit!

Një grua plakë mbetet pa njeri, fajin e ka Omeri!

Jetimi qan për fatin e zi, fajtor është prapë Omeri!



Nëse një vatër mjerimi e pakujdes shembet,
Jo tjetërkush, nën faj sërish Omeri mbetet!
Po qe se mbi tokë dikush me dhunë një pikë gjaku derdh
Pika e gjakut bëhet vorbull, Omerin e rrëmben!
Omeri ndihet në çdo thyerje zemre,
Omeri përzehet nga çdo mjedis ku ka zi!
Kur kalif është Omeri, kush mban përgjegjësi?
Ç'të bëjë Omeri, o Zot, njeriu mizor e injorant!
Nga Omeri kërkohet ajo që pritet nga Muhammedi vetë...
Omer! Omer! Si e more këtë barrë mbi shpinë?

- Po s'e more ti, kush do të vijë dhe më mirë se ti
Do ta drejtojë këtë fushë lufte ku ke rënë?
Po, po qe se drejtësinë si "absolute" e përfytyron,
Jo Omer, po sikur kush e di kush të jesh, lëre se e ke kot!
Po qe se njerëzimi drejtësi absolute pret,
E sheh shpresën gjithmonë të dënuar me pashpresim!
Ti, Omer, as engjëll s'je, as sundues tiran...
Ç'ke në dorë ti? Njeriu nga natyra është mjeran!
E shohin Omerin të gjitha yjësitë e qiellit
Nën errësirë, të rënkojë nën peshë!
Kur të dalësh para Zotit me këtë ballë me miell,
Nxirr dëshmitar jo vetëm tokë, por dhe qiell!
- Larg është? A ka edhe shumë?

- Vetëm pesë hapa!

S'i kish mbetur më fuqi të shkretit... Pashë
Se ecën dalngadalë, frymë më frymë
Duke mbledhur gjithë vendosmërinë.
Ja ku erdhëm! U fut në çadër dhe e zbriti miellin poshtë.
- Lëre shtambën e rregulloje këtë në një skaj.
Nga ena i hodhi gurët jashtë pastaj,
Mori shtambën, shtiu vaj dhe sipër miell i shtoi.
Deshi të ulej, por një tjetër bela tani: Oxhaku
Do të shuhet menjëherë...

- Teze, a s'ke ç've në zjarr?

Gruaja i solli Omerit pesë-gjashtë ferra të njoma
 Dhe Omeri, për t'i ndezur, u shtri sa gjerë e gjatë përdhe.
 Oxhaku tymon, Omeri e fryn me frymë të nxehtë
 Si në sexhde i përkushtuar, e fshin truallin me mjekrën e bardhë të
 kërleshtë.
 Brenda i djeg shpirti, në ballë djersa i shpërthen!
 Tymi shtëllunga-shtëllunga kthehet pas
 Dhe vërtitet mbi njerëzit si reja nën yje.

Oxhaku u ndez, gjella u poq.

- A ke, teze, ndonjë enë?

Sille e ta zbrazim...

- Ja një enë e madhe, merreni.

Gjella ish e nxehtë, por kush kish durim të ftohej!
 Omeri i ushqeu fëmijët një nga një gjellës duke i fryrë!
 Në çadër u pre zija, fryma e gëzimit u zgjua.
 Fëmijët lozin, gruaja plakë e gëzuar.
 Kjo pamje gazmore Omerin e kish turbulluar...
 I thashë:

- Po bëhet mëngjes, të ngrihem!

- Po, eja tani!

Rreth drekës, teze, eja te Emiri e më gjej mua;
 I themi bashkë Omerit e puna bëhet mirë!

* * *

Plakës i qeshnin sytë...
 I lamë lamtumirë e dolëm në rrugë.
 Pa rënë në sy të asnjë kalimtar,
 Zbritëm drejt e te Kalifi në shtëpi.
 Tani po lind dielli, më tha Omeri,
 S'ke ku shkon, rri këtu.
 Pas pak mëngjesi zhurmëshumë
 E zgjoi qytetin që flinte në gjumë!



Kur kishte kaluar dreka, gruaja erdhi.

- Ndoshta, teze, mbete pa gjumë!

Ja, dhe ndihma po të lidhet,

Do ta marrësh çdo muaj që këtej.

A më fale mua, apo jo, tani?

- Kështu tregoje drejtësinë!

EZANET

*Për shkak të rrotullimit të tokës
dhe lindjes së pandërprerë të diellit ,
në tokë nuk ka çast që të mos thirret ezan!*

Nuk ka çast që, ndërsa ekstaza dhe dehja kuptimore e qindramijra zemrave

Lartësohet nga toka dhe mbështetet në perden e njëshmërisë së Zotit,

Të mos e shtangë të mahnitur ndërgjegjen një thirrje.

“Allahu Ekber”*: ç’apoteozë transhendentale e trondit shpirtin...

Eshtë lutje drejtuar të Vërtetës, shum’ të duket nëse e rënkon gjithësinë?

Kur kjo thirrje tejfizike del plot ngazëllim nga toka,

Sekretet hyjnore me trajtë madhështore nga qiejt zbret.

Gjithë harmonia e krijimit duke e kujtuar Krijuesin paprá,

Drejtëpërdrejt merr frymëzim nga ajo e qartë dritë e dritave:

Nga muzgu i agimit dhe errësira e natës i Dashuri shfaqet!

Kur në muzgun e agimit qenia fle një gjumë të ëmbël,

Kjo thirrje shpirtërore i dallgëzon horizontet përnjëherë,

Në zemrën e heshtur të mjedisit fillon një rënkim i hidhur.

Sheh: gjithkahja errësirë; por një errësirë tërë dritë!

Qielli është zgjuar; çdo yll, një dritare hapur kah Bukuria hyjnore.

Kur të pashpresët e dënuar me telashet e mbijetesës

Që e rrënon shpirtin, dëgjojnë ditën këtë kujtim mëshirëplot,

E dëgjon dhe ekzaltohet sikur ta shohë të Madhin n’ahiret! Dhe me këtë entuziazëm jo që s’lodhen, por tërheqin

Çdo lloj ngarkese pa u prapsur, shenjë lodhjeje pa treguar!

Dielli po perëndon, faqja e qiellit esmer, horizonti bojëtrëndafili;

* Allahu është më i madhi.



Koha e plogësht, toka pluhurishte, bota e heshtur, shpirti i mërzhitur;

Vende-vende pamje të çuditshme, heshtja herëpashërë mbizotëruese...

Por ja tek ritmi hyjnor e mbush gjithësinë anembanë
Dhe, me Allahun mbushet një heshtje terri!

Dhe ja ku mbi tokë pushtimi i natës zbret
Dhe nga terri shtron mbi botë një hije hiçi;
Ndërsa vrojtimi hidhet i rrëqethur e i përthelluar kah ecën mbi tokë e qiell,
Sapo apoteoza "Allahu Ekber" ngjitet lart,
Si manifestim në Sina kthehet Zoti në krahërorin e errët të krijesës!

Duke kujtuar të Lartin çdo çast mbushet universi,
O Zot, ç'mbretërim madhështor, ç'sundim absolut i qetë!
Ezanet, madhërimet, dhikret janë respekt për atë sundim..
Jo, ti je shpirti i mëshirës, zërat nga Ti lusin përdëllim;
A do të kishte mundësi ankese po të mos tregoje mëshirë?

* * *

Shpirti i natyrës brenda zemrës së errësirës fle...
Yjet, madje, në një lartësitë e amshueshme
Duan të mbyllin sytë e të flenë dalëngadalë;
Agimi nën qiej s'i ka hapur sytë.
I gjithë rënkimi jetësor në shtratin e natës ka pushuar,
Çdo periudhë para meje nën mbulesën e heshtjes.
Me ta parë mjedisin të kredhur në një ekstazë të qetë,
Edhe unë u kredha ta sodis atë gjendje në butësi.
Ndërsa kjo pamje dremitëse,
Një thirrje kumbuese u lartësua horizonteve
Dhe u përhap në çast në çdo skaj të faqet së dheut
Dhe u fut mes të fshehtave të natës enigmëplote.
Botën e fjetur zgjoi duke ia prishur qetësinë,

Ç'botë nën errësirë i nxori në shesh!
 Gjithësia e ktheu jehonën e zërit të lartësuar,
 Nga gjoksi i natës një klithmë e gjatë u dëgjua!
 Ajo klithmë u ngjit në qiej si rënkimi i ummetit
 Dhe zbriti nga qiejt ai âh, u bë frymë e Mëshirës!
 Ndërsa qëparë, nga larg, më dukeshin si hije,
 Si nej i vogël i semahanes së natës
 Çdo minare ngjethëse në imagjinatën time...
 Nga ato zemra të gurta dilnin thirrje kaq prekëse, për çudi!
 Pastaj të nejët u bënë një,
 U zgjua në shpirt të heshtjes një gjëmim i madh.
 Kur në botën e pajetë ushtoi "S'ka zot veç Allahut..."*,
 Minaret m'u bënë si briri i Israfilit.**

Ndërsa dora e natës kish hedhur mbulesën e vdekjes
 Mbi mjedisin tim, dritat e jetës u ndezën në shtëpitë përballë.
 U zgjuan, pastaj, botët, shpirti mëngjesor u zgjua,
 U zgjuan një nga një trupat nga gjumi i asgjësë.
 U zgjua edhe tek unë një kandil nate zemërndriçues,
 Që, me dritë hyjnore, do të ma ndriçojë zemrën gjer në amshim.
 Gjersa drita hyjnore të mos jetë shuar,
 S'përfytyroj më për atë pishtar perëndim!

* Në origjinalin arabisht: *La ilahe il'Allah*.

** Briri i Israfilit: sipas besimit islam, engjëlli Israfil do t'i bjerë bririt për shpërthimin e kiametit dhe, pastaj, për ringjalljen e njerëzve.



ATDHEU I TË DASHURIT

Ajme, atdheu i të Dashurit i shkretë...
Çdo skaj, një varr i zyrtë!
Këngët brenda tij kanë fluturuar,
Ka mbetur një çerdhe e pazë, e harruar.
Shpresat e varrosura aty-këtu,
Sikur presin të ringjallen në ahiret!
O Zot, pse ai vend i pastër
Është bërë grumbull dhe dhe rri shtrirë?
O Zot, pse ajo dritë është shuar?
O Zot, pse kjo hije e zgjatur?
O Zot, ç'do të thotë kjo vetmi e ndarjes
Mbi odën e të Dashurit e shtruar?

Por iluzioni i kujt është ky që duket?
Krejt si i Dashuri në trup e pamje...
Balli i shkëlqyer nën flokët e zinj
Të pakrehur e të shpërndarë,
Mëngjes i përgjumshëm në errësirë;
Ose në beben e syrit bukuri shikimi;
Ose margaritarë që vrapojnë
Mes reve pranverore e rrjedhin si shi;
Ose kujtim që gjallërohet çdo kohë në zemër,
Ose në trupin e kufizuar shpirt i lirë.

O iluzion i të Dashurit tim
Që ma gënjen shikimin,
A s'mund të qëndrosh për një çast?
Ajme, u bërë mirazh ëndjeje...
Me të shkëlqyer para meje, u shojte përnjëherë!
Kë të pyes se ku e kam të Dashurin?
Kudo heshtje si në varrezë.
I Dashur! I Dashur!... thashë, prita,

Një jehonë prita e u dogja!
 O Zot, përse edhe shurdh, edhe pa gojë,
 Malet, përrenjtë, gjithë kjo botë?
 O atdheu i dashur të Dashurit tim,
 Gjendja jote tani shumë më preku!
 Hape krahërorin: edhe për një çikë aromë
 Të kujtimit Tënd sot jam i kënaqur!
 Një kohë ai zotërues i aromës së kujtimit
 Priste pranë meje gjer në të zbardhur,
 - Shpresës m'i jepte verë pavdekësie,-
 Shpirtin ma dehte me ngazëllim kënaqësie.
 Ajme, ajo erë e ëmbël dhe e kulluar tani

Tërë naze në qiell iku e shkoi.
 O vatër e shkatërruar, thuaj,
 A nuk zbret më i Dashuri tek ti?
 O zi e paprerë, më thuaj,
 Rënkimet atje a s'kanë të pushuar?
 O moj re që shëtit nëpër qiell e sheh,
 Ecjen e saj nazemadhe a e ke kujtuar?
 O fidanë që thoni vjersha rënkuar
 Ndaj erës që ju rreh për t'ju penguar,
 I Dashuri im një vjershë që sillet tejendanë
 A s'kalon nga këto hije duke u lëkundur?
 Dilmë para sysh, o i Dashur i hirshëm!
 Dhe, si jeta ime, ik përnjëherë!
 Ose duku në zemër të qiejve,
 Horizontin tim me dritë ma ndriço!
 Me mijra rënkime në shpirt trazuar,
 Me tmerr erdha në këtë vend të vetmuar.
 A s'ka një vesh që të ma dëgjojë klithmën?
 O Zot, ky ç'vend i shurdhuar:
 Dhe s'ka një zë që do të më thotë bile "jo"!..



ELEGJI

*Kushtuar të dashurit të zemrës, Hilmi,
që s'i kish mbushur ende të njëzetat
kur i la lamtumirën kësaj bote errësire
për t'u ngjitur në botën e dritës!*

Më në fund, ajo dritë e shquar u fsheh nga shikimet
Duke lënë pas në horizonte një iluzion të varrosur!
Natyrisht, pas përsosjes, vjen shkatërrimi,
Yjet që lartësohen qiejve, gjithashtu, bien e shuhen.
Mirëpo ky yll shprese qe si vetëtimë që të merr sytë,
Prandaj, pasi u shua, i ngjeu horizontet n'errësirë.
S'e i ra nën këmbë kësaj bote, në botën hyjnore u kthye,
Shkalla më e ulët e ngritjes, ishte xhenneti më i lartë për të.
Hija e tij në kujtesën time plot pikëllim, shpirti, qiejve shëtit,
Trupi, i shtrirë në shtratin e varrit, i perënduar...
Sikur u copëtua ajo dritë një copet,
Një shikim i rrezeve të veta u bë, që tregon mrekulli!
Po qe se varri të është qiell i madhështisë tënde,
A shumë është të shihen arsh* e tokë si një e vetme?
Epitafi, në gurin e varrit libër pëshpirtësie;
Kandili, dritë hyjnore e varur mbi varrin tënd, gjithsesi;
Shtylla e varrit, pohimi yt "nuk ka zot tjetër veç Allahut"
Mëshira dhe falja hyjnore, harqe të tyrbes tënde
Dora nazemadhe e flladit ta fshin dheun e varrit,
Reja perladerdhëse, sakije mbi hapësirën e varrit tënd.
Yjet, shërbenjësit e pagjumë të tyrbes tënde,
Varrit behari t'i ka shtruar një mbulesë blerimi të njomë.
Për gonxhe-faqen që t'u tha pa çelur mirë, bilbili
Këngës ia tha me të zbardhur agimi, në makam Jasini!
Rënkimi që dëgjohet në këtë selvishte, s'është era,
Është zhurma e kraheve të engjëjve që fluturojnë sipër.

* Froni hyjnor.

Netët janë intimitet i pafajësisë së atij iluzioni të hollë,
 Agimi, kujtim i perëndimit të atij dielli të shkëlqyer; sa zi!
 E gjithë hapësira, në vështrimin tim, vendshëtitjeje për atë Shpirt;
 Sado që ai u lartësua dhe zuri vend në johapësi!

O dritë që u ktheve në origjinë,
 Më del mua para sysh në çdo anë;
 Edhe sikur të jesh mbuluar nën hije,
 Nga ajo rreze s'mbetem asnjë çast larg:
 Shkëndija jote është në shpirtin tim për jetë.

Bukuria yte dallgëzohet në zbardhëllim,
 Nga shndërritja e ballit tënd hëna jep ndriçim;
 Nata, perde në fytyrën e sarajit tënd intim.
 Petalet e palosura të trëndafilit të njomë
 Aromën e thithin nga faqet e librit tënd.

Thirrja yte i vë erërat në lëvizje,
 Prej teje kjo ngazëllenjëse melodi!
 Me iluzionin tënd zgjohem agimeve...
 O ti, që kur të kujtoj më bëhet shpirti plot,
 Për mua, gjithësia je veç ti!

O rreze e tufës dritësore hyjnore,
 O ti që rri në mëngjesin e amshuar!
 Kurrë mos t'u shuajtë shkëlqimi,
 Nuri yt mos pastë të shuar...
 Dëshira ime: gjithnjë të mbetesh siç je!

Kush digjet, s'shuhet, s'ka mundësi,
 Fjala "shuhet" s'ka shpjegim...
 Jo, s'them se zjarri s'ka të shuar,
 Por bukuria jote s'është e tillë gjë.
 Për atë kurrë s'ka asgjësim!



O i dashur që më ke lënë kujtimin,
Tani ne na ndan një botë!
Ti, në qiell, i lumtur shikon bukurinë hyjnore,
Unë, në tokë, i vuajtur prore!
Çdo zë në veshin tim, më bëhet vajtim!

Në vesh, kënga e nejit, vajtim,
Në vesh, shushurima e ujit, vajtim,
Në vesh, zhurma e erës, vajtim;
Kur ti u jep buzëqeshje qiejve,
Në vesh kujtimi yt më vjen si vajtim!

DIRVASI

Thonë se në kohë të Hishamit emevit,*
 Në një vend pranë Damaskut
 Tre vjet s'qenka bërë bukë nga thatësira.
 Fshatarët, më në fund, po vdisnin nga uria.
 Çdo çadër qe bërë varr e qe mbyllur,
 Brenda, pesë-dhjetë kufoma shtrirë.
 Parësia e fiseve që kishin parë
 Se ky mjerim s'kish për të marrë fund,
 Qenë mbledhur në një fshat e qenë këshilluar:
 Po të rrimë, të gjithë kemi për t'u shuar.
 Meqë jemi parësi e këtij populli,
 Ngrehuni të shkojmë te sundimtari ynë Hisham.
 Po ta dëgjojë kalifi në ç'hall kemi rënë,
 Ka mundësi të na tregojë mëshirë.
 Po qe se një delegacion të parësh mjekërbardhë
 Ia përshkruan Emirit gjendjen,
 A s'e kupton ai se populli meriton mëshirë?
 Dhe në qoftë sulltan, s'është gur, është njeri!

Të gjithë njerëzit e pranojnë propozimin
 Por thonë: "Eshtë mirë edhe Dirvasi të marrë pjesë;
 Vërtet me moshë është ende i ri,
 Por te askush s'gjendet aftësi fjale sa te ai!"
 Kur parësia u fut në Damask, në qytet,
 Hishamit i shkon lajmi shpejt e shpejt:
 "Kanë ardhur nga pesë a dhjetë fise të parë!"
 Thotë emiri: "Le të vijnë tani menjëherë!"
 Edhe djali i ri hyn në pritje dhe flet;
 Në fillim bën një duâ, pastaj,
 Ia nis fjalës pa drojë e pa u ndalë...

* Dinastia që drejtoi halifatin islam mes viteve 661-750. Hisham bin Abdulmelik është halifi i dhjetë i kësaj dinastie, i hipur në fron më 724 dhe i vdekur më 743.



Hishamit i vjen kjo punë si çudi
E i thotë të riut me qortim: “Hesht, or djalë,
Kur ka të mëdhenj, si flet një i ri?
Dirvasi, atëherë, prapë zë të flasë bindshëm:
“Ç’është ky qortim? Mosha mos është
Masë për zgjuarsinë?
Dirvasin ti mos e pandeh fëmijë?
Dëgjoje një herë, pastaj jep gjykim;
A s’ka tek ju maturi e durim?
Lërmëni të flas, zotni, pa është e lehtë
Të më heshtni; e keni në dorë vetë!”

Dirvasi sheh: Sundimtari s’flet;
As zë, as frymëmarrje s’ndihet në kuvend;
Atëherë, me ligjërimin e bukur q’e kish zakon,
Me forcën e parë sërish ia fillon:

“Tre vjet thatësira pa ndërprerë,
Një i nxehtë që kurrë s’është parë
Na e thau mallin, iku, shkoi,
Të lashtat s’u bënë, buka na mbaroi.
Mijra çadra u mbyllën e u shuan,
Shkretëtira u kthye në hapësirë vdekjeje!
Fiset që ushqejnë qytetet,
Fshat më fshat shëtisin të përçmuar e lypsarë!
Beduinët që Hatemëve* ua kalojnë në bujari,
Sot japin dhe jetën për një copë bukë!
Ai që ka veshur gjer sot të tjerët,
Tani është i zhveshur dhe vetë,
Burra e gra pa një këmishë në trup!
Me urinë u shfaq vdekja vetë,
Shkretëtira e mbushur me kufoma plot.
Një mijë klithma në çdo skaj...

* Hatem et-Tai, simbol i bujarisë ndër arabët paraislamike.

Prej askund s'ka një zë për ndihmë.
 Fëmijët e vegjël u shndërruan në pleq,
 Kurse pleqtë, në varrezë që ec.
 Nën at qumësht s'kanë në gji,
 T'u japin fëmijëve, t'i vënë në gjumë.
 Më duket se Zoti na është hidhëruar
 Që beduinët u dogjën, por ende
 Nga qielli një pikë ujë s'po bje.
 Edhe vesë s'po bie me lutje.
 Froni i mëshirës mijra lutjeve
 Nuk u dha asnjë përgjigje.
 Tani po të biem ty ndër këmbë,
 Erdhëm të të lusim, nëse s'na kthen!

Po shohim, o Emir i drejtë,
 Dhe kjo s'mund të kundërshtohet,
 Ndërsa shkëlqimi te ti s'ka të matur,
 Te ne mjerimi nuk numërohet.
 Ndërsa në një anë ka me shumicë,
 Në anën tjetër s'ka as pakicë.
 Atëherë, është nevoja për drejtpeshim.
 Më dëgjo njëherë, pastaj më jep të drejtë.
 Ku e gjete ti këtë pasuri të majme?
 Nga populli, nga vetja, apo nga Zoti?
 Po qe se e Zotit është kjo pasuri
 Dhe ne jemi robtë e Tij,
 Kemi të drejtë të kërkojmë pjesë...
 Mohimi i kësaj të drejte nuk është maturi.
 Por po qe se kjo pasuri e pafund
 Është e popullit, jepe,
 Mos e shkel drejtësinë me këmbë!
 Po qe se pasuria është e jotja,
 Dhe që duket se të tepërt e ke,
 Jepua të varfërve si sadaka...
 Thuaj nëse ka të katërt mundësi!"



Kjo fjalë e kish lënë Hishamin të hutuar
Dhe u kish thënë njerëzve: “Ja, ç’fjalë e zgjuar!
Unë s’kam fuqi ta kundërshtoj këtë fjalë...
Çudi me këtë mençuri gjenu te ky djalë!
Tani s’duhet zgjatur më kjo punë:
Merrni ç’t’ju duhet, ç’kërkoni nga unë!”

KAFENEJA E MËHALLËS

Vëllait Hysejin Avni*

“Kafeneja e mëhallës!” E dinë osmanlinjtë ç’do të thotë?
 Mos mendo se do të të thonë: “Ç’është? S’e kemi parë!”
 Këta kriminelë tinzarë me trajtë lypësi,
 Këta hajdutë që s’hapin rrugë as ditën,
 Në çdo hap të dalin para, ia presin udhën punëtorit...
 Ia vrasin gjithë ditën rrugëtarit të mjerë!
 Po, kush e sheh nga veshja, e pandeh lypsar;
 Por, sapo t’i afrohet pak për mëshirë
 Kur sheh varfërinë me dorën e zgjatur për një dhjetshe,
 I pandehuri lypsar e godet gjahun mu në sinqeritet!
 Pse nuk duhet mbyllur kafeneja e mëhallës ende?
 Duhet mbyllur, më në fund, kjo e përgjakur perde!
 Jo, kjo perde, kjo plagë e pamjekuar e Lindjes,
 Me fëlliqësinë në pamje, faqe e zezë e vendit tonë,
 Në jetën tonë është një plagë me emrin “privilegj”,**
 Rri hapur me vigjilencës e një kombi të madh!
 Tragjedinë e saj me sifilizin kurrsesi mos e përngjasoni:
 Kjo varrë po ia thith popullit shpirtin e përpjekjes.
 Kafeneja e mëhallës është vrasës i Lindjes nga prehëri i vet,
 Është krejt si ato baltovinat e vjetra.
 Populli i ndjerë i mjerë groposet pa vdekur,
 I shuhet në këtë gropë vetëdija, pastaj vdes dhe vetë...
 Peizazhe të tilla të mbushura në mjedise të fëlliqura:
 Me të hyrë, drita e shikimit bëhet sterrë e zezë dhe del!
 Në truallin e fëlliqur të saj shtrihen trupa një mbi një,
 Në ajrin e rëndë të saj notojnë shpirtrat më të ndyrë.

* Hysejin Avni Ullash (1887-1948), një nga miqtë më të afërt të M.Akif Ersojit. Bashkë patën marrë pjesë në Luftën për Shpëtimin Kombëtar. Hysejin Avni pati marrë pjesë si deputet i opozitës në Mexhlinin e parë turk. Është ndër themeluesit e Partisë së Rindërtimit Kombëtar (M.K.P.), një nga partitë opozitare të periudhës së pluralizmit politik pas vitit 1946.

** Në origjinal përdoret fjala gedik që do të thotë edhe “e çarë”, edhe “plagë”, edhe “privilegj”. Poeti bën një lidhje kauzale mes këtyre kuptimeve të kësaj fjale.



Tavani me të çarat që duken si gojë mallkimtare,
Vjell në të ç'të ketë nga kujtimi i vet!
Kujdes, ky kujtim s'është kuptimor,
Tërë turpet e historisë sonë i ka mbi krahë.
Pse vetëm hedhim poshtë të parët tanë për t'u krenuar
Dhe kapemi pas të këqiave të së kaluarës?
Mos vallë jeta e të parëve tanë kaloi në letargji?
Jo, në damarët e atij brezi fisnik, e atyre bijve të shquar,
Në vend të gjakut rridhte burrëri e trimëri,
Në zemra, në vend të jetës, dëshirë për të vdekur.
Sa keq, çdo gjë që trashëgim na pati mbetur prej tyre,
E shembëm një nga një dhe ngritëm kafene.
Shihni se si trualli i begatë i Lindjes që pati prodhuar
Vetëm monumente artistike, u kthye në djerrinë.
As spital s'ka mbetur nga të parët e shkretë,
As një ndërtim s'është bërë në dorë të pasardhësve.
Nga kanalet shenjë s'ka, urat janë kthyer në gërmadhë,
Sebilet,* pa njeri, çezmat janë zhdukur!
Ky brez frikacak i lindur nga ata etër heronj,
As përpjekje për jetë njih, as të prodhojë me dorë të vet di!
Po të shohë në ëndërr punë, e zë tmerri!
Fundja, pse duhet lodhur në këtë "botë të vdekshme"?
Trupi është amanet i Zotit; e drejtë; dhe për xhennet.
Ashtu si këto kafe, edhe xhenneti për muslimanët, privilegj!
Është një gjë që i thonë "jetë familjare".
Po qe se na thuhet, "ajo është lumturi", kush kupton nga ne?
Në botë, jeta familjare, jeta më me kënaqësi;
Mirë, po, a e njohim ne atë botë? Ajme!
Ç'bëhet sikur në mëngjes të dalësh për të punuar,
Në mbrëmje të ulësh me nder të plotë për të pushuar;
Përreth të kesh gruan, fëmijët, nënën, babanë
Të të sillen si aureolë pranë

* Fontanat publike osmane.

Dhe pallat xhenneti ta shohësh shtëpinë?
 A pak është kjo kënaqësi për zemrën që ka ndjenjë?
 Gruaja, shok fryme, fëmijët, shpirti yt;
 Nëna e babai, prehër i pafajshëm ku ti gjen strehim.
 Mos u mërzite? Por po qe se mësohesh një herë,
 Ky rreth i ngushtë të duket se kozmosi më i gjerë.
 S'e di se ç'ka në këtë kafe që s'të nxë shtëpia?
 Ejani ta shohim... Urdhëroni, ja një kafe!

* * *

Një portë e përbaltur, mbi të një vrimë e rrumbullakët;
 Para saj, dërrasë a truall, s'e di, një prag i fëlliqur.
 Për këtë vend që shoh, ç'të them, është me vend;
 Ndryshimi me ahurin, këtu jo, kurse atje ka grazhd.
 Trualli, dysheme malteze na qenkësh e njëqind vjet më parë.
 "Na qenkësh" them se, për ta kuptuar, punë e gjatë;
 Nën atë njëmijë pëllëmbë pisllek, ç'minerale do të ketë?
 Tavani, ngjyrë kafeje të çelë; muret
 Kanë marrë shkëlqim mogani nga duhani dhe nargjilet
 Sepse nga çdo pipëz tymi del si oxhak.
 Në mes rri ngulur një mangall shalëlejlek
 Në fyt e sipër ngjyrë alle pak të thellë,
 Por me trupin të zi sterrë. Kush e sheh pa e ditur ç'është,
 Thotë: "Statujë çafke e bërë me lesh të zi!"
 Në anë, ngjitur murit, pranë kryes së një shtrati dërrase,
 Zvarritet një gjë e pistë mbledhur rrotull: dyshek, me siguri.
 Hequr sipër një mbulesë si pelerinë shiu,
 E shkreta me shpinën copë-copë e bërë nga mola.
 Mbi këtë mbulesë po thahet një shami dore e lyrtë.
 Zembili prej kashte që thotë "po të rashë mbi krye!",
 Sapo vjen në nivel të saj, një të kthyer kështu
 Me mestet çift me veshët lidhur fjongo me lidhëza spangoje.
 Në mur një e thelluar e gjerë sa oxhakët e vjetër,



Dollap me xham, në raftet e të cilit çfarë s'ka!
Në katin e parë, një kavanoz ku ushqehen shushunja,
Pranë tij, pesë a dhjetë brirë për të marrë gjak;
Në katin e dytë, plot pinca, darë dhëmbësh, brisqe rroje.
Domethënë, kafexhiu edhe dentist, edhe berber!
Po s'besove, s'është koha për t'u vënë në dyshim;
Ç'është nevoja për llafollogji të gjatë? Ja mostra e tij:
Po qe se ty, këta dhëmbë të shkukur si me kazmë,
Të radhitur në pe, më në fund, radhë-radhë, dhjetë-dhjetë
Të përvjelë prej mishrave me të cilat bashkë janë nxjerrë,
Nëse të kujtojnë banderolat me drita të varura për festë,
S'është ashtu; çdo dhëmb-kandil është shenjë e një varri
Në katin e tretë rrinë vetëm bohçat me peshqirë.
Në të djathtë të dollapit të xhamtë, pazar imtësirash
Qeli-qeli. Në mure, piktura turli-turli... qe mali Çamllëbeli
I iku Ajvazi, po qan Qorogllu* rahmetli
Shah Ismaili ia mëshon me topuz në kokë Arapit Yzengi
Sytë i ka te vajza e lidhur për druri, ai
Djegësirë shpirti ofkëllima e Keremit, këtij çuni
Po 'ah'-ut të dashurisë kush i rri karshi?
Kur vjen shtriga Ezrakabanu, ç'thua ti?
Dalta gurëgdhendëse i bie prej dore Ferhadit, i mjeri
E sheh kështu Rifaiun: në dorë kamxhik i bëhet gjarpri
Hipur mbi një luan të bardhë, rri pa folur gjyshi, thua ti?
U drejtua kah Haxhi Bektashi: Ec, nisu i tha murit, vetë ai.
Në fund të pikturave u vjen radha vargjeve, pa dyshim;
Lexoji një nga një, po munde, pastaj jepu kuptim!..

Jo, përmbledhja mjafton, e tëra një jetë e përpin
Kujto një çikë fjalët boshe të vjellura, pa mendim
Duhet më tepër kohë që të bëhen marrëzi!
Para se të ulet në tryezën e shkurtër që ka zënë
Lyrë nga brenda, njeriu pandeh se letrat e shumta

* Qorrogllu: hero legjendar popullor turk, luftëtar i lirisë kundër despotizmit.

- Të shpërndara mbi të, janë copra meshini të vajosur
 Në duar të lojtarëve. Po ndyrësia e tavllës?
 Eshtë e pamundur, s'mund ta pëshkruaj!
 Damat janë hapur në mes duke formuar hartë;
 Gurët të bardhë a të zinj? Mos pyet kot!
 Vija, kufiri i papërcaktuar i atdheut;
 Duhet të stërvitet mirë në të parë që të mund ta dallojë!
 Edhe pse pislëku në vrimat është gjer në fyt,
 Dominoja mbetet mjaft e pastër kur i vë re këto.
 Harruam çekmexhenë me vrima!
 Eshtë ndër pasuritë e patundshme të lokalit.
 Pranë tij, një maçok veshprerë... Aman, mos e harro!
 - lu var beu rastit!
 - Duket sheshit; shih, kokëtrashi u zgërdhi!
 - Kofshën në dorë e ke?
 - Djerrin; kurse ti, Hamdi, merr malësorin.
 - Birbo! Malësori qenka në kapak... Ah, qen bir qeni!
 - Qen bir qeni je vetë, gomar veshgjatë!
 - Tetë, a dhjetë, ç'të kesh tërhequr, jepe dhe kape letrën karo.
 - Halim, pse përpiqesh, kjo s'del, pra: kaput!
 - Xhihar-jek është ai gur?
 - Hiç mos u mërzi, vdiq, dy-shesh!
 - Thotë se s'ka në dorë? Tërhiq, babam!
 - Aman, shesh-besh!
 - More, po menjëherë e gjeti! Le të vijë, mos rri të bësh llogari!
 - A s'e fitoi një lojë mbrëmë? Mos m'u bër nuse prej lecke!
 - Me dy-besh po e lidh.
 - Me të vjedhur s'ka!
 - Ç'është ajo që ke në dorë?
 - Se-jek.
 - Aman, mos luani në qoftë kështu: penxh-jek, domino!



- Po u tha “prishës loje”, ti je, më thotë, shihni, agallarë:

Thoni, për hir të Zotit, a i thyer është ky zar?

- I thyer!

- S’është!

- Zoti e di, i thyer!

- Jo, për atë Zot!

- Si s’luajnë dot pa bërë bé! Ah, kalamanj, ah!

- A s’bën dot pa u përzjerë në lojë? Ama dhe ti, i marrë!

- Po të erdha, ta tregoj tani...

- O, pa shihe këtë shushunjë!

Do të vika e të na e tregoka... Te varrëmihësi Mahmud shko!

Me një të fryrë bie... Pupël fare!

- Kopilat, bij bastardë të kësaj kohe! Shihi, të gjithë pa besmele...

As respekt, as turp. Mjerë unë po qe se fati ynë

Ka mbetur në dorë të këtyre sharlatanëve!

- O ti, mjaft dërdëllite, do të biesh në belá!

- Të shkoj te varrëmihësi Mahmud, ë? Shih, qen bir qeni!

Gojëndyrë, i poshtër, i paedukatë. A thuhet kjo gjë, Beqir?

- A i dhe mësim sipas teje? Aferin, Hasan Aga!

- Po të më lënë, me kohë do t’i kisha dhënë një dru!..

- Të shkoj te varrëmihësi Mahmud, ë? Hë më të s’ëmës!

Në moshë të këtij ne, më parë mësonim si të silleshim,

Pastaj hynim te të mëdhenjtë dhe prisnim në këmbë;

Po të mos na thonin “ulu”, me duar lidhur vetëm dëgjonim;

Ku kishim ne të drejtë të thoshim “jo, kjo s’është kështu”!

Dhe, sikur të thoshim, na bërtisnin: “Mbylle, o spurdhjak!

- Duhet të isha në të tridhjetat kur ende s’mund të dilja

Aq lehtë pa nënën jashtë se më rrihte!

Sot, ende te gjashtëmbëdhjetat pa arritur vocërrakë

Nuk hanë dru; dije mirë! Dhe sikur të ngordhin, kundërshtojnë.

Ca ditë më parë desha ta provoj ta rrah Qerimin...

A nuk m’u hakërrye? “Mos, unë s’jam gomar!”

Njeriu s’u rrihka, druri na qenka për gomerë!..

- Po ne, mos kemi qenë gomerë, Beqir, ç’është kjo punë?

Për ditë na rrihnin dhe nuk kundërshtonim...
 Unë kështu u edukova... A e lehtë është të bëhesh njeri?
 - A lejon i biri i botës ta prekin? S'ka mundësi!
 Ata muslimanë ti mos i kërko më tani!

Po deshët lojë pa zhurmë, ejani në damë:
 I mjeri, ka rënë në gjendje pa rrugëdalje... Bëni llogari!
 Njëri nga lojtarët, i menduar; guri i ka mbetur në dorë,
 Kurse kundërshtari përdredh mustaqet pandërprerë.
 Shikuesit, të menduar; një shtresë e zgjedhur,
 Kurse mënyra e të menduarit, krejt e ndryshme:
 Ndërsa te njëri dora nuk përzihet kurrë në asgjë,
 Te tjetri, punët pa prerë tregohen me rrezik!
 Ja: "Rruga për te trutë kalon nga hundët, pra hyr!"
 Me kërkimin e thellësisë i zënë paprerë!
 Inxhinier duhet të jetë ky burrë mjekërbardhë:
 Në truall lëshon në formë rrethi një gëlbasë
 Dhe, duke hequr tangente me anë të një shkopi shtrembaluq
 Ku po mbështetej, i dha, ndoshta, njëqind trajta!

Nëpër kanape dërrase të lustruar me djersë këmbësh,
 Fytyra me qylafe, me feste, të radhitur radhë-radhë:
 Te asnjëri s'sheh hije ideje, mendim zgjuarsie,
 S'është dëgjuar të ketë në këta tru aftësi q'i thonë ndjenjë!
 - Aman, ç'përpiqet dhe ky komshiu ynë!
 - Ç'kujtove, zotëri? Ai ka dhe një emër: Haxhi!
 - Jo e dhashë, jo po s'e dhashë djalin në shkollë,
 Shëtiti sokak më sokak...
 - A s'e fut në medrese?
 - Punë që s'bëhet! Kush këndon më tani arabisht?
 - Po, ramë në kaurçe e sikur bëmë ndonjë punë me mend!
 - Kur pata shkuar te Biná-ja* për tre vjet, ç'kohë që qe!
 As dituri s'mbeti...

* Biná: emërtim i shkurtuar i përmbledhjes didaktike të zgjedhimit të foljeve dhe strukturës së fjalëformimit në arabisht.



- Fundja, ç'mbeti? Asgjë!

- Për shkollë mëhalla në rrugë të vjetër kemi nevojë ne;
Ndryshe, syls, nesih,* marrin fund të gjitha... Me shëndet!

- Isha trembëdhjetë vjeç kur mora ketebe.**

A s'më thotë një snob, "ku di ti nga dje?"

I thashë: "Birbo, eja e të të bëj provim,
Ulu e thuaj një herë të shohim, një temmim.***

- E, si, a e bëri?

- E mundur? Rabbi jessir-in unë

Në pesë muaj plot e mësova tamam kallfa ynë sa qe gjallë.

- Ç'farë ke në dorë, o ti?

- Gazetë.

- Hidhe atë gjë të pistë!

- Pse?

- Gënjeshtër shkruajnë, o bir, të gjitha ato!

- Po shkruajtë drejt, e varin... Ç'u bë Vullkanxhi,****

E harruat?

- Lëre, mos lodh fytin kot, Haxhi!

Ky me fes që na vështron përballë, më duket, gojëzi...*****

- Jo, nuk them, s'është ai...

- Mos rri ti, kërkoje vetë belanë!

- Mor po bën humor, a s'e njeh Omerin ti?

- Jam pak pa qejf, Ahmet, ndizmani fenerin tim!

U dëgjua një zë i fortë, pastaj, estagfirullah...*****

Kishte qenë gogësimë.

- Shumë shëronjës ky trangulli:

Sapo të hash tarator, se pse, gogësima gati...

* Syls, nesih: lloje të bukurshkrimit arabisht.

** Ketebe: çertifikatë shkollore e aftësimi në bukurshkrimin e arabishtes.

*** Temmim dhe, më poshtë, Rabbi jessir: fjalë të porosisë profetike me qëllim lutjeje, *Rabbi jessir ve lá-tuassir, Rabbi tem-mim bilhajt!*, "O Zot, (na e) lehtëso (punën) dhe mos (na e) vështirëso; o Zot, me dobi (na e) plotëso!"

**** Dervish Vahdeti, pronari i gazetës Vullkan të dalë mes datave 11 dhjetor 1908 - 20 prill 1909, i ekzekutuar për akuza politike më 19 maj 1909.

***** Gojëzi: kështu quheshin atë kohë policët e fshehtë civilë.

***** Kërkoj falje nga Allahu.

- Po, është e ngrënë me shërim...

- Ç'e ngrënë! Pa krahasim!

- Mos hyr në gjynah. Në tefsire* ashtu kanë shkruar...

Daja më pati thënë: Kam parë, trangulli është dhe në hadith.**

- Hasan, ç'u bë dhëndëri ynë i ri, s'e kuptuam,
S'duket!

- S'e lëshon gruaja: burrë që tërhiqet hunde!

- Habitu dhe me mendjen e mashkullit

Që veç bën ham-ham nëpër shtëpi...

Kafsha që i thonë grua, s'kupton fjalë, përpiqu sa të duash ti.

- Kush përpiqet, babush; e kam të njohur prej shumë vitesh;

Qorrogllunë tonë unë s'e vë në hesap për njeri!

.....
.....

Nga foleja prej balte në kënd të tavanit

Shohin nga këta anash dy shikime çift të mprehtë:

"A s'keni dhe ju një fole?" - duket sikur pyesin sytë

E dallëndysheve mashkull-femër

Që përpiqen së bashku për të vegjëlit e vet!..

* Tefsir: shkenca islame e komentit të Kur'anit, përgjithësisht e teksteve të shenjta.

** Thënie e profetit Muhammed.



IMAMI QOSE

*Vëllait Ali Shefki Efendi Hoxha**

Njoh unë një imam me pak dituri, me karakter të fortë e vizionar
Që ma pati bërë të njohur im atë në të gjallë.

Kështu, duke thënë “në ç’botëra është, kush e di,
Qoseja im me famë, ka tre vjet që s’e kam parë”,
Thash, të vizitoj... Dje mbrëma mezi ia gjeta shtëpinë.

Me ç’gëzim më priti mua! Goxha njeri:

- Eja, or ti, eja, i biri i tim mësuesi, na dhe gjallëri...

Ç’rastësi plot bekim, qëparë të patëm në mendim.

Ato kafe, nargjile, burnot, sherbete,

Biseda shpirtdëfryese gjer në ngopje;

Në atë kuvend nga këto s’mungonte gjë.

Ndërsa thosha “mrekulli!” me vete,

Veç kur troket porta me fuqi!

- Kush është? Shihni!

Fundja, s’është shtëpi, po han; natë e ditë punon...

Po qe mashkull, Asim, çojeni në kafe.

- Nëna e Ahmetit paska ardhur...

- Ç’Ahmet, o bir?

- E Ahmetit që qe sot te ne...

- Hë, Ahmeti i Vogël... E di.

- S’është për ne, atëherë, ç’o fjalë te gratë!

- Hyr, i thashë, s’do; ngul këmbë: “Ma dërgo tët atë!”

- Hyr, pra, zonja motër!

- Mos m’u lutni shumë!

- Ç’ke, ta marr vesh, o grua e mirë?

- As kokë, as sy më mbetën nga dajaku, të gjitha më janë fryrë;

Sikur të kisha kundërshtuar, puna ime

Me siguri do të ish mbaruar!

* Ali Shefki Efendi: hoxhë dhe mësues boshnjak, nxënës i të atit të M. Akif. Ersojit dhe mik i ngushtë i tij. Edhe për figurën e imamit qose të përshkruar në librin *Asim*, poeti frymëzimin e ka marrë më shumë nga Ali Shefki Efendiu.

Qava, u luta, mëshirë kërkova, kush dëgjoi?
 Paska bërë mend të më ndajë qysh dje.
 Nëna me tre fëmijë, me fëmijë në gji,
 Ta fshijë e ta pastrojë vetë e vetme tërë atë shkatërrirë shtëpi
 E ti, mizor, duke mos ia ditur vlerën, të ngresh dorë
 E ta provosh forcën e krahut mbi atë të mjerë!
 - Prit, ime bijë, mos qaj, tani i dërgoj unë fjalë atij
 E i tregoj sa e lehtë qenka të rrahësh grua!
 Thërrisni rojen...

- Ihsan beun, a e di, Memish?

Shko tani e sille...

- S'është në kafe.

- Do të jetë në shtëpi;

Tani të vijë...

- Nuk mund të vij, le të vijë vetë, - më tha.

- Ja!

Po i shkova unë, s'i del mirë. Shko e i thuaj

Tani të vijë!..

- Ç'xhentilesë kjo, zotëri? Një ftesë

S'mjafton? Ashtu, ë?

- Isha i lodhur zotëri...

- Po,

E morëm vesh... Mirë, po, punë e madhe që ke bërë kjo!

Dhjetë gra të rrahë, s'lodhet; e njoh unë se ç'ká

Eshtë Ihsan beu im.

- Hoxhë, shih, zemërohem.

Ti sillu keq... Po ta kem rrahur, grua e kam.

Po të kem qejf, e rrah; "mos e rrih" s'më thua dot ti!

Ky qëndrimi yt quhet prekje e dinjitetit tim...

Ç'dinjitet, o bir? Dhe dinjitet paske, pa le!

Iluzionit të tanishëm të dinjitetit të zotërisë sonë

S'ke ç'i thua... Vetëm se, në kërkofte qetësi,

Nuk duhet të hyjë fare nën kushte të tilla të vështira!



- Ti, imam, po flet përçart... Mjaft më, pusho!
A ky paska qenë qëllimi i këmbënguljes tënde
Për të më thirrur mua?
- Gruaja jote erdhi qëparë
Duke rënkuar e duke qarë...
- I dalçin sytë dosës, lëre, le të plasë po të dojël!
- Në e rreh, pse e ndan? Po e ndave, pse e rreh?
Edhe gjynah, edhe turp...
- Fjalët e saj mos i vër re!
Sikur ta dish se ç'dosë që është!
- Pse? Mos vjedh?
Apo është e pafytyrë?
- Asnjëra nga këto... Por mbrëmë
Ma mërziti shpirtin duke thënë: "S'duroj dot
Të marrësh një të dytë!" Ç'domethënë!
"Burri merr gjer në katër gra" ende pa i thënë,
la nisi grindjes... Dhe mua koka m'u turbullua!
- Për ta bërë ta gëlltitë marrëzinë që volle!
I marrë! Vajzën e huaj jetime e rreh, e ndan...
Ka të drejtë! Nuk mund të ndahet aq lehtë!
- Nuk mund të ndahet? Ama, ç'na the! Pse
Sheriati na lejon të marrim gjer në katër gra!
Po të marr dy, ç'del në mbrojtjen e lirisë?
Nëse e kam ndarë, dua dhe e ndaj, sigurisht.
Qitapi është në shesh: edhe marrim, edhe ndajmë!
- Sapo të biesh ngushtë, shariat! Pusho, birbo, i paedukatë!
Kur ke hyrë në xhami? A ke qoftë edhe një të mirë?
A ke ndryshim me një kokëkuq* ti?
Ndërsa goja i ndyn më keq se një mejhane,
Vjen e më bëhet mua shariatçi!
Torollak! Cilën t'keqe s'e gjen në fletoren e bëmave tua?
A njeh kënd në botë që të ka parë esëll?

* Në origjinal "këzëllbash", emër që u është vënë muslimanëve të sektit alevi.

Sheriati në islam këtë na paska lejuar: edhe për të marrë,
 Edhe për të ndarë! Sa punë e thjeshtë!
 Shih ç'thotë Pejgamberi për ata që ndajnë gratë:
 "Kur ndodh në botë një ndarje, dridhen qiejtë!"
 Ç'paska se marrka dy?.. Marrëzi që hahet është kjo?
 Vërtet, disa herë ndodh martesë gjer më katër gra...
 Por jo për shumicën e meshkujve që, si ti,
 Dhe një grua e kanë shumë! Pa mendo!
 Ku e ke pasurinë? Shëndetin ku e ke? Asgjë s'ke!
 Një qese boshe e një trup të thatë gjithë ç'ke!
 Ti lutu që gruaja s'kërkon të zbatohet sheriati në shtëpi,
 Ndryshe, sot s'do të shëtisje dot pa kapistër qafës kaq lehtë!
 Gruaja s'do të punonte, kopilin s'do të ta shikonte.
 As larje rrobash, as gatim; zjarr s'do të ndizte!
 Sipas shariatit, të gjitha këto janë punë për ty!
 Edhe për t'u dhënë gji fëmijëve duhet të gjeje një nënë tambl!
 Fjalë ndarjeje e martese mbylli tani
 Dhe, ç't'ju ketë dhënë Zoti, hani e pini e kaloni së bashku me
 kënaqësi!
 Hajde, merre e shkoni!..

Bija ime, eja po të them!

A s'ma dëgjon fjalën? Me inat s'është mirë, bijë...
 I thashë, s'ka për ta bërë dhe një herë... U turpërua...
 Janë gjëra që ndodhin...

- Ç'të them, s'ka vlerë!

Kjo gjë më është shkruar një herë në ballë...

- Ashtu!

Mbaje llambën, tregojau udhën Asim! Shkoni me të mirë!

* * *

- Shkuan, më në fund... Lutu që shpëtove lehtë;
 Ka çështje që vazhdojnë më gjatë se një natë dimri e gjatë!
 E dëgjove dhe e pe, o bir, ç'e prishur edukatë!
 Të bëjmë, ç'të bëjmë, t'u mësojmë njerëzve të sillen si njeri.



Shpëtimi i vetëm për popullin tonë është zgjimi;
Cilindo popull të shohësh, i zgjuar... Sepse erdhi agimi !
Se si po lozin me sheriatin e shkretë, pa le!
“A ky është muslimanllëku?”, thotë njeriu e vajton.
Një frikacak që trembet nga hija e vet, madje,
Vahdetiu i singertë, me shkop në dorë i poshtri
Një regjiment eprorësh vrau. Arsye: Sheriati.
Tridhjetë e tre vjet na ka trembur duke bërtitur: “Sheriati, bre!”
E rreh gruan, e ndan. Mbështetja, “sheriati”, “urdhër hyjnor”!
Të jesh i sigurtë, nga injoranca të gjitha këto!
Pyetmë mua për hallin e vendit, të të tregoj.
Sepse imami i njeh shtëpitë... Hë, edhe mjeku.
Disa herë iki që të mos më gjejnë e të më kërkojnë
T’u lidh kurorë... Sapo të bëhet një dasmë, komshitë vijnë
“Sërish erdhe hoxhë!”-thonë.
Por nuk e dinë se do të jem më i kënaqur të mos shkoj.
Para zerdeja si gjellë e përgjakur më rri;
Kur bien muzikat, më duket sikur qan një jetim...
Pse? Sepse fundi i kurorës, ndarje, herët a vonë,
Ose si këta që sapo shkuan, jetë me rrahje e vajtim!
Eh, sikur ana tjetër e dasmës të qe dasmë;
Kurse akti i fundit është ndarje në gjykatë.
Ç’gra, ç’femra që lindin mjerim shohim ne;
Ja mijra fëmijë me të atin gjallë, por bonjakë!
Zemra më copëtohet për tre shtresa të njerëzve!
Për pleqtë, gratë, fëmijët duhet treguar mëshirë,
Ndryshe, si e kupton njeri se ç’do të thotë njerëzishmëri?

Po e pata zgjatur pak fjalën, më fal, o bir...
Fundja, është vështirë të gjesh njeri për të qarë një hall...
Po, askush s’na e var më neve tani;
Të gjithë thonë për ne “i prapambetur”, “reaksionar”!
Po qe se sheh një të keqe e të thuash “mos!”,
Të zbret mbi ballë vula e sulltan Hamitit me tërë forcën e saj.

A s'e pe? Sapo i fola për lirinë, nisi të më kërcënojë.
E di ti për ata njerëz të pafrë që, dikur,
Shëtisnin nën hijen e Sulltanit, mbi çdo gjë duke vënë dorë
Tani ata janë liruar, janë bërë shumicë.
Kurse ne, kokëtrashë, reaksionarë... Mate pak, kujto hallin!
Nuk ecën kjo injorancë; shihni shekullin: shekulli i shkencës e i
diturisë!
Edukimi duhet të nisë nga familja, o bir!
S'del gjë vetëm me shpalljen e lirisë;
Duhet ta bëni popullin ta pranojë idenë e lirisë!



PJESË POETIKE

PIKTORI KA TË DREJTË ?

Një kohë, moda e historisë së shenjtë na kish dalë...

Një vilë kish ndërtuar pasaniku e kish hapur fjalë:

- Më gjeni një piktor! Od' e madhe pa tjetër do pikturuar

Me piktura të vjetra, do zbukuruar...

Del njëri e thotë hapur:

- E bëj unë!

E përvesh krahët e, pa ardhur mbrëmja, ka mbaruar...

Po ç'të mbaruar: një e kuqe tejpertej odës tetë arsh të gjatë! I zoti pyet:

- Usta, e ç'është kjo punë?

Ç'është kjo bojë e kuqe gjithandej qarkuar?

- Kjo pikturë: Deti i Kuq i çarë para Musait - thotë piktori -

Që Faraoni me ushtri mos e zërë atë...

- Ç'Musa, more, ç'po thua?

- Ka dalë, zotrote, matanë...

- Po Faraoni?

- U mbyt...

- Po kjo bojë ngjyrë gjaku, ç'është? - Tha sërish pronari.

- Deti i Kuq, zotni, jeshil, de, s'mund të jetë!

- Ç'pikturë e bukur paska qenë! - Tha sërish pronari

- Besa, ka të drejtë, oda na u zbukurua!..

ISHTE SHKRUAR MBI NJË GURË VARRI

Etapa e fundit e pushimit q'i thonë "varrezë", është pikëtakimi
I kësaj jete të vdekshme me jetën e amshuar.
Nëse jeta do të merrte fund me vdekjen, asgjë s'do të ish kuptuar;
Sigurisht, ka një jetë të dytë nëse krijimi s'është absurditet!
"E sigurova të ardhmen" thua, o ti, njeri indiferent,
Dhe për këtë, me dëshirën tënde, vuan një mal mundimi!
Po qe se s'e mendon ahiret për hir të tri ditëve jetë,
Kam frikë se ditët e kaluara në këtë botë kot të kanë shkuar.
Fatmirë i vërtetë është ai njeri që, duke u ndarë nga kjo botë,
Që pas vetes si pasuri lë emër e nam të mirë!
Si të gjejnë një rrugë të drejtë njerëzit, o Zot;
Ndërsa e vërteta sheshit rri, errësirat iluzive e mbulojnë atë?



SHKRUAR PAS NJË FOTOGRAFIE

Prej dikujt, kujtimi plot respekt për të mbetet,
E zëvendëson atë përmendja pasi ikën vetë.
Një grumbull të mirash që ka bërë një tjetër,
Mblidhen dhe i bëhen përmendore e fortë.
Kurse tërë kujtimet që ka lënë dikush tjetër,
Bëhen, si kjo, një hije zymtësisht e zbehtë!

KRITIKU PËRBALLË POETIT

Dikush që fliste kodra pas bregu, radhit një gazel:
Kuptimi, rrëmujë; forma, pa vlerë.
Natyrisht, atij vetë i dukej e shkëlqyer;
E recitonte, kërkonte ta dëgjonin, mpakej i mallëngjyer.
Pak më vonë kërkon ta botojë
Por druhet nga ndonjë e metë që mund të shpëtojë.
Dhe kërkon një kritik të madh, të ditur;
Më në fund, gjen një njeri të pjekur për ta pyetur.
Ky njeri s'do t'ia dijë për nderim dhe ndjeshmëri
Dhe gjen shumë të meta në formë e në përmbajtje.
Poeti i rremë zemërohet keq me kritikun tani
Dhe nis ta shajë me fjalë të ndyra ashtu si di!
Kritiku e dëgjon ca, pastaj i thotë esteti:
"Proza juaj tingëllon më bukur se poezia juaj, vërtet!"



EDHE KJO ISHTE SHKRUAR PËR NJË GURË VARRI

O Zot, ç'orator është varri:
Që me forcën e një zbulesë të lartë!
Kuptimin më të thellë
Ua sugjeron njerëzve përmes gjuhës së gjendjes
Po s'u muar dhe prej saj pësim,
S'mund të nxirret tjetërkund mësim!
Iluzioni i mijra trupave plot naze:
Ca selvi shtatgjata e qiparize.
Fundi i mijra kokëve në qiell:
Brenda një çasti të bërë dhé.
Çdo gur varri, zemërimi i thellë
Në përkohësi për mijëra jetë këshillë e mësim.
Ta shohë njeriu këtë përmbysje
Dhe ta kuptojë ç'plotëni ka kjo botë!
O vizitor, para këtyre të vërtetave
Akoma nga iluzionet dorë s'hoqe?

TRËNDAFILI, BILBILI

Katedër e ka bilbili çdo degë të njomë ku rri;
Ligjërata që ti e quan melodi, është *faslu'l-hitab*.^{*}
Për sytë që e dallojnë ç'është ngjyrë e së vërtetës,
Çdo petal i mbështjellë në gonxhe është *ummu'l-kitab*!^{**}

* Pjesë nga Kur'ani, fjalë që e ndan të vërtetën nga e pavërteta

** Kaptina e parë e Kur'anit, el-Fatiha..



PËRKTHIM

Klithmës sime vetëm klithma ime në iu përgjigjtë...
S'ka askush, vendi krejt i zhveshur nga të njohurit dhe miqtë.
Ndërsa unë thërres "Ku është i Dashuri im?" me zë të lartë,
"Ku është i Dashuri im?" jehojnë luginat, shkretëtirat,
majat lart.

PËRKTHIM

Të fshehur në zemrën fshehëse të natës sterrë të zezë,
Si dy njerëz të çlirët, të shpënguar, ishim unë e ti...
Sikur gjuha e mëngjesit të mos na kish nxjerrë në shesh,
Do të mbeteshim të pazbuluar nga shikimet gjer në përjetësi!



DISFATA E QARTË

Ditën e parë që më çoi në shkollë, dëgjova tim atë rahmetli

Të thosh: “Im bir ka për t’u bërë njeri!”

Kurse im më kish ndenjur e ngrinte pashallëqe n’erë...

Lëre njeri, edhe pashá do kisha pranuar të bëhem, por kot! Kur
prindët ushqejnë shpresa të kundërta, gjithherë

Të mbetur në mes, fëmijët dënohen me disfatë e fatkeqësi!

RRUGA PËR AHIRET

Në rrugë përhapet thirrja e vetme “amin!” e shkon:
 Popullsia e mëhallës mbledhur, imami lutjen këndon.
 Një shtëpi e ulët; në anën e brendshme të portës, një tabut
 Dëgjon i çuditur avazin që i kumbon mbi kryet.
 U tha “Fatihah!” I prenë amin-et, këtë radhë
 Gjokset rënkuan; ndërkaq, duart e hapura për lutje
 I fërkuan një herë ballet e zyrtë dhe zbritën,
 Meloditë e qëparme për një farë kohe heshtën.

U dëgjua, pastaj, zëri i idhët i imamit

Që thosh:

- Thoni, për hir të Allahut, o muslimanë,

Si e dini këtë të ndjerë?

- Për të mirë e dimë!

- Nesër do të mblidheni para Zotit të gjithë;

A do të mund të dëshmoni për këtë për mirë?

- Po!

- Imam efendi, kërko t’ia bëjmë hallall, trego mëshirë!..

- Bëjani hallall, pra, tani hakun tuaj!

- Eja, bëjani hallall, mos e lini të presë njeriun e shkretë!

Nga zemra e xhematit* u këput “hallall i qoftë!”

Një klithmë e thellë nga brenda iu përgjigj,

U përhap jashtë e u ngjit përplotë.

Në shtëpi nisi një vajtim i nxehtë tani;

Nëpër dritare u dukën femra me kryet mbuluar me shami:

- A na le, o vëlla, më në fund, ne?

- M’u shemb, o miq, shtëpia, vatra, ah, burri më shkoi...

- Daja që si engjëll, ah, ç’njeri! E si të mos digjem unë?

- Tridhjetë vjet plot që jemi komshinj;

Si s’u nxehtë një herë, moj motër, e të thotë “moj ti!”

- E mjera Remzije! T’u përkul qafa, moj bijë!..

* Xhemat: bashkësia e besimtarëve.



- Ç'pati babai?

- Babai... të vdiq!

- Mos, zonja Aishe,

A thuhet kjo? Vajz' e shkretë ra në zil..

- Moj ju gra, pa merreni pak këtë jetimin me të mirë...

Hapeni dhe këtë ballkonin të shohë përreth e të mos qajë...

Dhe pashë tek u duk në dritare të ballkonit

Një bjonde e vogël, e dashur, topolake... tek të pestat.

Lotët që i shkëlqenin mbi faqet e ngrira,

Qenë shpirti i pafajshëm i së mjerës që po shkrinte.

Ai vaj në kujtesën time të kumbojë pa pushim...

Një copë gjemie mbi një dallgë të pandjenjë

Lundron... Para, një hapësirë e gjerë shenjë hiçi

E tërheq atë drejt brigjeve të vetmuara...

A e sheh atë që ka ndenjor mbi një gur e qan?

Ndërsa i vdekuri lëkundej mbi supet e xhematit,

Asaj cope dërrase i ngjante lëshuar mbi dallgë.

E si mund ta dëgjojë gruan që rënkon në largësi?

E si mund ta shohë jetimin që i shkojnë lotët rrëke?

Rënkimi njerëzor që e bën thelbin e qenies të rënkojë,

Shuhet brenda kësaj rrëmuje apokaliptike...

S'paska qenë ashtu i gjerë kufiri i rënkimit:

Me të mbaruar sokaku në kthesë, vaji u pre.

Ajo copë dërrase e ngrirë, ajo flakë e heshtur,

Duke i grumbulluar brenda një heshtjeje të frikshme

Figurinat që gjen në itinerarin e vet, mbi dallgët përparon

Pa parë, tashmë, në tokë; vetëm qiellin sheh e shkon.

E pse të ndërrohen shpesh personat e këtij vigu?

Kjo pyetje i tregoi arsyes një të vërtetë të madhe:

Po, amshueshmëria do ta shtypë kurmin-cipë të vdekshme,

Trupi nuk do ta heqë dot jetën e përhershme;

Gjunjët që dridhen nën këtë barrë të tmerrshme,
 Nuk do ta durojnë më shumë se tre hapa ëndrrën njerëzore!
 Duke ecur rëndë-rëndë karvani i të vdekurit,
 Te sheshi i faljes së xhenazes më në fund e arriti etapën e parë.
 Me të dalë mbi minberin* e fundit hatibi i vdekjes,
 Iu hap vështrimit të vëmendshëm jeta fletë-fletë.

* * *

Kjo pllakë guri e shtrirë pa mëshirë, barrela jote e fundit është;
 Do të ngrihesh një ditë nga shtrati i butë për t'u shtrirë mbi të.
 Sado të përpiqesh, s'i shpëton dot. Pengesë e pakapërcyeshme
 Për ty në rrugën e jetës; kapërceje në mundsh atë!

Musal-la**: dallgë lotësh e ngrirë e jetimëve të shkretët;
 Musal-la: rënkim i hedhur nga zemra e vdekjes mbi tokë;
 Musal-la: katedër kumtese e ahiretit, në këtë botë;
 Musal-la: para njohjes së thellë, mësim që flet!

Nga kjo katedër, të vërteta të tmerrshme zbresin mbi botë,
 Lartësohen për në botën hyjnore opinionet më të sakta.
 Përreth tij kalojnë në errësirë fantazma pa numërim:
 Figura të mjera lakuriqe me qefinin hedhur supeve kanë kaluar.
 Im atë, vëllezërit e motrat, nëna ime... ndoshta
 Shumë miq të zemrës q'i kam njohur të çmuar,
 Pandeh që nga ky gur hedhin mbi botë të fundit vështrim...
 Nga ky monument, mijra klithma të pazë shpirti më dëgjon!

Frone mbretërore përmbysen, bota kthehet përsëprapthi;
 Yjësi të qëndrueshme një nga një rrëzohen, kurse ky gur
 Ende sikur tallet me dorën shkatërruese të kohës,
 Si të ish simbol asgjëje që sundon mbi tërë ekzistencën!

* Minber: brenda në xhami, shkallarja ku ngjitet hatibi për të mbajtur hutben.

** Pllaka e gurtë, e quajtur *musal-la* ku shtrihet i vdekuri për t'ia falur namazin e xhenazes.



Namazi u fal, lutja mbaroi. Karvani u rrjeshtua për udhë
Duke i vënë nga një dorë fronit të të vdekurit.
Qe bërë gjysmë ore kur udhëtarët qëndruan:
Pra, arritën te fqinjësia e dynjasë, në ahiret mbërritën.
Kufoma u zbrit nga supet dalngadalë e, pastaj,
U fut në një gropë mes selvive.
Iu hodhën sipër pesë-gjashtë lopata baltë me kocka,
U fry nën dhé një çiban, një mish i huaj!
Po, një çiban që, në s'ia ndjeftë tmerrin ai që rri shtrirë,
Kthehuni e pyetjani dhimbjen atyre që ka lënë pas;
Ndërsa ky grumbull dheu do të jetë duke fjetur në qetësi,
Ai shpirt i vogël do të përpëlitet gjer në pafundësi!..

DALLDÍ E PËRSHPIRTSHME

Përfytyro një natë të errët e pa yje, në prehrin e frikshëm
 Të së cilës shtrihet e zgjatur gjer larg një shkretëtirë;
 Udhëtari i saj s'e gjen dot udhën prej valëve të errësirës;
 S'ecet... Në çdo hap që hedh, ia zë udhën një gropë e zezë.
 Ashtu si udhëtari i vetmuar i zhytur në atë ranishte,
 Për një dritë, për një yll shpëtimtar është i dëshiruar,
 Ashtu dhe unë, o rreze shprese, digjem e përvëlohem!
 Duku dhe një herë se horizonti shumë m'është errësuar!

Kalo në përfytyrim një oqean të tërbuar
 Me dallgët-tufan që ngrihen lart si male;
 Vdekje ka, shpëtim s'ka, bregu i shpresës është larg,
 Kohë pas kohe shpirti dridhet nga frika në buzët e ngrira.
 Ashtu si njeriu që lufton me ato ujra të tërbuara,
 Sapo të shohë një skaj ngushëllimi, hidhet aty me padurim,
 Kështu siç ndodhem i rrethuar nga dallgë pesimizmi,
 Iluzioni yt m'është po ai breg në përfytyrimin tim!

Mendo një nënë të vetmuar të ndarë nga biri i vet;
 Ose përfytyro një bonjak të ndarë nga vatra e vet;
 Ashtu si kujtimi i të birit nuk del nga kujtesa e asaj të mjere,
 Ashtu siç bonjaku s'e heq dot kujtimin e s'ëmës prej zemre,
 Edhe çka kujtoj unë, o i Dashur, kujtimi Yt i zgjedhur është!
 Ç'të bëj, çdo shikim imi është frymëzimi Yt i kthjellët;
 Barërat, dallgëzime të ditës Tënde, fidanet më kujtojnë Ty,
 Trajta e reflektuar ujrash, bukuria Jote e pashuar!
 Dallgëzat lozonjare të lumit, ecja Jote nazemadhe,
 Lulet erëmira, aroma Jote e freskët që fshihet.
 Agimet nazemëdha që flenë në gji të netëve,
 Më kujtojnë ballin Tënd të dëlirë mbështetur flokëve...
 Yjet e ndritshëm që notojnë në detin e përjetësisë,
 Janë rreze të lëshuara nga shikimi Yt mhanitës.



Toka plot me veprat e tua, qielli, nën nurin Tënd;
Botët, pasqyrë për të të shikuar Ty, fytyrën Tënde bukurifalëse!

* * *

Një mëngjes herët pata dashur të hiqesha në një vend të qetë,
Qeshë ulur në breg të detit, qeshë kredhur në soditje.
Sapo kish zbardhur, qielli ende i përgjumur ishte,
Dielli ende nuk qe dukur nga vendi ku flinte.
Në buzë të detit të kredhur në heshtje të thellë, s'ndihet zë...
Flladi s'ndihet, ujrat të plogështa, gjithkahja në plogështi!
Ndërsa fëmija i bukur i dados mëngjes po flinte
Si një fëmijë lozonjar mbi atë shtrat blu,

Dielli qe dukur nga banesa e vet intime
E fshehur pas perdes së maleve
Dhe qe lartësuar në rrugën e vet shkallë-shkallë.
Duke marrë lartësi një kohë në lartësinë qiellore,
Dritërat dallgë-dallgë u bënë në atë gjerësi të qetë.
Këto lëvizje gjallëruese e zgjuan atë hauz argjendi;
Flladi me frymën e Tij të dashuruar, heshtjes i dha dallgëzim.
Pastaj, me dallgët që ndiqnin njëra-tjetrën, nga bregu

Një zë i dëshpëruar m'erdhi që ma shtoi ekstazën.
I vura veshin melodisë: melodi poetike qenkësh,
Kurse deti i fryrë e i dallgëzuar, yti oqean ideor qenkësh!
Dielli, shpirti Yt qenkësh; drita e tij e zbritur me tufa rrezesh,
Drejtprësëdrejti mendimi yt i dalë prej atij burimi qenkësh!
U shfaq, më në fund, e kuptova: Kjo botë je Ti!...
Mirë, po unë, o i Dashur i Fshehtë,
Po unë, i Dashuri i Fshehtë, vallë, ç'jam në Ty?

SHPURA E AMIN-IT*

*Kur sytë m'u bënë të kuqe gjak, verën e kuqe ç'ta dua?
Verën ç'e dua?
Ç'ta bëj qebapin kur zemra m'u përcëllua?
Qebapin ç'e dua?
Kurmi s'na u desh as të dashurës, as mua!
O Zot, këtë grusht dhe unë ç'ta dua?
Dheun ç'ta dua?
Amin, amin!*

*Më në krye, me pllakën e shkrimit në gjoks plot respekt
Ecën rëndë-rëndë një engjell nëntë vjeç;
Pesë-dhjetë hapa pas, tërë madhështi,
Dy të pafajshëm, të hijshëm aq sa dhe dritën e agimit
Mund ta shuajnë, i tërheq një pajton i hapur
Tërë naze e seriozitet. Pas tij,
Një tabor i jashtëzakonshëm me hapa të vegjël shumë i gjatë!*

*Nga ato zemra më të dëlira se një shpirt,
Kohë më kohë një melodi hyjnore lartësohet;
Me jehonën e këtij hovi të dëlirë, thirrja amin!
Nga engjëjt drejt tokës zbret.
Të gjithë individët e këtij karvani, mjedisi i të cilëve
Eshtë një mëngjes dritë mbi dritë, janë plot gëzim e hare.
Duke e çarë mespërmes turmën e popullit
Që u ka dalë para, ecin si një trup i vetëm pa u ndarë!*

*Ky është një karvan të pafajshmish, o popull,
Pra kalimin e tij duhet ta nderosh gatitu!
Ky është një tufë krahësh që, me një lëvizje të vogël,
Eshtë i aftë, në të ardhmen, t'i luajë nga vendi botët!
Vjen një ditë që, nën hijen e ndihmës hyjnore,
Ky merr drejtpërsëdrejti kuptim.
Ja, vetëm kjo është ushtria e famshme, në pastë të tillë!*

* Në traditën shkollore osmane, ceremonia solemne për nxënësit që hynin në klasën e parë të shkollës së mëhallës. Ilahi të cilën Akifi vazhdimisht e përsëriste, e këndonte për çdo ditë dhe emociohohej prej saj.



Po, nëse karvani rinor kërkon të shkojë përpara,
Nuk duhet t'i bëhemi pengesë në rrugën e tij,
Sepse ai po nxiton për në mëngjesin e pasosur të së nesërmes;
Sepse rinia nuk do që ta pranojë realitetin e të rrijë!
Nëse për përparimin rinor e ardhmja krahërorin e hap,
Atëherë a s'merr hov ky karvan për t'u bërë një me të?
A mund ta pengojnë e kaluara dhe e tashmja atë tani?

Fluturuan ato thirrje prej buzëve pa pushim...
Kënga e hareja në këtë botë nuk zgjasin përgjithmonë!
Ndërsa shpura kalonte rëndë-rëndë nëpër sokakë,
Vjen e ngulet, gozhdohet mu në grykë të rrugës
Një karrocë e njohur, e famshme me pamje të frikshme;
Brenda, tri fytyra të përgjakura të pudrosura.
Megjithëkëtë, një zë i fortë hapi rrugë e doli
Para karvanit e foli:

- O ju statuja të pashpirt të një kohe të shkuar,
Mos i zini udhën karvanit të së ardhmes!
Ç'është ky nxitim për t'ia prerë udhën?
Pritni, le të shkojë para, për Allahun, kjo e ardhmja jonë!

HALLQARJE

*Má medá fáte ve'l-muемmelu gajbun,
Felek-es-sáatu-l'leti ente fíhá.*
E shkuara iku e shkoi dhe e ardhmja s'dihet;
Ti përjeton vetëm çastin që në çast fshihet!*

Ky paralajmërim është parim i urtë i një poeti të madh;
Edhe nëse e ke të dëgjuar, përsëritja e tij s'është pa vend:
“E kaluara ka kaluar, kurse e ardhmja s'dihet;
Nga jeta jote ty të është dhënë vetëm ky çast që kërkon të ikë”.
Sigurisht, kthimi te e kaluara është i pamundur;
Po shpresa jote për të ardhmen e sigurtë thua? Hiç se hiç!
Puna e sotme duhet bërë sot se, po e le për nesër,
Të nesërmet zgjaten gjer në botën tjetër pa mbarim!
Punët e mia të pesëmbëdhjetë vjetëve më parë rrinë
Siç i kam lënë; nesër i filloj - pata thënë, pak më parë!
Natyrisht, ata që e lënë punën e sotme për nesër, humbin.**
Ky është një ligj krijimi, s'vihet në diskutim, është i prerë!
O dritë e syve, të mos të të shkojnë ditët kot,
Përpiqu sa ke mundësi sepse fundit s'i dihet.

Thonë se jeta s'i mjafton njeriut për të mësuar..
Por kjo fjalë s'është e saktë në çdo vështrim.
E padiskutueshme është që njerëzit të kenë një qëllim;
Ata që e kalojnë çdo orë të jetës me punë,
Edhe nëse s'ia arrijnë qëllimit final, në rrugën e tyre
Arrijnë mijra qëllime të tjera dhe gjen hijen e pushimit!
Po, dituria, në tërë kuptimet e gjerësinë e saj, e luhat njeriun,
Mirëpo, të paktën njeriu mëson se ç'është të thotë të jesh njeri!
Te njeriu, ambicja për ta njohur të vërtetën, është e natyrshme;
Edhe veprat dëshmitare, janë produkt i kësaj ambicije!

* Dyvargësh i një poezie arabe.

** Aludim për porosinë profetike, *heleke'l-musevvifún*, “kush e lë punën e sotme për nesër, është i humbur!”



Meqë përtacia bie në kundërshtim me ligjet e krijimit,
Kush e quan veten njeri, të mos rrijë, por të punojë!
Nëse gjërat e panjohura janë, para të njohurave, sa një mal,
Pse duhet të ketë turp ai që mëson një gjë të re?
Vërtet, po të krahasohen gjërat që dihen me ato që s'dihen,
Të parat dalin shumë më të pakta se të dytat;
Mirëpo injoranti kurrë s'mund të krahasohet me të diturin:
Injoranti është i verbër, i dyti s'lëshon pe nga rruga e drejtë!
Kur'ani thotë: "Të paditurit s'mund të jenë një me të diturit!
S'mund të jenë një errësira me dritën, i vdekuri me të gjallin!"
Sigurisht ti i di këto gjëra shumë mirë,
Por unë, pse i dua shumë, po i përsëris dhe një herë!

Siç duket, dola nga thelbi i bisedës... Kujtoma,
Ku e patëm fjalën? Nëse prapë rrëshqas, o dritë e syve,
Mos u druaj, sillmë ndërmend! Do të jesh mërzitur, vërtet,
Nga urtësia ime, nga biseda ime kokë më kokë me ty,
Por ja, pesë a dhjetë fjalë mbetën, dëgjoma poezinë e pakuptim:
Thonë: "Po qe se fundi i përpjekjes për të mësuar
Eshtë pohimi se asgjë s'ke kuptuar,
Ç'kuptim ka një përpjekje aq e lodhshme për ta nxënë atë?»
S'është kështu! Njeriu duhet t'i shkojë gjer në fund diturisë
Dhe më në fund të thotë: "Dituria nuk ka fund!"
Nën këtë pohim të së vërtetës shkëlqen hija e diturisë!
Ky është kuptimi i të qenit njeri,
Kënaqësia më e madhe e ndërgjegjes!

KUKULLA OSE HAKK-I KARAR*

Xhemilja me Feriden** më erdhën pranë një mëngjes
 E më thanë: “Baba, na sill, i dashur, në darkë nga një
 Kukull!” Dhe unë s’ua prisha vajzave. Dhe në mbrëmje
 U solla dy koketa të pashme me buzë të kuqe si qersh, i
 Me sytë si kokrra rrushi, me dhëmbët si inxhi.
 Aman, ta shihje gëzimin e atyre vogëlusheve atë natë!
 S’pushuan së luajturi! U thashë: “Shkoni flini,
 Pa nesër prapë luani!” As Feridja që e pati bërë zakon
 Të përgjumej kur hahej darkë, s’kishte ndërmend të flinte!
 -Ta dinit, ç’vajzë e prapë dhe ç’e ndjeshme ishte!
 Feridja s’i kishte pesë, kurse Xhemilja i kish mbushur shtatë.
 Si motër e madhe q’ishte, Xhemilja sillej si zonjë!
 Kjo luajti një copë herë dhe shkoi të flerë.
 Kurse e vogla e përkundi beben e vet gjer në mëngjes,
 Mirë po ajo as nga ninananat, as nga përkundjet merrte vesh!
 “Shih si i ndrisin sytë; kjo s’është foshnjë, po shtrigë!”
 Afër mëngjesit, vogëlushes i kishin shterrur fuqitë:
 E kish zënë, më në fund, një gjumë i thellë...
 Lëreni, mos e trazoni, le të flejë!
 Vajza ish zgjuar kur unë s’ndodhesha në shtëpi
 Dhe mbyllet brenda për ta vënë beben e vet në gjumë.
 - Aman, sa e prapë, i ka ikur gjumi krejt.
 Shihni, edhe djep solla, po a shtrihet kjo?
 Apo shtrihesh e fle, moj majmune? Mbylli sytë!
 A s’bën t’ia dëgjosh fjalën nënës një herë?
 Ja, t’u mbyllën sytë... Oh, fli tani!
 S’e di ç’pati bërë kukulla që, pastaj,
 Në odën tjetër qenkëshin dëgjuar të rrahura!
 Pse, a do ta rrihte vajza po të kish fjetur mirë e mirë?

* Këtu është fjala për çështjen juridike të parashkrimit të përdorimit të një malli të huaj, në bazë të së cilës, po qe se pronari i një malli nuk i del për zot mallit brenda kohës së parashkruar, përdoruesi i tij i përkohshëm fiton pronësinë mbi të.

** M.A.Ersoji pati dy vajza dhe tre djem të quajtur, me radhë, sipas moshës, Xhemile, Feride, Suad, Emin, Tahir.



* * *

Kur u ktheva në mbrëmje, pashë se Feridja ish fort e vrarë.
Po a rri e motra? Pa e pyetur unë, u hodh vetë:

- Sot,

Ta dish, baba, se ç'i bëri kjo bebes së shkretë!

- Ç'i bëri?

- E rrahu mirë e mirë e, më në fund, e theu!

- Pse?

- Ku ta di? Atë pyete! Eja, çupë, sille beben, ku e ke?

Feridja u largua meje, nuk desh ta sjellë.

Më në fund, e sollën kukullën e mjerë:

Sytë i kishin mbetur si kafazë bosh, në krye s'kish më flokë,

Këmbët, topalle, krahët s'i lëviznin vendit;

Kush e di ç'sëmundje e ka zënë! Ajo kukull

Që dukej si e gjallë, tani ish një gjë e gjymtuar...

- Kjo ka vdekur, moj, shko, varrose, ka mbaruar!

* * *

Feridja mbeti pa bebe, kurse e Xhemiles

Vazhdon të jetë e bukur: as qorre, as e çalë.

Një ditë prej ditësh kur po luanin bashkë,

Feridja i lutet papritmas me një mënyrë për të ardhur keq:

- Jepma pak beben, motër, të luaj ca!

Ne shohim Xhemilen ç'do të bëjë. Xhemilja i thotë:

- A mund të ta jap unë kukullën ty?

- Mos u bëj koprrace, bijë, jepja të luajë!

- Po e mori, do ta thyejë!

- Si e thyen? Mos bëj kështu, jepja menjëherë!

- Punë që s'bëhet, baba!

- Bëhet, bëhet!

- Po e theu?

- Nesër në mëngjes të marr një tjetër ty!

Pas ndërhyrjes sonë, Xhemilja ia zgjati pa dëshirë beben

Ferides duke i thënë: “Merre, luaj!”

Pashë se Ferides i qeshi fytyra, u gëzua.

Mirëpo ky gëzim i sajuar,

Përfundoi përnjëherë...

- Jepma, po të them!

- Ç'bëhet sikur të ma japësh edhe pak?

- A e sheh, baba?

- Moj vajzë, jepja dhe merrja prapë,

Malli amanet s'bëhet, nuk është zakon.

Pas pak e njëjta lutje u përsërit:

- Ma jep prapë beben të luaj!

- Jo!

Unë s'e përsërita lutjen për të dytën herë.

- U bë shumë, baba, pastaj e kërkon përherë!

- Edhe më parë ta mori e ta ktheu menjëherë;

Mos se preket! Ti je motër më e madhe...

- S'ia jap më, ama!

Po ma ktheve shpejt, merre e luaj, hë tani...

Këtë radhë Feridja qe shumë e kënaqur.

Luajti shumë, e përkundi për një kohë të gjatë

Dhe fjeti nëpër hasër me beben në krahë.

Por ç'e do! Ja dhe ku erdhi koha për ta kthyer prapë,

Shikimi i vajzës më kot kërkoi ndihmë!

Xhemilja e kërkoi amanetin me këmbëngulje;

Fëmija ia dha, por sikur t'ia shihje në sy zemërimin!

Vajza e madhe e shtypte krenarinë e pafajshme

Tek bridhte me beben në krahë. Tjetra përballë

E kishte të vështirë ta shikonte.

Iu afrua përsëri; shihni, s'ka dyshim, do t'i lutet:

“Jepma foshnjën!” Por unë s'e detyroj.

Por kësaj radhe s'qe një lutje fjala e saj;

Këtë herën e tretë nuk iu lut, por e urdhëroi:

“Jepma foshnjën time!”

Shih, shih! Edhe drejtësi na shet kjo e pafytyrë!...



PEMËSHITËSI PLAK

Vitet e mundimshme të jetës së gjatë
Shkaku i rrudhave të përzishme në ballin e pastër të plakut.
Në dorë, kandari, në shpinë, koshi me mallin që shet.
Ecën... Para, varri, pas, një mijë të qara e ngashërime!..
Ndodh që para, tutje larg, t'i shfaqet iluzioni i vatanit
Në trajtën e një mirazhi ndriçues në shkretëtirë.
Shpresa ndoshta do t'ia gjallëronte shikimet e shuara
Sikur kjo jetë lodhëse e dërrmuese t'i jepte mundësi përfytyrimit!
E bart këtë peshë tërë jetën për të mbetur gjallë;
Eh sikur ta dinim, pse duhet bartur kjo peshë jete?

POHIM

Në librin tim, *Safahat*, po, kush kërkon poezi, s'e gjen dot;

Vetëm për një gjë, "ja, ky është dëshpërimi" me siguri të thotë!

- Koshi është?

- Jo!

- Kafeneja?

- Jo!

- I sëmuri?

- Jo

- Po çfarë?

- E groposur në katër a pesë vargje, një goxha jetë e shkuar kot!



Libri i dytë
NË QYRSINË E SULEJMANIJES



NË QYRSINË E SULEJMANIJES*

*Vëllait dhe mësuesit Fatin***

Nga ura kaloj shumë; por sado të kem kaluar,
 S'di një herë në pashpresi të më ketë çuar,
 As ato ujrata e varfëra çehre myshku të Haliçit,
 As bregu i tij i fjetur sikur t'i ish zemëruar krijimit!
 S'ndejnë të gjithë njëlloj. Për shembull, për sa të jenë
 Shtëpitë e shëmtuara, sylotuar, të vjetra, të pista,
 Të menduara, kokë më kokë të bregut përballë,
 Ju për herë hidhërim, dhimbje keni për të ndjerë...
 Mirë, pa shihni, te unë s'ndodh kështu... Bëhuni dhe ju
 Pak poetë: Për shembull, nëse kalimtari i thjeshtë i rrugës
 Urës me dërrasa që lëkundet, "Të parët i ke pasë trap"- i thotë,
 Ç'del?
 Ejani ta supozojmë ne këtë, bulevard notues!
 N'hapësirat europiane, urat na qënqeshin të varura!
 Le të jenë, punë e madhe! Në Lindjen tonë
 Kështu të batisura... Hapini librat ç'thonë,
 Ku është parë të ketë ura ndër det?
 E kuptova: Sado të më pëlqejë poezia mua,
 Kjo pikëpamje, i dashur lexues, shumë, shumë
 Do të të bëjë të qeshësh pakëz... Ndryshe, ndërsa
 Në anën tjetër zyrtësi, në bregun e detit një mijë të vërteta
 Zgërdhohen, do të thuash:
 "E ke kot, vend për fantazira s'ka!"
 Mirë, po as kjo përmendore hyjnore, s'të pëlqen?
 Mos vështro ashtu i ndrydhur e me mosbesim,
 Lëre ç'ka përreth e shih kah faltorja*** që të rri përballë:
 Ka nxjerrë thua rishtaz deti i kohës në breg

* Sulejmania, vepër e Arkitekt Sinanit, një ndër xhamitë më të mëdha të Stambollit.

** Fatin Gokmen (1877-1955), astronom dhe themelues i observatorit sizmik të Stambollit.

*** Jeni Xhami, Eminony.



Nga pasuritë dallgësore një margaritar të tillë të madh?
Ç'agim artistik i dalldisur qysh në pafillimësi...
Nga bregu i detit fluturon një buzëqeshje drite në pafundësi!
Sikur një dallgë e amshuar e oqeanit të pavdekësisë
Duke u lartësuar qiellit ka ngrirë e bërë inxhí!
Në përmasat qiellore të kësaj cope margaritari
Sytë e tu të lodhur pse të zbresin në tokë
Në fëlliqësi të zhyten përsëri? Sa keq, mos, s'ka se si;
Kthehu nga perëndimi, eja tani, qëndro pak dhe shihe
Gjendjen e faltores që, për t'u lartësuar te Zoti kanë bërë shkallë
diturinë,*
I jep peshë diturisë! Ja, pra, besimi në plotëni!
N'sa ajo hedh hije mbi horizontet si malet e lartë,
Të mjafton një shikim për ta kënaqur shijen estetike
Mbi atë monument më tërheqës se vetë pavdekësia!..
Mos rri, atëherë, ngjitu në atë botë plot dritë
Që nuk di se ç'do të thotë errësi;
Ajo çerdhe qiellore nuk u fëlliq, as për t'u fëlliqur s'ka!
Ai që e ka lartësuar atë, përjetësisht e ka lartësuar!
Dhe sikur fëlliqësia botët si tufan t'i përmbytë, t'i pushtojë,
Kjo xhami, prehër i paqtë i majës që noton në qiej,
Do t'i sodisë nga përballë ato plehra përhapur gjithandej...
Dhe sikur zemra nga nëntoka tërmete të të shpërthejë,
Ç'gjettë mbi tokë, t'i përmbysë, t'i copëtojë;
Revolta të vërtetën me një goditje shkatërruese ta mbarojë,
Etikës, "kllapi" t'i thonë siç e kuptojnë sot,
Të mos mbetet, si rrjedhim, ndjesia e rrokullisur
As burrëri ndër zemra, as në burrëri jetë,
Prapë në madhësinë e qyrsisë së saj Sulejmania
Do të mbetet si e vetmja vatër e së vërtetës në botë!

* Një pjesë të themeleve të xhamisë Sulejmanije e përbëjnë medresetë.

Vjen një ditë e shemben faltoret, medresetë,*
 Vendet më të pastra, të shkelura nga këmbët më të fëlliqta;
 Njerëzimi ateizmin një fe të re e njeh
 Emri i së Vërtetës fshihet nga kujtesa njerëzore;
 Kuptimi i groposet në humbëtirën e historisë... Megjithëkëtë,
 Nga kjo shtëpi e Zotit qoftë dhe një gur nuk bëjë;
 Ai, për të cilin janë të huaja vlerat njerëzore,
 Kurrë nuk mund të hyjë në gjoksin e kësaj xhamie;
 Dhe në përkujtimin e Zotit këto katër minare
 Si një gjuhë zgjaten nga zemra, duke pohuar Madhësinë;
 Dhe s'groposet në të shkuarën kjo fytyrë madhështore,
 S'është cofëtirë që të hidhet në atë varrezën kolektive!

E tani, lexues i dashur, pakëz kohë po të kesh,
 Ndiqme pas se i kënaqur do të mbetesh;
 Sikur të lodhur të biem përdhe, i hyjmë në gji
 Xhamisë dritë mbi dritë që e kemi atje.
 Do ta shohësh, nën hijen e përjetshme të asaj xhamie,
 Shpirtin e artit në formë reje shëtitëse.
 Mos thuaj "e kam parë"! Eja ta shohim dhe bashkë;
 Prej ku t'ia nisim? Eja, nga porta e shatërvanit të hyjmë!

Një qemer artistik, Fjala e Njësisë** radhitur mbi të
 Dhe një ajet nga Zoti që mbështet prerësinë
 E urdhrit për namaz sipas kohës së vet!
 Sapo ta shohë njeriu përbërjen e portës,
 Më së pari nga të dy anët i shfaqen si udhërrëfyes
 Dy shtylla elegante, dy mihrabë simetrikë.
 Pastaj syri ngrihet kah gjysmëkubetë
 Mbështetur mbi qemer njëra më të djathtë e tjetra, më të majtë.
 Sapo shikimi dritësor, pasi t'i ketë përkëdhelur
 Ato gjokse të dëshpëruara të pajisura me stalaktite,

* Fjala 'medrese' nga katër botimet e para, në vitin 1928 është zëvendësuar me 'grykatat'.

** Fjala e Njësisë: pohimi i tevhidit ose monoteizmit islam, *La ilahe ill'Allah*, "Nuk ka zot tjetër veç Allahut!"



Të hidhet para, vijmë pjesërisht të hapura dy kanate,
Gdhendjet, lakimet e të cilave ç'i mrekullueshëm art!
Sikur Zoti, një tru të stërmadh, ideplot, sapo e ka hapur
Për të na e treguar ne çdo skutë të tij!
Shikimi sheh me të hyrë brenda tani
Kubetë e bëra me të njëjtën madhësi.
Në shtyllat me gjithato qemere që shtrojnë sheshin e zhveshur të
avllisë
Një mijë dritë-hije qëndrojnë krenare,
E fascinojnë syrin e njeriut që kërkon të shohë
Atë që lartësohet thjeshtësisht mbi portën e brendshme.
Sigurisht duhet të jetë për të treguar hyrjen
Që më e gjerë rri, më e lartë se kubetë e tjera
Të hedhura sipas një rregulli, të radhitura.
Të njëjtat kanate madhështore bien në sy
Prapë. Sapo të kalosh pragun e kësaj dere artistike,
Përballë të del gjysmëkubeje, zbukurimi i mihrabit*,
S'e sheh dot syri kubënë e vërtetë.
Kësaj i duhet shoqe, po, ndryshe s'është e mundur.
Apo simetria këtu është gjë që nënvleftësohet?
Ja, pra, pikërisht në madhësinë e saj, në përmasë të ngjashme,
Që mbi të ka një të njëjtë si vetja, pa e shih!
Po hodhe gjer në pesë hapa duke thënë "Këto gjysmëkube
S'do të rrinë varur, do të bashkohen sigurisht",
Shikimi ta sheh kubënë me mahnitje e habi...
Që do të pandehësh se mbështetet në ato gjysmëkube.
Por kjo s'është dhe aq e drejtë; ajo ç'është përballë,
Janë katër shtylla graniti që e bartin mbi kryet atë.
Heronj që për shekujt s'ua përkulin krahun dot!

Po ta shohim përshkrimin e faltores sot, pak a shumë
Drejtëndësh duhet të jetë. Ashtu? Jo!
A s'i sheh kubetë që, për t'u lidhur kolonat

* *Mihrabi*: Vend në xhami ku falet imami; është në drejtim të Qabes. Mihrabi ka një arkitekturë të posaçme.

Në murin kryesor, rrinë si skifterë në shpinë
 Të disa qemerëve të hedhur në vendet në mes?
 Këto, pra, nuk i japin mundësi kësaj.
 E pse, pastaj, kështu duhet të jetë kjo pandehmë pa vend?
 Aq llogari e hollë është bërë në simetri,
 Saqë vija tangente që zbret nga sipër kubesë nga jashtë,
 Takon plotësisht në të dy anët gjysmëkubetë
 Artistike në të dy anët e saj.

Eja, më në fund, i dashur lexues, rri në mes
 E shih kah muri frontal, kah xhamat, kah minberi shih,
 Pastaj kah mihrabi, mahfilet dhe qyrsitë.
 Ja, pra, ajetet që duken shpesh në çdo front, në çdo vend,
 Por që, të veshura me të fshehta, të duken si pa kuptim,
 Ajetet që ty të lënë të paaftë në të kuptuar,
 Duke mbetur frymëzim i pafrë i botës sate ndjesore,
 Si detet të dallgëzojë në zemrën tënde madhështia,
 Të mos të të shohin sytë ngjyrë jashtë Perëndisë, ngjyrë-hije!
 Bjer në ekstazë, zhytu në njësim,
 Larg prej botës së shumëllojshmërisë...
 Vetëm Krijuesin shihe, artin e Tij, jo veprën!
 Edhe unë të gjej një vend e, kështu, të zhytem në qetësi,
 Ta kapërcej qenien time, në hapërimin tim drejt Zotit!
 Penxheret gjysmë të errta në murin përballë të faltores
 Kanë hedhur në shpinë të diellit një tyl të hollë esmer,
 Një dritë e hijshme milet brendësisë pandërprerë...
 Pamja përmes asaj perdes që lëshohet nga lart si ujvarë,
 Turmë e stërmadhe besimi, e mahnitur, që nga pafillimësia...
 Gjokset, të vrullëzuara në ekstazë; buzët, të pafjalë!
 Të rënë në gjunjë mbi rrogozët mbi mermer shtruar,
 Të gjithë, presin lutjen: është koha për përgjërime...
 Fryn në hapësirën tronditëse fryma mëshirore e amshuar
 E kësaj gjithësie të njëshmërisë, duke u dhënë formë e trajtë
 Atyre mijra trupave si turmë e hije të padalluar:



Dridhen e rrëqethen qelizat e trupit nga kryet në thua.
Jehon rënkim i zellit nga dyert e muret
Duke i ardhur ngushtë thirrja nga brenda hapësirës.
Digjen shpirtrat nga pamundësia për t'u manifestuar,
Sytë, përjetësisht në dalldí, pa dimension, pa kufi.
Më në fund, nisi në mahfil një thirrje e dëshpëruar,
Sërish morën hov me rënkime ato përmasa të mahnitura.
Dhe pashë: ata krahë të zgjatur nga çdo radhë,
Sikur, duke e çarë boshllëkun, te Zoti kanë për t'u afruar!
Tani, me "amin-in!" drithërues të shkëputur nga gjokset
E pafajshme të tre mijë vetëve, pranim i lutjes kërkohej nga Zoti!
Pastaj ballët u fërkuan me duart e dridhura,
Përnjëherësh xhemati u kthye kah qyrsia!

I ngjiture në qyrsi, kush qe? Një plak që s'e njihja,
Prapë, s'më ish aspak e huaj për zemrën ajo fytyrë tërheqëse.
Me mjekrën borë, të pastër, me sarëk të bardhë,
Me atë ballë madhështor, fytyrëmbël, që të bën për vete,
Duke e përfshirë gjithkahjen si hënë e plotë,
Ç'burrëri e matur, ç'shije jep, O Zot!
Sidomos sytë, si dy vatra ku mblidhen rrezet qiellore,
Me një rreze të vetme kuptimin e ndez flakë.
Ah, ajo tufë rrezesh dritëplote që të zbret nga sytë,
Një mijë shpirtra të ndjeshëm të lidhur me telin tënd magjiplotë!

- Në qyrsinë më shihni, mos pandehni se do t'ju ligjëroj;
S'jam dijetar, pamja ime të mos ju mashtrojë!
Ligjet e fesë juristët po jua thonë,
Në paçi ndonjë gjë të pakuptuar, po jua tregojnë!
Ju, botën islame pyetmani mua t'jua them,
Se s'kam lënë vend pa kaluar e pa parë
Nga Lindja e Largët gjer në skaj në Perëndim
Botës muslimane që sa herë i kam rënë tejendanë!
Ndërkaq, ende fillimi i këtij udhëtimi shumëvjeçar

Më pati lodhur; por, po të isha lëshuar i dërrmuar,
 Atë kohë rrugën time ndoshta nuk do ta kisha vazhduar
 Sepse nuk mundesha as përkohësisht të pushoja
 Sepse një zë që, duke shpërthyer nga thellësitë e vetes time,
 Më urdhëronte, “ec, mos rri, vazhdo në qëndresë”,
 Nuk më jepte leje, nuk më njihte ndjesë...
 Ja, pra, ajo thirrje është zelli im fetar;
 Vetja më ngrihet peshë, më bëhet vullkan:
 S’më zë vendi vend, sërish ngrihem e dal.
 As drojë njerëzish nga kjo vuajtje e pashërim
 Dhe as shpirt, pa le ndonjë farë ndjenje si pengesë;

Të gjitha boshe e pa kuptim, shpirt e jetë e botë,
 Kuptimi i jetës qenka në qëllim, në pastë jetë!

Një kohë, në Stamboll pata ardhur përsëri.
 Edhe prej ç’shihja, edhe për shkak të së ardhmes
 Së ummetit tim i rënë në dëshpërim të thellë,
 U ktheva së rishmi në Rusi.
 Dhe të mos kthehesha, e dija, do të më kishin shtrënguar!
 S’i nxë më punët asnjë masë, asnjë kufi:
 Në emër të pushtetit, në emër të fesë, një mijë poshtërsi...
 Ç’fatkeqësi, ç’paturpësi ish gjendja e asaj kohe!
 Në krye, një kukull; e ardhmja e tërë një kombi
 Për qejf të dy a tre kukllavënësve ish bërë fli!
 Një politikë me të cilën, besoj, tallej dhe bufi!
 Për të paturpshmit, prijës, çdo maskara i zi
 Sillet në Audiencën Perandorake, o i lartë, o vezir!
 Hallin e popullit pashë: zemra të bëhej plagë:
 As punë për të siguruar bukën, as për bukë, lekë!
 Garnizon s’ka, zyra s’ka, medrese s’ka, shkolla s’ka;
 As shpatë e as kalem... Për ç’të pyesësh, vetëm “s’ka!”
 Te ushtarakët s’ka mbetur edukatë. E, ndryshe, si?
 Njëri gjithë jetën tetar, tjetri, qysh në shkollë



I ka kapërcyer shkallët: toger në ushtri!
Mareshal i biri i botës? Allahu na dhëntë mbarësi!
Pa le dijetarët, një turshi e prishur keq;
Zyra e quajtur “Bab-i Fetva”*, një çerdhe me analfabetë!
I diplomuar qysh në bark të nënës, të të parëve u ngjet;
Sapo fillon të ecë, një sarëk dhe ja, u bë kadiasker!
Ç’janë ministrat? Spiunë, intrigantë, të poshtër,
As frikë Zoti s’dinë, as turp sa të jenë gjallë;
Mezi lexojnë, hiç nuk mund të shkruajnë, një çetë me hajdutë!
Ç’ është e drejta, më keq se kur thonë “Qofshi shëndoshë vetë!”
Edhe në paça parë përreth se mos gjej, ndoshta, s’e di,
Katër-pesë vetë që t’u flas e të më kuptojnë, dyshimet
Më drejtuan kah një zhgënjim dhe hidhërim i pakufi
Sa herë që dëgjova përgjigjet e atyre që në pamje
Dukeshin si njerëz të drejtë e të vërtetë!
Shumica, të pakokë; nëse kish nga ata me pak tru,
Më thanë: “Kjo qeveri, kaftan i prerë për këtë milet!”
Kujt t’ia qash hallin? Eja provoje po s’pate punë:
“Ç’më duhet mua, unë do ta ndreq këtë punë?”
Nja-dy hoxhallarëve me vlerë q’i dija për të mirë,
Desha t’ua di mendimin dhe u thashë: “Zgjohuni,
Vendi po shkatërrohet, dhe feja bashkë me të po shkon!
Si ju thotë Kur’ani, shihni nga larg e rrini?”
- Shkatërrohet a s’shkatërrohet vendi, ata sipër e dinë;
Në u dashtë a në pastë çare, ata vetë e gjejnë!
Sa për fenë, me punë a përpjekje a mund të shpëtohet?
Sigurisht, fjala “Feja ka lindur si e vetmuar...”** do të vërtetohet!
Pastaj, le ta provojmë pak dhe cili është mendimi
I popullit, thashë; ej, ç’popull i shkujdesur!
Aq i humbur, sa dhe sikur ta dëgjojë bririn e Israfilit të bjerë,
Vështirë se shkundet pak aty ku është shtrirë!
Ecën populli në një tokë plot gracka

* Institucion i lartë juridiko-fetar.

** Në origjinalin arabisht, *Bede’e’d-dinu gariben*, fragment i një hadithi profetik.

Si një varrezë e lëvizshme: çdo ballë, një gur varri!
 Ndjenjë dyshimi e frike s'ndjen në ndërgjegje!
 Lexohet në ballin e disfatës së secilit:
 "S'di as kush vjen e as kush shkon,
 Qysh prej ç'jam krijuar endacak, si torollak sillem vërdallë!"
 Kjo fjalë e urtë e mbetur, si kujtim i përjetshëm,
 Shkruar me dorën hyjnore që ky tru i pajetë
 Para se të lindte te mëshira e Zotit vend kish gjetë
 Të pajetë ende pa lindur te Mëshira e Zotit!
 Kështu, "Ka ardhur radha t'i këndoje Fatiha shpirtit tënd,
 O popull i vdekur, sa mjerë!" pasi thashë,
 U hodha në vaporin që po nisej për Rusi!

Atë kohë në Rusi një shtypje e rëndë sundonte...
 A ka rrugë tjetër për ta bërë padrejtësinë të dëshiruar?
 Ia shtypnin kokën kujtdo që mendonte!
 S'e di, pse s'e shihte këtë Europa e qytetëruar?
 Të vdekur para kohe me plumb a me bajonetë;
 Ose të groposur pa u ardhur koha nën tortura;
 As frymëmarrje, as dritë, as të ulur, as pushim;
 Jetë me gjakra të ngrira, të lënë pa pirë, pa ushqim,
 Lakuriq në truall dy-treqind pashë nën tokë.
 N'ju thënça miljona, s'e teproj, ju kam thënë pak!
 S'e dinë që tiranisë s'i shkon gjatë
 Syri në fillim i trembet vdekjes, pastaj mësohet.
 Pandehin se duke prerë kokë, duke shtypur tru,
 Ideja e lirisë vdes. Ah, ju të poshtër të hutuar!
 Toka e ujitur me gjak më shumë merr fuqi:
 Të gjithë trupat e mbjellur nesër do të ngrihen me furí!
 Gjaku i cilit të pafajshëm mbetet në këtë botë pa u marrë?
 Apo mos njeriu mund t'a grisë ligjin hyjnor?

Në fillim ngrita fshehtas një shtypshkronjë,
 Gjeta pesë-dhjetë bonjakë e i mësova të botojnë.



Kalemi im qe mjaft i ngatërruar, po s'kisha ç'bëj!
Pastaj s'i bëhet hiç vonë popullit për stilin e dikujt
Dhe shkrova tërë ditën siç më vinte goje.
Dhe lexuesit u bënë aq shumë sa s'pata shpresuar kurrë;
Ustai jepte librat e djemtë shtypnin pa pushuar,
Pas gjashtë muajsh shtypshkronja jonë u bë e dëgjuar.
Pesë-dhjetë vullnetarë me gjoksin plot besim
Erdhën e thanë: "Ç'të shtypësh, ne do ta shpërndajmë,
Ne jemi mjeti yt, s'ka gjë për t'u frikësuar;
Pará n'u daçin, thuaj, gjinden ata që kanë për të dhuruar!"
Menjëherë nisa të predikoj me një gazetë
Se kjo është rruga më e parë popullin për ta zgjuar.
Shtypi për njerëzit e qytetëruar është, tani,
Më e larta e katedrave për të folur, kurse te ju, sa keq,
S'është aspak kështu; ndoshta e kundërta krejt:
Ngjarja më e keqe tregon më e mirë.
Atje, elementi musliman është pak a shumë i zgjuar;
Edhe ne, vetëm këtë e nxisnim pa pushuar.
Në nisje, mungesa e parasë ishte gjëja më e frikësuar;
Pasanikët dhuruan floririn me prehrin plot...
Pastaj, hapëm medrese të bukura, shkolla,
U përpoqëm vende-vende t'u mësojmë shkrim e këndim.
Sot, gjashtë ndër dhjetë tartarë shkruajnë drejt,
Kurse përqindja te rusët është mjaft poshtë.
Pandeh se edhe te ju do të ketë të pasur pak a shumë...
Vetëm se nuk u shkel këmba në dërrasë të kalbur!
Të varfërit tuaj falin namaz kur t'u shkojë ndërmend;
Edhe të pasurit, në mos gjë tjetër, të japin pak zeqat!
Mirëpo, jo vetëm që s'ia venë vëshin kësaj,
Por edhe sadrazemi* pranon fitre në pastë kush t'i japë!

Pastaj të pasurit tanë thanë: "Shkoni e sillni teknologji!"
Dhe, duke i dhënë secilit person s'e di sa mijë rubla,

* Sadrazemi: kryeministri.

Në Europë i dërguan. Dhe, ç'është e drejta,
Bashkëqytetarët e mi, flijues shumë janë treguar.
Shumica e atyre që shkuan, u kthyen seriozisht të mësuar,
Por ja që dolën katër-pesë të poshtër që padrejtësisht
Emrin e mirë të shumicës e morën nëpërkëmbë
Dhe ata që i dërguan, tani sa shumë janë penduar!
Kurrë nuk e harroj që njëri prej tyre, i pasur,
M'i përplasi, më në fund, syve këto fjalë: "Imam,
Dhjetë herë në ditë më erdhët e ju dhashë.
Prapë jap për popullin, mos qofsha burrë!
Veçse këto përpjekje për atë që e meriton të shkojnë,
Ndryshe, atyre që i çuam në Europë i ngjan puna jonë!
Ç'qëndrim mbajnë snobët që po i presim kaq vjet
Duke menduar se kanë për ta përmirësuar gjendjen?
Erdhi një prej tyre mbrëmë e volli marrëzira!
Do ta rrihja, por, sa mirë që pushoi i paedukati.
Një rrugë të vetme shpëtimi paska... Të shohim, hë!
Feja u dashka shkukur me rrënjë
E, pastaj, u dashka bërë si rusët, u dashka rusizuar!
Atëherë puna mbaroka... Atëherë vajzat tona
Do të shpëtokan nga mbulesa trashanike, pa kuptim
Dhe amësinë nga meshkujt paskan për ta mësuar!
Për këtë shkak muslimanët paskan mbetur pas, në mjerim,
Se femrat s'dikan ç'është emancipimi, qenkan robëruar!
Shihe, pra, të poshtrin që do të punojë për popull e për fe:
Fenë do ta shkatërrojë, popullin ka për ta rusizuar!
Këtë e bën edhe Moska! Tani po të dëgjojmë,
Në paç ndonjë aftësi, na e trego, ta marrim vesh, edhe ne!
Shkolloje fëmijën, arsim Europe, të thonë,
Ndaj nga pasuria dhe jep pará me të tepërt
E pastaj shih se sorrë paske mbajtur e ushqyer!
Dhe çfarë sorre, jo ashtu siç ty të shkon ndërmend!
Vetëm një kurvëri kishim mangut, nga rusët e importuam
Po e jetësuam, s'na del kush n'mejdan!



Nderi i sime bije zhytet në sy të rezilit!
Edhe pështyma më dhimbset, për Zot, s'e pështyj dot
Po të më thonin: "Për vajzat duhet shkollë...
Duhet të japësh kaq e aq!" U shofsha në do t'i bëja bisht!
Mjafton që ia varëm këta popullit në qafë...
Unë dua qetësi në varr, të lutem më kupto!
Bëhuni pak të matur, se, ç'do të thotë kjo?
Pse u bëmë të pasur, a duhet të blejmë mallkim?

Ja, pra, n'sa po përpiqeshim e po rropateshim ne,
Një mëngjes, tre të njohur na bënë zë në penxhere:
"Shteti do t'jua bastisë shtypshkronjën, s'ka kohë për të pritë!
Zhdukuni që të gjithë!" Dhe djemtë me një shenjë
U tërhoqën në një vrimë pa lënë gjurmë.
Pastaj më erdhi radha mua e u nisa shpejt
Drejt e për në Turkistan. E eca natë e ditë
Për të gjetur Tashkentin. Dhe kalova vende
Që s'është radha për t'i numëruar tani. Pastaj,
Pasi u zgjata gjer në Buhara, gjer në Samarkand,
U vura të shoh ç'gjëra ka në botën e vjetër.
Mos më pyesni ç'pashë, le të mos flas aspak,
Kujtimi ma trondit maturinë, zemra më pikon gjak!
Ajo Buhara, ajo tokë madhështore, e bekuar,
Deri në fytyrë në poshtërsi kish hyrë, flinte, në kllapi...
Toka që kish lindur me qindra Ibni Sina,
Asnjë fëmijë nuk i jepte më çerdhes së shkencës, ç'shterpësi!
Ai observator mbarëbotëror, ai Samarkandi, bile,
Aq ishte zhytur në bestytني me të shkuarën e tij,
Saqë, për hënën e zënë, mijra gra, burra e fëmijë,
Kishin dalë me daulle duke thirrur: "Ngrihuni
Shejtani ta përzëmë!" Në këtë hapësirë injoranca
Sado e thellë të jetë, dyfytyrësia është më e përhapur
Më për tmerr... Morali në përgjithësi
Do të ishte pak të thuhej "shumë i prishur";

Eshtë tejet i shkatërruar! Kur njeriu sheh fëlliqësinë
 E kurvërisë, lëreni, nuk thuhet, jemi në xhami;
 Dhe diku tjetër po të qemë, s'na lë të flasim turpi!
 Po fanatizmi i tyre? Mos pyet ç'maskarallëk!
 Shih se si hoxha me krahët e hirkës gjer në tokë,
 Në armiqësinë dhe shkatërrimin e fesë së vet s'ka shok!
 Dhe, çfarë të thuash, ta quan se po e shan fenë
 Dhe, çdo gjë që të mendosh për të mirën e popullit, bidat!
 Ndryshimi dhe poshtërimi i shariatit, Zoti na ruajttë, sunnet,
 S'shqetësohen as nga Zoti, as nga Pejgamberi!
 Mendoni se ç'mund të heqë vendi prej këtyre hoxhallarëve
 Pa dituri, prej njerëzve pa tru!
 Sot, ç'është e vërteta, në Buhara ka medrese plot...
 Po ç'merret vesh nga ç'lexohet? Shkencat s'vlejnë,
 Askush s'pyet për to në këtë botë, pa le më në ahiret!
 Letrarë ka plot, kujt t'ia hedhësh sytë, poet!
 Letërsia e atij populli të madh, vërtet
 Në dy tema ngushtuar: ose mashkull, ose femër, krejt...
 Ndjenjat, ende në nivelin e dëshirave të ulta!
 Pastaj, hyrje në kritikë: të gjitha mbushur me mistikë!
 A ka te mistikët, s'e di, rend libertinizmi?
 Pihet dhe bëhen çdo lloj të këqias pa u drojtur aspak!
 Divani i Hafizit, te ta, libër fetvash!
 "Mjafton të mos prekësh kënd dhe bëj ç'qejf të kesh!"
 Rruga e gnostikëve, mrekulli! Edhe lirë, edhe i ëmbël sheqer!
 Megjithatë, te rinia, një përpjekje e vogël ka filluar
 Dhe, sigurisht, do të vijë dita që ka për të ndriçuar.
 E, pikërisht atëherë kjo tokë do të lërohet përsëri
 E do të ushqehen mijra fidanë të tjerë si këta filiza të ri!

 Edhe në Kinë, edhe në Mançuri, feja s'është tjetër veç adet!
 Elementi musliman, mjaft i prapambetur, mjaft injorant!
 Ç'do të thotë, vallë, për ta, përpjekje për t'u lartësuar?
 Dhe sheh të ngrihet me të njëjtin shpërthim nga miliona



Koka, zëri: “Nga të parët kështu e kemi trashëguar!”
Fronin e shpresave ky zë e shemb që në themel.
Mos vallë zakonet dhe traditat epidemi veç në Kinë?
E gjithë bota islame e sëmurë nga kjo sëmundje pa shërim!
Silleni një musliman nga perëndimi i largët
Dhe një tjetër që shtrihet e fle nën murin kinez
Dhe ua ndjeni secilit shpirtin! Pa një pa dy:
“Nga të parët kështu e kemi trashëguar!”- drithshëm do të thotë!
“Kështu e kemi trashëguar” - në fe, e papranuar!
Pse, vallë, fusha e praktikimit, e pakufizuar?
Sepse ne s’e njohim fenë. Po ta njihnim, sigurisht,
Nuk do të tregoheshim kaq të paqartë e të hutuar!
Vetasgjësimi “Nga të parët kështu e kemi trashëguar”
Kjo, sëmundje e një sërë kombesh të prapambetur,
E ne s’marrim mësim dhe këndojmë përmendësh çdo ditë
Pa kërkuar në ato ajete ndonjë qëllim.
Nga Kur’ani, si duket, marrim vetëm trajtën
Sepse askush s’lodhet fare për kuptimin
Ose e hapim dhe shikojmë në faqet e Kur’anit,
Ose e përdorim për ta fryrë dheun e një të vdekuri.
Nuk ka zbritur Kur’ani, këtë ta dini me të vërtetë,
As për të parë fall, as për t’u kënduar në varrezë!
Këta të kësaj zone kanë mbetur mbrapa në fe,
E këndojnë Kur’anin si të ishte kinezçe!
Të gjitha zakonet, të ngjashme me zoroastrianë!
Një shehadet thonë dhe që s’i bie në fije!
Por të gjithë ua kujtojnë me respekt namin tuaj:
S’mund ta harroj se si një vajzë kineze m’u mblodh pas hirkës
Dhe më tha shumë gjëra që s’i kuptova dhe pastaj
Qau e pashpresë... Kurse, e shkreta
Më paska pyetur për sulltanin: “Si është?”
Po të kish qenë afër, do të kish dashur të vijë!

Tani pyetja juaj, këta japonezët ç'milet janë?
 S'arrij dot t'i pëshkruaj: një çudi! Vetëm kaq
 Po ju them: atje, fryma e begatshme e fesë sonë
 Është e përhapur në çdo anë, vetëmse, formën budizëm e ka!
 Ju shkoni dhe çiltërsinë islame te japonezët keni për ta parë!
 Ai individi shtatshkurtër i atij kombi të madh sot
 Në mbrojtjen e përsosmërisë muslimane, s'i gjen shok!
 Vetëm besimi në një Zot i mungon për t'u quajtur musliman!
 Ndershmëri, besë, besnikëri, dhembshuri,
 Përpyetje e sinqertë, të drejtën e të dobëtisë për ta mbajtur lart.
 Kënaqje me gjënë më të vogël; edhe kur është mundësia
 Për të dhënë me shumicë, nuk bëhet tepri.
 Askush s'ia vë syrin nderit të tjetrit,
 Gjer në shtatë breza, fis, motër e vëlla!
 Kur duhet vdekur, qëndresë burrërore;
 E lë jetën duke qeshur, sikur po bën shaka!
 Dëshirat vetiake nuk i bëjnë fjalë,
 Për interesin e përgjithshëm flijohet interesi personal!
 Sa gjëra të rralla si këto pashë atje,
 Një ishull i pasur me pasardhësin më të pastër të njeriut!
 Qytetërimi vetëm me teknologji kish mundur të hyjë...
 Dhe ajo, me lejen e posaçme të të zotërve.
 Vendosur në breg mijra vizionarë, mijra vigjilentë,
 Të gjitha poshtërsitë të nxjerra për dere jashtë!
 Produktet perëndimore ecin po qe se kanë vlerë,
 E keqja e ardhur si modë, kalbet në doganë!
 Shtëpitë hapur natë e ditë, dyert pa mandall,
 Pasuria e çdokujt, sheshit, nuk njihet hajdut;
 Atë thjeshtësi njeriu s'e gjen dot në asnjë vend...
 Mos ka "Togo"-ja sjellje mburravece? Ku!
 "Le të shkojmë!" - thotë e të çon, pastaj të vjen pranë
 E të hedh çaj sërish, kur e sheh bosh, në filxhan.
 Mendoj se muslimanllëku do të shkëlqejë atje,
 Vetëm se duhet, në këtë mes, zelli i osmanlije!



Misionarët natë e ditë vendit i bien anembanë;
Dijetarët tanë, frymëzimin hyjnor mos po presin, ku janë?
Indinë fund e krye ta shëtisja që qëllimi im,
Por, për shkak të ndjekjes së policisë kudo që të jem,
Më la fuqia dhe u detyrova të heq dorë!
Megjithëkëtë, u futa pak a shumë në çdo mjedis.
Ushqekësh, pastë bereqet, ajo klimë e hershme,
Me titullin “Rahmetullah”, të njëvlefshëm qindra të urtë ende;
Dhe gjeta dijetarë që shpirtin e feve e shohin, urtinë e Kur’anit e dinë
Dijetarë, para të cilëve sot, Perëndimi përkulet me nderim!
Sidomos njeriu para të rinjve që përgatiten bën çudi,
Një pjesë e madhe e tyre mësojnë në Angli.
Pastaj, fetarët janë njerëz me zemër, me shpirt:
Po që se vendosmëria u sjell vdekjen, s’kthehen, ecin drejt.
Nuk dinë, nuk kanë dëshirë si majmunë të imitojnë,
Ndjenjën kombëtare e kanë të shëndoshë, nuk e pakësojnë.
Në marrçin prej Perëndimit gjë, marrin vetëm diturinë,
Duart i kanë gjithë art, por pa thonj!
S’kanë kurvëri, pije, syrin e kanë të ngopur, zellin, të lartë,
Respektin për të sheriatin e pastër, më të lartë se ne!
E ardhmja e një kombi që pajis me arsim bij të tillë,
Ka të drejtë ta fitojë pavarësinë!
Dhe në mos nesër, një ditë do të ndodhë, pa dyshim...
Ç’bëhet po të vonojë? Mjafton që ka një të ardhme në synim!

Mikpritësi që erdhi të më përcjellë duke u nisur
Për në Hajdarabad, sa i hidhur i doli nga zemra ky zë:
“Ah, ne nuk jemi besimtarë që vlejme për dobi...
Islamin e Indisë mos e krahasoni shumë me atë të Turqisë.
Ata kanë gjak që vlon me shpirt mbretëror,
Kurse te ne s’e gjen të tillë fisnikëri të sinqertë, këtë damar.
Me këtë poshtërim, gjer në jetën tjetër jemi të dënuar...
Sepse shumica jonë disfatat nuk i ndjen!

Në paçim shpresë, te madhështi e osmanlijeve e shikojmë;
Sikur të dëgjonim një herë për të... Kjo lumturi na mjafton!”

Më bëri të qaj njeriu. Por biri i ri i tij tha: “S’është ashtu!
Zemra e popullit është plot gatishmëri për t’u ngritur,
Zemër atdhedashëse për atdheun për t’u flijuar!
Vetëm se ende veten s’ka për ta treguar.
I kalon tani ditët pothuaj në robëri
Si muslimanët me të kaluar të shquar;
Unë s’mund t’i dënoj me poshtërim të amshuar!
A mos jemi më të pashpresë se zoroastritët?
Do të thuash që jeta e ulët shekullore
E shuan, më në fund, prirjen ndaj ndjenjave të larta.
Jo! T’i mbyllësh sytë s’do të thotë se je verbuar,
Prushi, sado të rrijë nën hi, është zor për t’u shuar! Hape, trazoje pak!
Arsimimi në Angli këtë më mësoi mua:
Në pastë një shkak që vendi e populli të bjenë
Në të tillë mjerim, elitat në indiferencë të jenë...
Ndryshe, ky element i zgjuar i Lindjes merr çdo begati.
Ç’ka për ta drejtuar një popull në natyrën e fesë
Një popull që është në fenë me cilësi sipërore
Si islami që me një frymë ndërgjegjet i ngre peshë
Në një fe të tillë të natyrshme, ç’gjë i del para udhëzimit?
A mos janë më të larta e më të afta natyrat që Lindjen
E shtypin? Me këtë gjë unë kurrë nuk mund të pajtohem!
Për ta shtruar një popull në rrugë të mbarë, duhet burrë!
Kjo është rruga e drejtë! Eja, dil ti para dhe ec,
Atëherë ke për të parë pas teje sa shumë kanë për të vrapsuar!
Në fillim në tru një mendim i qartë i duhet shartuar!
Në gjoksin e çdo muslimani që veshin ta kem vënë,
Vetëm zemrën të rrahë ia kam dëgjuar,
Një zemër që rreh me ndjenjat më të pastra
Të një fëmije të shtruar!



Gjokset le të vazhdojnë ta nxjerrin zemërimin, ta shfryjnë,
Por, kur të vijë koha, i sheh se ç'zemra kanë!"

Arrita në Hajdarabad kur gjithë India u lëkund:
"Sulltani e dha Kushtetutën më në fund!"
Beso, a është e mundur? Ndërsa ato mijra mendime
Ma gërryenin shpirtin, një "ndoshta" e brishtë
Si t'i dëbojë të gjitha kaq lehtë?
Dhe më nisi në tru një luftë shprese, deprimimi
Që s'e kisha provuar kurrë që në lindje...
Ç'dridhje të tmerrshme, ç'emocion aman, o Zot,
Më shkaktoi Kushtetuta... Kjo, një ëndërr e vërtetuar?
Jo, s'është ashtu! Lutja e popullit ka marrë përnjëherë
Formë kërcënimi dhe ai ka mbetur i detyruar...
Po cili popull, vallë? Çfarëdo që të dëgjosh, e gabuar.
Sapo populli u ngrit i gjithi peshë njëlloj,
Pashë në zhvillimin e ngjarjeve të fshehur dorën hyjnore!
Ç'punë mbreti kjo, o Zot, e ç'ushtrie fitore;
Kjo, enigma e shpërthimit të fuqisë Tënde hyjnore!
Bëje të qeshë, më në fund, birin e paqeshur të vendit tim...
Dhe qava, pastaj, si fëmijët, me ngashërim...
Shpirti pakëz m'u qetësua, nervat gjetën pushim
Dhe pashë se u ndryshua gjendja e rrugës sime menjëherë:
Për të vajtur një ditë e më parë në mesin tuaj
U nisa drejt bregut, dola në det të hapur në udhëtim.

N'sa gjemia në hapësirë, dhe përfytyrimi im hapësirave shtrirë;
Një gjendje si e sofiut që ujë parajse ka pirë.
Vatërsheburi q'e kalon jetën mjerisht në xhehennem,
T'ia japin xhennetin, nuk heq ndëshkim si i hutuar...
Edhe unë, errësirat në shpirtin tim më në fund i përzura.
Armikun më të madh, pesimizmin, e ngulfata
Varka ende u lëkundka ende në oqean
Më hodhi përfytyrimi mua në brigjet e Marmarasë!

E shihja nga dy-tri milje larg duke e parë
 Stambollin tuaj të zi, se bora më të bardhë!
 I shkëlqen balli nga larg si hëna pesëmbëdhjetë;
 Dhe qeshet. Nga hijeshia e tij pasionohen të gjitha bukuritë.
 S'ka vend tani për atë poshtërim e mjerim? Ah!
 Kjo, ç'madhështi, oh, ç'pamje e shkëlqyer!
 Janë hapur shkolla pa numërim, femra e meshkuj mësojnë,
 Fabrikat punojnë, basma e stofra vendi prodhojnë;
 Shtypshkronjat pothuaj si një shërbëtor që s'di të flerë,
 Shtypin ditë e natë për popullin libra me vlerë.
 Ndërmarrje që do ta rregullojnë vendin skaj më skaj,
 Shoqëri të reja në shërbim të popullit që të kuptojë:
 Gjejnë punë, udhëzojnë, përpiqen e s'rrinë...
 Gjemitë bartin tërë bregut mall e shpjenë...

N'sa shihja këto ëndrra mbi rrogoz i nderë,
 Dy të mallkuar nën sy, erdha në vete menjëherë:
 Është një rus armik muslimani, e njoh kaheër...
 Kudo që ta shoh, iki, se është një mushkë shqelmuese, ogurzezë;
 Sidomos kur përmendet nami i osmanëve, bëhet i marrë,
 S'duron as shalë t'i vësh në shpinë, as samar!
 Kur ndodhesha në Rusi, sa më shihte, vinte e më thoshte:
 "Imam, lexoje ti, po s'pate punë, i sëmuri juaj vdiq!
 Dhe, nuk i del trashëgimtar legjitim veç nesh..."
 Sa herë më pati bërë të qaj kjo shaka prej dose!
 Prapë, qeshë detyruar ta kaloj duke thënë "la havle..."*
 Sepse qenë gjithato plane që mund të ktheheshin përmbys...
 Ja, pra, në ato çaste përfytyrimi të gjallë,
 A s'më shfaqet ai moskofi i ndyrë përballë?
 Po të mos isha zgjuar e me sy hapur, do të thosha: makth...
 S'e kuptoj se nga më mbiu ky spiun-djall?
 I ngulur mbi dy këmbët, në thellësi të syve më sheh,
 Më sheh dhe si, me ato sy si rrufe!

* Teksti i plotë: *La havle ve la kuvvete il'la bil'lah*, "Fuqia dhe forca janë të posaçme vetëm për Allahun!"



- Zotni, eja, pa të shohim, mos u ngul ashtu, pi çaj,
I sëmuri u ngjall, ç'thua ti? Këtë s'e shpresoje, apo jo...
E pe atë popull-hero? Një të shkundur bëri
Dhe zërat e sorrave që hanë ngordhësira, heshtën aty për aty!
Rusët, ëndrrat e tyre të vjetra,
Le t'i harrojnë po të kenë mundësi...
- Ç'the? S'e kuptova! Hej, ti, tatar që sheh ëndrra me sy hapur!
"Popull-hero"! A për turqit po më flet ti?
Po të të them ty, tani, ç'mendoj,
Endrrës tënde i jep lamtumirë përgjithmonë!
- Po ti, a mos prej votkaxhinjve të tu pret dobi?
- "I sëmuri u ngjall" po më thua, "mbaroi"! Mjerë ti!
S'mund të ketë për një popull të tillë të ulët
Të drejtë për të jetuar. Thirrja e lirisë, fryma e tij e fundit!
Të jesh i sigurtë se nuk jeton dot kjo çetë barbarësh
Në mëngën e Europës së kultuar;
Ndoshta në Azi, në Arabinë plot rërë
Ka vend për t'u groposur për një shtet cofëtirë...

E kuptoja se njeriu do të plaste nga marazi.
Meqë s'ishte rasti i përshtatshëm për shpagim,
Nisa ta kuptoj plagën e hasmit dhe ta trazoj.
Por, me të nisur kjo përplasje mes nesh, një afganas
Na përgjoka ne si skifter. Vërtet ne folëm rusisht,
Por prapë mistreci, mënyrës së fjalëve u kushtoka kujdes.
Dhe ç'bëri? I përmbysi menjëherë tërë samovarët e çajit
Dhe ia zu grykën rusit! Aman, të lutem, lëre!
Pa thënë, e lagu hutaqin si shi!
Por s'doli kush që të ankohej, sa çudi!
Dhe po të kish dalë, çfarë? Siç e dini, e drejta është tekanjoze,
Të rrahurin e përzënë nga gjyqi se s'ka fuqi!

Erdha në Stamboll; gjithë tregu vlon nga thirrjet:
Ka liri apo jo? Kur ardhka në qejf njeriu,

Gjykimi u tërhiqka pas; e drejtë:
 Kë të kem parë atë ditë, po hiqte keq për mend.
 Kuptohej se askush s'i binte në të se ç'po bënte!
 Kokat me fantazira në tym, sytë, të nxehtë!
 Sikur të lidhurit me zinxhirë në çmendinë, ishin zgjidhur,
 Kishin shembur çmendinën e kishin dalë jashtë përnjëmend!
 Zurnatë e kishin bërë popullin e qytetit t'u shkonte pas:
 Nga shtatëvjeçari zëre në të shtatëdhjetë!
 Turma me flamuj me katër tufa ecin e marshojnë,
 Edhe burrave më seriozë veç kumbonat në qafë u mungojnë!
 Ia thotë mbi çdo gur një dudur,
 Dëgjojnë tek kanë rrethuar gjithkahjen qindra kokëtrashë!
 Kushdo që të thotë diçka, duartrokitje në çast...
 - Rroftë!

- Kush rroftë?

- Ai që është gjallë.

- Trak, trak, trak!

As në zyra qeveri, as në popull punë, prokopi!
 As industri, as arsim-kulturë, as allishverish, tregti.
 Qyteti si të ish pishnajë e Çamllëbelit: roje s'ka, ligj s'ka;
 Nëse rrjedh gjak, rrjedh si lumë, mjet për ta ndaluar s'ka.
 Shkollat janë mbyllur krejt që shkollarët ta kuptojnë më mirë
 Se ç'është kënaqësia e të qenit i lirë!
 Dituria jepet me forcë, edhe kjo është despotizëm...
 Meqë qenka kështu, ejani fëmijë, përgjithmonë pushim!..
 U ka ardhur goja profesorëve, në njëren anë,
 Vrapojnë nga skena në skenë stazhierë nga janë e s'janë.
 Siç plas çibani qorr nën bisturi,
 Të gjitha gojët të çapluara, ç'xhevahir të ketë te çdo njeri,
 E derdhin jashtë, e pastër qoftë a fëlliqësi,
 S'mbetet më gjë e fshehtë te asnjë njeri!
 S'është periudhë dallkaukllëku kjo, çdo gjë hapur duhet thënë:
 Shkrimtarë e poetë, në vend që të shkruajnë kaside,
 E shajnë njëri-tjetrin me nënë...



Gazetat që dalin me turli titujsh, pa numërim,
Hedhin nëpër atdhe farën e përçarjes pa ndalim.
Duke e parë tokën mjaft pjellore për të rritur qen,
Një tufë qensh që bredhin të lirë, mbjellin kurvëri.
E sulmojnë fenë pesë-dhjetë maskarenj, duartrokiten,
Kurse brezi i ri e pandeh këtë në ndërgjegje liri!
Femra e meshkuj vrapojnë duke ia ditur për borxh Europës...
Më duket se bukuritë e tua po mbeten në bisht, Azi!
Tri vajzat e rritura në saje të Zotit dhe kunatën
Paska të tillë që, për t'i hequr qafe, i çokan në Paris
Për të mësuar amësinë... Peshë e rëndë,
Po edhe shpërblimi po kaq i madh duhet të jetë!..
Pa dyshim, m'i shembën ëndrrat ato ç'pashë...
Mirëpo unë, për një farë kohe, e mora veten me të mirë:
Eufori është... Kur vjen euforia, s'mbetet logjikë...
Po s'u turbullua, uji nuk kullohet, duro edhe pak...
Mirëpo, sado të durosh, punët shkojnë më keq se më parë,
Ku ka përmirësim! Vendi s'ka më fuqi për t'u ripërtërirë,
Shih se si shkojmë drejt asgjësimit me vrap e me dëshirë!
O njerëz, mjaft fjetët, zgjohuni tani,
Për këtë vatan, asgjë nuk ndjeni?
Dijuani vlerën lirisë e pavarësisë
Pa rënë nën thonjtë e ardhmërisë.
Duke e bërë fjalë robërinë e tyre nën një tjetër robëri...
Mësojani vlerën pushtetit se ç'është ai.
Ndryshe, pa të as kjo botë i mbetet islamit, as fe...
E pushton popullin e dënuar disfata e caktuar.
Ndërsa islami ju duhet për t'ju mbajtur të lidhur bashkë
Mjaft ngushtë, mjaft shëndoshë,
S'e kuptova, s'mundem ta kuptoj
Se si ju hyri në tru ndjenja për t'u ndarë e copëtuar.
A djalli jua shtiu në mendje idenë e kombësisë?
Ideja e kombësisë është tërmeti që do ta shembë nga themelet
Islamit që i mban të bashkuar në një bashkësi

Kaq shumë kombësi të dalluar nga njëri-tjetri.
Harrimi i kësaj dhe për një çast, është humbje për jetë!
Me shqiptarizëm, me arabizëm ky popull nuk ecën dot,
Edhe politika e fundit e quajtur “turqizëm” është kot...
Si një familje, Krijuesi ju ka krijuar,
Fshini, atëherë, shkaqet që ju ndajnë, për t’u veçuar
Sa i keni punët kështu, Zoti na ruajttë,
Të huajtë kanë për t’u bërë të zot të vendit pa u vonuar...
Sado të thonë etërit, “Kalaja merret nga brenda”,
Askush s’ua vë veshin, populli i ndjerë, i shurdhuar!
Jo vetëm një shtet islam është shkatërruar,
Të gjithë, për shkak të të njëjtës politikë hynë në varr.
Nuk hyn dushmani në një komb pa hyrë përçarja më parë,
S’e shpon dot topi nëse zemrat rrahin së bashku në një herë!
Lërimi qeveritë e vjetra! Këto që janë në shesh
Shpëtojnë, nëse ka njerëz që shohin e nxjerrin mësim.
Ja, shkuan Maroku, Tunizia, Algjeria,
Ja dhe Iranin duan tani ta copëtojnë...
Dhe ky është, mjaft natyrisht, mejdani i atij që vrapon,
Krijuesi, të drejtën për të jetuar, të fortit ia ka dhënë.
Muslimanët, një popull të ndarë e të copëtuar,
A s’i gëlltit dot në tri kafshata Europa e qytetëruar?
O njerëz, mjaft më në emër të Zotit, zgjohuni,
Ndryshe, kambanat në vesh kanë për t’ju tingëlluar...
Duke u shembur, Irani tokën nga vendi e tronditi,
Tek ju nuk lëviz qimja! Ç’gjak është ky?
A s’ndiheni aspak prej Pejgamberit të shqetësuar?
Kurse ai, nëse një besimtar kudo qoftë e shpoka gjembi,
Ndjeka dhimbje në zemrën e pastër nga ajo një e shpuar!
Sigurisht, shpirti i Profetit ka për t’ju akuzuar.
O njerëz, zgjohuni! Ndryshe, dielli në çast ka për të perënduar!
Zgjohuni! Kam frikë, do t’ia behë nata për t’u penduar.
As trena e vaporë nuk ju zgjuan,
As topat s’i bënë dot gjë këtij gjumi të thellë!



Kush ka për t'ju zgjuar, briri i Israfilit ju?
Mos, ... Gjendja e vatanit u keqësua... Ejani!
Për hir të Zotit, ejani se koha është e turbulluar,
Pasperdeja, Zoti e di, është e përgjakur...
Ju që jeni shkëndia-shpresë e fundit e islamit,
Qëndrojeni dhunës dhe hovit të popujve të qytetëruar!
Tani për tani, shkaku i paqes është fuqia e ushtrisë suaj
Si dhe vlera e pozitës strategjike të vendit tuaj,
Me këtë pavendosmëri, edhe kjo fuqi që keni do t'ju lëkundet
Për t'i shtypur kryengritjet, njerëz me detyrë ka...
Meqë ushtria përbëhet nga bijtë e popullit,
Nga përçarja mes popullit ajo si mund të mbetet e veçuar?
Ashtu është! Po s'u rregullua gjendja e vendit,
Garnizonet bëhen shtëpi dhe ushtarët, civilë të thjeshtë!
Le të përmbysë, pastaj, kazan, ushtria, le të rebelohet po të dojë,
Radhët dushmanit të bëra një, e shkelin këtë vend të bekuar.
Atdhe profetësh ky dhé, yjësi dëshmorësh ky vend,
Edhe mbi një tyrbe të shembur lëshon mëshirën Perëndia!
Faqja e këtij atdheu, nga skaji në skaj, kujtim i një brezi bujar;
Nga brenda, miliona trupa dëshmorësh gjerë e gjatë!
Aq i ngopur me gjak dëshmorësh ky dhé bonjak,
Sa, po t'i shtrydhësh barërat, do të gufojnë gjak!
Një vend të tillë që e lëshon dore brezi i mjeruar,
Mbi dhé i nëpërkëmbur mbetet, nën dhé, i poshtëruar!
Po ju iku ky vatan, vatan tjetër për ju më s'ka,
Sepse lypsari nëpërkëmbës i trashëgimisë përzehet nga çdo derë!
Të parët nomadë që ngritën themelet e një shteti të madh,
A të ngrihen e t'ju shohin të mbetur gabelë të mjeruar?
"Si gabelë" - po them... Kam frikë më të shkatërruar...
Po qe se, na ruajttë Zoti, përmbysset mbretëria,
Pamja do të bëhet aq e shëmtuar,
Sa përfytyrimi i saj, bile, për ndërgjegjet, fytyrë e turpëruar!
Duhet ditur pak vlera e pavarësisë,
Shiheni fytyrën keqndjellëse të humbjes dhe dërrmimit:

Sikur toka është çarë e hapur vende-vende,
 Mijra ushtri të mjerësh, pjesëtarët, të gjitha familjet.
 Të gjithë të uritur, pa asnjë lek, të zhveshur burra e gra;
 Sheshi i sokakut, shtëpi; shpina e kalldrëmit, shtrat.
 Qindra qen kalojnë aty pari e shkelin mbi ta,
 Margaritarin e nderit të nxjerrë në shitje e kërkon: do të nxjerrë
 fitim!
 Po s'pate punë, një mesxhid për t'u falur kërko..
 Disa xhami, tashmë goxha opera;
 Njërës i kanë varur në gjoks një kryq, tjetrës në qafë, kambanë,
 Një tjetër, për të dhënë ballo, mejdan!
 Banda ekzekuton në minberin aty para meje,
 Në mermerin ku ju keni vënë kokën në sexhde.
 Një turmë e fëlliqur meshkujsh e femrash dansojnë,
 Gjestet dhe gajasjet e bëjnë kubënë të jehojë!
 Avllia mbushur fund e krye me mijra lypsarë
 Pushtetarët e mëhershëm e kanë zënë rrugën
 Dhe u shtrijnë duart të zotërve të rinj që kanë ardhë!*

.....

Kjo e qara juaj i përngjau një të qare tjetër:
 Ndërsa fatziu që iu muar kurora e Andaluzisë nga dora,
 Përvidhet, ia lë të huajit atë vend të bukur,
 Hip mbi një shkëmb dhe sheh përreth.
 Fushat smerald si parajsë që i la e iku,
 E bëjnë të qajë të pashpresin me ngashërim.
 Nga përballë, nëna mbretëreshë e sheh, i jep të drejtë
 Dhe i thotë: "S'u përleshe me dushmanët si burrë,
 Tani, të paktën, qaj si gratë!"

* Xhemati duke i dëgjuar këto fjalë filloi të qajë në zë, ndërsa xhamia mori pamje kiameti. Në një gjendje të tillë fjalët e ligjëruesit s'dëgjoheshin mirë, kështu që ai u detyrua që për rreth dhjetë minuta ta ndërpriste fjalimin.



Lëreni zinë, more, mos klithni kot!
Po të kish dobi e qara, do të ngrihej im atë!
Ç'del nga lotët? Pse nuk derdhët djersë?
Të paktën përpiquni të ardhmen ta shpëtoni!
Ai që ka një grimcë besim, s'e humb shpresën asnjëherë,
Ju gjejeni dertin, pastaj dermani është i lehtë!

Te ju, mes mendimtarëve dhe popullit ka një të çarë; Ja, pra, kjo ë!
Po qe se mendimtarët i quajmë tru,
Duhet ta dimë se populli është trup.
Nëse një bashkësi, në trutë e së cilës vërtiten ndjenjat,
Nuk lidhet me nervat e trupit, harmonia jetësore ndalon;
Organet nisin të tregojnë shenja paralize.
Një trup i tillë, çdo urdhri që i jepet, i nënshtrohet.
Ata që e quajnë veten mendimtarë, shihni se ç'ju thonë:
"Ngjitja, përgjithësisht, e Lindjes drejt qytetërimit
Është e mundur duke ndjekur vetëm një rrugë;
Kush përgjon shpëtim në rrugë të tjera, nuk kupton.
Shihni në ç'truall ka ecur europiani
Dhe ecni pa u shmangur as në të majtë, as në të djathtë.
Trutë e Lindjes duhet të përvetësojnë idetë e Perëndimit;
Ndjenjat duhet të dalin gjithë nga i njëjti kallëp,
Domethënë, po qe se nuk e imitojmë Perëndimin
Në shoqëri, në letërsi, shkurt në çdo çështje,
Çdo gjë që të themi, do të jetë punë boshe!
Gjithashtu, t'i braktisim rregullat fetare sepse
Kjo e keqe na i bëhet pengesë gjithë përparimit ende!"

Të vijmë, tani, te ndjenja e popullit nga rreh:
Pa dyshim, krejt e kundërta e kësaj:
E nënshtuar zakonisht, siç thotë ajo,
Armike ndaj çdo ideje dhe veprë të Perëndimit.
Edhe me shpallje hyjnore të vinte e reja, s'duhet pranuar;
Lërimi reformat e ardhura prej jashtë,

Armik dhe ndaj të resë vendase dhe të drejtë
 Të lindur në hapësirën e kombit të vet!
 Ja, kjo është ndjenja e përbashkët e popullit te ju!

Në gjurmët e gabuara që zunë mendimtarët tuaj,
 Aq batisën, saqë s'ia varën tjetërkujt.
 Morën udhën pa kthyer kokën mbrapa fare,
 Duke e shpërfillur mendimin e popullit
 Që është opinion publik
 Të ecë përpara, si ka mundësi?
 Duke u zgjeruar, gjithnjë e më shumë
 Hendeku mes dy pjesëve, erdhi, shumë natyrisht,
 Radha e përplasjes. Me zbritjen nga "truri" të dhunës si rrufe,
 Nga "zemra" shpërtheu urrejtja si vullkan.
 Një armiqësi e tillë që çdo fjalë e shtresës mendimtare
 Zuri t'i vijë popullit, më në fund, e keqe, e papranuar
 Dhe u bë zakon i përhershëm për të bërë të kundërtën e saj.
 Një fatkeqësi kjo siç ka marrë... Por më e keqja,
 Për shkak të teprimeve të shtresës mendimtare,
 Mendimi i përgjithshëm u bë pandehmë dërrmuese:
 "Kreu i kësaj të keqeje, nga mësimi i shkencave!"
 Dhe u ngritën këtë ta shkatërrojnë kësaj radhe!
 Pse nuk ndihet emri i shkencës në gjithë këtë popull sot?
 Sepse mendimi i përgjithshëm është kundër dijes;
 Sepse në vendet ku shkenca shëtiti për të gjetur shtrat,
 Në fillim kërkon mjaft respekt, pastaj stabilitet.
 A ka mes jush qoftë edhe një njeri të përgatitur
 Që t'i thuhet se i zotëron shkencat e kohës?
 Edhe vlera e tre vetëve të njohur për shkencëtarë,
 Kuptimi i cekët, dëgjim dhe imitim.
 Kush arriti me punën e vet një synim të caktuar?
 Tregoni dikënd të jetë shquar në kërkim!
 Sa keq për jetën e kaluar mbytur në teorizim.
 Tashmë vlera e shkencës është vlerë praktike.



Por kush i lexon këto të vërteta, veshin kush ua vë?
Të gjithë snobët që përdridhen, ngulisin pesë-dhjetë fjalë
Dhe mendojnë: “Si ta shembim fenë me këto?”
Për një qëllim të tillë, dhe shkolla e mesme është shumë!

Letrarët tuaj, sidomos, qenie mjaft të ulta...
A këta kanë për ta edukuar dhe drejtuar popullin? Vaj, vaj!
Njëri, siç e dini, agjent tregtar i kurvërisë së Perëndimit;
Një tjetër, thotë “mall Irani”, merr demode e shet vjetërsira!
Përmbledhjet e divanit, plot e përplot homoseksualë e verë,
Poezia për të rinj, tjetër ç’është veç birrë e kurvëri?
Endacakë: askush s’ka profesion, as botëvështrim;
Të gjithë filozofë, por shumica s’kanë as shkollë!
Tani shan Allahun... Pastaj, jepi pak pará,
Protestanëve u bëhet kambanar!
Edhe Rusia, madje, hasmi im më i përjetshëm,
Të mos ia hamë hakun, s’është aspak e tillë!
Shkencëtarët e saj ngjiten gjer në zbulues;
Kur përmendet letërsia ruse, tundet vendi!
Po të kem fuqi, shtatëmbëdhjetë vjeç e lart
Sa letrarë të ketë, i hedh nga kufiri jashtë
Duke ua varur në qafë inventarin e veprës së vet;
Kush e lexon etiketën, sigurisht s’nxjerr zë e s’flet.
Pastaj gjej një mënyrë zëvendësimi, vërtetë të çuditshme:
Sjell me kontratë nga Rusia dhjetë-pesëmbëdhjetë letrarë
Dhe i vë të shkruajnë për popullin vepra me vlerë...
Ndoshta diskutimin e ndërruan këto fjalë plot mërzi...
Ku e patëm lënë? Po, në mes: një humnerë e ndyrë
Që bëhet më e tmerrshme ditë për ditë; s’e di,
Kam frikë se, po s’u mbyll ky jaz dhe po s’gjetëm njëmendësi
Do të bëhet një varr i përgjakur për popullin e mjerë.
Gjithashtu, përgjegjësia për atë disfatë të përjetshme
Sigurisht mbi mendimtarët do të bjerë!
Nëse populli mbetet kokë më vete e hutohet, kurrë

S'mund ta gjejë vetë udhën sepse, siç ndodh përherë,
 Ecën vetëm nëse beson që udha e treguar është për ta ndjekur,
 Ndjenja gjithmonë është udhërrëfyes në të përpjekur!
 Mendimtarët tuaj s'e kuptojnë, më duket,
 Se çdo hap i hedhur në fushën e përparimit,
 Ndryshon krejtësisht sipas popullit, sipas bashkësisë;
 Prandaj, shpesh herë, ecja në gjurmët e një populli tjetër
 Pothuaj bëhet vetëvrasëse; pastaj pse? Çdo popull
 Ndjek në ecurinë e zhvillimit një tjetër drejtim.
 Gjithashtu, nuk u kujtohet se përgjithësisht
 Rruga për n'majën që e synojmë gjithnjë e pa ndalim
 S'është e sistemuar njëjtë për të gjithë popujt që dalin n'vrapim
 Ndoshta, për çdo popull ajo përcaktohet nga "natyra e tij"
 Që lind e shpëputet nga shpirti i popullit.
 E tani, grupi shoqëror që e merr veten për elitarë,
 Së pari e përcakton se cila është "natyra e atij populli",
 Pastaj, duke i ndriçuar etapat zhvillimore,
 Duke dalë në krye, fenerin hyjnor mban për dore;
 Atëherë edhe bashkësia do ta ndjekë pas duke shkuar para
 Se është shpirti i vet që do ta kapë për dore;
 Udhëtari s'është hutaq që të ndalojë, do të ecë pa ndalim!

Mendimtarët tuaj edhe fenë aspak s'e kanë kuptuar;
 Konsiderata e tyre për shpirtin e islamit, mjaft e gabuar.
 Pandehin se islami nuk lejon dot përparim;
 Se nuk i kapën dot të arriturat e kohës.
 S'e dinë se islami është mëndesha e paraqenë e diturive,
 Hiseja që do të arrijë një ditë njerëzimi duke u lartësuar.
 Përmbahet në gjoksin e tij të dëlirë gjithë njerëzimi...
 Ata që janë të matur sadopak, këtë e pranojnë.
 Elementi musliman është mjaft i prapambetur tani,
 E drejtë; por, megjithëkëtë, nuk është barrierë për më tej.
 Po ta kërkojmë shpirtin hyjnor të quajtur islam,
 Sa larg që është prej turmave që thonë "jam musliman"!



Po deshëm ta analizojmë fenë, le të kthehemi pas
E ta analizojmë një periudhë nga të parat e Islamit:
Ç'përparim mbresëlënës, ç'shpejtësi marramendëse!
A ka treguar ndonjëherë njerëzimi një të tillë mrekulli?
Si ndodhi që një turmë e egër njerëzish
E mbetur për shekuj me radhë në periudhën pa profet,
E kredhur në thellësitë e mendjetrashësisë, e egërsisë,
Duke e groposur të gjallë të bijën në rërat e shkretëtirës
Duke ndjerë kënaqësi në vend të pendesës;
Që gurin e sjellë nga mali e të gdhendur pastaj
E quante zot; kjo turmë barbarësh, pra,
Me një përparim tridhjetëmijëvjeçar në tridhjetë vjet
U bë sundues kontinent mbi kontinent?
Si ndodhi që ai qytetërim ideal, ajo përsosmëri
Të lindte mes një fisi të tillë menjëherë?
Si ndodhi që të shfaqet një Siddik,*
Nga erdhi te Hajdari** ajo njohje shpirtërore e thellë?
Duke qenë një grindavec, si ndodhi që Omeri
Të përqafojë pastaj një drejtësi të pamundur për njeri?
Po të qe sheriati kuptimplotë pengesë për përparim,
Thua shekulli i zgjedhur periudhës së lumturisë,
Do të mund të shfaqej si një qytetërimin kaq i madh?
Po të mos përmbahej në shpirtin e tij një përparim i patëmetë,
Nga do të kishin lindur aq mrekulli?

Kuptohet, mendimtarët tuaj, shumë frikacakë
Ose mendjetrashë... S'e di, cila nga këto është e saktë?
Pandehin se "Europa është krejt qafir.
Po u dukëm fetarë, do të na thonë barbarë!
Ndoshta ndryshon mendimi po u përshkuam liberalë!"

Lindjen cep më cep për vite e shëtita, e përshkova
Dhe pushë me përthellim, gjithandej kot nuk brodha

* Ebu Bekri, halifi i parë i islamit.

** Aliu, halifi i katërt i islamit

Nuk thashë ky është arab, ky tartar, ky persian,
 E pashë vetë, të gjithë elementin musliman.
 Shpirtin e njerëzve të vegjël e shqyrtova,
 Mendimin e njerëzve të mëdhenj e thellova.
 Desha, pastaj, përse japonezët kaq lart ta mësoj,
 Cili është shkaku i përparimit nga afër ta shikoj.
 Dhe kjo përpjekje e gjatë, ky udhëtim i gjatë
 Do t'më jepkësh mua një opinion për këtë botë:

Të fshehtën e përparimit ju

Mos kini pasion në vende të tjera ta kërkon!
 Një popull e gjen atë në vetvete dhe ngjitet lart
 Sepse në çdo pikë imitimi lëvizje nuk jep.
 Merrni nga Perëndimi dijen, artin e tij
 Dhe jepini përpjekjes suaj më të madhen shpejtësi.
 Sot, më në fund, s'mundet të jetosh pa këto,
 Sepse arti, dituria, shkenca nuk kanë kombësi!
 Vetëm nguleni mirë në tru ç'ju thashë ca më parë:
 Për të çarë me gjithçka në rrugën e përparimit,
 Udhëzues të keni " natyrën tuaj shpirtërore",
 Se pa të, shpresa për shpëtim është e kotë!

Pastaj, është diçka që e vlen të kihet kujdes:
 Mendimtarët e një kombi, zhvillimin e tij
 E përngjasojnë krejt me lulëzimin e një peme të stërmadhe
 Dhe kjo është një e vërtetë e madhe për atë që kupton fjalë!
 Trupi i kësaj peme të madhe nga fundi në krye,
 Rrënjët e panumërim, degët e ngjeshura, sythet e dalë,
 Lidhur me të shkuarën e kombit, prej atje zgjaten e vijnë...
 Krijuesi ashtu e ka krijuar. Por po qe se një brezi
 Kjo pemë me të tëra s'i duket e mirë, degët e lule
 I pret dhe i ndan nga gjoksi i popullit, i shtrin përdhe;
 Ja, kështu ajo sëpatë një komb të tërë e bën pikë e pesë
 Edhe të ardhmen do ta ketë tepër të vështirë
 se në shesh do të ketë mbetur një barrë dru!



Në qoftë sëmurrur pema, tregojani atij që di,
I cili duhet të shohë më tepër rrënjët si cilësi.
Dhe, nëse e shartoni, shartojeni me nga lloji i vet
Dhe, po të doni që trupi i pemës nga trungu në degë
T'i ngjajë nuses së stolisur me lule e fletë,
Këmesa e krasitjes në dorë të fëmijëve të mos mbetë!
Ja, pra, halli, ja shërimi; ç'kam në dorë unë? Një kumtim...
Po ju? Përpjekjen e duhur që do t'ju japë shpëtim!
O Zot, na jep pëlqimin Tënd!

- Amin!

Tregoja popullit cila është rruga e drejtë!

- Amin!

Shpirtin islam po e ndrydh dhuna, do ta vdesë.
Nëse qëllimi Yt madhështor është edukimi i padrejtësisë, vërtet,

Të digjen në zjarr bashkë me të kaq të pafajshëm,
Shumica prej nesh jemi të pamëkatë?... Mos na digj, o Zot!

- Amin!

Po e mbyt botën islame një intrigë e tërbuar,
Kontinentet u zhdukën në atë vorbull duke vluar!
Familjet e shkatërruara janë një sërë të pafajshëm të Tu,
Edhe hallin e endacakëve të mbetur Ti e di fort mirë!
Rënkimet Qiellit po i japin tërmet! Si të mos jetë kështu?
Të heshtë, më në fund, o Zot, kjo uturimë!

- Amin!

Shtetet muslimane i goditi kudo fatkeqësia...
Ky dhé po mbetet atdheu i fundit i fesë sonë!
Po u shkel dhe ky, domethënë sheriati kuptimplotë u shkel;
Mos e bëj pluhur e dhé, o Zot, të paktën këtë!

- Amin!

Ve'l-hamdu li'l-láhi Rabbi'l-alemín...
Lavdi Allahut, Zotit të botëve!

28 Gusht 1912
15 Ramadan 1330



Libri i tretë
ZËRAT E HAKKUT



ZËRAT E HAKKUT*

Bismil'lahir-rahmani'r-rahim!

*Kul'li'l-llahumme málike'l-mulki tu'ti'l-mulke
men teshau ve tenziu'l-mulke mimmen teshá'
ve tu'izzu menteshau ve tudhil'lu men teshá'
bi jedike'l-hajr inneke alá kul'li shej'in kadír!*

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*Thuaj: "O All-llah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin
atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do,
e lartëson atë që do dhe e përlu atë që do. Cdo e mirë është
vetëm në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!"*

(Kur'ani, Al-i Imran: 26)

O Zot, i nënshtuar i urdhrit Tënd është kjo gjithësi;
Njeriu s'është asgjë... Çdo gjë Jotja, vullneti është tek Ti!
Mirëpo ende tregon shenja qeniesimi, hej, i marri!
Ndërsa sot në katër-pesë pashë tokë është i qenë ai,
Nesër, nga qenia e tij e bërë dhé, shpërthen mjerim e zi!

O Zot, "Unë jam sundues i çdo sendi" - po thua. E drejtë!
Besuam! A ka gjë në dorë njeriu vërtetë?
Kurrë! Dhe n'e pastë pushtuar një komb e bërë shtetin për vetë,
Dhe n'e pastë lëshuar dore atë pushtet, duke mbetur vetë shkretë,
Ti je që jep, Ti je që merr, e gjithë bota Ty të përket!

O Zot, po të duash, Ti, dhe popullin më fisnik e poshtëron;
Personit më të ulët, virtyte i jep nëse dëshiron!
Këto humbje, këto disfata, prej Teje, vetëm prej Teje janë!
Mijra klithma të pashpresa, gjer në Arsh si nuk shkojnë?
As toka, as qiejt, O Zot, s'ma ndejnë shpirtin tek rënkon!

Nën këtë kube të heshtur, shenjë njeriu s'paska!
"Një miliard e gjysmë" - thoshim, dhe një frymë s'paska!
Mbi këtë dhé të pandjenjë, vend për të vuajturit s'paska!

* *Hakk: e Vërteta.*



Lëre drejtësinë, për drejtësi kush s'bëka fjalë!
Njerëzimi qenka krejt i zbrazët: ç'të kërkoke, s'paska!

O Zot, gjashtëqind mijë muslimanë më një herë u prenë...
Shpirti i djegur, pafajësia e shqyer qenë gjaku që mori dhenë.
Ç'pleq të pafajshëm nën bajoneta u përpëliten,
Ç'vatrave të panjeri iu vu flaka, pra, u dogjën,
Këto turra të hirëzuara, njerëz qenë, shpirtra qenë!

Agimi i mbarë i lirisë, o Zot, errësirë nate u bë;
Një rënie e zezë u shfaq ngado, realitet u bë!
Trimëria iku, guximi u shua; fuqia u shter.
Ata flamuj dallgë-dallgë u përmbysën, ç'tmerr u bë!
Nga tmerri i rënies, zemra e mëshirës ndoshta gjak u bë!

Ezanet heshtën... kambanat i gjëmuan horizontet tej e tej!
Ajme, sa keq, hëna nuk po ndriçon më qiellin e Lindjes!
Eshtë koha e pushtimit dhe aneksimit kryqtar tashmë!
Megjithatë, e ardhmja e jetësimit të të drejtave, e shtrirë përdhë
Ç'ditë pa lindje që qenka, o Zoti fuqiptotë i të dobtëve!

O Zot, këto dherra qenë vatra e fundit e shariatit të dëlirë...
Pse shkatërrimi yt i goditi me anë të popujve më të ndyrë?
Po, tri ushtri* nga më të ultit e popujve, me të hyrë,

Na goditën mu në zemër dhe shih se në ç'mënyrë:
Sa zemrat që rrihnin për të ardhmen, u ndalën menjëherë!

Dhe një herë të vetme nuk e shfaqe bukurinë, Zoti im!
Treqind e pesëdhjetë milion shpirtra i vrave me ashpërsinë!
Ç'është ky pelëshim, me këtë të heshturin zemërim,
Ndaj ateizmit që rri e dëfrehet, më fal, me Tëndin perëndim?
Ç'është ky ndëshkim i islamit kështu me nxitim?

* Tri ushtri: ushtritë bullgare, greke dhe serbe.

Hesht, i marrë! S'ndalet ecja e zakonshme e gjithësisë!
Ç'kujtove, a e hesht ligjësia e krijimit klithmën e njerëzisë?
Sot ti duhet ta shpresosh ndihmën vetëm prej vetes;
Po, shko dhe me përpjekjen tënde ndaloje dorën e mizorisë!
Shih me ç'ndjenjë i përkulet bota ligjit të përpjekjes!
Ç'bëre ti? "Njeriut i përket vetëm ajo që ka prej vetes!"*

9 janar 1913
30 Muharem 1331

* Ajeti kur'anor, *Ve en lejse li'l-insáni il'lá má seá*, "Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar". (Kur'ani, Nexhm: 39)



Bismil'lahi'r-rahmani'r-rahim!

Fe tilke bujútuhum hávijeten bimá dhalemú...

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*E këto janë shtëpitë e tyre të mbetura shkret
për shkak të mizorisë së tyre...*

(Kur'ani, Neml: 52)

Po ka dikush që kalon këtej kah trojet e shkelura të islamit,
Kah kjo varrezë qindramijëshe e përgjakur dhe e pavizitë,
Ndjen në rrugëkalim një vaj që zemrën ta bën copë e çikë.
Kjo zi, nga pluhuri i sa zemrave të copëtuara del përpjetë,
Kush e di, nga thyerja e fundit e shpresës së fundit mund të jetë!

Po, nga thyerja e fundit që s'mund të ketë kundërshtim:
Shikimet janë shuar së prituri nazemadhin agim!
Si të mos ta shtypin ndërgegjen, o udhëtar, këto njëmijë mallkime;
Buzët na kanë plasur duke pirë këtë helm-dështim!
Miliona të dashur, pa vrapuar dot, shohim nga larg e rrimë!

Këto çerdhe të shkreta një kohë qenë se jeta më të çmuar,
Këto çati nuk gjëmonin nga kënga e bufit e vajtuar;
Në këtë luginë ku kërcejnë bretkocat, drenushat kanë vrapuar,
Ky lumë i vrullshëm që qan, nga ç'hije është hijeshuar;
Por të shkuarën një tufan gjithë e ka mbytur, e ka copëtuar!

Atdhe i pabesë! As për birin tënd të vërtetë besë s'ka?
Zemra pse të është nxirë? Në asnjë nga mijë vatrat dritë s'ka?
O Zot, e humba nga vetmia; për mua miqësi a s'ka?
Një i vetmuar jam, pa vatër e pa shtëpi; strehim a s'ka?
Kudo shtangie e hiçësi: të paktën një bërtitje "s'ka!" a s'ka?

* * *

Mos ik, o udhëtar, rri, bashkë të qajmë e të kuvendojmë!
Dhimbja ime s'i përket veç një zemre, ta ndajmë!

S'e di, si të bëjmë e ta shkatërrojmë pesimizmin tim?
 Aq e tmerrshme është zija që vërtitet në rrethin tim,
 Saqë pára më shtrihet një varrezë që është vatani im!
 Çelu tokë, të hyj në ty! Hej, udhëtar!
 Këto varreza që zgjaten e shkojnë pa mbarim,
 Shih ku nisën të ngrihen, shih nëse u gjen fillim!
 Ç'është kjo vetmi e përjetshme, ky i qartë dështim!
 Shtypet shpirti i qiellit, zemra e tokës bëhet copë-copë!
 Trazoji pak dherat e shih prej tyre ç'ka për të dalë:
 Kafka shtypur, nën qytë copëtuar, bërë gropë,
 Fytyra të çngjyrosura nën goditje dhe shtypje,
 Sy të gdhendura kush e di nga ç'e keqe!
 E mallkojnë egërsinë e quajtur "qytetërim"
 Sa e sa dhëmbë të prerë një copet e të zgërdhirë,
 Sa e sa mijra trupa të shpuar me bajonetë, me gjak të ngrirë,
 Sa e sa koka, sa e sa krahë nga trupi ndarë,
 Krijesa të nxjerra nga djepi, shkuar nën bajonetë,
 Pastaj, gjithato jetë të flijuara për nder,
 Të zhytur në katran gjyshër flokëbardhë,
 Nëna të pagji me gjoks të thyer me sopatë,
 Grumbuj mijra gjërash nga trupa të prerë:
 Flokë, veshë, nofulla, gishta, të gjitha gërmadhë njerëzore!
 Sa e sa jetë të pjekur lugatërisht në hell
 Me mendimin se mos pas të birin ia ndjell.
 Të gjithë këta me drapër u kositën si bar i thatë!
 Aq i madh qe krimi i tyre pse qenë muslimanë,
 Saqë ndëshkimin në krahasim me të, të vogël ua panë!

O karvan shpirtrash të ngjitur lart duke lënë në këtë tokë
 Secili nga një kufomë të shkatërruar! Mos shihni nga toka
 E të kujtoni: Është një gjak që vlon me afsh për të rënë dëshmor...
 Tek ne ka shpirtra të pandjerë që qelbin më keq se cofëtitrat!
 Mos na shihni, por në fytyrën e fëlliqur na pështyni!
 Pështynani se, ndoshta, nisim e ndjejmë pak turp!



Pështyni në frontin moskokëçarës të Lindjes, pështyni!
Pështyni, të shohim, populli a do të lëvizë nga vendi?
Pështyni goditjet e dhëna popullit poshtësisht!
Pështyni të poshtrit që i kanë duartrokitur ato bujarisht!
Pështyni në atë fytyrën e paturpshme të ndjekësve të Kryqit!
Pështyni atë fjalën e tyre në të cilën kurrë s'mund të kemi besim!
Shihni krijesën maskara të quajtur "qytetërim"
Dhe pështyni në ndërgjegjen e maskuar të shekullit, pështyni!

Sidomos pështymë me të tepërt lëshoni mbi trutë e idiotit
I cili, në kohën kur u shpall kjo luftë e mallkuar,
E heshti zërin e fesë duke ia paraqitur popullit si fe
Përçartjen e vet, sipas së cilës, "na duhet ideja e Perëndimit,
Gjë që bëhet duke e lënë Allahun në!..

Sot, mbi mua rëndon marria ime prej vetmisë përsëri...
Mua, një mik që të lë të lirë si vetmia më duhet;
O udhëtar, lërmë, pra... Unë po qaj në vetmi...

30 janar 1913
22 Sefer 1331

*Kale Resulull-llahi (s.a.s.): Idha kalet Nizaru ja le Nizar
ve kalet ehlu'l-Jemeni ja le Kahtan nezele'd-dararu
ve rufia'n'-nasru ve sul-lita alejhim el-hadidu.*

*Sapo që nizarasit të thërrasin: "O nizaras, ejani në ndihmë
nizarasve!" dhe që jemenasit të thërrasin: "O kahtanas, ejani
në ndihmë kahtanasve!", menjëherë mbi krye u zbret
fatkeqësia, ndihma e Allahut u hiqet menjëherë dhe
të gjithë menjëherë i godet shpata!**

Për shkak të hallit të tre kokave të patru, një popull tre milion
Pa shih si grihet! Ngrihu, ati im** nga varri ku pushon!
Të gjallët s'vrupuan në ndihmë, të paktën ti na dil...
Shqipëria digjet... Dhe, kësaj radhe, për tmerr!
Një shkëndijë e vetme u fry dhe ashtu volli zjarr ferri
Që shëtiti anembanë duke e përfshirë vendin mbarë!
Kuku ç'zjarr, s'la vatër pa shuar,
Aman ç'tufan që të gjithë luginat i shkretoi!
Një fytyrë të njohur u vura të kërkoj... Por të tillë s'paska...
Vetëm një shkretëtirë e thatë që, për çfarë të pyesësh, heshtje!
As fytyrë të njohur s'ka, as kujtimi s'u ka mbetur,
As kufomat e shumë jetëve të djegur!
Po t'i trazosh hirërat, nga poshtë, jam i sigurtë,
Do të dalin katër-pesë eshtra të qymyrëzuar!
Baba! Nëna jote më e dashur, ai vatani yt,
A do t'i bëhej fli furisë së tre pezevengëve?
Iku toka ku im gjysh lëroi e mbolli jetë...
Dhe shkoi ashtu që të mos kthehet më kurrë!
Ç'do të bëhej po të ngriheshe e ta shihje këtë, vallë?
A do të ngulej kryqi në trurin e Shehitllëkut,** baba?
Ç'fatkeqësi! Le të kthehen edhe xhamitë në ahure,
Ushtarët kroatë të vijnë e të luajnë mbi to hore!

* Porosi profetike. (Nuajm b. Hammad, Fiten, I-396, Kajro, 1412).

** I ati dhe mësuesi im, Tahir Efendi nga Peja, njëri prej myderrisëve të xhamisë Fatih. Gjithçka që di, e kam mësuar prej tij. Këtë shënim u detyrova ta jap me qëllim që poezia të kuptohet më mirë dhe që i ndjeri të kujtohet me mëshirë.

*** Bëhet fjalë për varrin e Sulltan Muradit në Kosovë.



Të paktën një kujtim të mbetëj në këtë tokë i gjallë...
Toka është çarë, tyrbet e dëshmorëve janë turpëruar!

Kudo që të jem, një fushë e përgjakur më bie kresë:
Ti vetë je, apo iluzioni yt, Kosovë e pabesë?
Hë, sikur çdo hap tek ti ishte mijra krenari!
Ku është rruga e Jëlldërëmit*, që çau rrugë në gjoksin tek ti?
Po ushtria? Po Mbreti i Shehidëve i shtrirë në zemrën tënde?
Ah, ku është sot ajo fitore-flijim? Ku është ajo festë?
Trego, o Shehitllëk, të ta puth atë dhë:
A s'ka te ti ca pika të gjakut të Muradit?
O Shehitllëk, po ç'është ajo gjë mbi ty, mejhane?
Ku e ke kandilin, s'po e shoh; mos është ky bardak vere?
Po sarhoshët me shapkë që flenë në gjirin tënd, kush janë?
Apo e kam gabim? Jo, mos fol, e di, e kuptova, mos!
A do të mund të të shkelte opinga sërbe mbi gjoks?
Sarëku i mijra shehidëve të shtrirë përdhe,
A do t'i fshinte çizmet e ushtarit më të poshtër?
A do të fshinte çdo kalimtar çdo copë të vet si ngordhësirë?
Mirë, po ky flamur tricopësh duke t'u ngulur në majë,
Pse s'u ul? Kush i doli para popullit dhe e pengoi?

Ku është populli fisnik që i sfidonte popujt?
S'pashë asnjë njeri, askënd në shesh; çudi!
Ah! Ku mbeti, ai zemërim trimëror i popullit me gjakun që vlon
Që kur shkilej hieja e dinjitetit të tij s'heshtej,
- Pa i shtri përtoke katër a pesë vetë! -
Ja dinjiteti kombëtar, i njollosur, i poshtëruar!
Ku janë tani ata burra që s'deshin regjistrim popullsie
Duke thënë: "Unë s'mund t'ia them të huajit emrat
e vajzës, e gruas; për këtë mos më pyet, se ta heq kokën!"
As dhe një shenjë s'treguan nga trimëri e vjetër

* E ka fjalën për sultanin osman Jëlldërëm Bajezid.

Një sërë frikacakësh tek vraponin për ta lartësuar kurvërinë
S'mbeti as selamllëk, as haremllek,* i bënë pikë e pesë!

Ku e ke autonominë, o komb viktimë robërie?
Kam frikë se ç'të ka rënë në pjesë tani, një dëshpërim i pambaruar!
Ku e ke pavarësinë, o entitet që s'lidhesh kund ?
Më duket se t'u shuan të gjitha shpresat përjetësisht!
Ku është iluzion i lartë i ngritur nga ata të "Bashkimit"?
Për vite të ka gënjyer ajo ëndërr e mallkuar
Dhe pate rënë në gjumë... Po të ishe zgjuar,
Mëngjesi i përgjakur i zbardhur papritmas,
Vendin a do ta kishte shkatërruar?
Hajduti malazez, gomari serb, gjarpëri bullgar
Dhe qeni grek vatanin anë për anë ta rrethojnë,
Gjithë ushtrinë ta shthurin, ta shkatërrojnë,
Të na e marrin nga dora vendin e të na përzejnë,
Dikush nga familjet e panjeri të shkojë nën thikë,
Dikush me një mijë dhimbje t'u bjerë në prehër...
Nderi i dikujt i shkuar kot, gjaku i tjetrit, hallall...

.....
Ja, pra, o element kryengritës, ky shkatërrim i dhimbshëm
Eshtë mjeshtëri e katër-pesë budallenjve që të nxitën ty!
Po pse nuk e prisje këtë fund poshtëruës?
Ti ishe prej ummetit islam, ç't'u desh kombëtarizma?
Të mbaheshe fort për këtë ummet!
"Shqiptari(zëm)" ç'do të thotë? A ka vend në Sheriat?
Pretendimi për nacionalizëm s'është tjetër veç mosbesim!
A ka përparësi arabi ndaj turkut, lazi ndaj çerkezit
Apo kurdit, persi ndaj kinezit? Ç'thua ti!
Paska në muslimanllëk racizëm?
Pejgamberi e mallkon idenë e racizmit.**

* *Selamllëk*: pjesë e shtëpisë tradicionale osmane e ndarë vetëm për meshkujt; *haremllek*: e kundërta, hapësirë e shtëpisë e ndarë për femrat.

** "Kush thërret në fanatizëm etnik e racor s'është prej nesh!": Ebu Davud, Edeb, 112.



Shpirti profetik është armiku më i madh i përçarjes.
I humbtë emri sharlatanit që e futi në islam!
A është e drejtë të bësh llafe për këtë që të ka gjetë
Kur kjo të është treguar mijra vjet më parë?
O popull i ndjerë, zgjohu, më në fund, se u gdhi!
Pse të erdhën pak ezanet, të bjerë kjo kambanë?
Hap sytë: As arabizëm, as turqizëm s'do të mbesë!
Ndjeja fjalën hyjnore Profetit Famëmadh!
Turku pa arabin s'jeton dot; kush thotë "jeton", është i marrë!
Kurse turku është për arabin sy i djathtë, dorë e djathtë.
Bëhuni tok: përndryshe, fundi, disfatë e pashmangshme
Pasha Zotin! As hilafet mbetet gjallë, as fe!
Prej kohësh "qytetërimi" i mpreh dhëmbët
Për t'ju copëtuar në fillim, pastaj për t'ju gëlltitur;
Ndërsa keni shembull shqiptarët, pse s'mblidhni mend
Ç'është kjo politikë e ngatërruar, kjo kauzë pa vend?
M'duket, shumica juaj s'e sheh rrugën e shtrembër që ka marrë...
Përzejeni, më në fund, hajdutin që ju prin!
Dëgjomëni mua që po, jam shqiptar..
S'kam tjetër ç'them... Ja atdheu im i mjerë!..

6 Mars 1913
28 Rebiul-evvel 1331

Bismi'l-lahi'r-rahmani'r-rahim!

*Já benijje'dh'hebú fe tehassesú min Jusufe ve ehihi
ve lá tej'esú min ravhi'l-láhi
innehú lá jej'esu min ravhi'l-láhi
il'lel kavmu'l-káfirún!*

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*(Jakubi u tha të bijve të vet) "O bijtë e mi, shkoni dhe
hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira
e All-llahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në All-llahun".*

(Kur'ani, Jusuf: 87)

Ta shohësh të ardhmen errësirë e ta humbësh zellin...
Po qe se ka një vdekje të ulët, kjo është, pa dyshim.
Kurrë nuk besoj dhe sikur ta shoh me sy, se
Besimtari nuk ngordh në këtë mënyrë!
O ti, meit i gjallë! "Dy duar për një kokë!"
Luaj vendit, pra! Koka është e jotja, dhe duart, të tuat!
Ndjenjë, jo; lëvizje, jo; dhimbje, jo; mos je ngordhësirë?
Po më lë pa mend! Ti s'ke qenë i tillë!
Zelli për shpëtim pse s'të ka vazhdim?
A ti vetë s'ke zemër, apo shpresa jote s'ka!
U shtange duke e parë ardhmërinë terr e zi
Në vend se të kërkosh zgjidhje, në pesimizëm u thellove!
Po qe se para s'ke dritë, kërko në të djathtë a të majtë
E gjej një dritë e udhën mos e le!
Në mos mbettë dritë në gjithësi, ti duhet ta krijosh, ti!
O njeri i hutuar që fle me duar në ije, çohu!
Po qe se, si çdo njeri, ke të drejtë jete në këtë botë,
Atëherë, pse s'tregon të njëjtin afsh për jetë ?
Pesimizmi është një baltovinë e tillë, që, po re,
Mbytesh; kapu fort pas shpresës dhe ec, ç'pret?
Kush rron, rron vetëm me zell e shpresë!
Shpirtin dhe ndërgjegjja e pesimistit,
Lidhen me një nyjë të mallkuar që s'ka zgjidhje...
Si fytyra e kriminelit më të frikshëm, pesimizmi s'qesh!



Meqë pesimizmi e idhujtaria janë njëlloj të ulët,
Meqë për ty o besimtar s'ka faj më të keq e të shëmtuar se,
Të mos kesh shpresë në përdëllimin e premtuar hyjnor
E të pajtohesh me disfatën. Përpiqu, me zell puno;
Në u djegsh vetë, madje, tët bir mos e përvëlo!

Shtëpitë janë bërë zgavra, kukuvajkat ia thonë...
Edhe zërat: "Vendi qenka në rrezik, ka për t'u fundosë!.."
Mirëpo nga ky grumbull që mbulon miliona,
Nuk del një krah që të dojë ta rrokë!
E meriton fundosjen vatani që s' i del kush për zot,
Por kurrë s'ka për t'u fundosur po i dole ti për zot!
Lëre qarjen, në vete eja, koha është e paktë...
Përpiqu se janë shumë dëmtime që duhen ndrequr!
Po qe se shpreson se shpëtohet me të qarë, vajto!
Jo, jo! Më parë këput zinxhirët që të kanë lidhur pasionin!
Mos thuaj: "Mbaroi kjo punë, puna s'ka fund!"
Mos u praps; o popull i ndjerë, shpresën mos e humb!

27 Mars 1913
19 Rebiul-ahir 1331

Bismil'lahi'r-rahmani'r-rahim!

... etuhlikuná bimá feale's-sufeháu minná...

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"A po na zhduk për atë që bënë të marrët nga ne?"

(Kur'ani, A'raf: 155)

O Zot, a s'ka mëngjes për këtë natë ogurzezë?
 Apo shpëtimi i të fatkeqëve është lënë për në mahsher!*

Ne duam dritë, Ti neve na vë zjarr!
 "U dogjëm!" - bërtasim ne, Ti na dërgon gjak për t'na mbytur!
 Po s'fryu së afërmi një frymë e amshimit,
 O Zot, mes atij xhehennemi dhe këtij tufani
 Bota islame e bërë rërë, e bërë dhé;
 Do të vazhdojnë të shpërthejnë nga nëntoka idhujt
 Druaj se mos pikëllohet gjyshi i Hysejnit**
 Kur t'i shohë pyll kryqesh dy Haremet...***
 Ka një mijë e treqind e tridhjetë e pesë vjet
 Që lutja jote prekëse nga mjedisi i zjarrtë i tokës së Hixhazit
 Dallgëzohet drejt qiellit dhe entuziazmon botën hyjnore
 E tani këtë përgjërimit mos vallë duhet ta mbysin
 Kumbimet e kabanave e të groposet në heshtje?
 A duhet të shuhet, o Zot, ky pishtar i besimit në një Zot
 E të zbresë, me trininë, errësira mbi tërë një botë?
 A duhet që besimi që i mban gjallë treqind e ca miliona,
 T'i bëhet fli ateizmit të pesë a dhjetë njerëzve pa mend?
 A duhet të zbehet ajo fytyrë e ndritshme e Kur'anit
 Me egot e ndyra të pesë a dhjetë shpirtave të ulët?
 A duhet përfundimisht islami të merret nëpër këmbë?
 O Zot, ç'disfatë që është kjo, ç'poshtërim!
 Ç'kuptim ka shtypja e të pafajshmit, ç'kuptim fshihet në të?
 E pse drejtësia jote, o Zot, mizorët ende s'po i vret?

* Mahsher: grumbullimi i njerëzve pas ringjalljes në sheshin e Gjyqit të Fundit.

** Gjyshin e Hysejnit: profetin Muhammed.

*** Dy haremet: dy vendet e shenjta, Mekën ku ndodhet Qabeja dhe Medinen ku ndodhet xhamia e Pejgamberit.



Krimineli bredhën kokëlartë, viktima shpirt po jep...
Pse kur faji është i tjetërkujt, tjetërkush dënohet?
Edhe sikur mijra pyetje t'i bëheshin fli devizës “s’thirret
në përgjegjësi”*...
Njeriu këto enigma duke u rrëqethur i vështron e rri...

Sa keq, nga besimi i pesë a dhjetë qafirëve u mashtruar
Dhe ramë në një gjumë që në xhehennem u zgjuam!
Meqë, o drejtësi hyjnore, dikë kishe për të djegur,
Të digjje të mallkuarit! Kurse Ti na kape e na dogje ne!
Ato duart e poshtra të mohimit, ajetet t'i fshinë,
Mijra xhami u shembën, për tokë u shtrinë!
Nja-dy faltore në paçin mbetur, dhe ato kanë ndërruar fe:
Kryqi në gjoks, prova më e sigurtë për mohim!
Gratë mbetën të veja, fëmijët pa baba jetimë,
Në një vajtim, zija e një mijë familjeve tingëllin!
Nga zemra e milionave jetë të përzënë nga vatani
Me krimet më të përgjakura, kullon gjak!
S’ka kush ta ngrejë në këmbë islamin, ta mbajë për dore?
Klith për një gjë që s’e meriton, për të dobtin s’ka drejtësi
A s’janë mjaft mbi kryet tona të gjitha këto fatkeqësi ?
Goja m’u thaftë! Ku je, o e Allahut drejtësi?

10 Prill 1913
4 Xhemadul-euvel 1331

* Aludon në versetin kur’anor el-Enbija: 23 (*La jus’elu amma jef’alu ve hum jus’elun: Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten!*)

Bismi'l-lahi'r-rahmani'r-rahim!

... kul hel jestevi'l-ledhine ja'lemune ve'l-ledhine la ja'lemun...

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?"

(Kur'ani, Zumer: 9)

Natyrisht, s'ka se si... njëri, hajvan, tjetri, njeri!
 E, në është kështu, përpiguni të shpëtojme
 Nga faq' e zezë q'i thonë "padituri!"
 Mos vallë ky mësim i fatkeqësisë së fundit nuk mjafton?
 Ky mësimi i fundit ja se ç'na kushtoi:
 U shkri truri e si lot i syrit pikoi!
 "Mësimi i fatkeqësisë së fundit" ç'kuptim ka? Këtë, pra:
 Nëse populli kësaj radhe s'vjen në vete, do të zhduket,
 Një goditje të re s'e durojmë dot, si duket
 Gjumi kësaj radhe është vdekje, zgjim s'do të kët'!

Njerëzimi, si një rrjedhë e furishme, gjithherë entuziast,
 Shkon drejt së ardhmes me nxitim, me vrap!
 Malet, greminat kërkojnë të mos i japin rrugë,
 Por ai ecën pa pyetur për të përpjetë e tatëpjetë!
 Popujt, si përrenj që bashkohen në një lumë...
 Bashkohen, gjithsesi... Kush do që të mbetet pas, në fund?
 Ne që përballemi me këtë rrymë tronditëse e madhështore,
 Përpigemi kundër saj,... shih sa të marrë jemi, kupto!
 Ani, mundohu, të shohim, o i hutuar, në mos paç punë!
 Kjo s'i përngjan gjëje tjetër veç ngjitjes përpjetë, të një ujëvare
 Të shpejtë si plumbi, përmytës si deti, drejt burimit të vet;
 O ti, pikë uji e vetmuar! Po s'iu përshtate harmonisë
 Së kësaj rrjedhe, mbytesh, më beso!

Shkundu, më në fund, nga gjumi që po vazhdon me shekuj
 Dhe digji dhe shembi errësirat e tua atje ku rri!
 Pa shih, qiejt janë zgjuar, toka është zgjuar;



Eshtë maskarallëk të flesh kur bota është zgjuar!
Sa keq! Shkaku i këtyre errësirave je vetë ti...
O ankth i injorancës! Duke rënë në ty ky millet,
E bëre që të mos i mbetet nder, të mos i mbetet fe!
O makth i zi i rënë mbi gjoksin e islamit,
Ty duhet të të vrasim më parë, o armik i vërtetë:
Ti je dora që i ke nxjerrë armiqtë fitimtarë mbi ne!

O popull, zgjohu, injorancës tënde po i bëhesh fli!
Edhe islamit po e merr me vete e po e shemb si ti!
Ki turp nga Allahu! Të paktën fenë lëre në liri...
Në dhé hyr vetë si ngordhësirë në daç të hysh!
Allahun e përdor për të na heshtur neve, ç'njeri je ti?
Ah! Nga Allahu turpërohet vetëm ai që ka dituri!*

24 Prill 1913
18 Xhemadul-euvel 1331

* ... *innemá jahsha'll-lahe min ibádihî'l-ulemá... / ...po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët* (Kur'ani, Fatir: 28)

Bismi'l-lahi'r-rahmani'r-rahim!

*Kuntum hajre ummetin uhrixhet li'n-nasi te'murúne bi'l-ma'rufi ve tenhevne ani'l-munkeri
ve tu'minúne bi'l-lah...*

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e
njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga
veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun."*

(Kur'ani, Al-i Imran: 110)

Një kohë edhe ne kemi qenë një millet dhe si:
Kemi ardhur në botë dhe kemi mësuar ç'do të thotë bashkësi!
Ndërsa gjithë horizonti njerëzor qe errësirë,
Jemi bërë dritë e kemi gufuar nga gjoksi i saj!
Netët e gjata të mbetura nga periudhat pa profet i kemi çarë;
Ideja e të nesërme pa lindur ende, progres kemi shpërndarë!
Ide progresive që e kanë ngritur botën peshë;
Sytë kanë pritur paprá agimin e pambarim.
Njëzet e pesë vjet qenë të begatë sa njëzet e pesë mijë vjet!
Shih se ç'përsosje e menjëhershme! Historia, ende e mahnitur
Nga kujtimi i jashtëzakonshmërisë së kësaj mrekullie!
S'ka parë njerëzimi një të tillë ecuri dhe s'ka për të parë!
Në një anë, feja, morali, kultura jonë,
Në anën tjetër, mbështetur në shpatë, drejtësia, bujaria jonë
Duke u lartësuar, i kanë marrë popujt një nga një në prehër,
Të gjithë janë përfshirë nga gazi e hareja e njësimit.
Urdhërimi për të mirë paska qenë puna e vëllazërimit islam,
E pengoka kur paka një punë të keqe, vëllai vëllanë!
Askush nuk mbyllka sytë me dashje para padrejtësisë,
Nga goditja e njërit u tronditkan gjithë pjesëtarët e shoqërisë!
Po tash, ku jemi? Vështro dhe krahaso me atë që kemi qenë!
Si qyrkun, e kemi kthyer përsëprapthi edhe fenë!
Dhe ashtu e kemi veshur. Shih: ajo çka shëtit në shesh,
Eshtë "pengoje të mirën dhe nxit të keqen"!
"Shih e mos çaj kokën"- morali ynë më i shëndoshë!



E shembën një mijë pena të mallkuara nderin, ne s'nxorëm zë,
Por thamë “heshtja është flori” dhe heshtëm,
Thua se s'dëgjuam! Vollën mijra gojë të ndyra
Mbi të gjitha ligjet e Sheriatit; ah, sikur dhe një zë i vetëm
Të dëgjohej në emër të dënimit të kësaj anomalie!
Gjashtëqind mijë jetë ikin, besimi pakësohet me miliona;
Askush nuk sheh! Dhe ai që sheh, i hutuar, nga Zoti e di!
Por, nëse dikujt i preket nga vetja qoftë dhe një qime,
Kush sheh zhurmën e bërë, pandeh se bota u shemb!
Shkurtojani pak rrogën, vonojani ca ditë!
Buka e zezë pa pjekur të mbetet, “pilafi u sos” – po t'ju thoni, e
vëreni se ç'bëhet!
Festeja, qylafi, kallpaku, sarëku sheh se janë lidhur
Dorë për dorë, n'sa nga barqet lartësohet një thirrje urije
Gjer në qiej! Në një mes të tillë katrahure,
Nuk nxirrja kurrfarë zëri, eja e më shih tani!
Allahu im, tregojë mrekullinë e vetme që na shpëton ne:
Na jep “ndjenjën e turpit” nga thesari Yt i fshehtë!

29 Maj 1913
23 Xhemadul-ahir 1331

Bismi'l-lahi'r-rahmani'r-rahim!

*Ve idhá kijle lehum lá tufsidú fi'l-erdi kálú
innemá nahnu muslihun. Ela innehum humu'l-mufsidúne
ve lákin lá jeshurún!*

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"E kur atyre u thuhet: 'Mos e prishni rendin në tokë!'
Ata thonë: 'Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)!'
Veni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit,
por nuk e kuptojnë."*

(Kur'ani, Bakara: 11-12)

Ata që popullin e shohin kah digjet në zjarrin e vënë
nga ca fitneshi,
Pandehin se ky ajet tronditës ka zbritur tani!
O të pafismë të paatdhe, o të poshtër ngatërrestarë,
Populli ka një fe, ka një nder që qëndron në këmbë!
Tashti radhën e kanë këto...të digjen dhe këto; këtë doni ju?
Gjithë bota muslimane, doni, të bëhet copë-copë?..
Ej, ti i pafytyrë, i paturp që s'di, madje, as se është
Një ndjenjë që i thonë "turp"! Pa le
Popullariteti yt më i ulët për të cilin u gëzove shumë;
Të ra kësula e të doli sheshit që je qeros!
Po qe se synimi i shumë e shumë ambicjeve qenka
Të rrëmbesh një qylaf, herët a vonë me nder e paguan.
Prandaj, me nderin dhe ndërgjegjen e popullit mos luaj...
Se, pastaj, nga balli do të të varen shumë arrna palë-palë!
Një fytyrë që nuk skuqet ke gjetur, o kriminel, hyr në të:
Edhe ngatërroje gjithë botën, edhe duku sikur po paqëton!
Po qe se e ke zakon të tregohesh dorëlëshuar me nderin tënd,
Malli yt është, e përdor si të duash, kush mund të të thotë gjë?
Birit të pafajshëm të popullit, veçse, mos i nxit
Një prirje të mallkuar ndaj zakonisht tënd të poshtër!

Ne që çdo gjë të qenë e shembëm me një ide pa synim,
Nuk shembëm gjithçka, lamë veç një gjë: familjen.



Cilën ndërtesë, pasi e shembëm, e ngritëm të re?
Ja vendi ynë gërmadhë: copë e vrima ngado që sheh!
Meremetimi mund të bëhet, duhet seriozitet, vendosmëri;
Ndryshe, mos e thëntë Zoti, familja në u rrëzoftë,
As krahët më të fortë s'e ngrenë, s'ka më mundësi!
Kush thotë se ngrihet, s'merr vesh as sa një kafshë!
Kush thotë të bëhet "revolucion familjar", bëhet pesimist;
Asgjë s'fiton me këtë, veç n'u bëftë thjesht një kodosh,
Sepse fundi i revolucionit "lakuriqësor" është faqe e zezë!
O ju, ngatërrestarë të poshtër, këtë gjë e pamë shumë te ju!
Veç kësaj, populli ka fé, që shpesh po sulmohet!
Ç'hall? Ai është vrasësi i ndjenjave të popullit!
Për ta shpëtuar vendin, u dashka bërë feja flí!
Eja, atëherë, o i marrë, me këtë pikëpamje ec e bëru dijetar!
Nga çdo bashkësi pesë-dhjetë të pafe kanë për të dalë!
Natyrisht! Por është e pamundur një popull i tërë ateist!
A më gjen një popull pa ndjenjën e fesë?
Shih kah popujt më të mëdhenj: feja, më e shëndoshë se çdo gjë!
Mos bjer, o popull i mjerë në poshtërsitë e këtyre,
E njohim mirë ne diturinë e tyre të cunguar:
Lindjen s'e shohin, Perëndimin s'e njohin, s'kuptojnë;
I vetmi kapital i tyre: fytyrë që nuk skuqet, sy që s'lotojnë!

22 Maj 1913
16 Xhemadul-ahir 1331

Bismi'l-lahi'r-rahmani'r-rahim!

*Fendhur ilá áthári rahmeti'l-láhi keffe juhju'l-erdá
ba'de mevtihá inne dhálike le muhji'l-mevtá
ve huve alá kul'li shej'in kadír!*

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"Shiko pra gjurmët e mëshirës së All-llahut, se si e ngjall tokën
pas vdekjes së saj, e s'ka dyshim se Ai është që do t'i ngjallë të
vdekurit, se Ai për çdo send është i plotfuqishëm."*

(Kur'ani, Rum: 50)

Dil e sodit harenë ngjyra-ngjyra të pranverës;
Dhe dëgjoje rënien e bririt valë-valë, si melodi!
Me t'i lëshuar fuqi e Zotit tokës një gjak të blertë, një shpirt të blertë,
Qielli është bërë krejt i blertë; mal e lumë, krejt të qielltë!
Toka më shterpe ka lindur, shumë bimëve u jep gji,
Në e shtrydh një fije bari, del prej saj e shpërthen jetë!
Çdo fidan i zhveshur dje, si një shufër eshtre qe;
Shih sot ç'gjak i shëndoshë prej shëndetit i pikon!
Mijë zefire skëterrore frynin dje pyllit me tërbim,
Në çdo degë sot një zog shtegtar ka bërë çerdhe!
Dje miliarda shpirtra qenë nën vëzhgim të gjumit, e pe?
Eshtë shkundur e ka dalë nga ai burg tërë një gjithësi!
Në ç'zi qe gjithësia dje! Toka e zyrtë, qiejt të zyrtë!
Sot briri i krijimit bje: sot natyra, fushë e blertë!
Ndër djerrinat e lëruara, dora e begatë e fuqisë hyjnore
Gjethe të tilla ka nxjerrë që duhet shkuar për t'i parë!

Ashtu është, por, përkundër pamjeve të gëzuara që pashë,
Tek unë ende s'ka ndjenjë që t'i përngjasë kënaqësisë!
Jo një, por njëqind pranvera të zbresë qielli,
Nuk lëviz aspak nga vendi vjeshta që ka lëshuar rrënjë tek unë!
Teksa bilbili këndon për qejf, korbat krrakisnin në trutë e mi!
Pastaj para një nga një më kalojnë shtëpitë e shembura!
S'njeh njeri, madje përfytyrimi në të çoftë në vendin më të njohur,



Këmbë të huaja shkelin; ka rënë vatani në duar të huaja!
Zë tjetër s'di, vetëm rënkim e vaj atje ku unë rri;
Pres të heshtë kjo zi, më kot po pres: qetësi!
Ah, ndërsa nga një çerdhe e vetme lartësohet vaji
I një mijë jetimëve, ai që dëgjon bilbilin, a është njeri?

Nuk ka sëmundje më të rëndë në botë se të jesh i pandjenshëm;
Aq ngjithëse qenka e mallkuara, sa s'ka shpëtuar asnjëri!
Vetë i shëndoshë, por ndjenja e shpirti i kanë vdekur
Popullit tënd: ja disfata, shkatërrimi, humbja më e rëndë!
O ti që nga toka e vdekur jetë nxjerr,
Dhe një copë dhé në qofshim, pse vetëm të shkelemi?
A veç të tjera krijesa e meritojnë bujarinë tënde?
Eh, sikur të ngjitesha e të bija, pastaj në prehrin tënd!
Shpirtrat sot një fllad të fryjë kërkojnë për të lëvizur,
Një fllad të fryjë, o Zot, e të gjitha gjakrat të marrin jetë.
Shpirti i pranverës të shfaqet edhe në mes tonë...
Ndryshe, ringjallja, Britit të Israfilit i ka mbetë!

5 Qershor 1913
30 Xhemadul-ahir 1331

NJË NATË MEVLUDI SHUMË E ZYMTË

12 Rebiulevel 1331

*18 Shkurt 1913**

Vite kalojnë, o Muhammed,
Muajt për ne u bënë vetëm Muharrem!**
Mbrëmja, ç'natë plot diell qe...
Ajme, edhe ajo, natë zije u bë!
Bota sot, për treqind e pesëdhjetë milion
Viktima, një botë e frikshme u bë!
Shenjtëria e Sheriatit tënd të pastër u shkel,
Të huajin e bëmë mik intim, na hyri në nder!
Prej zërit të kambanave q'u tingëllojnë në tru,
Mijra minare memece u bënë!
Për hir të Allahut, o Profet i pafajshëm,
Islamin mos e lër kështu, pa njeri, jetim,
Islamin mos e lër kështu, si viktimë!

* Eshhtë data e shkrimit të kësaj poezie, përkatësisht sipas kalendareve hënor dhe gregorian.

** Sipas kalendarit hënor, muharremi është muaji i parë i vitit. Në këtë muaj ka ndodhur ngjarja e Qerbelasë. Kështu, ky muaj është bërë simbol zije. Këtë simbolikë ka patur parasysht edhe poeti.



*Ky është një kujtim i vyer i mikut tim të ngushtë mjeshtrit të madh
Ferit Kamit i cili na ka dhuruar një vepër madhështore siç është
vepra "Biseda fetare, filozofike".**

Mikut tim Akifit,

Të uroj nga zemra për suksesin e botimit të pjesës së tretë të veprës *Safahat (Fletët)*; i lutem Allahut që të kesh sukses edhe në botimin e pjesëve të tjera të kësaj vepre.

Ti tregove se je i talentuar në krijimin e vargjeve pa e tjetërsuar përmbajtjen e tyre dhe vërtetove me veprat e tua se gjuha turke është një gjuhë që i përshtatet shumë kombinimit të vargjeve. Meqënëse ka një farë kohe që në gjuhën tonë çdokush sipas dëshirës së vet e kundërshton përdorimin me kritere të caktuara të fjalëve, gjuha jonë, nga një gjuhë e të gjithë Osmanëve**, është shndërruar në një gjuhë personale. Në të vërtetë, stili i përket dhe është simbol i personit që shprehet në një tekst; mirëpo kjo gjë vlen me kusht që të mos preket shpirti i gjuhës së shkruar.

Çdokush mund të jetë i lirë deri në një farë mase për të zbatuar përdorimin me kritere të caktuara të fjalëve në një gjuhë; atyre të cilët e tejkalojnë këtë masë u duhet thënë "Ndal!". Mirëpo ata që e kundërshtojnë përdorimin me kritere të caktuara të fjalëve në gjuhën tonë dhe që nxjerrin risi të ndryshme, ata nuk respektojnë asnjë masë, prandaj dhe dita ditës gjuha jonë po del nga binarët.

Për shembull, një skulptor përpigjet të bëjë një vepër të përsosur duke pasur parasysh gjithmonë masën e caktuar. Mirëpo asnjëherë ai nuk mund të kapërcejë kufirin e caktuar nga natyra. Ai e realizon veprën e tij brenda atij kufiri. Në momentin që ai e tejkalon atë kufi, vepra e tij nuk është më një vepër arti por një formë e çuditshme. Ekziston një masë e cila quhet ndryshe dhe kënaqësia e një lloj përsosurie që është specifike për artin. Përsosuria që tregohet në një vepër artistike gjithmonë matet me këtë masë.

Kështu është edhe piktura. Piktori konsiderohet se e ka treguar aftësinë e tij në një vepër nëse zbaton rregullat e natyrshme të artit; nëse nuk i

* Ky shkrim që Mehmet Akif Ersoji e vendosi në fund të librit të tretë (*Hakkin Sesleri*) të veprës *Fletët (Safahat)*, përmban ndjenjat dhe mendimet e mikut të tij, Ferit Kamit në lidhje me poezitë e tij. Ferit Kam ka jetuar gjatë viteve 1864-1944. Është një nga përfaqësuesit e idesë së Islamizmit. Ai ka punuar së bashku me Mehmet Akif Ersojin në të njëjtën periudhë në Universitetin e Stambollit. Po ashtu ai ka qenë bashkë me Mehmet Akifin edhe në Ankara në Teqenë e Taxhedinit. Ai është një filozof dhe poet që vlerësohej shumë nga Mehmet Akif Ersoji. Vepra e tij me titull *Biseda fetare, filozofike* është botuar si një libër i tërë mbasi është botuar pjesë pjesë në revistën *Siratimustakim*. Përveç veprave filozofike, ai ka shkruajtur dhe vepra letrare me poezi.

** Kjo shprehje e cila në dy botimet e para kishte formën "të gjithë Osmanëve", në botimin e vitit 1928 u shfaq me fjalën "të gjithëve ne".

zbaton ato, ai nuk është tjetër veçse një imitues i zakonshë në punën që bën.

Nëse dikush e ka larguar artin nga rregullat e tij të natyrshme, kjo do të thotë se ai i ka cënuar ligjet e këtij arti. Ata të cilët e e kundërshtojnë realizimin e një pune me një masë të caktuar që është dhe një cilësi që i përket një njeriu gjeni, gjithmonë mashtrohen dhe nuk kanë sukses.

E njëjta gjë vlen edhe për artin e muzikës. Qoftë skulptori, qoftë piktori, qoftë muzikanti, ai gjithmonë është i detyruar që të punojë me masën që është specifike për artin që bën, dhe, që ta masë përsosurinë e veprës në artin e tij me atë masë. Veprat e artistëve që nuk e respektojnë këtë kusht nuk konsiderohen vepra arti. Edhe në poezi nuk ka dobi nëse kjo specifikë nuk merret kurrë në konsideratë. Shumë njerëz i konsiderojnë vargjet, të përshtatshme, për risitë gjatë punës së tyre që realizohet me një masë të caktuar. Gjërat e çuditshme që shfaqin gjatë punës, ata duan t'i paraqesin si një aftësi të tyre. Këtë gjë mund ta shohësh në poezitë e reja që janë bërë. Ngaqë shumë vetë janë të paaftë për të përcaktuar masën gjatë punës për realizimin e poezive, ata i konsiderojnë këto rreshta si risi apo si përsosuri artistike. Nëse puna me masë sipas dëshirës që shfaqet në poezitë tona do të shfaqej në skulpturë dhe pikturë, një skulpturë që del nga dora e skulptorit me siguri do të ishte një krijesë e panjohur për ne! Po ashtu edhe veprat që do të realizonte një piktor sipas parimit të punës me masë të caktuar, do të pasyronin imazhet e një bote të panjohur për ne. Në poezitë tona kjo gjë e çuditshme ka kohë që është shfaqur. Mirëpo meqënëse dallimi i saj nuk është aq i lehtë sa dallimi i gjërave të çuditshme në artet e tjera, sot, ato gjëra të çuditshme, ashtu siç e thashë dhe më sipër, konsiderohen risi apo përsosuri artistike. Le të shohim deri kur do të vazhdojë kjo situatë e tillë. Mirëpo, ti i ke dhënë gjuhës së poezisë një zhvillim të veçantë për nga lloji i cilësisë; këtë gjë ti e ke realizuar me sukses; edhe më tej do të jesh i suksesshëm.

Le të vijmë tek opinioni i dytë: Ka nga ata që thonë “Arti është për artin; qëllimi nga arti është përsëri arti; është e kotë të kërkosh një qëllim fetar, moral dhe politik në art” si dhe ka nga ata që e kundërshtojnë profesionin tënd dhe që nuk e pëlqejnë atë. Mirëpo, nëse kjo gjë pranohet për artin, ajo nuk duhet vlerësuar si një mjet ndaj ateizmit dhe amoralitetit. Në këtë mënyrë, arti nuk është i pavarur nga kjo lidhje, por mbase është i kufizuar me pjesën më të keqe të lidhjeve. Në veprat e tua unë nuk shoh diçka që e kundërshton këtë gjë sepse edhe ti nuk kërkon ndonjë qëllim në art; por e kërkon artin në qëllimin që ke. Profesionin yt të mjafton tërësisht për të siguruar qëllimin tënd. Tani menjëherë merr në dorë lapsin e frytshëm dhe



me të gjallëroji ata të cilët janë të etur ndaj veprave serioze! Meqënëse burimi i vargjeve që përbëjnë këtë pjesë të veprës *Safahat (Fletët)* është nga Kur'ani, është e tepërt të thuash se frymëzimi i të gjitha këtyre është një vepër e plotë. Menjëherë thuaje dhe shkruaje! Allahu të ndihmoftë, i dashur!

30 Maj 1329
(12 Qershor 1913)
FERIT



Libri i katërt
NË QYRSINË E FATIHUT



*Poetit tonë epik,
Mit'hat Xhemal**

* Mit'hat Xhemal Kuntaj (1885-1956), poet e prozator, mik i M.A. Ersojit.



DY SHOKË NË RRUGË TË FATIHUT

- Vapori a u afrua?

- Qëkuri!

- Domethënë, jemi në Urë...

- Aman, të zbresin këta udhëtarë!..

- Mirë, po, a e dini,

I gjykon për keq njeriu ato varkat e vjetra!

Sapo thuhej “afrohu”, lazdrania, ikte prapë

Dhe, sapo kthehej prapë, i jepte një të rënë me kokë Urës:

Barku i shpuar i të mjerës

Përpinte plot gjashtë peshore dru

Dhe gjente nga dhimbja derman...

- Dhe po të vrapoje për të sjellë mjek, atëherë s’kishte mjek!

- Infermierët, qofshin bekuar, qenë mjeshtra për atë punë:

Me sëpata në duar, tri pritnin, pesë shtonin...

“Duro, o Omer atje në ballë, mbahu, Memish!”

Shihnit se si operacioni kish mbaruar shpejt e shpejt!

Bregu i Amasrës, një institucion shumë i vjetër;

Çdo amasras bëhet kirurg... Preje menjëherë!

Tregoja sëpatës së tij mprehur sot pyllin,

Ta pastrojë për një ditë, të mos e lërë për nesër!

- Sikur të dinin pak edhe për të mbjellë...

- Aman dhe ti!

Shih ç’mendon! Ti mësoje një herë këtë shkencë dhe...

- Kësaj shkence s’ke ç’i thua: koncepti i saj, i prerë!

Shkencat e tjera, të shpifura, kurse kjo, shumë e natyrshme!

- Ç’e do se s’mbeti më vend për ta zbatuar!

- Pse?

- Pse? E shihje po të dilje e të shëtisje.

Pylli që di ti, ku fshiheshin drenushat,

Sot u bë që të mos strehojë një lepur për be!

Ato pyje të blerta, shpina e të cilave s’pati parë kurrë diell,

Janë, tani, shkëmbinj grumbuj një mbi një!

- Mu në mëngjes përsëri na mbajte një fjalim të gjatë,
E le të lirë fantazinë, ngrite iluzione pa fre!

- Jo, s'kam me fantazira dhënë e marrë...
Besoni, çfarëdo që të kem thënë, e kam parë.
Kjo është gjëja që më tepër pëlqej në jetë:
Fjala e fortë si druri të më jetë, e vetmja e vërtetë!

- S'është keq, mirëpo rruga ka për të të qenë fort e përpjetë!
The "dru" e, për çudi, ja ç'më ra ndërmend:
Ky vend i mjerë s'paska prodhuar gjë tjetër;
Kudo që të ndodhesh, druri, malli me shumicë.

- Domethënë, toka jonë s'prodhoka dot njeri!..
- Shakaja mënjanë, ama jo vetëm njeri,
Por dhe dru do të kërkojmë së afërmi nga Europa!

- Atëherë, kujdes, se mos na i dërgon filizat tanë!
- Ti po ecën ngadalë... Sikur të shpejtonim ca!
- Eci ngadalë se dua të fitoj kohë.
- Atëherë, a mos duhet të kërcejmë si shpendët?
S'është turp: s'kuptova gjë nga këto fjalë.

- Pse e hodhe këtë kundërshtim pa u menduar?
Kalimin e kohës ne e quajmë fitim!

- Domethënë, tani s'ke ndonjë punë...
- Jo, pas pak do të kem.

- Ç'punë? Sikur ta merrnim vesh... Kaq e rëndësishme qenka?
- Dua të shkoj në Fatih për ta falur drekën;
A po vjen? Eja!

- Jo, pse atje në këtë vapë?,
Ç'më shtrëngon të shkoj e të mbytem në djersë?
Po e pate fjalën për namaz, hyr në një nga xhamitë përreth.

- S'e kam qëllimin vetëm për namaz... Sot dikush
Do të ngjitet e do t'i predikojë popullit...
- Tamam!

Është pikërisht koha për t'u ulur dhe dëgjuar marrëzira,
Për t'i çmuar ende ata që flasin marrëzira!
Njerëzit me çallma janë në kokë të popullit ngatërresë...



- Megjithatë, s'duhën futur të gjithë në një thes!
A e di ti se ç'gjení përgatitën medresetë?
- Gjení po thua? Zbraze, pa të të shohim, pa u mërzhitur, qesen!
- Ta zbrazkam pa u mërzhitur... Pse ta zbraz?
Po s'besove, prit të të tregoj...
- Mos u lodh kot, s'ke nevojë t'i mbash mend!
Pesë a dhjetë emra të dëgjuar.
Po ky i marri që do të predikojë, kush është, vallë?
Kushdo që të jetë, fundja një mulla me çallmë!
- Me ty, o byrazer, u kapëm pa gëdhirë mirë!
Përballë inatit, ç'të bëjë logjika veçse të heshtë?
A është e drejtë të përbuzen të mëdhenjtë e ummetit
Pa i njohur, vetëm duke thënë për ta, "njeri me çallmë"?
Sikur të ndodheshe në predikimin e tij të shkuar,
Zoti e di, gishtin do kishe kafshuar!
Sikur ta mposhtje një herë inatin
Dhe me mua në Fatih të vije...
- Ja tek erdha, bre!
- A t'u hapën sytë, e gjete udhën? Eja, sokoli im!
- Aman, sikur të zinin këtë udhë të rrafshhtë
E të mos ngjiteshim përpjetë...
- Mos thuaj afër apo larg, tani, rrafsh e të përpjetë!
Le të shkojmë pa përtuar, dilmë këtu në krah të djathtë!

- Aman, shihja madhështinë kësaj faltoreje të bekuar:
Shih e shih e s'ngopem, i jam bërë ashik pothua!
- Me të vërtetë, s'ngopen sytë me hijeshinë e saj...
Mirëpo të huajt janë hedhur mbi mjedisin e saj të virgjër!
Ç'janë këta grumbuj barakash që kërkojnë
Të vendosen në harem, mjedisin e saj intim?
- Po, e kanë parë truallin nga larg e janë mpakur,
Janë futur, pastaj dalngadalë e janë përhapur!
- Atëherë, Drejtoria e Vakëfeve duhet të vijë në vete...
- Ta zëmë se erdhi në vete... Po s'vuri mënjanë

Një grumbull floriri sa këta gurë të zinj që sheh,
 Si mund t'i pastrojë ato, si mund të ngrihet e t'i shembë?
 - Jo, duhet ta mbyllë qemerin duke thënë "pronë e xhamisë"
 Dhe atëherë për pak kohë shemben një nga një vetvetiu.
 - Si duhet ta mbyllë?

- Shumë kollaj! Duhet thënë:

"Ky shesh që qe bërë si han, është avlli;
 Nëpër këtë avlli kalohet vetëm për namaz!"

- O ti, je i mençur vërtetë!

- Kohë më parë a s'u ngritën ta shembin mahfilin?

- Domethënë se këta janë të shkalluar!

- Ç'e pyet, të luajtur mendsh!

Si mund t'i shkojë dora njeriut, pa u çmendur,
 Ta shkatërrojë këtë mahfil apo këtë kalim të shkëlqyer?
 Do ta gris in këtë dokumentin prej guri
 Ku ne mbështetemi për të mund të thënë, "edhe ne
 Kemi lidhje me qytetërimin, të vjetër, madje...", dhe
 Do të shëtisin nëpër sokakë "të gjerë" pa u mërzhitur fare!
 E lëshove një "pa u mërzhitur", por i re në të!

- Jo, por ti kupton saktë!

- Unë s'kuptoj gjë, por duhet të jetë shumë me vlerë...

Ky kalim a është i bukur me të vërtetë?

- Ç'thua!

Arti arkitektural i saj, ndoshta, shkruan histori,
 Ato sy-imitime të mpakura plot naze
 Shohin pak të epura ndaj bukurisë së qemerit...

- A mund të jetë art, vallë, ky qemer?

- Çfarë the?

- A për këtë qemer të hedhur diagonal e ke fjalën?

- Është zbatimi mjeshtëror i metodës grafike

Të artit gjeometrik.

- Domethënë se është shumë i rëndësishëm shqyrtimi i kësaj.

- Ke sy të saktë... Sa është ora tani?

Ta rregulloj... Prit, prit... Zaten s'është kurdisur...



- Në njërin është bërë dhjetë e gjysmë, në tjetrin, tre...

- Sa bukur!

Kohë brenda kohe... S'kishte gjë të tillë më parë.

- Por qe mungesë e madhe...

Ashtu qe në të vërtetë;

Llogaritja hënore, koha diellore, pastaj llogaritja gregoriane!

Populli i zgjuar që njihte tri kalendarët,

A mund të mjaftohej me një sahat? Jo, sigurisht!

- Si të duket kjo bankë, ndërtesë e bukur, ë?

- Edhe në mos qoftë

Aq e keqe, pranë xhamisë mbetet thjesht një mur...

- Çudi!

Po e pe me sytë e mi, sa e hijshme, ç'madhështi!

- Tjetër gjë ajo... Po të pyesin për stilin,

S'mund t'i vihet emër. E para gjë në art,

Duhet origjinalitet. Kurse kjo është hibrid!

Jo, as hibrid s'është... Ndoshta përzjerje e disa stileve

Që, po t'ia hysh analizës, shkon gjatë!

Nëse kërkon vepër fisnike, shih këtë sebil, ja...

Duke rrjedhur e rrjedhur ajo poezi e zgjedhur,

Natyra e saj e pastër dëshmon origjinalitetin e saj

Osmane edhe gjaku, edhe jeta që i qarkullon nëpër damarë!

Duhet ta shohin në këtë entuziazëm arti shpirtin e të parëve

Të bijtë indiferentë të qytetit duhet të mërzhiten pak!

- Mërzhitje i thënkëshin një dobësie nervore të dukur rrallë

Te burrat e vjetër, gjë që tani ka kaluar!

- Pse?

- Sepse ndryshoi gjendja shpirtërore; sipas kohës...

- Aman, kjo "gjendja shpirtërore" si dhe "ideali",

S'është turp ta them, m'i cingërisin nervat!

- Pse nervozohesh? S'është vendi për fanatizëm ?

Duhet të ndërrojë pak kjo mendësi e vjetër...

Është marri të thuash, «mos fusni asnjë risi në gjuhë!»

- Jo, s'është fjala për fanatizëm. Por duhet që, e para,

Të shfaqet nevoja për risinë. E dyta, e reja duhet të hyjë

Me dorën e njerëzve kompetentë...

Pa mendo: a kështu ndodh te ne?

- Pa dyshim!

- Assesi!

Argumenti: fjala jote...

- E kujt, e imja?

- Po!

- Ç'pata thënë? E harrova...

- Hë, pra, kjo "mendësi"...

- A s'e pëlqeve? A e ke parasysh frëngjishten "mentalité"?

Përgjegjësja e saj...

- Ja, pra, këtu është halli!

Po i morëm fjalët siç janë në anglisht, frëngjisht,

Si i bëhet halli, pastaj, gjuhës sonë?

Gjuha duhet të ketë karakter kombëtar,

Ndryshe, përparimi i saj s'është i lehtë.

- Edhe ky, ja, tani, po tregohet pak konservator...

- Po, jam konservator... A e di, po qe se kjo modë

Fillon të përhapet, ...

- Le të fillojë! Ç'bëhet?

Puna merr të çara gjithandej, s'mban më të qepur,

Gjuha jonë prishet.

Siç është bërë sot laramane e për turp pamja e jashtme

E njerëzve, edhe gjuha ashtu bëhet!

- Qëndrimin inatçor s'e kuptoj...

- A e di si është halli i këtij ummeti të shkretë?

Ashtu si halli i zgjedhimit të foljeve të çrregullta në arabisht...

Ne edhe tingujt e gjuhës sonë i kemi zgjatur apo shkurtuar

Si, si?

- Duro një çik? Nga rrënja "Jehâfu"...

Na tha e na mësoi fraza përmendësh

Mësuesi, aty nga përfundimi i zgjedhimit

Çapitej të gjente rimën në kohën e tashme



Përsëriste pandërprerë si të ishte zakon
“Vav”i vetë zanore s’ka, edhe shkronja pararendëse, gjithashtu
Shkronjat e mangëta si “vav”i s’e durojnë zanoren dot
Bëmë ashtu edhe ne, dhe doli “Jehâfu”
Edhe tani ne shohim se ç’bën e si e bën Europa,
E imitojmë dhe themi: “Edhe ne e bëjmë!”
Ç’dobi shpreson ti nga këto lloj risish?
- Ua, sa i vështirë paska qenë zgjedhimi i “Jehâfu”
- Kjo është përmbledhësja, përndryshe do zgjatëshim shumë
Keq, thua! Shih, u zhytëm në fjalë dhe s’e ndjemë të përtpjetën!
- Me të vërtetë! Gjithë këtë rrugë paskemi bërë!.. Ç’është kjo?
- Shkolla e djegur që qan kur e sheh sebinin e shembur...
Këto janë rrënojat e zjarrit që ra ca ditë më parë!

- Domethënë se qenkemi pranë xhamisë Sulejmanije...
- Ç’domethënë “domethënë”? Jemi mu përballë!
- Eh, si hidhet vështrimi nxirës i njeriut mbi të kaluarën!
Ne sot, jo vetëm që s’jemi në gjendje t’i bëjmë këto vepra
Që na vështrojnë nga lart, as që i ruajmë dot!
- Me të vërtetë ashtu! Ç’është kjo faltore? Shih, ç’pamje madhështore!
- Lëre xhaminë, se vepër si kjo s’gjendet në botë,
Pa shih këto monumente, këto medrese!
Të duken nga larg si qemere argjendi
Që kanë dashur ta përqafojnë shtatin e këtij monumenti të
njëshmërisë;
Të hedhura nga tri anë si rrip, s’kanë arritur
T’ia mbërthejnë as gjunjët, e lëre më belin
Fundja, a s’është njeri! Sado që të lartësohet në dituri,
Vatrën intime të Zotit si mund ta përfshijë?
Po, medresetë para atij pallati të shkëlqyer të njësisë hyjnore,
Gjithmonë kanë përfaqësuar respektin e shkencës karshi fesë.
Vargu i kubeve si dallgë një pas një,
Si të ishin karvan i rënë në sexhde para Zotit!
- Mirë, po, kështu është sot?

- Po s'qe, fajin kush e ka?

Ne jemi bij të pahair, për këtë gjë etërit tanë s'kanë faj.

A mos vallë gjyshi yt i ka hapur ato kafene pamjendyrë

Që po e brejnë si minj në çdo hap një qemer?

Jo! Pa shih: gjyshi ka bërë spitale për ty!

Afër tyre, komplekse shkolla të mjekësisë, sa mendja s'ta merr

E sheh këtë kompleks të madh? Është fakulteti mjekësor!

- Domethënë kjo medrese qe fakultet mjekësor...

- Turp!

- Ç'është turpi?

- Që as këtë gjë s'e dini!..

- Po ta shohësh kështu, ju jeni që thoni "mos e dini!"

- Mjekësia kishte një vend aq të nderuar,

Saqë ndër më të dalluarit e myderrizëve tanë

Ishin edhe shkencëtarë dhe mjekë të shquar.

Jazëk për bijtë e pabesë të atij brezi të fisëm

Që nuk janë kujdesur aspak për këto institucione:

Ç'nuk sheh njeriu kur hyn në një medrese!

Disa herë ndodh të përhumbem duke dashur të shëtis:

Eshtë e pamundur të mos të të ngatërrohen këmbëve

Në çdo hap rrënojat e një kontributi shekullor!

Po qe se do ta vështronim me kujdes një gërmadhë,

Do të shihnim ose të groposur sekretet e shpërndara

Të një kërkuesi, ose të fshehura gjurmët e një kirurgu;

Ç'gjë e hidhur!

Bankot e gjera të zhytura në baltë, krejt mermer...

Domethënë se mësuesi s'e ka dhënë anatominë vetëm në teori...

E ka shtrirë kufomën mbi mermer gjer' e gjatë,

E ka hapur dhe ka shpjeguar duke treguar një për një.

Sot vetë bankot shtrihen si kufoma pa jetë;

Mbi to beqarët fasule zjejnë!

- Mirë bëhet të dalë në lagjen Vefa ky sokak i shtrembër...

- Po, zbret në Vefa.

- Ndoshta është mjaft larg...



Apo jo!

- Aspak..., por, me ç'kuptohet, ti u lodhe pak!

- E paskam harruar; të thashë, kam kohë pa ardhur.

- Sapo të marrim kthesën, jemi në sheshin e Vefasë.

- Më duket sikur po e njoh... Se mos pak kohë ka kaluar!

- Ja, merre ç'kërkoje: tyrbe, gur, konak, karakoll...

- Po ç'shesh është ky? Kjo është pothuaj rrugë...

A s'është çudi?

- Ndoshta në kohën e vet ka qenë shesh...

Edhe pse me kohë është ngushtuar, emri i vjetër i ka mbetur.

- Shumë kafene dhe ka...

- Ku s'ka që kafene! Kudo!

Me këto, populli i ndjerë ka rënë ngushtë!

Kjo botë, e shkurtër, s'ka përjetësi, fundin mos e mendo!

Zgjatë në këtë kanape dërrase dhe e gjete ahiretin!

Një plak kish hipur për herë të parë në një kaikë;

Dhe kur kaikja kish nisur mbi ujë të rrëshqiste,

Plaku kish thënë duke i përshndritur sytë:

"O Zot, ja, kësaj i thonë jetë: edhe rri, edhe rrëshqit!"

Edhe këto kanape dërrase janë shoqja e kaikes së atij tirjaqiu;

Ku dalin fjalët "ah ç'kënaqësi!" Ulu këtu pranë.... Sa mirë!

Jeta rrjedh e shkon... Pse duhet mërzhitur?

Kësaj i thonë kohë... Mos rri, merr dhe një herë tjetër frymë!

Bëj qejf se s'dihet: o del, o s'del nesër në dritë!

- Kthehesh andej-këtej e sheh... Ç'të erdhi ndërmend?

- Këto ndërtesat përballë a të vënë në mendime ty?

- Përse do të më vënë në mendime? Në fillim më thuaj psenë.

- Kjo në anë të djathtë?

- Shkollë.

- Po kjo përballë?

- Një medrese e vjetër duhet të jetë... Apo jo!

- Mirë!

- Ç'do të thotë "mirë"? Shumë shkurt! Shpjegohu pak!

- A s'e sheh se si zgërdhohet "dyshja" që e ka larguar
 Popullin e mjerë nga bashkimi?
 Me ato dhëmbë të pista përballë?
 Si ka mundësi që njeriu ta vërejë këtë e të mos pështyjë?
 Besimi s'është shembur, sado që jemi munduar
 Pastaj fenë ta ndajmë prej kësaj bote kemi dashur;
 E kemi ndarë, por shariatën vazhdimisht duke e nënvleftësuar.
 Në realitet këtë të dytën më tepër kemi dëmtuar
 Sigurisht, këtij trupi të dobët nesër i pritët frymëmarrja,
 Por kjo "Medreseja Emekçiogllu" që sheh,
 Me gjoksin si hekur, jeton ndoshta njëmijë vjet...
 Sepse çdo brinjë e saj, gur i fortë i lidhur me plumb!
 Po të kish ky popull një kokë me tru, thoshte:
 "S'është punë me mend ta hedhësh trupin mënjane
 E kokën në anën tjetër" E s'vepronte kështu.
 Pa pyet, ç'ndodhi? Bijtë e vet të këtij populli
 lu bënë njëri-tjetrit më armiq se të huajt!
 - Në fund prapë bëhen vëllezër se ua kërkon gjaku.
 - Këtë koha e di.

- Ja ku u duk dhe ujësjellësi...

- Pse, a të mos dukej? Një pjesë, bile, mbeti pas.
 - I shkreti fshihet: s'do të shohë ç'ndodh përreth!
 - Pyeti këta "sy" që shikojnë nga historia jonë e vjetër:
 Ç'ishin ata? Burra si mal që sundonin tokën...
 Po ky brez i zënë ndryshk e i thërrmuar?
 - Vërtet, aq është zvogëluar, sa thuaj "s'është" e kalo...
 - Në thelb, a s'është maskarallëk kjo qenie si të mos ishte qenë?
 - A "duhej të ngordhte" po thua?
 Ja tek kemi ngordhur, ç'del nga kjo?
 As kjo s'është e lehtë... ekziston rruga për të vdekur si njeri.
 Po qe se mes xhematit gjen katër burra që "po të jenë,
 I huaji i pëlqen, po të vdesin, toka i pëlqen" dhe m'i trego!
 Lëre vdekjen dhe më fol për këtë ujësjellësin që po sheh!
 Në përmasat e mëdha apo ku është mjeshtëria e këtij?
 - Kur erdhën osmanlinjtë, e panë se vendi s'kishte ujë,



Por kjo ishte një gjë me shumë rëndësi...

- Sigurisht.

Menduan se nga ta sillnin ujin e si

Dhe, më në fund, bënë një punë: shkencë, teknologji!

Edhe sot, rrugë tjetër s'ka; sjellja dhe shpërndarja e ujit

Bëhen me anë të shtypjes së tij...

- Pa dyshim.

- Mirëpo,

Meqë s'kanë njohur një maqinë të tillë që t'i japë ujit fuqi,

Kanë shfrytëzuar lartësinë e burimeve.

Kanë gjetur rrugën më të lehtë, shtypjen e fortë për të shfrytëzuar

Gjetën metoda për ta shpërndarë edhe ujin e akumuluar

Ndërtimin e këtyre monumenteve,ujësjellës më pas kishin filluar...

Mirë, po, a thua me këtë, mjeshtëria mbaroi?

Jo! Pa edhe ato qendrat e shpërndarjes një nga një i shih!

Shihi dhe do të bësh çudi... Ç'punë e hollë, ç'mjeshtëri!

Me të vërtetë, gjë për t'u habitur... Ç'e mençur llogari!

Uji ashtu është shpërndarë që, po të mos rridhte kot,

Do ta merrte pjesën e vet çdo çezmë; llogaritja ish bërë

Gjer në një të dhjetën e pikës me imtësi.

- Kjo kubeja që na rri këtu përballë, ndoshta tyrbe...

- O ti, namazi po na ikën, ama ç' qenkemi zhytur në fjalë, bre!

Lëre tyrben ti e nxito pak!

- Xhanëm, pse të vrapojmë? Kemi edhe kohë, mjaft...

Edhe sikur të mos e kapim, e falim më pas...

- Jo, duhet ta kapim meqë mund ta falim në kohë!

- Domethënë, duhet të përvishemi për abdes...

Sikur të kishte një çezmë...

- Çezmë? Ja, ku e ke?

- Prit, mos shko!

- Po e kuptoj se abdesi yt do të shkojë gjatë;

Do të nxjerrësh këpucët, ku ta di se çfarë, se meste s'ke.

Unë po shkoj, mos më pengo, ti ec më pas...

Mos u vono, ë?

- Erdha, erdha! Kam dëshirë ta shoh!

VAIZI NË QYRSI

***Mbështetem te Allahu nga djalli i mallkuar!
Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!***

*“Eshhtë e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam.”**

*Allahu im, mëshira dhe paqja qofshin për atë profet
që s’di shkrim e këndim, për familjen dhe shokët e tij.
Lartësoje emrin e tyre!***

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*“A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë.”****

Nisni nga atom e ngjituni te trupat qiellorë
Q’u thonë “nebulozë”; shkurt,
Shëtiteni botën e mundësisë!
Ndërgjegjja, me një besim vrojtues, konstaton:
Të gjitha trajtat e krijimit që mund të jenë,
Sublime, materiale, të afta për të kuptuar, organike apo joorganike,
Përkulin qafën ndaj të njëjtit ligj me të njëjtën dëshirë...
Çdo gjë që ndodh në gjithësi, është shfaqja e Tij.
Ç’ligj është ky ligji i krijimit që, në hapat e tij,
Me shpejtësi më të madhe se edhe zgjuarsia,
Përhapet deteve, fushave, shkretëtirave,
Qiejve e hapësirave kozmike duke u zgjeruar
Në një mënyrë që s’lë vend pa kapluar?
- Po, kur t’i drejtohet papritur kjo pyetje kuptimit njerëzor,
Do ta thotë me gjuhën e trupit me zë të lartë
Këtë parim:
“Kush thotë: ”e drejtë imja është të mbijetoj” ,
E ka për detyrë të përpiket e të punojë;
Përpiqu, përpiqu se mbijetesa në këtë bot’
Realizohet vetëm me përpjekje për jetë e mot!”

* Kur’ani, Ahzab: 56.

** Tekst përshëndetjeje dhe lutjeje për profetin Muhammed.

*** Kur’ani, A’raf: Ajeti 185.



Çfarëdo qenie që të shtrihet mbi tavolinë për t'u analizuar,
Do të vihet re përqëndrimi i një përpjekjeje të vazhduar.
Mos thoni që e kundërta e të paqenës është qenia
Poli i kundërt i hiçësisë është përpjekja. Shihni
Se si hapësira e heshtur, e djerrë e të paqenies
Ku përsillet gjithësia, ka nxjerrë në shesh një botë.
Por kur përpjekja të ndërpritet, do të shihni
Se si ky pallat pa anë e pa fund i ekzistencës
Do të bëhet një botë e paqenë... as një dritë e as një shkëndijë.
Vërimi veshin fuqisë së kuptimit se ç'thotë:
Ky përqëndrim i madh, kjo përpjekje mahnitëse,
Është përpjekje që nga paraqenia, rregull hyjnor;
Vrulli i begatisë së paraqenë duket hapur në gjithësi.
Vullneti që të qenën e bart nga Pafillimi në Pafundësi
Që, universin me cilësi mbresëlënëse
Përmes ndryshimeve, e çon drejt fundit të caktuar,
Dhe që është vetë Ai që e drejton këtë ecuri,
Themi se gjithë ç'shohim, është përpjekja e Tj.
E kujt? E Atij që e zotëron këtë fuqi,
E asaj enigmës së fshehtë!
As pushon, as rri në qetësi, për më tepër,
Nuk ndalet duke shfaqur krijimtarinë e Vet në vepër!

Ejani, tani, e të mendojmë një tjetër fuqi
Që i ka lindur të gjitha forcat dhe në thelb është lëndë...
Po! Ç'është kjo? Jo tjetër, puna e të njëjtës urtësi:
Plotësisht trajta e përqëndruar e përpjekjes në Pafillim.
Edhe thelbi i kësaj lëndës që futet në shumë trajta,
Mbështetet te dinamizmin e pandërprerë të përpjekjes
Pse? Sepse është krejt përqëndrim energjie.
Edhe koha mbështetet në përpjekjen,
Sepse gjithë po me atë ecën.
Edhe hapësira mbështetet në përpjekjen.
Zbriteni përpjekjen në zero
Do të jetë absurde t'i mendoni hapësirat dhe krijesat në to.

Shtyllat e dritës shpërthyer prej shkencave
 Të ngjitura në zenith, takuan qiejt, por ende s'kanë arritur
 Në faqen e parë të librit të lartë të krijimit.
 Dhe kjo faqe e parë, prapë në errësirë gjer në pambarim!
 Nuk shihen që të këndohen faqet e errta të së panjohurës,
 Në çdo rrjesht, njëqind mijë dyshime
 Janë kah pengojnë arritjen drejt njohurisë së drejtë.
 Sapo përfytyrimi të dojë të notojë drejt dritës,
 Netët dallgë-dallgë e zvarrisin atë drejt vorbullave.
 S'ekziston mundësia të arrijmë në kuptimin e krijimit;
 Ndërkaq, në krye të atij librit mbresëlënës të ekzistencës
 Ndriçojnë të shkruara me një shkrim shumë të lexueshëm
 Këto fjalë që, po s'i patët parë, merrini:
 "Kush thotë: "e drejtë imja është të mbijetoj" ,
 E ka për detyrë të përpiket e të punoj';
 Përpiqu, përpiqu se mbijetesa në këtë bot'
 Realizohet vetëm me përpjekje për jetë e mot!"
 Hëna përpiket, tokë e qiej përpiqen;
 Dielli përpiket, planetet përpiqen.
 Kometet s'mbeten pas në përpjekjen e mundimshme,
 Djersë e ballit janë të gjitha ndriçimet që reshajnë pa pushim!
 Mos i shihni dhe i pandehni të huaj trupat në qiej...
 Ata janë një familje e vjetër, në qiell e kanë pasë të shkruar.
 Ndërkaq, edhe pse e kanë qendrën shumë larg në qiej,
 Vijnë e na ushqejnë ne me plot bujari.
 Megjithëkëtë, kjo familje s'u përngjet aspak tonave:
 Pjesëtarët e saj s'kanë rënë në mosmarrëveshje
 Ndoshta dhe një herë.
 Gjuha e tyre është 'gjuhë e trupit' të natyrës,
 Mes tyre bie në sy një marrëdhënie prej mjeshtërish.
 Mjeshtëri shumë e hollë por dhe krejt e mprehtë...
 Ç'dialog qiellor ky, ç'oratori krejt e qartë!
 Shihni si duhen anëtarët e kësaj familjeje:
 I vogli, shpirti i të mëdhenjve, dritë e syrit të tyre.



I madhi është për të vegjlit mbrojtës, edukues...
Shkon, ua vë në rregull jetën, i sheh, i përgjon me kujdes.
Dielli që është kryetari i dhembshur i familjes,
Duke e rrokur seriozisht hapësirën nga froni i tij i shkëlqyer,
Kërkon me shikime nga çdo anë shpurën e tij
Ashtu siç kërkon një i mjerë të dashurën e humbur.
Dhe kur i gjen të gjithë, ajo zemër nazemadhe,
I merr një e nga një në prehërin e ngrohtë e të dhembshur.
Ajo çka e mban këtë familje, është gjithmonë kujdesi i tij;

Hija që shëtit mbi ta është hija e vet.
Ajo hije është që, kur nuri i shpërndahet largësive,
Në pallat të qiellit blu nisin të shkëlqejnë dritat e jetës.
Po, pjesëtarët e kësaj familjeje nuk rrinë
Por, duke u kapur dorë për dorë,
Me një orientim të përcaktuar qysh në Pafillimshmëri,
Vrapojnë pa prapë për ta rrokur më të mirën e së mundshmes
Dhe, kur e shohin pafundësinë e hapësirës,
Shpërthejnë në entuziazëm krejt!
Këtë vendosmëri dërrmuese,
Si mund ta rrëzojë në pesimizëm ndonjë pengesë?
Sepse as që duan t'ia dinë se rruga është tejet e gjatë!..

Ç'pafundësi harmonike! Ç'lëvizje e sistemuar!
Po programi që kanë në duar? Po e patë me kujdes,
Është përpjesëtimi i detajuar i përpjekjes,
Një detajim i hollë, tepër rëndë për ta kuptuar.
Nuk shihet që dikush të ndalet për të pushuar...
Sepse ndalesa e tij në çast tërë një familje ka për ta shkatërruar.
Domethënë, po deshi, një thërrmijë shemb një mijë botë!
Po ku është parë që ajo thërrmijë të priret për përtesë?
Shihni, a rri Plejada, shihni, Kaneopea, a rri?
Edhe Siriusi tek sheh Kaneopenë, përpiqet pa pushim.
Sheh Arusha e Vogël Zenithin dhe përpiqet.

Pa le Ramihu me Azelin që nuk bëjnë asnjë çast pushim!
 Shkurt, yje të panumërt që duken apo përfytyrohen,
 Përpiqen pa pushim!
 A mund të përfytyrohet në largësitë e pafundme
 Ndonjë ndalim?

Secili prej individëve që e përbëjnë këtë shpurë,
 Këtë karvan që vrapon natë e ditë,
 Eshtë kryetar i pandryshuar që drejton një familje të pasur.
 Në të vërtetë, këto familje nuk shihen edhe sikur
 T'i kontrollonim vend për vend largësitë;
 Ndërkaq, po të shëtisnit me dritën udhërrëfyese të shkencës,
 Në çdo hap kuptohet ekzistenca e një ylli.
 Duke u bërë bashkë këto familje qiellore,
 Në gji të qiellit blu lind një fis;
 Kjo masë, duke iu nënshtruar një kryetari Famëmadh
 Që ndodhet çdo kohë pas perdes, gjithnjë krenar
 Me të gjithë harmoninë e një uniteti serioz por dhe të gëzuar.
 Dhe kjo masë është gjithësia jonë
 Që, pavarësisht se në sytë tanë duket sikur i përfshin qiejt,
 Brenda Kashtës së Kumtrit i ka kufijtë.

Lërinin yjet... Edhe nebulozat, me të drejtë,
 Përpiqen, rrotullohen, rropaten me qëllim për t'u zgjeruar;
 Ato janë nga një fis më vete, nga një gjithësi e gjerë.
 Pjesa e mbetur e kësaj bote qiellore, një komplet i së cilës
 Eshtë në trajtë familjeje siç e thamë më parë,
 Përpiqet vazhdimisht për t'u dhënë jetë individëve
 Ende të fshehur në mitrën e krijimit.

Ç'është kjo hije e quajtur fushë fuqie, e cila zgjatet e shkon,
 E tillë që edhe hapat e dritës, madje, e kanë prerë shpresën
 Për t'i ndjekur dhe matur përmasat e saj?
 Ç'është rregulli i përpjekjes në të gjithë këta përpjekës?



Ç'illoj rregulli është që i orienton pa i shpërndarë
Drejt pafundësisë?
Këto botë të pafundme nuk bëjnë dot pa drejtim...
Mirë, po cila pikë është qendër për drejtim?
Cili është, vallë, tani, vendi i gjithësisë sonë
Brenda kësaj mase që s'e nxënë largësitë?
S'duhet përpjekur aspak për t'u futur në fytyrën e brendshme
Të urtësisë së ekzistencës:
Ajo është një botë enigmatike e mbyllur fund e krye!
O ti, forcë e kuptimit njerëzor, a e di se je një hiç?
Ndryshe, a do të ta bënin këto të fshehta zemrën copë-copë?
O ti, mendje njerëzore e mjerë, sa e dobët paske qenë,
Ndryshe, fundi i përpjekjeve të tua
A kështu bosh kish për të qenë?
Po, nuk ka aspak dyshim se botët një ligj i drejton...
Por cili është kuptimi i tij?
Gjithësia mos është kjo masë që shikojmë?
Apo të gjitha këto botë që shihen,
Janë një copë e parëndësishme e botëve të tjera
Që s'u dihet emri? Po qe se ekzistenca s'rrethohet
Nga mosekzistenca, ç'natyrë do të ketë, vallë?
Pse s'ndriçohet kjo natë të fshehtash, o Zot?

Është një zë që këtë guxim e huton papritmas dhe e hesht,
Me dallgët e larta të të cilit tronditet bota engjëlllore:
"Mos e harro veten, o njeri dhe dije se e fshehta e krijimit
Do të mbetet e pazbuluar gjer në pafundësi.
A është e mundur që një grusht dhé ta përfshijë qiellin?
Ato fusha ku drita e forcës së kuptimit nuk do të arrijë dot,
Mendo se janë vetëm një fillim i Fuqisë Sime.
Gjërat që ekzistojnë, që, sipas mendimit tënd, s'kanë fund,
Janë një thërrmijë e parëndësishme e botës Sime krijuese.
Në breg të oqeanit Tim të pafundësisë vjen
Dhe gjer në pafundësi përkulet para tij, bën ruqu

Forca e kuptimit në kijam duke qëndru'.
 Zgjuarsia bie në sexhde, fantazitë asgjësohen.
 Ti s'ke punë në atë fushë! Ajo fushë është distanca
 E mbyllur për të gjitha krijesat: *Kâbe kavsejn*.*
 Të fshehtat e saj 'janë të hapura për parashikimin e vizitorëve,
 Hiq, mos rri para pallatit Tim të unitetit! Hiq
 Dhe hidhu në mes të një bote që Ta dhurova ty
 Me anë të bujarisë Sime të hapur qysh në pafillimshmëri...
 Ngjitu në qiell, shëtite hapësirën, zbrit në tokë
 Dhe ndjeje harmoninë e argumenteve të mia të urta
 Që janë gjuha ime e fshehtë,
 Që e bëjnë ekzistencën të rënkojë
 E që janë të drejtuara për kah një kuptim i vetëm!
 Mos u mendo gjatë,
 Eja dhe përshtatiu kësaj harmonie të pafund:
 "Kush thotë: "e drejtë imja është të mbijetoj",
 E ka për detyrë të përpiqet e të punoj';
 Përpiqu, përpiqu se mbijetesa në këtë bot'
 Realizohet vetëm me përpjekje për jetë e mot!"

Merrni një gur të vogël dhe, në fillim, të gjitha pikat e tij
 Mbajini nën dritën e shkencës, pastaj ngrihuni
 Dhe vrojtojani qenien me mikroskop,
 I cili duhet të jetë drita e vetë mendjes.
 Dhe zmadhoheni këtë gur sa toka, zmadhoheni sa qielli,
 Shkurt, zmadhoheni e bëjeni sa një gjithësi
 Dhe do të shihni se me atë ekzistencën e tij të vogël
 Që kërkon të mos rrijë, por ta përfshijë rryma,
 I kapërcen të gjitha pengesat që i dalin
 Zellit të tij përpara.
 Domethënë se kjo copë guri tani përpiqet me të gjitha
 Mundësitë e tij sepse në përpjekjen që mbush tërë botët,
 Duhet të shtohet edhe përpjekja e tij!

*E ka fjalën për versetin 9 të kaptinës kur'anore Nexhm.



Kështu, pra, ju mos e shihni të pavlerë këtë copë guri...
Ai është një qenie madhështore, një mikrokozmos,
Bashkë me planetet, nebulozat, yjet, qiellin, diejt.
Tregon gjithësinë këtë gjithësi që e njohin krejt
Përfytyrimi rrëqethet nga tmerri i kësaj pamjeje:
Secili prej elementëve që e përbëjnë atë, është një fis,
Kurse molekulat, janë familjet me radhë.
Merrini thërrmijat më të vogla: Megjithëse s'shihen,
Edhe ato përbëhen nga elementë shtresë-shtresë.
Kjo do të thotë se thirrja që i jep rënkim zemrës së largësive,
Harmonia e asaj përpjekjes që lëshon thirrje gjithandej,
Ajo luftë e përgjithshme, qenka brenda ekzistencës së ngushtë
Të gurit më të pavlerë... Çudi!
Elementët që e përbëjnë këtë gur të pajetë,
Lëvizin e vijnë rrotull brenda një uniteti,
Një harmonie të pafund, ashtu që çdo përqëndrim
I prodhuar nga kjo përpjekje, me kohë shndërrohet
Në shumë lloje energjish aktive:
Ose shndërrohet krejtësisht në forcë tërheqëse,
Ose merr trajtë tjetër e bëhet dritë,
Ose duket në trajtën e një ndriçimi rrufeje,
Ose formon një nxehtësi që rrjedh e shkon,
Ose krijon dridhje magnetike valë-valë.

Po ç'do të ndodhte sikur këtë model të gjithësive, vallë,
Të vogël edhe kështu,
Ta zvogëlonim me sa të kishim mundësi?
Ta zëmë se u zvogëlua, u bë, më në fund, një molekulë...
Dhe tani shqyrtojeni dhe shiheni këtë molekulë një herë:
Shihni se si në zemër të tij lëvizin e përpiqen
Me të gjitha botët bashkë diej të panumërt!
Në qiejt e tij ka shpalosur flatrat e njëjta harmoni,
E njëjta përpjekje ngjyra-ngjyra në detrat e tij!
Shihni, pra, se edhe molekula, me trupin e saj të paqenë,

Arrin ta përfaqësojë tërë gjithësinë!
 Dhe shihni se edhe gjithësia e merr molekulën për model!
 Dhe, kur ky det të fshehtash pamundësisht i kuptueshëm,
 Fryhet e dallgëzohet në diell, në hije e kudo,
 Hedh në breg, me anë të një dallge të saj, këtë ide:
 “Kush thotë: ”e drejtë imja është të mbijetoj” ,
 E ka për detyrë të përpiqet e të punoj’;
 Përpiqu, përpiqu se mbijetesa në këtë bot’
 Realizohet vetëm me përpjekje për jetë e mot!”

Shihni te forcat e natyrës këtë përpjekje të vazhdueshme:
 Po të mos vepronte forca e nxehtësisë, s’do të kishte stinë!
 Ajo një kohë pakësohet, pastaj një kohë shtohet,
 Ujin e avullon, avujt i merr e i dendëson.
 Po drita, a rri? Vazhdimisht me errësirën bën garë...
 Shkurt, toka, deti, gjithçka përpiqet e punon.
 Me ngjitjen e avullit lart, në ajër grumbullohen re,
 Ujrat e mbledhura në re, reshojnë si lumë në dhé.
 Toka hedh nga përbrenda flakë drejt faqes së qiellit,
 Faqja e qiellit, si përgjigje, i lëshon tokës rrufe.
 Kur dëgjojnë se ajri ka marrë vrull,
 Edhe lumenjtë nisin të gjëmojnë;
 Kur e sheh këtë era, nis të fryjë e të shkumbëzojë!
 Ç’është kjo zhurmë në qiell, ç’është kjo rrapëllimë në tokë?
 Po, ky zelli i forcave të natyrës sup më sup,
 Që është një përpjekje zinxhir që s’ka fund,
 Mblidhet në gji të tokës e përqëndrohet;
 Është një shembull i madh
 Që e bën të pavdekshëm emrin e jetës;
 Në ballë të tij shfaqet e rri kjo ide:
 “Kush thotë: ”e drejtë imja është të mbijetoj” ,
 E ka për detyrë të përpiqet e të punoj’;
 Përpiqu, përpiqu se mbijetesa në këtë bot’
 Realizohet vetëm me përpjekje për jetë e mot!”



Gjallesat shihni. Të gjitha bimët, të gjitha kafshët,
A nuk vrapojnë pas të drejtave të tyre të jetës?
Duke u marrë me forcat e natyrës,
Edhe ata, si gjithë bota, kërkojnë të jetojnë.
Disa forca të natyrës i ndihmojnë ata të mbeten në jetë,
Kurse disa të tjera, sulmojnë për t'u përgatitur vdekjen.
Të mjerët, brenda një çasti një mijë herë
Ikin nga një palë për të vrapuar te pala tjetër!
Ata që e quajnë se kanë të drejtë të jetojnë,
Nuk dinë të lodhur... Por sa keq që deri ku?
A e kanë parë organizmat se ç'është prehja?
Sapo që një qenie organike që bie në këtë shesh mudi,
Të pushojë së përpjekuri, tjetra e shkel menjëherë
E vazhdon më tej. Po përse do ta zgjedhë këtë vetëvrasje?
Ja, pra, shkon përpara pa ndërprerë aspak
Për shkak të vrapimit pas një qëllimi të zgjedhur
Të lënë si amanet shpirtit të saj me dorën e Fuqisë Krijuese
Qysh në pafillimshmëri.
Jo për t'ia arritur atij qëllimit nazemadh,
Gjë që është synimi i jetës,
Por vetëm përfytyrimi i arritjes, madje, është tërheqës për atë.
Shpresa e kapjes së këtij synimi, të këtij përfytyrimi,
E bën atë shpirt të lëvizshëm të vërtitet natë e ditë.
Përpiqet ta bëjë të veten faqen e tokës,
Por ç'e do se edhe shpresat të tjera përzihen në të papritë.
Sapo te shumë gjallesa shpresat të nisin të përballen
E të cysin njëra-tjetrën, ajo luftë e përhershme s'mbaron kurrë.
Në këtë luftë fiton ai që është përpjekur,
Kurse i mbyturi, i ngordhuri është ai që ka ndenjuri.
S'dihet ç'ka dashur, por i Urti i Përjetshëm,
E ka krijuar botën fushë lufte dhe jetën, si një luftë.
Ai që s'ka në dorë armën besnike q'i thonë përpjekje,
Të mos shpresojë aspak se një ditë ka për të shpëtuar!
Qoftë në mbrojtje, qoftë në sulm,
Pa tjetër duhet qenë i armatosur ai që hyn në këtë luftë!

E gjithë kjo zhurmë e luftës për jetën,
 Zëri i hidhur i të mbeturve gjallë,
 Zëri për të ardhur keq i të vdekurve,
 Pemët që i spërkasin gjethe kohë më kohë qiellit,
 Lulet që shtrojnë aty-këtu qilima mbi tokë,
 Elegjitë e çuditshme të zogjve përballë pranverës,
 Klithjet e frikshme të kafshëve të egra përballë gjuetarëve,
 Pranvera me bukuritë e saj, vjeshta me shqetësime,
 E recitojnë paprerë këtë vjershën e krijimit:
 “Kush thotë: ”e drejtë imja është të mbijetoj” ,
 E ka për detyrë të përpiqet e të punoj’;
 Përpiqu, përpiqu se mbijetesa në këtë bot’
 Realizohet vetëm me përpjekje për jetë e mot!”

A nuk ka rënë edhe njeriu në këtë luftën për jetë?
 Jeton në këtë botë duke luftuar pa shpëtim.
 Po, jeta e njeriut është produkt lufte dhe përpjekjeje.
 Pa këtë s’ka as individë, as familje.
 Shihni individët një e nga një: përpiqen paprerë;
 Shihni se si familjet nuk rrinë por përpiqen.
 Merrni me radhë shoqëritë, pastaj fiset,
 A ka, vallë, mes tyre që ta kenë lënë luftën për kafshatë?
 Ndërsa ai ligj i përjetshëm, roje i harmonisë së ekzistencës,
 E mban nën sundim tërë gjithësinë,
 Njerëzimi do të mbetet i vetëm po të mbetet jashtë tij.
 Jo, në drejtësinë e natyrësisë nuk ka përjashtim.
 Ata që kanë fituar të drejtën për të jetuar, i kujton, i sheh;
 Ata që s’përpiqen, i vret me dorë të vet një e nga një!
 Ata që duan të jetojnë, vrapojnë e përparojnë,
 Në rrugë, duke e ditur se mundimi është mëshirë,
 I pranojnë vështirësitë.
 Ah! Ata që e shohin përparimin te popujt, kanë të drejtë
 Që thonë se brenda kohës na duhet edhe një tjetër kohë.



Tani shihni një herë Perëndimin që përpiqet e lufton;
Sundon edhe në ajër se toka s'i mjafton.
Kthehuni dhe soditeni Lindjen dembele: Sa pas!
Së shpejti ndoshta s'do t'i mbetet më vend mbi tokë!
Ç'janë këto një sërë shkencash, këto arte?
Ç'janë të vërtetat të zbuluara me këto shkenca?
Anijet që çajnë detrat pjesë-pjesë.
Trenat që e përshkojnë botën vend më vend.
Të rejat që ia hipin rrufesë e përhapen në fushë.
Balloni me gaz të dendur që ngrihet në ajër...
Shkurt, të gjitha këto vepra marramendëse
Janë produkt i përpjekjes së përqëndruar në një vend.

Grykët e frikshme të topave që vjellin drejt armikut ferr,
Re armësh që mbajnë mbi supe rrufe,
Prita të gjata që s'u japim mundësi syve plot lakmi,
Kala të hekurta me vullkane në gropat e tyre,
Jetë të jetuara në mirëqenie, gëzimet dhe haretë,
Lumturi të mëdha që u japin syve gëzim,
Shpresa të realizuara, pushtete, nam e famë,
Vlera të larta të pazhvlerësuara,
Zhvillime të vazhdueshme në qytetërim...
Të gjitha këto janë produkte të konkretizimit të përpjekjes...

Ndërkaq, vende me pamje varri,
Të cilat shfaqen kohë më kohë,
Jetë që s'kanë aq ndryshim nga një kufomë,
Gjaqe të turbulluar, të qelbëzuar që qarkullojnë nëpër damarë,
Zvarritje, ngordhje, gjëra për turp e për faqe të zezë,
Pendime me përfitim lotë dështimi,
Vlera të larta të humbura, mirëqenie dhe ardhmëri e shkatërruar,
Një depresion kolektiv, pavarësi e humbur,
Qeveri të pafisme që rrojnë me të lypur,
Popuj të mjerë që lavdërohen me robëri,

Gërmadha, shtëpi tërë baltë, njerëz prej balte,
 Fusha të pambjella, pyje të prerë,
 Ujra të ndenjura, kanale të kthyer në përrenj,
 Ethe, tifo, sëmundje ngjithëse që përhapin vdekje,
 Besime të kota, nomatisje, lidhje nyjesh për magji,
 Të gjallët shkojnë varr më varr, duke kërkuar derman për të sëmurët...
 Të gjitha këto, mbetje të ndyra të dembelizmit!
 Shembulli i kësaj jemi ne... Kush dëshiron, le të shohë!
 Shihni dhe merrni mësim nga gjendja e këtij vendi!
 Si ishe, o popull i madh, fundi si t'u bë?
 Të huajt paskan neveri, kanë, posi:
 Pasha Zotin! Edhe lypësit janë më të nderuar se ti!
 Ke kohë që e ke harruar ç'është nderi e dinjiteti,
 Ndjenjën e turpërimit e mënjanove,
 Gjërat e shenjta i vrave, Allahun e sulmove!
 As për kujtimet respekt ke, as traditat i kujton;
 A kështu pati bërë yt gjysh, o bir i mjerë!
 Jeta që e ke bërë zakon, më e turpshmja e jetëve;
 Tani etërit e tu të turpërohen prej teje!
 Gjaku në damarë të është pothuaj qelbëzuar,
 Edhe ai shpirti që s'do të të dalë, qenka një copë ngordhësirë!
 Po qe se s'paske mundësi ta kthesh të kaluarën prapë,
 Gjithsesi është më mirë të ngordhësh nga kjo jetë e pështirë.
 Fundja, s'të ka mbetur anë ende pa ngordhur...
 Mos ka shumë ndryshim të hequrit zvarrë nga vdekja?
 Gjëja që kërkon ti, të hiqesh zvarrë! Megjithatë, koha
 S'të shqitet pas; do ta gjejë një gropë
 Për të ta hedhur kufomën e ngordhur!
 Sot ti je një njollë në fytyrë të botës;
 Pse mos të ta heqë trupin, përse të vuajë?
 S'mund të thuash "s'dita gjë"; e dije fort mirë:
 "Në jetën e një populli s'ka vend e ndenjura dhe pushimi".
 Po u shfaq topitja në jetën e një populli,
 Mbetet si ti për turp, nën robëri!



Ç'është ky pajtimi yt me mizerjen, pa lëviz vendit edhe ti!
Pse nuk lëviz? Pse? Ç'po ndodh me ty?
A pse? "Sepse nuk ke prirje për këtë jetë kalimtare,
Prandaj dhe nuk të shkon dora për të punuar!" Kështu?
Edhe unë besova! Zoti e di se është gënjeshtër!
Ku është parë të kapet dikush pas jetës sa ti?
Gjithë puna, vetëm të mos ngordhësh
Në këtë "botë të vdekshme"!
Jo vdekja e vërtetë, po dhe sikur iluzioni i saj
Të të dalë para në ëndërr, të plas tëmthi pa dyshim!
Mendo: Ç'të ka mbetur në dorë pa e flijuar për jetën?
A nderi, fama, trimëria, feja, besimi?
Apo vatani, ndjenja e dashurisë për vatanin,
E drejta, ndërgjegjja, varret, tyrbetë, eshtrat e të parëve?
Apo njëra nga xhamitë që ia ka hapur prehrin kryqit?
Ç'të mbeti pa dhënë për një jetë të kalbur?
Sikur të numëroheshin dot, ah, shpërblimet për shpëtim!
Ndërsa fëmijët theren, gratë rënkojnë,
Të mjerët të presin ty duke të pandehur për burrë,
Ti ikën lakuriq tërë rrugës duke braktisur turpin, nderin,
Pa u mërzhitur aspak, o bastard, apo jo!
Kur në një anë mijra vetë të thërrisin "kthehu!",
T'u ngulën para varret e të parëve
Që ti u the "mos më dilni n'udhë duke ikur"
Dhe vazhdove të ikësh duke u kaluar sipër!
A s'e dëgjoje ç'thoshte Ati yt i madh*?
"Fitorja është pára, o bir; është më mirë të sulmosh,
Ta kapërcesh kufirin e armikut dhe të marrësh,
Në mos tjetër, një varr, se sa të zbrapsesh
E, pastaj, një mijë vjet të rrosh!.."
Ç'fjalë e madhe kjo, ç'besim heroik!
Turp për ty që e turpërove këtë shpirt të madh

*Gazi Tiryaki Hasan Pasha.

Dhe tërë varret e muslimanëve i le t'i shkelë mosbesimi!
 Piskama vaji e mjerimi ushtojnë nga çdo varr
 Por a ka kush që të kujdeset për gurët e mjerë?
 Jo rënkimi mallkimtar i kufomës në varr,
 Por as klithma e shumë e shumë njerëzve të gjallë
 S'të pati kthyer dot ty!
 S'është mendim i keq dëshira jote për t'i shpëtuar vdekjes,
 Por për të mbetur në jetë, për jetën duhet flijuar!
 Jeta e vërtetë është jeta e fituar duke dhënë gjak,
 Kurse jeta jote mjerane është fituar duke dhënë nder!
 Si të ketë jetuar gjyshi yt, ashtu jeto dhe ti në qofsh burrë!
 Nëse s'arrin që mbi kokë të vësh kurorë ngadhënjimi
 Ta ngrënçin kafkën korbat e zinj, të raftë mallkimi!
 Ç'thua? Të shkon për qejfi t'i dëgjosh këto fjalë mjerimi?
 Aq miq të ngushtë i ke bërë poshtërsinë dhe ultësinë,
 Saqë çdo të keqeje ia hap gjoksin
 Mjafton që të mos shohësh vdekje në skaj të saj!

Vendi yt mes popujsh është vendi që gëzon
 Mes një shoqërie një lypsar!
 Më thuaj, ç'kënaqësi ka në këtë jetë të shkatërruar?
 Shkon drejt veriut: një pritje e ftohtë;
 Shkon drejt jugut: një nënvleftësim i hapur!
 "Aman, Grej, veç ti mund të na gjesh shpëtim!..
 O shpirt, Puankare, mbaruam, tregohu i madh, na jep ndihmë!"
 Kur ti the kështu, të thanë nga ajo anë: "Zoti të dhashtë!"
 A ecën politika me lypësi, o budalla?
 Gjaku i politikës është kapitali, jeta është forca.
 Europa e shtyp të dobëtin, ajo i njeh të drejtë vetëm fuqisë.
 Kur flota dhe ushtria jonë përparonin me fitore,
 Përfaqësuesit e Perëndimit kishin mall të na puthnin yzengjijtë!
 Pse e lëshove nga duart atë madhështi
 Dhe sot i shtrirë nën këmbë rri?
 Thua "qe e shkruar"! Ashtu, ë? S'është e drejtë!



E drejtë është: Zoti ta dha belanë që deshe vetë!
Ç'të kërkosh, në fund atë do të gjesh;
A mund të të bëjë vullneti hyjnor ty padrejtësi?
Sheriati të tha "përpiqu", kurse ti ndenje,
Në emër të shariatit sajove sa e sa bestytни!
Më në fund, nise të arsyetohesh nën pretekstin "I nënshtrohem Zotit",
Fenë e gjorë e poshtërove me këto fjalë!

Lëre ti punën dhe urdhëro prej ku je ulur
E mos u lodh se ja, ke Zotin shërbëtor personal!
Në mëngjes, para se të dalësh, i shkruan punët
Një nga një në një listë se i kryen Zoti: është detyrë e Tij!
Ngarkesa t'u lehtësua... Pra ti shko tani drejt në kafene!
Fëmijët mund të hiqen zvarrë e të mbeten të uritur...
Po a s'i ushqen Zoti ata? Ti shih qejfin tënd!
Thesari i të mirave të Tij është dhe i yti;
Ngarkoja të gjitha shpenzimet... T'i jep!
Zoti përdor armën, Ai ruan në kufi;
Qenkan mbaruar ushqimet e municioni? Furnizon Ai!
Dërgon nën komandën e vet engjëj si ushtri
Që i shtrojnë për tokë armiqtë për hesapin tënd!
Po mbete ngushtë, mjafton ai zëri yt nazemadh:
"Na ndihmo!" Dhe Ai vjen vetë ose dërgon Hëzrin!
Po të kesh të sëmurë në shtëpi, e ka për borxh t'i shikojë,
Thesari i shërimit do të derdhet e do të kullojë.
Domethënë se Zoti është çdo gjë për ty: shoqërues, argat;
Fëmijët janë të Tij: dado, motër e madhe është Ai!
Veqilharxhi, qehajai, arkëtari yt është Ai!
Ti je përgjegjës për të marrë, për të të dhënë ty, Ai!
Në det do t'u bëka luftë... Ai është gjemi dhe kapiten!
Po të të duhet ushtri, Ai është ushtri dhe komandant!
Ai është roja i fshatit, defterdari i qytetit,
Mjeku, farmacisti i familjes... Shkurt, gjithçka është Ai!

Po ti, çfarë je? I nënshtruar dhe dorëzuar Zotit!
 Këtë s'e ha kush më!
 Trego pak respekt! Ç'mungesë respekti kjo!
 E bëri Zotin rob, kurse vetë u bë Zot
 Dhe këtij guximi i thotë, pa u turpëruar, nënshtrim!
 Çifutët për Uzejrin dhe krishterët për Isanë thanë se janë
 Bij të Zotit dhe besimi mbi njësinë e Zotit u prish;
 Po ky politeizmi yt i thellë, si përputhet me besimin tonë?
 Nënshtrimi dhe dorëzimi Zotit mos do të thotë
 T'i japësh urdhër Atij? As që mendon se Kur'ani
 Është zbritur për të... Po ta pyesin, ka rrezik të thotë
 Se Kur'ani i flet Zotit!
 Kjo krijesë e ulët që u ka hapur luftë gjithë urdhrave të Zotit,
 Edhe gjërat për të cilat është përgjegjës, ia ngarkon Atij!
 E sheh njeriu i shkretë se ku ka rënë ky i pafismë
 E si nuk mëkaton ndaj nënshtrimit e kaderit?
 Edhe në një punë krejt të vogël, po s'përdore
 Mjetet që do të çonin në plotësimin e qëllimit,
 A do të kishe vallë mundësi të arrije sukses?
 Po e kalon edhe cakun e marrëzisë! Mjaft me kaq!
 Ku ka arë të korret pa mbjellë? Na e trego!
 Kaderi siç e kupton ti, është shpifje ndaj shariatit.
 Sidomos kuptimi yt mbi nënshtrimin ndaj Zotit,
 Është humbje pas humbjeje...
 Kaderi është nga detyrimet e besimit... Besuam...
 Por në të nuk ka ndonjë kuptim të shtrembër siç e kupton ti!
 Kaderi është, pas plotësimit të kushteve të duhura,
 Realizimi në botën tonë i gjërave të paracaktuara.
 Pse? Si vjen?.. Kjo është krejtësisht e fshehtë,
 Ne jemi përgjegjës për atë që kemi zgjedhur vetë
 S'të takon ty ta hetosh se ç'është e fshehta e kaderit;
 Detyra jote, të bësh ashtu siç të ka urdhëruar Zoti!
 Kur kaderi hyn në atë trajtë ku ti kërkon ta futësh,
 Të gjitha urdhrat e shariatit asgjësohen në çast!
 Ndryshe, përse Profeti i dashur i Zotit



Ua ndalon shqyrtimin e kësaj çështjeje besimtarëve?
Shih se ç'kuptonin shokët e Profetit me kaderin:

Një herë, halifi Omer, me ushtarët nën komandën e vet,
I pati shkuar në ndihmë Ebu Ubejdes.
- Mos u lëkund se ngjarja është plotësisht e dokumentuar. -
Omeri zuri rrugën e Damaskut e zbriti në Surg.
Sapo mori lajmin, Ubejde vrapoi menjëherë pranë tij.
Omeri e pyeti kryekomandantin: "Ku është ushtria?
Ç'keni bërë? Ç'duhet të bëjmë?"
Ebu Ubejde i tha se në ushtri kish rënë murtaja.
Në vend që të ecte para, Omeri qëndroi
Dhe i pyeti muhaxhirët fisnikë:**
"Si është mirë, të hyjmë aty ku ka murtajë,
Apo të mos hyjmë?"
Disa prej tyre thanë se qëllimi ishte i rëndësishëm,
Pra, duhej shkuar. Të tjerët thanë se kjo ishte e rrezikshme.
Atëherë, halifi thirri ensarët*** që shfaqën po të njëjtën lëkundje.
Halifi i shpërndau ata, por u mërzit..
Kishte mbetur t'u drejtohej më pleqve
Të muhaxhirëve kurejshë. Dhe i pyeti dhe ata, në një fjalë,
I thanë: "Të shkosh drejt murtajës është gabim!"
Omeri u tha sahabëve se të nesërmen do të ktheheshin pas.
Dhe, kur të nesërmen herët u vu për udhë
Me njerëzit e vet, Ubejde i doli para e i tha:
"Të qoftë për mbarë, Omer!
A nga kaderi i Allahut po ikni tani?"
Halifi Omer iu kthye e i tha: "Drejt e the, vetëm se
Ne po ikim nga një kader i Allahut
Për në një kader tjetër të Tij!
Po qe se devetë e tua, Eba Ubejde,

* Mos flisni shkel e shko për kaderin, sepse ai është fshëhtësi hyjnore. (Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, 1-132.

** Muhaxhirët: emigrantët mekas.

*** Ensarët: ndihmëtarët, medinasit muslimanë.

Ndodhen në shtratin e një përroi dhe ti i nxjerr
 Në një vend shkëmbor të thatë ose, ndryshe,
 I çon në një kullotë, a s'ka të bëjë kjo me kaderin?"
 Duke thënë Omeri këto fjalë, vjen aty Ibni Avfi
 Dhe nis menjëherë të rrëfejë hadithin e murtajës.
 Kur e dëgjoi Ebu Ubejde këtë, pushoi.
 A e pe se ç'kuptonin me kaderin muhaxhirët kurejshë,
 Të mëdhenjtë e shokëve të Profetit dhe Omeri
 Që qe shtyllë e fortë e sheriatit?..
 Mos u nis përsëri pa turp të shpifësh kundër Zotit!
 Sidomos kuptimi i nënshtrimit ndaj Zotit
 Nuk është aspak ashtu! Sa keq që një turmë injorantësh
 Me tru merimange, duke i luajtur fesë lojën më të poshtër,
 Bënë, ç'bënë, e sollën në këtë gjendje atë!
 Sa keq që fytyra e fesë u bë që të mos njihet,
 E rrethon sot islamin një vështrim mallkimtar.
 Sikur ta dija se si i mpitë mendjet, o të pafytyrë,
 Për t'i dhënë nënshtrimit një trajtë të tillë të keqe!
 Mos vallë në ballin e sheriatit të pafajshëm
 Qëndron ende gjurma e zezë e asaj njollës ndjellakeqe?
 Nënshtrimi ishte një shenjë e tillë e fuqishme besimi
 Që, po ta quaje më të lartën e vlerave, i kishte hije.
 Sa keq që i shartuan frymës së tij mjerimin
 Dhe, si një mikrob i keq e shkatërroi vendin!
 Pa nënshtrimin, vlera dhe virtyti s'kanë më emër..
 Përfytyro një herë periudhën e parë të islamit:
 Në saje të kujt qe ai zhvillim i pafund
 I realizuar brenda një kohe të shkurtër gjysmëshekullore?
 Ç'pushtet ka një periudhë e tillë kohe në jetën e popujve
 Që të jetë e mjaftueshme për një mijë përmbysje?
 A qe parë një gjë e tillë ndonjëherë?
 Për sa kohë që njeriu e sheh të pamundur të ketë
 Kohë brenda kohës, e ka të pamundur të mos mbetet
 Gojëhapur para kësaj të vërtete!



Kur feja islame e çau errësirën dhe shpërtheu,
Në gji të Mekës bleroi një jetë e re.
Kur shpirti i Perëndimit ende s'e kish ndjerë këtë revolucion,
Forca e një grushti arabësh e përfshiu botën!
Një skaj i tyre u mbështet në Murin e Madh Kinez,
Skaji tjetër, duke kapërcyer si re mijra konstelacione,
U zgjat papritur në brigjet Iberike.
Mendoni ku është Hixhazi, Kina dhe ku janë Pirenejtë!
Cila është e fshehta e kësaj mrekullie? Gjithmonë nënshtrimi!
Kështu çon në fitore forca e qëndresës e buruar prej besimit.
Kur nënshtrimi i bëhet në zemër shok zellit,
Ndihma e Zotit i vjen rrotull dëshirës së zjarrtë të zemrës.
Shih se ç'i thotë Zoti të Dërguarit të Tij të madh:
“Sikur zemra të t'i dijë të gjitha fshehtësitë, sërish
Në punët e kësaj bote këshillohu me shokët
Dhe fali ata, sepse ti je një shpirt që fal.
Po të bëjnë gabim, mos ua vër re, fali, bëju mirë,
Pastaj lutu për falje për të gjithë ata.
Por, kur të marrësh vendim, mos rri,
Nënshtroju Zotit dhe nisu për udhë përsëri!”*

Domethënë se në fillim të çdo pune, duhet vendosmëri
Dhe pranë saj duhet nënshtrimi që ta mbështesë.
Shkurt, nëse edhe Pejgamberi është urdhëruar për vendosmëri,
Mendo dhe gjeje, më në fund, se ç'detyrë të bie ty!
Këto të dy janë shtyllat më të mëdha të shariatit.
Ata që kanë një besim të shëndoshë, të paprishur,
Nuk i ndajnë këto, i quajnë një dhe mbahen pas të dyve...
Ta themi hapur: Shpreh zell, nënshtrohet!
As fe mbetet, as botë po s'u kuptua kjo...
Edhe kuptojeni këtë, më në fund, edhe shpjegojani popullit.
Kjo duhet kuptuar mirë... Ose zgjati shalët
E shtrihu butë mbi shilten e leshtë

* Kur'ani, Al-i Imran, 159.

Dhe mos mendo për nesër! Sido që të jetë,
 Nga shtrati me pupla mos u largo as një hap;
 Nëse mërzitësh, nën jorgan klith: “Pa të shohim, Zoti ç’është
 duke bërë?”
 Ti s’e di se ç’bën Zoti. Vë re: “Pa të shohim,
 Ç’po bën ky robi Im tani?»
 Atëherë, pra, mblidhe shilten e shih të përparosh!
 Sa këndshëm e rrëfen Sadiu këtë hallin tënd...
 Duhet ta kesh dëgjuar... Sidoqoftë, pa e dëgjo:
 Një ditë një dervish hidhet nga fshati në mëngjes
 Për të kërkuar fatin dhe, në kthim, e zë mbrëmja në një rrugë.
 Kur dielli perëndon e erret, sheh se përdhe s’mund të flerë
 Dhe ngjitet në pemë. Pas pak, që aty dëgjon një rënkim...
 Sheh se është zëri ankues i një dhelpre të gjymtuar.
 E mjera ish bërë kockë e lëkurë, s’kishte këmbë për të punuar.
 Kurse gryka i kërkonte të punonte...
 Ç’të bënte, do të rënkonte!
 Pasi kaloi ca, një luan me një dre ndër dhëmbët e fuqishëm
 Po zbriste nga përballë në luginë.
 Tani njeriut mbi pemë iu pre fryma,
 Edhe dhelpra e la, sipas natyrës së saj, rënkimin.
 Pasi luani i ngopur së ngrëni, u fut në pyll,
 Dhelpra u zvarris e u afrua pranë sofrës së lënë,
 U ngop me ato që kishte lënë zotëria dhe ra në gjumë.
 Njeriu që i pati ndjekur nga pema këto ndodhi,
 Nisi të mendojë: “Sa i mëshirshëm është Zoti
 Që, sapo një dhelpër e çalë e dobësuar i ankohet për uri,
 Ia dërgon mu ndër këmbë ushqimin më të mirin...
 Atëherë, edhe njeriu duhet të heqë dorë nga puna!
 A e vlen kjo botë e rreme të vraposh nga mëngjesi në darkë?
 Ai që rri na del më i mençëm se ai që vrapon!
 A s’e sheh? Po fle për qejf një dhelpër e rregjuar,
 Më e ngopur se ti!
 Duhet nënshtruar që tani, ndryshe, s’ka se si.
 Sa keq për gjithato shqetësime që hoqa gjer tani!..”



Kur bëhet mëngjes, njeriu gjen në majë të malit një shpellë
Dhe vendos të mbyllet në vetmi adhurimi atje sa të jetë gjallë.
Ditën e parë sheh se askush s'kalon andej pari!
Ditën e dytë e zë uria, tretet e kullohet si qiri.
Ditën e tretë bëhet si mizë në letargji.
S'e kupton ç'është, vdekje apo gjumë
E, më në fund, shtrihet gjerë e gjatë; por shpejt shkundet
Nga një zë që se nga i vjen:
"Sillu përreth e bëhu luan grabitqar, o mjeran,
Pse dëshiron të shtrihesh e të bëhesh dhelpër e gjymtuar?
Kur të bëjnë këmbë e duar, puno të fitosh
Që me tepricat e tua të jetojë edhe një i paralizuar!"

Omeri e dinte, sigurisht, më mirë se ne ç'është nënshtrimi...
Ç'i bëri grupit që thoshte «ne nënshtrohemi Perëndisë»?
E shpërndau me forcën e kamxhikut duke thënë:
"Shkoni mbillni!"
Domethënë, ai që nënshtrohet,
Pa tjetër në fillim do të mbjellë;
A e kuptove? Domethënë nënshtrim s'do të thoka
Të biesh, siç bie miza, në enën e këtij apo atij!
Shihni në ç'hall e ka sjellë injoranca fenë tonë:
Besimet e kota ia kanë zënë burimet më të pastra!
Sot, jo vetëm të vërtetat themelore të sheriatit,
Por as të vërtetat krejt të qarta që s'kanë nevojë për vërtetim,
S'i pranon kush pa i diskutuar!
Librin, Sunnetin, Ixhmanë* më në fund i hoqëm,
Dijetarët i poshtëruam, popullin e gënjyem.
Sheriatin e shembëm, një ndërtesë krejt tjetër ngritëm,
Duke ia ngarkuar Profetit, mijra marrëzi sajuam!
Guximi shkoi gjer atje sa të thuhet se "sajimi i haditheve
Me qëllim nxitjen e adhurimit, është i lejueshëm",

* Mendimi konsensual i dijetarëve muslimanë lidhur me një çështje të caktuar.

Një vendim të këtillë të marrë e bënë fetva!
 Dhe sa çudi, ka njerëz që nga hadithi i sajuar mbi gënjeshtren,
 Të shpresojnë mirësi!
 Vjen koha dhe e kuptojnë mirë nëse ka sevap e mirësi!
 Përderisa thirrja “Me kedhdhebe”* gjithësinë trazon
 Shihni të paturpshmin që, duke bërë sikur s’dëgjon,
 Sajon gënjeshtër në gojën e dëlirë të Profetit
 Dhe, pa u mërzhitur, thotë se ka bërë sevap!
 A s’e mendove kur sheriatin e vrave?
 Mos pandeh se krimi yt do të mbetet pa u ndëshkuar?
 Dhe ka shpresë për të fituar sevap, ë? Thojini të poshtrit:
 Do ta shohësh sevapin tënd ditën e llogarisë para Zotit!
 Shpagimi i Zotit do të të bubullojë mbi kokë,
 Rrufetë e tij do të të ziejnë në tru...
 Dora shkatërruese e dhimbjes nuk do të të zbresë prej jake...
 Si mund të zbresë kur, edhe po të ikësh e të strehohesh
 Në mjedisin e nurshëm të Profetit edhe në shpëtofish,
 Gjë që është e pamundur,
 S’shpëton dot nga dora ndoshta e miljarda njerëzve
 Të shkatërruar; a nuk duhet të të ngarkohet nesër
 Mëkati i të mjerëve viktima të prapësive të tua sot?
 A e lehtë është ta nxjerrësh ummetin nga udha
 E ta bësh mëkatar? A është e lehtë ta bësh të rënkojë
 Fenë brenda bestytnish?
 Pse e vure nënë këmbë librin e Allahut?
 Pse e fëlliqe sheriatin me duart e tua të fëlliqura?
 A s’pate vend tjetër për të marrë turr?
 Ç’janë këta shqelma që ia dhe Qabes së Allahut?
 I poshtër! Ç’deshe nga ky popull i pafajshëm
 Që rrugën e shtrembër për rrugë të drejtë ia tregove?
 I mjeri përpëlitet duke u ngjitur të përpjetën e disfatës...
 Të paktën të kishte mundësi të ikte mënjanë!

* Aludohet në hadithin profetik: “Të garantuar e ka xhehenemin ai që qëllimisht më përshkruan një fjalë që s’kam thënë”.
 (Buhari, IIm, 38)



Sa keq që ngrihesh në këmbë me shpresë për të dalë nga balta,
Por zhytesh fund e krye po i luajte këmbët!
Kohë më kohë pa përreth dhe skërmiti dhëmbët,
Sepse ndërsa të tjerët ecnin, ai vazhdimisht fundosi!
Dhe sot sheh me një vështrim për të ardhur keq,
Sepse balta i ka ardhur gjer në supe, kurse shpirti në grykë!
Ende nuk i është fundosur zverku të shkretit,
Vraponi e shpëtojeni të paktën në çastin e fundit!
Por për ta shpëtuar, gjeni rrugën më të sigurtë,
Në fillim thajeni këtë batak e pastrojeni!
Por kjo s'është e lehtë se kërkon dije të thella dhe përvojë;
Po të futeshin mendimtarë pa mendim, të shquar papritë,
Në opinionet e tyre të mbrapshta si përherë,
E ardhmja e të mjerit fëlliqet një herë e mirë!

Brejtës e parazitë tufë tufë më të ndyrë se tenja
E kanë mbuluar trupin e popullit këto kohët e fundit aq keq
Saqë, po të veprojnë shpejt e t'i hedhë tutje ato fëlliqësi,
Ndoshta do të shpëtojë... Ndryshe, ka për ta mbytur morri!
Po qe se do të kujdeseshe pak për trupin,
Po qe se do të kujdeseshe për pastërtinë e ndërgjegjes,
S'do të kish mbetur shkak për të ardhur në këtë gjendje.
Edhe balta, edhe morri, gjithë prej atij dembelizmit të ndyrë!

Forca e kuptimit të popullit të mjerë u shkatërrua,
Nuk merret kush me shkencë, i mbyllur vendi i teknologjisë;
Emri i industrisë është fundosur, po ashtu dhe i tregtisë;
Bujqësi, por me metoda të profetit Adem!
Shkurt, çdo gjë ka për t'u bërë me punë, me lodhje,
Përpjekja kërkon së pari dëshirë e vullnet.
Pa këtë, me ç'mjet do të ecim para ne?
Shkencëtar i pashqetësuar, dijetar i pamërzitur, sa lezet!
A s'ka ndonjë zgjidhje për këtë? Hë, u gjet:

Në Tokatllijan* nesër mblidhen pesë a gjashtë kopukë!
 Pas një krikllë birre, veprojmë me ngut,
 Ia vëmë shpatullat dhe e thyejmë derën e ixhtihadit** menjëherë.
 S'është gjë që hapet pa e thyer, drynin e ka për tmerr!
 Ejani t'ia vemë supet... Një punë që me kaq merr fund.
 E tillë është forma e guximit qytetar,
 Na prishet vendosmëria po e çuam zvarrë!
 E çau Suezin burri i botës.. Mesdheu dhe Deti i Kuq u bashkuan.
 Atëherë, po që se dhe ne, idenë tonë e nxjerrim
 Nga projekti dhe e realizojmë,
 Qytetërimi dhe feja përputhen plotësisht me njëra-tjetrën.
 Ashtu siç është ngritur në grykë të Suezit monumenti i
 Dë Lesepsit***
 Me qëllim për t'ia bërë emrin të pavdekshëm,
 Edhe ne na lind e drejta të kërkojmë nga një monument
 Gjatë tërë kanalit që ka çarë përgjysmë ixhtihadit duke dhënë mend!

Shihni ç'ditë që erdhën për ne: pesë a gjashtë kopukë
 Së bashku me përkrahësit e tyre, që të gjithë ca bishtrrjepur,
 Dalin paturpësisht e tentojnë të futen në ixhtihad!
 Eshtë me të vërtetë e vështirë të jesh i durueshëm para kësaj!
 Ligji i shenjtë islam s'është ahur... Hiqur që aty
 Dhe kërko për vete ndonjë vend tjetër, o injorant me brirë!
 A s'po merr vesh? Para ke një portë me dry;
 Pallati i shenjtë i sheriatit nuk është një vend
 Ku mund të hyjë kushdo. Ashtu siç ka çdo portë një dry,
 Edhe ai ka. Një sy që sheh, e kupton me shikim të parë.
 Ç'është ky dry? Eshtë njohuri e thellë, po edhe kjo mungon
 tek ju!
 Atëherë, t'ju vijë turp nga dallkaukllëku!
 Kjo portë, për ata që shquhen në injorancë për gjenialitet,
 Eshtë e mbyllur, kurse dijetarët japin opinion gjer në kiamet.

* Tokatllijan: një bar i famshëm i kohës.

** Përpjekje e përhulluar shkencore për të arritur një konkluzë fetare.

*** De Lesseps: Ferdinand Marie de Lesseps (1805-1894), burrë shteti francez, nismëtar i hapjes së Kanalit të Suezit.



Sigurisht, kur te njeriu t'i jenë pjekur kushtet,
Ç'pengesë mbetet për opinionin në këtë mes?
Nga kjo bashkësi mund të përgatiten mendimtarë gjer
në pafundësi,
Vetëm se në fillim duhet dalë nga kjo errësirë në një të nesërme të
ndriçuar.
Një herë shihni me kujdes këtë analogji absurde:
Burri i botës hapi Suezin. Drejt. Por me çfarë e hapi?
Duke i vënë supet? Jo! Me një teknologji të tillë
Që ka shpenzuar tërë jetën për ta siguruar.
Këta kopukë nuk mendojnë se personi që merr iniciativë
Të japë opinion, duhet të jetë një njeri
Që të quhet autoritet i kohës në dituri.
Librin, Sunnetin, Konsensusin duhet t'i kuptojë saktë.
Pikëpamjet e kundërta t'i analizojë, nevojat parasysh t'i mbajë.
Ndryshe, si mund të japë opinion një injorant me brirë
Që s'di nga e drejta islame as sa një çifut, sa një krishter?
O bir, edhe për të mësuar të bësh potkonj për gomerë,
Duhet të punosh pranë një ustai evgjit në krye të morsetës!
Bukur fort! Kur talentet e lindura nuk janë të mjaftueshme
Edhe në këtë punë të thjeshtë pa mësuar,
Si mund të ngrihen të japin opinion këta të hutuar?
Të japin opinion që kërkon specialitet në një sërë diturish?
Po qe se çdo njeri fut hundët pa u menduar në çdo punë,
Shpëtimi i popullit tonë mbetet gjer në ardhjen tonë tjetër në këtë
botë!
Pse nuk ju pëlqen aspak ndarja e punëve?
Po qe se njëri përpiqet të marrë dhjetë kunguj nën një sqetull,
Shpëtimi ynë as për në ardhjen e dytë s'ka për t'u gjetur!
Sa keq, sa keq! Ja shkakun e gjithë fatkeqësisë sonë!
Të zotët e punës të dalin në shesh
E, një herë, të paktën, ç'është e ç'nuk është të marrim vesh.
Në mëngjes, burri i botës, filozof kallp, pasdite, në islam, jurist;
Sapo të bjerë mbrëmja, bëhet letrar i gëzuar pa asnjë rrjesht!

Nesër historian, pasnesër, ujk në politikë,
 Kurse ditën tjetër e sheh tek pretendon për ixhtihad në besim!
 Shkurt, në duar të snobëve me natyrë kameleonike
 Na u nxi fytyra - thoni - dhe merrni një vendim!

Këto maskarallëqe kështu nuk mund të vazhdojnë prore!
 Puna nuk merr fund duke thënë “ç’më duhet mua!”
 Largimi i njerëzve të drejtë nga shfaqjet e rreme trimërore
 Të rrenacakëve dhe mbetja pasivë e tyre është një intrigë e madhe
 Nga frika e së cilës qe shtrehuar Omeri nën mbrojtjen e Zotit.*
 Të jeni të sigurtë se fatkeqësitë që na kanë shtyrë ne në pesimizëm,
 Janë që të gjitha prej mungesës së ndjenjës së përgjegjësisë.
 Atje ku çdokush thotë “s’është puna ime”, si mund të bësh punë?
 Në atë gjendje erdhi populli nga papërgjegjësia,
 Saqë edhe ndjenja e përgjegjësisë sot më nuk mjafton.
 Po, ajo që na duhet neve sot, është më shumë se kaq,
 Dhe kjo gjë është sakrificë që ne si popull duhet të tregojmë!

Me tregimin në fjalë, Mevlanai** i lartë me të vërtetë
 I ka shpalosur kuptim sa botët shikimit mësimnxjerrës:
 Një i varfër me shtëpinë gati në të shembur,
 Çdo ditë ia hidhka sytë asaj dhe i thoka:
 “Shiko, mos u shemb pa më lajmëruar që më parë,
 Se, na ruajttë Zoti, marrim fund të gjithë me të mëdhenj e fëmijë!”
 Kalojnë vite duke thënë kështu i varfëri...
 Dhe një mbrëmje, kur kthehet në shtëpi,
 E gjen të shembur me familjen të zënë nën gërmadha!
 Kur e sheh i shkreti përballë këtë pamje të hidhur,
 U kthehet gërmadhëve të shtëpisë së kthyer në një grumbull gurë
 Dhe nis t’i qortojë: “Pse s’thoni që qenkam mashtruar?
 Ç’u bënë gjithatë lutje, o shtëpia ime, mikja ime e vjetër?
 Në vend që të mbeteshin jetimë fëmijët e mi, mbeta unë!

* Omer ibni Hattab pat thënë: “Mbështetem te Allahu nga iniciativa e pafre e injorantëve dhe fshehtësia e të diturve!”

** Mevlana: poeti, mistiku i shquar, Xhelaleddin Rumi (1207-1273). Vepra e tij poetike mistike, “Mesnevi”, në vitin 2010 është botuar edhe në gjuhën shqipe nga SHB “Logos-A”-Shkup.



A nuk të thosha të mos shembeshe pa më lajmëruar?
A këtë, moj mizore, prej teje paskam shpresuar?
Ti s'paskë ditur ç'do të thotë marrëveshje, ligj, fjalë;
Turp të qoftë për gjithë atë shërbim që të pata bërë!"
Shtëpia gjermadhë, me një zë që vinte si nga thellësitë,
Iu përgjigj njeriut: "Lëri ankesat e padrejtësitë!
Tani po më del përpara e më qahesh me bërtitje?
Unë të pata paralajmëruar, po kush ma vuri veshin?
Nga gojët e të çarave të mureve të mia që i pandeve për plasaritje,
Të jam lutur shumë pa pushim, o njeri i pakuptuar!
Çdo radhë ti s'ke bërë tjetër veç gojën me baltë ma ke mbuluar
Dhe unë ç'të bëja tjetër? Kam pushuar!.."

A s'është i njëjtë halli ynë me ngjarjen e treguar?
Vetëm me këtë ndryshim: Ne kemi ende forca,
Forcat nuk na kanë shterruar!
Edhe nëse me gabimet turrë-turrë të kohëve të shkuara
Një pjesë e madhe e mureve na është shembur,
Themeli që mban në këmbë ndërtesën e popullit,
Është i shëndoshë. Domethënë se shpëtojmë sot
Po të bëhemi njeri. Duke u përpjekur të lidhur dorë më dorë...
Përpjekja është aq shumë e mbarë sa njeriu bën çudi!
Sigurisht, disfata nuk do të thotë se të ka ardhur vdekja!
Edhe të tjerë kanë rënë në këtë gjendje më parë,
Mirëpo sot jetojnë dhe më mirë se atëherë!

Një popull i madh një herë e pati humbur luftën krejt
Dhe pati rënë në robëri. Një grup njerëzish të mençur
Nga gjiri i tij, pati menduar: "Ç'duhet bërë për t'u çuar?"
Idetë e kuvendit të të mençurve ishin derdhur në shesh një e nga një.
Dikush dëshironte ta shpëtonte ç'kish mbetur, me anë
të politikës;
Një tjetër thoshte "Vatanin ushtarakët e shpëtojnë!"
Njëri mendonte se vendi kish nevojë të madhe për flotë;

Një tjetër i behu: “Jo, pajisja me shkenca është prioritet!”
 Kush prirej nga arti, kush dëshironte sa më shumë pará,
 Shkurt, nga çdo kokë kish dalë nga një zë!
 Vetëm një plak që gjer atëherë vetëm kish dëgjuar,
 Në fund ishte ngritur dhe kish thënë: “Shkollë e mëhallës na duhet!”
 Në fillim fjala e të shkretit s’ish kuptuar,
 Aq sa dikush kish thënë për të “i matufepsur” pa u menduar.
 Plaku e kish shpjeguar qartë se ç’kish dashur të thotë me atë fjalë,
 Dhe me këtë fjalët e mëparshme i kish kthjelluar

Më në fund, ish vendosur: “Fuqia jonë, pa dyshim,
 duhet përparuar
 Por para çdo gjëje: themelet murë dehet venduar.
 Arsimi duhet përhapur pa dyshim;
 Po të dijë të shkruajë e të këndoje populli, ka gjë që s’e arrijmë?
 Ushtria, flota janë mjete të domosdoshme,
 Por për t’i njohur dhe përdorur ato, duhet mësuesi që na jep mësim!”
 E lidhën fjalën kuvendarët dhe e qitën në zbatim,
 Dhe doli në shesh Gjermania që ne dimë!

Francezët që e dorëzuan ushtrinë në Sedan,
 Gjë të cilën e kujtojnë gjithmonë e qajnë,
 A e dini ç’thonë? Dhe ashtu është, si thonë ata, besojeni!
 “Luftën e bëri ushtria e edukuar e Prusisë,
 Pra, fitorja i takon stërvitësve të kësaj ushtrie të madhe!”
 Të paktën nga kjo fjalë të merrnim mësim!
 Mirëpo, s’është punë që bëhet, shumica jonë ende kokëfortë!
 Botës sikur të mos i mjaftonte dështimi ynë si mësim!
 Me këtë injorancë s’mbeti fatkeqësi pa na rënë mbi kokë!
 Na duhet shkollë në mëhallë! Mos u mendoni më!
 Po qe se do të hapej me kohë shkollë në mëhallë
 Dhe ato që kishim të rregulloheshin e rinoheshin mirë,
 Tre bythëgrisor që shëtisnin me gjysmë këpuce,
 A do ta rebelonin gjithë Shqipërinë?



Sot popujt islamë një rrymë çakërcejfe i tërheq zvarrë
Dhe shihni ajo burimin nga e merr.
Burimi i fatkeqësisë, pa asnjë dyshim, është injoranca jonë.
Dhe shërimi i kësaj të keqeje bëhet vetëm me shkollë.
As kurdi s'e ka zbërthyer abëcë-në, as turku lexon, as arabi;
Shihni, as çerkezi, as lazi libër kanë në dorë!
Shkurt, njerëzit e popullit janë të mangët në dituri!
Vetëm se këtë mos e harroni: shekulli ynë është shekulli i diturisë!
Duhet të mësonim shkrim e këndim dhe kështu po të mos ish;
Për ta mbrojtur fenë, meqë jemi lidhur kaq fort pas saj.
Se edhe mbrojtja e fesë me shkrimin dhe këndimin e saj nis!
Feja e shkretë nuk e duron dot injorancën, a e kuptuat!
Domethënë se duhet ta hedhim hapin e parë drejt diturisë!
Ja, pra, shkolla e mëhallës është hapi i parë;
Por në fillim ky hap duhet menduar mirë.
Po qe se në vend të ushtrisë së mësuesve na del në shesh
Ushtri karkalecësh, bëjani ju tani këtij dëmi llogarinë!
Ai që thotë "jam mësues, jam edukator", duhet të jetë besimtar,
Pastaj me edukatë, pastaj me ndërgjegje, pastaj i aftë në profesion!
Pa këto katër kushte, s'bëhet, sepse përgjegjësia është e madhe.
Trashamani i djeshëm që hidhte shkrimin në feste e e bënte çallmë
Ose druri i çdo kohe që është bërë filiz duke hedhur mbi meste
Një këpucë llastiku me majuce e takë të lartë,
Për hir të Zotit, të mos thonë "jam i aftë për këtë punë!"
Dhe sikur të thonë, t'u thuhet: "O bir, kush je, ç'je ti?"
Po qe se thoni që të gjitha këto s'duhën përsëritur më,
Mos u hapni rrugë injorantëve dhe atyre me një dërrasë mangut!
Njëri vë një ká përpara dhe mbi të e vë botën,
Tjetri me shqelmat e atij káu shemb tokë e qiell!
Fëmijëve tanë s'u duhet as të venë në qafë kularë si ká,,
As të hedhin me shqelma deri në qiell, pra!
Rinisë sonë dijet e kohës t'ia mësojmë,
Por dhe për gjërat e shenjta respekt të tregojmë!
Po qe se qëllimi juaj është ta mbani vatanin gjallë,

Shihni ç'është ajo lidhje që i ka mbajtur lidhur
 Pas vatanit të përbashkët popujt muslimanë
 Dhe mos shkoni pas atyre që e presin shpëtimin te mohimi i saj!
 Në shpëtoftë ky popull, në saje të asaj lidhjeje shpëton;
 Në u zgjidhtë kjo lidhje, Zoti na ruajttë, çdo gjë mbaron!
 Po qe se qëllimi juaj është shembja e vatanit, kjo është tjetër punë!
 Vetëm se s'e di, kjo çështje a mban shaka?
 Jo, synimi i çdokujt është vatani të rrojë,
 Çdonjëri hyn në luftë duke thënë "Vatani të rrojë!"
 Natyrisht, kur them "çdonjëri", kurrë nuk mendoj të fus në llogari
 Pesë a dhjetë qenër stani, që, kur u hipën damari,
 Gjer te gjërat e shenjta s'lënë gjë pa sulmuar!
 Atyre krijesave pa kërpesh, s'mund t'u them njeri, jam i justifikuar!
 Dashuria për vatanin: të harxhosh jetën për hir të popullit,
 Në përgjithësi, bashkë me ndjenjat familjare, të gjitha ndjenjat
 Gjenden në zemrën që rreh për gjërat e shenjta.
 Nga gjoksi që bart brenda kërmë, ç'mund të shpresohet?
 Vatani ka rënë në fatkeqësi... Mos pandeh ti
 Se te ai vlon dëshira për atdhe? Ti burrë i botës pa fare atdhedashuri!
 Mjafton të gjejë një vend e t'i japë grykës si di,
 I mbyllet goja të pahairit, s'i ndihet zëri!
 Por ti nuk je i tillë, ty të digjet zemra për atdhe;
 Dhe në qiell po ta kesh vendin, "vatani" thua e vdes për të!
 Kush është i lirë, si mundet ta durojë robërinë?
 U qorroftë ai që s'ta vajton, o vatan, fatkeqësinë!

O njerëz, mjaft më, nga ky gjumë zgjohuni,
 Për hir të Zotit, ngjarjet e djeshme kujtojini!
 Po qe se nuk lëvizim e nga gjumi nuk zgjohemi sot përsëri,
 Ç'vdekje e tmerrshme do të jetë gjumi i dytë, mendoni!
 Për të vdekur, e lehtë... Në thënçim dot në fund "shpëtuam!"
 Kjo vetëvrasje, për botën e mjerë islame
 Më se treqind e pesëdhjetë milionëshe, tepër e dhimbshme!
 Po s'qemë ne, kaq shumë vatra do të mbeten jetim!



Me gjithë kërcitjet, është froni ynë i famshëm dhe madhështor,
Është papë shteti ynë që e ka shpëtuar këtë fe.

Ndërsa bota islame e shkretë që jeton ende nën sundimin e
krishterëve

Në Tunizi, Marok, Algjeri, Kinë, Iran, Indonezi, Indi

Dhe Pakistan dhe ndoshta në Afganistan, Hijve, Buhara, Krime,
Siberi,

Nuk është kapur ende pas krishterizmit, është e hilafetit kjo fuqi

E juaj që e tërheq për krahu. Po të mos jetë kjo fuqi,

Bota ka për t'u bërë e krishterë.

Kështu që tash ne s'kemi të drejtë të vdesim!

A s'mjafton ç'hoqëm në këtë botë, por duhet të mbajmë mbi supe

Mëkatet e të tjerëve edhe nesër në botën tjetër?

Ndërkaq, ç'dështim i pamasë pëlqimi i vetëvrasjes!

Në jeni muslimanë, ikni, ikni nga kjo gjë!

Thoni, kjo mërzitje nga jeta ç'është?

Vetëvrasja e të zotit të shtëpisë është marrëzi!

Hilafetin, atë fron tëndin që ende qëndron në këmbë

Mbajeni fort të mos shembet! Rënia e tij do të jetë e tmerrshme...

Ç'është kjo përçarje, more? A s'keni turp?

Akoma nuk u besoni fatkeqësive të së kaluarës?

Ata që s'duan të groposen në asgjësim sa gjerë e gjatë,

Dyftyrësinë duhet ta groposin në harrim!

A e harruat se ç'gjë e frikshme dhe e turpshme është hipokrizia?

Mos e gërryeni të kaluarën e mos e nxisni këtë mundësi të mallkuar!

Qëparë ju, në fillim duke u rrëqethur, pastaj me respekt

U ngritët e u rrjeshtuat para Allahut si bashkësi.

Kur zërat "Allahu Ekber!" duke e çarë kubënë u ngjitën lart,

Qielli i të fshehtave i Allahut u zbraz për tokë si shi.

Dhe kur pashë dallgëzimin e radhëve të entuziazmuara,

M'u shfaq si e gjallë para syve mbledhja dhe shembja e deteve;

Detet e mbledhura e të grumbulluara në oqeanin e përjetshmërisë,

Si dallgët bien në sexhde e më në fund humbasin brenda tërësisë.
 Kur radhët qenë në këmbë, edhe dallgët ishin në këmbë;
 Me thirrjen entuziaste të imamatit, “semiallahu limen hamideh”,*
 Një botë e heshtur u shtri njëcopet përdhe.
 Dhe kjo përngjante me varre që zgjaten të radhitura sup më sup.
 Nga ato varre të shtrira dallgë-dallgë
 U dëgjua përnjëherë se mijra zemra rrahën në një hop!
 Kjo harmoni zemërtronditëse e varreve,
 Dhe gjithë po ai zemërimi i hidhur i zemrave
 I dhanë vrull oqeanit të përjetësisë
 Dhe, më në fund, ajo sexhde e përjetshme u plotësua.
 Dhe pas kësaj një zë i thellë që e dridh tokën erdhi,
 Të gjitha dallgët e qëparshme tani u lartësuan!

Kryerja e këtyre adhurimeve të ndërthurura me njëri-tjetrin,
 Rënia e balleve në tokë dhe ngritja e tyre pastaj
 Edhe më bëri të qaj mua me lot në namaz,
 Edhe më tregoi një të vërtetë të tillë që të bën për të qarë;
 Po s’e kuptuat këtë të vërtetë, populli, sigurisht, shkatërrohet;
 Fatkeqësia juaj: bashkimi i copëtuar!
 Po qe se zemrat ju rrahin me të njëjtën ndjenjë,
 Po qe se, si ajo ndjenjë, keni të njëjtin qëllim,
 Të jeni të sigurtë, rrëzoheni, rrëzoheni, por ngriheni përsëri!
 Domethënë se, kur të kemi arritur bashkimin, kemi shpëtuar.
 Atëherë, ç’pengesë të ketë për bashkimin, shkeleni...
 E pse kjo përçarje? A s’ju është e njëjtë çdo gjë?
 As marrëzi partish na duhet, as sëmundje racizmi;
 Si mban kjo fe tetë-nëntë kombe!
 Po qe se do të kërkonit të dinit për të gjitha këto fraksionizma,
 O rob të Zotit, do të kuptonit se nga e kanë burimin!
 Si qëndruat qëparë të bashkuar para Zotit?
 Mosni, se është gjynah, është turp, mosni!
 A pak kurbanë dhatë duke u shkuar pas këtyre ambicjeve?

* “E dëgjon Zoti falënderuesin e Tij”.



A vetëm për t'u ndarë ju rrahin zemrat?
Pse vëllazërinë e keni kështu, të kufizuar vetëm në namaz?
Pse të gjithë mbërtheheni për gryke kur dilni në avlli?
S'e kuptoj, ç'muslimanllëk është ky që bëni ju!
Kam frikë se kjo prapësi do të jetë për ju një rrugë pa krye!
Përgatitja e thikës me të parë njeriun me feste,
Ndërimi i rrugës me të parë njeriun me shapkë,
Dasia në zemra edhe pse gjokset qëndrojnë pranë e pranë,
Janë krejtësisht, o bir, shenja dyfytërsie.
Për hir të Zotit, bëhuni dyfytërsisë* armik me gjithë zemër
E me këtë sjellje të sinqertë ndoshta arrini te Zoti shpëtimin.
Fatzi është dyfytërsi, vatra e poshtër i shuhet...
Nëse oxhaku ende i lëshon tym, domethënë se ende koha s'i ka
ardhur!
Me zjarrin e lëshuar prej tij merr fund dhe vendi
Po qe se nuk është shuar para se të marrin flakë strehët.
Pranë të thatit digjet edhe i njomi, i shkreti, pa shpëtim...
Thotë Libri i Allahut: "Ruhuni nga ajo intrigë
Se s'mjaftohet vetëm me të këqinjët brenda jush;
Edhe të pafajshmit nuk shpëtojnë dot nga kjo, pa dyshim!"**
Bëni llogari se sa gjak të pafajshmish ka rrjedhur...
Mos e hidhni në zjarr vatanin për pesë a dhjetë të paatdhe!
Është mëkat! Për hir të Zotit, hiqeni dyfytërsinë!
A mos doni që flaka t'i përfshijë strehët, o rob të Zotit?
Po qe se do t'i përfshijë, kujt ka për t'i shpëtuar vatra e shtëpia?
Të ndizet një herë dhe e sheh ti se s'mbetet as vatër e as oxhak!
Pse ndodh që pesë-gjashtë të paatdhe, pesë-gjashtë piromanë
Gjejnë përkrahës t'u shkojnë turma-turma nga pas?
Pse përçmohen, ata që prej andej lëshojnë zë
"Vraponi përderisa ky xhehennem është ende një shkëndijë!"
As përpjekje për t'u zgjuar bën ky popull, as punë për t'u lartësuar;
Edhe sikur të shembet bota, populli ynë do të shkojë pa u zgjuar!

* Shih: Kur'ani, Hashr, 14.

** Kur'ani, Enfal, 25.

Për t'u ngritur ai, duhet pritur Briri i Israfilit!
Zoti im, a s'ka shpëtim për këtë pandjeshmëri?

Një fshatar të shkretë në fillim e kishin sharë gjerë e gjatë,
Por s'kish dëgjuar... Pastaj e kishin rrahur me një dru shpinës.
Dhe fshatari, megjithëse ishte enjtur e bërë si kacek,
Kish thënë: "Më duket se daullja bie në shtëpinë poshtë!"
E kishin rrahur prapë duke e qëlluar këtë herë në kokë,
Prandaj, më në fund, ia kishte thënë truri:
"Daullja paska ardhur në shtëpinë tonë!"
Edhe halli ynë krejt si halli i fshatarit!
Ndërsa shembeshin një nga një kalatë e mëdha të shariatit
Të shenjtë që është baza e islamit,
Gjërat luajtën vendit, kurse ne ëndërruam se
Ndryshimet që solli koha, nuk do të na preknin ne
Dhe e lejuam femohimi ta shkelte besimin pa luajtur vendit!
Megjithëkëtë, ende s'duket ndonjë lëvizje
Tek ne për ta kompensuar të kaluarën;
Harruam kush ishte goditur më parë nga fatkeqësitë!

Kur sytë hidhen në mjedisin përreth dhe popullin tonë,
Shohin se ka turra-turra koka me tru të thartuar.
Mendimet shkojnë gjithmonë në drejtime të kundërta
Dhe, më në fund, të gjithë kanë gabuar!

Shtresa e popullit që formon grupin e parë,
Po të lihet, gjumin e ëmbël ka për ta vazhduar.
Pasi ta ketë mbushur barkun për sot,
S'mendon për nesër, po shtrihet në të djathtë.
N'u shembtë froni i hilafetit, vatani futet në varr,
S'do t'ia dijë, sepse të gjitha "prej Zotit janë!"
Në të vërtetë, ç'vlerë ka kjo botë e rremë?
Po vdiq, do të shkojë në xhennetin e Zotit!
S'është mashtrim! Por, po të më pyesë mua, i them:
"Ç'lumturi për ty, xhaxha, po u pranove në xhehennem!"



Shtresa që formon grupin e dytë,
Janë të pakënaqurit nga jeta; të rënë në pesimizëm,
Thonë, “s’ka rrugë për shpëtim, ç’të bëjnë, është kot”,
Duke u tërhequr mënjanë në indiferentizëm.
Ky lloj qëndrimi është krejtësisht një mosbesim,
Se Zoti, në një verset preraz urdhëron,
“Mos e këputni shpresën nga mëshira Ime
Se vetëm ata që më bëjnë shok Mua, e këputin shpresën!”
Kjo e para; e dyta, cilidoqoftë shkaku i pashpresisë,
Gjëja që del më në fund nga kjo, është krejt një dembelizëm!
Rezultatet e këqia të këtij dembelizmi i patëm parë edhe më parë.

Kush e përbëjnë grupin e tretë?
Ky brezi i dhënë pas dëfrimit që u thonë “intelektualë”!
Ndërkaq, e kam për detyrë t’i veçoj të pastrit mes tyre nga
ky fajësim!
Ç’seksi i përkasin këta snobë, vallë?
Të thuash është femër, zë mashkulli të vjen nga pas;
Të thuash jo, s’është femër, është mashkull, ç’janë këta flokë?
Mustaqet sa të shkurtra! Flokët tufë-tufë gjer në tokë!
Zëri i ngjet bufit, tundet si laraskë;
Shkurt, thashë snob, apo jo, kupto, më në fund!
Mirëpo ky njeri-kukull bart një karakter të madh
Që, po të më lejohet t’i them “të lumtë!”, i shkon!
Ç’dua të them? Po ta shpjegoj: Ka një qëndresë të tillë
Që pesimizmin më të pashmangshëm me një birrë të vetme e dë-
bon!
Në nervat e tij nuk ka ndonjë të keqe të tillë si ndijimi a përceptimi,
Natyra e tij s’do të dijë ç’është turpërimi;
E dini, te njeriu paska një cipë që, po t’i plaska ajo,
Njeriu u bëka patjetër i pafytyrë.
Siç duket, lutja “Zoti mos të turpëroftë!”
Ka të bëjë me këtë njeri: pa damar turpi e fytyrëzi!
Po të shohë në xhep tre copë kurushë laramanë,

Shkon e krekoset si gjel në pijetoren Tokatllijan.
 Dhe, po qe se e ka marrë me mashtrim paranë e duhur,
 Banori i mëhallës e sheh maskarain gjer në karnaval!
 Hyn mu në mes të atij mjedisit të fëlliqur kurvëror të Bejogllusë
 E i ngjitet pas një kurve. Fjalë të tilla si turp, edukatë, etj.,
 Janë zakon i gabuar; madje dhe vatani e familja
 Janë kufizime të panevojshme - thotë
 Dhe i sulmon të gjitha menjëherë si qen i tërbuar...
 “A s’është turp?” - i thua, po kush ta var?
 Me gjë të tilla si namazi, agjërimi s’ka të bëjë,
 Të tallet me gjërat e shenjta, puna e tij e parë.
 Po ta dëgjoni të thotë “forcë e errët”, e ka fjalën për besimin;
 Edhe “libër i prapambetur”, mos qoftë e thënë,
 Eshtë libri i Allahut, Kur’ani. Po qe se s’përton e i flet për të,
 T’i zbraz fjalët si më poshtë një e nga një:
 “Po qe se s’bën tjetër veç përsërit lutjet e pakuptim
 Të mbetura nga shekujt e kaluar, a e drejtë është kjo për bijt
 e shekullit të njëzetë?”
 Ç’lidhje ka me shekullin e njëzetë, shekullin e shkencës,
 Ky njeri dallkauk? S’është turp ta them që s’e kuptoj!
 A mos ka ndonjë vlerë në dorë që të na e tregojë?
 Ç’aftësi ka, ta shohim e ta mësojmë!
 Jo! Për asnjë bukuri të Perëndimit s’i djeg zemra,
 Por, kur është fjala për gjëra të turpshme, të gjitha i ka për parim!

 Njoh një kopuk për të gjitha mëkatet e mëdha tirjaqi...
 S’e di ç’është bërë tani, në qoftë gjallë...
 Kumar, çdo lloj të keqeje, pije, rushfet...
 Shkurt, libri i punëve të tij aq i zi,
 Saqë nata e xhehennemit për të, mëngjes i gdhirë në xhennet!
 Po t’i thuhej “si s’të vjen turp, këto që bën ti, janë fëlliqësi”,
 Niste të të numëronte mëkatet e mëdha të të gjithë njerëzve
 Të njohur të popujve: “filani pinte, filani shkonte pas kurvave...”
 Për ta treguar veten se diç ishte, fëlliqësitë e veta



I kërkonte te njerëzit e shquar të së kaluarës.
Po të dilte kush e ta pyeste nëse ata njerëz kishin ndonjë virtyt,
Ndonjë vlerë, thoshte: “Unë s’jam historian!”
Edhe këta snobë sot të njëjtin shpirt tregojnë.
Ç’ka francezi? Kurvëri dhe pafesi;
U lëshua pas këtyre biri i shekullit të njëzetë!
Ç’është ajo gjë që e përkëdhel kënaqësinë e gjermanit? Birra!
E harroi dhallën, u matufeps, që u shkrettë!
Ata kanë gjëra të mira e bukuri sa kjo botë:
Dituri, shkenca, letërsi, industri!
Po qe se çdo njeriu ynë që shkon atje, sjell një grusht nga ato mirësi,
Vendi ynë, sigurisht, kthehet në vend me kulturë e dituri!
Të këqija të papara me bollëk na sjell ky njeri;

Po s’na pëlqyen, “qytetërim” thotë; besuam, mirë!
Po të themi, “sikur të kish prurë edhe pak kulturë e dituri”,
Të jeni të sigurtë, do t’ju thotë: “a s’bëra hamallëk gjer tani”?

Ç’mbeti ndërkaq? Njerëzit e grupit të katërt.
Edhe jeta e përditshme e këtij grupi është dëfrim e kënaqësi.
Dhe veset e shprehitë kurrë nuk i ndërrojnë,
Se në atë zemër plot naze dhimbja nuk mund të hyjë!
Për kiametin e shkuar, thonë: “Ishte një furtunë, kaloi!”
Thonë, ama kënaqësitë e dëfrimi me të gjithë vrullin vazhdojnë.

- Sot në Flora? Bukur fort! Po nesër, ç’ka?

- Koncert...

Në “Ujrat” bëhet jetë, por ende nuk janë hapur, thanë.

- Pse s’janë hapur, s’do të thotë se duhet të mbetemi nëpër shtëpi!

- E drejtë! Ç’të bëjmë? Po sikur të shkojmë te “Mama”-ja?

- Ç’ka atje?

- Teatri i lojrave popullore. A po vjen? Eja, pra, ti!

- Kavukllu? Hamdi? E vërtetë... Ai s’është gjallë...

- Abdi.

- Jo, jo! Mua s’më duhet as Abdi, as kush e dil!..

- S'e di pse, je pak nervoz sot, Feridun bej!
- Jo, por këto lojra të pashije s'durohen më, janë bërë monotone!
- Shumë mirë, po ç'të bëjmë? Na thuaj të paktën ti!.. Shih: ora vajti dhjetë.
- Po, vërtetë, ç'të bëjmë? Prit, prit! As Yskydar, as Mama...

Na duhet një teatër, ose një film i mirë!
 Domethënë teatrin e dashka zotëria im i dashur..
 Atëherë, unë atij po i propozoj plot gjashtë skena,
 Që në secilën të ndërrojë rregulli krejt;
 Dekori i njëjtë, por atmosfera ngjyra-ngjyra!

Kala e Edrenesë është kalaja madhështore që pe,
 Kurse pema sterrë e zezë e mbirë në majë të saj, kryq!
 Majat e shëtitura në shpinë të Muratit të Parë, e sheh,
 Këtë radhë shih si i përkulen Ferdinandit vetë!
 Mos kujton se është i yni ky flamur që ngjitet lart?
 E ngjit Savofi, o shpirt, jo Lala Shahin, shihe mirë!
 Edrene... ajo kala e çeliktë e islamit,
 Edrene... ai ballë krenar i Lindjes,
 Hipja e dytë në fron e të bijve të Osmanit,
 Në prodhimitari, ndoshta zona e parë e botës;
 Edrene... dryni i "selisë së hilafetit",
 Tani nën këmbët e poshtra të bullgarit!
 Ushtria fitimtare hakmerret si të dojë,
 I bën copë-copë fëmijë, gra, burra, ç'të gjejë.
 Edhe këtë gjenocid e pranoj nëse respektohet,
 Në mos shenjtërinë e fesë, së paku të mos shkelnin atë të nderit!
 Kjo xhami katër minarësh që s'kish të ngjarë,
 Që i shkëlqente dielli i artit në hënën e re,
 Tani ka marrë kryqin në gji e pret... pa shpresë!
 Zë ezani s'janë ata tinguj kambane që zgjaten e shkojnë
 E që ti po dëgjon! Tempulli i famshëm i Sulltan Selimit
 Që ka gjetur mëshirën e Allahut,



Tempulli që i ngjante shkëlqimit të përgjumshëm të mëngjesit,
Shih si është fundosur menjëherë:
Nën ato beze të përgjakura s'duket asnjë dritë!
As Zoti s'është më në zemër të saj, as Profeti në kujtesë...
Si një kufomë e qelbur e groposur në errësirën e blasfemisë!
Shihi shtëpitë të kthyera secila në një varr të përhershëm:
Në pesë muaj dyzet mijë vatra janë shuar, asnjë s'tymon!
Klithma që dëgjohet sokak më sokak, klithma e fundit e të vdekur-
ve,
Zëri që duket sikur vjen nga thellësitë, thirrjet e tyre për ndihmë.
Vetë jashtë i dënuar, nderi brenda...
Shih se si i vret robërit mizoria më e rëndë!

Grumbujt që ke parë mbi Maricë dhe Tunxha,
A e di se ç'janë? Kufoma njerëzore hedhur e trazuar!
Të gjithë të pashpresët brenda mureve të Pallatit, gra...
Eshhtë pjesa e hedhur mënjanë e këtyre kufomave!
Në pamjet, shikimet e shuara të syve të shuar;
Në veshët, agonia e njerëzve përreth që sa s'kanë vdekur;
Në prehrat, nga një kufomë e copëtuar e groposur...
Me vdekjen jep e merr një grumbull kockash... Sa e hidhur!
Këmbëzbathur, kryezbuluar, me një rreckë hedhur mbi shpinë,
Në mjedisin e shkretë të këtij ishulli ku s'gjendet asgjë,
Edhe uji në i lëntë të ikin që aty, s'i lë bullgari!
As shpëtim, as vdekje... Shih ç'fatkeqësi..
Të jetojë? S'ka të drejtë! Të vdesë? Edhe vdekja e ndaluar!

- Kush është kjo luginë përballë që po e rrethojnë flakët
E që përpëlitet për tokë si gjarpër?
- Kush është? Kuptohet nga bulërima: Arda...
- Po ishujt që ngrihen e ulen ndërsa zgjaten të frikshme?
- Varri që noton i mijra trupave, kokëve!
- Ngjyra zjarr e këtij përroi të kuq flakë,
A mos është hija e reve të mëngjesit?

- Ç'thua!

Aq jetë të shuara në brigjet e tij
Ku rrodhi për muaj të tërë gjaku i të pafajshmëve!

- Kjo skenë e përgjakur ç'është?

- Cila skenë e përgjakur, kjo?

Është mjedisi i Gymylxhines ku bullgarët
Kanë bërë të këqija të mallkuara që s'i bën asnjë egërsirë!
As pleq kanë dalluar, as për të vetmuar kanë pyetur,
Në pesë-gjashtë ditë tridhjetë mijë burra kanë therur!
Duke i shpuar pomakët tejpertej me bajonetë,
Kanë dashur t'ua heqin besimin që nga thellësitë!
Po u shemben një e nga një virtyti, nderi, foleja familjare...
Dhe, pasi kanë humbur çdo gjë, u thuhet: "O ngordh, o bëhu bullgar!"
Ata që u është copëtuar gjoksi me sëpatat më të pamprehura,
Ata që u janë derdhur trutë të shtypur nën gurë,
Jetët që rënkojnë shtrirë mbi baltë
Që u dogjën me vajguri a me katran
Me një gjakftohtësi që i ka hije bullgarit,
E flijuan veten për hir të Zotit duke thënë:
"Përkulja para kryqit është kundërshtim i Zotit, ruajuni aman!"
Thanë mijëra shehidë që për hir të Madhit u bënë kurbanë,
"O bëhu bullgar, ose ngordh!" është vetëm thënie tradhtare...
Shihe qenin se si sulmon i tërbuar për hakmarrje
Me të parë një imam, sepse i pengoka njerëzit për t'u bërë krishterë!
A numërohen të varurit me çallmë?
Sikur të mos mjaftonte toka, varr edhe në qiell!
O ju dëshmorë që nuk e flijoni çallmën e kokës,
Por lartësoheni me të në botën shpirtërore,
Ç'lumturi për ju! Shumë vdekje kam parë në këtë botë,
Por nuk kujtoj një vdekje heroike si kjo!
Tablloja që e përfaqëson më bukur lidhjen më të fortë
Pas litarit të Allahut në këtë botë,



Eshtë kjo vdekja juaj heroike!

O ju njerëz të lumtur të bartur nga puhizat erëmira

S'e pati hak dhëu trupave t'ju bëhet varr,

Edhe po s'e morëm ne shpagimin tuaj te armiku,

Do të vijë një ditë, sigurisht, kur Allahu

Që jua ka shkruar emrat në librin e robve të Vet vepërmirë,

Do të zbresë nga këto male poshtë një popull të gjallë

Që atë shpagim pa dyshim ka për ta marrë!

- Ç'është ajo fushë e shkretë që duket atje larg

E që rri ashtu e dëshpëruar?

- A s'e njeh? Kosova!

Po si mund ta njihje? Po, edhe pse s'e njeh, ke të drejtë,

S'ka lënë gur mbi gur egërsira e tërbuar!

Po qe se më parë të ka sjellë rruga e nga kjo shkretëtirë ke kaluar,

A po sheh tani ndonjë shenjë nga e kaluara?

Ç'janë bërë gjërat që të jepnin krenari? Gjithë ato troje fisnike?

Si janë zhdukur ato vepra që s'kishin të numëruar?

Si është shkatërruar, o Zot, me një revoltë,

Ajo luginë, në qiellin e së cilës ka kumbuar

Zëri tronditës i mbretërve trima si Bajazit Jëlldërëmi,

Por mbi çdo gur të së cilës tani një korb ulet e rri?

Pa shih tani se nën këmbë të kujt rënkon toka

Që Muratin e Parë e fsheh në gji!

Në dorë të kujt e lamë amanetin e kujt!

Atë varrin tronditës të atij Sulltanin shehid

A do ta shkelnin, më në fund, ushtritë serbe,

Fanfara e tyre ushtarake në ballë e pirë?

O ti dëshmor i madh që shpirti yt i begatë dëgjon

Se ç'po heqin gërmadhat e mbetura mbi dhé,

Zbrit mbi ne të paktën një frymë nga ai shpirt,

Se ndryshe nuk zgjohen këta të vdekur që sheh!..

- Ç'janë ato hije që ecin atje përballë?

- Ushtria fitimtare tani po popullin po e vret.

Popullsia muslimane është shumë më se ajo jomuslimane,
 Pa drejtpeshim është problem të qeveriset
 Muslimanët theren që të sigurohet drejtpeshimi;
 Po u realizua kjo, vrasje muslimanësh më nuk do të ketë!..
 Siç duket, ende nuk është drejtpeshuar: çdo anë digjet,
 Mijra jetë priten sikur të pritëshin dru në pyll!
 Ç'hije e zezë ka rënë mbi atë Kosovë të blertë!
 Drejt veriut, Prizreni, Peja, Gjakova
 Janë kthyer në qiell të ditës së fundit nga klithmat e zisë...
 Dhe një ditë e tillë kur nuk ka ndërmjetësi për shpëtim!
 As e drejtë jete për të pafajshmit njëvjeçarë në djep,
 As e drejtë jete për pleqtë tetëdhjetëvjeçarë në prag të shtëpisë!..
 Ky, i prerë me sëpatë, ai i shpuar me bajonetë,
 Grumbuj-grumbuj kocka përzjerë me gjak të ngrirë bashkë!
 Gjithçka shihet, oxhaqe të shembura, jo gjë tjetër,
 Oxhaqet e shuar u bënë njëqind e pesëdhjetë mijë!
 O ju pesë-gjashtë të poshtër që e përgatitët këtë zjarr,
 Që na turpëruat ne para kroatëve e serbëve,
 Pse e ndatë shqiptarin e lidhur me Kur'an pas halifit
 E copëtuat dhe e shkatërruat tërë vendin?
 Kuptoni se ç'qenka të pretendosh për racë!
 Shihni se në ç'rrugë u asgjësoka një komb!
 O ju të patru që të parët e vollët këtë helm,
 Pandehët se ikët e shpëtuat... Por sa gabim!
 Po qe se sot ende s'e keni gjetur belanë,
 Nesër rrufetë do t'ju plasin mbi krye pa dyshim!

O Vardar që ecën duke u fryrë e fryrë,
 Burrat e gratë që ke mbytur, a kanë të numëruar?
 Dallgët tua, që në varr për shumë kufoma janë shndërruar
 A ende s'janë ngirë nga trupat e pajetë mbi ujë duke notuar?
 Ç'u bënë ato qëndisma që ta zbukuronin kujtesën çdo çast?
 Ç'janë këto njolla të zeza dallgë-dallgë të rëna mbi gjoksin tënd?
 Pse u prenë meloditë brigjeve tua?



Sikur të dëgjoja një zë miku pa vdekur! Sa keq!
Ata trima zemërzjarrtë, hijet e gjalla të të cilëve
Vraponin e shëtisnin mbi supet e tua nazemadhe,
Ato nuse të bukura, reflektimet e ndriçme të fytyrave të të cilave
Flinin plot naze e dashuri në prehrin tënd,
Ata baballarë heronj, ato nëna që silleshin
Rreth brigjeve të tua me fëmijët për dore...
Janë bërë tani, bashkë me ato hije, nga një ëndërr e shembur,
Nga një ëndërr e groposur, tani, apo jo! Ah!
Shih, në dorë të kujt është sot ajo fusha e famshme

E Selanikut, e Serezit? Fole e cilit hajdut?
Ashtu i është ngjyer trualli me gjakun e muslimanit,
Saqë e kuqja alle e tij është reflektuar në ballë të kohës!
Nën horizontet e kuq, i kuq çdo vend...
Pa shih, u skuqën malet, u skuqën luginat,
U skuq fytyra e botës, u skuqën qiejt;
Por ky flamur bojqielli akoma nuk po skuqet!
Nëpër vendet ku valon ai, një tufan i kuq
As jetë la, as besim, as ndërgjegje pa e mbytur!
Minaretë u shtrinë për tokë, xhamitë heshtën,
Medresetë u shembën, tyrbet u rrafshuan.
Shumica e faltoreve s'janë më, kurse ato që kanë mbetur,
Ja mejhane janë, siç i ke parë, ja kishë.
Shtëpitë në qytete u bastisën, populli në qyteza u vra,
Në katunde s'mbeti nder pa u fëlliqur! Dhe kush i bëri të gjitha këto?
Grupi me emër osman, me shpirt grek, më mjeshtri për këtë punë!
Këta të tërbuar që e mbështesnin të ashtuquajturën "ushtri e shenjtë",
Hapën zjarre të tilla anembanë
Që, ku shkuan, nuk tymon më asnjë oxhak
Që nuk ka për të tymuar, ndoshta, gjer në kiamet!
Në çdo hap grabitje, në çdo hap krim,
Të gjitha llojet e të këqijave të përgjakura, të lejuara!

Këta të mjerë me ballin e copëtuar për të vizuar kryqin,
 Këta të mjerë të ngrirë në liqen të akullit për pagëzim,
 Jetimët e shkretë të ngrirë në të ftohtë,
 Këto mitra të bëra copë-copë me bajoneta,
 Këto kufoma vajzash të shkelura nga opinga të gjakosura,
 Këta që u janë shkretuar familjet, që kanë mbetur pa shtëpi,
 Këto nëna të shkreta, këta fëmijë të braktisur, pa njeri,
 Këto gjyshe që shkulin flokët, këta baballarë që rënkojnë,
 Këto kufoma që dalin si blloqe eshtrash
 Nga nënkubetë e shembura me bomba,
 Klithmat zemërçjerrëse përreth këtyre trupave të fshehur
 Nën grumbuj hiri, as në teatër s'shihen, apo jo zotëri i mirë!
 U mërzite, ë? Prit të të tregoj një skenë tjetër:
 A e di se cili vend po rënkon kështu?

.....
 A mos u bë iqindi, o ti? Ç'është ky zë që fton për falje?
 Po... Qenka bërë iqindi... Ejani, pra, të lutemi,
 Të themi se do të na pranohet... Te Allahu të mbështetemi:
 O Zot, mos na ndëshko, mos na shkatërro...

- Amin!

Të mos bëhemi ibret, shembull i keq për botë...

- Amin!

A s'u bë boll më shfaqja Jote përmes ndëshkimit?
 T'u bëfshim kurban, u mërzitëm tepër nga këto pasqyrime!
 Me një mëngjes plot shpresë për ne, të ardhmen na e garanto
 Me ato ditë të bukura, o Zot, neve na përgëzo!

- Amin!

Nëse kemi mbetur për të nesërmet, ku janë ato?
 A nuk do të mbarojnë këto zi të gjata që e shtypën islamit?
 A nuk do të ngrihen perdet e përgjakura nga horizontet tona?
 Mjaft me zjarrin Tënd... Dritën Tënde presim tani!

- Amin!

Në zemrën e popullit nuk ka shpresë për të ardhmen!
 Vetëm një dhimbje ka ai: s'e gëzon ndihmën Tënde!



Ti ke për t'i kënaqur zemrat duke thënë "Ja ndihma"!

Mos e kurse, o Zot, për ne një frymë prej atje lart!

- Amin!

A të zvarritet Kur'ani nën këmbë, o Zot?

A të shkelet mbi ajetet e tua, o Zot?

A të duket kryqi në ballë të Qabes, o Zot?

A të shembet, më në fund, një fe kaç e madhe?

Mos na bëj, o Zot, të heqim kaç shumë mjerim!

- Amin!

Ve'l-hamdu li'l-lahi Rabbi'l-alemin!

Lavdi Allahut, Zotit të botëve!



Libri i pestë
KUJTIMET



*Shkëlqesisë së tij, Omer Faruk Efendi,
personalitet i shquar i Derës së Hilafetit,
me respekt ia kushtoj **

* Omer Faruk Efendi (1898-1969), biri i halifit të fundit, Abdylmexhid, i larguar nga vendi më 1924 pas rrëzimit të halifatit.



Me emrin e All-Ilahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"Zoti ynë, mos na ngarko me atë
për të cilën ne nuk kemi fuqi!"*

(Kur'ani, Bakara: 286)

O Zot, që ke shumë kohë që po na edukon e na jep mësim,
O Zot, që po e shtyp botën islame, po i jep rënkim!
Ne, që premtimit tënd hyjnor i besuam,
Ne, që për një mijë e treqind vjet Ty të kujtuam,
Ne, që, kur njerëzimi u falej një sërë idhujve,
E shembëm atë besim të shtrembër përgjithmonë,
Ne, që i hodhëm poshtë dyshimet menjëherë
Duke u sjellë faltoreve Zotin e Vërtetë,
Ne, që ia bëmë të njohur botës emrin Tënd,
Nëse e kemi marrë shpërblimin, mjaft me kaq, o Zot!
Ç'dhimbje, ç'mundim na ka mbetur pa e hequr?
Çdo çast i jetës për ne, ditë ndëshkimi është!
Gjaku i etërve tanë si lumë ka rrjedhur,
Kurse qëllimi i tyre, me fenë tënde të jetojnë paska qenë,
Edhe të bijtë kurban do t'u bëmë për të!
S'ka gjë, mirë po për këtë vend pa dritë,
A s'ka një vështrim-dritë që nga baxha ta vështrojë,
Një yll, o Zot? Ç'burg është ky, kjo, ç'errësirë?!

Ende shëtit në qiellin tonë nata e pambaruar?
Ende nuk po duket ajo copë agimi e premtuar?
Në periudhën më të gjallë e më energjike të jetës
Po llaçitemi në baltovinën e zisë dhe vetmisë!
Bota kënaqet, ne, me shpresën për të nesërmen kemi mbetur!
Na e trego, më në fund, të nesërmen, se u turbulluam,
Një fjalës Tënde, dhe ati, dhe biri kurban!..
A s'po bëhet ende ky popull, për mbështetjen Tënde i denjë?
Disfata e mbështolli qëllimin e të pashpresit sërish,
Në shikimin e tij e ardhmja u errësua e u errësua...
Ndërsa zjarri në Ballkan sapo zuri hi,
Sa shpejt: Shpejt e shpejt të dalë një xhehennem i ri!

Por mos e mposhti ky xhehennem atë? Kurrë!
Ende është kah e ngjit me vrap namin e vet përpjetë!
Nëpër dunat ranore kalon ashtu me nxit:
Sikur era që i ngre ato, të jetë fllad mëngjesi,
Kurse shkretëtirat nga kalon, bulevard me pemë përreth!
Nga shtresat e dëborës rrjedh aq i frikshëm,
Sikur të ish ujvarë që i copëton gurët mespërmes!
Nën diellin përvëlues, shkretëtirat i shëtiti,
Mbi akujt e ngrirë rrëshqiti e male kaloi.
Më në fund, po shkon: Ka zënë një rrugë që arrin te Zoti,
Sytë që ia shohin Allahun, botën e kanë harruar!
Jo gëzim, nga pas rënkim disfate e ndjek...
Kur kujtohet, tani për të s'ka as zi e as vetmi!
Kur kujtohet, nuk ka më dhimbje e dëshpërim,
Kur kujtohet, nuk ka më për fëmijën e tij trajtim për jetim,
Kur kujtohet, s'është më dheu ku lindi e derdhi djersë,
Kur kujtohet, ka mbetur një gjë si kujtim:
Thirrja e etërve shehidë: ngjitu e merr lartësim!
Dhe ai u ngjit, por, prapë, me shpresën përdhé
Se shpërblimi i një shehidi të tillë është fitorja;
Gjaku do t'i shkojë humbur, o Zot, po s'ia dhé!

Berlin, 14 janar 1915



ZGJOHU!

Pa shih me qafë përkulur kush po qan ?
E drejta për të jetuar, e jotja, o musliman!
Shpëtoje atë të pashpresë për hir të Zotit,
Nga gjumërat e vdekjes zgjohu, pra!

Nuk u ngope, megjithë se ke kohë që fle,
S'të mbeti gjë pa hequr, s'vure mend ende;
Ta shkelën vendin fund e krye,
Kurse ti një herë vendit s'u trazove!

Tronditja që ndjeve, s'është ninanana...
Është një rrymë e përjetshme që rrjedh pa prá;
Eja, bashkohu dhe ti me atë rrymë plot vrull
Që s'ndalon: emrin "kohë" e ka!

Rrymë zemërplasur: para s'i dilet dot;
Në pastë që t'i dalë, bëhet copë-copë!
Pse vrapon pas dallgëve që s'e di nga shkojnë,
Ç'është ky pasion për të rënë në gropë?

Tmerrin e së kaluarës sille në kujtim;
Askush s'të vrapon nesër në ndihmë!
Nëse ti s'ke mëshirë për veten,
A s'ke mëshirë as për birin tënd?

Po ngrihesh të bësh një veprim pa kuptim
Duke thënë: "Unë e kam sjellë në botë birin tim..."
E drejta prindërore, për fat të keq,
I shtyka njerëzit edhe në këtë krim!

A është e drejtë të biesh në pashpresim?
A s'ka ndonjë zgjim me zell e durim?
Mos është mëngjes kiameti ç'po pret?
Dita po perëndon, ti kërkon agim!

Jeta e popullit që i mban sytë pas,
Bëhet vrapim drejt fatkeqësisë.
Zoti të ardhmen ta ka vënë para
Ta shohësh, kurse ti ende s'ke ndërmend!

O Lindje e madhe, o i pafund meskinitet!
Mendo dhe ti të shkundes, mos rri në vend!
Kam frikë se nesër nga dora e Perëndimit,
E keqe pa hequr s'ka për të të mbetë!

Po qe trime, duhet ta rrëmbesh me gjak
Të drejtën për të jetuar pa t'u shkelur prapë;
Sepse sot, i zoti i të drejtës së vet
Eshtë ai që thotë: "Të drejtën s'e jap!"

Berlin, 18 Shkurt 1915



Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"O ju që besuat, kini frikë All-llahun me sinqeritet të vërtetë.."

(Kur'ani, Al-i Imran: 102)

Moralin as kultura, as ndërgjegjja s'e lartëson,
Ndjenja e virtytit te njerëzit nga frikë e Zotit buron.
Po qe se nga zemrat është hequr frika nga Zoti,
As kultura s'ka ç'të bëjë, as ndërgjegjja kurrresi...
Jeta është shtazore... madje edhe më e ulët:
Kafsha është e lidhur pas natyrës, njeriu është i liri absolut.
Kafsha s'del dot nga kufiri i palëvizshëm i krijimit,
Njeriu, ende për një kusht të tillë s'ka njohuri.
Në zemër, drojtja nga Zoti duhet t'i ketë zënë vend;
Ndryshe, nderit s'i mbetet më asnjë kuptim! këtë ndjenjë
E kanë edhe populli, edhe individit në paçin ndërgjegje;
Ndërprerja e saj, shenjë disfate për njerëzinë!
Ky është ligji më i madh veprues i Krijuesit në krijim,
Pa të fillon te popujt asgjësimi i moralit,
Prapësia morale, më rrëqethsja prapësi
As komb shpëton, as ndjenjë kombëtare, as pavarësi!
Mos ju duket lodër, morali kombëtar është shpirti kombëtar;
Falimentimi i tij është vdekja më e frikshme, është vdekja
E përgjithshme: shoqëria shkelet me këmbë pa shpëtim!
Përderisa Zoti s'e shpëton duke zbritur një shpirt të dytë;
Sigurisht, në ringjalljen pas vdekjes për këtë gjë ka mundësi...
Por, s'ndodh dot shumë epoka pa kaluar!

Ajo shoqëri, në ndërgjegjen e së cilës sundon frika nga Zoti,
Zotëron gjithë botën, është mbret mbi gjithë njerëzit.
Kurse populli, individit i të cilit s'di gjë për këtë frikë,
Poshtërohet sa evgjitet, kombi më i poshtëruar;
Më s'i mbet dëshirë për t'u lartësuar, fisnikëria ngrihet gjithë;
As vullnet për të sunduar ka, as frikë nga të qenit i sunduar.

Ndërsa të parët për hir të nderit s'e kanë vënë në hesap vdekjen
fare,
Nuk lënë tani nipërit e një brezi të pastër disfatë të paparë
të denjë për t'u nënvleftësuar për hir të jetës!
I gatshëm të ngordhë nën shqelma; një i vetëm të mos bëjë "pët"!
Zemrat rrahin për qëllimin më të ulët, më të mjerë,
Nervat dridhen nga frika më e pamundur, bërrr, bërrr!
Nga anëtarët e shoqërisë interesi personal bëhet zot!
Pyet kë të duash, s'di kush gjë për të vërtetën!
Ndjenja gjithnjë e gjallë e turpit për Zotin bëhet fli,
Gjithë ndjenjat e larta, fisnikëri, njerëzi!
Eshtë gabim të thuash se pa këto ndjenja kombi mbetet gjallë;
Një popull me shpirt të vdekur që jeton, a më gjen vallë!

2 Shtator 1914



*"Kush nga muslimanët nuk merr pjesë
në hallet e muslimanëve të tjerë,
nuk është nga radhët e tyre!"*

(Hadith)

Ku është muslimanllëku! As njerëzillëku s'ka të bëjë me ne...
Mashtrim i botës po qe qëllimi, kot e ke, s'mashtrohet kush!
Sa muslimanë të vërtetë që të kem parë, të gjithë në varr,
Kurse muslimanllëkun, s'e di, ndoshta e gjen në qiej!
S'e dua, ajo krenari e fundme le të rrijë mënjane...
Tregomëni një gjak që t'u përngajë të parëve pak a shumë!
Dëshiroj të shoh tek ju nga raca juaj një kujtim;
Jo shumë, vetëm një tipar, të denjë për një bir të pastër.
Thomëni, në ju ka mbetur një copëz maturi:
A kështu të pagjak qenë të parët tuaj heroikë?
A kështu qe dhënë gjithkush pas sevdasë për t'u ndarë?
A qenë besimtarët si xhuzat e pangjitur të mus'hafit*
A ishte parë që nyja e bashkimit të ishte bërë pikë e pesë
A pati ndodhur popullit t'i prishej kështu zemra ndonjëherë?
Vëllai vëllanë kështu prej urie a e pati vrarë?
A pati qenë zakon të hahej kufomë njeriu drojë pa ndjerë?

Nderi na është shkelur, bijtë na janë therur;
I panbregë, n'mos u mërzitsh dhe qafsh, turp të kesh, mos u zgërdhij!
Po të qe i pajisur populli me forcën që i thonë "ndjenjë",
Nga kryeqyteti sot s'do të ngrihej lart britma e të dehurit!
Ujku e paska parë nga larg gomarin të menduar vetëmvetë
Dhe e paska sulmuar papritmas si shigjetë.
Po m'i lumtë gomarit që, pa ia varur, vazhdoka të hajë bar
Sikur të vinte një urith thatoq a një lepur lozonjar!
Fitim e paska quajtur gomari dhe një dorë bar më shumë,
Por ndërkohë armiku ia paska prerë kafshatën në gojë!..

* Kur'ani Famëllartë.

Kjo është e vërtetë, kurrë s'devijon, jepi formë si të duash,
Halli ynë, si i gomarit me ujkun është, s'ka asnjë ndryshim.
Armiku na ka zënë për hundësh, ne ende grykën mendojmë,
Pa shihni: akoma pas grykës e lakmive po vrapojmë!
Kini pak respekt për veten, sado pak ju duhet turpëruar,
Koha e turpit ka kohë ka ardhur e është duke kaluar.
Lëvizni pa ju rënë këmbana e asgjësimit;
Në një të tillë vorbull keni rënë që,
Jo për të bërë qejf, ju s'keni kohë për të mbajtur zi!
Lëvizni se gazi i gjithë botës jemi bërë!
Ndërsa hakmarrje presin në qiej qindra mijra shpirtra,
Pritja është haram për popullin në tokë tek kufomave u ka ngjarë!
A s'ka tek ju gjak nga të parët heroikë?
Kujdes, e ardhmja e juaj në rrezik, jashtëzakonisht në rrezik!

26 Qershor 1913



Me emrin e All-Ilahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

“E kush ka qenë i verbër në këtë (botë), ai do të jetë edhe në botën tjetër i verbër dhe më i humburi i rrugës së drejtë.”

(Kur’ani, Isra: 72)

Më në fund gjëja që kuptove nga kjo jetë,
Po të njëjtën gjë do kesh si pjesë dhe nga tjetra jetë.
Është gabim të presësh çdo të mirë të kësaj bote nga ahireti,
Bota tjetër nga kjo botë s’është e ndarë!
I hutuar, ti, që thua se kjo botë triditëshe s’ka vlerë,
Mos pandeh se ç’dëshiron, të pret gati në tjetrën jetë!
Çfarë ke mbjellë që nga e nesërmja po kërkon prodhim?
E drejta jote me të drejtë: sot dështim, nesër dështim!
Po qe se qëllimi i Krijuesit do të ishte vetëm tjetra jetë,
Përse do ta kishte krijuar nga hiçi këtë jetë?
N’sa vendqëndrimi i përhershëm i shpirtit të ndarë nga “ezel”-i
Është “ebed”-i, pse me trupin të takohet në rrugë?
Po qe se pas “elest”-it nuk vjen xhennet dhe xhehennem,
Përse shpirtrat në këtë botë sërish të merren në provim?
Domethënë: bota nuk është dhe aq për t’u nënvleftësuar;
Një begati e përjetshme është me këtë jetë e kushtëzuar.
Thonë: “Bota s’është e vërtetë, pra është e përkohshme”.
Po, e përkohshme, por, nga një vështrim, e përjetshme.
E pavazhdueshme qenka jeta... Le të jetë!
Kënaqësia e përhershme, disfatë, çdo çast i saj është
Një përjetësi me këtë vlerë.
I hutuari që thotë: “Bota është e përkohshme, pra, e pavërtetë”,

Ç’përgjigje jep, «Atëherë krijimi del një gjë e kotë!», po t’i them?
A mos vetëm vdekja është synimi i ardhjes në këtë jetë?
Fundja, përpjekje qoftë dhe vetëm për të kuptuar.
Jeta të është përfitim, përfito, mos rri, që në të aguar
Që nesër miliona klithma të mos të bëhet fryma e numëruar!
Meqë kjo botë është për shpirtrat shesh prove,

Po s'u përpoqe pa pushuar dije se njeri nuk je!
Përse të të kalojë koha me papasje, varfëri e mjerim?
Në zell pune s'tregon vazhdimësi, në të Madhin a s'ke besim?
Puno, bëhu njeri në këtë botë sa e ke në dorë,
Bota tjetër, e pe, s'shtihet lehtë në dorë!
Ahiretin s'e lëshon goje, o musliman, por ç'di për të,
S'është gjë tjetër veç dëshirë për përtaci!
Po s'u shërove nga ky iluzion i marrë
Dhe po ndenje duarbosh, do të mbetesh duarbosh!
A s'mjafton ç'vrapove pas hijeve, o i hutuar?
Ç'të drejtë ke ende të vërtetën për të mos e kuptuar?
Kjo botë qenka ëndërr ose e përkohshme!?
Në ahiret e kupton ç'e vërtetë e palëkundshme!

29 Tetor 1914



"Islami është sjellja dhe karakteri i mirë!"

(Hadith)

Ne që patëm çarë oqeanin më të madh të fenomeneve,
Patëm shtypur dallgët e pasosura të ngritura lart të tyre;
Ne që përkundër kohëve, epokave dhe ngjarjeve,
Patëm shtënë në dorë pushtetin e gjithë një bote;
Tani jemi nën shtypjen asgjësuese të një dallge të vetme!
Tani jemi në brigje simbole të dënimit!
Me një goditje të tillë të përmbysset një gjemi...
Mbresa e tmerrit ende ma trondit dyshimin!
Një fatkeqësi e tillë ngjitëse, një vdekje e tillë e papritur:
Edhe ma shohin sytë, edhe them: vallë mos është ëndërr?
Ç'ëndërr! Është vetë ajo që je duke parë!
Pikat e pamundura: vetëm nëse ajo goditje shkatërrimtare
Të jetë nga jashtë, një aksident, një e papritur,
Si dhe - mendimi më i gabuar - të jetë qiellore.
Goditja është nga brenda... jo nga jashtë, jo, kurrë!
Pastaj, një gjë e tillë s'ndodh aksidentalisht, dije mirë!
Fjala "rastësi" s'ka kuptim, është marrëzi,
Sepse e asgjëson të ardhmen, o të patrú!
Dhe asgjë nuk zbret nga qielli, e gjitha nga toka del;
Një komb prej moralit të vet vdes ose i gjallë ngel!

Po u shkelëm ne sot, shkelemi me të drejtë,
Sepse ku është nderi, ku na mbeti morali?
N'sa muslimanllëk, sjellje e pastër do të thotë,
Sa keq që ramë aq shumë në fëlliqësi! Dhe s'po dalim dot!
Të jepesh pas dhunës, të mos pyesësh për të drejtë e drejtësi,
Po qe vetë mirë, të mos ngresh kokë edhe nëse bota digjet,
Ta thyesh fjalën, të mos druhesh nga fjala e rreme,
Të jesh me të fortin, i dobëti të drejtë fjale të mos ketë,
Shumë ceremoni pa vlerë: përkuljet plot servilizëm,
Buzëqeshjet, dyfytërsitë, gënjeshttrat pa pushim,

Fraksionet, nacionalizmat, ndarje për shkak gjuhe pa nda,
Dobësia më serioze në trutë e njerëzve më të sinqertë,
Pas shpine, luan, përballë, mace e shtruar...

.....
Para nesh muslimanllëku poshtërim të tillë s'pati parë!
Gjendja jonë, gjendja e një trupi të shkrirë;
Asgjësimi ynë shpirtëror, asgjësim i moralit është.
Eshtë një fjalë e thjeshtë, por më përmbledhësja e urtësive:
Një mundësi shpëtimi kemi: moralin ta lartësojmë,
Ndryshe, disfata na shumëfishohet e keq përfundojmë,
Sepse, po s'e bëjmë, dhe bota, dhe feja shkojnë!

3 Korrik 1913



Me emrin e All-Ilahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"E atyre (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha:
'Populli (idhujtarët) është tubuar t'ju sulmojë, pra kini frikë!' Ajo,
vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: '
Neve na mjafton që kemi All-Ilahu,
Ai është mbrojtësi më i mirë!'"*

(Kur'ani, Al-i Imran: 173)

Vetëm islami është feja e përpjekjes, feja e guximit të drejtë;
Është heroizëm i madh të jesh musliman i vërtetë!
Frikacakërinë, shpirtvogëlsinë nuk i nxë dot shpirti islam,
Për kauzën time librin e Allahut po ta sjell dëshmitar!
Po të kesh besim e ndërgjegje, e ndjen, e sheh
Se ç'trimëri e madhe troket në zemër të Kur'anit!
Po ku është ajo ndërgjegje? Te kush ka të tillë besim?
As unë s'e di ç'ka ndodhur: tani ndjenjat janë krejt errësirë!
Sikur ky komb të kishte dhe pak nga ky besim,
Treqind e pesëdhjetë milion popull s'e shihje në këtë mjerim!
Ai besim kërkoi nga ne bashkim, kërkoi njësim...
Na tregoi si duhet të jemi "të lidhur si tullat një për një"
Mirë, po ne, ç'bëmë? U ndamë degë-degë, u bëmë copë-copë...
Më në fund, me një goditje të poshtër ramë, u bëmë trokël!
Ai besim, përgatitje dhe forcë pati urdhëruar,
E ne thamë "iu mbështetëm Zotit", fjetëm dhe mbetëm të dobësuar!
Ai besim thotë se arsimimi është pa diskutim i detyruar...
Po ç'popull injorant jemi ne, muslimanët, sot në botë!
N'sa ai besim që mbrojtësi i krijimit më të mirë,
Nga virtyti ç'na ka mbetur, ç'kemi mangut nga fëlliqësitë?
Domethënë: te muslimanët, islamit vetëm emri i ka mbetur,
Prandaj kohët e fundit disfata kombëtare na qenka shkaktuar.
Po që se s'duan të shtypen nën rrjedhën e ditëve, muslimanët
Duhet t'i kthehen kohës së parë të islamit!
Kujtimi dritësor i asaj periudhe është madhështi e pambaruar,
Krenari është histori e tyre, ummet është ai ummet
Që, nga një anë, duke shpërndarë heronj,

E ka bërë botën të dridhet, nga ana tjetër,
Ç'është njerëzillëku botës ia ka mësuar!
Këtë ndëshkim duke rënë nën këmbë kurrë s'e kanë parë!
Posti i lartë nuk zbritka nga maja.
Cilësia e "dorëzimit" vetëm për ta paska kuptim
Që të gjitha dhimbjet i kanë përbuzur.
Nuk u tërhiqkan kurrë prej vështirësive nga vendosmëria,
S'u kthehan nga qëllimi vdekje sikur të shpërthejë nga toka!
Thashë: "Të jesh musliman, është heroizmi më i madh!"
Ja, pra, çështja ime mbështetet mbi ta!

17 Shtator 1914



NË LUKSOR*

*Shkëlqesisë së tij, Emir Abbas Halim Pasha***

Moti që i rëndë, por e nxehta shumë nuk ndjehej,
Gjer në perëndim vetëm gjysmë ore pati mbetë.
Banesa ku isha mik, afër bregut ishte,
Dalëngadalë zbrita nga maja me pemë në ranishte.
Para meje, lugina me Nilin në gji, e bleruar,
Që vjeshtë në jetën e vet kurrë s'ka shikuar;
Dallgëza rrathë-rrathë që ngjasin me smerald,
Zgjaten e zgjaten: një jetë përrallore si mirazh!
Shiheni këtë shtrirje: a ka shoqe në shtat e gjerësi?
Dielli që e mban gjithë ditën të përqaftuar këtë hapësirë,
Që e mori Nilin në lindje dhe po e lë në perëndim,
Po shkëlqen në horizont tashmë me të fundit rrezatim...
Megjithatë, e pamundur të shihet me sy të lirë.
Në të majtë kam një hurma tek po hedh shtat krejt e vetmuar...
Edhe pse truallin e ka mjaft të pjerrët, ç'të bëj,
U fsheha, më në fund, në gji të hijes së saj të copëtuar.

Shikimi drejt qiellit nga kjo pikë, ç'emocion!
Fusha që në të dy brigjet si flatra marrin të përpjetë;
Shikimi me t'u zgjatur një herë në supet e tyre magjike,
Përfytyrimi fluturon e shkon në një botë tjetër!
Horizonti që tash derdh flakë mbi tokë,
Frymë dehëse derdh të ngrohtë, të ngrohtë.
Buzëqesh fytyra e mjedisit të ngopur me ujë,
Sepse lagështia e kësaj rrjedhe nga qielli ka zbritur.
Vendi kumbon në qeshje si kundërvlerë e heshtjes qëparë,
Buzëqesh gjithajo luginë, majat me radhë,
Buzëqeshin një velatore me varka lopatagjatë

* el-Uksur: vend rreth gjashtëqind kilometra në jug të Kajros.

** Abbas Halim Pasha (1866-1934), farefis i Ali Pashës nga Kavalla, vëlla i kryeministrit Said Halim Pasha, mik i poetit.

Tek duan të ngjiten rrjedhës përpjetë.
 Buzëqeshin që tej hijet duke derdhur në Nil
 Ndërtesat e hoteleve me sjellje mirënjohjeje.
 Buzëqeshin pesë-gjashtë hapa brenda bregut
 Puset që punojnë me hunj të lidhur me litarë.
 Buzëqeshin felahët tek bartin ujë me bucela,
 Buzëqesh udhëtari që e sheh këtë në jetë për herë të parë.
 Buzëqeshin përrenjtë e mbuluar me gjembishte,
 Buzëqeshin ara e korije që s'kanë të numëruar.
 Buzëqeshin gratë tek kthehen nga lumi
 Me enë balte në kokë në formë gjymi.
 Buzëqeshin fëmijë të zhveshur tek peshkojnë:
 Marrin ujë me qepshe nga lumi dhe e kullojnë...

Statujat që pashë në mëngjes duke u përsjellë,
 Që ambicja njerëzore e mjerë pas përjetësismit e marrë,
 Në vend që ta qëndisë në zemra kujtimin me mëshirë,
 Hijen e vet të pavlerë për ta gërryer në qiell,
 E ka ngulitur me tmerrin e këtyre dordolecëve
 Duke ngulur me çdo një shkëmb epitaf për një mijë jetë.
 Dhe toka do t'iu nënshtrokësh nën këmbë,
 Dhe vijat në ballë qiellit do t'i jepkëshin drithërimë!
 Por dora e fuqisë tronditëse q'i thonë "kohë",
 U ka dhënë këtyre heronjve një mësim të tillë
 Që as hundë mendjemadhe s'u ka mbetur pa iu thyer, as krah!
 Mjedisi mësimdhënës me grumbuj kufomash mbushur plot!
 As madhështi në fytyra, as krenari në ballë,
 Tërë kuptimi rrëqethës i rënë mbi shkrimin e fshirë.
 Shfaqja kaq e pamëshirshme e drejtësisë,
 Ngjall te shikimi i vizitorit ndjenjë për mëshirë...

Po, varreza e atyre statujave që e largët për mua;
 Veçse, me t'm'u kthyer sytë kah ata,
 Them se qeshin dhe çehret e tyre,
 Buzëqesh vendi i një tempulli të madh atje tej.



Buzëqesh, kur shoh në të djathtë, “Karnaku” përballë,
Buzëqeshin ato shtylla të zhytura në Nil,
Lozin dallgët me hijet që drithërijnë.
U buzëqeshin mbi kokat e hallakatura skeptrat e florinjte,
Hurmat furçojnë qiellin bregut nga shkëmbinjte.

Nga sheshi i rehatshëm ku po rrija,
Hijen si çardak ca më sipër
Të ngrihem e ta shoh pak, thashë... Sa mirë!
Si nja trembëdhjetë udhëtarë francezë, anglezë, gjermanë
Të bërë tok nga tre e nga pesë: bardakët drithërijnë!
Francezët gajasen... se xhepi plot
E bën të dridhet gjithësinë e mbetur tyre borxh!
Edhe nëse Sedani e vë ca në mendime maskaranë,
Mirëqenia e bën njeriun ta harrojë dhe plagën më të thellë!
Anglezët qeshin; do të qeshin, kanë të drejtë:
Bota nën urdhër të tyre, “vdis!”, po t’i thonë, do të vdesë!
U kanë vënë flakën popujve, rrinë përballë e vështrojnë!
N’sa çelik e gurë përplasen, ata llullë tymojnë!
Gjermanët qeshin, sepse, ç’të thotë ai që ka forcën,
“E drejtë” do të thonëse s’kanë ç’të bëjnë!
Njerëzimi që ende s’ka forcë ta marrë të drejtën,
Ç’shpëtim tjetër ka veç ta marrë me forcë?
Në je i dobët, e drejta jote: të rrish e të vajtosh!

Po, brenda kësaj skene entuziazmi, hareje kënaqësie,
Vetëm unë i mjeri s’qesh...
Jam ulur e po qaj; dhe në qafsha, i justifikuar jam:
I pavatan jam në vendin e të parëve!
As një zë miqësor, apo gjurmë miqësore
As në dheun e këtij vendi, as në ujëvarë!
Fushat, jehonën e thirrjes që u bëj nuk ma kthejnë.
Sikur ta dija, o Lindje e stërmadhe, o botë skaj më skaj,
Birit tënd në qetësi, ku i bje të rrojë?
Kryet në fatkeqësi të ka rënë, krahë e duar thyer,
A fryu ndonjë ditë brenda teje ajri i mëvetësisë?

Gjithë vendin e shëtita gjersa më lanë këmbët
 Vendin musliman para vetes për ta parë...
 Kur zëra të huaj më erdhën nga rruga nga kaloja,
 Gjithë dëshira të thyera më shpërthyen nga zemra e qarë!
 Në gjoks të islamit të jem pa vatan?
 Ky fund, ç'hakmarrje e dhimbshme e kohëve!
 Për mua, të padorë e të pakrah të plakurin
 Të përpiqet të marrë shpagim biri im!

Tani në horizont dielli lëkundet në të shuar,
 Veçse ende fytyra i digjet duke flakëruar.
 Pas pak, me rrezet e fundit, një shtyllë
 E ndritshme e palakueshme me ujrat e Nilit
 Papritmas më erdhi e m'u ngul përballë.
 Por kjo hije krenare, kjo mbresë pamjerëndë
 Që pandeha nga shtrirja se do të mbetej shumë kohë,
 Për pesë-dhjetë minuta u fshi nga kujtimi i Nilit.
 Sa keq, ajo hije dhe miliarda hijeza
 Qënkeshin hedhur në këtë vorbull për t'u bashkuar me të!
 Dielli tashmë s'shihet, malet i ka si perde përballë;
 Tani ai nga horizonte të tjerë e shfaq bukurinë.
 Perëndimi e derdhi hidhur-hidhur shpirtin e vet të dëshpëruar,
 Mbi tokë u shtri dalëngadalë një natë e mjeruar.
 Nilit i ndryshoi fytyra: para meje, pak në të gështenjë;
 Në vend të shtyllës-hije të pak më parë, një alle shumë e thellë;
 Por pak më tej, pothuaj errësirë.
 Kësaj ngjyre zije dhe malet i bënë shoqëri:
 Pashë nga larg se balli i tyre i tymtë u bë zi.
 Më në fund, perdja e perëndimit vendin kish mbështjellë.
 Ndërsa errësira mbulonte si me tyl horizontin
 Që qeshte pak më parë,
 M'u zgjua në shpirtin e brengosur një përfytyrim i pabesuar:
 Bota e heshtur para meje po qan, kujtova...
 Zbrita nga ajo hije, drejt dritës lart u drejtova.

28 Janar 1914



KUJTIME BERLINI

*Vëllait tonë, major Omer Lutfi Bej**

Më kish thënë shoku: “Sikur dhe pak nga kafja të kishim dalë!”
Ai kish folur drejt, por unë e kisha kuptuar shtrembër;
Kafeneja e mëhallës, nga më shkoi ndërmend?
Në fakt, s’duhej të më shkonte. A e njihja unë atë?
Kafeneja e mëhallës, ...Berlin,... ç’lidhje ka?
Por, ju lutem, më dëgjoni, tregoni bujari:
Fakiri juaj, qoftë dhe më e qarta fjalë, jam i detyruar,
Gjënë që e gjeta në kokën time, ua them e rri.
Po qe se një shembull i saj më ka kaluar, fundja, nëpër duar,
Them: “Hë! Këtë paska dashur të thotë ajo fjalë e dëgjuar!”
Për shembull, në u tha “hotel”, shoh se ç’thotë
Ai fjalor i respektuar: po, fjalë e njohur;
Pseudonimi në regjistër, han, moshën, shtatëdhjetë!
I mjeri në fund të jetës kish ndërruar fe;
Vetëm se ateizmin stomaku nuk ia kish tretur;
As musliman, as frëng; një trup, ashtu, i mjerë.
Nuk lahet, tualet nuk ka! Verës baltë në bel;
Shiu kore zë duke i rënë nëpër rroba poshtë!
A nuk është ai që i varet uçkuri, i matufëve model?
Pa kah ballkoni: e shqetëson diellin
Ai jorgani tërë lagështirë tek shkundet nga dritarja!
Pajisjet e shtratit, seriozisht për të ardhur keq!

Jastëku prej kambriku bërë si kadife...
Bëni llogari, tani, ç’transformim!
Mbresat me morra njolla-njolla janë shpërndarë,
Faqja e atij çarçafi tashmë me njolla duhet stampuar!
Në broken e thyer pret një lëng me myshk
Që për të uriturin është mjaft sa për tre të ngrëna.
Vendi i një buke s’u mbushka pa qenë tre ujë;

* Omer Lutfi Bej, oficer me detyrë në Berlin në kohën kur qe ndodhur edhe poeti.

Një gotë e këtij plot u bëka, ndoshta, pesë bukë.

Thoni shimendifer... Ja, ia gjeta shembullin:
 E vërtit rrotën e nazes pa përtuar
 Karroca që punon në e lejoftë fati
 Dhe afër në qoftë kasabaja nga pika ku keni hipur.
 Lordi i Samatjas, inspektor; konti i Tatavlas,* drejtor,
 Individët e të mjerit popull, në mes: robër!
 A “biletari” e ka emrin? S’e di mirë;
 Një bodrum me tavan të ulët, me myk, me lagështirë,
 Në këmbë tek gogësinjë të mjerë udhëtarë.
 Ku është biletashitësi? Ai robi nazemadh i kompanisë
 Nuk e sheh drejt popullit nga ajo perde atje tej...
 Po pse duhet ngutur? Robtë e Zotit le të bëjnë durim!
 Penxhereja më në fund u hap, vetëm se, në s’daç
 Të shtypesh në presë, mos u fut në penxhere!
 Shtytjet, të zakonshme; rrahje dhe të shara mbi gjithçka!
 Biletçi, mësjë, treni kur do të niset, vallë?
 Ma shkele këmbën, o njeri! Ç’ke? Plase, vjen vërdallë!
 Ta dhashë një turinjve!

- O ju, ç’është kjo zhurmë! Rrini!

- Ngadalë, o ti!

- Yt, bre, qorr je?

- Pardon!

- O Zot!

Si doli ky “pardon” edhe gomarllëku u bë zakon!

- Ç’fjalë që tha, për Zotin, thoni, a shkon?

- Mos e zgjat!

- Zëre se e zgjata?

- Burrë, ama i trashë!

- Dhe në thënçin, i vrari s’është fajtor...

- Shih, pa shih!

- E, ç’është? Ja, pashë!

* Dy lagje të Stambollit, Samatja (Koxhamustafapasha) dhe Tatavla (Kurtullush), atëbotë të banuara kryesisht nga jomuslimanët.



- Pushoni, do të dalë ngatërresë!
- Duhet të kesh të holla!
- S'kam, mësjë!
- Po s'pate, shko e i prish!
- Mos ngul këmbë, ç'të thotë sinjori, është ligj!
- Po më ikën treni, o shpirt...
- Ai s'dëgjon, kurse unë, jepi!
- Ikën treni, them; nuk dëgjon fjalë, thotë; çudi!
- Po u nxeh, ka gojë të keqe, të thotë një fjalë që s'mban;
- Dhjetëshen e prishin; shko e e prish paranë!
- Duhanshitësi thotë "dhjetë para janë pak"... E keqja e ze:
- Duke kërkuar simitçiu, bilbili i trenit bjë...

Thoni, për shembull, "sokak"... Pashë nga fjalori...
A duhet papë referim një burimi? Sigurisht, posi!
Po: sokaku është një spirale, gjashtë pëllëmbë e gjerë;
Po e gjatë? S'e di; sado të them, do të gënjej.
S'mund të kesh sukses në parashikim;
Po shkoj e po hyj pak brenda njërës prej shtëpive!
Rregullimi i ambientit poezisë së kohës i përngjet:
Si fillimi, si fundi, kredhur n'errësirë.
Mirë, po ç'duhet të bëj nëse s'dua të përplasem me dikë?
Në s'qoftë keqndjellës, ç'është kaq i çuditshëm ky vend?
Po të kesh në gjuhë Besmele, në dorë Sure-i Nur,
Në qese myhyr,... askush s'përplaset dot me ty... Me lejë!
Hapi i parë, ... shpëtova; hapi i dytë, ... i lehtë...
Por s'e hedh dot pa u menduar hapin e tretë...
Pse? Ka hapur gojën një gropë e thellë
Që, po të bjerë njeriu brenda, s'di a del?
Bjeri anash, sillu larg! Mirë, u muar dhe një pengesë,
As atij që kapërcen, i mbetet gju, as atij që ngjitet, një!
Atëherë duhet shkuar anës... A ka mundësi?
Në të djathtë, mur me bark që e kanë zënë të prerat,
Në të majtë, baltë ngjitesë e bërë rrëshirë!

Prit, e gjeta zgjidhjen... sa mirë:
 Shkul pesë a gjashtë gurë sipër nga kjo rrumbullakësirë
 Dhe i mbjell rrugës duke thënë “kjo zhytet, kjo rri mirë”!
 Domethënëse Thesarit të Vakëfeve do t’ia shtosh edhe një urë
 Eja, ec, mos e zgjat! O ju që duke u hedhur vini pas,
 Po ju porosis: mos e shpenzoni kot këtë thesar me gurë
 Se, një ditë, po qe se balta e kalon timen urë,
 Besomëni, ka për t’ju hyrë në punë kjo minierë!

Ai yni s’paska qenë hotel, as shimendiferi, tren...
 Thua sokaku i përngjan ca? Aman, ç’fjalë? Assesi!
 Hotelet na qenkëshin të rregulluar si saraje;
 Njeriu hyka brenda e jetoka për shtatë palë qejfe!
 në secilën prej pesë-gjashtëqind dhomave, shtrat me pupla...
 Mos u mendo, shko e shtrihu po t’u dha mundësia!
 Në sokak le të bjerë borë, në dhomën tënde, pranverë;
 Jashtë nata më e gjatë e dimrit, brenda mesditë!
 N’sa perden e dritës e zgjat çdo abazhur,
 Në qiellin e dhomës endet një mëngjes i mugur.
 Një oxhak e nxeh ajrin pa u ndjerë,
 E njëjta ngrohtësi shëtit nga çdo anë duke u nderë.
 Çezmat rrjedhin të kthjelltë, të kthjelltë,
 Ujë të ftohtë ka, po të duash, dhe të nxehtë!
 Mjedisi kërcëllon, shkëlqen në pastërti,
 Pandeh se mbi dysHEME s’ka shkelur njeri.
 As marr ka në atë shtrat të bekuar, as plesht;
 Këtu s’ndjen të kruar, mos prit të kruhesh!
 Ishte një insekt... emrin ia harrova...
 Ngjitej në mure, shihte jastëk e hidhej.
 Kur e shtypje, një erë e ndyrë përhapej...
 Po ç’ ishte, xhanëm, ç’ ishte? Tartabiq!
 Ai kish kohë që s’kishte zbritur këtu,
 Qoshe më qoshe e kërkova, do ta kisha gjetur një në mos hiç!



Edhe shimendiferi, treni, tjetër gjë na paska qenë:
Menjëherë hipën e fluturon... Aman, u mpaka!
Njeriu s'di madhësi vendi, s'di largësi,
Një orë, sa një minutë; koha si u shkurtoka!
Po, i përfshin përmasat duke i përshkuar si rrufe!
Njëllonj si shikimi që kalon mbi hartë,
Qytetet, si të qenë të ngjitura, pranë e pranë,
Po u hodh një gjilpërë nga dritarja jashtë,
Do të bjerë, gjithsesi, në një stacion, mbi çati!
Tabela me emrin e qytetit nga kalon, të vjen në xham,
Për fishkëllimën të merr malli, fishkëllimë s'dëgjon...
Treni ynë fishkëllen e s'luan vendit, mjeran!
As bukë me vete s'ke pse ngarkon...
Ç'është ajo në letër, djathë? Mos e hap, fute në gjil!
Qejfit të restorantit s'ke ç'i thua, po deshe, shkon,
As gjuha e huaj s'të duhet, një shenjë dhe kupton...
S'ka ashtu të dremisësh mbështetur supin në hejbë,
Po desh të flesh, brenda... dhe ç'shtrat!
Shtrihesh e i shkëput lidhjet me këtë botë;
Vërtitu qiejve, tashmë, në ëndërr, vend më vend!

Ç'qenka ajo që i thokan «sokak»? Gjerësi e pafund
Që këmbësori nuk ka mundësi ta kapërcejë shpejt.
Domethënë, ato mrekulli që, nën emrin "mjet transporti",
Fluturojnë në ajër, në tokë e, shpesh, nën tokë,
Janë një nevojë e fortë!
T'i kalosh në këmbë këto largësi? Mos qoftë e thënë! Kjo, punë e gjatë!
Shihni sa i lëmuar: trualli i shkëlqyer
Rrezatimet qiellore i zbret në tokë!
Këtë zgjatje shikimi le ta përfshijë, po të dojë,
Duke kaluar në anën tjetër, bie i pafuqi!
Vetëm se nuk ngrihet, pastaj, i zhyer në baltë!
Në këtë qytet balta s'ka baltë as dimër, as verë!

Para do kohe në Berlin ra mjaft borë,
 Po prapë, vendi kërcëllinte nga pastërtia!
 U bëra kureshtar e pyeta; “s’e lëmë” - më thanë!
 - Mirë që s’e lini, po në vazhdoftë të bjerë?
 Prapë po ajo përgjigje: “Nuk e lëmë!”
 Vendosmëria e tyre sheshit në këtë fjalë.

Tek ne, pak borë të bjerë, hiqet me vështirësi.
 Mëhalla po mbeti, më në fund, shumë në hall,
 Thuhet: “Për lutjen e jugës duhet dalë!”
 Dhe Zoti, erën e ngrohtë të jugut dërgon, por ç’e do,
 Vendi mbushet me grumbuj balte ca më keq
 Dhe ne themi: “Eh, sikur të ngrinte...” Eshtë pastërti;
 Akulli thyhet... lëre, mos e pyet:
 Bie, shkrihet, akull bëhet... fundja, dimër është tani!

Të ngratit, jaka që s’i ka parë ujë, i është bërë blozë...
 Dikush i kujdesshëm, e ka parë dhe i ka thënë:

- U shofsh!

Ç’e ke atë këmishë në atë hall? Pse s’i jep një të larë?
 - Pse, a s’ka për t’u fëlliqur prapë? Shih qejfin, të më rrosh!
 - Ujin s’e ke me pakicë..., o përtac njeri,
 E lan përsëri...

- I varfëri, s’e bëj dot;

Edhe pse ka sapun, Zoti s’na ka dërguar në këtë botë
 Vetëm për të larë këmishë!
 Ky tregim, për ne, normë bazike që vërteton statusin tonë;
 Fjala mbi fshesën nuk mbaron, që ta zgjasim pa pushim!
 As ne s’erdhëm në këtë botë sokakët për t’i fshirë!

* * *

- Sikur të dilnim për një kafe, - patëm thënë; ku?
 - Ndoshta ju lodha pak duke ju shëtitur.
 Por s’është larg, gjithsesi...



- S'u lodha, ju pyeta për ta ditur.
- Sa të hyjmë në ato katër rrugë, frikë mos ki...
- Mrekulli!
- Ja ku u duk!
- Mor, po ku? Akoma s'po e di...
- Do ta dish, do ta shohësh sa t'i afrohem dhe një copë...
- Kjo është kafe? Ashtu, ë? O ti! Ç'është kjo?
Se Zyra jonë e borxheve më madhështore!
Vetëm se jo e zyrtë dhe e papëlqyer si ajo!
- A s'pate tjetër shembull? Atë përmendore falimentimi lëre!
- A s'e kemi lënë? Po ku merr vesh nga shpërfillja, ajo!
Ka thënë djali: "Baba, së fundi prure turbullirë!"
Djalit të paturp plaku i shkretë ç't'i thotë:
"O ti, s'e prura unë që, ajo erdhi vetë!"
Edhe kjo punë krejt si kjo rrëfenjë. Kush i tha
Ndjellakeqes "eja"? Ti lëre sa të duash, nuk të lë ajo!
Si? Borxh duke marrë, a mund ta mbash qesen plot?
- Byrazer, mos u zhyt në dhimbjen e pafund të popullit
Për ta kthyer bisedën në një histori të pafund!
Për të shëtitur dolëm, mos harro!
- E drejtë!
Kjo qenka kafja... Ashtu, ë? Po më lë pa mend!
Gjerësi brenda gjerësisë... Një intimitet tërë dritë
Me një mijë diej në qiellin e tij të pafund!
Ndriçimi i kthjelltë që na del para plot hare,
S'është ndriçim, fryma e agimit mëngjesor që rrjedh rrëke!
Atë tufan zbardhimi ta shohësh përballë netëve,
Zoti e di, hutohesh, t'u bie ngricë ndjenjave...
Pse të mburrem? Edhe unë ngriva, në do ta dish dhe ti,
Sepse masa e ndriçimit në mendjen time ish qiri!
Me hesapin tonë, kjo këtu luajtka me miliona,
Masa e kandilit të zbehtë këtu tepër cung.
Në çastin e parë, m'u morën sytë, mendja m'u rrotullua,
Po të mos ish shoku, do të isha turpëruar:

As pashë ku shkela, as se nga ç'anë shkova,
 Çudi si s'u shemba përdhe, s'u rrëzova!
 S'qe çudi se, duke u rrëzuar, karrikja më erdhi në ndihmë,
 U ula mbi të e mora thellë frymë...
 Desha të shoh përreth, e kuptova, shumë e vështirë:
 Koka tradhtare e varur mbi zverk, më ka ngrirë!
 Jo! Inati i saj s'qenka i pashkak, paska,
 Unë s'kuptokam gjë, por ajo shumë gjëra kuptoka:
 Xhufka e festes sime ftoka mirë e mirë
 Ato shikime të huaja si rrufe nga një lartësi!
 Tufa e shikimeve si rrufe u mbledhkan te unë
 Ngado që ardhkan, afër apo larg... Dhe, Zoti pastë mëshirë,
 Do deshkan të ma mbledhin mbi krye xhufkën
 Që të mos më varet përdhe... Më mirë vdekjen!
 Domethënëse në këtë vend festja ende s'paska hyrë!
 Tanët ç'vënkan, qylaf? Gjithsesi!
 Për një çast, m'u shkëput nofulla nga këmisha...
 Dhe koka m'u drejtua pak
 Dhe m'u rrotullua përreth për të parë ç'ka e ç's'ka;
 Ndërkaq, zbuluesi ynë rrethkahjen duke e kontrolluar,
 Pashë një tavolinë tej e i thashë shokut:
 - Sikur të rrinim pak si mënjanë; a s'dalim në krye atje?
 - Pse?

- S'më pëlqen të dukem, prandaj...

- Dalim, shumë mirë!

Edhe unë jam i prirur më shumë për vetminë.

Po, nuk dukeshim për njerëzit si një çast më parë
 Prej këtij vendi syri më lehtë ta kapte mjedisin.
 Ashtu siç ndodh që lakuriqi i natës në dritë duke fluturuar
 Përplaset me një gjë të zezë qoftë shkëmb ose mal,
 Do të përplaset dhe mblidhet edhe shikimi im i nervozuar
 "Paf", një herë, sidoqoftë... O flutur e hutuar!
 Dhe si i marrë, pa përreth duke u rënë në qafë të gjithëve:
 Fëmijë, grua, burrë, krejt ç'gjeti!



* * *

Para meje lartësohen balle të zhveshur të pafund
Ku te secili kuptimi i fitores së luftës ndaj botës
Eshtë shkruar; shihni dhe merrni mësim.
Me atë besim populli të gjitha kërkesat,
Dhe në mos sot, pa dyshim, nesër do t'i shpëtojë.
Përpjekje e mbështetje!.. Ç'veprim heroik!

Pasi u liruan atë mes katër-pesë karrike,
M'u ulën përballë një burrë mjekërmurrme
Me shokun e vet të fatkeqësisë mbuluar si për zi
Si dhe një çupëz e dashur pesë a gjashtë vjeç.
Hidhërimi shumë pamjerëndë i kryetarit të familjes
Ia mbështillte fytyrën dhe me një ngjyrë inati me vendosmëri.
Edhe gruaja po kaq kërkon të tregojë qetësi,
Por shikimet e shuara, të dëshpëruara gjer në vajtim!
Hidhërimi u është bërë në buzë një nyjë e helmuar,
E pazgjidhur, vetëm shpërthimi në vaj në pastë për ta lëshuar!
Në të majtë, buzëqeshja e detyruar e burrit,
Në të djathtë, lehtësimi i natyrshëm i të birit,
Përballë, skena periudhash të pafundme nga jeta
Shpirtin rënkongjës nuk ia heshtin assesi.
Duhet të kish parë një gjë që pastaj e mjera
E çoi papritmas në fytyrë shaminë.
Ç'ka këtu për t'u turpëruar, o grua e shkretë!
A s'je ti një nënë dhe i vdekuri, djali yt?
Përpjekja për ta mbytur atë vajtim të me të drejtë,
Zoti e di, që është gabim... Lëre, mos hyr në mëkat!
Lëre shpirtin që dhemb të rënkojë me thëllim...
Mos është zija jote një fatkeqësi që do reshtë pa u zbratur?
Po qe se soditës e pandeh mjedisin për zinë tënde,
Cili vështrim është i huaj për vajin tënd të fshehur?
Fundja, është shoku im, apo jo, edhe unë pastaj...

E paç më qafë po qe se mendon kështu!
 Po qe se fatkeqësia ka një mik të hershëm, jemi ne;
 Në këtë botë dhe një ditë s'na ka kaluar pa fatkeqësi!
 Edhe për gëzimin, të vetme, zemrën muslimane ke;
 Di të rënkojë përballë të pafajshmit të prekur thellë.
 Me të bisedohen dhe ndarjet më të dhimbshme
 Se çdo kujë, sa dhe një gjuhë të hapur e kupton.
 Atëherë, ndajeni dhimbjen me ne me mirëkuptim,
 T'jua dëgjoj si e keni hallin kam për qëllim...

Pa të shohim ç'është klithma jote e fshehtë?
 Po, djalin që e rrite gjatë gjithë kohës bashkë,
 Të shtypur ende në pranverën e jetës
 Trupin si fidan një tokë e huaj ia ka gëlltitur
 Që s'dihet ku është; dhe në daç ta dish, e pamundur.
 Krejt kujtimi i tij sot, një iluzion i përbaltur, i përgjakur!
 Atë kujtim në shpirt e gropose: e ke për detyrë.
 Të të thuash "harro", varrin e hapur të mos e shohësh
 Do të thotë! Unë nuk them. Ai varr ka besë, e di.
 Por mendo: përse e ka përbuzur jetën?
 Mendo, përse ky djalë shkoi dhe e dogji nënën?
 Po, për ta bërë të jetojë mëmëdhenë:
 Ndjenja e vatanit i paska thënë "të japësh jetën!"
 Domethënë, kot s'të ka shkuar djali martir për vatan.
 A e di sa nëna ka sot në zi në Tunizi,
 Në Kaukaz, në Algjeri?
 Vëre një herë dorën në zemër, o nënë
 Dhe mendo të të mjerëve fatin e zi!
 Ç'dhunë! Ç'fatkeqësi! Qëkur ekziston kjo botë e njerëzi,
 Jam i sigurtë, s'ka hequr këtë dhimbje, këtë fatkeqësi!
 Tani për tani s'po i fus në llogari në bregun tonë
 Oxhakët e shuar; vetëm në Afrikën e mjerë,
 Oxhakët e njëqind e pesëdhjetë mijë grave nuk lëshojnë tym!
 As për djalin e parritur kanë pyetur, as për burrin plak,



I kanë marrë e sjellë në Francë në ushtri
Për t'i vënë në radhët e para si mburojë!
Dhe, duke kujtuar tët bir, moj e shkretë ose burrin ti,
Pa mendo një herë ato nëna, ato gra
Dhe thuaj për hesap të kujt kanë vdekur dhe rënko!
"Për hesap të kujt?" Përgjigjja trutë t'i copëton!
Kur sheh të keqen e qëllimit të synuar,
Pothuaj çmendet njeriu për tragjedinë e kësaj pune!
As për nderin e kombit, as për famën e vet!
Do të flijosh jetën për armikun e jetës!
Ngordh ti; atdheu, vendi i shenjtë ku të ruhet nderi,
Le të shkelet nën thundrën e huaj!
A nuk do që të ngordhësh? Shih se ç'bëhet:
Pjesëtarët e familjen që i le peng, kapen
E shtypen një nga një. Dhe me çfarë mjetesh:
Do të të digjej koka po të kishe mundësi ta gjesh!

A dëshiron të kalojmë pak dhe nga ana jonë?
Ja ku e ke Azinë ku s'ka një ditë pa zi!
Ai tempull i vjetër i diturisë, ai djep i Ibrahimit,
Tani, qafëpërkulur, tokë e mbetur jetim!
Le të rrijë e ta qajë, kur e kujton, kohën e drejtësisë,
Tani nën sundim binjak të Anglisë dhe Ruisë!
Kujdestarët hundëqurrashë gjakun ç'ia pinë,
Ia nxorën shpirtin, s'i mbeti më durim!
I gjithë thesari i Indisë, i atij vendi të shkëlqyer
Shkon për të kënaqur ambicjen e tre lordëve hajdutë;
Zija dhe uria vendasin e mjerë kohë më kohë e brejnë;
Ai le të pështyjë gjak, ... ata majmen për ditë!
Mbi të drejtën e popullit një despotizëm i poshtër sundon.
Jeta e tij, grumbuj kufomash të zhveshur shpirtit
Që japin edhe sikur të mos u mbetet gjë, gjithë paratë,
Pastaj i vjen radha pikës së fundit të gjakut në damarë...
Që s'do të mbetet fshehur, dashur pa dashur do të pikojë:

Do të shkojë e me dushmanin e zotërisë do të luftojë.
 Ai jep jetën, kurse ky, a e dini ç'thotë?
 "Në vdektë, shërben, në vraftë, shërben!"
 Kështu, sepse që të dyja janë në favor të kriminelit të pashpirt!
 Po dole drejt veriut, sheh poshtërsitë e pushtuesit tjetër
 Që e bëjnë me turp dhe Neronin rezil; sheh
 Dhe s'mundesh ta mbash thirrjen për mallkim.
 As grua të vejë, as jetim la ai vatërshkatërrues...
 Sa e mprehtë karshi popullit ajo shpata qorre e tij!
 Gjërat e përditshme: shkel fshatra, djeg qytete...
 Ushtria e të poshtrit, katile, kurse qeveria, shtrat!
 Nënshtetasit që e kujtonin paqen me mall në qetësi,
 U zvarritën nën bajoneta për në luftë një të fundit herë,
 U shembën pastaj shtëpitë e miliona të të pafajshmëve.
 Rënkimi i jetimëve e bën hapësirën të rënkojë tani!

A nuk je nënë ti? Gjermane a nuk je?
 Atëherë, je njeri me mendje dhe ndërgjegje.
 Atëherë, s'i ka hije virtytit tënd sjellja e huaj
 Që thotë, "aziatik, racë tjetër"
 Duke i fyer femrat që janë vajza dhe nëna si dhe ti...
 Sjellja raciste s'i ka hije virtytit tënd...
 Eja, merr pjesë dhe ti në fatkeqësinë e këtyre.
 Se thonë: "Gëzimi, kur përpjesëtohet, shtohet,
 Kurse dhimbja, në të kundërt, pakësohet".
 A e di se vështrimi yt i kthyer për kah Lindja
 Eshtë për të mjerët agimi i lindur për herë të parë?
 S'di pse, ndërsa dënoheshin me vdekje me mijra
 Treqind e pesëdhjetë milionë jetë me vatrat të shembura,
 Të fajësuar nën akuzën e njohjes së një Zoti,
 Nuk doli një zë kundër këtij urdhri!
 S'di pse nuk e ndjeu ajo ndërgjegjja e ndjeshme e Perëndimit
 Këtë gjak, nga rrjedha e të cilit rënkojnë gjokset e shekujve!
 S'di pse rënkimi njerëzor i ngjitur gjer në qiej,



Kur jehoi në qiejt tuaj, u shua!
S'di pse, dora e dhunës që e shkatërroi unitetin islam,
U quajt e madhe, e shenjtë u konsiderua!
Kur dhuna digjte e përcëllonte truallin e Lindjes,
Kur faqja e asaj toke të kuqe gjak përplasej për qiell,
As sa një soditës i rastit i kuqëlimit të perëndimit të diellit
Nuk mori pjesë bota në vuajtjen e saj!
Të merrte pjesë? Ç'është ajo fjalë? E duartrokiste xhelatin
Pa u turpëruar biri i goxha shekullit të njëzetë!
Po: të gjithë përplasnin duart për poshtërsitë!
Por në dorën tënde, pislleku i kësaj duartrokitjeje s'është!
Ai ballë që, me pastërtinë e një pasqyre të panjollë,
Dëshmon për pjekurinë e kombit krejt
Kah Lindja duhet të kthehet që edhe kujtimi i papastër
I Perëndimit tuaj të fshihet sadopak nga kujtimi i saj.
Zonjë, sikur ta dinit se femrat si ju ç'hoqën
Nga tradita e ulët e mjedisit tuaj që e ka përbuzur
Dhe shtypur të dobëtin me ta parë në vështirësi!
Është si paralajmërim i rezultatit të saj që,
Me të thënë "europian", ne kuptonim një bashkësi
Njerëzish shpirtshurdhët e zemrën mbyllur ndjenjave,
Për ne armik për jetë!
Por unë kërkoh të të paraqes te bashkëseksi yt
Duke thënë jo, kjo traditë s'është e drejtë!..
Dhe mos rrini si e huaj se jeni në zemër e butë.
Hidheni tej atë bestytini që keni për ato nëna të mira!
Mos u mendo, zgjatia Lindjes dorën e miqësisë.
Ç'nëna të dhembshura janë femrat tona!
Sa keq që s'ka pasur kush t'u tregojë e gabim i keni kuptuar.
Sa keq që, ata që i përshkruajnë ato si shtriga,
Janë pesë a dhjetë romanxhinj
Dhe, të pamërzitur, pesë a dhjetë qëllimkëqinj!
Ç'është kjo mosmarrëveshje? Ejani e kuptohuni,
A s'ju bëhen dot gjuhë e përbashkët lotët tuaj?

Dhe aq shumë dhimbje s'ka për t'u rënë në pjesë,
Për më tepër, ana tjetër jua lehtëson dhimbjen tani.
A s'besoni? Atëherë, bëni një llogari:
Po bëhet, ndoshta që në luftë po bëhen pesëdhjetë vjet
Që s'keni hyrë; nga lufta e fundit sapo dolët
Me një të famshme trimëri, u lidhët dorë për dorë,
Punuat ditë e natë, po aq dhe u lodhët
Që qetësia, me zhurmën në rritje, u kthye në rrapëllimë!
Statizmit absolut të paqes i dhatë dinamikë lufte;
Bëtë garë dhe e kapërcyët kohën, sa çudi!
A ka mundësi që popujt e tjerë të ecin me këtë shpejtësi?
Dhe në vrapofshin, pas gjurmës së ditëve shkojnë.
Popullsia juaj u rrit dyfish, dituria, dhjetëfish,
I ngjitët teknikës krahë dhe i dhatë fluturim!
Tokën e rroku fuqia juaj, hapësirën, arti juaj.
Në mos qoftë sot, deti nesër do të jetë robi juaj.
Përparimi juaj arriti, më në fund, gjer atje, sa
Kultura u bë ushqimi i përbashkët i gjithë popullsisë.
Elita juaj shkroi, populli juaj mësoi,
Sepse qëllimi i atyre që shkruanin, qe arsimimi i popullsisë.
S'harronin mendjet, horizontet duke përfshirë,
Popullin që e priste prej toke pjesën e të mirave.
Për t'u ngjitur në qiell, toka duhej të ish e lartë...
Këtë ngjitje ju e arritët më parë
Dhe u dukën në gjoksin e atdheut tuaj lartësitë.
Këto lartësi mund të jenë dhe te të tjerë,
Mirëpo te ju pas tyre nuk ka vende-vende
Gremina të thella, përroje si skëterrë.
E pse? Lartësitë nuk ngrihen të vetme, nga trualli ndarë,
Por ecin bashkë me truallin dorë për dorë.
Duke harmonizuar mendje e zemër e duke i vënë në punë,
U hodh themeli i çatisë së unitetit kombëtar.
Ky unitet është, pra, sekret i gjithë shkëlqimit tuaj,
Zëri që e dridh botën janë tingujt e tij!



Qëllimi juaj në shpërndarje nuk bën, siç ndodh te ne
Që ta çojë unitetin në copëtim.
Burimi në mendime le të mos jetë i njëjtë;
A s'është një synimi i të gjithëve? Pse ke frikë?
Po të shihet, rrezet e rrethit janë pa numërim,
Por të gjitha bashkë mblidhen në një pikë!
Ç'bashkim madhështor: nga brenda milionave,
Në raportin më të mirë, gjashtë dalin për një mijë
Ndjenja që shmangen nga ai synim me dëshirë;
Edhe më shumë në qofshin, s'ka vend për shqetësim.
Por mendimet tona janë të kundërta me ju.
Më parë qenë bashkë, tani ndahen të gjithë.
Duke u nisur nga ky vështrim, u ngjajnë vijave
Që, të dala nga e njëjta qendër, shkojnë
Drejt një hapësire të pa fund duke u hapur pa mbarim...
Ja, pra, e fshehta e dekompozimit tonë.
Lartësimi juaj me atë lidhje duke shkuar,
Me këtë copëtim populli ynë i shkatërruar.

Një melodi një akord që keni dëgjuar ju,
Në djep, pastaj në prag, pastaj në shkollë.
Shkurt, çdo nënçati, me të njëjtin zë mbushur plot.
Me të zënë këtë udhë që lidh bashkë në një harmoni
Të gjitha ndodhitë, me kohë, shkolla, garnizoni,
Fabrika, teknika u bënë të padallueshme,
Në të vërtetë, nga mjedisi intim familjar.
Këtë njësim deshte ta bënte të jetueshëm natyrisht...
Në atë punë e tregoi populli pjekurinë e tij të vërtetë.
Nga cili qiell zbriti jeta, mendoj,
Fenë që mëkon shpirtin e përbashkët mendoj.
Dhe në fund pa se ndërgjegjja e përbashkët në bashkësi
Pasurinë ndiesore e merr nga i njëjti burim;
Po të thahet një ditë ai burim, as ndjenjë mbetet, as jetë;
Jeta shoqërore e qëndrueshme në saje të vazhdimësisë së fesë;

U përpoq të përcaktonte ç'kishte të shenjtë...
 Ngriti një botë me gjëra abstrakte të patejdukshme.
 Me të marrë identitet iluzioni i vatanit,
 Kjo është më e larta e lidhjeve mes kombit
 Thatë dhe kurrë nuk u lëkundët për t'u kapur pas kësaj.
 Siç e keni shkollën, po ashtu edhe faltoren.
 As këmbana s'e mbyl melodinë e artit,
 As e hesht qytetërimi këtë zë jete të amshuar.
 Mjedisi juaj, ç'mjedisi i çuditshëm zhurmëplot:
 Çdo zhurmë e rrapëllimë, e denjë për një tjetër zgjim!
 Ç'ka nëse vrulli i industrisë shkon gjer në horizont?
 As harmoni e bukurisë s'është gjë që të narkotizon!
 As në muzikë nuk ju kanë hyrë tinguj që të mpijnë,
 As poezia idenë për jetën s'jua shkatërron!
 Po qe se i flet shpirtit gjuha qiellore e muzikës,
 Gjuha e poezisë i frymëzon kuptim ndjenjës.
 Duhet ardhur dhe parë nëse paska në art qëllim;
 A thuhet "jo"? Ja tek lartësohet në çdo tuajin qëllim
 E fshehta e artit më të mrekullueshëm, më të imtë!
 Mirë, po ec e na pyet ne si i kemi punët!

Në djep, secili nga ne dëgjon të njëjtën melodi
 Që s'ka për kompozitor natyrën, por traditën.
 Ndërkaq, po qe se në telat e kësaj tradite e shkuara
 Jonë këndon, me atë zë të shkëlqyer biem në ujdj.
 Mirë, po "teli bazë" që na përcjell krenarinë e të parëve,
 Ngaqë për shekuj s'është përdorur, është lënë në pakujdesi,
 Ose është shurdhuar krejt, ose ka zënë ndryshk
 Që, cilës perde t'i biesh, nxjerr tingull të shtrembëruar.
 Ky tel që, forcën legjendare të Jëlldërëmit
 Duke e kompozuar qysh në krye, me pangopshmërinë
 Me atmosferën e fitores, nuk linte të binte në gjumë
 Fëmijërinë e gjyshërve, sot i mpin nipërit me ninanana!
 Po qe se nesër këta fëmijë kërkojnë të hidhen



Nga pragu në jetë, zërat e dëgjuar në djep u vijnë n'vesh
E thurin mbi horizontet e tyre një mirazh opak:
E kanë mjaft të dobët shpresën për ta çarë e për të dalë jashtë!
Dhe kalojnë ditët më të zgjedhura të rinisë sonë
Duke e kuptuar jetën pa e hedhur tej këtë iluzion!
S'e kupton jetën, sepse e lexon, s'e shikon;
I shkreti është bërë dyzet dhe goja qumësht i kundërmon!
Mos i jep arsim, mbaroi; jepi, i marrë pas poezisë e fantazisë!
N'daç jepi shkollë, n'daç mos i jep, e njëjta perspektivë!
N'u bëftë llogari, aq sa injoranca del vrasëse kultura
Po qe se bëhet në një vend thjesht mjet për konsum.
Është dobia që pritët prej shkencave në përdorim.
Domethënë, e para, dituria duhet t'i shërbejë jetës.
Atëherë, dijet tek s'janë për zemrën ilaç!
Përfitimi prej shkencave ekzakte, negativ.
Ç'mbeti, një letërsi? Mjerë për ne!
Lëre që nuk i shërben ndonjë nevojë,
Ose e magjeps shpirtin e popullit, e turbullon,
Ose përplasët me ndjenjat në zemra pa pushim.
Gazeli më i pastër i të parëve kundërmon verë...
Gjatë pesë-gjashtëqind vjetëve fryma "saki" e pavlerë
Nuk la te osmanlijt nerva pa vënë në gjumë!

Ndërsa po mbyllej kjo e çarë që villte mejhane
Mbi mjedis, vrima të tjera dolën
Dhe u shembën të gjitha ç'duhej në këmbë të qëndronin.
Katër-pesë të varfër në turp, duke menduar
Se "ç'vlerë edukimi ka te një e pështyrë në fytyrë",
Deshën t'i japin fund moralit, turpit, nderit
Dhe nxorën në shesh saksi të mbushura plot
"Zambakë" të helmuar që nxehin atmosferën e kurvërisë!

.....*

.....

* Këtu mungojnë 98 rreshta..

Pasi e preu krejt shpresën populli i shkretë
 Prej belasë së vjetër të quajtur “shkrim-këndim”,
 Mbi mjedisin e tij ideor u lëshua një makth i përgjakur.
 Po të tërhiqej, nga pas netët e mundimit të quajtur “e shkuar”;
 Po të hidhej, para një e ardhme si mirazh dallgë-dallgë!
 As në qiell një ndriçim i vogël sa një yll,
 As në tokë një dritë që ndriçon sa një kandil;
 Me të derdhur retë e papasjes tufanin hijesor,
 Iluzioni lakuriq i vdekjes shëtiste me qefin.
 Deshi të bërtiste, por zëri s’i dëgjohej;
 U turbullua se i qe zënë krejt fryma.
 Më në fund, nga kjo ëndërr ashtu u bë një zgjim
 Që i kishin ikur dore të gjitha;
 As të dashur s’kishin mbetur më, as vend.
 Lëkundej e kërciste themeli i gjithë ngrehinës,
 Flaka kish mbështjellë strehët,...
 Rumelia s’ishte më në vendin e vet!
 Besimi gërmadhë nën opingat e hajdutëve,
 Zotin e bën të dridhet tek kërkon ndihmë!
 Në Ballkan, çobanët e derrave, fisnikë hijerëndë!
 Ata fisnikë, ata bejlerë, të gjithë të poshtëruar.
 Kryetarët e familjeve të gjithë kishin rënë dëshmorë,
 Vejushet mbyllur nëpër shtëpitë plot jetimë.
 Trualli i pajetë është një flakë rrjedhëse, përfshin,
 Të gjitha ujrato kanë qëndruar, gjaku ecën plluq-plluq.
 Virgjëreshave, që s’u përkasin shikimeve të huaja
 E që i rrëqeth vetëm përfytyrimi i kësaj,
 S’u ka mbetur më vend pa hapur, gjithçka sheshit;
 Mbulesa e papërlyeshmërisë mënjanë, vetë mënjanë.
 Kokat që s’janë zgjatur tej pragut të shtëpisë
 E që tani u rrinë sipër tufë-tufë lugetër,
 Tërhiqen zvarrë në mes të dimrit në bregun e Varnës
 Dhe barten me gjemi brenda Rusisë!



Kurse, kur Europa i futka zjarrin këtij vendi të plakur
Nëse sheh se i ka mbetur ndonjë pjesë pa u djegur,
Asnjë tru s'mendoka nevojën për të thënë:
“Zgjohu nga ky gjumë, zjarri e ka përfshirë gjithçka!”
Paskam harruar, pati të tillë që e patën ndjerë këtë vërtetë
Duke dalë e thënë: “Furrik s'ka, vezë s'ka!”

Edhe nëse edhe ju keni ndonjë disfatë shumë të përgjakur,
Tonëve s'u përngajnë askund! Pa krahasim.
Ushtria franceze qe fitimtare, ndoshta, në Jenë,
Por ju, sipas meje, nuk u mundët prej Napoleonit.
Në s'qe fitore, ç'qe ai shkatërrim i tillë
Që e çoi Gjermaninë në unitet?
Qe ky unitet që tregoi mrekulli në Sedan;
Domethënë, ajo disfatë qe lumturi, qe shpëtim!
Fatkeqësia jonë s'është kurrë e tillë:
Duke e pushtuar mjedisin deprimimi në çdo cep,
Nuk lë mundësi as për zgjim, as për përparim.
Dhe kuptimi i kësaj: ndërgjegjja te populli s'është një!
Kur vatani qesh, nënshtetasit tanë të nderuar
Nuk e durojnë dot, fytyrat nisin në të thartuar!
Po nisi prapësia për vendin e mjerë e të dobësohet,
Surratet e varura, të gjitha të kënaqura, duke qeshur!
E si të mos bëhet ky vend për të ardhmen pesimist?
Sapo të shfaqet në horizont një dritë e zbehtë,
Një shpresë e dobët, veç kur sheh se korbat e djeshme
E kanë mbytur atë dritë të qiellit që në bark!
N'sa Europa vrapon për të na e shpejtuar agoninë,
Brenda një tufë tradhtarësh na e gërmon varrin!
Edhe sikur të themi “S'duam të ngordhim!”, kush na dëgjon?
Po luajte vendit, “Ju shtypim, shkatërroheni!” na thonë!
Edhe nëse rri e vendit s'luan, dëgjon këtë refren:
“Të drejtë jete s'ka për atë që s'punon!”
Shkurt, çfarëdo që të bëjmë, është e kotë;

Edhe të punojmë, edhe të mos punojmë,
Jemi të dënuar me vdekje! A s'ke dëgjuar anglezi ç'thotë?

“Mos u hidhëroni, prejeni shpresën për të jetuar!
E vërteta është sheshit: a ka kuptim për të ëndërruar?
E dini: Egjipti është pothuaj koka mbi atë trupin
Si tullumbace të botës islame,
Kurse India, zemra e ndjeshme në gjoks të saj
Dhe ju, krahët që kërkojnë të lëvizin,
Të cilat nuk duhen nënçmuar se, sido, është frikë.
Ne, që jemi anglezë, e njohëm gjendjen që më parë.
Truve u ngulëm kthetrat e zumë vend në atë gjoks.
Kështu, mbetet një krah, që edhe ai do të varet;
Sapo ta lidhim, punën e vëmë në vijë!
Dhe jo me detyrim se “ideja e nacionalizmit”
I bën shërbim të madh lehtësimit të këtij qëllimi.
Sapo ta hedhim atë farë dyshimi të mallkuar në mes
Dhe t'i ndajmë arabët me turqit nga njëri-tjetri,
As krahu s'i lëviz dot më, as dora,
Edhe halifit i mbetet vetëm emri i bukur!
Pastaj, me ta bërë Lindjen rrëmujë me flotën tonë,
Në goditjen e parë e ngulim flamurin tonë në Çanakala
Dhe, në goditjen e dytë, e ngremë mbi “Daru'l-Hilafe”^{*!}
Ja, kështu, dëgjo dhe qaj! Po ç'komb i paaftë
Paskemi qenë në botë, me fatin të zi sterrë
Që, për ta shpëtuar atë tru duke shkuar në ndihmë,
Pesë-gjashtë kthetra për të na mbytur qenkan bërë bashkë!
U fshi e shkoi, ndoshta, gjurma e Hënës
Nga gjiri copë-copë i të shkretës Marmara!
Tani një copë beze angleze është ndoshta që valëzon
Në horizontin copë e çikë të Çanakalasë sonë,
Në atë portën e turpëruar të hapësirës sulltanore!

* Stamboll



O ti Bosfor që zgjate krahun e hekurt,
Rrugën detare që kërcënon vendin e Halifit
E lidhe për shekuj përballë njerëzimit.
Ende s'është e hapur rruga e bllokuar,
Kiblja ime në vend mbeti, mjedisi intim i besimit.
Për hir të Zotit, më thuaj se jam i shkatërruar!
Megjithëse jam larg nga mjedisi i vajtimit,
Mjedisi im rënkon nga zëri monoton i agonisë.
Këtë çast, ballin po ta shoh: zjarr po reshon,
Njëra prej reve mijra rrufe po lëshon!
Për hir të Zotit, më thuaj se s'po m'i dallon syri,
Ushtarë, gurë apo hije janë gjërat e zeza
Që qëndrojnë kundër asaj rryme së bashku me flakët
Që e përcëllojnë shikimin prej aq miljesh larg?
As gurë, as hije, as ushtarë... mirazh, kam frikë,
Ç'ka shoh, me grupe në supe të kthyer në hi!
Sepse, po të jetë gur, shkrihet, po të jetë hije, copëtohet,
Shpërthen dhe vjen ky tufan pa njohur para pengesë!
Qëndroni! Fantazmat që pashë, po lëvizin...
Shihni: përparuan... ushtarë! Zoti e di, ushtri!
Po, syri po m'i shquan tani një e nga një:
Bijtë më të shquar të ushtrisë të Halifit,
Që me ballët e pastër janë për islamin i fundit istikam.
Për hir të Zotit, o muxhahidë bujarë!
Mos e prisni qëndresën, vetëm te ju ka shpresë;
Po u tërhoqët, shuhet e shkon Tevhidi për jetë,
Shejtëria e të vërtetës shembet me sulmin e pandehmës!
Vendi që keni në dorë, është nyja e vetme
E jetës së islamit. Po shkeli këmbë i huaji,
Shenjat e fesë kthehen në një çast përmbys!
Treqind e pesëdhjetë mijë jetë me shpresë tek ju,
Gjoksin e sëmurë të të cilëve po e shemb ankthi që tani,
U këputen damarët e bëhen si libër i palidhur,
Fletët e hedhura andej-këtej të të cilit i shkel një kalimtar!

Minaret shkulen nga gjoksi i horizonteve,
 Gjuha e Zotit nuk u flet më hapësirave!
 Ç'pastë në zemrën e trembëdhjetë shekujve
 Nga jeta e së shkuarës sonë, për këtë çast janë gjallë;
 Harresa i kap një e nga një e i mbyt të gjithë,
 Dhe atëherë krenaritë tona bëhen iluzion!
 Shtëpia e Zotit shtegton në varrezën e historisë,
 Bie nën këmbë e kalbet gjoksi i Kur'anit!
 E dini se pothuaj ka njëqind e pesëdhjetë vjet që ne
 Po dorëzojmë gjithçka kemi në dorë e po tërhiqemi paprerë!
 Ne, bijtë e pabesë të Omerit, të Javuzit,
 Nuk e mbrojtëm dot kujtimin e të parëve.
 Ç'shpirit i dashur qe ai, por ne s'u bëmë të denjë për të;
 Më në fund, vendi ynë i copëtuar copë-copë,
 U zvogëlua aq sa nuk ka mundësi gjallë t'i mbajë
 E t'i kthejë prapë ndërgjegjen, nderin, fenë!
 Po, në na mbettë në dorë, më në fund, pesë pëllëmbë tokë,
 Për këto ndjenja vetëm varr mund të bëhet!
 Vatani po rënkon... Mos e braktisni këtë të mjerë,
 Për hir të Zotit, mos u ktheni mbrapsht!..

- Mos ki frikë!

Xhehennem në qoftë ç'po vjen, në gjoks e shuajmë;
 Kjo është rruga e Zotit, ecim, kthim nuk dimë!
 Mos pandeh se bie dhe një gur i ndërtesës së nderit?
 Gjersa dhe ushtari i fundit që hyn në luftë të bjerë dëshmor!
 Edhe sikur hordhia para nesh tërbohët, çmendët,
 Detet bëhen ushtri, retë reshajnë flota,
 Vullkanet poshtë nesh vërshojnë jashtë
 Dhe horizontin një e kuqe zjarr e mbështjell,
 A s'është në gjoksin e frontit tonë besimi një,
 Gëzimi një, dhimbja një, qëllimi i njëjtë, ndërgjegjja një?
 A s'është i gjallë bashkimi i çerkezit, lazit, turkut, arabit,
 Kurdit, secilit që vrapon në luftë sot?
 A s'është një zemra që rreh në gjoks?



S'përkulet, beso, bota të shembet, ky front s'lëkundet!
Ashtu si bie pa e ndarë horizontin pjesë-pjesë
Marrëzia njerëzore që sulmon Zotin ta mbysë,
Ashtu siç përplasat iluzioni me dritën e së vërtetës,
Bëhet me shkëndijat e përpjekjes fundi emërharruar,
Ashtu do të mblidhet edhe kjo turma para nesh.
Ky front së afërmi do të shpëtojë...
- Do të shpëtojë?..
Domethënëse nuk do të shembet vendorientimi
I shpresave të mia; domethënëse nuk do të mbarojmë...
Eja, shok, të shkojmë!

Berlin, 18 mars 1915

NGA SHKRETËTIRAT E NEXHDIT NË MEDINE

*Shkëlqesisë së tij, Sherif Ali Hajdar Pasha**

Dielli në kohë të drekës, prush i bardhë është, apo çfarë?
 Nga maja e vet derdh mbi trutë e horizonteve zjarr!
 Tufës së rrezeve që zbresin si shi rrufeje
 Shkretëtira i ka vënë gjoksin lakuriq e digjet.
 Ai gjoks i bukur, ajo shkretëtirë
 Që të fshehtë e artit nga piktori i Amëshuar e lexon,
 Që tërë krijimin shpirtpastër në vetvete e ndjen,
 Që vizaton tani në truall agim, tani në retë pranverë,
 Tani tufan drite, tani avull, tani shkumë,
 Tani hapësirat e shtrira, të heshtura e të menduara,
 Tani shkëmbenjtë e mprehtë të ngrënë e rënkues,
 Tani vizaton një oazë, tani të gjitha ngjyrat
 Tani përrenjtë e menduar, tani oqeanin e hijeve
 Duke i mbledhur dhe kaluar nëpër sitën mavi,
 Thur një mijë bukuri mbi rërat lakuriqe,
 Sa e frikshme bëhet shkretëtira, ai gjoks i bukur, në këtë orë:
 Një xhehennem i shtrirë me gjuhën jashtë merr frymë!
 As në truallin e saj s'ndjen jetë, as në hapësirë;
 Eh, sikur një ngjyrë jete të shihja!..
 Ku është ai qiell mavi? Ngjyra e fytyrës m'e zbehtë se hiri...
 Ajo ethe kronike mbi të pashpresin përsëri!

Nga doli tani etheja si krizë e fshehtë
 Pa u lodhur e dridhur sikur zhytet me zjarrmi,
 E shpon gjoksin e hapësirës, gërryen, bart
 Dhe atëherë mjediset flakë lëshojnë;
 Gjoksin e skutave që japin një dorë hije me mirënjohje,
 Mijra furra e lëpijnë dhe e copëtojnë!
 As frymëmarrje, as zë... shkretëtira, shkatërrirë!

* Sherif Ali Hajdar Pasha: guvernator i Mekës në kohën e Luftës së Parë Botërore, mik i poetit.



Rrjedh mirazhi endacak në horizontet monotonë
Si dhe përsëritja e tingujve të këmbanave që dallgëzon...

N'sa gjembishten ku qenë futur natën,
Devetë të bëra karvan janë kah e shkelin për të kaluar ditën,
Ç'përkulen e përdridhen gjer në padurim
Me ankthin e kuçedrës së rënë në zjarr!
Digjen duke zbritur tatëpjetë, digjen duke u ngjitur përpjetë!
Po ato hije njerëzore mbi shpinat e tyre,
Një grumbull që noton mbi dallgët e zjarrit,
Shkon, ajme, për të gjetur një tokë të jeshiltë!
A s'ke, o shkretëtirë gjidjegur, një skaj të amëshuar?
Ku është, o Zot, oazi i këtij vendi mirazhesh?
Ka që prej dy muajsh që një karvan i madh
Eshtë zhytur në thellësi të Nexhdit, si Mexhnuni
Frikacak dhe memec, që vrapon nga shkretëtira në shkretëtirë
Me shpresë ta shohë një ditë çadrën e Lejlasë!
As fuqi për të vazhduar, as vend për të ndaluar;
Një hije të ngrohtë, o Zot!.. Po s'qe as kjo,
S'mbetet shpresë për të arritur në bregun e synuar!

Sërish me të marrë hov një tufan flake,
A s'shfaqet papritmas Kubeja e Gjelbër* përballë?
Ç'statujë e hijshme ajo, ç'i bukur ballë!
Një mal i tillë që çdo pamje e tij e ekzaltuar
E sheh Krijuesin pa u përcëlluar!
Bota hyjnore e shqetësuar me t'ia parë agimin e amëshuar,
Me të rënë nën hijen e zgjatur, diejt të hutuar!
Sikur nga Sidre ka zbritur oaz për t'u derdhur hije
Shpirtrave të djegur nga kërkimi në shkretëtirë.
Ç'i bukur xhennet në atë luginë si xhehennem!
Edhe poezia më e bukur s'të rrok Ty, o i bukuri i amshuar?
Një varg i brishtë i bërë për ty nga kujtesa është
Që shpirti e dëgjon por s'e kap dot harmoninë e tij në ngjitje.

* Kubeja mbi varrin e profetit Muhammed (a.s.).

Nga Menaha-ja* po kalonim, ishte bërë iqindi.
 Me të më dalë përballë vendi i blertë i të Dashurit tim,
 M'u errën sytë, u hodha në tërheqjen e intimitetit të tij,
 E çava xhemaatin, rashë në fund të shtyllave.
 Pasi, më në fund, e groposa qenien time më një vend,
 Kujtova se u mbështolla pas mbulesës së frikës.
 Emocioni i thellë që ndjeva qëparë, ngadalë-ngadalë
 Më ngriu përbrenda dhe një drithmë m'u këput nga shpirti
 Duke ma rrëqethur çdo grimcë të krijimit tim.
 Një heshtje botërore në gjendje hijesh të ngrira
 Me radhët ngjyra-ngjyra vende-vende të fryra
 Ma drithëroi devocionin e tërhequr brenda vetes para meje!
 Po, ajo botë e stërmadhe... tuniziani, afgani,
 Boshnjaku, vendasi, kashgarlliu, buhariansi etiopiani,
 Transvalasi, kinezi, sudanasi, e gjithë trajta
 E Serendibit, Xhavasë, Magribit;
 Shkurt, krahët që hodhën bijtë e panumërim
 Të asaj familjeje fisnike, nga hapësira perëndimore,
 Duke u përsjellur, në skajin e hapësirës lindore,
 E la në kënaqësi këtë grumbullim plot hare!
 Ç'pamje që ishte, O Zot, ajo trazirë e pafjalë!
 Bota hyjnore u ekzaltua papritmas prej soditjes:
 la dhanë të pesta menjëherë minaret e djegura,
 Dallgëzuan oqeanin ku qenë groposur njerëz grumbuj-grumbuj
 Që e patën marrë në zemër Zotin,
 Bënë të rënkojë grumbullimi i qëparshëm, kujtoi Surin!
 N'sa ballet ktheheshin drejt qiellit me thirrjen e parë
 "Eshhedu en la ilahe il'lallah",
 U dëgjua i njëjti pohim edhe i 'Varrit të Pastër',
 Përsëritja e ardhur me anë të kumbimeve thellë-thellë.
 Gjithë ballët tani kah ajo jehonë qenë kthyer,
 Thirrjet e tij sundonin në tërë mjedisin tani.

* Një shesh i qytetit të Medines.



Me dëshminë e dytë i njëjti reflektim i zgjatur,
Nga faqja e dheut zëri prekës Zotin madhëroi në njësim.
Dëshmia e tretë u tha dhe i zu gjerësitë,
Kujtimi përjetësisht i zgjedhur i Muhammedit.
Ç'gurgulé qe ajo që u dallgëzua pas atij kujtimi!
S'e di i Dashuri si s'u ngrit nga gjumi!
A pak është që mjedisi i tij ka kaq kohë që rënkon?
Apo nuk zgjohet hiç gjer në ditë të ringjalljes?
Si e nxë kuptimi, përfytyrimi, o Zot,
Këtë rrjetë hekuri që e rrethon këtë shtrat,
Që ta ndjejë në tërë trupin sa një mal
Që s'lëviz nga vendi, tërë këtë vrull me drithërima
Dhe, ai i Dashuri i Amëshimit, me shpirtin e ndjeshëm
Të mos zgjohet me gjithë atë rënkim të grumbullimit?

Duke marrë vrull dhe ngritur në këmbë papritë
Minaretë me melodinë "La ilahe il'lallah" sërish,
U panë në tokë radhët të formuara para Zotit,
U përhap dimensioneve një rënkim pa zhurmë.
Para meje, Pejgamberi me bashkësinë e vet të shtypur,
Dhe unë, nga sytë, lotët si përrua, përbrenda, të dridhura,
As i zoti i zgjedhjes sime, as i nënshtruar zakonit tim,
I paqetë në mes të kësaj vorbulle robsh,
Si një copë anijeje rënë në hapësirat ujore
Sikur tani po del sipër, tani po bje në fund,
Zbret e zbret e fshihet tani atje tej në largësi,
Pastaj ngrihet dalëngadalë me dallgët që fryhen
E duket përsëri, kështu, pra, dhe unë,
Më në fund, rashë i zhytur në përmasën e paaftësisë!
U esëllova: kur ajo vorbull njerëzore e tmerrshme,
Ai vrull i shndërruar në heshtje, pret plot tmerr.
Me të zbritur truallit nga mahfili një i fundit rënkim,
U zbraz nga ato mijra gjokset "amin!"
Qafëpërkulur, me krahët hapur qiellit, symbyllur,

Ç'rënkon ajo bashkësi, ç'rënkon tani!
 Duart që e kanë mbushur hapësirën dhe e lusin Zotin,
 E kanë çarë gjysmerrësirën, një mbështetje dritësore kërkojnë!
 Këto gjuhë tjetër-tjetër, kjo rrapëllimë e pazë monotone
 Qenë një lutje Zotit dhe e njëjta lutje!
 Sigurisht, plaku serendibas që ka qëndruar para
 Ose i mjeri magribas i mbetur në radhët pas,
 Duke shkuar të përhumbur drejt qiellit mëshiror,
 Ç'mund të kërkojnë për këtë ose për atë botë
 Që të mos e kërkoj bashkë me ta dhe unë?
 Unë që jam vëlla me secilin syresh veç e veç.
 A mund të ketë ndarje për shpirtrat e shkrirë
 Me njëri-tjetrin qysh në ezel?
 A luan vendit ky unitet dhe sikur bota të shembet?
 Kur minberi, arshi dhe Zoti ynë të jenë një,
 Drita që pres unë, është dhe synimi i tij!

Dërgoje atë dritë, o Zot, shekuj u bënë, mjaft!
 Horizonti i popullit u turbullua, një mëngjes kërkon.
 Me favorin tënd shpëtoje që islami
 Të mos rropatet e zjejë mes errësirave dallgë-dallgë!
 Për zemrat që digjen rënë në këtë vend-sexhde,
 Për këtë grumbullim me të gjitha frymëmarrjet-klithmë,
 Për Qaben tënde intime, për Librin tënd të amëshuar,
 Për ajetet e tua të pallogaritura të botës sime,
 Për bashkësinë me fatin të caktuar dështim të paprerë,
 Për këtë thirrje mëshire të veshur dhé të pastër
 Të qeshin pak horizontet e botës islame!
 A s'ka kufi kjo dhimbje pa fund e pa mbarim?
 Ndërsa që fuqia e vetme sunduese në botë, ajo,
 Me një përmbysje, e humbi vendosmërinë
 Dhe e pranoi robërinë me të gjitha format e saj...
 Bijtë e saj u bënë të huaj në vend të vet!
 Atë vendosmëri ti do t'ia japësh që të përhapet



Gjak në fytyrat e zbehta, në zemrat që rënkojnë, jetë!
Jepi atë shpirt, o Zot, që feja jote të ngrihet në këmbë
Dhe të përhapë mbi tokë begatinë e jetës së shkuar...

Ende po lutem kur thirrja “Ja Resulallah!” duke bulëruar,
Një fantazmë e zezë u shfaq te hijet grumbuj-grumbuj
Që kishin shkelur dhe pushtuar pragjet,
Në vendin para “Portës së Paqes”* në skaj.
Britma madhështore tingëllonte ende në hapësirë
Kur u ngjit sërish dhe çau duke përshkuar njerëzit.
Me të rënë nën këmbë të Ravza-i Mutahhare,**
Iu mbështoll rrathëve të hekurt që i shpuan gjoksin.
Dhe para Profetit i zhytur në mendime thellë.

Thoshte duke rënkuar:

- O Profet, shih në ç'hall kam rënë!

Ashtu siç i digjet gjoksi shkretëtirës kur nxehet dita,
Edhe shpirtin tim e dogji mungesa jote!

Desha ta shihja i dëshiruar mjedisin tënd intim,
M'u shfaq i tendosur para për vite familja, vendi im.
“Duro!” - më thanë. Gjer kur?

Sado i gjerë të jetë durimi, edhe ai e ka një fund!

Në sy m'u përflak, me këtë kujtim, toka ku u dogja
Dhe para meje s'mbeti më as vatër e as oxhak...

Të gjitha u shembën... Kalova vendin e quajtur Sudan

Dhe tre muaj shkela shkretëtirën duke thënë “Tihame!”***

Ndoshta eshtrat do më qenë djegur në shkretëtirë

Sikur të mos më vije, o Muhammed, në ndihmë:

Fryma jote e freskët frynte duke notuar në rërë,

Zëri yt gjëmonte në çdo anë si ujvarë!

Ka ditë që vullneti m'i është nënshtruar vullnetit tënd,

Pushimi në rrugë dhe për një çast për mua u bë haram.

* Babu's-Selam, një prej portave të Xhamisë së Profetit në Medine.

** Hapësira ndërmjet varrit dhe minberit të Muhammedit (a.s.) në Xhaminë e Profetit.

*** Mekke

Me të gjitha përmendoret e krijimit bisedova,
 Netëve ua qava hallin, me malet fola!
 Nga padurimi, për muaj s'i mbylla sytë,
 Pyeti yjet, këta qerpikë a kanë parë gjumë?
 Ka pesëdhjetë e tre vjet që po e duroj
 Dhimbjen e largësisë prej teje...
 Ç'është kjo mbulesë mizore që më përplaset tani syve?
 Për zemrat e dala duke bërë të rënkojnë pesë-gjashtë gjokse,
 A humbje duhet, apo mëshirë?
 Ngrije mbulesën prej hekuri nga varri yt i dëlirë,
 Mos ma ndaj toka jote këtë shpirtin e sëmurë!
 Nuri yt, o i dërguar i Allahut, ç'është ai pishtar?...

.....
 Në heshtje një çast kaloi, pastaj një i shkurtër "ah!"...
 Oh, ç'pashë! Sudanezin të shtrirë për tokë...
 Mbi krye, një cejlonez të mjerë duke qarë,
 Ia puth e ia mbyll me duar sytë.

Me të mbaruar larja e qefinosja,
 Trupi i vdekshëm i dëshmorit shkoi në "Bakí";*
 Por në Harem mbeti shpirti i përjetshëm i tij!**

* Bakí: varrezat e Medines.

** Bëhet fjalë për Xhaminë e Profetit në Medine.



Libri i gjashtë

ASIMI



Mikut tim, Fuad Shemsi



Kjo vepër është një bisedë e zhvilluar në shtëpinë e Hoxhazadesë në Sarëgyzel gjatë Luftës së Parë Botërore para zjarrit të Fatihut.

Personat që marrin pjesë në bisedë, janë:

HOXHAZADE - biri i të ndjerit hoxhë (mësues) Tahir Efendi

IMAMI QOSE - një nxënës i të ndjerit hoxhë (mësues) Tahir Efendi

ASIMI - biri i Imamit Qose

EMINI - biri i Hoxhazadesë

- O, hoxhë, mësuesi im! O dritë e syve të mi, zotni, bujrum!
 Ç'erë ju hodhi këtej ju? Ju lutem, uluni!
 Na pati marrë malli për ju, zotni, ç'mirësi, ç'fisnikëri!
 S'jua putha dorën, më falni...

- Rrofsh... Por... Nuk mund të ta jap.

- A s'bën sikur duart tuaja që shëtisin në buzë të të gjithë Stambollit,
 Të mos na bëjnë naze neve? Jepnaini!

- Më munde me fjalë, ti fjalëshumë!
 Të mos e kërkosh Qosen një herë në muaj? Qoftë edhe një herë?
 Pyet njeriu, ky burrë ç'u bë, ka vdekur apo është gjallë!
 Nëse më ke mik të babait, do të pyesje për mua.
 Apo kur plaket njeriu s'pyet më kush për të!
 Në ç'ditë arritëm, aman, o Zot, aman!
 Gjëja që i thonë "brezi i sotëm", një gjë shumë e çuditshme;
 Shih të ndjerin hoxhë e shih të birin, po deshe!

- Ama ç'e shan keq tjetrin, që në fjalët e para...
 Jep një herë selam, pastaj... Kështu, pa dhënë selam?
 - Selamun alejkum!
 - Alejkum selam!..

U pajtuam, të qeshtë fytyra, imam!

- Prit, prit, ta plotësojmë zemërimin...
 - Plotësoje!

Zaten ajo pati mbetur mangut, e rrahura: Druri ka dalë nga xhenneti...
 - Po të të rrah, ç'bën ti? Unë jam mësues, mësuesi edhe të rreh..
 Ku të godasim ne, mbin trëndafil se godasim me dashuri...
 - U binda, është e lejuar!..

- Si shumë e dobët doli kjo "e lejuar", domethënë s'ke besim!
 - Në pastë hyrë druri në "amentu", jam i ngirë sa s'bën.
 Jo trëndafil, por nën të rrahurën as qime nuk mbin!
 - Jo more!

- Po të ish ashtu, kjo kokë e trashë që ke përballë,
 Nuk do të dallohej nga trëndafilishtet në Këzanllëk!
 Dhe nuk e kuptoj se pse kjo punë dajaku me barkun thatë!
 Prit të kullojmë çaj, nargjilja të na vijë, bëhu zemërgjerë!



- Thuaj të vijë, eja, edhe në e paç vështirë...
- Mos qoftë e thënë, e kam dëshirë!
- A ke burnot?
- Natyrisht.
- A tërhiqet thellë?
- Për të gënjyer hundët, mjafton.
- Ky ç'është, gjerman?
- I përzjerë.
- Nejse, në këtë kohë të vështirë do të shkojë mirë.
- Hoxhazade, pa të të shohim, hiq dhe nga ky i yni.
- Po sikur të them se i ngjet prodhimit të vendit?
- Vetë ai.
- Ti nuk je as tirjaqi, por merr vesh mirë.
- Të ishte yt atë e të të shihte, do të kishe punë.
- Për çfarë?
- Për gjënë e pistë që heq.
- S'e donte, po, një gjë të tillë.
- Ç'ishte te i ndjeri ajo pastërtil..
- Sikur t'i kish ngjarë pak dhe i biri...
- Si?
- Ç'kam më pak se im atë, ma trego, të të shoh!
- Por, po të nxehesh, s'ngatërrohem me ty!
- Por po të duash përgjigje të drejtë si qiri,
- As sa thoi i tyt eti s'mund të bëhesh ti!
- Ç'thënie me politesë! Çfarë qiriri, krejt si dru!
- Pse pranove nëse do të nxehesh kështu?
- Pranova, por një e drejtë e tillë është krejt pa shije...
- "Selamun alejkum, qorr kadi!"
- Më the "fjalëshumë", s'të mjaftoi; më shave,
- Prapë t'u duk pak...
- Nuk të thashë, më detyrove.
- Ja fillove tani nga fyerjet... A nuk nxehet njeriu, o mësues?
- Mos u bëj snob!
- Çfarë? Snob jam unë?

- Mjaft!

- Në të vërtetë, të dua shumë; ç'të thuash, nuk më prek; Megjithatë, kjo s'hahet; mbaj vendin, imam!

- Mbaj vendin edhe ti!

- Ama u nxeval!

- Sa i çuditshëm je:

Nxehesh për një fjalë!

- Kujt i thonë snob?

- Ty.

- Pse?

- Edhe pse s'i ngjave tët et.

Dhe, pse s'i ngjave, mos më pyet!

Ç'është ky tërbim, ç'është kjo arrogancë! Përpiqu e i ngjaj!

Koha që i pati ndarë yt atë diturisë: pesëdhjetë vjet!

- Edhe ne nuk u përpoqëm pak në rrugë të diturisë...

- S'të thamë ty injorant,

Vetëm snob... Shih, përsëri na vështrove drejt e me inat!

Ku qe rritur i ndjeri mësuesi ynë, pa mendo!

Biri i kujt qe ati yt? A e harrove, kush qe gjyshi yt?

Fshatar nga Peja, analfabet, njeri gjysmë i egër...

- Të paktën thuaj kanibal! Ç'të pengon, po, kanibal i bardhë!

- Dëgjo, biri im...

- Ç'delicatesë kjo, mësues? Të kam zili!

- Ma le fjalën në gojë, i vogli im, prit o shpirt...

- Të të kisha lënë ta mbaroje fjalën, gjyshi im kish shkuar...

Mezi arrita ta shpëtoj !

- Si, mos u bëmë çakej tani?

- Nejse, vazhdoje fjalën, të shohim...

- Ja, pra, yt atë

Nuk mësoi gjë nga ai baba injorant.

Ç'të ketë fituar, të gjitha vetë i ka fituar, vetë.

Mirëpo zotëria juaj rrëmoi sa andej, këtej.

Ti faliu trashëgimit që mblodhe prej tët et.

Gjithë përpjekja e tij është në ke tre rrjeshta dituri.



- Tre rrjeshta, o Zot, dhe ç'kulturë e pafund!
- Treqind le të themi në ta mban koka!
Për t'u ngjitur në lartësinë e mësuesit male duhet kaluar!
- Po u ngjita?
- Eja, ngjitu, të të shohim, ja muri.
- Ke për ta parë!
- A me këto shalë?
 - Po, po!
 - Duket që në të parë!
Sa vjeç kishit, pashai im, pesëdhjetë?
 - S'bëhen pesëdhjetë.
- Por i keni kapërcyer dyzetë!
 - I bëmë dyzet e gjashtë.
 - Shumë mirë...
- Por edhe në i arrifsh njëqind, "i njëjti gur, i njëjti hamam" përsëri.
Po s'pati thellësi jeta, në është e gjatë, ç'ka rëndësi?
Ç'ke në dorë nga prodhimi i dyzet e gjashtë viteve?
Në ç'fushë teknike, o bir, u lartësove?
Trego, në ç'degë të artit bie në sy dija jote e thellë?
- Je nga ulemaja, apo nga juristët islamikë?
 - Jo!
- Politikan je, apo ç'farë? Veço për vete një profesion.
- Jam poet!
 - Më mirë të mos kishe qenë! Turp e për faqe të zezë!
Për mua, poeti, më maskarai i të papunëve në botë!
- Fale atë!
 - S'kam mundësi! Ç'domethënë?
- A duhet t'i përkushtoheshe poezisë, o bir, si profesion?
Ah, sikur në kohën e duhur të vije për t'u këshilluar me Qosen tënd!
Ndoshta tani do të qenë të tuat ato dyzet e gjashtë vjet!
- Ama shumë e godite poezinë...
- Po, e godita,
Sepse s'jam gomar; edhe unë ngjeva në bojë,

Këndova histori, botën e njoh pak a shumë.
 Sa të thuhet “poetët”, menjëherë më hipin nervat.
 Miq të ditëve të mira, ç’bashkëpunëtorë të ndyrë,
 Ç’njerëz të pështirë! Dhe qënka jo mirë për t’i parë!
 I gjithë kapitali i tyre, edukatë e marrë për dallkaukëri...
 Poetët e tërbuan parësinë e pafisme.
 Duke u dhënë poetëve pará për t’i lavdëruar,
 Lexo historinë e shih se ç’persona të ulët janë fisnikëruar!
 Ata e futën në letërsi paturpësinë;
 Nën mbulesën e fesë kjo kundërvënie s’ekzistonte;
 Ia vunë para turkut mushtin e rrushit si tesavvuf,
 Tani vazhdimisht “të vërtetë” vjell daja Sidki!
 Kjo botë është e kotë, vetëm një të vërtetë ka: verë, raki;
 Kibljaja, banaku; mejhanexhiu, mihrab!
 Shko e hape atë poezi divani, të turbullohet barku
 E merri erë: era parfum vjen atje në Sandëkburnu!*

- Plotësoje,

Vetëm mos shaj shumë se Pejgamberi ynë e donte poezinë!
 - Vërtet, “inne mine’sh-shi’iri...”** e madhe dhunti;
 Vëreje me kujdes: dashuri, por dhe urtësi!
 Unë i lexoj dhe i dua Attarin, Sadiun,
 Vetëm ata që kanë zënë rrugë tjetër, i shaj.
 Eshtë pa vend që ti të ngrihesh për ta mbrojtur poezinë;
 Vetëm ti e konsideron veten poet,
 Se dikush thotë për ty këndues mevludesh...

- Ah sikur të isha!

S’arrihet gjyshi Sulejman në ato lartësi!

- Dikush thotë për ty bidatçi...

Këto janë që më kanë rënë në vesh.

- A s’ka të tjera, imam?

- Ka, ka, po paskam harruar: veteriner.

* Zonë e Jenikapësë e njohur për pijetore të vjetra.

** Aludon në hadithin “Vërtet nga poezia ka vargje plot urtësi, kurse në retorikë gjen shprehje magjepsëse.” (Buhari, Edeb, 90)



- Eh, sikur ta bëja veteriner...

- Megjithatë, po munde, bëje.

- S'mund ta bëj.

- Ndoshta e bëje, bre...

- E harrova, bre Qose!

- Sikur të të kish mbetur ndërmend, sa nevojë ka;

A po më dëgjon mua, bir, prapë, po munde, puno,

Sepse, po të fitosh përvojë, edhe mendja jote fle;

Neve na duhet më shumë veteriner se doktor për njeri.

- Hiqe një herë këtu!

- Edhe ti hiqe nga kjo e jona!

- More, po çaji s'na erdhi!

- O, e harruam, me të vërtetë.

- Ku është Emini? Bëji zë Eminin, mos shko vetë!

- Emin, ku je?

Pa shih, do të na kishin kulluar çaj qëpari...

- Kanë kulluar, baba.

- Po eja, o bir, këtu...

Harrove që duhet puthur dorë?

- Jo!

- Po si?

- Ia putha, baba, më parë...

- Nëse ia ke puthur, shko!

Hej, Zot, shyqyr, na erdhi, më në fund, edhe çaji.

Po të duash sheqer, të të gjejmë!

- Katërqind?

- S'kam marrë hiç, të rrojë rrushi i mirë i Izmirit;

Edhe i lirë, edhe më i shijshëm.

- Dhe pa fara.

- Urdhëro, merr.

- Fillo, xhanëm, a ka ceremoni te ne?
 - Mësues, në fillim përtypet rrush, sipër, çaj...
 Le të pijmë për hir të miqve të Zotit!
 - Me gjithë dëshirë!

* * *

- Hoxhë, parashikojë, ta shohim, tani, fundin e kësaj lufte.
 - Allahu e di atë, por a do të ketë fund?
 - Ç'domethënë? Mos do të vazhdojë pa mbarim?
 Sigurisht që mbaron, mjafton që njëra nga dy anët të thotë "mjaft!"
 - Dhe nëse s'ma merr mendja, o bir, që kjo punë të marrë fund,
 Duhet njëra prej këtyre të dyjave...
 - Ç'është ajo?

- Pa dëgjo:

Anglezi, ai hain, ose duhet të ngopet e të pëlcasë,
 Ose të mbetet pa ngrënë... Ndryshe, falli ynë del i zënë.
 Mos i hap, tani, ti, o bir, ato fletë, pyetmë mua:
 Halli ynë, i madh, shpëtim nuk ka... Dhe në pastë, vështirë.
 - S'ka hall pa shpëtim, o mësues, më thuaj, po të dëgjoj!
 - S'është një...
 - Zëre se janë bërë një mijë, ç'të bëj, jam i detyruar.
 Shërbimi për ty është mëshirë për shpirtin e tim eti, o ti!
 - Hoxhazade, o biri i mësuesit tim, të gjitha i di,
 Rrofsh. Në fillim a çështjen e djalit ta hap? Mirëpo,
 Ta hapim këtë kur është halli i komshiut, a s'është e shëmtuar kjo?
 - Si e ka hallin djali? Më thuaj! desha ta di...
 Lëre të rrijë, në fillim të të tregoj këtë:

Ka katër-pesë vjet që një pasha në pension
 Erdhi gjer në viset tona s'e di që nga!
 Kujtdo që kishte për të shitur ndonjë mall për lirë
 la rrëmbeu dhe për pak pará bëri tetë shtëpi e katër parcela.
 Në fillim burri i botës s'i bënte kujt keq,
 Por kohët e fundit s'dihet pse namazin e la;



S'dukej më as në xhemat, as në xhami komshiu pasha!

- Gjë e zakonshme, fetaria e tij s'ia doli dot në krye.

- Ndërkaq, nisi të hollohej, të rinohej...

Aman!

- As aman dëgjoi, hovardai im, me kohë, as kohë!

Mjekra dhe flokët i zunë, se pse, një ngjyrë për çudi,

Mustaqet u ngjyen, dy pëllëmbë, në një vijë!

Me sapune grash, fytyra e lëmuar çdo ditë;

Festja e rrëzuar, tulla e zbuluar, vetulla e harkuar, syri i kulluar;

Me gjilpëra, tufëza, medaljone, qafore, kërpeshe... çdo gjë e plotësuar,

Si të ish djalosh i pashëm, i turbulluari!

- A dhe ti ke qenë poet, imam?

- U vura në dyshim për pashanë, i shkova zonjës në fshehtësi

E i thashë: "Mbulohu, ime bijë, e më eja pranë".

Më duket se sjelljet e tët shoqi po marrin për prapë!

Unë s'e di se ç'thua ti, por, po më pyete mua,

Shih ç'po të them: - A keni kush ju gatuan, kush ju shërben?

- Po!

- Kush?

- Vajza Elenë!

- Hiqe tani!

- Pa asnjë shkak?

- Moj vajzë, në më ndjen,

Në këto punë s'kërkohet shkak, urtësi!

Menjëherë duhet larguar, ndryshe ju mbuloi turpi!

Pashai qenka tërbuar!

- Mos vallë një tjetër trëndafili i merr erë?

- Atë s'e di, erë i merr, a e prek me dorë!

Mos më bëj të flas, moj bijë, po shko e përzeje vajzën menjëherë!

* * *

S'kaloi shumë kohë dhe pashë që palaçoja ynë

Na vjen dhe kërkon t'i shkruajmë një certifikatë! Çfarë?

Një leje për martesë!

Leje për martesë? Duhet kjo, posi!

Kush do martohet, djemtë, apo vajza, o pasha?

- S'është koha për ta!

- Po kush, pra?

- Unë!

- Ti? Rrofsh!

Mu në kohë je! Por shpejt, s'ke pse e zgjat!

- Hoxhë, mos u tall, shkruama shpejt, ja ku i ke paratë!

- A, mos vallë kaq shumë vleka ajo letra e jote e fëlliqur

Që kujton se më tut me një a dy?

Të gjitha paratë që ke, mblidhi, bëji turrë e futi në xhep!

S'ta shkruaj, mos u përpiq më kot!

- Sigurisht që do ta shkruash, ç'të duhet ty?

- More, po si nuk e sheh veten burri! Të ketë pak maturi!

- Shumë mirë jam! Ç'kam? Faqen, të bardhë, ballin, të larë!..

Pa më shih pak një herë dhe ti!

- Jo, shihe vetë vetveten ti:

Kokën, tullë, mjekra e thinjur gjer në rrënjë!

- Ama dhe ti po sillesh keq! Me mjekrën time ç'punë ke?

- Ç'punë? Njerëzit dëfrehen falas me ty, a s'sheh?

Në treg tallet me ty bakalli, në kafene, gjithë ata vetë;

Mos e bëj veten të të qeshin nga pas, o i shkretë!

Dhe sikur të plasësh, nga banakierja greke s'del bashkëshorte për ty!

- Pa më thuaj, kush të ka treguar?

- Ama, sa i trashë që je!

Kush më ka treguar? A duhet të më pyesësh mua?

Qorri i ka parë, shurdhi i ka dëgjuar budallallëqet e tua!

Mjafton të të shohë tjetri pamjen dhe e kupton menjëherë...

- Mjaft me kaq, imam, mos ma nxeh kryet, shkruaj!

- Dëgjomë mua: asnjë imam s'shkruan dot një turp të tillë!

- Bobo, i thotë sunnetit turp, pa le!

- Sunneti?



- Po çfarë?

- S'ekziston një gjë e tillë...

- Ç'do të thuash?

- Dëgjomë, o i marrë!

Nuk mund të thuash sunnet për t'u martuar çdo herë;

Vjen koha e për burrin bëhet detyrim...*

- Tamam, doli ç'thashë unë!

- Kurse vjen një kohë që bëhet, si në rastin tënd, haram.**

- Nga askush s'e paskam dëgjuar një fetva*** të tillë...

Sa çudi!

- Çudia është tek ti!

Preje davanë se ke fëmijë!

Gruan të ndershme, vetë gjashtëdhjetë e pesë, urtësoju tani!

Ç'të mungon, bre burrë, ç'ke që lot nga trutë?

A shembet për një femër një oxhak shumëvjeçar?

- Ç'fjalë është kjo? S'po martohem për të shembur oxhak!

- Pse, a s'mund të ndodhë që ajo greke

Që ka shëtitur shtatëdhjetë dyer, ndërsa tani është banakiere,

Pasi të t'i ketë marrë mendtë ty, t'i thotë vetes zonjë

E të nisë të bëjë naze?

Gruaja e dredh, zotëriu pasha lakuriq për merak;

Ajo, me të vërtetë e paturpshme; ai, me plot fjalën sallak!

Madama bën naze, ikin një nga një shtëpitë,

Në ranishte luajnë fëmijë...

- Ç'të duhet ty, o njeri?

M'u bëre avokat! S'ke të drejtë të përzihesh në çdo gjë, llafazan!

- Zhduku që aty!

- Eja, shkruama shkresën!

- S'ta shkruaj, bre, hiqmu tej!

- Do ta shkruash!

- Shembu që aty, s'ka për ty çertifikatë

* Në origjinal: vaxhib, domodoshmëri fetare.

** Haram: ndalim fetar.

*** Fetva: konkluzion dhe vendim fetar.

Edhe sikur të më urdhërojë në ëndërr ai Pejgamber!
 - Mos shkruaj gjashtëdhjetë vjeç, bëj ç'ke mundësi;
 E dëgjon pas shtatë ditësh: u bë zonjë Eleni!

* * *

- O biri i tim hoxhe, më në fund, a e di se
 I doli fjala burrit dhe më përqeshi mua? Qejfin si ma ke!
 - Kush e kish lidhur kurorë?

- Të zgjuar kërkon? Plot...

Vetëm rrugën e parasë tregoju, s'të kthejnë prapë!
 Por lëre atë, tani plasi belaja e vërtetë:
 Mora vesh, ajo femra e ka bindur atë trutharë,
 Të gjithë pasurinë ka për t'ia marrë!

- Me të vërtetë e ke?

- Po!

Mendo një shpëtim për këtë, të mos ikin shtëpitë, ndihmo!
 Ç'do të bëjnë pastaj fëmijët?

- Mos më keq! Po zonja?

- Edhe ajo, më e padjallëzuar se nëna ime, rahmet pastë, o shpirt!
 I fola e i fola, s'ma vari fare, indiferente pa kufi!
 Kurse ajo dreqja e mallkuar, sa e djallëzuar!
 Burri, po, gomar! Zoti dëshmitar që është gomar:
 Me gojën më të lirë se nyja e uçkurit në brekë!
 Sikur dy fjalë të thotë ajo lavirja që përdridhet,
 Atij nisin t'i rrjedhin jargët çurg e ia jep ç'të ketë!

Mbrëmë pas namazit e shoqja erdhi te ne...
 Ish turbulluar e gjora në rrugë, kish hyrë në baltë;
 T'ia shihje rrobat, ç'pamje e hidhur, o shpirt!
 Vetë qante, vajzat qanin... S'di ç'të të them.
 Më qau zemra, po ç'dobi?
 Lojë e fatit, i bëhem kurban atij që na jep një ndihmë!
 Njerëzit e pashqetësuar e paskan jetën si dëfrim;
 Po pate zemër të ndjeshme, e pëson, shih ç'fat!



Tani, o bir, ka vetëm një mundësi:

T'i ndalohej burrit ta përdorë mallin e tij!

- E lehtë!

- Sikur ta cilësonim "i papërgjegjësi"?

- Ta cilësosh, posi!

Po qe se një njeri e humb pasurinë duke e dhënë

Dhe duke e shpenzuar pa kufi,

Juristët islamë e quajnë "person mendjelehtë"!

Edhe personat kokëtrashë e naivë që, me iluzionin për të fituar,

Nisen të blejnë e të shesin e gënjehen,

Po, "të papërgjegjshëm" i cilëson sheriati i lartë!

Le të vijmë në zgjidhjen e problemit tonë: meqë ky njeri

E shpenzon më kot tërë pasurinë pas një femre të fëlliqur

Duke braktisur gruan e fëmijët që ka nën përgjegjësi,

Sigurisht, është ose mendjeturbull,

Ose një viktimë e përshtatshme shumë për t'u mashtruar,

Prandaj, gjykatësi mund t'ia ndalojë ta përdorë pasurinë!

Tani juve ju duhet vetëm një çertifikatë.

Mblidhuni të gjithë: kryepleqësia, kryeplaku i lagjes

Dhe shkruani shpejt e shpejt me hollësi

Dhe ia dërgoni gjykatës pa humbur kohë!

- Puna është me rëndësi.. Kam frikë se mos...

A s'po e shkruan, o bir, më mirë ti?

- E shohim, po prit pak...

Më e mira: Ti shkruaj, unë të flas!

Të takon ty ta rregullosh siç duhet për një imam!

Eja, bëj një Besmele e, po të duash, ia fillojmë!

Por... vëri syzet më parë!

- Po, po, po i vë,

Kurse ti më jep një copë letër...

- Po bojë, penë, të gjinden?

- Pa tjetër!

- Ja dhe letër!

Në fillim hedhin një “Hu”* në krye, apo jo! Hidhe!
 Fillo: “Kjo çertifikatë...”
 - Po, “jepet për...”
 “Në mëhallën tonë...”, shkruaje shpejt!
 - Prit, të mos e ngatërroj!
 - “Në filan sokak...”
 - Fol ngadalë, ... u bë.
 “Që ndodhet...”
 “Filani i biri i filanit që rri në filan shtëpi...”
 Mos u mendo! “Sado që..”
 - Vazhdoje ti...
 - “S’e kanë lënë trutë”
 - Në rregull!
 - Po m’u thye pena, bre! Ptu!
 - Merre penën tjetër, s’kemi as gdhendëse e as çaki.
 “Që ka për të ushqyer...” A e mbarove?
 - Thuaj!
 “E për të cilët
 Duhet të kujdeset vetëm vetë,,,” Vazhdo! “Që janë shumë
 Vetë...”
 - Po, prit pak...
 “Një familje...”
 - Mirë.
 - “Të gjithë mallin e pasurinë...”
 - Qëndro!
 - U lodhe, sado!..
 - Nuk u lodha, or ti...
 - “Që zotëron...”
 - Mos rri tani!
 “Kërkon t’ia kalojë sipër vajzës
 Të quajtur “filan” nga popullsia greke që e mori tani vonë...”
 - Jo “e mori”, por “që e lidhi me kurorë...”

* Hu: Ai, Allahu; në emër të Allahut!



-“Dhe, në këtë mënyrë, t’i lërë të mëdhenj e të vegjël
Të vdesin në nevojë!..”

- Shumë mirë!

Dhe tani lidhe e jepi fund!

“U përgatit nga mëhalla jonë kjo deklaratë

Se i duhet ndaluar personit të lartpërmendur

Ta përdorë pasurinë e tij

Dhe iu paraqit të lartës gjykatë!”

- Të lumtë, o bir, imami kështu shkruan!

- Atë s’e di, por di se këtë me hir a me pahir e mbaruam!

- A thua do ta shohin me vend t’ia ndalojnë?

- Ej...

Eshtë një gjë që i ka mbetur

Mendimit dhe ndërgjegjes së gjykatësit.

Edhe ti shihe veten një herë.

- Po, o bir,

Ta shoh... Se çfarë të bëj tjetër, s’e di,

Mbarova, s’e di ti se sa kam mbaruar...

Ah, sikur ta shihja të shembesha e të ikja nga kjo botë!

Ç’trup si trá që s’di të ngordhë!

Pse ma dhe, o Zot, si shëndet këtë gërmadhë?

S’e dua, le ta marrë kjo tokë!

- Ç’thua kështu? Pa shiko!

- Lërmë, o bir, ta derdhë pak të keqen ky trutharë!

Për mua në botë s’mbeti as vend, besoje, as të dashur,

Kërkoj të tjera vise, të tjera vende për të ikur!

Shpirti im i turbulluar kërkon, tashmë, të dalë

Për në atë udhëtimin e gjatë; ditët e kota pse duhen jetuar?

Nuk ka për mua një fytyrë të qeshur ta shoh e të gëzoj;

U bëra ditën prej natës më të mos e dalloj!

Ka vite që nuk di ditë të mos jem dërrmuar;

Shëtis si në atë teatrin popullor i shastitur e i hutuar.

Më ngulet përballë gjithë një gjë që s’e kam parë, që s’e di;

E pyes: a në kurbet jam, apo në habi?

I hetoj gurët, dherat: gjurmët, gjurmë gjaku;
 Deti i murrëtyer i shtrirë i vendit tim, vjell gjak!
 Katër-pesë oxhakë në të rrallë kanë mbetur që tymojnë...
 Sikur të dalloja një fole të njohur, duke thënë...
 Duke vështruar, ndjej sytë që më digjen,
 Ma mbështjellin horizontin mijra grumbuj hiri të nxehtë.
 As ata përrenjtë e qielltë janë, as ato male të smeraldtë,
 As ato të mbjella të tërbuara, as ato vreshta të harlisura.
 Tani nën ditën përvëluese dremisin, presin
 Vetëm shkëmbenjtë e ashpër, vetëm shkretëtirat e heshtura.
 Oxhakët e djeshëm të gëzuar, të hareshëm të turkut
 Me vendin të kthyer në gërmadhë fund e krye, sot shtrihen përdhe.
 Dhe sikur të bërtasë si bufi me zë të mprehtë,
 Udhëtari s'dëgjon zë njeriu ditën, natën një dritë.
 Ti pyet: "Ku janë të zotët e këtij vendi?"
 Xhindët, "Ku janë të zotët" thonë nga mali përballë tani!
 Ku janë çadrat nomade që Ertugrullin e rritën në prehër?
 Po etërit trupmëdhenj si Osmani, si Orhani?
 Po një Sulejman Pasha me famë, i përgjakuri Selim?
 Ah, qoftë dhe një Jëlldërëm nuk sheh dot, sa hidhërim!
 Ku janë kalorësit që ndjekin kapronj si skifterë,
 Fushat e gjera të blerta në dallgëzim, në shpërthim?
 Ku fshatrat me tokë të pasur që rritnin heronj,
 Që, në ua pyetsh historinë, ngjarje heroike tregojnë?
 Ku janë shigjetat që shponin horizontet si pyej,
 Ku janë pelat që e gërryenin shkretëtirën si kuaj?
 Ku janë vajzat si hënë që loznin e vraponin?
 Ku janë miliona trimat si copë mali?
 Asnjëri prej këtyre s'janë sot; gjithë gënjeshtër, gjithë përrallë!
 Një plagë e pashëruar është, në zemra në pastë mbetur vallë!

* * *

Ç'pyet, në Kartall isha unë këtë të mërkurë.
 Më thanë: "Në fshatin Kurna bëhet dasmë që dje;



Po të të pëlqejë, eja!” “Pse jo? Shumë mirë, shkojmë dhe ne;
Edhe shohim pak pllajë, edhe shkojmë në mundje!”
Eh, sikur të thosha se nuk vi... O Zot, ç’hall i zi;
Ç’tubim maskara qe ai që s’mund ta përshkruajë!
Rreth dyzet fshatarë qenë shtrirë në rrëpirë,
Shihnin nën të mbjellat livadhin pa bar.
Të gjithë me fytyrat të verdha, të mjerë,
Eh, sikur të shihja njeri të fortë e të gjallë!
Si fëmijë me barqe të fryrë, me krahët të varur,
Shpina, gungë, gjoksi, i rënë, supet, të ngritur.
Ngjyra e syve, e turbullt, kapakët, të fryrë;
Fytyra e rrudhur e zgjatur, balli i ngushtuar.
Në vend që të shëtisin, ato shikime zhyten,
Sapo të zgjaten e bien mbi një pikë, zor se ngrihen!
I është përkulur qafa atij turku me trupin të drejtë,
Rri e mendohet si jetim, i zemëruar vërtetë.
Trungu i është bërë kadvrë, këmbët si purtekë,
I dridhen duar e këmbë, ende njëzet vjeç!
Eshtë shumë gabim të kërkosh burra në të tetëdhjetat,
Për të, stacion i fundit, vjeç dyzetë!
Nipi i asaj race luanësh,
Kurse unë thosha se elementi musliman i ri e i shëndoshë,
Po të më pyesnin mua, as shekujt nuk e bëjnë plak;
Mirëpo sa shpejt do ta lënkëshin atë këmb’ e dorë!..

Gjithsesi, dhe rendmbajtësi erdhi e urdhëroi:
“Hiquni, të hapet sheshi” Daullja me zërin e grisur filloi.
“Bum-bum” të gjëmojë? Ç’ne! Kasnaku është bërë tëknefes!
Gjoksi godet mbytur e mbytur si tokmak!
Zurnaja çirret s’ia thotë dot njëfarësoj;
Ngjyra e evgjinit që i bie, varr, ai vetë ka vdekur!
Dielli qe nxehur mjaft, e nxehta më pati lodhur,
Të gjej një hije, thashë, e i mbatha shpejt.
Sapo mendova të mbështetem ca e të pushoj,

Dikush m'u kollit mu në zverk... Çudi, kush të jetë?
 Ç'të shoh: një cjan i moshuar, nga sëmundja e fluturës ngrënë,
 Merr frymë me vështirësi e më spërkat në shpinë..
 "Ama shih, dhe në s'më ardh të në mendje respekt,
 Kaq shumë afërsi s'e pëlqej, kushdo që të jetë!
 Ta këputa mjekrën pastaj, mos thuaj... Ik!"
 Ku e ke! S'ma vari... Pyeta, kryedekorata qenka ky trim!
 Pa kalo, trimi im, të të shohim, tjetër ç'ka?
 Një shkop të dobët, në qafë, astar tre arshin.

Po mundësit pehlivanë? Pa e mbaruar unë fjalën, o mësues,
 A s'dalin tetë burra lakuriq, njëri më i mjerë se tjetri!
 Dhe në ëndërr t'i shihje lakuriq, të vinte frikë,
 Se dhe nga mishi qenë zhveshur si nga një këmishë!
 Në vend të pantallonave meshini,
 Në një torbë të shpuar kish hyrë njëri;
 Një tjetër u kish hequr gjunjëve një thes të vjetër.
 Dikush çakshir kish veshur, dikush shallvare bezeje,
 Dikush kish brekë me ushkurin varur në qafë.
 Vallë a do të lyhen me vaj? Mirë, po ku ka vaj?
 Pastë bereqet, burimi i tij qenka në lumë:
 Burra, gra me nga një shkop me krye të shpuar
 Mbështetur në sup të djathtë, bartin ujë kova-kova.
 Pastaj se nga erdhi një zë që thirri: "Ejani, lyhuni tani!"
 Dhe u hodhën mbi enët të gjithë ç'ndodheshin në shesh;
 Si bibat, u zhytën pëllëmbët në ujë
 Dhe u njomën lëkurat e rudhura si të njomej meshin.
 U tha se do të niste mundja, pasi të mbyllej kjo ceremoni.
 Më në fund, dolën dy çifte duke u rropatur me njëri-tjetrin.
 A nuk u zbraz djersë, thua ti, nga ballet qysh në rrokjen e parë?
 A nuk shfrynë ato gjokse, thua ti, si kaceku që fryn zjarr?
 Dhe pashë: Nën ato çifte gjoksesh të bëra trokë
 Ngrihen e ulen çifte barqesh njerëzish asmatikë!
 Pastaj gjunjët i zuri një e dridhur e fortë,



Dhe, pa u zgjatur shumë, u shtrinë që të katër në tokë pa jetë!
Ndërsa dy të mjerët shtriheshin përdhe,
“Ngrihuni” - u thanë; po atë fuqi ku e ke!
Një mundje e tillë ish një gjë që kurrë s’e kisha parë;
Të fortë e të dobët, të gjithë si këta, të pajetë e të hutuar!

* * *

Atje përballë, me njërën rrotë më të vogël, një qerre e anuar
Me gjysmën e tendës rrogoz, gjysmën shajak,
Duke shkuar sipas ecjes së dy qeve të mërzitur,
Njëri pak më i madh se cjapi i vendit, tjetri, më i vogël se ai maltez,
Ç’vaje e bëjnë të vajtojë boshtin e drobitur!
E pashë këtë dhe m’u dhimbs nusja në shpirt;
Le të të shohë fati yt ty, moj bijë, e t’i vijë turp!
Ç’të them? N’sa engjëjt i hapnin prehrin shpirtit të sat gjysheje
Që s’e di kush ishte e ku prehet sot,
Tabuti që mbulonte me mëshirë kufomën e saj e pastër
Ishte më i mrekullueshëm se kjo qerre nuseje!
Si ëndërr kaluan, Allahu im, ç’qenë ato ditë!
Në këto djerrina që qenë të gjitha vreshtë dikur,
Shpërthente një bereqet që dëgjohej në tërë këtë botë!
Po kjo luginë e shtrirë tani lakuriq e drobitur,
A ndodhte të pasqyrohej, kështu, në qiell, e mjegullt?
Tani flakë u shfryn horizonteve çdo e çarë e saj,
Si buzë të sëmuri e çarë toka andej-këndej.
- Mos e lëngo, o bir, se është plagë, plagë zemre...
- Ç’ishte, o Zot, ky vend, tridhjetë-dyzet vjet më parë?
Malet, me pyje, majat, me vreshta, fushat gjithë me të mbjella;
Gjithajo kullotë mbushur plot skaj më skaj me të mjela.
Ta hidhje gjilpërën, s’binte poshtë, të lashtat aq të ngjeshura,
Të hyje brenda me kalë, të mbetej koka nën grurë!
Ndërsa hapeshin dhentë e dhitë e fshatarit livadheve,
S’e dalloje dot horizontin nga dallgët e leshrave!

Vërtiten si trape nëpër gjole buaj pa numërim;
 Për elefant e kujton nëse e sheh në tokë!
 Mijra që i çajnë barërat me ballin e gjerë,
 Nga kullota e mirë, me shpinën të drejtë!
 Ç'vezullim violet në hundën e lagësht të deles;
 Le të vijë, po të dojë, të përtypë nën strehë!
 Përgjunjet po të gjejë shesh sa për t'u mbështetur,
 Zvarritet mbi tokë ai gjerdan shtresë-shtresë.
 Sytë çift përumben, asnjë nofull s'rri, po bluan;
 Dy fije të tejdukshme zbresin nga të dy anët përdhe.
 Ngjitësi i këtyre trashet duke u ngjeshur palë-palë;
 Një tufë vajzash fshatare faqekuqe që përtej
 I krehin të gjitha një nga një e i bëjnë me këna.
 Ndërsa zbresin nga maja lopët me bishtin përpjetë,
 Qindra mëza të shënuar të fshatit kridhen gjithandej,
 Zëra kuajsh, zëra pelash fushën e bëjnë të rënkojë!

Ditën askush s'shihet, burra e gra punojnë;
 Në pastë dikush që shëtiti në shesh, janë fëmijë topolakë.
 Kur bie mbrëmja, ezani i mbledh njerëzit;
 Disa herë, edhe pjesa e fundit e xhamisë është plot.
 Sapo dielli horizonteve t'u ketë thënë lamtumirë,
 Lartësohen drejt Qabes balle të ngritur mbi tokë.
 Në fillim dallgëzohen, pastaj marrin të gjithë drejtim;
 Thuret me supet e gjerë nga një kështjellë e gjallë.
 Harmonia e këtyre radhëve të jashtëzakonshme të mahnit:
 Sikur shkëmbenj të thepisur janë mbërthyer pranë e pranë!
 Një front i tillë që prerë: besim i lidhur varg;
 Ah, ato ditë bashkimi e uniteti u bënë ëndërr sot!
 Hallin e popullit shihe e të kaluarën e mendo:
 Ç'mjerim mund t'i trondiste këta shkëmbenj të vështirë?
 Ashtu u tronditën që shekujve u dhanë tërmet!

* * *



Fshatari s'ka më gjë: shëndeti, morali, të mbaruar;
Shih, edhe këmisha mbi shtat, e copëtuar.
I gjalli i pavdekur, kockë e lëkurë,
Ku është një e dhjeta e mirëqenies dikur?
Çatia, e shembur, ara, rehin, bahçen përmbarimi e do;
Për borxhin një kalem, faizi defter-defter!
A pse s'i është bërë hiç shërbim që toka është aq e ligësht
Sa të mos e japë as farën e mbjellë?
Kur merr katër për një, fshatari, më beso, harbohet,
Shpenzon me të dyja duart sikur s'ka për t'u mbaruar!
S'shkon tërë ditën në shtëpi, as në arë;
Në mëngjes luan me letra në kafene, në mbrëmje, domino!
Besimin e ka të ngushtë, me njohuri që s'bëjnë dobi;
S'e dallon dot ç'urdhëron Allahu e ç'ndalon!
Në namaz shkon vetëm për bajram,
Sexhadeja, dushman për fytyrën që s'ka parë ujë kurrë!
Jo më shumë se katër-pesë vetë falin rregullisht namaz;
Xhamia s'i vlen imamit veçse si hambar!
Këndimin lëre, ai defter është mbyllur;
Shkollat i ka bërë depo një nënoficer!
Turli gjëra ngjitëse: ethe, kurvërim, pije, kumar,
Pastaj dhe sëmundje të formës që s'thuhet dot!
Ndere të panumërt përlyhen me ndyrësi, nga një anë;
Miliona vetë shtrihen në dhé, nga tjetra anë!
Dhe sikur të mos i vëmë re vdekjet që shtohen,
Ku janë jetët e reja që të zëvendësohen?
Martesa dhe ngritja e familjes sot s'është e lehtë
Shih se sa rrallohen kurorat sot më shumë e për ditë!

* * *

Dikur, kur binin zurnatë, rënkonte qielli;
Ç'ditë të mrekullueshme, ç'dasma, ç'kënaqësi!
Shtroheshin në shesh si lëmë dyzet-pesëdhjetë tepsi,
Mbusheshin me pîrg sinitë me deshër për majmëri!

Dhe pastaj shtrohen këmbëkryq përreth
 Burra me gjoks të gjerë, me këmisha të fryra,
 Në kokë çallma të bardha të qendisura, në trup, këshishë
 Gjysmëhënë; në bel, shall Lahore, sipër, jelek krejt argjend,
 Në gjunjë, poture të ngushta, të hequra gajtan.
 Dhe secili merr mbi gjunjë një cep të peshqirit
 Të gjerë të vënë nën sofa si shtrojë,
 Përreth me pe argjendi punuar të punuar hollë.
 Pas çorbës dhe mishrave lloj lloj që shtrohen e ngrihen,
 Vijnë brumëra nga të gjitha llojet për bukuri.
 Në tetë a dhjetë vende ziejnë gjyma pa ndërprerë;
 Sherbet taze jepet i ftohur me borë taze të prerë,
 Kurse dhalli me akull me gota të bakërta vjen vërdallë.

Kur vjen mesdita, e falin namazin në bashkësi.
 Pastaj buçet gërnetë zëhollë e mundjes gyresh.
 Ulen përdhe lodëtarët e ushqyer, të shëndoshë, të shëndoshë.
 Fillojnë pastaj kabatë me gërnetë
 Dhe rënkon qielli dhe zemra i hidhet përpjetë!
 Zërat e lartë të gërnetës shtatë krahina i mbërthejnë!
 Dhe e rrethojnë sheshin e shënuar me litar
 Grupe-grupe gra, vajza, burra, djem, në këmbë a shaluar!
 Nga ana tjetër zbresin qerre pa numërim...
 Zbresin dhe aq të stolisur, sa thua: Nën këto tenda të bardha,
 Vallë, nga një dhomë nuseje ka?
 Ndërkaq, tregohen çmimet: tetëmbëdhjetë desh të zgjedhur,
 Dy krerë që, nga një mëz, viç, topa-topa copë të endur...
 Mos pyet për dhuratat si peshqirë...
 Vaji rri në kazanë, pa peshë, pa masë, pa kufi;
 Po të duash, lyeju, po të duash, lahu, po të duash, pi!

Të gjitha këto mbarojnë, shfaqet një ngazëllim;
 Ç'shfaqje është ajo, dridhet njeriu si në thëllim.
 Kur tre çifte trupash njëri më i rregullt se tjetri,



Hidhen në skenë e nisin të lëkunden si skifterë,
Gjithkush zë të dridhet, s'ndihet asnjë pipëtimë
Dhe vjen e ngushtohet me frymëmarrjet ai vend i gjerë.
Sepse jo vetëm në sheshin e mundjes, por dhe te shikuesit
Bien në sy trupa si statujë që i përngjajnë Asimit.
Tani ajo gjysmë duzine levendësh që kanë lidhur
Në dorë të djathtë një lidhëse veshur me argjend
Dhe me qafën me nuska të pajisur,
Në fillim bëjnë peshrev*, pastaj mbërthehen
Dhe mundja nxehet, kundërshtari kundërshtarin e mat.
Gjokset zgjaten, puqen dhe, përsëri,
Përplasen me njëri-tjetrin siç përplasen dallgët.
Njëri futet kryq, kundërshtarin e heq zvarrë
Tjetri e kap për brezi, e gjuan andej, ç'trim i paparë
Njëri e mbështjell, dhe ia vë sarmën mbi qafë
Tjetri mprehet si shpatë, e tërheq vërdallë.
Dorëzohet livadhi para burrave trupfortë
I shtrirë, i paaftë të ngrihet edhe një herë
Trimi ia ka vënë dorën në zverk, i rri përmbi
I poshtmi, bën qindra marifete të dalë sipër si e si
Njëri e ka kapur për kësmetesh, kundërshtari vërtitet
Tjetri, ia del prej poshtë të ngritet, fiton, loja ndërpritet
Njëri hidhet me të dyja duart, e mbështjell si pe
Tjetri e shtyp dhe e kthen, mundësit shpina i zë përdhé
Pa shihe, një herë dhe popullin që sodit: ç'njerëz zemërmirë,
Ç'bashkësi e pastër, ç'njerëz të gatshëm për shërbim!
Kokët e çara të fshehura mes turmës më tregon?
Ata që u fshijnë sytë, ata që u fërkojnë këmbët më tregon?
Tjetërkush lyen me vaj, tjetër lidh, tjetër zgjidh;
Tjetër jep ujë, ata që shëtisin me gjyma, të tjerë janë.
Siç qe ndër njerëz ndjenjë e nderit e lartë,
Edhe ndjenja e dhimbshurisë ashtu qe, apo jo Qose!

* Peshrev: Në mundjen popullore "Gyresh", ceremonia e përshëndetjes së mundësve.

Ç'farë? Asgjë s'the!

- Të shkuarës i thonë "e shkuar"!

- E drejtë, por...

- Lëre, bir, për të ardhmen ç'di?

- Atë vetëm Allahu e di!

- Pak edhe robi e di!

- Nuk e di sepse nuk duket, nuk e sheh.

- Mirë, por parashikohet:

Agjërimi paska ardhur në vapë. Agai i livadheve paska parë se Pritja nga mëngjesi në mbrëmje s'qenka punë; ky tirjaqi Qenka mërzitur nga dremitja gjithë ditën, nga zemërimi Dhe, duke u bërë një me kalin e kuq, paska dalë në udhëtim! Takëmet të rehatshme, fushata të qoftë për mbarë: Disa javë në fshatrat me pula, me gjela deti pushim! Shoku i udhës e ka gjetur tagjinë; e pret me kënaqësi e gëzim; Ha katër herë në ditë, pastaj do dhe syfyri! A re në sofër pa pará, ramazani shkon shumë mirë! Jam mysafir - thotë njeriu - dhe shtrohet si në shtëpi të vet! Por vjen një natë dhe ëndërr sheh udhëtari ynë; Pa pritur mëngjesin, i zgjon gjithë fshatarët e u thotë: Shpejt shkoni e më gjeni një njeri të zot Që të dijë t'i japë kuptim një ëndrre të vështirë! Njerëzit e këshillojnë të pyesë xha Opingarin.
- Mirëpo në syfyri fle, në këtë orë nuk ngrihet dot! Tregohu pak me durim...
- Tani e dua, të vijë!
Unë kështu s'pres dot; ç'do të thotë nuk ngrihet dot? Xha Opingari, njerëzit e ardhur i kthen për dere prapë. I shkojnë përsëdyti:
- Të biem ndër këmbë, aman,
Njeriu nuk merr vesh fjalë; eja dhe pastaj fli!
- Ç'ëndërr kjo pa zbardhur mirë? Mos ndjeftë!
Sapo isha shtrirë... Shihni, ç'ngatërresë...



S'kishte për të ngordhur!

- Mirë, po ec e bëje të marrin të kuptojë fjalë!

Ç'ti thuash, nxehet... Allahu na ruajttë mendtë!

Opingari del nga shtëpia, i përgjumur e i mërzitur

Dhe arrin, më në fund, te agai i livadheve

- Amman, bre Emmi!

- Ç'është?

- A di të shpjegosh ëndërr?

- O njeri,

Rri të marr pak frymë, i lodhur jam...

- S'mund të rri!

- Pse?

- S'më vjen mirë të pres, ja pse...

- Bre! Bre! Bre!

- A e di se ç'kam parë?

- Të daltë për mbarë!

- Hëngra darkë e rashë dhe mesi i natës qe

Kur i hipa një kafshe që s'e shqova mirë ç'qe.

- Mirë, po a kalë qe? Ta marrim vesh mirë gjënë!

- E ku ta di unë? Një gjë me katër këmbë!

Mushkë të them? Apo gomar të them?

Ká të them? Apo lopë të them?

Kal i kuq të them? Apo tredhak të them?

Dash të them? Apo Cjap të them?

- Bukur fort!

- Ecëm pak...

- Si ishte vendi nga kalove?

- E harrova!.. A e sheh ç'hall më gjet?

I përpjetë të them? Apo i tatëpjetë të them?

I gjatë të them? Apo i gjerë të them?

Djerr të them? Apo livadh të them?

Ujishte të them? Tokë e thatë të them?

- Në rregull! Më tej ç'pe?

- Më tej ishte errësirë...

- Mirëpo, emër s'kishte?

- S'e di, aman!

Pemë të them? Apo trung të them?

Mur të them? Apo tumulus të them?

Vathë të them? Apo hamam të them?

I shembur të them? Apo në këmbë të them?

- Po pastaj?

- Pashë që m'u ngul përballë...

- Kush?

- Një njeri...

- E njohët njëri-tjetrin?

- S'e di a më njeh ai, por unë, jo...

Im atë të them? Apo ime bijë të them?

Dushman të them? Apo farefis të them?

Çifut të them? Apo kaurr të them?

Ky qe të them? Apo ai qe të them?

- Mos e zgjat, prej Zotit e gjeç belanë!

Dhe do ta gjesh! Vetëm se nuk e di me siguri kur të ta them.

Sot, të të them? Apo nesër, të të them?

Larg, të të them? Apo tani afër, të të them?

Verës, të të them? Apo dimrit, të të them?

Dimrit, të të them? Apo verës, të të them?...

- Sa drejt! Kjo vajtje, o mësues, për mirë s'duket të jetë.

- Ti thuaji asaj ëndrrës, e vërtetë, si puna jonë krejt!

Si puna e atij njeriu, edhe sot ky millet

Në po atë rrugë, në po atë mendje, në po atë logjikë:

Nuk e njeh kafshën q'i ka hipur, ikën qorrazi ku ta shpjerë;

S'e njeh vendin ku arrin, gjënë që sheh.

Si ndonjë paralitik që ecën, s'ndjen gjë, s'ka ndonjë ide.



Në qoftë kjo shëndet, vdekja është më e mirë!
Përkul qafën si ta drejtojnë tre të patru,
Tërë ditën nën kërbac, as ankohet, as kundërshton.
Më morët, o bir, e më treguat mua për të shkuarën
Dhe bëtë të dëgjoj për gjendjen e fshatarit sikur të mos e di!
I sëmuri është sheshit dhe ka nevojë për kurim,
Vetëm se dua ta di ku është mjeku, ilaç ku ka?
Brezi i sotëm, po pa çallmë, e poshtëron;
Zhduku, i thotë, lypsar, kufomëtar!..
Ç'shushunjë paska qenë ky brez, o bir i mësuesit tim,
Paska mprehur gjuhën prej vitesh për gjakun e turkut!
Pret rastin t'i ngjitet e t'ia thithë gjakun e ç'të thithur!
Këpushë thua? A ç'gjë e pangopur!
Ç'pate, u nxeve, a si?
- Jo, këpushën e kuptoj,
Por dhe ju e molët për shekuj atë lopë për t'u mjelur.
- Kemi të drejtë, e mjelim, se të keqen ne ia kemi hequr
E kemi ushqyer..
- Ashtu, ë?
- Posil!
- E ushqyet! Ke të drejtë!
Lëre ushqimin, cili prej jush i dha një dorë bar?
- A s'ka medreseja kontribut të paktën në fshat?
- Shkolla, ndoshta... Por, për medresen, s'e besoj!
- Do të nxehem hë!
- Është e drejta jote e hapur, o imam!
- Vetëm një prijës ka që t'i tregojë popullit rrugën:
Dijetarët e fesë! Të tjerët, të gjithë bosh!
- Bosh, zotëri, por..
- Ç'qenka kjo "por", zotëri?
- Këto medresetë tuaja
Të mos u bëjnë inat kërkesave të kohës..
- Shkoni e i rregulloni, atëherë!
- Me të vërtetë, me shumë vend!

- Ç' thua, a të tregojmë një anektodë?

- Le ta tregojmë, ta shohim ç' do të jetë!

- Kohët e fundit qeveria, një të marrë të llastuar

E çon në një vend si valí...

- Mrekulli!

- Puna e parë e valiut, urdhri: "Të vijnë hoxhallarët të gjithë!"

Hoxhallarët i binden urdhrin e shkojnë.

Në fillim njohje dhe pak urim.

Pastaj "kuvend" thuhet dhe ngrihet një podium i lartë;

Vali Beu yt hipën në katedër, bërrylat mbështet

E, duke e kujtuar veten diç, zë të prashitë...

- E,

Ç'ka thënë?

- Jo, ç'ka prashitur, thuaj!

Një turrë fjalësh pa lidhje e pa kuptim!

Spërkat një prehër marrëzish, hedh një sërë çmendurish;

Dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, përplas grushtin tri herë

E thotë:

"Ana e shquar, për t'u lavdëruar, e shekullit të njëzetë,

Eshtë se shkencat e natyrës, teknologjinë, i ka gjallëruar.

Ç'është e vërteta, popujt kanë psikologji të vetë,

Por, sipas këtij parimi të shekullit tonë, shoqëria ka përparësi!

Ndoshta, përparësia e shoqërisë individin e lëkund,

Por duhet parë e vërteta që shekujt kanë parashtruar.

Edhe vlimet dhe dallgëzimet në opinione kanë rëndësi,

Por idetë ekonomike kanë më rëndësi dhe produktivitet!

Po qe se hoxhallarët, mësuesit, në këtë rrugë

Nuk sigurojnë dot një zhvillim,

Industria nuk zhvillohet me mendimin skolastik!

Këtë hap të parë ka për ta hedhur shkenca, gjithsesi,

Parprensip*, për përmirësimin e medreseve, të bashkohemi!.."

- Parprensip? U mpaka, bre!

* Në këtë formë në origjinal; si parim (frëngjisht).



- Për frëngjishten time?

A mos e pandehje imamin më gomar se ai njeri?

- Menjëherë gomar mos thuaj, i shkreti është ende në zhgarravinë!

Sa shembuj ka që janë për t'u quajtur gomar i tërë

Që le të rrinë fshehur nën atë të shëndoshë formë!

- Në ç'projekt? Ç'zhgarravinë? Një fjalëkryq që...

- I gomarit...

- Dhe?

- Soji më i zhvilluar a s'mund të jetë?

- Po si?

- Ja, pra, disa, gjatë krijimit, dalin të hedhur në të pastër,

Kurse disa të tjerë hidhen duke qenë në projekt...

Nejse, kalo ku e le.

- Ku e lamë? Po, fjalimi këtu mbaron,

Por në kuvend përhapet një plogështi.

- Sepse gjërat që dëgjuan, s'ua nxunë trutë!

- Pastaj ngrihet njëri nga hoxhët e thotë:

"Vali Bej,

Mos i përbuzni këta që ju rrinë përballë

Nëse s'i kapin dot idetë që fluturojnë nga tavanet

Me këto fjalët tuaja të larta! Shih, ju jeni në shekullin e njëzetë,

Kurse dje sapo shkelëm në të katërmbëdhjetë!

Prandaj duhen plot gjashtëqind vjet

Që të kuptohet ky fjalimi juaj i lartë!

Diçka si "t'i përmirësojmë medresetë" thatë...

Edhe pse duket sikur e kemi kuptuar disi,

Ju lutem, na e bëni të qartë, Ç'ju detyroi për këtë?

Që të bëhet, përmirësimi kërkon të ketë një keqësim.

E para, këtë nuk e pranojmë, e hedhim poshtë!

Pastaj, medresetë e mjera, megjithëse kaq pa zot,

Megjithëse janë lënë kryekëput mënjanë,

Bien e ngrihen, po prapë bëjnë shërbim.

Cili është qëllimi i tyre? T'i tregojnë popullit rrugën!

Tamam! Qytetit i jep myfti, xhamisë, imam;

Hatibët prej aty vijnë, vaizët prej atje janë!
 Aty përgatiten mësuesit, hoxhallarët, shërbyesit e xhamisë, hafizët,
 Gjykatësit që gjithandej shpërndajnë drejtësi, fikhun e kanë
 mësuar aty.
 Sidomos nxënësi i medreses është ai që shëtit fshat më fshat
 E i bën njerëzit njeri!
 Tani është një çështje që duhet sqaruar me rëndësi:
 Medresetë që kanë përgatitur gjithë këta,
 A kanë ndjerë nevojë dhe për një çast për ndihmë nga jashtë?
 Jo! Mirëpo, zotëri i mirë, po ta shohim çështjen më gjerë,
 Ka vende që quhen shkolla të larta,
 Për të cilat pyesni, sa jep mileti? Me miliona!
 Ç'është kjo? Shkencat Politike! Kjo? Mjekësia!
 Kjo? Shkolla Ushtarake Detare! Po kjo? Veterinaria!
 Kjo? Bujqësia! Po kjo? Inxhinieria!
 Bukur fort, për asnjërën s'kemi fjalë, vetëm se
 Ç'përgatitën këto të gjitha, vallë? Na i tregoni neve, pra!
 Po na doli punë për detari a për kantier anijesh,
 Sipas zakonit tonë, vrapojmë te Anglia!
 Për një urë të shembur, vjen mjeshtri nga Belgjika!
 Mjeku specialist s'e di se nga vjen...
 Për shembull, buxhetin s'ka kush ta nxjerrë...
 Eja të na vijë në financë mësjë Loran!
 Tezgjahët ku i kemi? Industrinë ku e kërkojmë?
 Në Bruksel, në Berlin, në Mançester!
 Ne nga Europa s'kërkojmë as myfti, as imam;
 Dhe, për në botën tjetër nga papa s'kërkojmë ndërmjetësim!
 Ja, pra, këto kërkoni të rregulloni me radhë ju,
 Hoxhën, medresenë lëreni, Vali Bej, lërinini ashtu!

* * *

Ç'thua për anekdotën time?

- Shumë e bukur! Më bëre të hesht, imam!

- Pa kthehu, kështu, përsëmbari, ç'qenë ato fjalë?



- O mësuesi im,
Ne s'të thamë ty se medreseja s'bën asnjë shërbim;
Të përpiqesh ta mohosh këtë të vërtetë të qartë, është marrëzi!
A ka veç jush tjetër që t'i tregojë popullit rrugën e drejtë?
Intelektualët s'e vlerësojnë popullin e thjeshtë as për njeri!
Kur bijtë e popullit iknin prej fshatarëve andej-këtej,
Ju ishit ata që jetonit në fshat me fshatarët bashkë!
Shpirti juaj, me shpirtin e popullit, me shpirtin e fshatarit i njëjtë,
Të një fjale, të një rrënje me ta, ç'përshtatje që të jep lumturi!
Ne s'duhej ta prishnim këtë harmoni, por e prishëm,
S'është nga ato që mbyllen e çara e përgjakur që hapëm.
Sa i ngajmë tani një muri të epuar!..
Kjo plagë në ballin e pastër të unitetit, sa e shëmtuar!
Eja, bëj punë, të të shohim, a ka mundësi? Ku e ke!
Dyzimi i bëhet pengesë vendosmërisë në çdo vend!
Çfarëdo që të themi, e kotë, askush s'na dëgjon ne.
- E, pra, përshtatiani edhe ju pak veten popullit, zotëri!
- Ke të drejtë!

- Me kundërshtime, kjo rrugë s'të nxjerr askund!

- Isha në Konja...
- S'di gjë, kur?
- Verën që shkoi.
Rrethinat s'i njihja, por qytetin brenda, pak a shumë;
Pra, thashë sikur t'i shëtitja fshatrat dhe dola...
Në rrugë e sipër dëgjova se parësia e filan nahieje
E kish përzënë filan hoxhën tri ditë më parë;
Shkolla ishte mbyllur, fshatarët fëmijët i kishin marrë.
Shumë gjë e keqe! Dhe desha ta kuptoj shkaku ç'qe!
Mirë që unë s'kisha ndonjë punë, kurse rruga
Me udhëtarë plot; dhe arritëm në mbrëmje atje.
Pas jacistë, njerëzit më thanë: "Na mbaj vaz, na këshillo!"
Më vunë poshtë një minder të vjetër, të shkallmuar.
Pyeta dërrasën me mëngët e varura që fshiheshin përtokë,

Më erdhi një rahle e çalë që më vinte gjer në gjoks.
 Me falënderim për Allahun dhe paqe për Profetin e fillova,
 Para se të hyja në temë, një hyrje shpejt e shpejt sajova.
 Si bilbil unë atë natë para njerëzve ligjërova,
 Të gjithë ajetet dhe hadithet që i japin vlerë diturisë, i këndova.
 Pastaj, me ndihmën e Allahut, gjithsesi,
 Aq keq injorancën e poshtër e turpërova,
 Sa me të vërtetë veten e pëlqeva!

- Pa na trego, ç'the, o njeri!

- Jo vetëm një gjë!

- Ashtu, ë?

- Pashë se ishte pikërisht koha

Për të hyrë në temë; nga njerëzit kokën ktheva,
 Dhe hapa gojën, atëherë, dhe thashë ç'më erdh për mbarë:
 "Pa më thoni, ore ju, a përzihet mësuesi? Kjo ku është parë?
 Ai është për ju çdo gjë: shtet, fuqi, dhunti.
 A ka të drejtë që të barazohet me të drejtën e mësuesit vetë?
 A s'kanë për t'ju pyetur në jetën tjetër kur t'ju kërkojnë llogari?
 Me shkop në dorë, me divit* në brez, me çallmë në kokë,
 Në shpinë, si rezervë, dhjetë dorë opinga me xhufkë në majë,
 Do të niset muslimani për gjashtë muaj rrugë
 Duke kapërcyer fusha e male pa pyetur për lodhje e vështirësi
 Për ta kërkuar diturinë dhe sikur t'i duhet të shkojë gjer në Kinë e
 përtej!**
 A s'mendon fare, o njerëz, ç'është kjo punë?
 Shansin më të madh Allahu juve jua ka dhënë,
 Për më tepër, duke jua dërguar mu në derë,
 Kurse ju e kthyet mbrapsht nga hutimi të mirën që ju erdhi vetë!
 S'do të kalojë shumë kohë dhe keni për të parë
 Se kjo mosmirënjohja juaj ç'fatkeqësive ka për t'u prirë!
 Sot, më se tetëdhjetëpërqind e fshatrave pa mësues;
 Kuptojeni se edhe ju si ata do të mbeteni injorantë

* Divit: takëm shkrimi (shishe boje e penë).

** Aluzion për porosinë profetike: "Kërkojeni diturinë qoftë edhe në Kinë!"



Dhe do të pendoheni dhe do të thoni: “Ah, ç’bëmë gabim!”
Por pa dobi! Dhe ja se si ndaj fëmijëve tuaj bëtë krim!..

Dhe fola kështu, fjalë të tilla një copë herë
Dhe e preva fjalën kur zëri dhe fryma më qenë prerë.
Pandehja se nga lutja e gjithë ajo faltore ka për të rënkuar..
Por s’doli ç’shpresoja: ata thanë “amin” ngadalë e me zë të shuar..
Atëherë edhe unë thashë “Fatiha” pa e zgjatur më tej.
Pastaj, kur dolëm jashtë xhamisë, mikpritësi ynë ku do të shkonim
Për të fjetur, daja Mestanli, i cili më printe me fener në dorë,
Thoshte një fjalë të urtë me zë të ulët sikur s’e kish me mua:
“Këndon me zë të kthjelltë, lutet me zë të qarë;
Po shih, more djalë i marrë, i tyt eti është ky varr?”
- Ama e bukur, me të vërtetë!
- Kur e dëgjova këtë, u turbullova sikur të kisha pirë helm..
Erdhëm në shtëpi dhe njeriut zemrën ia rrëmoja;
Po sa gjëra dinte, o mësues! Dhe kush? Një copë fshatar!
- Ashtu është!
- Edhe ti do të bësh çudi po t’i tregova!
As dhelpira nuk mund të ishte më e zgjuar se ai!
- Eja, më fol, të shohim se ç’gjëra dinte!
- Më tha:
“Para se të marrë vendim, po të them,
Gjykata i dëgjon dy palët gjer në fund me ç’të kenë,
Gënjeshtria e të vërteta... Atëherë, gishti i prerë nuk dhemb!
Por të shohësh në gojë të vetëm një pale, s’është mirë!
A mos kujton ti se dushmani pas shpinës time
Për mua mevlut ka për të kënduar?
Prit e më dëgjo mua ç’do të të them, o biri im i mirë!
Pse është injorant fshatari, mos do të thotë se është kafshë?
Kush e kthen të mirën mbrapsht? Veç në qoftë veshgjatë!
Një nahije e tërë u dridhëm, pa dru e pa u ngrohur fjetëm,
E pe atë shkollë të madhe? Dimrit ne e ngritëm!
Kush dëshiron ta rritë fëmijën injorant, or ti?

Dy gjëra të domosdoshme na duhen ne: shkolla, një; rruga, dy!
 Pse shpirti i turkut digjet zjarr, pse populli jeton në prapambeturi
 Prej vitesh e kemi kuptuar ne këtë, po si,
 Por pastaj pamë se, për sa të kemi shpresë në shtet,
 S'do të na vijnë as inxhinieri, as mësuesi vetë!
 Së fundi, "paraja nga ne, mësuesi nga ju" - thamë;
 Atëherë, a s'na del ky i pafismi? Aman, o Zot, aman!
 Ti, o bir, na fole ne nëpër tym,
 Duhet ta kishe parë atë bastardin q'i thoshin "mësues"!
 Ngordhte e s'hynte në xhami; as agjërim kishte, as namaz;
 Zoti e di, por, ndoshta, trupin asnjëherë s'e kishte larë!
 Kudo nga kalonte, linte një gjurmë që kundërmonte shurrë;
 Siç duket, vetëm në govatën e mami së trupi ujë i kish parë!
 S'e di, nesër, kur të vdesë, cili imam do të mundet ta lajë
 Edhe në i dhënçin në ndihmë dy kazanë me ujë të valë!
 Në pyetsh për shprehitë, një burrec që s'ngjan me burrë,
 Sikur një copë të mësohej, po s'u mësua dot kurrë!
 Po t'i afrohet kush ta pyesë si je, si shkon, s'afrohet ariu,
 E sheh tjetrin me bisht të syrit siç kthehet dhe sheh bualli
 Te nallbani kur në shpirt i ther...
 Jep një selam, o njeri, se s'të hahet goja! Por jo,
 As di të përshëndesë shtaza, as përshëndetjen ta marrë.
 Ha yndyrë, në çezmë nuk shkon; ujë derdh, duart s'i lan;
 Pa le thonjtë si kazmë që s'ia sheh dot!
 Kokën, si pyll, mustaqet i lëshojnë filiza për ditë;
 As kupton t'i thuash "është turp", as turpërohet ta pështysh.
 Futet në vende të pastra me galloshe të fëlliqta;
 Na u bënë odat nga kalldrëmi më të pista;
 Minderet e mbulesat ngjyhen që të gjitha me baltë!
 Inxhinierët e ujrave patën ardhur... kaurrë, pra,
 Mirëpo ne s'na ngacmuan as sa një fije;
 Besomë, o bir, më të matur na paskëshin qenë çorbaxhinjtë e pafel!
 Fytyrëmbël, fjalën si mjalti... fshatari tjetër ç'do?
 Njeriu e njuh mirë mashtrimin, kopili!



As që pinin, as që shkelnin me çizme në sexhade ndër ta!
Ç'të të them, tjetri e ka fenë të shtrembër, por është njeri!
Kurrë s'ndodhi të shëtiste esëll ai farmasoni ynë...
Pija qe për të nder, sikur t'ia njihje moralin atij!
Tani n'daç më shih me të drejtë ti mua, n'daç mos më shih,
Fjalët e bukura mua më hyjnë këtu e më dalin atje!
Sikur ta gëlltitë tërë shkencën, s'bën dobi nga këto fatkeqësi...
Lëreni tim bir, me injorancën jam pajtuar!"

- Ka të drejtë!

- Shumë mirë, por kjo punë s'ka fund.

Ja ku e përзумë farmasonin dhe e mbyllëm shkollën,
Kush do ta udhëzojë fëmijën e fshatarit që s'di nga të shkojë?
Duhet njeri t'ia fusë atij në shpirt njerëzinë!

Po ku ta gjejmë këtë njeri? Ku ta porosisim?

Në fillim të shohim sa tezgjahe kemi, t'i numërojmë...

Mos bëj llogari shumë të gjatë se çështja është e qartë;

Gjëja që di çdokush: medreseja, një; shkolla, dy!

- Ja, pra, po jua them personit tuaj të nderuar,

Nën këto kushte, nga të dyja s'ka dobi për ne!

- Më duket se ti përsëri do të nxehësh Qosen;

Më thuaj, o plangprishës, kush e shembi medresenë?

Ne, apo ju? Ju, gjithsesi...

- Gjithsesi!

- E shembët me fuqinë e kazmës dhe sa shpejt!

- Po!

- Sikur të ish një gjë e bukur, e pranon me gojë të vet...

- Sepse shkollë do të bënim me gërmadhat e saj.

- Sepse do të bëka shkollë!... Sa lehtë ta thuash me fjalë!

A mos bëre ndonjë qymez, një qymez për patok?

- Fama e revolucionarëve është të djegin e të shembin.

- Në pastë njeri që të mos ju thotë të çmendur, është kokëtrashë.

A mos u jep vlerë shembja njerëzve siç u jep ndërtimi?

Shembjen, më beso, mund ta bëjnë edhe njerëzit më të paaftë;

Mjafton t'u thuash "ja, kjo është kube"

Dhe me dy punëtorë shembet xhamia Sulejmanije!
 Mirëpo, po të thuhet “ejani ta bëjmë”, eh, atëherë,
 Një Sulejman dhe një Arkitekt Sinan duhet të dalin dhe një herë!
 A ka të tillë në listën tuaj? As që t’u afrohen atyre.
 Por çfarë ka? Një gjuhë të thatë; ju bujrum, unë e kam
 barkun plot!

Mos më krakitni përballë si sorrë, heshtni!

- I prapambetur je, bre imam!

- I prapambetur, falënderuar qoftë!

- Pa shih, edhe falenderon!

- Edhe në falënderofsha, është me vend:

E Shafiiut*, apo e kujt është ajo vjershë?

- Cila vjershë?

- Ja, pra, ajo që thotë, “po t’i duash fëmijët e Profetit

Nga zemra, është shiizëm...”

- Po,

“... edhe sikur të gjithë njerëzit mbi tokë

Dhe engjëjt në qiell të thonë për mua se jam shiit,

Unë po ky jam...” - thotë.

- E mora vesh.

- Se kush e ka thënë?

- Më duket, Shafiiu; por, ku e keni hallin?

Ju lutem, ma tregoni, ma shpjegoni!

- Vendit tim të shembur nuk mund t’i them xhennet, më falni!

Hë, ku është vendi i urbanizuar? Ç’punë kam unë me një
 gërmadhë?

A ka mundësi të jesh i qetë kur populli

Lyp “drejtësi” me hejben në shpinë?

Opiumi “rroftë!”** qe shumë i mirë, gëlltite e shihe qejfin tënd!

Tani nuk zë më dhe sikur ta ngjyesh gishtin një mijë herë!

- Tirjaqi i ç’gjëje u bëre kaq shumë, or ti?

Nuk zë, se u mësove... Të mos haje shumë!

Dhe a është e drejtë ta copëtosh pastën tonë gjer këtu?

* Shafiiu (767 - 820), dijetar i shquar musliman, themeluesi dhe imami i shkollës juridike-islame shafite.

** Është fjala për parrullën e Kushtetutës së Dytë (në Turqi), “Rroftë liria, drejtësia, vëllazëria, barazia!”



- Prit, o shpirt! Unë nxehem për një shaka të tillë të pakohë...

Ta mbaroj fjalën...

- Pastaj mbaroje, dëgjo pak:

Gëlltit një, gëlltit një tjetër, droga s'e zë të droguarin

Dhe thotë: Dhé, a ç'helm është ky, duhet vajtur dhe parë.

Hapet govata nga kryeja, i bie peshtemalli,

Ua hipën nallaneve dhe shkon drejt duke i hequr zvarrë,

E gjen drogierin dhe i thotë: "S'më zuri, jahu, përsëri!

Ndërsa njerëzit e mbledhur në pazar shqyhen së qeshuri,

Drogieri i thotë: "A s'e ke mjaft me ç'të ka zënë, o njeri?"

Edhe ju shumë e zgjasni, madje, shumë;

Kam tri orë që jua dëgjoj fjalimin pa dremitur unë.

Gota e frymëzimit, ja, opiumi i asaj "rroftë!" është krejt;

Zog sarhosh u bëre, pa pushim këndove!

- Mjaft, o bir, lëre, s'është koha për shaka!

- Mëso edhe ti ta përkulësh qafën para opiumit tonë!

- Po qe se goja ëmbëlsohet vetëm me një të thënë "mjaltë",

Mos u shqetëso fare se bleta ka ikur, ka fluturuar!

Le të qajnë fëmijët e popullit me ngashërim,

Ti mos rri, po këndo se e fituam lirinë!

Padrejtësinë dhe dhunën s'i duartrokas dot, tiranin kurrë s'e dua,

Për qejf të asaj që vjen, të shkuarën dot s'e truaj;

Po qe se dikush m'i sulmon etërit, e mbys...

- S'e mbyl dot që!

- Më e pakta, e përzë!

Tre e gjysmë të pafismëve pas si zagat s'u shkoj,

Në emër të drejtësisë, padrejtësinë, vdes e s'e adhuroj

Që kur kam lindur, jam i pasionuar pas pavarësisë,

Kurrë s'm'u bë zinxhiri i artë për kërpesh;

Nëse jam i butë, kush tha se jam dele që shkon nga ta çosh?

Ndoshta më pritet qafa, po nuk bie poshtë;

Po të shoh një plagë që rrjedh gjak, zemra më djeg,

Për ta pushuar atë, kamxhik ha, çifte ha!
 Nuk them, “mos çaj kokën, kalo”, ndaloj,
 Shkel me këmbë, shkilem, po e kap të drejtën dhe e ngre lart!
 Jam armik i shtypësit, të shtypurin e dua...
 A ky është kuptimi i prapambetjes në gjuhën tuaj?
 - Jo, xhanëm!
 - Mos thuaj “jo”!
 - Po e tepron, Qose...
 - Ashtu, a?
 Ja, unë jam i prapambetur, le të vijë bota të dëgjojë,
 Madje, koka e të prapambeturve, po të doni, bëni bam!
 Eja, kanuni juaj, më var mua; apo ligji juaj?
 - Ligj s’ka tani.
 - Pse, a mbaroi?
 - Ka kohë!
 - Gjyshi Xhengiz?
 - Lëre, ma trazove hallin: Shkoi!
 - E sjell përsëri, po u desh...
 - Jo, shkoi e mbaroi!
 - Mos, more bir!
 - Paskësh qenë dushmani ynë ai...
 Një çifut tradhtar* paska qenë ai që na e mballoi
 Duke na e paraqitur si gjyshin tonë...
 - Juve, ë?
 - Ashtu, por nuk shkoi gjatë
 Veç kur erdhi një tjetër kaurr që na tha: “Nga doli
 Kjo farefisnija juaj me Xhengizin? Ju turq, ai mongol!..”
 - Pastaj?
 - Hiç!
 - Hiç?
 - U shua e shkoi ai treg i nxehtë.
 - Dhe me një të fryrë!

* Është fjala për autorin Leon Caun të veprës *Hyrje në historinë e Azisë, turqit dhe mongolët*.



- Po, dhe tani, as ligj, as sundimtar!
- Paska qenë me mend në kokë, cilido që të jetë...
 - Mos e pyet, Qosja im!..
- Sa mirë që edhe tek ju nuk ka pak të hutuar!
- I fut ca gjilpëra këtij brezit tim sa herë që të gjesh rast;
Por kush ta dha, o mësues, ty, lirinë si diamant?
A e harrove atë periudhë shtypjeje se ç'gjë e egër qe?
Gjithë ngjarje fatkeqe u jetuan, jeta nuk kishte shije.
Njerëzve u zverdhej fytyra, nuk dëgjohej mirëqenie;
Çdo frymëmarrje, një e zgjatur "ah"; ç'ditë qenë ato!..
 - Flet posaçërisht për të më nxehur mua,
Mjaft!
- Pse?
 I di të gjitha përmendësh, pusho!
- I çuditshëm je! Nuk do të më lësh të ta hap zemrën...
- Jo, pashai im, çudia është tek ju, ku e meritoj unë!
- Dole soj i palëkundur edhe me despotin, shko, shko,
Ti që për lirinë syrgjynosesh, o plak!
S'ka punë tani, burri i botës, ka hall të bëjë opozitë...
- I ndjeri mësues fliste fjalë plot parashikim...
- Të paktën, a i mbajte?
 - E mundur? Ku kishte mend atë kohë?
- Po, sigurisht, të erdhën më vonë, sipas tim zoti, apo jo?
- Të rrah, ë!
- Zëre se më rrahe!
 - Prit, bre burrë,
Dëgjo, zevzekllëkun lëre!
- Ta lashë ty, imam!
- Ç'po thosha, bre?..
- E sheh? Koka jote, po ajo kokë!
"I ndjeri mësues" - the, ashtu hyre në fjalë.
- Po, o bir, mësuesi s'e donte Sarajin, e di...
- Por edhe s'e shante ngaqë s'e pëlqente.
Kishte një ndjenjë, kuptohet qartë...

- E paska pasur, s'e di...

Po u tha "padishah", shumica nuk zgjatka gjuhë!

- Kurrë s'e harroj, o bir i mësuesit, ish një ditë e nxehtë,

Në bahçe ishim, i zemëruar ish pak me mua yt atë.

- Po im atë ish i dhënë shumë pas teje, si të zemërohej?

- "Je, llafazan, je si thes i shpuar", më pati thënë.

- Parashikim!

- Mos pyet!

Atëherë mendova ta nxej me të vërtetë...

- Ashtu, ë? Shumë mirë:

Te ne e kanë pasur traditë "ta nxjerrin gozhdën me gozhdë"!

Dhe ia fillova fjalës me hyrjen e njohur: "Punët e ngatërruara,

Mjedisi rrëmujë; po s'vdiq korbi në Jëlldëz menjëherë,

Fundi ynë do të jetë shumë i keq..."

- A nxehej?

- Jo.

- Vazhdo!

- A më la? E drejtoi trupin mësuesi i ndjerë

Dhe më tha:

"Dëgjomë mua, o bir, se kujt i ngjan kjo dëshirë:

Gomerët që u digjej shpirti nga barra,

Thanë: Ç'është ky hall sikur të kishim sipër një çift samar!

Duke u marrë me njërin, ia mbërrin tjetri,

Më zemërgur se i pari, më trupmadh se ai.

Sikur ustai samarxhi të ngordhte, lëre ç'qejf keni për të bërë!

Mallkojeni, po, të ngordhë sa më parë!

Më në fund, ustai i mjerë mërgon një ditë, mirëpo

Mos ka për të mbetur vendi i tij bosh për një kohë të gjatë?

Dhe vijnë e mblidhen në qoshe kallfa e çirakë

Dhe u presin e qepin takëme gomerëve që vijnë e shkojnë.

Kallfa na qënkej axhami, kurse samari dashkej shumë mjeshtëri

Dhe, kështu, gomerët e mjerë mbeten te veterineri.



Beli e supet u zhvishen nga lëkura, u kalben,
Më në fund, shpina e secilit bëhet mish jeshil si bari.
Gomerët nisën ta kujtojnë ustanë e parë;
Ai s'ishte kallfë, mjeshtër ishte ai!
Si s'ia kishin ditur vlerën më parë?
Samarët e të ndjerit s'paskan qenë samarë, por mëshirë!
Këshilla ime për ty: Me marrëzira mos u merr;
Gjeje ku është rrugë e burrërisë e në atë rrugë hyr!
A je burrë? Je i lirë në këtë botë gjer në fund, ec;
Askush s'të vë kërpeshe e s'të tërheq zvarrë.
Por po s'qe burrë, o bir, je vullnetar për nën samar,
Pra samarxhinjtë që u përkule qafën, mos i shaj!

* * *

- Në s'paç punë, bërtit e shaj e bëj rrëmuje;
Brezi im e quan të ulët të kthejë kokën pas për të parë.
Unë s'i kam sytë në zverk, dua të shoh se ç'kam përballë;
E premë dhe e hodhëm sidomos atë nyjë që i thonë "e shkuar"!
Që prej sa kohësh të lidhur jemi, u mërzitëm,
E ngritëm spirancën nga ai tradicionalizmi juaj.
- Hapni velat e kçit në s'u shtroftë gjemia!
Kjo shëtitje, o bej i bukur, mos është drejt për në Kagëthane?
- Jo, drejt synimit, hapësirat një nga një duke i kaluar!
- Po më parë dilni nga Marmaraja për në Detin Mesdhe!
Ta them anekdotën?
- Fundja, puna jote, anekdota, imam!
Kam frikë se do të fillosh përsëri nga fyerjet...
- S'di të fyej e të ngacmoj!

"Ndërsa kapiteni i papjekur sodit e sheh përpjetë,
Përqafof një shkëmb gjemia e shkretë!
Ç'është kjo, kapiten, i thonë, mbaruam, ç'u bë më?
Dikush bën një lutje, nomatiset, dikush ia lë në dorë Zotit.
Jo, more, u thotë kapiteni udhëtarëve të mbledhur rreth tij,

Qënka mbaruar uji e unë s'dikam gjë; ja, zbrisni në tokë!”

Edhe ju, o bir, kaq të aftë jeni kaq të guximshëm jeni:

Për ju s'mbeti det që të vozitni gjemil!

- Dëgjo një anekdotë edhe prej meje tani.

- Punë që bëhet.

- Një varkë që pat kaluar aksidente më parë, një vapor i vjetër, Caktohet për linjën e Detit Mesdhe me të tepërt.

Kapiteni i vjetër thotë: “Nuk shkoj dot, sillni, në pastë, një tjetër!”

Vjen kapiteni i ri e del drejt e në kapiteneri.

Njeriu paska pasur fat të mirë, që ka erë që s'e lë të presë gjatë;

Ngrihet natën kjo postë vdekjeje e drejt për në Izmir.

Ndërsa vozit diku duke rrëshqitur mbi ujra si në qiell,

Veç kur ia shpërthen, më në fund, furtuna mbi det:

Varka bëhet si kandil i verbër, udhëtarët hidhen sa andej-këtej.

Tani kapiteni i shkretë as ndalon, as ulet dot

Dhe lëshon urdhra sikur ta dëgjonte njeri:

“Silleni hartën!” E sjellin; mashallah, Shile, Bartën, Këzëllërmak, harta e Detit të Zi!

- Po e Detit Mesdhe?

- S'ka!

- Ç'është kjo kapiteneri?

- Ke të drejtë, baba, shkruam, por s'e kanë dërguar.

Përkulet pastaj e sheh busullën: pa gjilpërë...

Gjemia s'ecën përmendësh, o të uruar!

Era shtohet, dallgët egërsohen...

“Gjejeni gjilpërën!” - thotë kapiteni; a ka mundësi?

“Gjilpërë s'ka, kapiten baba” - i thonë, ç'të sjellim tjetër?”

“Sillni shehadet*, pra!” - u thotë kapiteni tani.

* * *

* Shehadet: në islam, Fjala e Dëshmisë. Këtu, me kuptimin “lutuni e bëhuni gati për të vdekur”.



Ç'ka dhe, një dhjetëshe e vetme e fshirë, qe, o ti, imam i prapë;
Fjalë është hamami i emaluar, me nëntë kube?
Ç'ishte ajo gjë që na u dorëzua ne si shtet?
Një varkë e tharë që kërkon shkëmb ku të përplaset, qe!
A tetëmbëdhjetë milje të shkonim? Fundoseshim...

- Çfarë thatë?

A mos ju mbeti ndonjë pjesë e pafundosur, o bej bukurosh?
“Periudha e mëparshme”, the tani?.. N'e paç në dorë,
Kapi ditët për zverku e ktheji, të vijë ajo periudhë!
Të jesh i sigurtë se shtatë në dhjetë njerëz janë pa pesë para!
Gjatë ditës vërtitet i uritur; në mbrëmje, si mace e dyzet
shtëpive është!
Detyrojeni çdo njeri në plehrishten ku është përzjerë thekër:
Kur t'ju pyesin se ç'është ajo, mbyteni botën në zhurmë:
është bukë!

Le të na rrethojë sëmundja, morri, mjerimi gjithandej,
Vetëm ju shihni të rrini e të vështroni!

- Luftë Botërore, kjo, or ti!

- Në periudhën e mëparshme nuk ngordhte njeriu kështu, në mjerim,
I gjalli i shtrirë në këtë anë, i vdekuri në tjetrën anë!

- Për lirinë pse shkove në internim?

- Shkova, po,

Por liria që pata pritur, s'është kjo!

Fundja, qysh kur po shpallej, i pata rënë në të!...

E sikur të plasje, ajo ëndërr nuk shpjegohej për të mirë!

Ç'njerëz, ç'paraqitje, ç'fjalime, mendo!

- Mendohem e t'i them pastaj!

- S'harroj, një ditë,

Po ngjitesha nëpër të përpjetën e Portës së Lartë

Dhe pashë një grup me flamur që e kish zënë rrugën skaj më skaj.

Mbi kryet e tyre shëtiste një zë si nëpër hundë.

Edhe pse çdo njeri përkulej, lotonte e jargavitej,

Unë me ta parë zurnanë që ia thoshte, u trondita...

O, maskarai që del në Zuhuri!* E njoha, e njoha...
 S'ka bërë asnjë ndryshim, s'e dëgjoj, le të thonë.
 Prapë zverku i mbyllur nën një qime të dhirtë;
 Prapë qafa tërë zhul prej vitesh e palarë;
 Prapë thonj sa një gisht që ngulen horizonteve;
 Prapë një fytyrë e tëhollur e shtrirë me shkop,
 Që s'ndjen asnjë pengesë morale, as turp!
 Prapë një ballë i pashije, një hundë e rrafshhtë,
 Një nofull e shtypur, po ai që pata parë një vit më parë!
 Kush ishte, pa na e trego!

- Në Kuzgunxhuk kalova një ditë,

Kur, pa u afruar në qoshkun e Mollait, lëshohet një tufë
 Prej pothuaj pesëdhjetë qensh duke lehur...

- Mos e fsheh, a u trembe dhe u ule, Qose?

- Kurrë s'e bën atë që thua ti, Qosja;

Mund të më copëtojnë, por nuk më përmjerin dot sipër qentë!

- Atëherë, ngrihte shkopin dhe u afrove për t'i qëlluar...

- Por nuk më sulmuan... Ndërkaq, një goxha karabash
 Nisi të japë zë përballë...

- Mirëpo ky, i keq.

Roja i konakut, me siguri...

- Jo s'qënkej, prit, aman!

Ai lehu nga brenda, kurse këta trimat, nga jashtë

Dhe nisi një grindje me gojë e vazhdoi.

Karabashi pushoi pastaj, s'e di pse, qentë u shtruan;

Tani horizontet nga të qeshura t'argjendta kumbuan.

Thashë të shoh nga porta, por ç'të shoh tani,

Karabashi ishte bërë njeri, kaloi pranë beut të tij.

Unë po shihja i hutuar, kur zërat pushuan.

Karabashi që rrinte mbi këmbët e pasme, u shkund,

U bë një koçek me zile, i luajti barku me hop-hop e iu shkund

Sikur të kish pasur në bark një fëmijë pesë muajsh!

* Aludohet për filozofin e kohës, Riza Tevfik që pati dalë edhe në role komike.



Pastaj karabashi doli në skenën e teatrit popullor
Ku nisi të imitonte arabë, lazë, çerkezë, pomakë
S'matej dot me të i Pahundë Hasani
Dhe aq bukur, sa mbarova...

- Pa shiko!

Qen bir qeni na qenka!

- Po, një gjë që s'turpërohej shumë...

- A u bënë shumë bakshishe?

- Lëre, t'i mbledhë, o bir, e meriton...

Aq shumë qeshëm, sa pati që e lëshuan poshtë!
Ja, pra, vogëlush, gojëbilbili që shëtiti mbi këta shpatulla,
Që leh, që ka varur zile, që pastaj futet në teatrin popullor,
A nuk qe një klloun?

- Gënjeshtër!

- Karabash, eja, do t'i thoja...

- S'i ke thënë, apo jo!

- S'e di ç'thashë, por një çapkën që atje tej
E ndjeu, siç duket, dhe tha menjëherë: "Mos bëj gabim, sofi!
Atë që e pe, ishte me feste: filozofi i popullit tënd!
Ky dhe gjeni si ky e mbajnë vendin.
Nëse ti i sheh këto festa, kush ka meritë?"
I thashë: "Le t'i përmendim, numëroi, bir, një nga një,
Cilët janë, sa vetë janë këta gjeni!"
Njëri, sociolog; tjetri, politikan i tmerrshëm;
Pa le, ekonomisti ynë, i pari në dituri!"*
Numri ishte mbushur, por zerot ishin mbaruar te unë;
Lëre me kaq se kanë për t'u marrë mendtë!
Një frikë të tillë nuk e kam kaluar në jetën time;
Kaloi ajo ditë duke ia përngjasuar veten kurdit të mërzitur.
- Prapë do të fusësh në mes ndonjë anekdotë?

- A s'janë ata maskarenj që përshkohen si vaizë?
Thotë njëri duke goditur me grusht mbi tryezë:

* Aludohet me radhë për figurat e njohura të Kushtetutës së Dytë, Zija Gokalp, Talat Pasha, Xhavit Bej.

“Dëgjo se mbi ç’gjë qëndron bota, o trutharë!
Nën tokë ndodhet kau, nën të është një peshk,
Kurse nën peshkun, një det i vështirë dhe shkëmb”.

Hidhet kurdi që përtej:

“O hoxhë, a e ke me të vërtetë?”

“Ç’do me thënë me të vërtetë, o ti, xhaxha i pamësuar?
Fjalët e mia s’janë në erë, të gjitha në libër të botuar;
Kush nuk beson, ta dish se bëhet menjëherë qafir!”
“Atëherë, prej sot e tutje për mua s’ka më qetësi,
Thotë kurdi, më mirë po mbulohem në një gropë qysh tani
E të shpëtoj.

“Ç’zor ke, o njeri?”

“Prit, hoxhë, të të tregoj:

E shihja këtë botë dhe e pandehja të shëndoshë,
Por sa e kalbur na qenka, shihe fatin tim;
Po ta kap kaun, peshku s’do të rrijë i qetë.
Megjithëkëtë, ta zemë se peshku qëndroi se gjeti pak ushqim,
Po deti? S’i duket fundi kësaj pune; më mbulo të vdes!”

* * *

- Ç’i the anekdotës sime?

- Mjaft keq!

- Mos!

- Dëgjo:

Vendi po shkatërrohet me pesimizëm, pa shiko.
Unë që s’jam nga ata që shajnë etërit tanë,
I kujtoj të gjithë me ndjesë... Por jam i zemëruar.
- Pse?

- Nuk më futën dot në zemër një pikë shpresë,

O mësues; nuk rrohet në këtë botë duke prerë shpresë!
Ende nxënës shkolle ishim ne kur na vrau jeta,
Kurse nuk do ta njihnim frikën kurrë, sa keq!
Frikacak ishte brezi im se e bënë frikacak;
Në vend që të më jepnin zemër, “ec para, o bir!”,



Më ngulën para një të ardhme të frikshme,
Që edhe po të ngriheshin kas divat, s'do të ishte aq e frikshme!
Kur po dilja në botë, më thanë “do të zhytesh”...
Ç'mrekulli e marrë ta mësosh zhytjen pa hedhur hapin e parë!
Pesimizmin e njoh përmendësh, jo se zell s'kam;
Kështu më patën mësuar, a të pëlqeu, imam?
- Erdhi ajo e ardhme, por e ardhme jashtë të vërtetës.
- Le ta zëmë kështu, po faji kujt i takon?
Po të qe kush që të tregonte një dritë të vetme,
Ne do t'i kishim bërë një mijë copash ato errësira
E do të kishim dalë! Prej treqind vjetësh nuk zhvillohet rinia,
Sepse të mjerit i është shkatërruar besimi në të ardhmen.
Ndjenjë s'ka, mendimi i prishur, zelli, i paralizuar...
Ku është ai kundërshtimi në shpirtin tënd ndaj padrejtësisë?
E sheh të gjallë nga larg e i afrohesh: gjysmë...
U dogjëm duke thirrur etërit, ende digjemi!
Betohem në besimin tim që e quan pesimizmin herezi,
A s'na frymëzuan neve shpresë, apo kjo fe
E kishte përhapur përsëri botëve hijen e saj të blertë,
Përsëri zëri i të vërtetës e kishte mbytur zërin e mbrapshtisë.
S'është muslimanllëk ky, ne devijuar nga rruga jonë;
S'kishim një idhull për ta adhuruar, e kërkuam, e bëmë!
Ec, të të shohim, mbroje Allahun që e di për të madh...
A ka njeri që të besojë në ndihmën e Allahut, jo!
Kurse bota jote islame që i ka besuar pesimizmit?
Feja zyrtare ajo është, ajo, nuk ndryshon, pavarësisht se ç'thonë!
Në fillim ai besim i shëndoshë që i pëmbysi katër kontinente;
Tani në të gjitha katërqind milionë njerëz frikacakë!
Zbrit në Lindje, ngjitu në Perëndim, s'sheh dot lëvizje, emocion,
Si ka ndodhur që është mpirë gjaku në të gjithë bashkësinë?
Pse kjo fe madhështie, trimërie, e kursen për mua
Atë që u ka dhënë etërve të mi me të tepërt?
A kam, me të vërtetë, të drejtë të jetoj? Po! Asnjë logjikë
Nuk e mohon dot këtë, sepse është e qartë.

Atëherë, edhe kjo është e vërtetë e qartë: “Duhet të punoj!”

Por për këtë nuk kam vullnet, pra, jam një paralitik i gjallë!

- Pra, faji përsëri te e shkuara?..

- S’e di te kush...

Ka disa vite që shpulla e një çifuti më jehon në tru:

“Prano se Azia jote qenkësh shtatëqind milionësh;

Ç’del nga kjo? S’lëviz se ka ngrirë skaj më skaj.

Vërtet ne jemi një grusht njerëz, por e mbysim

Këdo në botë që shohim të mpirë, të pajetë!”

Ah, ku është ajo fe, ajo fe e vendosmërisë, e qëndresës,

Feja e tokës e zbritur nga qielli, feja e jetës?

Ç’është ky këndvështrim i ngushtë, i ngurtësuar?

Muslimanllëk the?.. Mos qoftë e thënë, ç’ne!

Kush është gjurma e frymës së Kur’anit në këtë fantazmë?

Si e barazojmë veten me islamin,

Me fenë që i është ngjitur pesimizmi nga ata që ia kanë ngjitur...

Ç’ngjitje e mallkuar, s’i përngjet asgjëje!

Vër re: Që nga viti njëmijë, një botë e madhe besimi

Me vlerat shpirtërore të prishura shtrihet e pajetë përdhe.

Zemrat, të mpira; gjakrat, të ndenjura;

Të zgjuarit e kthejnë jastëkun nga ana tjetër e flenë sërish!

Dielli që godet në tru nuk e shohin sytë!..

- Mirë, po si do ta ngacmoh këtë kufomë?

- S’është kufomë.

- S’është kufomë?

- Krejt e gjallë... veçse e mpirë...

Po të tregojmë zell e vendosmëri tani, e shpëtojmë;

Eja t’i japim zemrës së kësaj një shpresë të gjallë.

- Sa lehtë! Përpjekje të gjatë do, o ti, përpjekje të gjatë!

- E shtoj dhe unë përpjekjen time e bëhen bashkë;

Ja, pra, o shpirt, u bë e gjatë.

A ke fjalë tjetër për të thënë?

- Sigurisht që kam:



Ndihmën e Allahut s'e shtove, pa të ç'del?
- Mirë, po a s'është detyrë e robit ndihmën e Allahut të sigurojë?
Ai duhet të përpiqet, Allahu të tregohet bujar!
Mbahu pas shkaqeve dhe dil; ja rruga, ja miku që do të të ndihmojë;
S'e ke për detyrë të diskutosh për ndihmën;
Në vend që të rrish e të derdhësh fjalë, derdh djersë!
Përpiqu një mijë herë për qëllimin e fito një herë, të mjafton.
Po ato nëntëqind, o mësues, ku t'i lëmë?
- Edhe nëntëdhjetë e nëntë do, shtoji dhe ato!
- Ja, i shtova... Asnjëra prej këtyre nuk shkon kot;
Çdo punë e përpjekje e ka në arritjen e qëllimit pjesën e vet.
Dëgjo të të tregoj një ngjarje të vogël mjaft me rëndësi
Të ndodhur katër-pesë vjet më parë...
- Po të dëgjoj.
- Hysen Qazimin* e njeh, gjithsesi?
- Cilin?
- Biri i Kadri beut, or ti!
 - Hë, Qazim beu ynë!
- Ai është përpjekur shumë me bujqësi, e njeh bujqësinë...
- E pashë; ka dhe vepra për fshatarësinë... Dhe me mjaft vlerë.
- A s'mblidheshim një kohë
Për ta ndriçuar popullin?..
 - Po, "Grupi i Udhëzimit"***
- Ato vepra të gjalla për të cilat fole ti, më duket
Se sapo ishin mbaruar, kur i tregoi një ditë Qazimi dhe tha:
"Po e pa me vend Mexhlisi, të shtypen menjëherë
Dhe të dërgohen nëpër krahina, të shpërndahen falas,
T'i këndojnë njerëzit. Ne e pranuan këtë propozim,
Por e kundërshtoi Rexhaizade*** në këtë mënyrë:
"Janë vepra të shkruara bukur dhe, pa dyshim, me dobi,
Por, po të shtypen, a do t'i lexojnë? Pak shpresë kam gjithsesi;

* Hysen Qazim Kadri (1870-1934), biri i valiut të famshëm të Trabzonit, Kadri Bej, autori i Fjalorit të Madh të Turqishtes dhe mik i ngushtë i M. Akifit.

** Hej'eti Irshadijje: Ekipi i ngritur pas Luftës Ballkanike për të përgatitur vepra të dobishme për popullin.

*** Rexhaizade Mahmut Ekrem (1847-1914), poet dhe shkrimtar i njohur i periudhës së Tanzimatit.

Po, do t'i lexojnë pesë a dhjetë vetë e do të marrin dituri.
 Dhe, ndofta, shpenzimet e shtypjes do të shkojnë kot!"
 I thamë: Le të përgjigjet vetë autori!"
 U pranua ky propozimi ynë dhe na thanë "shumë mirë".
 - Ç'paska thënë, ta shohim, që paska folur shumë mirë?
 - E mori fjalën Qazimi e tha:
 "Zotërinj, bejlerë,

Ç'janë librat për të cilat bëhet fjalë? Për bujqësinë.
 Apologjinë, atëherë, do të jetë krejt e natyrshme ta bëj
 Duke u frymëzuar krejt nga natyra, nga dukuritë
 E krijuara nga Allahu që sundon mbi gjithë natyrën.
 E dini se edhe bimët më të imta që mbijnë vetvetiu,
 Çdo vit derdhin miliona fara jete
 Dhe vetëm pastaj mërgojnë nga pranvera e krijimit.
 A mund të mos mbetesh i mahnitur para mustardës së egër?
 Ose për kamomilin a mund të mos ndjesh respekt?
 Ç'tatim që paguajnë! Shuma e farave nga çdo lule
 Arrin në miliarda, vërtet!
 Domethënë se ka shkaqe që e detyrojnë natyrën
 Për këtë madhështi, për këtë shpenzim të gjerë që të mahnit!
 Ndryshe, ajo kursimin nuk do ta kish lënë mënjanë.
 E vërteta e kësaj pune: Krijimi nuk do as dëm, as qar,
 Vetëm kujdeset për vazhdimësinë e brezit,
 Vazhdimësinë e brezit ka për synim!
 Pse? sepse kjo është i vetmi qëllim i jetës,
 Ndryshe, kjo jetë do të bëhej jetë tjetër, e amshuar.
 Duke i shpenzuar të gjitha thesaret e veta,
 Krijimi arrin, kështu, synimin e vet.
 Megjithëkëtë, shumica qysh më parë e di se
 Këto miljardado të shkojnë kot.
 S'është e lehtë: njëra nuk mund të gjejë vend për të mbirë;
 Tjetra gjen vend, por nuk mbin dot.
 Kjo shkelet, atë e ha krimbi, tjetrën zogu i gjorë



Dhe shihni se, më në fund, vetëm pak fara kanë shpëtuar!
Kjo do të thotë se qëllimi i një shpenzimi aq të madh
Është vetëm shpëtimi i një grushti farë;
Se, për ta arritur qëllimin e vet, natyra
Bëka shpenzime dhe u treguaka shumë dorëlëshuar!
Mirëpo natyra s'mund të akuzohet për dorëlëshuar,
Është gabim; Ajo e bën këtë për të mirë!

Zotërinj, krijimi na jep shembull ne;
Na thotë: "Punoni shumë për qëllimin tuaj
Dhe kurrë mos mendoni për t'u kursyer!
Zotërinj, këto vepra tani do të shtypen
Dhe do të shpërndahen nga një mijë nëpër vend
Se duhen. Por na thonë se do të shkojë kot
Një pjesë e madhe e tyre; mirëpo,
Pa dyshim që kanë për të dalë ca pak vetë
Që do t'i mbledhin dhe lexojnë mendimet e shpërndara;
Ky është edhe qëllimi ynë: brezin ta shpëtojmë!"

- Me të vërtetë, s'ke ç'i thua, bre! Aferin, Qazim!
- I mjeri Eqrem atë ditë pati hequr dorë nga kundërshtimi
Duke thënë: " Të drejtës i duhet nënshtruar!"

- Aferin, Eqrem!"

Tani, o bir, po sikur të të them një ngjarje dhe unë?

- Thuaj, o mësues, po të dëgjoj!

- Aferin, o bir, dhe ty!

- Edhe mua më the një aferin, më në fund!

- Kadri beu ishte gjallë, në Trabzon ende vali.

Përsëri dikush e kishte mbushur Abdylhamidin

Që nga karakolli më thanë: "Imam, në Erzurum tani!"

Ishte dimër, ishte një kiamet që lëre, mos e pyet!

Më futën në një varkë; shpinën, të zbuluar,

Gunën s'e kisha hedhur, pastaj as jorgan, as dyshek;

U dridha katër ditë e pesë net...

- Sa shumë! Pesë net?

- O bir i mësuesit, sidomos gjemia jonë mezi na lëshoi
Me një mijë mundime në Trabzon, në breg.
Ndërsa sapo kisha zbritur e po sodisja, një goxha aga
Jep urdhër: “Valiu e kërkon për ta parë, pra, mos rrini,
Por dërgojini menjëherë bashkë me lazin në Konak”!
Rilinda përsëpari. Kaloi pak
Dhe u shfaq hoxha Mandall duke bërëtitur...

- Mos more, lazi ai qe?

- Ndoshta e di, vaizi në Xhaminë e Re.
- Ç’do me thënë “e di”? Hoxhën Mandall kush s’e njeh?
As fron, as kurorë, por sulltan që sundon mbi vetvetë!
Mos ka vdekur që s’e kemi parë asnjëherë?

- Qëkur!

Sa bukur e the, o bir, hoxha ishte sulltan, vërtet!
Nuk kishte në botë fuqi që t’i bëhej rob!
Po sikur ta shihje në ç’gjendje qe atë ditë;
Më keq se më parë...

- Natyrisht, internim!

- Në kokë një feste e rrudhosur; xhufka që nga maja
Rrinte e shikonte; pesë-dhjetë kat pé mavi.
E kish kapur xhufkën e shturur duke e lidhur nga jashtë
E duke menduar se s’ka për t’u shturur përsëri.
Çallma e rënë para, nga pas kish dhënë bel,
Pashë xhufkën që tundej, mbi të tel mbi tel.
Nën tufat, ata sy që zgjateshin nën vetulla,
Si qiell plot rrufe, digjeshe n’i sheh!
Pastaj një ballë kat më kat sikur të ishte hapur me hendekë;
Shikimi mbi të të bëhet një mijë copë.
Nga hunda e madhe zbret dhe lëshohet një tym çift,
Me këmbë e duar lidhur duke marrë frymë
Ky luan që s’mund të vritet; le të jetë dimër e furtunë,
Ka në trup vetëm një këmishë të mbetur qëmoti
Që i varet nga lart poshtë...



Por s'do t'ia dijë; edhe shan, edhe ecën;
Qimet e gjoksit i kanë ngrirë, ai lëshon zjarr!
Ofasi duke shpërndarë "mallkim për tradhtarët" me shumicë,
S'e di me kë më përngjau që më uroi, "i lumtur qofsh!"
Dhe më përkëdheli rënkuesi; sa shumë më kënaqi,
S'e beson; m'u duk sikur veshi një gunë të ngrohtë.
- Të shohim tani takimin me Kadri beun në zyrën e tij;
Vali i vështirë që ai njeri...

- Kishte kontribut edhe në dituri.

Po, o bir, u zumë me hoxhën Mandall dorë për dorë
Dhe pamë në fillim Qazimin; na mori me respekt ne
Dhe, pa pritur, i dërgoi shpejt valiut fjalë.
Qazimi në krye e ne pas u futëm atje.

- Vaj, medet, o imam, ti përsëri re në këto kala? Sa keq!
Hoxhë, ti përsëri u ngjite në Jëlldëz këtë radhë?
Ulu e trego, të shohim, sepse folën keq.

- Kush foli keq?

- Patëm pyetur në Stamboll dhe...

Ofasi u ul ngadalë këmbëkryq në kolltuk
Dhe tha:

"Prej kohësh e kisha një hall;

Desha të shkoja, mizorin ta paralajmëroja.

Xhamia jonë është larg, ai s'vjen atje; po ç'më pengon?

Shkoj unë te ai dhe arrita në xhaminë e tij.

Abdylhamidi ish fshehur pas kafazësh si gratë;

Goxha njeri! Ç'është e drejta, këtë s'do ta besoja!

Pallati Jëlldëz ish rrethuar me, ndoshta, pesëdhjetë mijë ushtarë!

Ata luftëtarë, ata burra të panumërt me feste të kuq

Llogariteni sa kushtonte namazi i një njeriu:

Vetëm mijra vetë të mbetur pa namaz mendo, jo shpenzim tjetër!

Maskarallëku që pashë më rëndoi shumë

Dhe thashë: Pse kjo e fshehur që kaq kohë?

Dil pak në shesh të ta derdhim hallin tonë!

Njeri je apo xhind? Askush s'të sheh

Sepse fshihesh buxhak më buxhak nga ne!
 Fshihesh, apo jo? Domethënë se ke frikë,
 Sepse fshihen burrat që kanë frikë!
 Dhe domethënë se ke faj meqë ke kaq frikë!..”

Veç kur ç'të shoh, dolën rojet nga pusitë si lugetër,
 Vrapuan dhe kush kishte fuqi, me shkelma, kush me qytë,
 Ma shtruan gjithandej lëkurën e shpuar...

- Pastaj?...

- Unë i kisha humbur ndjenjat më në fund...

- More, more!

- Si një ëndërr e frikshme që... Të nesërmen në mëngjes
 E pashë veten mbi det dhe u habita me këtë punë
 Dhe thashë: “Ta tregoj, Hamid, kur të vij, radhën tjetër unë!
 Pasi të marrë varka nga bregu i Lazistanit,
 Mandalli të kap përsëri ty një ditë, s'ke shpëtim!”
 Kadri beu edhe mua, edhe vaizin na la të kënaqur;
 Na veshi nga një gunë që për ne qenë kaftanë me shumë vlerë;
 Pastaj na dha dhe shumë pará...

- Nga xhepi i vet?

- Po;

Ofasi i refuzoi, unë i mora...

- Mirë ke bërë...

- Sigurisht!

* * *

Ja, pra, o mësues, ajo që duhet për popullin,
 Një besim i shëndoshë si te hoxha Mandall.
 E dridh, atëherë, botën, më beso, mjafton
 Sill në Lindje ti pesë a dhjetë zemra me atë besim!
 Cilindo hoxhë që ia ka përplasur syve valiut snob,
 E pyes: A përgatiti ndonjë nxënës i cili të lërë kokën
 Në rrugën e një të vërtete të parë prej tij hapur?
 Punë është vetëm të rrish e të kritikosh shkollat?



Nga fjala e thatë ç'del? Sitë boshe, saç pa brum!
Në qoftë e uritur shkolla jote, edhe medreseja më e uritur se ajo!
Edhe ajo prej vitesh nevojtare për ushqim ushqyes, edhe kjo!
E kanë pyetur devenë se pse e ka qafën të shtrembër,
"Po ç'gjë e kam të drejtë?" - U është përgjigjur!
Po të mos kesh punë, ngrije lart një profesion,
Por po ta masim, ndryshimi me të tjerat, sa një shpinë thike!
A më sheh mua? Sa pará poet të jem unë, Qoseja im,
Aq pará bën dhe dituria jote, kot që heq mundim!

"Roja zë një hajdut në vreshtë dhe vrapon te beu
E i thotë:

- E lidha hajdutin për këmbësh në një shtyllë!
- Për këmbësh, the? Domethënë, krahët i ka të lirë!
O birbo, ti qenke kokëtrashë! Tani i zgjidh...

- Kush do t'i zgjidhë?

- Pa shih! I zgjidh vetë po t'i ketë duart të lira...

- Pashai im,

Mos u shqetëso aspak!

- Pse?

- Sepse është fshatar...

- Ç'del nga kjo? Ka ikur, madje...

- A ka mundësi?

Zëre se unë s'e kam ditur se i duheshin lidhur duart;

Kështu, pra, as atij s'ka për t'i shkuar ndërmend

Ta lirojë litarin ndër këmbë!..."

Edhe ne jemi si ata, fshatarë, që kemi zënë një tokë,

Pra, mos të përpiqemi ta mashtrojmë veten kot!

Cili nga ne ka një tjetër vlerë? Të gjithë, një kokë!

A e ke medresenë ti? Sipas meje, ajo ka kohë që ka mbaruar.

Eja, ma trego, tani, Ibën Rushdin! Pse nuk ka më Ibni Sina?

Ku është Gazaliu, ta shikojmë? Ku janë tani

Si Sejji, si Raziu, katër-pesë dijetarë?

Dijetarët tuaj më të mëdhenj, ata që rrëmojnë në komentet

E veprave të këtyre dhe nxjerrin një ide të thatë!
 A mundet të plotësohen nevojat e kësaj feje
 Me vepra të shtatëqind vjetve më parë? Kurrë!
 Frymëzimin duhet marrë drejtpërdrejt nga Kur'ani
 Sipas percetimit të kohës duhet të shpjegohet islami
 Kjo s'bëhet me pretendime boshe, por kërkon dituri.
 Unë nuk shoh ndonjë njeri që ta ketë këtë fuqi,
 Ma trego ti! Rrëmo klasën e juristëve dhe gjej tre juristë islamë
 Me ide të qarta, shpirt të hollë dhe personalitet juristi të vërtetë!
 Janë të panumërta çështje që duhen praktikuar;
 Gjeje një metodolog të së drejtës islame, një të vetmuar!
 Me të tilla mendime të rrënuara nuk jetohet! Sa keq!
 Titulli i librit tonë të drejtësisë, "Mylteka",
 Kurse i metodës, "Mir'at"!* Po qe se pandeh që jetohet,
 I Baba Xhaferit je; jepi një të fryrë vetes, të shkojë!
 Kjo fe s'është fe të vdekurish, edhe ti e di;
 Ka lindur e gjallë dhe sa të ekzistojë kjo tokë,
 Do të mbet' e gjallë! Për ta bërë të besueshme këtë,
 S'ka nevojë për shumë fjalë! O mësues, meqë kjo fe
 Është fe e njeriut dhe e jetës, që njeriu të jetë me ndërgjegje
 Pranë Zotit, duhet të ecë bashkë me njerëzimin siç i ka hije;
 Po të thuash se kjo është e pamundur, shpirti i islamit asgjësohet!
 Mendo: po e humbe këtë shpirt, fundi yt si do të jetë?
 Sikur ofasi të kishte sipas atij besimi edhe dije,
 Tani bota do të ish mbushur me tevhid skaj më skaj!
 Ç'zemër, ç'zell, ç'vendosmëri ajo e tij!
 Ja, pra, këta janë ata që i besojnë nga zemra ndihmës së Allahut...
 Ja, pra, duke bërë fjalë për njerëzit për të cilët s'do të ketë frikë,
 Kur'ani plot urtësi vetëm këta robtë më të afërt ndaj Zotit i lartëson!
 Krijuesi ka emra pa numrim; por më i pari është I Vërteti, i Drejti.
 Ç'gjë e madhe për robin ta kapë për dore të drejtën e të vërtetën!
 Shokët e Profetit, në të ndarë për në shtëpi a punë

* Tituj librash të vjetër drejtësie me të cilët jepej mësim në kohën e osmanëve.



Patjetër e këndonin suren “Asr”.* Pse?
Sepse në atë sure të madhe, të fshehtat e shpëtimit rrinë!
Në krye vjen besimi i vërtetë, pastaj mirësia,
Pastaj e drejta, pastaj durimi dhe vendosmëria në këto.
Ja, o bir, njerëzimi! Kur të bëhen të katërta bashkë,
Nuk do të ketë për ty më disfatë kurrë!
Muslimani është i detyruar të jetë ndihmës i të drejtës për çdo çast!
Po të nisë plogështia në këto, ekzistenca e tij nisët të lëkundet.
Veçanërisht kur padrejtësia të shtohet gjithnjë e më shumë,
Ky detyrim fiton ndaj të tjerave më shumë rëndësi!
Sepse e drejta në kohë të tilla mbetet në rrezik
Që s’ka mundësi as të përpiqesh për ta shpëtuar!
Po qe se një njeri ngrihet e urdhëron drejtësinë në sy
Të një prijësi të padrejtë dhe ky prijës i padrejtë,
Në vend që të nënshtrohet, ta vrasë këtë njeri,
Në krye të shehidëve të rënë në rrugë të Allahut shkruhet ai!
Vetëm ai është pas Hamzait dëshmor me famë;
Sigurisht, kjo është grada e atij që jep jetën për të drejtën!
Ç’xhihad i madh t’i kujtosh të drejtën njeriut të padrejtë e mizor!**
Prandaj Profeti i dëlirë e pati quajtur atë “më i madhi”;
Kur merret nëpër këmbë e drejta, dhe populli, dhe
shteti poshtërohet!
“Ai ummet ku e drejta e të dobët nuk merret dot
Nga dora e të fortit, nuk fuqizohet dot!”***
- Ç’fjalë e bukur e thënë shkurt!
- Hutben e Omerit ke ndërmend, apo si?
- S’e di..
“O njerëz, betohem në Allahun që adhuroj,
Se kurrë nuk ka një të dobët në këtë bashkësi
Që në sytë e mi të mos jetë m’i fuqishmi ndër ju,
Që ta mbroj të drejtën tuaj te një i fuqishëm ndër ju!

* Asr, Koha: “Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (Kur’ani, el-Asr:1-3)

** Shih: Ebu Davud, Melahim, 17

*** Hadith i përcjellë nga Hz. Aliu.

Nuk ka një të fuqishëm që më del para në këtë bashkësi
 Kur ta kem rrokur për t'ia kërkuar të drejtën e më të dobët
 ndër ju!”

Ky njeri, në sytë e mi është më i dobëti ndër ju
 Ja, pra, kjo ishte rruga e përvijuar nga Omeri.

- Dhe ato që bëri, u përputhën plotësisht me fjalët e tij!
 - Se atëherë tundeshin shpatat; as bisht e as kurorë!
 E lehtë të ishte i madh në atë kohë me guxim e drejtësi!
 Të të rrethojnë ty grumbuj të mjerë,
 Dikush, i paturpshëm i stërvitur; dikush, i poshtër me shkollë;
 Natyra e dikujt, nga ndjenja e turpit, larg,
 Nderi i dikujt tjetër, mburojë mishi në rrugën për përfitim.
 Ai, pas bixhozit; ky, hajdut; për të në pyet, alkoolik.
 Ndërkaq, që të gjithë prishës, dallkaukë, dezertorë...
 Dil, po munde, tani, nga ky mjedis;
 Ç'do të bësh? Edhe në qofsh Omer, do ta kesh të vështirë...
 Aty nuk futet njeriu i mirë,
 Por, ajme, sikur një turmë insektesh përpiqen natë e ditë
 Ta nxjerrin nga udha njeriun e mirë!
 Veshi yt do të ketë mall, tani, përjetësisht për fjalën e drejtë,
 Fjalët e marra që volle, ose urtësi, ose e madhe dhunti!
 Por po s'pati kush t'i gëlltitë, po thua? Mos u druaj më kot;
 Dallkaukët duan me shpirt t'i gëlltisin ato.
 I gogësin te hunda, “oh, sa e këndshme”, thotë!
 Ti teshtin, ai të thotë: “ç'melodi e rrjedhshme, zotëri!”
 Ti pështyn në atë surrat të pistë, “ptu” me zë të lartë,
 Ai zgërdhiet dhe të thotë: “sinqeriteti ynë, i lartë, mos pyet!”
 Po pive, sofi, pijanec, të gjithë bëhen për ty saki;
 “Akoma pija haram? Rrofshi ju se kjo punë ka mbaruar!”
 Po qe dushman i nderit, të gjitha femrat janë për ty...
 Kjo ndenjja harem-selamllëk, ç'barbari!
 Atmosferë të kundërt s'ka, po të njëjtin zë dëgjon:
 “Personit tuaj të lartë edhe mileti, edhe shteti iu bëftë fli!”
 Interesi personal, e vetmja gjë që të kërcënon;
 Po dole në shesh si profet, hasmi të bëhet rob e të adhuron!



Ta zëmë se je sofi; tesbihe radhë-radhë tani;
Dallkawkët, mos qoftë e thënë, bëhen krejt njeri!
Çallmë me bisht të gjatë pas, xhybe, hirkë, krejt gjëra me dy fytyra,
Nga jashtë, si periudha e Omerit duket krejt.
Dikush i agjëruar, një tjetër në namaz, tavanet e shtrojet
Nga thirrjet “Kulhuvallahu ehad”^{*} rënkojnë..
Ti po të duash besoji këtij entuziazmi, gjithçka gënjeshtër;
Kur thuhet “Ai”, s’mendohet as Zoti, as dikush tjetër.
Sepse, meqë salltaneti yt është ai që ecën,
Tani për tani ti je, statuja e interesave, që të bëjnë adhurim;
Mos u mashtro, o njeri me pamje kuklle, o i hutuar,
Goja e njeriut, “samed”^{**}, qindra idhuj në stomak!
Sapo ta gjesh edhe ti vendin tënd me një shkelm,
Me çfarë pamje të jetë ai që vjen, të gjithë të tjerët
Identitetin e kthejnë si të atij shpejt e shpejt.
Ty çdo ditë të shajnë tetë-dhjetë herë me siguri.
Në ç’gjuhë të shëtit emri, nderi yt pa një vlerë?
Sa i shëndoshë qenka, po, ta kuptojë pasardhësi yt kokëtrashë:

“Ah, zotëri, ç’hajvan, ç’gomar qe ai!
Ne qemë që ia deshëm më shumë të mirën, edhe ne na prapësoi.
Ky është turp, thotë, kjo, edukatë, thotë, i jep iluzionit trup,
S’e di kokëtrashi se asnjëra prej këtyre s’ekziston.
Njeriu është bërë rob për fe, vatan, familje, popull, përjetësi,
ndërgjegje,
Për dinjitet njerëzor, nder, popullaritet, famë
Si dhe për shumë gjëra të tjera të sajuara si këto.
Të vërtetat nuk ndikojnë në trurin e tij si hudhër.
Emrin e ka Feniks, vetë kënaqet me gjëra të paqena.
Njeriut jo vetëm durimi i soset, por dhe emri vetë.
Vajza, gra, gjithë ditën të burgosura në shtëpi;
Shiheni këtë mendje: nderi, më e keqja barbari!

* Thuaj: Ai, Allahu është Një! Ajeti i parë i sures *Ihlas* të Kur’anit.

** Samed: i vetëmjaftueshëm.

Shampanja e tij në sofër, ende dhallë;
 Të paktën, nga shekulli i njëzetë mërzitu, o budallë!
 Le të pijmë për shëndetin tuaj shumë të çmuar! Pse jo?
 Ne, zotëri, japim edhe jetën për ju!
 Le të pijmë, të mos rrimë.. Të bëftë mirë! Gëzuar!”
 Pastaj, me radhë, gjerë e gjatë i shajnë ata që kanë shkuar!

Ta zëmë se udhëheqësi i ri është nga shkollë tjetër.
 Dallkaukët vënë një maskë të re
 Dhe menjëherë e rrethojnë anembanë:

“- Subhanallah!

Ç’natyrë kjo, ç’ndërgjegje që bart një kuptim të lartë!
 Personaliteti juaj, nga Zoti për ne, dhuratë!
 Thoni, kush jeni, mos vallë hazreti Musa?
 Atëherë, nga Faraoni kemi shpëtuar!
 Atëherë, populli ju gjeti ende vetë pa u shkatërruar!
 Ah, zotrote, ai që shkoi, një qafir i kuq qe,
 Asgjë nuk njihte, për çdo gjë mbante qëndrim të mohuar!
 As edukatë, as turp, as virtyt, as seriozitet,
 Gogësin si kërmë, por nuk e ka zakon të kërkohë ndjesë,
 Përkundër, të teshtin, pastaj, pa u drojtur, mu në hundë...
 E gëlltitim, ç’të bëjmë, me derrin kush hyn në ngatërrësë?
 Ta lëshon gëlbasën mu në mes të ballit
 Sikur po pështyn në tasin e pështymës në gurishte!
 Pyeteni për Allah, marrëzi; marrëzi për pejgamber;
 Ndjenjat e larta si feja, vatani, familja, kombi,
 Gjëra që u thokan për t’i mashtruar budallenjtë, sipas tij...
 Këto gjëra të sajuara kush i merr për të vërtetë?
 I mençur qenka ai që besoka se të gjitha kënaqësitë
 E jetës u dashkan plotësuar pa ndaluar.
 Mendimi për jetën tjetër gomarit i paska hije;
 A duhet t’i besojë njeriu një gjëje të tillë të paarsye?
 Dhe ç’do të thoka të mbahemi pas moralit ende pra?
 A durohet, zotrote, natë e ditë kjo bela?



Për njeriun, kënaqësia është e vërtetë, çdo gjë tjetër gabim,
Shumë e çuditshme se si njerëzit nuk e kuptojnë!
Ah, zotrote, ka ende shumë gjëra për t'i kujtuar,
Sepse nderit i binte në qafë ai lugat i tërbuar!
- Mirë, po pse i rrinit gjithmonë përreth?
- Keni të drejtë! Do T'jua parashtrojmë shkakun e kësaj!
Nëse çdo ditë, të mbështjellur ngushtë përreth tij,
I kemi gëlltitur ato pështyma me gojën plot,
Për vatanin e kemi bërë, vetëm për vatan, zotrote!
Po qe se nuk do t'i prananim ato poshtërime dje,
Sot vendi s'do të ishte më, Allahu e ruajttë, s'do të ishte...
Ta vrisje miletin për ato tri gëlbara, do të ishte mëkat!
Vetëm ne na respektoi sadopak ai njeri;
S'mbeti vetëm në kokë të tij, se, po të mbetej,
Do t'ua kishte shitur vendin armiqve e, veç kësaj,
Për Zotin, s'do të kishte lënë familje pa shkatërruar!
Shumë vetë gjenden për të vrapuar në luftë e jetën për të flijuar,
Por gjëja më e vështirë e luftës, dinjitetin ta bësh fli...
Këtë sakrificë jemi ne që e morëm parasysh;
Zoti e di dhe nëse peshku nuk e di!*O i zoti i dhuntive, tani ne jemi skllevërit tuaj;
Ju vetëm urdhëroni, të urdhëroni është puna juaj!"

- Tani, o bir, do të nxelesh, por, ç'të thuash, e kotë;
Kjo poshtërsi më bën për të ardhmen pesimist.
Kur sheh këtë gjendje, njeriu helmohet, s'di ç'të thotë;
A ka ndonjë brez tjetër që të na shpëtojë?
- Brezi i Asimit, o mësues!
- Ku e ke!
- Jo, s'ke të drejtë!
Ndoshta me tët bir këto ditë je shumë i zemëruar?
- Brezi i Asimit, thua... Ç'fantazi e gjatë!
- E nesërmja brezit të Asimit ka për t'iu nënshtruar.

* Aludim për fjalën e urtë, "bëje të mirën e hidhe në det, në s'ta di peshku, ta di Zoti vetë!"

Ta hapa ndërgjegjen ty, ta lexova, më dëgjo;
 Tjetër është ç'më detyron të flas, mos 'u zemëro!
 - Ç'profeci kjo?
 - E di ti, s'e kam zakon.
 - Mirë, po ç'vlera ka, biri im?
 - Ç'vlera? Fëmijët vrapojnë lakuriq, të uritur,
 Nga njëri front në tjetrin si luanë, pa u ndalur.
 Prapë, edhe te luani ka një frikë vdekjeje,
 Kurse këta fëmijë janë bërë një me vdekjen vetë!
 Secili front, në një kontinent, përreth, det;
 Toka, më e frikshme, as rrugë, as gjurmë.
 Lëvizjen po e sheh, mësues, më e lehta,
 Kaukazin ta zësh zbathur, Sinain kokëzbuluar!
 Në pandefsh se bëhet, zhvishiu edhe ti;
 Kjo lojë s'është më të zësh një qoshe, por një kontinent!

Kjo luftë e Gjirit të Çanakalasë ç'është, a ka të ngjarë në botë?
 Katër-pesë ushtri nga më të mëdhatë sulmojnë
 Për të kaluar në Marmara duke gjetur rrugë nga lart;
 Me sa flota e ka rrethuar një copë tokë?
 Ç'turmë e pafytyrë, s'duken horizontet...
 Është dalluar që është evropian, kudo ka treguar barbari;
 Gjithë egërsirat grabitqare, të pandjenja, grigja hienash,
 Janë lëshuar nga kafazi apo burgu dhe kanë ardhur këtu!

Bota e Vjetër, Bota e Re, të gjithë popujt
 Vlojnë si në apokalips, si rërë, si tufan;
 Shtatë klimat e botës të ngulen përballë;
 Sheh se Australia ka ardhur bashkë me Kanadanë!
 Fytyrat të ndryshme, gjuhët, lëkurët ngjyra-ngjyra,
 Vetëm një gjë kanë të përbashkët: egërsinë.
 Dikush, hindian; dikush një fis i egër; një tjetër, s'di se çfarë;
 Ky pushtim i turpshëm dhe mikrobin e leprës e turpëron!
 Ah, ky shekulli i njëzetë, ajo krijesë fisnike,
 Të gjithë elementët e vet të shquar, vërtet të pafismë



I volli dhe i nguli për muaj para ushtrisë sonë;
E derdhi paturpësisht të fshehtën që mbante brenda.
Ende fatkeqësi për ne do të qe ajo fytyrë të mos i grisej maska...
Orospia e quajtur “qytetërim”, me të vërtetë e pafytyrë.
Pastaj, mjetet që përdor për të shembur ajo e mallkuar,
Janë aq të frikshme, sa secila prej tyre mund ta shembë një shtet!

Atje tej rrufetë i copëtojnë hapësirat,
Tërmetet, nga ana tjetër, i ngrenë lart thellësitë;
Rrufetë bomba duke zbritur nga truri i çdo transheje,
Shuhen mbi gjoksin e atij ushtari si luan!
Nën tokë, me mijra hendeqe si skëterrë,
Qindra burra të hedhur të djegur nga çdo hendek.
Qiejt zbresin vdekje, toka, të vdekur sipër nxjerr;
Ç’furtunë e frikshme, copëra njerëzish hidhen tej...
Kokë, sy, trupa, krahë, nofulla, gisht, dorë, këmbë,
Zbrazen shpinave, grykave rrebesh, rrebesh.
Ato duar frikacake të blinduara
Hedhin tufane rrufesh kositëse, stuhi flakësh,
U japin flakë gjokseve të zbuluara
Avionë të panumërt që shëtisin në tufë.
Topi më i shpeshtë se pushka, gjylet të hedhura si plumba...
Shihe ushtrinë heroike si qesh para këtij rreziku!
As mburoja çeliku do, as tërhiqet nga armiku,
A pushtohet kalaja shumëkatëshe e besimit në gjoksin e tij?
Cila fuqi mund ta nënshtrijë atë?
Vepër e Allahut është ai istikam i sigurtë!

Rrethohen e zbriten pozicionet e fortifikuara,
Nuk mund ta presin vendosmërinë njerëzore gjërat e sajua,
Kurse këto gjokse, e fshehta e pafund e veprës hyjnore,
Thanë: “Ajo është vepra ime më e bukur, mos e shkel!”
Brez i Asimit... thosha; brez paska qenë, vërtet;
Ja, s’e la t’ia shkelnin nderin, s’ka për t’i lënë!

Pa shih, trupat e dëshmorëve, sa një mal...
 S'do të ishin përkulur kokat po të mos ishte ruqja në namaz;
 Të plagosura në ballin e pastër, janë shtrirë gjer e gjatë;
 Ç'diej perëndojnë, o Zot, për një flamur me gjysmëhënë!

O ushtar i rënë në tokë për këtë tokë!
 Po të zbresin etërit nga qielli, ta puthin atë ballë, e vlen!
 Gjaku yt e shpëton tevhidin, i madh je ti...
 Vetëm luanët e Bedrit ishin të famshëm si ti.
 Kush do ta hapë varrin që s'ka për të të ardhur ty i ngushtë?
 Po të të them "eja të të varros në histori", s'të nxë.
 Ai libër historie s'mjafton as për epokat q'i ktheve përmbys...
 Ty vetëm pafundësitë mund të të nxënë.
 Edhe sikur të ta ngul te koka Qaben, "guri yt" duke të thënë,
 Edhe sikur frymëzimin hyjnor të shpirtit tim ta ndjej
 E t'ia përçoj gurit tënd,
 Edhe sikur kupën qiellore ta marr e, si mbulesë,
 E t'ia shtroj sipër varrit tënd që kullon gjak, me gjithë yje,
 Edhe sikur me retë e zeza tyrbes tënde t'i ngre një çati,
 Edhe sikur Saturnin me shtatë satelitë prej atje ta zgjas,
 Edhe sikur dritën e hënës të ta sjell këtu pranë
 Ndërsa ti shtrihesh nën këtë abazhur i mbytur në gjak ,
 Duke e bërë që të presë si roje e tyrbes tënde gjer n'agim,
 Edhe sikur abazhurin të ta mbush me dritën e agimit,
 Perëndimin e purpurt dhe netët të t'i mbështjell në plagë,
 Përsëri nuk mund të them se bëra diçka për kujtimin tënd!

Ti që duke e thyer goditjen e fundit të ushtrisë kryqtare,
 Sulltanin më të dashur të Lindjes, Salahuddin*,
 E bërë të mahnitet pas madhështisë tënde si Këllëç Asllan!**
 Ti që kur islamin e kish rrethuar disfata dhe e mbyste,
 Atë rreth të hekurt e këpute me gjoksin tënd dhe e copëtove;

* Salahuddin Ejjubi (1138-1193), themeluesi i shtetit Ejjubi.

** Këllëç Asllan II (1155-1192), sulltan selçuk i Anadollit.



Ti, emri dhe shpirti i të cilit shëtit me të gjitha trupat,
Ti që po u gropose në shekuj, s'do të të nxënë... Ah!
Këto horizonte s'maten dot me ty, anët ty të vinë ngushtë...

O dëshmor, bir dëshmori, mos kërko prej meje varr,
Ty ta ka hapur prehrin e të pret ai Pejgamber!

- Lërmë, n'e daç Zotin, përsëri u dërrmova,
Mbylle atë defter të djegur, se u mallëngjeva...

Pa shih, po më zihet fyti e po rri, herë herë...
S'i urdhëroj dot as nervat, ki mëshirë!

- Le ta shoh, tani, ç'ishte ai halli yt i vështirë
Që ke qysh në mëngjes që nuk ma thua, nuk ma thua?

- Halli i Asimit i keq: shumë i zemëruar, ama shumë!
Gjer atje sa nuk dëgjon as këshillë, as qortim!

Djali është i gjallë, ç'është e drejta... Domethënë e teproi...

- Nuk e di, por si e ka nisur s'është për t'u pëlqyer.

- Qenka një ngjarje ramazani, ç'është?

- Të ta tregoj...

Zaten prej në atë kohë nuk e afroj më pranë!

- Ç'do me thënë?

- Sikur s'dalim bashkë jashtë.

Ky, i lëvizshëm; të rinjtë e tjerë, në thënç, të prapë.

Kush e di dhe sa marifete të tjera do t'u shohim, unë s'duroj dot!

- Mor, po ngjarjen e ramazanit, këtë më trego, or njeri!

- Nga Yskydari vinim të dy: Asimi dhe unë.

Ora ishte aty në njëmbëdhjetë.. Vaporin duke pritur,

Udhëtarët, a s'na e lëshojnë një tym cigareje Bafre në turi?

Ikë se ka për të dalë ngatërresë!

Jo, o bir, ndodhi si ndodhi, u ula pupthi e mbeta i topitur.

Qëndrimi i fëmijës kishte ndryshuar. I thashë: "Shih, Asim,

Po të kapesht me këta birbo, do ta dëshpërosh babanë!"

Njëri prej tyre, dhe, pa dyshim, më i paturpshmi,

Duke më fryrë tri frymë në hundë, më tha:

“Më thuaj, hoxhë, pse duhet lidhur pas agjërimit ende si hajvan?”
 Kur, natyrisht, pëllëmba e tim biri
 U lëshua mbi gojën e çarë të atij birbos së marrë.
 Siç duket kishte pak shpirt që iu rrokullis kufoma përbri...
 Gentë e vërtetë që ndodheshin atje pas,
 Vrapuan katër-pesë e ma shtrinë djalin mu nën këmbë.
 Unë isha hutuar, “o bir” kisha thirrur një herë.
 Falënderuar qofsh, o Zot, djali e mbledh veten përnjëherë
 Dhe ngrihet në këmbë si deveja e ngarkuar me qymyr
 Që, me një të shkundur, i hedh poshtë të katër thasët menjëherë!
 U thashë: Hë, tani ua rregullon shpinën mirë ky djalë i prapë!
 Dhe s’mbeti as gojë te trimat, as hundë;
 Te kush ra grushti i tij, e la si të paralizuar në vend!
 Kjo shaka e papëlqyeshme pati një fund të hidhur;
 Përreth asaj kasaphane kush vështronte,
 Qen shihte, me sytë tërë gjak, me fytyrat tërë gjak!
 Të gjithëve hakun për Allahun djali ua dha!
 Sidomos truri i njërit do të ish copëtuar
 Sikur katër ushtarë të mos i kishin dhënë grindjes fund.
 - Ta merrnim vesh, pse ndodhi kështu?
 - Sepse me tapanxhë sulmoi ky daja që nga larg.
 Falënderuar qoftë që çështja u mbyll me ushtarë;
 Sediljet erdhën, të plagosurit shkuan me policët bashkë.
 - A s’pati njerëz që t’ju nxirrnin juve fajtorë?
 - A mundej? Çudi!
 Më fal, o bir i mësuesit, kjo ç’marrëzi!
 A e pranon kush ndarjen e të drejtës nga e padrejta?
 Kjo botë, pa shiko: ngrënës e të ngrënë krye e fund!
 Kush nuk ia fërkon kurrizin të fortit?
 Kur të mbetesh poshtë, atëherë nis e qaj!
 Drejtësi e njeriut, përrallë, e drejta, e atij që sulmon;
 I rrahuri përzihet nga gjyqet sepse është i dobët;
 Djali im e paskej mësuar përmendësh këtë, e thoka kudo...
 - Fjalë të drejtë, pastaj, natyrisht, kapadaillëk ka në kokë!



- Kapadaillëk, shumë bukur, por kjo rrugë s'ka fund;
Mos o bir këshilloje dhe ti pak,
Sepse unë kam frikë, po t'i flas tjetër herë,
U bëmë si shumë të afërt, kam frikë, do më dalë kundër!
- Ç'do të thotë? A të kundështon Asimi ty?
- Sipas meje, çdo mundësi duhet menduar në kohë.
- Mësues, si djali yt s'mund të gjesh dhe po të kërkosh,
Nuk kam gjetur unë njeri të tillë pa asnjë të metë.
Ç'krijesë e madhe ai Asimi, ç'përmendore e dalluar!
Po qe se atë frymëzimi hyjnor si një vjershë heroizmi
Ta ka ofruar, hapja zemrën e përpiqu për ta kuptuar!
Ndoshta djalin gabim e sheh, gabim!
A mos vetëm përmasat e gjoksit i sheh të lartë?
Zbrit dhe në thellësi shihe, ajo zemër sa e thellë!
Detin e besimit që dallgëzon e derdhet jashtë,
Ndjenjat që i derdhen ia shih: më të pastrat inxhi!
Trupin, përmendore prej shkëmbi të vështirë,
Ndaj vdekjes, indiferent sikur të mos kishte fare ndjenjë...
Por shihja dhe shpirtin, ç'delicatesë pa kufi!
Po ta shqyrtosh, se shpirti i një femre më delikat.
Pastaj, nuk gjej dot fjalë të them për diturinë e tij;
Çdo gjë që ka mësuar djali, çdo gjë që di, e saktë.
Qafën, të tmerrshme, po dhe trurin, të gjallë;
Koka me zverkun bashkë ecën në zhvillim.
Kësaj radhe unë me Asimin në shkretëtirë u takuam shpesh.
Mësues, të siguroj me besimin që kam në Zotin një,
Nga biseda e tij u përpoqa të kap një pjesë
Sepse cilësitë ia njoha nga afër shumë.
Sa shumë që bëmë mundje, sa shumë që vrapuam,
I thashë se "në çdo gjë je zero!" dhe e entuziazmova.
Ditët që na kaluan në atmosferën e qetë të shkretëtirës,
Më treguan krejt se djali yt është i pashoq.
Një botë më vete me cilësi të pafund ai djalë;
I shumanshëm, por, njeri!

Nuk e harroj kurrë, një fitore na pati rënë në pjesë;
 Ushtarët kishin organizuar mundje dhe gara.
 “Eja, Asim”, i thamë; ai “s’bëhet” tha; ne s’e dëgjuam;
 Gjetëm dhe një gjunjësore të trashë e ia vumë në gjunjë;
 S’thamë që qenkësh i plagosur, i zhveshëm tre vetë,
 Doli djali i shkretë ku vërtitej kundërshtari në shesh.
 Por ç’harmoni qe ajo në trupin e djalit të ri!
 Kuptohej se krijimi kishte punuar më vete mbi çdo organ.
 Ç’eshtra të shëndosha, ç’mishra të forta
 E kishin mbushur trupin nga koka në thua;
 Në trupin e një lisi të shtuar në tri pjesë.
 Sidomos ai gjoksi i dalë e i derdhur,
 Muskujt e pashëm me dallgëzimet e tyre
 Që e magjepsin shikimin mbi to të lëshuar.
 Sa të gjera supet, trupi aq i gjatë në masë,
 Ç’kokë e rregullt, pastaj, ç’qafë e shtrënguar!
 Një derë e vogël, përmasat e fryra të shpinës,
 Dy krahët e përsosur përplasen e rrinë pa duruar.
 Ajo vijë e thellë, ajo e çarë që zgjatej nga zverku në bel,
 Vetëm një shtat tani duket me gjerësinë e humbur në thellësi.
 Vithe të gjera si supet, muskujt e këmbës të gjerë sa qafa,
 Krahët si degë pishë, kush do t’i kapë, kush do t’i përkulë?
 Duart dhe nyjet më të forta se hekuri,
 Plagët i japin trupit një të veçantë bukuri;
 Një pamje e tillë trimërore që njeriut i shtie drithma në gji.
 Edhe kundërshtari, një djalë i shëndoshë ishte,
 Por sulmi i Asimit a do t’ia dijë për fuqi?
 E shkund të shkretin si man, këtej e matanë;
 Ç’është ajo? Çapraz? Hyr menjëherë se i yti është mejdan.
 Ah, tjetri i shmanget dhe me sa lehtësi!
 Aman, Asim, kjo mundje mos të jetë e sajuar!
 Na e trego ngjyrën e vërtetë të kësaj pune ti!
 “S’e mundka dot atë: e para, s’është kategori e tij
 Si dhe i gjori njeri na qenka një gjë mjaft e sajuar,



Do të ishte dëshpëruar keq po të ishte mundur.
Mirëpo a e drejtë qenka të shtrish përdhe
Një trim që lufton me armiqtë gjithë ditën i lodhur!”

* * *

- E kuptuam, çdo gjë, bukur, s’ke ç’i thua... Por
T’i kishim gjetur një zgjidhje këtij hallit tim më parë!
Ngjarja e ramazanit, çdo ditë, o bir i mësuesit, çdo ditë;
Pa le sikur ditët të jenë me bereqet, katër-pesë vakte!
Pothuaj është kthyer në çmenduri... Dhe shkaku kryesor
I kësaj çmendurie, mijra shokë dëshmorë të djegur të varrosur.
Mendoj se pas plagës së fundit do të urtësohet pak...
Pastaj, durim ndaj gjendjes? Mjaft e vështirë?
Ç’intriga thuren, mendja të tronditet t’i dëgjosh!
Për mua, o bir ky gjak si lumë është i kotë.
Ajo që pak më parë e quajte “Lufta Botërore”, maskarallëk,
Më qesharak se dhe Karagjozi, pesë para s’i vlen.
Perdja u hap, puna e humbi çdo lloj kuptimi,
Kushdo që vështron, i sheh fytyrat e përvjedhura në errësi.
A durohen, të lutem, kaq shumë dhimbje dhe varfëri?
Për vite hoqi populli, tani s’ka më fuqi;
Eja dhe ti, tani, dhe binde kokëtrashin me “vatan dhe millet”;
Fjala e fundit e gjyshit që i është djegur zemra: “s’durohet!”
Ndërsa unë vdes nga varfëria e ti jeton në mirësi,
Nuk besoj që evlijatë t’i thonë kësaj “ejvallah, drejtësi”!
Pamja e vendit, si gërmadhë, pa shih... Por
Kurrsesi mos e ngacmo, është plagë zemre për të ardhur keq.
Zëra njerëzish gjëmonin në këto hapësira dikur...
Pyeti horizontet, ku janë ato kohë, ajo njerëzi?
Vendi i blertë ka marrë ngjyrë dheu të zi,
Heshti harmonia e mijra jetëve e nisur në përjetësi.
S’njihet sot numri i atyre që flenë të pangrënë,
Çdo vatër e varfëruar, një varr familjar!

Po më vdes, o bir mua kjo heshtje gërmadhë,
 Çdo ndërtesë të shembur që ta prekësh, këputet një e qarë!
 Të sëmuret, me mijra, s'i sheh kush; të shëndoshët, lakuriq;
 Të vdekurit janë bërë turrë, kush do t'i heqë?
 Ndërsa nga njëra anë këto ngjarje të dhimbshme
 E brejnë vendin, nga ana tjetër një tufë ujqish
 Të huaj, të pangopur kafshojnë si hiena
 Kufomat e të mjerëve; s'dëshiroj që kjo të jetë
 Udha e fitores së fundit që iu ra pas!
 Hytë në luftë duke thënë "e pashmangshme";
 Ta dimë, a dhe kjo fëlliqësi është e pashmangshme?
 - Ama e zgjate shumë o, mësues, të vimë në çështjen e vërtetë!
 Për ç'po flisnim ne, e ku e nxore ti!
 - Ja, pra, o bir, shkaqet që e trondisin shpirtin e djalit,
 Zemra, e shembur; truri, gërmadhë; përpëlitet pa pushim.
 Dhimbjet e cilit të mjerë t'i pakësojë?
 Në ndihmë të kujt të shkojë?
 Sa shumë janë ata që po jetojnë e heqin në mjerim!
 Me cilën shtëpi në zi ta ndajë dhimbjen e saj?
 Mijra oxhakë, pa shih, janë kthyer në një grumbull hi!
 Cilin të dobët ta ngrerë që kërkon ndihmë?
 Qafën e cilës çetë të mallkuar ta këpusë më parë?
 Shtëpia jonë, gjykatë; gjykatësi, pastë bereqet, i shpejtë;
 Natën jep vendim, ditën vrapon ta çojë në vend!
 - Ç'na duhet, dora e tjetrit shumë praktike!
 - Lëre mos e pyet shqetësimin që po heqim ne:
 Kur vjen mbrëmja, fytyra e vajzës i ka ikur krejt;
 Duke u shqetësuar tërë frikë për të vëllanë që ende s'ka ardhë,
 Më ngulet para... Zoti është i madh, them dhe bëj durim;
 Mua kush do të më qetësojë, unë jam më keq se ajo!
 Më rëndojnë mbi tru qindra dyshime të frikshme;
 M'i trondisin të gjitha nervat, s'bëj dot asnjë punë.
 S'e njoh më orën: gjashtë, apo shtatë;
 I tendosur, plot emocion: erdhi a s'e erdhi djali!



Mbrëmë më humbi durimi e i thashë:

“Asim, pa dëgjo!

Kthehu sa s’është vonë, mos u përpiq kot, kjo rrugë s’ka të dalë.

Vrapon, por do t’i biesh murit me kokë

Dhe do të copëtohet atëherë koka, mos, hiq mënjanë.

Ç’rrugë të vështirë ke zënë, si Ebu Dherri.*

Polic në kohën e Omerit të paktën të ishe;

Atë mejhanen ta bastisje mos kishe për detyrë?

Po ata kumarxhinjtë pse i kërcënove?

Ndërsa fëmijët e hallkut të mbledhur dëfreheshin atë natë,

Me ç’të drejtë shkove e i rrahe të gjithë si i marrë?

Kapi ti sarhoshët pse kanë thirrur e ndiqi pas...

Të paktën shko e bëhu roje, budalla, e merr pagesë!

Pse i ndan gruan me burrin me detyrim?

Pa shiko, komshinjtë ta kanë ngjitur nofkën “qehaja qeros”!

Ka marrë peshk! Pastaj i ka dhënë të hajë! Ç’del prej kësaj?

Sikur një kohë s’ka ushqyer edhe vetë zagat!

Ty s’të ka thënë gjë; është ulur e ka kafshuar gjuhën;

Pestilin tjetrit pse ia shtrin, o bir?”

Tani s’jam unë që flas, por yni Asim Bej:

“Veprimet e mia ju bezdiskan juve... gjë e madhe shumë!

Baba i dashur, s’është ashtu, mos i vini re se ç’thonë;

Dëgjomëni dhe mua, kam apo s’kam të drejtë.

Çdo njeri i uritur pret në shpinë të kalldrëmit...

Ju shkoni hapini të gjitha perdet

Dhe pini që t’ju shohin të gjithë!

Mor burra! Tregoni pak respekt! Pini fshehtë!

Të kredhur në tufan mezeje, hidhni kulaç;

Shihni nga penxheret popullin që gëlltitet, pa numrim.

S’keni pará, apo jo; unë kam, të them me qese plot;

A keni të drejtë të hidheni në dëfrim kur të gjithë janë pa ngrënë?

Eja, jahu, mjaft... keni pirë shumë madje;

* Ebu Dher: një ndër shokët e Profetit, i dalluar për mënyrën e veçantë të jetesës së islamit.

S'bën të rrini, shpërndahuni, ndoshta jeni nga larg...
 Të paktën të mos ma kishin vënë re; më thanë zhduku, shko.
 U thashë: "Kujt t'i takojë të zhduket, ai do të shkojë!"
 I zura për krahësh e i hodha një nga një jashtë;
 Thoni, në ka faj këtu, mos vallë është tek unë?
 Le të vimë tani te kërcënimi i kumarxhinjve. Po,
 Ndërsa në të gjitha shtëpitë njerëzit mbyten në pa dritë,
 Njeriu s'mund ta durojë atë festë të përvjedhur nga ai klub:
 U digjka, thonë, në javë, një sandëk gaz!
 Natyrisht, unë këtë shpërdorim s'mund ta duroja;
 E transportova karburantin sandëk sandëk.
 Një masë të vogël, thashë, e gjeti, më në fund, bakalli;
 Morën të gjithë vajguri si vaj trëndafili, nga pak, nga pak!
 Ç'u ndriçua sokaku, një festë e vërtetë!
 Mos pyesni errësirën e copëtuar: u fshi tri ditë!
 Baba i dashur, ja e keqja q'u bëra kumarxhinjve, kaq;
 Veç kësaj, një mijë lira mora për jetimët,
 Me të mirë e me të keq!

Le të vijmë te dëfrimi në grup; a ia keni zgjedhur kohën?
 Ose po të dëfrehen si njerëz, kush u thotë gjë?
 Takëmi i tregut të zi na qenka; as turp, as edukatë!
 Të varfër e të uritur të rënkojnë, bota të japë shpirt,
 Ju prapë të dëfreheni, të mos ia kuptoni zinë!
 Tërhiqeni zvarrë gjer në vdekje atdheun tim të shtrirë!
 Në të djathtë, qindra të vdekur, në të majtë të zvarritur pa numrim;
 Të rrish e të qeshësh përballë tyre, ç'do të thotë, vallë?
 Mos rrini, merrni pjesë në hallin tim
 Megjithëse e di se është mbi fuqitë tuaja!
 Të qash nuk qenka kënaqësi për të gjithë,
 Por, më duket, të mos qeshësh, është mjaft e mundur për çdo njeri!
 Ruhuni nga komshinjtë, me zë të ulët bërtisni
 Se, po u dola lart, pastaj, ju bëj të heshtni krejt!
 Është fjala ime e fundit për ju... Më kot; kush të dëgjon?



Më hodhën nga çdo dritare fjalë të marra e pa vend!
Natyrisht që s'mund të rrija..."

- Prit, o bir, mjafton me kaq!

- Më falni, nuk ka mbaruar...

- Dëgjomë, një herë, pastaj, mbaro!

Më trego tani mua: Ky oxhak i mjerë
Nga mbretërimi i përdhunuesve kur do të shpëtojë?
O i marrë, a mund të qeveriset një vend me këtë logjikë?
Në një shoqëri ku ata në krye i bëjnë punët me grusht,
Koka ka mbaruar, hiqja bishtin të shkojë!
A është e drejtë e fuqisë të rrahë kë të gjejë?
Ne, o Asim, as grushti i këtij na duhet, as i atij;
Vetëm kthetra e njërit na duhet: ligji është ai.
Jepja tërë fuqinë ligjit që uniteti të ecë...
Ndryshe, nuk je komb, por një kope e shpërndarë...
Prandaj vendi, pa shih, rrëmujë;
Po të veprosh dhe ti me ndjenja, e fundos, pa fjalë.
O bir, vendi i atij që qeveris me idenë e shtetit policor,
Nuk është mbi tokë, por nën tokë!
- Nuk është ashtu, baba i dashur...
- Nuk të dëgjoj më, shko!

* * *

O bir i mësuesit, hallin e vërtetë ti nga vajza jonë e dëgjo;
Kokëtrashi yt me ca të tjerë të marrë e konsideron Portën e Madhe...

- Mos!

- E ka bërë plan ta shkelë...

- Pa shiko!

Mirë, po, kush është ai që e rregullon këtë? Nuk pandeh se...

- Mos, o bir, ngjarjen ma tregoi krejt vajza Melek.

Vajza pak pengesë për vendosmërinë e tij, ndryshe, keq...

Edhe shkel, edhe var, gjë shumë e marrë; e besojmë!

- Thuaji, është punë fort e përgjakur, të mos gënjehet ta luajë.

- Mua s'më quan gjë, më kot... Vetëm ti je

Si dhe e motra njerëzit që mund ta përmbani atë.
 Aman, o bir, mos ma lini mua këtë të marrë!
 - Jo, xhanëm, heq dorë, gjithsesi, a është vërtetë i marrë?
 - S'mund ta di, kam frikë, qëkurse vajza më ka paralajmëruar.
 Po të ish puna si ato ngjarjet e mëparshme, po,
 Ndoshta gjeja pak guxim për t'u ngushëlluar.
 Por, o bir, e sheh: perdja e vënë, shumë për t'u pasur frikë:
 Fund e krye, gjak, brenda e jashtë, gjak!
 Sikur një damar të plasë, rrebeshi e merr me vete vendin,
 Zoti mos na e tregoftë atë fund të hidhur!
 - Përsëri e teprove, më duket...
 - Aspak;
 Ti shihe gjendjen: me të vërtetë, vështirë.
 Eja, le të themi vështirë, a nuk ka asnjë shpëtim?
 - Ka.
 - Ç'është, atëherë, kaq shumë emocion, kaq shumë shqetësim?
 S'kam emocion, por zvarritja e kësaj çështjeje,
 Sipas meje, s'është aspak e drejtë. Po, njeri është tjetri;
 Po sikur të mos e pyesë vajzën e djali që e ka humbur mendjen,
 Të nis të veprojë përsëri, ç'bëhet atëherë?
 Mendo, më parë, o bir, rrëmujën që ka për t'u krijuar;
 Më duket se është krejt gabim mendimi se unë e teproj.
 Jo, s'e gjej të drejtë gjykimin se unë e teproj!
 Edhe unë jam mjaft i qëndrueshëm, për më tepër, mjaft i moderuar.
 Pa pyetur për afër, për larg, për të nxehtë e për të ftohtë,
 Ky djalë ka vite që shkon në luftë duke kërcyer!
 Kur i thashë "mos shko"? E dërgova duke i thënë "vrapo!"
 Kur e përcolla thashë "shkon e s'kthehet prapë"
 S'do t'i shkoja më pas, sikur ta kisha harruar,
 Do të merresha me të vëllanë e mbetur në shtëpi.
 Të gjitha familjet po shemben, tërmeti vetëm për mua po bje?
 S'e hap dot plagën unë ndërsa mjedisi heq shpirt!
 Nuk e kuptoj të emocionohem unë për tim bir!
 Po fëmijët e të tjerëve, ç'janë? Çdonjëri trim, çdonjëri xhan.

Në tokë apo në qiell? Eja, të të shohim,
Vetëm je?

- Vetëm erdha, zotëri, këtë radhë.

- Sikur t'i sillje, xhanëm, këta...

- Sikur ta dija...

- Të lumtë! Ç'është e drejta, fëmijë si margaritarë!

Duhet ndjerë kënaqësi kur sheh këtë brez kaq të mbarë!

- Edhe unë t'ju paraqis tani mirënjohjen time

Që m'i pëlqyet kaq shumë shokët e mi më të dashur!

Zotëri, xhaxha, e patë, për Allahun, njeriu ca gjëra...

Mirëpo nuk ngrohet, s'di pse. në një farë mënyre babai.

- Nuk ia merr mendja babait, dëgjomë mua ti!

- Shkrimet e reja tuajat ku janë, zotni, t'i lexonim;

I kërkova, te askush s'janë...

- Edhe në pastë, tre-katër librat e mi

Pandeh se nuk e kënaqin dot personin tuaj të lartë:

Kënaqësia juaj e përgjakur, sigurisht që kërkon poezi të përgjakur!

- Edhe në qoftë nxitëse, e pranojmë ne, zotëri...

Një karakter ka me të cilin s'pajtohemi ne: të jesh pa gjak, pa jetë,

Sepse për kombet përtacia, ç'është e drejta, është me rrezik.

- Letërsia jonë, pse s'thua ti, Allahut amanet!

Krejt si yt atë je, Asim, sido që të jetë!

- Po, s'është mjaft përkrahës im atë...

- Mos pyet, i keq!

Sot, për të gjithë letrarët, pa përjashtim,

Bëri për shpirtrat e tyre një urim...

- Mos!

- I thashë: Nuk jemi të denjë për kaq poshtërim?

"Kush je ti?" - Më tha; ta dish si u bëra!

Unë si poet përshkohesha, shihe tani këtë ti!

Ç'gjë e keqe të tallesh me hallin e komshiut!

- Sigurisht!

Nuk ka në botë një veprim që të mbetet pa ndëshkim!

- Po, o bir, vetëm ku janë ata që marrin mësim?



Bisedë letrare u bëka në një vend disi të madh.
Pse të gjitha veprat tona të pafuqishme? - Thonë.
Në këtë udhë të gjithë thonë nja-dy fjalë;
Gjindet, më në fund, ku qelbet peshku:
Poetin e madh, të famshëm që Lindja ka tri mijë vjet
Që e pret ditët duke i numëruar, nuk e ka nxjerrë
Ende t'ia vërë vendit mu në prehër.
Nuk e ngopka dot shpirtin tonë kombëtar asnjë shkrimtar!
Meqë pa dalë ai gjeni në skenë të kohës,
Netët janë shtatzënë, fëmija herët a vonë do të lindë.
Por ti tani shih gjendjen e fundit ku ka hyrë puna:
Cili rapsod e ka marrë këtë dhe lajmi
"Kush jam unë" për ditë të tëra goditka tërë djersë?
Pastaj, dhe në pastë qëndruar, thanë zemërimi ende i vështirë;
Si bilbili që ha man, qenka mbyllur në vetvete nga hidhërimi.

Pata qeshur me këtë, po, nuk do të qeshja, o bir;
Shpejt e shpejt drejtësia e Allahut tha: "Prit tani, robi im,
Ti që atje ku duhet qarë, qesh me ha-ha-ha;
Ja ç'ke bërë, ja ndëshkimi, vuaje të të shohim!" Ejvallah!
Babai yt që gjëmon më keq se një daulle,
Krejt me ata që zgjohen nga ëndrra më ngjasoi mua!
- Jo, zotrote, s'pandeh të bisedojë aq ashpërsisht;
Megjithëkëtë, babai s'ka të drejtë të bëjë kritikë.

Tani, Asim, lëre letërsinë më njërën anë
Se kemi punë më serioze; të kalojmë në tjetër temë.
Ndoshta s'kam thënë gjë? Po, asgjë:
Mjeshtri më i madh i Egjiptit, Muhammed Abdu,
Duke folur, për çfarë të ishte me Xhemaluddinin,
I thotë Afganiu nxënësit:

"Muhammed, dëgjo!

Përmbysje kërkoj, jo tjetër, dhe shpejt e shpejt!
Po qe se nuk dalim para ne e ta ngremë islamin,

Mos pandeh se bëhet diçka duke ngritur teori!..
 Edhe argumentet që i vërtetojnë këto, mjaft, mos i bëj t'i
 dëgjojnë,
 Sepse s'ke nevojë ta tregosh se sa i aftë je!"
 - "S'ka dyshim, Mjeshtri ka shumë të drejtë...
 Të shkojmë diku, madje te ky Sudani ynë,
 Të ngremë një medrese të re për arabët në shkretëtirë,
 Të gjejmë dhe katër-pesë njerëz me moral të lartë që të luftojnë
 E të merremi me rregullimin, lartësimin e brezit të ri.
 Të nxjerrim, o mësues, Xhemaluddinë e t'i dërgojmë
 Në botën islame vend më vend..."
 - "Por kjo do njëzet vjet kohë që s'më duket e lehtë...
 Ti shih ndonjë punë për njëzet ditë!"
 - "Robi yt, sa keq që këtë punë s'mund ta bëj!"

Sikur të nxjerrim mësim nga kjo ngjarje, ç'thua Asim?
 E kupton, pra, s'ka dëm, të merremi vesh më mirë:
 Edhe unë përmbysje kërkoj, por si Abdu...
 Jo të bëhem vegël qorre në duart e të tjerëve dhe,
 Si kapadainjtë, të shkel Portën e Lartë, të var të tjerë!
 Hiqi nga kjo punë të gjithë shokët, hiqi dhe vetë.
 Mos shëtisni në shesh, o bir, futuni në një vrimë
 Dhe, po qe e mundur, nesër drejt e në Europë!
 - Zotni, xhaxha!
 - Mos fol kot, Asim, nuk të dëgjojmë...
 Sepse ti je një njeri, kurse ne, të shohim, a jemi si ti?
 Unë, yt atë, pastaj Melek... S'i mban dot çfarëdo që të thuash...
 Shih ta mbarosh arsimimin sa më shpejt ta mbarosh,
 Sepse, o bir, për t'i ngritur kombet lart,
 Duhet dy forca: dije dhe moral i lartë!
 Në fillim dija popullin do ta bëjnë të lumtur;
 Sigurohen të gjitha mjetet, pastaj, duke ardhur morali i lartë,
 Ai i merr të gjitha mjetet e bëra bashkë
 Dhe i përdor për ta ngjitur vendin lart!



Po qe se një shoqëri nuk ka fuqi diturie,
Vetëm me moral nuk ngjitet dot lart, bie e dobët përdhe;
Ajo plogështi e paorientuar, tipike për primitivitet
Zbret në sistemin nervor, kurse ai nga kjo i kënaqur krejt!
Ta zëmë se ka dituri, por moral të lartë jo!
Ja, kjo është për shoqëritë njerëzore një rrënim i pafund;
Kjo është plaga që e helmon shpirtin njerëzor.
Ç'bela është ajo: më e keqe se murtaja!
Ne jemi bij të një kombi të madh, o bir,
Me periudha me moral të lartë, të shkëlqyera!
Ai moral nuk u bashkua me diturinë në zhvillim
Të treqind vjetëve të fundit dhe, duke u fundosur edhe populli
Në injorancë, fuqia në trupin e saj, duke u paralizuar
Çdo ditë e më shumë, pësoi një rënie që,
Edhe sikur të përpëlitet për të kundërshtuar,
Është e dënuar të ulet e të ngrihet me urdhrin e Perëndimit,
Sepse i mungon fuqia teknologjike që siguron epërsi!
Ne, vërtet, meqë nuk mundëm të merrnim pjesë
Nga fuqia e shkencës dhe teknologjisë së armikut,
Nuk shpëtuan dot nga kjo gjendje poshtëruese!
Pastaj, për shkak të vuajtjes nga mungesat për shekuj,
Ai moral i lartë sot është i pandjeshëm, i pajetë!
Tani, Asim, më thuaj, po të duash, mua ekstremist
Ose tjetër ç'të duash, Lindja është sot larg
Edhe nga morali, edhe nga dituria!
Por a do, o bir, të gjesh pak ngushëllim?
Shih të gjithë faktorët shoqërorë, fuqitë shoqërore.
Forca e secilës prej tyre është sa rrënjët që u zgjaten
Në të shkuarën; sepse më i shëndoshi, më i larti
Prej këtyre faktorëve, është ai me rrënjët më në thellësi!
Tani ti, po qe se i krahason fuqitë tek ne, do të shikosh
Se morali i lartë në këtë komb është ai që mbështetet
Në rrënjët më të thella; veç kësaj ai ka një ujë
Të shenjtë që kurrë nuk than: feja islame!

O bir, ngjarjet kurrë të mos të bëjnë pesimist ty;
 Dy a tre të rëna s'na ndajnë ne dot nga e kaluara jonë!
 Meqë rrënjët e pemës janë me të vërtetë thellë,
 Ç'u bë se iu këput një degë? Po se i iku trupi, ç'del?
 Ja, tek sheh se ai përsëri i çan epokat sipër tij,
 Shpërthen e lartësohet në horizontet tona të shkatërruara;
 Përsëri njëmijë oaza shtrihen në besimin tonë të përcëlluar.
 Në të vërtetë, në mes me qindra të këqia notojnë,
 Por ti këtë makth shpjegoje jo për të keq, por për të mirë,
 Sepse asnjëra prej tyre s'ka vend në zemrën e popullit tonë!
 Në kërkofsh, gjithçka marifeti i pesë a dhjetë vetëve maskarenj!
 Prandaj, të mos ju trembet aspak, o bir, syri;
 Vetëm në shkencën e Perëndimit ta ktheni fytyrën,
 Së bashku me djemtë natë e ditë të bëni detyrën;
 Diturinë treqindvjeçare të ikur ta fitoni me forca të bashkuara.
 Burimet e panumërta të dala në truallin e teknologjisë,
 Edhe pijini, edhe ujrat e tyre të dobishme sillini në atdhe.
 T'ju punojë mendja, o bir që të njëjtat burime
 T'i gjallëroni edhe këtu!

Më parë ti ke thënë:

“Sa keq që ne ende

Jemi të huaj edhe për shkencën e djeshme, madje,
 Jemi injorantë. Ja, pra, mungesa e diturisë
 Së nëpërkëmbur, e ka rrëzuar brezin në atë dobësi,
 Që fuqitë natyrore të vendit tonë ne nuk kemi mundësi
 T'i komandojmë sa të huajt! Shkenca e të nesërme ç'është?
 Energjia atomike! Ajo që e preokupon atë që ka fuqi!
 Ka shumë koka që mendojnë si ta sundojnë atë forcë
 Dhe shumë punë shpenzohet pa ndalim.
 Pasi ta gjejë atë, bota do të hyjë një tjetër trajtë,
 Sepse nga një dorë qymyr do të sigurohet;
 Një fuqi jo me miliona, por e pafund!..”



Merr mësim nga fjala jote, bir, puno!

Më duket se ke edhe një vit!

- Po!

- Shiko sa lehtë!

Po ata shokët e tu të shtrenjtë?

- Shumica nga gjashtë muaj.

- A do të shkojnë të gjithë bashkë?

- Shkojnë, e di.

- Dega që ka zgjedhur secili, e fortë?

- Po, e secilit, një shkencë ekzakthe.

- Meqë rruga e transformimit është vetëm kjo,

Shkoni duke thënë, “ku je, ej gjidi Berlin!”

Gjashtë muaj, një vit përpjekje për ju, do të thotë dëfrim...

Për ju që me vite të tëra ç'hoqët dhe duke qeshur!

Çdo dita juaj që shkon, vlen sa një jetë;

Një ditë e më parë shkoni, kthehuni një orë e më parë!

Prehri i Lindjes i hapur është atëherë për ju,

Atëherë e keni të mundur të arrini në synim,

Atëherë të dëgjoj gjerë e gjatë ty, Asim...

- Nesër në mbrëmje shkojmë.

- Ashtu, ë? Të uroj lumturi!

18 shtator 1919
22 Dhulhixhxe 1337



Libri i shtatë

HIJET



*Të vetmit gjeni arti të Lindjes,
Sherif Muhjiddinit,
në shenjë respekti**

* Sherif Muhjiddin (1892-1967), muzikant i madh i kohës, i respektuar shumë nga poeti si për mjeshtërinë e tij artistike, ashtu dhe për moralin e tij të lartë.



DISFATA

Unë nuk do të rrija kështu duke parë gjuhëlidhur.
Do të bërtisja fort islamin nga gjumi për ta zgjuar.
Vrapojnë vetëm trutë e kulluar, me besim të kulluar,
Fundja unë isha larg nga të menduarit gjerë e gjatë!
Bërtitu! Po kujt? Ku janë të zotët e këtij vendi!
Pashë djathtas, pashë majtas, ata që flinin qenë të huaj;
E kapa për fyti kufomën e klithmës time,
Ia bëra një mijë copa, në poezinë time e groposa dhe e lashë.
Kur rënkimet e mia do ta mbështillnin luginën si shtrëngatë,
Rrodha si lot që zbret fshehurazi, pa bërë zhurmë aspak.
Nuk ka gjurmë nga dhimbjet e mia në këtë kube të shurdhër;
Dhimbjet e mia në *Safahatin* tim, madje, rënkojnë pa zë, heshtur!

Stamboll, tetor, 1919

LINDJA

Perëndimi si makth i përgjakur mbi krye pa e lënë t'i hapë sytë;
 Islamit prej shekujsh pothuaj i kanë shteruar mendtë, fuqitë.
 “Botën e Lindjes e shëtite - më thonë - ç'pe?” Pashë, këtu-atje,
 Shtete të shkatërruara, kombe pa krye, vatra të shtrira përdhe;
 Ura të shembura, kanale të çara, rrugë pa udhëtarë,
 Fytyra të rudhosura, balle të padjersitura, krahë të tharë;
 Shpina të kërrusura, gjaqe që nuk vlojnë, qafa të holluara,
 Kokë pa mendim, zemra pa ndjenjë, ndërgjegje të ndryshkura;
 Padrejtësi, robëri, nënçmim, poshtërsi,
 Shprehi të neveritshme, sëmundje të ndryshme, dyfytërsi;
 Oxhaqe të zëna nga merimangat, që s'tymojnë, pyje të djegura,
 Ara mbetur pa mbjellë, shtëpi q'i ka zënë bari, të lashta të mykura;
 Imamë pa xhemat, fytyra të palara, krye sexhde pa parë,
 Besimtarë të mjerë që, në emër të fitores, vrasin besimtarë të tjerë;
 Shtëpi të shkreta, fshatra pa njeri, çati të shembura,
 Ditë pa punë, mbrëmje pa mendim për të nesërmen, të mekura!..

Eca dhe qava duke ecur; ndenja e qava duke ndenjtur,
 Shumë vendeve të shkatërruara iu drejtova pa m'u përgjigjur;
 Përballë, varreza që zgjaten e zgjaten, një tjetër botë,
 As një fytyrë që të qesh nga toka, as nga qielli që të qesh një dritë!
 Klithmat e qindramijra dhimbjeve vijnë nga thellësitë,
 Në qafën e përkulur të islamit, horizontet një rreth i kuq i zjarrtë!
 Gjokset shfryjnë në mundim, zinxhiri të shtrëngon, të mbyt;
 Treqind e pesëdhjetë milionëve të mekur, shpirti u ka ardhë në fyt!

* * *

Zoti im, a mos vendet që pashë u bënë djep për njerëzim?
 A prej këso shkretëtirash gjithë qytetërimet historike morën
 përparim?
 A ky është vendi i atyre që besonin në një Zot, sot pa vizitorë,
 A nga këto rëra dolën, Zoti im, aq pejgamberë?



A nga këto qiej, o Zot, reshuan fetë e tua
Kur mbi boshllëkun e botës ende s'kishte rënë rrufeja e parë?
A këto janë malet e Nuhut, brigjet e Ademit,
Yjet që i tregonin rrugën Ibrahimit?
A nga kjo tokë janë mbrujtur Meka, Medina, Jerusalemi?
A këto lugina e dehën Davudin duke ia jehuar meloditë?
A kryevepra të këtyre horizonteve janë shpella Hira, mali Sina?
A nga këto gurë buruan të fshehtat e profetit Isa?

* * *

Kur Perëndimi gjëllonte në egërsi, a s'lartësoheshin qiejve
Tempujt rreth Nilit, piramidat, Muri i Madh Kinez, pallatet sasanite,
Kopshtet e Babilonisë, pallatet plot gjelbërim e dritë?
Ajo kohë e shkuar, Zoti im, mos është një ëndërr e shembur tani?
Ç'të bëjë, ta presë shpresën nga zgjimi i Lindjes
Shpirti ynë i dërrmuar tek kthehet duarbosh nga prania jote e lartë?
U mërzitëm tejet ne, tani, nga këto mungesa, kjo dhimbje
të mbarojë!
Zoti im! Ku e ke një frymë të ngrohtë t'i dridhë ndjesitë e ngrira?
Duke e shkundur, më në fund, makthin nga sipër njerëzit e shtrirë,
Të thonë, "edhe unë kam të drejtë të jetoj!"
Kur bota këtë kërkon t'ua mohojë!

Stamboll, 19 shtator 1918

BALLET DUHET TË DJERSIJNË

N'sa bota përmbysëj, ti ndenje e sodite
 E sot, në vendin tënd je një i pastrehë, një endacak!
 Ke të drejtë të jetosh, por duhet të bërtasësh për këtë të drejtë!
 Kubetë, të shurdhëta, dëgjojnë një zë: Jetësim i kauzës!
 Kur e ngrej në zërin për të drejtën male, fusha pa kufi,
 Kush e dëgjon një viktimë që qan ulur në vetmi?
 N'sa ti ende hiqesh zvarrë si fëmijë qumështi nëpër dhé,
 Veç kur sheh se njerëzimi është ngritur në këmbë dhe si?
 Hapësirën qiellore e ka pushtuar tej e tej!
 Vullkane ka rrafshuar, në mendjen e botës i shëtit;
 Skëterra ka përmbytur, në zemër të oqeanit i vërtit;
 Gërryen thellësitë, nga epokat e krijimit gjurmë zbulon;
 Horizontet shpon, ca gjëra nga të fshehtat e Zotit parashikon;
 Toka i është nështruar urdhrit të tij, koha shkon duke
 iu nënshtruar,
 Sa hidhur, ai kërkon të urdhërojë pafundësitë!

* * *

N'sa natyra zotëron mijra forca të çelikut, me ç'sundim dërrmues
 Mbretëron një krah i brishtë! Ec e shih e mbetu i mahnitur!
 Jo, s'është një krah, por miliona krahë
 Që punojnë së bashku se janë të detyruar të punojnë të bashkuar!
 Ç'është sot fitimi i punës individuale? Vetëm dëm e humbje,
 Djersë e derdhur kot, nga ballët veç e veç e pikuar!
 Tashmë bota ka ndryshuar, për individualizëm s'ka më mundësi;
 Edhe sikur të ikësh nga qyteti në shkretëtirë, në një vend të humbur,
 Do të shohësh se s'jetë vetë, koha e jetesës së përbashkët është tani!
 Në s'daç të ngordhësh, në s'paç qëllim të humbësh pa gjurmë,
 Mos e sulmo islamin duke kërkuar të shpërndahet kjo bashkësi!
 Dhe në u largofsh nga besimi, mos u ndaj nga bashkësia.
 Dëgjo, është një e vertetë që s'mund të hidhet poshtë:



“Ndarja nga bashkësia, nga Zoti ndarje do të thotë!”
Për ç’arsye e lartëson ateizmin e poshtër në vend të besimit,
Kështu i shkatërron edhe individët e bërë trokë prej dërrmimit!
Pa shih rreth teje kombet që janë si një trup i vetëm;
Mëso ç’është bashkimi, nga bashkimi i tyre merr mësim!

Në daç të ngordhësh, tjetër punë! Por kam frikë se u dogje!
Kur je nën kular, të drejtë jete e vdekjeje mos pandeh se ke?
Ti je i tyre që kanë frerët e tu në duar;
Në do pjesë nga jeta, do të pranosh të ngarkohesh si gomar
E të shtypesh, të rënkosh, të shtrihesh, të hiqesh zvarrë;
Vdekja është lumturi e fundit në këtë botë për ata nën fre!
Dhe sikur njëmijë herë të thuash “jam njeri”, kush ta pranon, e pse?
Jo, vetëm për sa kohë të ruhet e drejta, liria, njeri je!
Kjo e drejtë, kjo liri kërkojnë nga ne sot përpjekje të gjerë:
Ç’janë dy-tre balle? Të derdhet djersë nga ballet e një vendi të tërë!

Stamboll, 3 tetor 1918

A TA MERRTE MENDJA?

*"Hyra në dhomë, e mbylla derën dhe nisa të qaj;
atë ditë gjer në mbrëmje, për vetminë e islamit,
për shkatërrimin e muslimanëve qava e qava..."*

*Sebilurreshad**

*Ataullah Bahaeddin,
një nga muslimanët e veriut*

Në rrugët nga shkon, as dhe një fytyrë e njohur s'duket;
Ç'mërgim ka rënë mbi islamit në hapësirat e tij?
A mendoje se xhamitë kanë për të mbetur jetimë,
Se një brez i pashpresë do të qajë pas ezaneve?
A mendoje se, ndërsa minberet prisnin të falej xhematin,
Do të shihte katër shtylla të ngulura, ndërsa mermeri i shtrirë?
A mendoje se tavanet e çara nga pesha do të rrëzoheshin përdhé,
Se në pragjet do të mbinte myshk
E në mihrab merimangat do të bënin fole?
A mendoje se nga kubetë e ndërtimeve të shëndosha
Të shembura gur-gur,
Një klithmë e fundit të ngjitej gjer në qiell nga këto shembje?

Dëgjo: Ende horizontet rënkojnë nga vazhdimi i gjëmimit të qiejve
Të shkakuar nga shembja e një bote katërmëdhjetë shekullore!
Përreth teje, ç'sheh, atmosfera, çdo vend në zi;
Vër veshin: mijra botë në zemrën e një zije përpëliten prore!
Sa e hidhur është të mbushin sot rrënojat e besimit monoteist
Klimën e begatë të asaj toke që ka nxjerrë profetë!
Ndërsa përreth shëtisin mijra të këqija kundër islamit,
Milionë besimtarë përtojnë, "të dalim e t'i pengojmë" s'thonë!
Për shkak të nënshtrimit në mënyrë mesquine për breza të tërë
Ndaj një grupi të poshtër, është fshirë nga kujtesa
Emri i prirjes për të mirë; perdeja e turpit nga fytyrat ka rënë...
Ç'fytyra të shëmtuara paska mbuluar një perde aq e hollë!

* 3 tetor 1918, nr. 372.



S'ka më besë, fjalë, amanet; gënjeshtër, pará që shkon në treg,
Mosmirënjohja, sjellje e mirë, e drejta s'njihet e ç'është!
Zemrat, të ngurta, ndjenjat, të ulta, dëshirat, të pavlerë;
Kuptimi që shpërthen nga shikimet, nënvleftësimi i robve të Zotit!
Mendjet rrëqethen, o Zot, ç'përmbysje:
As fe ka mbetur, as besim, feja e shkatërruar, besimi, dhé!
Gjërat për t'u mburrur të ziejnë e shkojnë, ndërgegjet të pushojnë;
Përsa kjo shembje morale vazhdon, as mund të flitet për pavarësinë!

* * *

Ti, o bashkëbesimtar i pashpresë, sikur shpresove prej nesh;
Në fund re në pesimizëm, qave, na bëre të qajmë, rënkove.
Zemra m'u përmbys nga lotët e sinqertë, m'u ngrit peshë,
Por zia nuk e shpëton vendin të rrethuar nga skëterra;
Shoqëria duhet të zgjohet, por jo me lotë të fshehtë!
Duhet punuar, rrugë tjetër s'ka! Po si? Me shpirt, me mend!
Të djersiten ballet dhe e sheh se si zbret në çast mëshira e premtuar;
A thua s'e merr të drejtën populli që ndihmën e Zotit ka fituar?
Allahu im! A s'ka një dorë të mirë të fuqizuar Teje,
Ta kapë Lindjen për dore për ta nxjerrë në dritën e synuar?

Stamboll, 24 tetor 1918

MEHMET ALIUT*

O bir, si një libër i madh dhe shumë i vlerë në dorën tonë ti qe:
Te unë veten tënde e lexoje dhe unë, veten time te ti!
Kur lartësimi yt ma lodhi aftësinë për të të arritur,
I hyra poezisë për të të arritur me zemër.
Fillimi i poezisë paska qenë harmonia eternale në krijim...
Por unë atë harmoni as e dëgjova, as te të tjerët e përcolla!
Një shtëpi të madhe jetëgjatësie e shemba e, si një korb,
Mbi ditët e shkatërruara të dyzet e pesë viteve u ula.
Ti vazhdove të ngjitesh duke gjetur horizonte të tjera,
Unë vazhdova të qëndroja e të përpëlitesha te gjermadha ime.
Në pastë dëgjuar vendi im dy-tre elegji plot ankth,
Kurrë nuk dëgjoi prej meje një zë të këndshëm.

Stamboll, 4 korrik 1918

* Nxënësi shumë i dashur i poetit, për të cilin ka një kushtim në fillim të librit.



A ENDE TË PËRFYTEMI?

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"E mos u përçani mes vete,
e të dobësoheni e ta humbni fuqinë..."*

(Kur'ani, Enfal: 46)

*Kur individët të thonë "unë", "ti", uniteti priset
Dhe atëherë për kombet kiameti fillon!
Zbrit në të shkuarën dhe shëtitë të gjitha kohët
Dhe do të shohësh se ligji i Allahut nuk ndryshon!*

*Historia, ajo gërmadhë e përgjakur që dimë ne,
Në miliona gurët e varreve, miliona epitafe fsheh;
Kuptimin e mjerë të një fati shkruar në ballë bart
Çdo copë e gurëve të varreve bërë mijra copësh mbi dhé!
Në mundsh t'i bashkosh ato copë me dorën tënde,
Do të dëgjosh fjalët e tyre të flasin qartë:
Çdo gropë, një bashkësi, këta që shtrihen, fiset;
E njëjta aventurë i sjell në këtë fund të gjitha fiset e bashkësitë!*

O vizitor i hutuar, a dëgjove?
Të njëjta qenkan të gjitha shkaqet e asgjësimit të bashkësive!
Por nuk e di a do të ishte e drejtë t'i sillja dëshmitarë
Të shkuarën, popujt e shkuar? Sa keq!
Ç'do të thotë ta shpenzosh kot kohën me historinë
E një brezi me ditët plot ngjarje sa për disa shekuj?
Për më tepër, të hetosh thellësitë e të shkuarës
Për të marrë shembull, është e kotë:
Horizontet e gjithësisë dhe gjallesat me provat e Allahut është plot!
Ata që shohin kah sekretet e dukura në to,
E kuptojnë se ku qëndron për bashkësitë fryma e pavdekësisë!
S'e di se pas kujt jemi lidhur e kemi mbajtur shpresë,
Ne që para atyre provave kemi mbyllur sytë!
A ka ndonjë këshillë në botë që mbi Lindjen të ndikojë për mirë?
Mijra fatkeqësi nuk vlejten për të marrë këshillë!

O popull i vdekur, dielli u fundos, zgjohu!
A ende zhurmat e rrebesheve, rënkimet e horizonteve
Që trondisin shtetet e botët, të vijnë si nina-nana
Për gjumin tënd që po vazhdon prej qindra viteve?
Një sërë popujsh që bëhen pothuaj një miliard,
Përpiqen me zell gjer në fund për të gjetur jetë,
Ndërsa i kanë të ndryshme gjuhët, racat
Moralin, idetë, botët, klimat...
Janë njësuar ata për qëllimin ku duhet arritur, ajme
S'gjen shenjë uniteti në një grusht njerëzish si ne!
Të gjitha grindjet për të rrëmbyer një post;
Akoma do të përfytemi? Ç'padituri, kjo ç'turp!

“E morëm lirinë!” - thanë dhe ne
Kësaj gjëje të padukshme i besuam
Dhe ajme, në këtë lojë prapë ne u përvëluam!
Shoqërinë thamë ta ndajmë në parti dhe u përçamë,
Një legjendë për “krahinat turanike” sajuam
“Legjendë, madje synim!” thamë, goxha energji harxhuam
U shembën shtyllat që e mbanin popullin të bashkuar në këmbë!
Sa vendeve, kështu, u thamë lamtumirë,
Lërinë ata që ikën, t'ju dhimbset ç'ju mbeti ky vatan!

Stamboll, dhjetor 1918



JO PESIMIZËM!

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"Tha: "Askush nuk e humbë shpresën në mëshirën e Zotit të vet,
përveç atyre që janë të humbur".*

(Kur'ani, Hixhr: 56)

Por ja që as dhe një frymëmarrje shprese s'ka tek ti!
"Vdiq" - po thua? Ah, a duhej ta vrisje atë ti?
Drita e përjetshme e Allahut s'mbytej, o mizor,
Nesër do të shohësh se ç'errësirë!
Nëse thua se ecën pa të, të jesh i sigurtë se s'ecën dot!
Për vite të vështrosh, një shkëndijë s'do të shikosh!
Në tru të uturijnë dallgët e netëve,
Në vorbull vret ballin tek vrapon iluzioni yt!
Horizontet t'i mbështjell dëmi e humbja,
S'i gris e s'kalon dot, o udhëtar i mbetur në rrugë,
Udhëtar i jetës, natës tënde të gjatë!
Shpëtimi është jo në qiej, jo në dhe, por tek ti,
Pra ndize flakë shpirtin që e quan të vdekur,
Që të hapet një copë në mjedisin tënd perdja e mbyllur!
"Një copë" - them sepse u turbullove,
Nga drita e përjetshme e preve shpresën e ngrive!

O zemër beson në Allahun nji, që hutohesh duke iu falur Atij!
Vetëm një zemër rron pa ideal, zemra e pabesim!
A mund të bashkohet mungesa e shpresës
Me besimin në një Zot të vetëm? Kurrë! Ti e di!
Atëherë, pse e ke përkulur qafën e rri?
A s'ke hiç mëshirë qoftë edhe për birin tënd të zemrës?

Lindëm dhe në djep, "për ju s'ka jetë" - na thanë;
Dhe e kaluam pragun duke e ditur botën varr!
S'na bëri zë kush për ndjenjë të jetës, të gjallërisë;
Çdokush si të ish korbi, vajtojci i përjetshëm i vendit,

U kujdes të përvetësonte frymën e turbullt të pesimizmit!
Kjo shartesë e mallkuar e mpiu një brez dhe e la!
Klithma “shteti do të fundoset” të tingëllojë në tru
Dhe ndjenja e përjetësisë te populli të mos shtypet? Ku!
“Shteti do të fundoset!” Ja, kjo e vrau rininë;
Dil heto e shih, a ka fuqi të lëvizë?
Edhe sikur mijra rreziqe ta sulmonin në katër anë,
S’do të fundosej ky shtet po të mos thoshim ne kështu!
Megjithëkëtë, jo, nuk u fundos, nuk do të fundoset
Përderisa ti e ngordh pesimizmin që ulurin,
Dhe e zgjon zellin e vendosmërinë!
Mjafton një frymë besimi për t’i dhënë jetë atij;
Të të veprojë shpresa, ç’është ky pesimizëm, kjo varfëri?
Fillo t’i heshtësh dhimbjet e paharruara të së kaluarës,
Tharmoje tët bir me një tharm ideal të së ardhmes!
Mbështetu te Allahu, kapu pas përpjekjes, bindiu urtësisë...
Në ka rrugë, është kjo; unë s’di rrugëdalje tjetër drejt mirësisë!

Stamboll, 30 tetor 1919



PAS ZELLIT, NËNSHTRIM

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"...e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun..."

(Kur'ani, Al-i Imran: 159)

- "Të mbështetemi te Allahu? Për shekuj u mbështetëm!
Në paçim rënë në këto dhimbje, në zjarrin e Tij u dogjëm!
A s'mjafton koha e fëmijërisë për përralla?
Akoma s'u maturua ky ummet?
Mund të thuash: Le të zgjohet në horizonte një dritë;
T'i japim zjarr të shkuarës, të digjet skaj më skaj!
Ringjallja e ideve të vjetra na çon në hutim,
Shih se si vrapon si e marrë bota për të përparuar,
Mjaft dëgjuam përralla një kohë kaq të gjatë;
Unë s'bindem, shko, po deshe, ti e bindi ca truthatë!"

- Te Allahu, jo, te iluzionet që adhurove, u mbështete;
Nëse u dogje, u dogje se e meritove...
Dhe me dije e me dashje e paralizove zellin,
U shtrive, si paralitikët vazhdimisht ndenje shtrirë!
Meqë s'ngrihesh dot, s'mund të punosh
Sikur eliksir të pish, beso, nuk mund të jetosh!
Në pastë, vërtet, një të drejtë për të jetuar,
Kjo s'është absolute, por me një detyrë e kushtëzuar!
Janë kushtet e vëna nga Allahu, së cilave gjithë botët
U nënshtrohen me një nënshtrim të padiskutuar!
Edhe ti do të tregoheshe i matur, s'do të rrije indiferent
Po ta njihje këtë në zemrën e krijimit tek rreh!
"Iu nënshtrova Zotit e mos dil prej shtrati...
O injorant, ky është kuptimi i mbështetjes te Zoti?
Mos pandeh se patën fjetur me shekuj etërit e tu;
Ndryshe, ku do ta gjeje këtë vatan ku jeton?
Për këtë janë dëshmitarë gjurmët që rrjedhin gjak
Vende-vende në të pesë kontinentet!

S'bëri pushim një ditë ai brezi i madh muxhahid;
 Po qe se nënshtrimi do të thoshte dembelizëm,
 A do të mund të jetonte populli me trashëgimin e fesë?
 Prej kohësh do të ishte shuar drita e islamit në botë,
 Kur'ani do të kthehej te Zoti, s'do të qëndronte dot!

“Bota vrapon”! Fjalë është kjo? Me të bashkë
 Të vraposh edhe ti! Sa keq që zellin e le pas!
 Meqë u zgjove nga ato gjumëra të gjata,
 Eja, të paktën lëviz, se ata që të rrinë pas zverku,
 Të shkelin me këmbë si kufomë pastaj
 Dhe ringjallja jote mbetet për kur të fryjë Briri;
 Të shkel, posi, pse të mendojë e të të lërë?

Lëviz pak, po të them, se do të humbësh me gjithsej!
 Ndërsa bota vrapon, në mes të rrugës s'rrihet shtrirë;
 Njeriu që s'do të lëvizë, nuk hidhet në këtë shesh!
 Gjeje ardhmërinë, bëhu tok me ata që vrapojnë;
 Mos u nis ta shembësh të shkuarën në këtë rrugë
 Se kam frikë, pasardhësit, paraardhësve do t'ju bëjnë hyxhym;
 A mund të ketë të ardhme një popull me histori të rrënuar?

O udhëtar, zgjohu, ndryshe del në një mëngjes
 Ku ka vetëm një shkretëtirë të thatë; as dritë, as vesë!

Stamboll, 13 nëntor 1919



SULEJMAN NAZIFIT

*Sa të jetë bashkë shpirti im me këtë besim,
Pret treqind vjet, pesëqind vjet, pa mbarim...*

*S. Nazif - Ishulli i Maltës**

Të presësh pesëqind vjet? Si do të presësh?
Të ta heqë shpirti këtë dështim për shekuj?
Tmerrin që më rri përpara, e cilësova menjëherë
Si "dhimbje", por fjalët nuk mjaftojnë të përshkruash
Errësitat që m'i kanë mbështjellë horizontet si skëtërrë!
Kemi kaq shekuj që presim, të nesërmet s'lindën për ne;
Mjaft më me netët e gjata që përjetuam!
A s'po fryn një erë mëshire? – Pyet e më digjet shpirti,
Ndërsa skëtërra zbrazet nga qielli përdhe!
Por këto rrebeshe flakësh më në fund do të pushojnë,
Më në fund, jo zjarr, por dritë do të zbresë mbi ne!

O mik i vetëm i ditës së zezë**, i atdheut tënd të vetmuar!
Ti ia njoftove botës dhimbjet e popullit tënd
Me atë penën tënde të fortë*** në ditët më të frikshme...
Emrin ta kujtojmë me nderim... Por më dëgjo mua:
Ndërsa vendosmëria jote statuja e gjallë e idealit tënd qe,
Si ndodhi që sot në pesimizëm re?
Meqë populli prej shumë kohësh priti, s'do të thotë
Se duhet të presë edhe shekuj të tjerë kështu, i poshtëruar!
Vendeve islame a vetëm skllavëri u ka takuar?
Apo atë të shkuar të famshme e harrove?
Në vend që të të tronditej shpresa duke parë përreth,
Besimin, ndërgjegjen tënde duhej ta dëgjoje!
Ti thua se ai makth nuk do ta lërë islamin t'i hapë sytë,

* Vargje të patriotit Sulejman Nazif të internuar nga anglezët në ishullin e Maltës më 1920.

** Eshtë fjala për artikullin me titull "Një ditë e zezë" të Sulejman Nazifit në gazetën "Hadisat" më 24 nëntor 1918, një ditë pas pushimit të Stambollit nga Aleatët.

*** Sulejman Nazifi e kishte treguar me fakte se ishte një patriot i madh.

Sepse urrejtja e pafundme e Perëndimit të rrëzon në pesimizëm;
Mirëpo, meqë premtimi i Zotit për ne është i vërtetë,
Mëngjesi i përjetshëm i Lindjes është afër, do të lindë!
A s'e djegin, thua, Arshin, trupat e gjithatyre dëshmorëve,
Ky tufan, ky tym që tymos në zemër të krijimit të gjaktë si lumë?
A mos mbetet e pandjeshme mëshira e Zotit përballë kësaj?
Edhe nëse kryengritja është e posaçme për ne,
Një vështrim të tillë nuk e pranon drejtësia e Allahut kurrë!

Islamin, përçarjet e dogjën, e përvëluan,
Vëllai, dashur pa dashur vrau vëllanë!
Jeta iku, vatani iku, thika preku mbi fenë,
Por atëherë u shkund e u zgjua menjëherë.
Pa shih: Sot edhe jeta, e saj është, edhe gjaku, i saj!
Bota është e saj, feja, e saj, fama e saj.
Ndërsa vëllazërimi po lidh unitetin e bërë mijra copë-copë,
Shih se si lidhja e përjetshme gjetën forcë:
Edhe sikur të sulmojnë dyzet ushtri kryqtarësh krahpërkrah,
Katërqind milion vetë s'bien rob, më beso!

Ankara, 15 prill 1921



BILBILI

*Birit tonë, Basri bej **

Mbrëmë isha mërzitur shumë, me tërë botën isha zemëruar;
Në pllaja kisha shëtitur, në fshat pata qëndruar.
Kur po desha të ikja nga qyteti, mbrëmja sa s'kish filluar
Dhe një errësirë shumë e heshtur luginën e kish rrethuar.
As dritë, as udhëtarë, as zë, të gjitha qeniet rënë në heshtje,
S'kishte dhe një frymë ta prishte këtë dalldi, madje.
M'u duk se gjendja e mjedisit simbol i njerëzimit që
Dhe iu ngjita të shkuarës, ç'dhimbje, ç'kujtime përjetova!
Një valë kujtimesh që më shpërthyen krejet,
Një klithmë e gjatë e shpërthyer nga gjoksi i errësirës,
E ngriti peshë atë dalldi ashtu përnjëherë,
Që nga lugina gjëmoi e tëra nga rënkimet anembanë.
Sa tinguj prekës, o Zot, sa tinguj dallgë-dallgë qenë;
Drurë e gurë qenë rrëqethur sikur Briri kish rënë për mahsher!

- Grua ke, vatër ke, behar ke, prisje:
Ç'pate, bilbil, që bëre aq zhurmë?
Në atë fron të smeraldtë u vendose, në qiej mbretërim ngrite,
Sikur të gjitha vatrat të shtypeshin, vendi yt s'shtypej;
Sot një luginë e blertë, nesër një e kuqe flakë trëndafilishte!
Ti shëtit: folenë të gëzuar, zemrën të gëzuar, botën të gëzuar.
Po të desh shpirti i paqetë një mjedis pa vjeshtë,
Ja ku e ke: nën pushtetin e krahëve të tu horizontet e pafund!
Jo vende të kufizuara, por, po të fluturosh, s'të nxënë largësitë,
Liri për të dashurit e tu, ideali më i madh për ty në jetë!
Pse, atëherë, ditët të kalojnë keq në zi?
Pse në gjoksin tënd sa një pikë një oqean gjëmon?
Jo, ti s'ke të drejtë të mbash zi, është e drejta ime kjo:

* Hasan Basri Çantay (1887-1964), shok shumë i afërt e i singertë i M. Akifit. Ka marrë pjesë së bashku me M. Akifin si deputet në parlamentin e parë turk dhe kujtimet lidhur me të i ka përmbledhur në librin me titull *Akifname* (Stamboll 1966).

Ka shekuj që horizontet e mi s'dinë ç'është dritë!
S'gjej dot ngushëllim, në pranverën time vjeshta qan,
Sot, në vatanin tim, një endacak i pa shtëpi, i pavatër jam!
Sa e dhimbshme është që unë, biri i pagjak, i pabesë i Lindjes,
la lejova Perëndimit t'i shkelë tokat e saj anembanë!
Tani që më kaluan në përfytyrim, mendimi m'u përmbys:
Vendi i Salahaddin Ejjubive, i Fatihëve...
Ç'poshtërim të rënkojnë tingujt e kambanave në trutë e Osmanit,
Ezani të heshtë, kujtimi i Allahut të fshihet nga qiejt!
Sa e hidhur është e kaluara e madhe të bëhet iluzion,
Ato fuqi, ato epërsi të shpërndahen, të bëhen dhé;
Një kube e shembur të mbetet nga xhamia e Sulltan Bajazitit,
Varri i Orhanit të madh të shkelet në mënyrën më të shëmtuar!
Ç'humbje e madhe, qendra e halifatit të shembet gur më gur,
Miliona bashkëfetarë të mbetur pa strehim, të hiqen zvarrë;
Foletë e shembura të përpëliten në tortura përdhe,
Mijra, qindramijra trupa të shtrirë të theren si pré!
Të vërtitet, pastaj, në vendet e shenjta të islamit i huaji...
Pusho, bilbil, jo e jotja, është e drejta ime të mbaj zi!

Ankara, Dergahi (Selia) Taxheddin

7 maj 1921



LEJLA

A s'po më strehon në gjoks, o dhé?" - I them. Toka, shtang!
Kthehem dhe e pres ndihmën nga qielli; qielli është larg!
U turbullova nga vetmia; koha, e heshtur, hapësira, e heshtur;
As një shok rruge në rrugën e shkretë pa njeri,
As një yll në errësirën e dendur;
Drejtimi, i papërcaktuar; para muret e pafund të një nate të pafund,
Balli yt endacak bie e përplaset me dhimbjet;
Ngrihet, përplaset me shpresën e humbur!
Pa oxhak oazet, shkretëtirat; të shurdhëta luginat, gjerësitë!
Mendo pak: truri rrotullohet në boshllëk;
Bërtit: të përgjigjen xhindtë!
Kjo kube e shkretë ka vite larg zërit, larg dritës;
O Zot, a s'ka në horizonte një dritë mëngjesi të lindë?
Ç'natë e pambaruar qenka! Lindjen pse e ka pushtuar?
Jo njerëzit, por botët e saj nga jeta u mërguan;
Makthi i saj shtyp treqind e pesëdhjetë-katërqind milion besimtarë;
Vorbulla e saj mbyt në çdo rrotullim miliarda pasuri!
Ka qindra vjet që vendi i islamit merret nëpër këmbë për ditë;
Shekuj kaluan, të nesërmen e premtuar ende po e pret!
S'e dua fare ardhjen e saj po që ditë e llogarisë...
Vetëm nëse s'është kështu, por muslimanët
Janë përgëzuar me një status të fuqishëm!
S'e di, por pse të mos hapen këto perde shtresë-shtresë?
Pse të mos spërkatet ende nga horizontet një dritë?
Ajo dritë që shpresën e ndritshme që s'di të shuhet,
Lindjen që ti e pandeh se, "e penduar pse është, kërkon të vdesë",
I ka tërbuar me përshndritjet e saj magjepsëse sa s'ka;
I zvarrit prej kaq vitesh nga kjo sevda në atë sevda!

Në të vërtetë, Lindja, Mexhnuni që s'e mendon veten,
Ka në këtë botë Lejlanë e vet që është e ardhmja e islamit.
S'e di se si është kjo botë, kalimtare e quan veten këtu;

Sot, i dalldisur me përmendjen e ardhmërisë, nesër, i magjepsur përjetimin e saj,

Eja, Lejla, eja, o më e dashur se jeta, eja, mos u largo!

Mos u merr me Mexhnunin që, për hallin tënd, heq dorë nga jeta!

Mendo: biri më i shëndoshë e më hero i të shkretit,

Për kë u bë kurban, për kë u gri e u copëtua?

Kush u vuri zjarr këtyre qindramijra vatrave të shuara?

Në qafë të kujt janë tani këta miliona bonjakë e të veja?

Në qafë të kujt janë të varurit në litar?

Kush mendon, Lejla, për ato vende, ato burgje ku u vranë aq vetë?

Të qofshin falë, ata kurbanë, ato gjakra, o Lejla,

Duku qoftë edhe një herëz, pesimizmi Mexhnunin pa e pushtuar!

Pse fluturon ende larg botës së krijimit?

Po qe se në këto toka nuk ke fare mundësi për t'u pritur,

Mëngjeset janë rruga jote e shtruar, agimet, kandili yt;

Hëna ime e re, çadra jote që ka zënë vend në zemër të qiejve.

Ezanet, janë roje të çadrës tënde, një pas një i bëjnë të rënkojnë horizontet;

Alemet,* kubbetë janë paja jote

E zbritur nga Allahu; bashkësitë, skllavi yt

Qabet, oda jote e nusërisë, eja, o Lejla,

Eja, o më e dashur se jeta që ende je në botët e padukshme!

Kjo naze të shkon, Lejla, zbrit, më në fund, nga lartësitë,

Pranverë e pafund të zbresë nga Zoti mbi këtë vend të djegur!

Ankara, prill 1922.

* Simbolet në formë të gjysëmhënës që vihen mbi majat e minareve të xhamive.



ME FARAONIN SY MË SY

*Lartësisë së saj, krenarisë së grave,
princeshës Hatixhe!**

Le ta zgjidhim këtë velore të lidhur dhe, duke kapërcyer lumin,
Të lundrojmë pak në drejtim të bregut tjetër.
Dielli, fëmijë: s'ka për të na lodhur; ujrato, të mpirato;
Ejani, të mos vonohemi, është koha për lundrim.
Le të punojnë lopatat, të shkojmë pa ndalim...

Mirëpo ky "Nili i Bekuar" i pandjeshëm si varri:
Ndërsa të gjitha brigjet i mbysin dhe groposin valët e tij,
Ç'bëhej sikur të ndjente një dhimbje? Jo dhimbje,
Por të duket sikur dëgjon ninanana në kënaqësi të plotë;
Qiellin e ka shtrirë nën vete, thellë-thellë fle!
Tani për tani nën hijet e tij një botë të tërë fsheh.
Ai, ndoshta Karnak-et madhështore shtatëdhjetë shekullore;
Dhimbjet e përgjakura, e djersitura të grumbulluara të balleve:
Ky lartësimi valë-valë i gjermadhës së Teb-it,
Këto, veprat që ende përshpërisin për pavdekësinë,
Mbi të cilat patën rënkuar mjediset me përpjekje të gjata.
Sot, me pamjen zemërike të kolonave,
Shihni si janë reflektuar përmbys në Nil!
A u afruam? Shumë mirë! Dhe një ranishte e gjerë;
Menjëherë të shkelim e të dalim pa u hapur trapi në skaj.
Trualli fundoset mjaft: në shumicën s'ka kaluar udhëtar...
Po i kapëm ato hurmishte, oh, shpëtuam...
Mirëpo s'paska qenë aspak ashtu; ç'zhgënjim:
Me ta kapërcyer oazën, një rërë na doli përballë!
Zhytemi e dalim, shkojmë të pashpresë dhe n'u lodhshim.
Po, vende-vende hasim në nga një ishull të dashur;
Ç'ka pas? Jo ndonjë vend të sistemuar,
Ajo, shkretëtirë i thonë, refren i pambaruar!

* Gruaja e Abbas Halim Pashës që i ka pasë dhënë mbrojtje M. Akifit.

Gjithnjë e më shumë u ngushtua lugina, pra, u afruam.
 Gërmadhat le të vazhdojnë të shemben dalëngadalë, më në fund.
 U dukën, ja, kolonat, të thyera e të derdhura vend më vend,
 U dukën monumentet të mpira nëpër shesh,
 U dukën disa radhë tempujsh që e kanë mbështjellë vendin,
 U dukën zotat e shumë prej tyre, të bërë copë-copë!
 Në të djathtë, dallgë rrënojash të panumërta,
 Në të majtë, muri i vetëm i një foleje të shenjtë.
 Para, statuja me trupin ndarë në dhjetra copë,
 Më tej, kokë me hundën të këputur, bele pa shpinë.
 Në atë anë, qindra skelete vigane fundosen në rërë,
 Në këtë anë, tokën e grisit një mijë fosile e teprojnë.
 Gërmadha shpresash të shembura hidhen këtu,
 Vështrimet kalojnë, ndërkaq, mbi sarajet e shembura...
 Shkurt, një dhë prishjeje pa vend në qenien e përjetshme,
 Kufoma të grumbulluara gjer në kiamet brenda tij!

Gjithnjë e më shumë u shtrëngua lugina e u kthye në grykë,
 Dielli s'është më fëmijë, por, megjithatë, mjaft i prapë!
 Më në fund, sidomos kur deshte ajrin ta ndizte,
 Nuk hiqej edhe në këto ditët më me naze, madje!

Aman, shihni, sa e mjerë gjendja e kësaj toke:
 Brezat i janë copëtuar buxhak më buxhak e bërë dhé,
 Me gropat, jo, me kërmat i kanë gëlltitur!
 Kufomëzhveshësit qenkan njerëz, këta minj lugetër! *
 Shpuar e copëtuar shkëmbinjtë, djathtas e majtas,
 Varre kërkojnë nga çdo anë një sërë krahësh.
 Zvarriten të radhitura grumbuj paçavrash,
 Për të nxjerrë në shesh, mbase, nën ta ndonjë mumje;
 Rrëmohen, shoshiten, hi, eshtra, të gjithë grumbujt...
 Pse bëhen ambiciozë njerëzit megjithëse e shohin dobësinë e
 njeriut?

* Poeti e ka fjalën për arkeologët.



U përkul pak rruga që zumë drejt jugut,
Kurse dielli, megjithëse u poq, përsëri shumë i prapë:
Para asnjë pikë hije që ta shuajë flakën;
Ja, ku, brenda një çasti, e kalon ajrin hap më hap,
As gropë, thotë, as mbrojë, copëton e kalon pa përjashtim,
Ashtu siç e ka copëtuar: çdo anë lakuriq!

Më e keqja është se ky bërryl që përdridhet gjithnjë e më shumë,
Po të zgjasë, besoj, s'ke mundësi të vazhdom më tej:
Një gjë e ngjashme me oxhakë për shuarje gëlqereje,
Lopata-lopata e përhap diellin që na bie mbi shpinë!
Mbaroi, edhe atë si, për tmerr;
Ejani e soditeni skenën, ejani tani!

Atje ku kalimi kthehet pak e varet kah perëndimi,
U var papritmas mbi horizontet një perde e kuqe flakë:
Ç'madhështi! Ç'salltanet! Ç'shfaqje hyjnore!
Toka nga rrëzët e tij ka zbritur e është ulur rathë-rathë;
Ky front duhet të jetë thurur nga drita e agimit të përjetshëm
Ose flakët e kohës së perëndimit duke u bërë gur,
Vazhdojnë të kërcënojnë me dëshirat e tyre plot ambicje.
Në qiell e ka përplasur kokën kjo piramidë e pavdekshme! *
Po, ky orator i dalë e i afruar pranë gërmadhëve të epokave,
Në heshtje tronditëse e dalldisur, e kredhur nëpër thellësi.
Jo, kjo s'është as ligjëratë që lartësohet, as minber,**
Është më i lartë, është një varr i thellë!

Në sa vende i gërryer gjoksi i këtij shkëmbi gjak të kuq!
Ka shumë emra që vijnë me radhë... I lexuam rastësisht:
"Amnofisi i Dytë"! Shumë bukur! menjëherë të hyjmë...
Në prag gjysmëdritë, një e futur e thellë, tani krejt errësirë.
Megjithatë, kjo nuk vazhdoi gjatë, perdet u hapën menjëherë.

* Në el-Uksur, në fund të "Luginës së Sundimtarëve", është një mal i kuq plot me varre faraonësh brenda. Kjo s'duhet ngatërruar me piramidat në periferi të Kajros.

** Minber: brenda në xhami, shkallarja ku ngjitet hatibi për të mbajtur hutben.

Kuptohet që, pas nesh, një felah e rrotulloi sustën.
 Drita e mirë, rruga pak e vështirë por kjo s'ka rëndësi.
 E keqja, nxehtësia që vjen nga brenda, të jep shqetësim.
 S'kemi ç'bëjmë, duhet të zbresim meqë hymë pa pyetur njeri...
 Vazhdimi i truallit që shkon teposhtë, mjaft i rrëpirë...
 Jo, të mos biesh përmbys s'është ndonjë e madhe aftësi;
 Sepse në çdo hap ka një shkallare të gdhendur në gur.

Duke zbritur dalëngadalë, u zgjat një urë...
 Me që para ke udhërrëfyesin, nënshtroi Zotit dhe ec!
 A mund të kalojmë? Mundet! Eja, pra, bismil'lah!
 Aksidenti u mënjanua, por ja se ç'thotë ai felah:
 Por një gropë gjaku ndjellakeqe sterrë e zezë
 Nën këtë urë të sajuar na paska zënë pusi!
 Domethënë se kush kërkon ta shpojë varrin
 E Amnofisit të Dytë për t'ia vjedhur eshtrat e shkëlqyera,
 Duke u përpjekur t'i kuptojë gjërat që fshihen në rrugë,
 Sapo të shkelë në një nga kapakët e lëvizshëm,
 Do të rrokulliset duke e pandehur për fundin e xhehennemit!
 Aman, të kalojmë shpejt, vendi s'qenka aq i sigurtë...
 Shkallaret që lamë, na erdhën në ndihmë përsëri,
 Pamë, së bashku, të bëhemi firar teposhtë.
 Grupe shkëndijash si karvan yjesh
 Të radhitura gjatë gjithë kalimit sikur të ishin
 Një turmë xixëllonjash të burgosura në kosh
 Që kërkojnë ta shpojnë për të shpëtuar nga nata e gjatë!
 Në të gjitha pjesët e mureve dhe tavaneve,
 Shenja të pafund të kuptimshme të përsëritura.
 Ç'janë ato trajta ngjyra-ngjyra të mbështjella netëve?
 Në emër të kujt janë bërë në këtë errësi?
 Fantazmat vallëzonjëse?

Të kujt? Ç'është? Por e bëmë të lehtë kalimin,
 Shihni, në një vend me shtylla po dalim tani.



Pra, erdhëm në odën private të Faraonit;
Të mos bëjmë zhurmë, shqetësohen, amani!
Por kjo skenë në gjoks të malit shumë e frikshme:
Një dallgëzim blu me yje si qiell i hapur
Vezullon pa pushim, e ka veshur gjithë tavanin,
Djathtas e majtas muret, tërë anët; vdekja e tij
E tregon rrugën gjithë me kujtime të frikshme,
Në trajtë ushtrie xhindësh plot mijra bestytini.
Në mënyrë të ngjashme, dhe këto kolona radhë-radhë,
Të njëjtat mite rrëfejnë me të gjitha hollësitë!

Mirë, po ai ku është? – Thoshim ne, kur ja tek na u shfaq
Varri që shndërriste me ngjyrën e kuqe pulla-pulla.
Sipër i hapur, kapaku një xham i trashë;
Në kokë paska edhe sustë që, kur biri i kohës,
Vrapoi e iu përkul, shpërtheu dritë tufë-tufë
E u duk, i paaftë për t'u ngritur vendit, lugat i mjerë!
Ç'shfaqje syverbonjëse dhe trime e drejtësisë
Ta shohësh Amnofisin e Dytë, kështu, sikur po sheh një kërmë!
Ky faraon që, nga frika, s'i qaseshin dot njerëzit pranë;
Ky faraon, pallatet, kolonat, përmendoret e të cilit
Horizonteve ua mësonin përmendësh tërë jetën e tij;
Ky faraon që, nëse pati gjë para së cilës qe përkulur,
Pati qenë vetë fryma e vet, pavdekshmëria e vet;
Ky faraon që, kur ëndrra për të jetuar gjer në amshim
Ia mbështillte trutë e turbulluar, njerëzve s'u mbetej më mundësi
Të gjenin në këtë jetë qetësi;
Ky faraon që, para se të bëhej skëterrë, trupi i tij ogurzi
U bëhej njerëzve një makth skëterror mbi tokë!
Ky faraon që njerëzit, duke e përkulur belin
Gjer në tokë, para statujës së tij patën bërë adhurim;
Ky faraon, kjo e keqe e padukshme, kjo bela e fshehtë,
Të cilit një herë e një kohë iu tha: "Ti je zoti ynë i madh!"..
Ç'shpagim hyjnor, ç'i pafund dështim:

Rri shtrirë lakuriq në mjerim,
 Shembull mësimdhënës për ata që shkojnë e vijnë!
 Një mish i pazhvokshur i ka mbetur, qefini s'i dihet;
 Në shesh trupi me mumjen ende të pashpërbërë.

A kjo qe fytyra para të cilës dridhej toka?
 A kjo qe fytyra, qeshja e të cilës mbushte horizontet?
 Jo, tani kjo fytyrë, një fletë ku janë shënuar ndëshkimet!
 Të gjitha shkrimet janë trazuar, të gjitha kuptimet janë prishur.
 Në vend të syve gjëmues e vetëtues, gropa të zeza;
 Tash në vend të rrufeve, erëra fryjnë!
 N'sa vdekja thellohet në tëmthat e shembur,
 Në buzët ende një intimitet i lidhur nyjë.
 S'e di në mendoi ç'është ajo mjekër e rralluar,
 Por balli i tij, robi i një ankthi tërë frikë!
 Në trungje të djegur i janë kthyer barku, këmbë e duar,
 Së shpejti të gjitha do të bëhen hi për t'u shpërndarë.
 A ky që po shoh do të ishte fundi yt,
 Më në fund kishe për t'u bërë ngordhësirë?
 A për këtë i bërë miliona shpirtra të rënkojnë?
 Sa e kanë pushtuar qiellin të këqijat e tua:
 Jeta jote, fatkeqësi më vete, bela më vete vdekja!
 Po, ti nuk do të kishe zjerë e shpërthyer në currila
 Po të mos zbrazej ajo djersë nga ballet e pamëkat!
 Statujat e tua shpërthyen si bar helmues mbi tokë
 Sepse u vadit kjo luginë me të njerëzve gjak!
 Kufomën tënde, kam frikë, s'ta nxuri toka,
 Mjerë ti që s'gjete dot dhé
 Për t'ia hedhur sipër trupit tënd të qelbur!
 A e vlen të gërmohet mali me thonj e me duar
 Për të sajuar brenda tij një pallat të bukur për një kërmë?
 Ç'është ky nderim i paparë në botë

Për këtë kufomë që lëshon erë?
 Pse nga ky respekt, konsideratë dhe këto dhunti



Shpirti yt gjë s'mori?
Dëshiron të bëhesh i pavdekshëm, ka mundësi:
A the që, të paktën një pjesë e frymëmarrjeve të jetës
Që i çove kot, t'i flijoje në rrugë të Zotit
Dhe a le nën këtë kube një zë që tingëllon pa pushim?
Kur përhapje vdekje, ata sytë rrufehedhës
A i përkule në tokë për të parë popullin se si jepte shpirt?
A i heshti kjo zemra jote e pandjeshme dëshirat e ulta
Për t'u dhënë fytyrave të djegura kujtimet e mirësisë?
Jeta jote e ulët e shkuar – gjithë baltë, gjithë gjak –
A ndodhi të çahet, të shpërthente sipër e ti, një ditë,
Nga thellësitë e kujtimeve, ta shihje atë fëlliqësi e të të vinte turp?
Jo, sa larg nga fytyra jote ajo ngjyrë që i thonë turp!
T'u mbyllën sytë, ike e shkove, qerpikët një pikë loti pa parë!
T'u strehua në mumje kufoma, e vetmja kryevepër jotja:
Mirë, po a u strehua dot te mëshira e Zotit ai shpirti yt i lig?

Po qe se ta gris perden e parë të jetës,
Veshët do m'i dëgjojnë zërat e mishrave lakuriq,
Të atyre mishrave që në vapët që shfryjnë flakë,
Tymonin ndërsa kërbacı yt binte mbi ta pa mëshirë
Se e drejta për t'u lodhur s'njihej për ta;
Të atyre mishrave me të vetmen të drejtë: të copëtoheshin!

Ashtu si dalja e fantazmës tënde duke shpërthyer nga rërat
Ca më parë, ajo kohë plot shkëlqim më del e gjallë tani ndër sy.
Kurse klithma e pandërprerë e njerëzve që kanë pjesë
Në këtë shkëlqim, janë rënkimet e jetimëve!
Sa oxhakë ua shembe pa u shembur vetë këtu,
Kush e di sa vatra pati shtypur ky shkëmb!
Po ta prek, do të qajë se s'thotë dot sa gjak ka
Ky muri përballë gropës ku ti shtrihesh gjatë e gjerë!
Me ç'fytyrë mund ta thotë: ortak i krimeve tua!

Sikur ta dija, o perëndi lakuriqe e Egjiptit të lashtë!
Me të vërtetë, për pavdekësinë tënde qenë
Tërë këto varre e statuja? Në pastë qenë ky qëllimi yt,
Të ka shkuar kot! Po, të gjithë njerëzit kanë të drejtë
Të shpresojnë për pavdekësi;
Por kjo e drejtë s'duhet kërkuar as nga kufoma, as nga guri!

Hilvan, 28 dhjetor 1923*

* Hilvan, qytet i vogël pranë Kajros ku pati banuar M. Akifi gjatë atyre viteve me ftesë të Abbas Halim Pashës dhe pati dhënë mësim në Universitetin e Kajros.



PËR PËRMENDOREN E SHEHIDËVE

Nën kubënë e qiellit shtrihen, mes gjakut të kuq alle
O udhëtar, burrat që dhanë jetën për këto dhera!
Këta rob të lartësuar të Allahut s'i nxë e gurit tyrbé ;
Të rrethuar nga mëshirë e Allahut, presin një Fatiha!

Hilvan, 27 dhjetor 1924

UNITET

Hudhejjetu'l-Adevi* thotë:

“Ishte një ditë shumë e nxehtë

Kur lufta e Jermukut qe nxehur keq.**

Afër pasdites përleshjet sikur u lëshuan pak.

E hodha armën prej dore duke iu sulur ujit sakaq;

U lëshova mes luftëtarëve për ndihmë,

Për ushtarët me plagë të rënda të mbetur larg.

Ç’fushë lufte që qe ajo! Gjoksi i vendit tërë gjak!

Duke menduar se, edhe nëse mes këtyre trupave

Të shtrirë me zemrën hapur ndaj Allahut, dëshmorë ka plot,

A nuk duhet të ketë dhe gazilerë,

Një rënkim të thellë dëgjova... Po ky zë, nga vjen?

Të gjitha gjokset q’i ledhatova me radhë, të pajetë...

Biri i tim ungji na qenkësh ai që rënkonte i plagosur.

I thashë: “Kam sjellë ca ujë; a e pi po të të jap?”

Ndërsa me sy po donte të më thoshte “më jep”,

Atje pas një dhimbje nisi të rënkonte. E pashë:

Shikimi i tij i mëshirshëm po më tregonte

Anën nga erdhi zëri; ujin atje deshi ta çonte.

E kuptova se s’do ta pinte, pra s’duhej shtrënguar;

Te zëri që ngrihej lart vrapova: ishte i biri i As-it, Hisham.

Sa ma pa hijen, iu prenë rënkimet menjëherë;

Shikimi i kthyer këtej i të mjerit, ujë kërkonte.

U përkula për t’i dhënë të pijë, kur, a s’lëshohet

Pa pritur përballë me gërvima një “ah” i shkurtër, i tretë?

Dhe shihe Hishamin që, në atë gjendje, me vetulla

Më bërtiste: “Unë s’dua, ik, jepi atij që bërtet!”

* Hudhejjetu'l-Adevi, një prej shokëve të shquar të Profetit, i cili ka pasë marrë pjesë në luftën e Jermukut.

** Lufta e Jermukut: Në periudhën e hilafetit të Hz. Omerit, në vitin 636, ushtria muslimane prej rreth 30 mijë vetësh nën komandën e Halid bin Velidit, pati korrur një fitore të madhe kundër ushtrisë bizantine prej rreth dyqind mijë vetësh.



M' u desh kohë që ta kërkoj, ah, atë që jepte shpirt;
E arrita kur shikimi i fundit me Allahun i ish bashkuar!
Të paktën Hishamin ta gjeja, mendova, u ktheva menjëherë :
Por vdekja te gjahu i vet para meje kishte shkuar!
Në kisha një shpresë, te biri i tim ungji e kisha lëshuar...
Vrapova e i shkova pranë: edhe ai hero kishte rënë shehid!”

* * *

Ç'plagë e rëndë është gjendja e sotme e Lindjes, o Zot,
Me të kaluarën e mrekullueshme me gjëra për t'u krenuar plot!
Besimi, si një libër i shthurur,
Me fletët të grisura, zvarritet për tokë!
Dikur, parimi themelor qe uniteti; ejani, shiheni tani:
Në dorë të kohës, çdo copë iu bë lodër çdo copë!
O ummet i shkarë nga rruga me helmin e copëtimit!
Historisë tënde që në zanafillë i ishte premtuar “amshimi”
Pse mbete i shtangur në rrugën
Që të bën t'i harrosh të së kaluarës epërsitë?
“S'ka Allahu është zotëruesi i fuqisë së vërtetë”!

Hilvan, 12 janar 1924

NATË

*Mjeshtrit tim të urtë, Ferid Bej!**

Të gjithë kandilët ishin kredhur në tehlil...** m'u morën sytë:
 Ç'tempull veprat e tua, një sexhde e pandërprerë qielli yt!
 Janë mbyllur, dridhen me frikë përballë Teje botët
 Engjëjt, me kokat përulur, qëndrojnë në sheshin e Arshit.
 O Zot, me ç'adhurime të shumëngjyrshme janë përmbysur
 horizontet!
 Errësitrat, dritërat, hijet, janë kredhur gjithë në botën e kuptimit;
 A s'i zgjon kjo kredhje ndërsa e përmbys gjithësinë,
 Telat e besimit të shpirtit tim të mjerë që rënkon?
 Të mjerë, se thirrja ime e çoroditur s'është ngjitur lart!
 Këto dritat e tua tufa-tufa të më jepnin rrugë pak, Allahu im!
 Po, miliarda botë janë ekzaltuar në largësi të pambarim,
 Hija ime e pashpresë përpëlitet mbi një grusht tokë!
 Allahu im! Të singërtat janë zërat që dëgjova nga gjithësia;
 Pse lotët e syve të më kthehen duarbosh nga ajo gjithësi pa mbarim?

Thonë se këto qenie qiellore janë ndarë gjithë nga dielli Yt...
 Allahu im, po qe se për to nuk ka qoftë dhe për një çast ndalim,
 Hija ime e shkretë pse të rrijë prej teje e ndarë?
 Nuk është ndër diejt, o Zot, nga gjoksi yt, i ndarë!

Ende në kujtesë më janë çastet kur u rrëqetha në kuvendin tënd;
 Ato kujtime që më shpërthejnë në tru mijra herë kur i sjell
 ndër mend!
 Hodhe një mbulesë nga madhështia jote, më fluturove nga sytë!
 Ndërs a më kalon me një mijë shfaqje nga kiblja ime, o Zot,
 Me mungesën tënde më përplasat balli nga mihrabi në mihrab;
 Me mëshirën dhe faljen tënde të nesërme s'mund të gje ngushëllim!

* Ferid Kam (1864 – 1944), filozof me shumë pririje poetike të cilin M. Akifi e vlerësonte shumë

** Tehlil: përsëritje rituale e pohimit "La ilahe illallah", "Nuk ka zot tjetër veç Allahut!"



Miraxhi i sexhdes time shtrihet përdhe!
Tehlili i oqeanëve ngjitet qiejve e kthehet valë-valë!
Pushoni, ju errësira, drita, hije që, o Zoti im,
Sexhdeja ime, rënkimi im ta bëjnë të rënkojë tërë gjithësinë!

Jetë të tëra shkuan, ti s'je, eja, i vetmi Zoti im;
Eja, o i vetmi i panjohshëm për shqisat, eja o i vetmi që ekziston!
Le të hiqet kjo ndarje që e bën të qajë këtë zemër,
T'i vijë kësaj zemre të përmallur besimi, prehja me një frymëzim!
Jo, me besim, me prehje pesimizmi i shpirtit tim nuk merr fund:
Çdo gjë e kotë; as botë nuk dua pa ty, as frymë!
Unë Mexhnuni yt, Lejlaja ime e adhuruar je vetëm ti!
Ende jam i dehuri i shikimit tënd të lehtë që ma fale në pafillim!
Eja, o saki i pavdekësisë, Elesti* yt u kujtoftë e u lartësoftë!
Gjysmë gote, një grykë më jep, por nga e njëjta pije të jetë!
N'sa frymëzimi i asaj vere hyjnore më rënkon në çdo qelizë,
Gjithë ritmi i krijimit të pushojë nga rënkimi im!
Eja, o Zoti i botëve, o Lejlaja e ndërgjegjes sime,
Në gjoksin Tënd u kujtofsha, në u bëftë i fundit vendqëndrimi im!

Hilvan, 5 janar 1925

* Elest: çasti kur Allahu i pyeti shpirtrat: *Elestu bi Rabbikum, A nuk jam unë Zoti juaj?*

VUAJTJE TË NDARJES

Në qoftë tempull kjo zemër, lakuriq s'ka hije, pastaj mjaft në errësirë;

Zoti po vjen! Gjej një dritë, një shtresë; shko me vrap në të tjerë!

Mora menjëherë një kandil nga komshinjtë dhe një sexhade;

I thashë: "Eja, tani, miku im, selinë e lumturisë nën urdhër e ke!"

Ç'llogari e gabuar kjo e imja: as më kalove para dere, shih!

O Zot! E shkula dhe hodha gjithçka; ja, qelia ime lakuriq tani:

As një kandil në fund, as në mihrab sexhade;

Toka që e njeh qysh në pafillim, e çlirë nga çdo pasuri,

Janë sexhadetë që e presin mikun, të shtrira përdhe!

Kjo, flakë lakuriq, nëse thua, besimi i pafund i gjoksit tim.

A s'e vlen mallëngjimi im, o Zot, nëse kam bërë gabim?

Diejt lindën, hënat lindën, unë ende në mjerim!

Shpërthejnë rrufetë përballë meje, i grisin horizontet, i copëtojnë;

Shpirti im ende i dashuruari i një shiu një mijë herë.

Ti, o i bukur që, kur të spërkatet buzëqeshja,

Shpërthejnë vend më vend nga qielli e nga toka

Agime, trëndafilë e tulipanë...

Kësaj vatre jetime a s'po i qesh një herë? Eshtë ende jetimi yt;

Ç'ke zbritur gjer tani, janë zjarre, zbrit një ditë edhe dritë!

Jo, hoqa dorë nga buzëqeshja, të mos më kërcënojë madhështia jote

Çdo sexhde e ngrirë imja, me rrëqethje ngjall shpresa ngjyraplote!

O Zot! U turbullova; ku është drita jote? Ku është falja jote?

A të më bëjë shëtitje xhehennemi kjo ndarje nëpër horizonte?

Po, ç'kam bërë, kanë qenë pakujdesi, gabim; por a s'bën njeriu gabim?

Jam larë në lotët që kam derdhur një jetë të tërë, a s'mjafton?

Eja, pra, s'kam asgjë më të kësaj bote, vendi i Zotit është vendi im!



Besimi që ty mon në qelinë time, sexhdja ime e shtrirë vende-vende.
Nga shpirti i lidhur pas sexhadesë dhe kandilit që rri larg Teje,
Nuk ka më shenjë, o Zot, as në ndërgjegjen , as në mendimin tim!

Thellësitë e gjoksit më kumbojnë me kujtimin tënd, o Zot;
Ç'ta bëjë robi yt këtë vend të shkretë të kthyer në gërmadhë?
Ç'kuptim ka mihrabi po s'pati një Zot,
Përkulja para teje, frika, dalldia, të gjitha këto gjëra pa vlerë?
Gërmadha një shembje besimi është, shtrihet e vetmuar përdhé;
Ç'pret sexhdeja që nuk shkelet nën këmbët e tua kur ti kalon këndej?
Të shembet, të bëhet copë-copë me gjithë qiejt e yjet;
Ç'kuptim ka një zemër që s'të ka ty në horizontet?
Ditë shkuan, muaj shkuan, eja, më në fund, miku im,
Nuk mundem më të jetoj me këtë besim që s'të sheh Ty!

Hilvan, 10 janar 1925

SEXHDE

Ka shumë kohë që besimi im s'të kap Ty;
 Erdha në këtë botë - gjoja- uniteti, por jam një mijë herë i penduar:
 Mundësi qetësie s'ka, botën joshja Jote e ka pushtuar;
 Ç'disfatë, o Zot, tempulli im përreth krejt klithma i rrethuar!
 Thellësitë, gropat, skutat, ujvarat, rivierat,
 Retë, rrufetë, shkretëtirat, hapësirat, ujrato, borërat,
 Diejt, hijet, hënat, agimet... Klithin që të gjitha;
 Bubullima vijnë nga përplasja e yjeve në errësirat.

Era e mëngjesit në male Brrit të Apokalipsit i bje,
 Mijra turma vlojnë në fushë;
 Detet fryhen, rrebeshet vërtiten, gurët rrotullohen duke bërë ziqër.
 Horizontet llokoçiten, vlon vorbulla e dritës në qiej;
 Shekujt përmbysen: pishat, lisat shekullorë përpëliten përdhe.
 Të gjitha grimcat e veprës tënde, nga një ngazëllim i pafund,
 sarhoshe;
 E djathta ime, sarhoshe; e majta, sarhoshe; o Zot, ç'të bëj, boshe!
 Jetë të tëra sytë e mi në rrugë, ende pres, ende;
 Të të shohësh ty është e pamundur ndërsa qenia klith kështu!

* * *

Jo! Një frymë tjetër ka fryrë në mbrëmje që në botën e përjetësisë
 U zgjova, pashë agimin që dridhej para vullnetit tënd.
 Ato thirrje entuziaste janë lodhur, ato grimca të harbuara,
 pa ndjenjë;
 Në horizontin e Lindjes, nga tufanet e dritës vetëm një dritë
 përshkon.
 Ajo kube krejt qiellore, një grusht dhé, ka marrë ngjyrë si Sina:
 Ndërsa dritërat shpërthenin, tani e dalldisur në drithërima!

Ato yje, ah, ato sy te Zoti ashtu janë tretur, sa
 Nuk kthehen qoftë dhe një herë për të parë në largësitë!
 Detet, dallgët, malet, pemët, hijet, të mpirë...



O Zot, nuk ka një hije që të dridhet në prehër të horizonteve.
Në iluzionin e erës së mëngjesit të mpirë, të ujrave të mpira,
Të liqenit të mpirë, sa të kuptimshëm ata qiej
Si një frymëzim i bekuar!

Pashë dje kah kjo hapësirë e njëshmërisë: Ç'mejhane
zhurmëmadhe qe!

Sot pashë shpirtrat leckamanë: Nga një gotë pijeje tjetër
ishin mpirë.

E gjithë bota, nga vera e njëshmërisë, e servirur teje ndehej shtrirë;
I joshur prej Teje , mbeta pa u bërë sarhosh, Allahu im,
sheshi është im!

Lëre, le të vazhdojë miraxhi im në soditjen tënde plot mall;
Ndërsa rukuja në tokë më dridhet, përshpirtshmëria ime
Arshin ta dridhë.

O Zot, një pika jote endacake jam, disfata ime a s'është mjaft?

Lëre, ta vërshojë e ta vrullëzojë këtë hapësirë të njëshmërisë
besimi im!

Lëre, në gjithësi s'ndihet zë fare, lëre, e ka radhën të klithë i joshuri
me Ty!

Lëre, i pashpresë jam, të përhapet valë-valë tehlili im!

.....

Nuk vritet, Allahu im, ky që me dehjen e ashkut shtrihet i mpirë...

Lëre, le të bëhet një qenia ime me gjithë qenien në një sexhde!

Hilvan, 15 janar 1925

HOXHË HYSAM EFENDIU*

Duhet t'ia kish dëgjuar emrin nga shërbëtorët e tij
 Që sulltani kish dashur ta sillte Husam Efendiun në saraj.
 Duke kërkuar falje ndaj të gjitha urdhrave,
 Jo të shkonte, por ai as përreth sarajit s'ish afruar!
 Kishte kaluar mjaft kohë nga kjo naze e nga ky vetëvlerësim,
 Kur një ditë prej ditësh një punë andej nga Beshiktashi
 E kishte tërhequr mjeshttrin tim të Mesnevisë në ato anë.
 Me ta dëgjuar këtë parësia e njerëzve të sulltan Abdylmexhidit,
 E kishin pyetur: "A ta thërresim?" "Po!" kishte thënë Sulltani.
 Menjëherë rojet grupe-grupe në rrugë kishin dalë.

Ndërsa Hysam Efendi ndodhej ende në Dollmabahçe,
 E kishin arritur njerëzit nga tre e nga pesë që andej.
 - Zotëriu ynë na dërgoi, të bën shumë selam
 E thotë: "Unë dua të takohem, ai vetë a nuk do? E pse?"
 Saraji s'është larg, katër hapa që këtej;
 Kthehuni menjëherë të shkojmë, hiç mos u mendoni këtë herë!
 Kthehuni, ju lutemi...
 - Dëgjoni e kini durim:
 Ndërsa unë jam ende larg fundit të rrugës së vetme
 Që kam pesëdhjetë e pesë vjet që i jam kushtuar,
 Jeta m'u sos e shkoi; dhe, po u ktheva pas, u dogja, do të kem
 mbaruar!

Hilvan, 4 shkurt 1925

* Hoxha Hysam Efendi (1839 – 1861), një sheh që ka jetuar në kohën e sulltan Abdylmexhidit, i famshëm veçanërisht për njohuritë e tij të thella mbi Mesnevi-në e poetit Mevlana Xhelaluddin Rumi.



STROFA

MËSIM NGA RRËFIMI

Njeriu nga e shkuara marrka mësim... ç'rrenë!
Ngjarja pesëmijëvjeçare dha një gjysmëndjenjë?
Thonë "historia është përsëritje";
A do të përsëritej po të nxirrej mësim?

PORTRETIT TIM

Kur t'i hidhet dhé hijes sime prej dheu që shëtit,
Ditët herët a vonë edhe siluetën time do ta fshijnë.
Të kujtohesh me mëshirë, është përjetësi, megjithëkëtë,
Unë kam jetuar i heshtur, për mua kush do të dijë?



PORTRETIT TIM

N'lënç gjurmë të gjallë mbi këtë dhé, s'fshihet, mos ki drojë;
Po të vdesësh, nëntoka mbi shpinë do të të durojë.
O ti njeri që shpresë bese te hija ke,
Kjo siluetë sa ditë do të të kujtojë?

URIM*

Si një copë hëne ai diell mëshire zbriti nga qiejt
Në horizonte këtë mbrëmje, këtë mbrëmje tërë gëzim!
Kur t'i ndizet kandili i përjetshëm, Allahut i lutem:
Shkëlqeftë pa pushim ai kandil në ballin tënd, pashai im!

* Kujdestarit tim, Emir Abbas Halim Pasha



URIM

Ashtu si haxhinjtë e vlerë të ardhur nga të katër anët
Do ta rrethojnë nesër Qaben,
I lutem Allahut që po ashtu t'ia rrethojnë jetën
Qindra bajrame të lumtura pashait tim!

PËR “SAFAHATIN”

“Pas meje do të mbetesh, me rahmet do më kujtosh”
Thosha kur t’i hidhja sytë, i mjeri libri im!
Kush mendonte se vërtet do të mbeteshe pas
Ti, për të cilin shkruva të shkretin fatin tim?



PORTRETIT TIM

Pamja ime e jashtme zbardhet në të zbardhur, por ç'e do se si!
Mos pyesni fare për ç'kam brenda: Për faqe të zezë!
Më bëri të kem turp nga vetja me të vërtetë tani
Portreti im që mua s'më përngjet kurrsesi!

PËRKTHIM NGA SADIU

Pranvera erdhi, bari, lulet, trëndafilat çelën përsëri;
Trëndafili im, nga ky dhé nuk ke mbirë ende vetëm ti!
Duke qarë mbi varrin tënd si një re pranvere,
Eh, sikur të derdh aq lot sa të mbish dhe ti!



MEVLUDI

Ç'natë përjetësisht e pashoqe e botës hyjnore paske qenë,
Adhuresi i të nesërmes së lindur nga mitra jote jam;
Në ndërgjegjet nuk ka dritë tjetër veç saj; po të shuhet ajo,
Jeta kthehet në një natë të gjatë pa kufi;
O i Dërguari i Allahut, fjalët pa rregull, me të mirë m'i shiko;
Vërtet, robi yt është i marrë, por i marrë në rrugën që hape ti!

FËMIJËVE

Ç'dru paskej qenë ati juaj që s'u bë as bisht për një sëpatë!
Ju mos i ngjani se, pastaj, keni për të rënë në flakë!
Nuk rrohet më si lis, ato kohë kanë kaluar;
E ardhmja është koha e njeriut të holluar, latohuni!
Vetëm se kujdes: Vetëm kokën ta holloni,
Jo krahun, krahun s'hollohet, mos u mashtroni!



NJË LETËR*

O erë e mëngjesit, a do të shkosh në veri?
Kam një punë, s'e di, a të ta ngarkoj ty?
Kur të kapërcesh tetëqind milje me një frymë,
Kur t'i dallosh vendet tona si një përfytyrim,
Shih me vëmendje: e shtrirë në gjoks të Marmarasë,
Me mbulesën mbi shpinë, e kredhur në smerald,
Një ishull është; i thonë Hejbeli;
Për rreth ka ishuj të tjerë q'i ngjajnë pak a shumë atij...
A e sheh? Po. Në këtë breg rri pak tani
Dhe, si të gjithë, te qoshku i Abbas Pashait shko.
Ti je udhëtar, mungesat s't'i vënë re, mos u dro!
Kur t'ia njoftosh emrin pashait e të dalësh para tij,
Dashurinë e hilvanasve për të ia thuaj një e nga një;
Pastaj, kur të mbarojë ky defter, i thuaj:

- "Por

Eshtë një burrë i marrë që marrëzinë e bën poezi
Që s'janë veç një sërë marrëzish të vëna në radhë, me rimë!
Pandeh se duhet të jetë nga poetët që kanë dalë në pension
Që nuk ka asgjë të re; e vjetër çdo gjë e tij!
S'ka hequr dorë ende as nga mjekra, as nga mustaqet e gjë tjetër;
Edhe veprat të kënaqura i duken nga pamje e vjetër.
I numëron përmendësh muajt hixhri e kameri,
Por shekulli i njëzetë s'i hyn dot në tru! Sa çudi!

Edhe pse e ka shëtitur botën e zhvilluar anë më anë,
Në fund, "eja dhe ti luaj pak këtu në rërë!" i kanë thënë!"

Ore ti, pyeteni një herë tjetrin, a ka fuqi,
A dëshiron të luajë në rërë kur njeriu piqet në diell?
O ju që ikni nga dimri për klimë në Hejbeli,
O ju që korrikun e Afrikës e pandehni përrallë!

* Kushtuar mirëbërësit tim, Shkëlqesisë Emir Abbas Halim Pasha!

O ju që shëtisni me kaike treshe si në vaj,
O ju që e Pendikun nga Maltepeja e quani një hap!
O ju të shtrirë nën hijet e pishave
O ju që, sa herë të merrni frymë, fitoni një jetë!

N'sa ju mbuloni xhamat e ruheni nga era,
Ne ikim nga dielli përvëltonjës e zbresim në bodrum!
N'sa ju gëlltitni peshkun më të mirë të skuqur në hell,
Ne piqemi në rërë si peshqit që hedhin vezët nën diell!
N'sa ju horizontet e Marmarasë i thithni me dylbi,
Për ta ndjerë flladin, ne shëtisim në çati!
N'sa ju keni hapur velat e vozitni mbi ujë,
Ne na hipin xhindet duke ju parë juve me zili!
Bëni maturi: mos kujtoni se kiameti s'do të shpërthejë?
Gjithsesi! Dëgjo, pashai im, ndjesë pastë yt atë:

Unë heq dorë nga Hejbelia tani për tani, vetëm se
Bëhet mirë të rri katër a pesë ditë në Remlé!*

Hilvan, 1 gusht 1929

* Remle: zonë klimatike pranë qytetit Aleksandri të Egjiptit. Poeti ia shfaq dëshirën pashait anasjelltas.



NJË NATË

Katërbëdhjetë shekuj më parë ishte një natë si kjo përsëri,
Kur nga rëra, si hëna pesëmbëdhjetë, doli një jetim!
Por, ç'pafatësi: Sytë s'e panë atë dritësim
Kurse kishte mijra vjet që e prisnin të vijë!
Nga do ta shikonin? S'e shihnin dot, natyrisht;
E para, vendi ku doli në shkretëtirë, ish vend më i fshehtë;
Nga ana tjetër, vendet e zhvilluara të botës në ato kohë
Ishin në krizë, më keq se tani!
Njerëzit i kishin kaluar në egërsi çakenjtë,
Njeiun e dobët e hanin të vëllezërit!
Anarkia kishte rrethuar gjithë botën anembanë,
Sëmundja e sotme e përçarjes Lindjes ishte epidemi!

Ndërkaq, jetimi ishte rritur, ishte bërë dyzetë,
Kur këmbët e përgjakura që shëtisnin kokëve, ranë në ujë!
Ai i pafajshmi e shpëtoi njerëzimin me një frymë!
Sundimtarët e Bizantit dhe Iranit i shtriu me një goditje për tokë!
I dobëti dhe i pafuqishmi që shtypeshin sa mund, gjetën jetë.
Ngordhi dhuna që asgjësimin s'e shkote as ndërmend.
Sheriati i tij i dëlirë ishte mëshirë për botët,
I hapi kanatet mbi vatrën e atij që donte drejtësi.
Ç'të ketë bota, janë gjithë ç'i ka dhënë ai;
Shoqëria dhe individi i janë borxhlinj atij!
Atij të pafajshmit gjithë bota i ka detyrim...
O Zot, na ringjall ditën e tubimit me këtë besim!

Hilvan, 28 gusht 1928

AS VEPËR, AS SAMARI!

“Po qe njeri ai që vdes, lë pas një vepër për të gjallë;
Kur ngordh gomari, lë pas samar!”

Pse kështu kanë thënë të parët, mijra balle
Derdhin djersë pa pushim gjer në vetëshkatërrim!
Për hir të pasionit të pavdekshmërisë, s’e kuptoj kurrsesi;
Po të më pyesnin, është prirja më e keqe e njerëzimit!
Ta zëmë se ke lënë një shenjë që s’fshihet mbi dhé;
Ç’del nga kjo? Ç’vlerë ka nëse varet nga pikëvështrimi?
Merre filozofinë që bënte kiametin në trutë e njerëzve dje,
Dhe pyete për të shijen që sundon sot: s’vlen pesë pará!
Nëse e kërkon natën kryeveprën që ditën shëtiti mbi krye,
Ndoshta e sheh të hedhur në plehra!
Ai që kërkon, përmasat e shtatit të shikojë,
Ti rri pas, pendohen ata që hidhen para !
E di: ata që do të vijnë pas, do të thonë, “prapë samar!”
Duke u rënë me shkelm grumbujve të dheut të butë të varreve...
Ç’njeri i ditur është ai që shkon nga kjo botë pa zë;
Askush nuk e merr vesh në ka lënë vepër a samar!

Hilvan, 21 mars 1930



DERVISH AHMETI*

“Një jetë të tërë ke që pi, lëre, më në fund, këtë tani” thotë;
Me këtë udhëzim, Dervish Ahmeti bën menjëherë pendim.
Por një pendim që shishet trilitërshe i përplas për muri;
Tas, çanak, shtambë përhapen dërrasave copë-copë.
Ndërsa tufani i rakisë, vorbulla e ujit dhomën e përfshijnë,
Mezetë rrotullohen e në pikën e nisjes vijjnë,
Im gjysh me profeci e shtron postiqen në kanape
Dhe nis ta sodisë sarhoshin fitimtar që atje!
Nis, por mërzhitet nga soditja e gjatë...
Edhe Dervish Ahmeti mërzhitet, nuk arrin gjer në mesditë.
Ngrihet, s’bën; shtrihet, s’bën; kthehet, s’bën;
Me çfarëdo që ta mbushë, e çara që i thotë “s’bën”, mbetet e çarë...
Bën zikër, e shtrëngon veten të tërhiqet n’adhurim, s’e bën dot;
“Hû” thotë, e rreh gjoksin, asnjëra nga këto s’e dëfren.
Ndërsa jetëgjatësi e orës është më e shkurtër se një frymë, pra dje,
Kush e di sa vite përmbys ai për çdo sekondë që kalon sot!
I përmbysuri le të përmbysset, gjyshi im thotë “il’lallah”,
S’kam më durim; xhami tundet, çatia tundet duke e kundërshtuar!

Kaq shumë zhurmë, sikur të luante vendit pak;
Ç’gjë inatçore që koha nuk ecën aspak, s’luan vendit aspak!
Mirë, po ja që Dervish Ahmeti të thotë ty “eci unë”!
“Aman, Ahmeti im, pa më shih mua!
A do ta prishësh pendesën përsëri?
A do të më thyesh mua përsëri?
Ahmeti im, kurrsesi mos thuaj “unë po shkoj!”

Joshja i kishte ardhur gjyshit e fuqishme nga jashtë
Që, me zërin e fryrë nga brenda, duke mos u drojtur aspak,
Bie në rrugë Dervish Ahmeti: pa e zënë vendi vend!

* Nejzen Tevfik (1879 – 1953) një poet i famshëm satirash dhe mjeshtër fyelli, për përgatitjen e të cilit pati dhënë një ndihmë të madhe M. Akifi, i cili ka qenë dëshpëruar shumë për prirjen e tij për të pirë.

“Dervish Ahmet! Po shkon, pra, po, ki kujdes, mos kthe në të majtë!
 Ja, e sheh, erdhe në kthesë, të të shoh tani: pushim!
 Kjo vajtje nuk është për të mirë, Ahmeti im,
 Qëndro, Ahmeti im, mos u përkul, Ahmeti im!
 Aman, Ahmeti im, të të shoh ty,
 Qëndro, Ahmeti im, të të shoh ty!”

Por s’ia vë veshin Ahmeti, i shkon lëng goje mrekullisht;
 Po iu drodh barku, shalët do të shkojnë, dhe çfarë të shkuar!
 “Çfarë? Erdhe në mejhane? Kursesesi mos hyrë, qëndro!
 Aman, Ahmeti im, fundi shumë i vështirë!
 Shpirti im, Ahmet, mos thuaj kam për të hyrë!
 Ahmeti im i vërtetë, tërhiq Ahmeti im!
 Ky kalim, bela, i vërteti Ahmeti im!
 Ç’fundosje ato, ç’mbytje ato!”

I varet, kot; i përulet, kot; pastaj gjyshi im hidhet.
 “Meqë në mejhane re, o dervish i bekuar,
 Kalo pa pirë që të thonë: gjyshi sulltan është’ shenjtëruar!
 Hajde, Ahmet, hajde, biri im, hajde, një përpyekje të fundit jep!”

.....
 Por, Ahmet, ç’përpyekje kjo, ç’durim, çudi!
 Ti shtrohu në mejhane si deve, shtroje postiqen, ulu;
 Merr flakë, pastaj digju: qëndro si mal, qëndro si gur!
 Thashë mal, thashë gur; a është e drejtë! Ç’ka rëndësi!
 Atë një tërmet e trondit, këtë një dallgë e shtyp.
 Sa tërmete të provuan ty, pa të tronditur aspak;
 O asllani plak! Zoti të ka lavdëruar e të ka krijuar!
 Një pendim të tillë kalove që me të vërtetë zuri vend;
 Bela e vogël që, në kohë të zbardhjes, ai tufani ç’që?
 E nëpërkëmbe dallgën, vorbullën, s’pyete,
 Posten te mali Xhudi e afrove, u hodhe në tokë.
 I ka dhënë një shqelm pasurisë Et’hemi, thonë:



I ka dhënë grusht gjysmë mijëshe? S'pandeh aspak!

Dervish, shih veten mirë, dije se kush je:

Ti je shembulli madhështor, jo ato që lexohen!

Ç'margaritar je ti, o i lumtur, ç'shpijt je, ta dish;

Ti je mbret për mbretërit nën gunë!

Ti që je rob vetëm i Hajdarit që shpërndan Kevther,

Kush s'porosit për ty pije, kujt t'i porositë?

.....

Hajde, o bir, pyet, gjyshi sulltan ç'pi?

Mbushjani dervishit dy mijëshe nga unë, Jorgil!

Hilvan, 1 shtator 1930

IMAMI SAID PASHA*

Abazhuret ngazëllehen, kandilët fryhen;
 Nga kjo ujvarë dritash të gjitha horizontet rënkojnë!
 Para jallisë,** vendi, si ylli i Plejadës, fund e krye, dritë;
 Dritaret gjysmë të hapura, të mekura nga dritat dhe ngjyrat.
 Brigjet të pajisura me fenerë të kuq, jeshil e mavi,
 Drita e hënës e kredhur në ujra, dridhet nga vezullimet.
 Duke shkukur tri çifte kaikesh që hidhen mbi dallgë,
 Qindra lopata rrëshqasin për në breg si skifterë.
 Ndërsa kjo rrjedhë ngjitet për në breg, nga një anë,
 Rradhët e para derdhen për në saraj nga tjetra anë.
 Gurët e molit, si smerald; bari i mbirë në ujë, qilim persie;
 Dhe mbi to, Pallati Sulltanor!

Kryet e të ardhurve kanë çelur ngjyra-ngjyra;
 Shih ç'grumbullim apokaliptik: feste, qylafe, yazma,**
 Byrymxhyk,***jashmak,*****tajlasan,*****take,shamimehoja,jemeni...*****

Mirëpo një shumicë na qenkan të paftuar! Kush e vë re?
 Këto porta të pahapura, të hapura për çdo të ardhur tani.
 Avllia, kopshti i jashtëm, kopshti i haremit, gurishtet, ngado,
 Fushë e vajtje-ardhjeve të pafund: sini nga të gjitha madhësitë
 Të plotësuara edhe me ato krye rreth e qark,
 Tavllat e mëdha të drunjta, si hënë e plotë

Nisin të përsillen rreth e qark.
 Përhapet i mekur një avull i vakët, një tym i ëmbël,

* Unë s'e di se kush është Said Pashai. Këtë njeri që e kishte moralin si dhe zërin hyjnor, e pata dëgjuar vetëm një herë në vegjëli.

** Jalli: pallat, saraj bregdetar.

*** Jazma: shami koke me dizenjo.

**** Byrymxhyk: këmishë prej kambriku.

***** Jashmak: mbulesë e hollë fytyre që lë zbuluar vetëm sytë, e përdorur bashkë me fërexhe.

***** Tajlasan: bisht çalme.

***** Jemeni: opinga lëkure.



Çlirohen krejtësisht atë kohë nervat e mpira.
Me ta marrë temjanicën kokat, u merren mendtë;

Të dehur nga jeta, dy duar për një kokë, le të përmbysset! Vaj!
Katet e mesme, sofatet, për të ftuarit, pa dyshim:
Sofrat nuk janë mbi dërrasë;
Si ata të ulurit, të zënë me një ceremoni,
Ashtu dhe ata që ulen pas tyre, të gjithë dinjitarë!

Jacia kalon shumë, këndohen, të përsëritur, ezanë
Dhe sexhadetë e pikturuara shtrohen anë për anë.
Të gjithë drejtohen kah kiblja e falet namaz,
Thuhet në fund “amin” dhe i drejtohen lutje Zotit tonë.
Fillojani mevludit!

- Po si? S’është hoxha që do ta këndojë!
- Çoni të pyesin!
- Askush s’e ka parë!
- Ish fjala të vinte nga Yskydari, punë që bëhet kjo?
Të paktën mos jep fjalë!..
- Ama dhe ti, lëre të marrin!
- Për mua, mosardhja e të marrit është mbarësi:
Të gjithë këta ilahixhi* këndojnë më mirë se ai!
- S’e di!
- E dëgjuat tani...
- Po, shumë bukur...
- Por nuk mund të krahasohen me atë zotëri!
- Ç’do të thuash ti?
- Atij bilbili kryemjeshtër nuk mund t’i ushqejnë më foletë shok!
- E fluturove shumë lart, zotëri!
- Jo, bre, s’e fluturoj unë, ai fluturon vetë!
- Mjafton të vijë... Por nuk erdhi, s’e di pse.
- Është e kotë të presim, nuk ka as që shkon, as që vjen ende!
- Lajmi, te agai i haremit...

* Ilahixhi: interpretues të ilahive, himneve fetare.

- Sikur ta kuptonim ç'thotë...
- Këndojeni, mos prisni, urdhrin jua njofton.
- Ndoshta Nëna Mbretëreshë me hoxhën është nxehur...
- N'është zemëruar, i dha shkak tjetri, ç'është e drejtë.
- Njerëzit e një saraji bashkë me sulltanin mos i quaj gjë ti,
- Gjithë ata të ftuar e të paftuar bëji të presin, një ceremoni,
- Dhe qesh duke u thënë: "Ju luajta një rreng juve, o njerëz të hutuar!"
- S'është gjë që durohet... E ç'qenka ai? Kryemjesh të bilbil!
- Kush e di, mund të ketë arsye!
- Nuk e dëgjoj edhe sikur të ketë, madje!

Fillon mevludi siç është zakon.
 Në fillim këndohet tevhid, çdo njeri dëgjon në dalldi.
 Bukur, pastaj tetë zëra prekës të shkëlqyer,
 Diku ilahi, diku salavat,
 Diku bashkë me xhemaatin duke u ngazëllyer;
 Dhe pasi këndohen tri pjesët e mbetura
 Dhe vjen radha për "amin",
 Që tej nga larg nëpër errësira këputet një zë me të thirrura.
 Zemra e natës ndalet, njerëz e xhindë rrëqethen;
 Dritaret e hapura ngrehin veshët e dëgjojnë.
 Ndërkaq, ai rënkim hapet pak nga bregu përballë,
 Bosfori tani nxjerr zëra si Briri i Ditës së Ringjalljes!
 Atmosfera merr flakë si mali Sina pas shfaqjes:
 Sikur qindra nejë hedhin flakë gjithandej!
 Nga brigjet e nga shkëmbenjtë flakë jehojnë,
 Sikur me një harmoni davudiane malet rënkojnë!
 Ah, ai vajtim i shenjtë neji duke u përhapur gjithë qenieve,
 Ndërsa toka është ekzaltuar dhe ujjat vlojnë,
 Një poezi hyjnore nga të gjitha anët e Bosforit
 Duke u lartësuar harmonikisht,
 Në shoqërim të tyre nis të kumbojë:

"Mbreti i profetëve, person i lartësuar je, zotëri!
 Për të pashpresët, mbështetje shpëtimi je, zotëri!



I merituari i betimit “Le amruk”* je, zotëri!
Në kuvendin hyjnor, i pari je, zotëri!
Ti, Ahmed dhe Mahmud dhe Muhammed** je, zotëri!”
I dërguar nga Zoti te ne, Mbreti i Përjetshëm je, zotëri!”

.....

Më në fund, duke u shuar dalëngadalë, zërat priten,
Këndonjës in e mevludit një varkë e vjetër e sjell në breg.
Pritësi e çon me vrap në dhomën e takimeve;
“Ku mbete, hoxhë?” i thotë Nëna Mbretëreshë atëherë;
“Po gënjeve dhe ti, ç’mbetet për ne?”

“Ishte ende mbrëmje kur dola në rrugë për të ardhur
Dhe eca mjaft, kur, shihe, tani, kësmetin e shkruar,
Më doli para që atje tej një grua e moshuar
Dhe më tha: “A po qëndron pak, o bir!” Qëndrova, i detyruar.
- Zembrën dukesh se e ke me besim, kam për ty një shërbim,
Por mos ma kundërshto; zaten vdekja më ka shkatërruar,
Një nënë e djegur jam, fëmijë sa një mal kam shtënë në dhé!
Të paktën këtë të dyzetën natë për shpirt të sime bije
Të këndoja një mevlud thashë me vete;
Po si? Ka shumë që këndojnë, por dora ime, e thatë..
Ti je hoxhë, e këndon, pa fjalë; eja, o bir, të shkojmë!
Ç’bëhet sikur të lodhesh pak? Eja, mos më bëj të pres, është mëkat!
Gëzoma për hir të Allahut bijën time,
Edhe Allahu ty të të ketë ndër robtë e zgjedhur në të dy botë!

Fjalët e gruas më hutuan:
As saraj më mbet në përfytyrim, as sulltan!
“U bëftë ç’u bëftë, ec – i thashë vetes – mbaroi!”
Me qindra vetë mund t’ju këndojnë juve mevlud më mirë se unë,
Kurse nëna e djegur e së mjerës vajzë

* ... *Pasha jetën tënde (Muhammed)*.... shih Kur’ani, Hixhr:72.

** Ahmed: shumë i dashur e i pëlqyer. Mahmud: i përlavdëruar. Muhammed: i përlavdëruar në mënyrë të përsëritur.

Do të provonte shumë trima e frikacakë për njeri
Si ai që kërkon të dallojë diçka në errësi
Dhe, më në fund, do të kthehej duarbosh në shtëpi!
Të varfërve ndoshta vite të tëra ua fshijnë lotët;
Le t'i bien kokës me gurin më të fortë!
Nuk digjet pa para njeriu për fëmijën e tjetrit!
Isha i detyruar t'ju lija të më prisnit në ju paça lënë!
- Hoxhë, thotë nëna mbretëreshë, mos më bëj të qaj, mjaft!
Na këndo mevlud sërish dhe çështja merr fund!

Hilvan, 15 qershor 1931



STROFA TË REJA

PORTRETIT TIM

Ti më kujton mua me mëshirë; po dëgjove një ditë
Nga kjo kube e shurdhër se më është shuar zëri im shpresëprerë?
Shih, qoftë edhe një herë kah kjo ëndërr
Që ta dëgjoj gjer në përjetësi se më ka zbritur dritë mbi varr!

Hilvan, 10 nëntor 1931

UNI TËRHEQËS

Njeriu adhuron vetëm statujën e vetvetes;
Nuk e dëgjoj edhe sikur gjithë ditën të rrijë Zotin duke e lartësuar!
Unë ngordha për hir të këtij idhulli të mallkuar,
Kurse nga brenda kufomës së qelbur ende lartësohet zëri:
Rroftë uni im i ëmbël, tërheqës!

Hilvan, 12 korrik 1932



GJASHTËDHJETËVJEÇ

Allahu, i pakënaqur, populli s'më do, qeniet e tjera thonë:
"Ngordhtë!"

Kush më pëlqen mua? Unë i vetëkënaqur, mos ka mundësi?

Ndërsa para meje ulen një nga një gjashtëdhjetë perde nga jeta ime,

Unë s'di të kem turp nga vetja, pra vazhdoj të gogësisj!

Edhe sikur të ngrihen prapë ato perde të ulura, përfundimi
është po ai:

Me këtë meskinitet dhe pandjeshmëri a mund të quhem unë njeri?

Hilvan, 4 gusht 1932

NEVRUZIT

A po e dëgjon xhaxhanë plak, Nevruz, o biri im!
Mos fol lart, mos fol shumë; puna ta do të jesh trim!
Te fjalëshumët, barkgjerët mos i mbaj sytë!
Bëhu njeri fjalëshëndoshë, rrënjëshëndoshë, hiq nga soji yt!

Hilvan, 15 nëntor 1932



KU JE?

Ku je, o Zot i padukshëm? Mos je atje ku s'bëhet fjalë për hapësirë?
Ka qysh në krye të herës që vërtitem nëpër botët subjektive e objektive.

Ato pika drite të spërkatura kubesë tënde, lot të ngrirë;
Janë gjurmë të lotëve të mi që të kërkojnë Ty kohëve e vendeve!

Hilvan, 19 nëntor 1932

E VËRTETA E VETME

Nga kjo botë mësova një të vërtetë të vetme
Edhe pse shëtita pesë-gjashtëdhjetë vjet i hutuar:
Dashnorë zemërdjegur të vetvetes të gjithë jemi ne;
Prapë, kjo dashuri e çuditshme, e vështirë për t'u pohuar!

Hilvan, 17 korrik 1933



SHOKUT TIM TË JETËS

Vrapova e u përpoqa të të nxjerr ty në dritë,
O shoku im i jetës sime plot dallgë!
Kapërceva ç'më dolën para: mal apo gur, por këtë radhë
Balli im i rudhur u përplas me gurin e varrit tim!

ARTISTI*

*Shkëlqesisë së tij, zotëriut Arçibald Bullok Ruzvelt!***

Këtë aventurë e pata dëgjuar prej dikujt tre vjet më parë;
Ndoshta del dikush që ka kureshtje për ta dëgjuar.

... Kur treni u nda nga Bostoni më dymbëdhjetë e pesë,
Ata që vërtiteshin kot më kot në vagon, u shpërndanë menjëherë.
Pra, në kompartimentin tetë vetësh, tani vetëm unë...
Atëherë, po shtrihem, të më pushojnë koka, mendtë.
Jashtë le të kalojnë e rrotullohen në dalldi qiell, horizont, tokë,
Ti shih që qoshja ku je groposur të ketë zënë vend!
Aman, ç'pemë të smeraldta, ç'valë-valë të lashta!..
A për lule pyet? Për shtëpi? Ç'fshatra: të pasura si qytet!..
Po bukuri e rrugës? Aman, ç'pamje të bukura!..
Dhe sa shumë fabrika!..
- Ndërkaq, shpirti më kridhet ngadalë;
Nga kujtimet e qëparit as gjurmë mbetet, as vend.

Fundosem unë i mjeri duke dalë në largësi,
Kompartimenti ynë tetë vetësh nuk paska mbetur vetë:
Përballë më paska lindur një yll krejt i ri;
Nga drita verbonjëse e tij, shikimi bëhet i paaftë për ta parë
Dhe mbetet në cep të këmbëve të tij i mpakur përmbys.

Pranë, i dashuri, pa dyshim, i dashur, qibar,
Të gjitha linjat e fytyrës e tregojnë se është artist;
Shtatgjatë, serioz, një mashkull fisnik.

Drojtjen e këtij çift kumrie duke patur frikë,
U mbajta në qoshen time unë dhe një copë herë,

* Këtu është fjala për Sherif Muhiddin Beun (1892 – 1967), një muzikant i madh, ndaj të cilit M. Akifi ndjente shumë respekt si për artin, ashtu dhe për moralin e tij të lartë.

** I biri i presidentit të famshëm Ruzvelt. Kur Sherif Muhiddin Beu pati shkuar në Amerikë, ky i pati bërë një pritje të mahnitshme.



Por s'paska qenë aspak e nevojshme, e provova më pas.
Me sytë e mjegulluar te i dashuri kredhur dhe harruar;
Shpirti i vajzës dhe qielli po të shembet, s'ka për ta kuptuar!
Në qoftë ky i dashuri yt, balli serioz me linja mërzitjeje,
Shikimet e thella i janë kredhur në faqen e qiellit gjatë-gjatë.
Ndërsa qiellin sodit me ëndje me Lejlanë e vet pranë
Më përfytyrimin e së ardhmes në sy,
Me qenien tënde-hije pse do të merret?
Harroje veten, më në fund, dhe vajzën shihe ç'thotë:
- Zotrote, princ, ato tri pjesët më në fund, ç'mrekullil!
Këto kryevepra s'ka skenë që t'i ketë dëgjuar në jetën e vet!
N'i djegtë qiejt zjarri i pandërprerë i rrufeve
Ashtu siç u jep zjarr reve dielli i verës,
Edhe gishtat e tu s'i ranë, por i dhanë flakë udit
Që këlthet nën hapat e dritës!
Sikur ta dije me ç'ndjenja rënkuan para teje gjokset
Ndërsa derdhje flakë me turra ti mbi tela!
Zemra e qindra bilbilëve si të zjente e digjej,
Ato zëra vajtimi që lartësoheshin valë-valë, ç'qenë, o Zot!
Po, zëri i parë i qytetëruar yni që dëgjoji Perëndimi,
Kjo, frymë e këputur dhe ardhur nga zemra e djegur e shkretëtirës,
Ky, bashkëbisedim që, si thirrje e Zotit, epokat i bën bashkë!
Allahu e di që, ndërsa zbriste ai hark-rrufe,
Më dukej mua si e kaluara e Egjiptit, Irakut, Iranit, Mekës,
Jemenit, Gaznes, Buharasë, shkurt, Hindisë e Sindit,
E kaluara e të cilave ëshptë tani një mirazh.
Tym, tym tymon nga çdo gërmadhë kjo ndjenjë mirazhi!
- Por si do të përputhen këto fjalë me dobësinë time n'art?
Njeriut i vjen turp të falenderojë...
- Ç'do të thotë?
Edhe modestia e ka një kufi, njihe se kush je!
- Kurse unë kaq di!
- S'është aspak ashtu!
A ka mundësi ta fshehësh gjenialitetin tani?

Kokat që e ndoqën sot koncertin me habi,
 Kokat kryesore të artit,
 Ç'pamje që qe: u përkulën, më në fund, një e nga një!
 Sidomos kur, mes duartrokitjeve që këputeshin kohë më kohë,
 Godovski* të uroi dhe të tha me nderim:
 “Zotni, princ, nuk e di nëse ky art ka të ngjarë,
 Aq bukur që interpreton! Jam krenar për ty!
 Ti qëndron sot mbi çdo lavdërim!”
 Ishte një kryevepër ku të gjithëve u kish ngrirë fryma!
 - Më do i shkreti dhe...
 - Jo, jo; përsa kohë nuk ndryshon zakoni këtu,
 S’ka njeri ta dojë të varfërin: “Dollarin e do ky vend!”
 Vendin tënd s’e di, tjetër duhet të jetë!
 - Jo, një hap kali është, e shumta, ndryshimi që mund të ketë!
 - Atëherë, të njëjtët kopukë qenkëshim, shih, ç’mrekulli!
 - Por nuk është e drejtë të goditet kështu Godowski!
 Lëre gjeninë e artit që sundon atje larg,
 la shohin ata që ka pranë fisnikërinë e shpirtit.
 Po qe se edhe ai s’ka në gjoks një zemër që ndjen,
 Trupit të qenies hiqi sipër si bark një qefin!
 - Mirë, po të tjerët? Mos dhe ata i ke miq?
 - Jo.
 - Ç’të thanë pastaj, a e harrove?
 “Një lloj të tillë koncerti violonçeli s’e patëm dëgjuar, princ!
 Gjenitë e mëdhenj rrallë e marrin kështu nën vete
 Këtë instrument të gjallë që gjenitë e vegjël i trondit.
 Mënyra si ti luan në ud, është një botë mrekullish.
 Po, çeloja jonë mjaft e vështirë, mjaft e ngatërruar,
 Por e ka gjetur përsosmërinë, kurse ky s’është kështu:
 Një vegël primitive përkundër të gjithë zhvillimit.
 Ato zëra ujëvarash nuk mund të dalin nga gjoksi i këtij,
 Është e kotë gjithçka! Ndërkaq, të gjithë i heshte:

* Kompozitori polak, Leopold Godowski (1870-1938).



Udi yt kohë më kohë u duk jashtëlëndor!”

Mirë, po të gjitha këto, komplimente?

- Ç’është, pra?

- Më fal,

Kam frikë se modestia do t’i ngjasë hipokrizisë!

Dili për zot, më në fund, gjenisë!...

- Lëre gjeninë tani,

Illuzioni për t’ia arritur përsosmërisë është prej meje larg!

- Ç’është kjo, në të njëjtat perde, i njëjti vendim?

- Është kështu: artisti nuk ngjitet me krahë,

Gjenialiteti kërkon flatra, kurse unë flatra s’kam.

- Ti s’ke flatra? Thuaje dhe një herë, s’e kuptova!

Qëparë, kur majat e artit tënd gjetën pikën e fundit,

Duke i kapërcyer kufijtë e botës së mundësisë, si u shndërrove?

Këtë shndërrim të zgjatur, këtë lartësim, si e realizove?

Gjithsesi, në botën e amshueshmërisë këmbëzbathur su përsolle!

A s’është pak e çuditshme të thuash tani se s’ke flatra?

Nga një flatër në kujtesën time ato të dy instrumenta që hapën flatra.

A ka vallë një të tillë gjeni që,

Ndërsa përfytyrimet ia përshkojnë qiejt e frymëzimit,

T’i hapen katër flatra kat më kat?

Gjaku në damarët e tu, nga damarët e profetëve;

Një valim i atij gjaku, për Lindjen, entuziazmi më i pastër.

Pas, etërit e tu që secili ka sunduar shekujt;

Para, emri yt që e siguron të ardhmen prej tani...

A erdhi, ta di, në këtë vend, një tjetër po kaq i lumtur sa ti?

- Lumturi? Jo, jo, mos e trego një mirazh si të ishte i vërtetë!

Në fëmijëri, po, vërtet kam qenë i lumtur,

Familja ime s’kishte ndryshim nga një xhennet.

Por ditën që u hodha nga djepi, ajri ndryshoi;

Lindjen e copëtuar, tymërat, flakët e rrethuan.

A mund të ndalet zjarri që e ka përfshirë gjithë shtëpinë?

Të gjitha krenaritë e historisë sonë u shtrinë përdhe;
As gërmadha s'mbetën nga ajo e kaluar e famshme, madje!

Ndërsa unë përpëlitesha nën këto kufizime,
U këputkësh e shkokësh copa-copa ai atdhe!
Kur u ktheva pas, pushë: as vendi ishte në vend as i dashur,
Të gjithë kishin kaluar në duar të huaja një e nga një:
I mbetur nën këtë kube: pesimizmi i një bashkësie të përmalluar!
- A ia përcillje këtë pesimizëm udit ti?
- Jo udin, por sikur të gjithë universin ta bësh të rënkojë,
Eshtë iluzion t'ua përcjellësh këtë dhimbje klithmave!
Filozofi Ikbal,* ai poeti indian, thoshte kështu:

“Zemrat i mbushën me emocion
Zërat e emocionuara të zemrës sime;
Unë jam i emocionuar nga ato zëra
Që s'kam mundësi t'i këndoj.”

Edhe ndarja që ndjeva unë në zemrën time të shembur,
Ende nuk është dëgjuar nga gjuha e instrumentit tim.
Ajo është një erë e nxehtë shkretëtire,
Si do ta përcjellin katër-pesë “ah”? Nuk përcillet dot,
Prandaj dhe ti, qëparë, pa e kuptuar as vetë,
Krejt në të kundërt, për lumturinë time fjalë të bukura the.
Mos u prek nëse bëj çudi për gjërat që dukem i denjë!
Mos u prek, kupto, jam njëri që në fund kam pësuar fatkeqësi,
Jam kah përleshem me elementin që i thonë kader.
Koka, krahu m'u lodhën nga goditjet ditë e natë;
Në këmbë jam ende, por rinia m'u shtri për tokë, më shkoi.
M'u shtri dhe në ç'kohë, shih ç'mangësi:
Iluzionin e fitores e kapërceva, shpresa e shpëtimit, larg!
Çdo hap që hodha për të ardhmen, më shkoi kot;
Në s'qoftë kjo, cilën disfatë s'e provova?

* Muhammed Ikbal (1877-1938)



A fantazma e vendit tim e kthyer në një grumbull hi?
A mjerimi i popullit tim endacak të paatdhe?
A vatra ime gërmadhë jetime me erën e vjeshtës?
A oxhaku im i pazot i hedhur në hapësirë?
A xhamia ime, tyrbeja ime, në vend të të cilave fryn erë?
A Qabeja e shenjtë e heshtur si një shkretëtirë?
A shtrirja për tokë e fesë sime që kullon gjak?
A zëri i korbit mbi këtë shembje ndjenjash?
Shkurt, cila ngjarje tragjike është që s'e kam përjetuar?
Perden e së nesërme s'e di, ajo është enigmë tani për tani.
Por po ta dëgjosh të sotmen, shkurt po ta përshkruaj:

Jam në një varkë të vjetër të rënë me ujrat në hapësirë;
Siç duket, nuk ka më mundësi të kthehem sërish në jetë.
Ç'është që, ndërsa individët më të dashur të familjes sime
Janë me mua pranë, pra, të paktën jemi bashkë,
Me furtunën që shpërthen, varka jonë ndahet
Dhe, menjëherë, të gjitha kockat që i kërcasin,
Shpërndahen një e nga një...

Aksidenti le ta zvarrisë gjeminë iluzion...
- Jo, as iluzioni i saj s'është më, dil e shih në shesh!
Përse përpiqem unë, ky i mbeturi n'oqean?
Copa e dërrasës ku jam kapur, s'vlen për ndonjë punë;
Si mund të luftohet me këto dallgë sa një mal?
Ankthi i reve shpërndahet fletë-fletë,
Zbret mbi hapësirat, më në fund, nata më e zezë.
Djathtas, majtas, para, prapa meje, errësirë turrë-turrë;
As qëllimi i qartë, as vendi ku ndodhem, as anë, as drejtim!
Kthehem e kthehem e s'dal dot, përpëlitem në pashpresim.
Më duket sikur jam një i gjallë që zbret në varr!
Herë hidhem tej me dallgët që gufohen;
Herë, një humnerë skëterrore që hapet,
Zbret bashkë me mua duke e bërë hapësirën të rënkojë;

Herë, vetëtima e fshehur nën re, e shpon dhe errësirën
 Dhe, beso, tregon një skenë që më neverit nga jeta krejt
 Dhe them: “S’luftohet me fatin, në qoftë fundi ai që pres,
 Këto copa dërrasash ku jam kapur, duhet t’i lëshoj...
 Mjaft u përfyta...” Por jo, nuk mund të rri;
 Po qe gur, e kërkoj, por vetëvrasjen s’e kërkoj!
 Zhytem, dal, shkoj...

- Sapo të thashë, princi im,
 Gjaku i Profetit është që të ndikon në shpirt.
 - Po, fundosem, dal, ndoshta, pa bërë para
 Ende unë me ato dërrasa që ti i quajte flatra!
 Ato dërrasa janë që kam në dorë në më pastë tepruar
 Gjë nga rrënojat e rinisë sime të rrënuar.

- Perëndimin e diellit do të sodisnim qëparë, apo jo? Sa keq!
 Edhe ajo rozë në perëndim tani një iluzion!
 Dëshpërimi i mbrëmjes edhe mbi horizontet jetime ka rënë,
 Zemrave plot dhimbje u është kthyer, kthehu e shihe në fytyrë!

- Në këtë çast, muzgu po i ledhaton horizontet jetime
 Dhe, kur muzgu të shuhet, yjet do t’i ledhatojnë;
 Në flet për “zemrën plot dhimbje”, nesër do të jetë me diell.
 Ndërkaq, për horizontet sterrë të zeza të natës sime,
 Nga kjo kube s’ka as një dritë sa për ilaç, as dhe një zë;
 E gjitha ç’i bje në pjesë, ajo natë e zezë pa zë!
 Kur zbres në thellësitë e zemrës sime, dridhem
 Sepse shenja në krye të emrit tim, është shenja e një fundosjeje.
 Po, shenja e fundosjes, por e thellë sa mosqenia
 E diejve të mi të fundosur, lindja e të cilave ka mbetur për në
 ringjallje.
 Po emocionit yt, pse? Loti në fytyrën tënde ç’është?
 Mos e ngacmo në fund udhëtarin tënd, ej shok udhe i mirë!
 Zoti e di se zemra nuk duron dhe në qoftë gur
 Të derdhet ai rrebes që përsillet në sytë e tu!

Jo! Më djeg mua të dal i njohur me hallin tim,
Lërmë të qaj, ti hiqmu mënjanë!
A mos më mbet pa parë në këtë botë shqetësim?
Lërmë, të shkoj të paktën këto lotë pa i parë!

Hilvan, 22 gusht 1933

SHTOJCA 1

POEZITË JASHTË SAFAHATIT

Shënim

M. Akifi nuk e pati futur në *Safahat* asnjërën prej poezive të botuara para vitit 1908. Gjithashtu pati lënë jashtë librit edhe disa prej poezive të dala nga botimi më pas.

Ndërkaq, meqë poezitë që s'u botuan asnjëherë, i zhduku, në dorë të të interesuarve dhe shtëpive botuese kanë rënë vetëm një pjesë prej poezive, tekstet e të cilave ndodhen në fletoret e miqve. Gjithashtu, gjer më sot ende nuk janë mbledhur dot në një vend të gjitha poezitë e M. Akifit, qofshin ato të shtypura, qofshin në dorëshkrim. Vetë M. Akifi thotë se vëllimi i poezive të mbetura jashtë *Safahatit* është po aq i madh sa dhe i atyre të përmbledhura në *Safahat*.

Sa për himnin *Marshi i Pavarësisë*, ai atë nuk e futi në veprën e vet pasi thoshte se i përkiste jo atij, por popullit!

Në të gjitha botimet e *Safahatit*, pjesa e plotë e *Shtojcës* është e renditur si këtu duke e vënë *Marshin e Pavarësisë* në krye, kurse poezitë e tjera, sipas datës së botimit. Për poezitë e pabotuara janë shënuar burimet. Poezitë janë shoqëruar me shënime të ndryshme sqaruese duke u mbështetur kryesisht në botimet turqishte.

M. Ertugrull Dyzdag



HIMNI I PAVARËSISË

Ushtrisë sonë heroike

Mos u tremb! Nuk shuhet flamuri i kuq all që në agime valon
Pa u shuar oxhaku i fundit që mbi vendin tim tymon;
Do të ndriçojë, ai është yll i kombit tim,
Ai është imi, ai është vetëm i kombit tim!

Mos u ngryso hënë e re nazemadhe, t'u bëfsha fli!
Pa buzëqeshi kombit tim hero... Pse kaq mundime, pse kjo ashpërsi?
Se pastaj s'të bëhet gjaku ynë i derdhur, hallall, assesi!
Hak e ka kombi im që Hakkun adhuron, këtë pavarësi!

I lirë jetoj, i lirë kam qenë që në pafillimësi
Ç'i marrë mund të më lidhë me zinxhirë mua? Çudi!
Si vërshim gjëmues jam, shtratin e shemb, e bëj hi,
Çaj male, fushat e gjera s'më nxënë, s'njoh kufi!

N'sa horizontet e Perëndimit me mure të çeliktë janë rrethuar,
Gjoksin tim plot besim si fortifikatë kam vënduar!
Le të ulërijë, mos ki frikë! Kurrë s'ka për ta shuar një të tillë besim
Kuçedra me një dhëmb në gojë q'i thua qytetërim,

Mik! Mos i lër të poshtërit të kalojnë nëpër këtë vatan
Bëje trupin mburojë, ky sulm i paturpshëm të ndalojë, aman!
Do të agojnë për ty ditët që Zoti t'i ka premtuar..
Kush e di? Mbase nesër, mbase më herët kanë për të aguar!
Tokës që shkel mos i thuaj dhé, njihe, thjesht mos e kalo!
Për mijëra të paqefinë që shtrihen nën të mendo!
Ti je bir shehidi, është turp ta fyesh tët baba,
Mos e jep këtë xhenet vatan, edhe n'të dhënçin shumë të tilla
si kjo dynja!

E kush për këtë xhenet vatan nuk bëhet fli?
 Shehidë shpërthejnë, po ta shtrydhësh, nga kjo tokë, po si!
 Edhe në m'i marrtë Zoti gjithë ç'kam, xhan e xhanan
 Të mos më lërë të ndarë në këtë botë nga ky i vetmi vatan!

Shpirti në ty ka o Zot vetëm një shpresë:
 Në gjoks të xhamisë sime të mos prekë dora e të pafesë!
 Këto ezane, shehadeti i tyre themel i fesë
 Jehonë e tyre mbi tokën e atdheut tim përjetë të mbesë!

Atëherë guri i varrit, në paça, mijra herë në sexhde, në dalldí;
 O Zot, nga çdo plagë më kullon si gjak loti
 Nga dheu kufoma më shpërthen si një shpirt i ri;
 Atëherë, ndoshta, koka ma prek Arshin, ç'krenari!

Valëzo si agimet edhe ti, o gjysmëhënë me nam!
 Hallall t'u bëftë gjaku ynë i derdhur edhe në s'jam!
 Për ty, për kombin tim që s'do ta shohë më robërinë!
 E ka hak, flamuri im që i lirë jetoi, lirinë!
 Hak e ka, kombi im që Hakkun adhuron, pavarësinë!*

* *Sebilurreshad*, vëll. 18, nr. 468, f. 305, 17 shkurt 1921, Ankara.



ME LEJEN TUAJ...

Marrëzisht i dëshpëruar, me dëshira si varg i pambarim;
Me këtë hall, shkak zilie për dashnorët jam!
Mendjen ma more, o ti që djeg shpirtrat;
Zoti e di, në të shkruarën e Tij i mbytur jam!
Po deshe, vramë, o shpirt i im i trazuar;
Flí të është urdhrit tënd jeta, flí dhe unë të jam!
Koha më la jashtë portës së bujarisë mua;
Edhe nga nderi për ta kuptuar shpresën i mangët jam!
Ti: qiri për kuvendin e kundërshtarëve, ah;
Unë: në Hallkallë, heqësi i dhimbjeve jam!
Nuk e di ç' iluzion tregon pasqyrë e qiellit;
Pritësi i pashpresë i favorit të Zotit jam!
Ti je që më ke shtyrë të bëhem poet, o hënë;
Me harenë tënde, pamje e një Shpirti të ndritshëm jam!
Kalem i të fshehtave që shpërthen flakë,
I dobët s'jam, mjeshtër i fjalës me kuptim të thellë jam!
O fllad i agimit, në ardhsh tek një dashnor i tillë, thuaji
Shok i dhimbjeve dhe vuajtjeve zemërthyese jam!
Kuptoje ç'ka hequr Akifi yt i mjerë që vajton;
Më vdiq; i merituari i ndihmës nga plag' e vuajtjes jam!
Pyete, a do të ndjejë kënaqësi kjo zemra ime e pashpresë?
Dhimbje ndarjeje, apo e tillë gjithmonë do të mbesë?*

22 Teshrinievel 1308, 3 nëntor 1892

* Fevzije Abdullah Tansel, *Mehmed Akif*, 2.b., Stamboll 1973, f. 11-12.

GAZEL

Pash Allahun, mos m'u zhduk nga sytë!
Për kokën tënde, të dashurin mos e ço më kot!
Kurban m'i bëhet shpirti shikimit të zemëruar;
Nga viktim' e dashurisë sate kështu mos i hiq sytë!
Eja në ndihmë, o hënë, kuvendi i miqve n'errësirë;
Çdokush po fle, nga të zgjuarit kurrë mos u tut!
Se ç'mundim është ashku yt, edhe ti e di;
Eja, mos ma thyej zemrën, mos më dëshpëro krejt!
Unë s'e braktis vendin ku je ti, ah, e vetmja ime!
Të pashpresit në portën tënde mos ia pre shpresën krejt!
Mos e përzë nga porta këtë zemërdjegur;
Ki mëshirë për atë që derdh lot për ty, mos e troshit!
O dritë e syve të mi! S'ngopem duke të parë!
Pash Allahun, mos m'u largo nga sytë!*

* *Hazîne-i Fünûn*, viti I, nr. 25, f. 200, 16 Kanunievvel 1309 / 28 dhjeto 1893.



TERKIB-I BEND*

Saki! Sille atë verën që është shpirt i gjallë;
Sjell hare për ankthin e të strukurit në hall!
Në sy të njerëzve të përkryer, çdo pikë e saj
Si dielli i të vërtetës, dritë shpërndan!
Pasqyra e ardhmërisë së çdo pjesëmarrësi
Në gotën ngjyrëtrëndafilore, është shndritje e paanë!
Saki, le të pimë për dashuri të miqve të vjetër,
Kushdo nga të cilët fshihet në një skaj mënjanë!
Saki, le të pimë, s'na vjen më në dorë koh'e djalërisë,
Ja, kjo kohë e çmuar është e dëfrimit stinë!
Mos hiq dorë nga ky i dehur vere i përjetshëm;
Në gjendje të keqe, i pashpresë është viktimë!
Bota begatisjellëse që është e huaj për të,
Si ta dijë? Ky është një tjetër njerëzim!
Të shkujdesurit rrinë e bëjnë shenjë në atë mjedis;
Edhe sasexhinjtë, madje, si bilbilë, ia thonë me vajtim!
Gjoja në favorin e gotës së atij sakiut me gotë elegante,
Begatia është e shprehur qartë pa dyshim!
Në çdo qoshe një mijë shfaqje bukurie të ndritshme;
S'është mejhane, por trëndafilishte parajsore me begatim!
Gota e verës s'mund t'i bëhet njeriut bashkudhëtar;
Sidomos në mejhane për njeriun nuk ka shpëtim!

* * *

Nga buzëqeshja në fytyrë të të poshtërve u mërzita,
Nga miratimi apo grindja pa vend u mërzita!
E ardhmja do u arritka duke puthur dorë;
Unë nga temena të tilla të turpshme u mërzita!
Kot paskam shpresuar për përparim;
S'di ç'të them, së fundi, edhe nga kjo sevda u mërzita!

* Poezi e formuar nga disa fragmente me tipe rimash të ndryshme.

Zoti e di se s'e kam syrin në pasuri e pushtet!
 Nga kjo botë me pasuri e pushtet të rremë u mërzita!
 Mos i beso askujt dhe në qoftë trim a frikacak;
 Unë nga soditja e çdokujt me habi u mërzita!
 Përpiqem të vazhdoj t'i mbetem besnik rrugës së drejtë;
 Sa keq që sot, ja, nga kjo çështje e drejtë u mërzita!
 Sigurisht, vjen një ditë e mërzitesh ngaqë s'kupton dot;
 O Zot, duke ta hapur zemrën ty u mërzita!
 Vendosa të qëndroj në pikën ku bëhet durim;
 Edhe së ia rrëfyeri Zotit hallin tim u mërzita!
 Hoqa dorë nga pranvera dhe blerimi i fatit;
 Së qeni shok i ngushtë i bilbilit të marrë u mërzita!
 Në daç, hiç mos u duk, o agim i qëllimit!
 Së përfytyruari ty çdo kohë si ëndërr u mërzita!
 U përpoqa mjaft me idenë për të qenë indiferent;
 Falenderuar qoftë Zoti, me çdo gjë u përshtata!

* * *

Injoranti shëtit në varkën e të mirave dhe dëfrimeve,
 I dituri noton në mes të vorbullës së halleve.
 Sa keq që njerëzit e mirë e të zgjedhur
 Dërrmohen në dorën e ndyrë të injorantëve!
 Disa vazhdojnë të kënaqen me pranverën e bukur,
 Disa jetojnë dimrin nën shtrëngesën e furtunave!
 Disa mbyllin në zemër mendimin për të dashurin,
 Disa shëtisin me pesimizëm në botën kalimtar!
 Njëri mbështetet në shtratin tërë naze të bashkimit,
 Tjetri ndryshket i strukur në një skaj prej vuajtjeve!
 Te njeriu i mençur nuk sheh dot dëfrim,
 Kurse te injoranti, përtej të gjitha mundësive!
 O Allah me urtësinë që i bën të virtytshmit të të admirojnë;
 A mos u le ndonjë dhunti admirimi të virtytshmëve?
 Po të mos ish bërë njeriu i dobët në gjithësi,



Ruana Zot! Do t'i gjente të meta artit hyjnor!
Ç'të bëjë njeriu kur s'ka mundësi të fluturojë!
E fshehta e Zotit, në të shtatin kat të qiejve!
Allahu e di, urtësinë e tij tjetërkush s'e di;
S'ka thërrime njohuri as në mendjen e gjenive!
Në vorbullën e mahnitjes mbetet mendja më në fund;
Mahnitje përtej mahnitjeve, tejpërtej mahnitjeve!

* * *

Për aftësinë e vlerësimit, dhe engjëjt të admirojnë,
O Zot, rrugën e njohjes tënde njerëzit si mund ta gjejnë?
Ç't'i bëjë dituria enigmës hyjnore?
Dituria pa prâ dobësinë e vet parasyshe e mban!
Kudo jep ngushëllim dëshmimi i begatisë tënde;
Me dritën e bukurisë përshndrit gjithësia anembanë!
Begati e shenjtërisë sate është shndritja e diellit;
Treguesi i hyjnitetit tënd është hëna që vezullon.
Fuqia, madhështia: të posaçme vetëm për ty;
Fuqia, madhështia vetëm tek ti shkëlqejnë!
Një je, i pafillim, i pafund, i përjetshëm;
O Zot, a ka mundësi të themi s'je, të të mohojmë?
Ti je në të gjitha aktet aktori i vërtetë;
Ti je ai i zoti i arshit që jep prej atje ferman!
Një pjesë e këtij populli të dinë ty për Zot,
Kurse një pjesë tjetër këtë çast ty s'të besojnë!
Ndërsa njerëzit e virtytshëm janë treguesi i besimit,
Shumë të ditur, nga mosbesimi disfatë pësojnë!
Në çdo vështrim bien në sy një mijë nyje urtësie,
Por ato shikimi i syrit dot s'i zbulon!
Vendimet e urta të ligjit hyjnor janë të mëdha,
Kurse masa e vogël e meditimit dot s'e zotëron!

* * *

Statujën e çdo njeriu, njeri të gjallë e pandeh?
 Njerëzimin, një trajtë të ngurosur po e pandeh?
 Meqë njeriu është i denjë për respekt,
 Këdo person që sheh, a mos të nderuar e pandeh?
 Është koha e zemrës së thyer, e fatit zemërthyes;
 Njerëzit e mendjes në këtë botë a të gëzuar i pandeh?
 Bujaria e të bijve të kohës atyre u mbettë;
 Hileqarin që shtiret bujar, Hatem* po e pandeh?
 O ti që mbështetesh në fatin e mirë të një dite,
 Shkëlqimin e madhësisë a çdo kohë e pandeh?
 Një herë vetëm bëje të flasë të mjerin që ke para
 Dhe shih ç'thotë; atë memec po e pandeh?
 Mos e shih të dobëtin gojëmbyllur se s'ka ç'të bëjë;
 Të shkretin, me të vërtetë s'di të flasë e pandeh?
 O kokëtrashë që krenohesh me pasuri e pushtet!
 Dhe botën, të hutuar si veten po e pandeh?
 Një mijë lloje të vërtetash ka në të që ti s'i di;
 Me tri fjalë, o hoxhë, veten njeri më të ditur po e pandeh?
 Dijetari që i thua, s'është nga i llojit që njeh ti;
 Kohët që kalojnë në shkujdesje, dëfrim po i pandeh?
 Rruga e Zotit e qartë është për syrin që shqyrton;
 Kur ke rrugën e drejtë, të ecësh prapë është marrëzi!

* * *

Dikush ia ka ngulur sytë së ardhmes,
 Kurse e ardhmja vjen vetiu vetë!
 Njeriu që e flijon të sotmen për të ardhmen,
 Një dëm shumë të madh bën pa vend!
 Sa keq për jetën që kalon me keqardhje për të shkuarën;
 Keqardhja e shpenzon dhe e humb jetën pa vend!
 I mençur i thonë atij njeriut që në kohë
 Merr fitime të mëdha e s'rri në vend!

* Bujar i njohur ndër fiset arabe; përgjithësisht kryebujar, kryefisnik.



I pakuptuar i thonë atij njeriu që në botë
Veçse dëshpërohet për të shkuarën aty ku rri në vend!
Duhet ditur qëllimi i ardhjes në këtë botë;
Mos pandeh se kush vjen në botë, bën një udhëtim për qejf!
Ia arrin qëllimit kush duron,
Kurse përpjekja i jep fitoren atij që përpiqet!
Ata që tregohen të ngathët në marrjen e masave,
S'e dinë, pra fatit ia hedhin fajin e vet!
Iu lumtë atyre që i bëjnë pasardhësit të lumtur
Dhe emri i tyre zë ndër zemra vend!
Mijra vetë dëshirojnë të kujtohen për të mirë;
Mijra vetë mallkimit ia nxjerrin gjoksën vetë!
Në këtë botë, ç'të mbjellësh, do të korrësh, pa dyshim;
Atëherë, ç'do të thotë të shpresosh mirë duke bërë keq?*

* Erzurum Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Araştırma Dergisi, nr. 3 1972, f. 1-3 dhe fotokopjet.

KUR'ANIT

O libër – shpirt i besimtarëve!
 O këshillë e famshme ndaj mohuesve!
 O pishtar i urtësisë hyjnore!
 O përmbledhës i begatisë që s'ka të mbaruar prore!
 Kapaciteti gjykues i njeriut
 Është i pafuqishëm, s'të zbërthen ty dot? Ah!
 Ti je skena e nazeve të bukurisë hyjnore;
 Pasqyrë e të Vërtetës – të të them, e meriton!
 Shpallje e Zotit të madh e të fuqishëm je;
 Provë e fuqisë hyjnore të Zotit je!
 Bota mori frymëzim nga ti;
 Një shkëlqim përsosjeje je ti!
 Një shkëlqim i merituar me përjetësi,
 Gjer në ringjallje çdo rreze e tij!
 Asnjë rreze nuk të ka të shuar;
 Me këtë nder çdo çast je i shquar!
 Begatinë e Zotit na e ke mësuar;
 O dritë shquese, qofsh e bekuar!
 S'je e krijuar, por fjalë e Zotit vetë;
 Ndër krijesat e Zotit, je krijesë e lartë!

* * *

Furkani është libri i Mustafasë,
 Është një mrekulli e Hyjnisë.
 U bëhet i ditur të mençurve,
 Një mijë mrekulli çdonjëri prej ajeteve.
 Të shquarit e beduinëve a s'e panë
 Dhe mbetën pa gojë nga ai Kur'an?
 Furkani është nder i besimtarit,
 Është llambë ndriçuese e besimtarit.
 Rruga e Zotit me të është dalluar;
 Mbetet e panjohur po të jetë e sqaruar.



O Zot, ç'libër i lartë është ky!
Mendja s'e nxë kuptimin e tij!
Ata që lartësinë hyjnore ia mohojnë,
Ta bëjnë një si ai, ta provojnë!
I vërtetë ai libër i pashoq,
I pasjellë ende në shesh, i pashoq!
Të dobët njerëzit e kësaj bote, të dobët!
Kush ka fuqi? Njerëz e xhindë, të dobët!
Meqë fuqia u mungon
S'kanë as fuqi ta imitojnë!

* * *

Ahmedi që është profet i padyshim,
Me Kur'anin mori begati e famë!
"Fe'tu..."* duke thënë Profeti Bujar,
E bënte kokëngjeshurin të mbetej pa fjalë!
Kur thuhej "fe'tu...", mohuesit
A mund të ngulnin këmbë prapë?
Për grindje, a mund të mbetet vend?
Për zënie e luftë, a mund të ketë vend?

* * *

O stoli e dorës sime, o nderi im!
Në këtë botë, plotësimi i qëllimit,
Stolia e kujtesës m'u bëre ti!
Kapitali i kujtesës m'u bëre ti!
Ti je, sidomos, o libër i lartë
Dhe për këtë s'nguroj aspak!
Në këtë botë, shoku më i afërt,
Në tjetrën, ndihmë dhe ndihmëtar!**

* Eshtë fjala për fragmentin e ajetit kur'anor *Ve in kumtum fi rejbin mimma nezzelna ala abdina fe'tu bisuretin min mithlih...*, E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) (Bakara, 2:23). Zoti në Kur'an i ftonte mohuesit dhe kundërshtarët ta provonin në praktikë pretendimin e tyre se Kur'ani ishte njerëzor. Siç dihet historikisht, askush nuk mundi t'i përgjigjej kësaj sfide, askush nuk mundi të bënte jo ndonjë imitim të Kur'anit, por as dhe të ndonjë ajeti të vetëm të tij! Shqipëruesi.

** *Mekteb Mecmuasi*, vëll. II, nr. 26, f. 577-78, 2 mars 1311 / 14 mars 1895.

E DREJTA FITON!*

Po! S'ka parë syri në këtë botë,
Më të drejtë se kjo fjalë!

E drejta është te e larta gjithmonë;
Lartësimi është i posaçëm për këtë shqiponjë!

E drejta nuk bie poshtë, gjithnjë lart rri;
Këtij miraxhi, s'ia gjen fundin ti?

Dritë, edhe në qoftë hije që mbulon!
Jehonë, edhe n'se tejçimi ndalon!

E drejta asnjëherë nuk perëndon;
Në qiej ajo hapësirën kapërcen!

Shtirja si qorr, injorant, indiferent,
Dhe kryeneçësia s'janë gjëra me vend!

Po ta vazhdojë gënjeshtria tri ditë
Këtë këmbëngulje, del mbi të drejtë!

Po! Ndoshta perde është për një çast;
Ku është dielli? Po era, ku është?

Po s'u pa më parë ramazani vetë,
Vjen çasti kur hëna mbush katërmbëdhjetë!
Po pate frikë e nuk sheh në qiej,
Ç'të duhet, i shtrenjti im, besojë

Se drit' e saj dallohet nga toka,
Syri në këmbë që ecën, si shpëton nga ajo?

* Në origjinal: *el-hakku ja'lu* (arab.); e drejta është fituese dhe e lartë.



Ata që vëzhgojnë, hënën e dallojnë!
Ata që ngulmojnë, drejt katërmbëdhjetës shkojnë!

* * *

Ç'duhet ky pretendim pa vend?
Gabimi është tjetër, e drejta, tjetër, përherë!

Toka është tjetër, qielli është tjetër!
Hapësira është tjetër, tejhapësira, tjetër!

Përhershmeria është tjetër, përkohshmëria, tjetër!
Pafillimshmëria është tjetër, fillimi është tjetër!

Njoftimi është tjetër, ajo që është sheshit, tjetër!
Ai që dëgjon është tjetër, ai që kupton, tjetër!

I paditur s'barazohet dot me të diturin kurrë!
Dikush me dikë tjetër s'mund të kenë një gjuhë!

Urrejtja a është me pastërtinë e zemrës po ajo?
Edhe urrejtësit e thonë vetë se jo!

Nga një i urtë kur qeshë fëmijë e pata dëgjuar,
Ja, shihni, përmendësh e kam mësuar:

Sëmundja më e rëndë me mjekimin më të vështirë,
Është urrejtja, urrejtja, urrejtja, sëmundja urrejtje!*

* Resimli Gazete, nr. 67, f. 794, 12 mars 1314 / 24 mars 1898.

SADIU

*Shkëlqesisë së tij
Arif Hikmet, poet kompetent*

Jemi çirakë ne të gjithë, në të vërtetë,
Të këtij mjeshtri të kulturës vetë!
Ai është edukatori i mendimit të bashkësisë,
Ai i jep mësimë urtësie popullsisë!
Poezinë me urtësinë ndërthurur e ka ai!
Të drejtën dhe të vërtetën me poezi i thotë ai!
Dhe s'mund të përfytyrohet se,
Duke pasur një të kaluar prej gjashtëqind vjet,
Gjylistani i tij ende nuk ka parë vjeshtë,
Njomështia pranverore i mbetet e pametë!
Ç'lulishte që një çelje ka fuqi për të dhënë
Kënaqësi sa një mijë pranvera!
Ç'peizazh që, po t'ia hedhësh shikimin,
Të duken vendet e tjera zi, të errëta!
Kjo trëndafilishte çdo çast e hapur,
Soditja e saj, frymë llojlojesh dëfrimtare!
Shihni, mijra bilbila në çdo skaj të saj,
Këngës melodike ia thonë pa pushim!
Të gjitha meloditë për kohën që ikën janë thirrje!
Dëgjues të një zëri të tillë të lartë, a ka?
Ç'fjalë të zjarrta, ç'kuptim i shkëlqyer,
Shprehja ndaj iluzionit, frymë e përkryer!
Qesh, të bën të qeshesh, vajton, të çon të vajtosh!
Por përherë të tregon një parim!
Nga rrëfime të shkurtra, mësimë të mëdha,
Sa Sadiu, a ka nxjerrë tjetërkushi, pra?
Lafonteni, i dyti pas Sadiut vjen thua?
Kush ka fuqi ta zgjidhë këtë davá?
Dilni e thoni edhe ju, o poetë, një fjalë:



Tjetër *Bostan* a është shkruar, vallë?
Tjetër letrar si ai s'ka në ligjërim;
Folës i pashoq është në predikim!
Për besnikërinë ndaj të drejtës shquhet,
Në atë botë: ndërgegje që duhet!
I dashuri i të përjetshmes është përherë ai,
Në pastë gjë të pavdekshme, është vepra e tij!
Ajo është stolia e kulluar e kujtesës sime,
Ç'kam tjetër pasuri të kujtesës sime?
Imagjinata ime: vendi ku zbret drit' e saj,
Syri im: i dashuruar në të sa s'bën, i ndarë prej tij!
Në ballin e tij të gjerë, gjenialitet që shndrit,
Në bukurinë e përkryer, zgjuarsis e lartë!
Në vështrimin e tij: jashtëzakonshmëri,
Qylafi i tij, i vjetër, ç'thjeshtësi!
I qetë në dukje, i painteresuar, i pafrikë,
Me një zhgun të pastër, dervish i lirë!
Më vjen ndërmend më del ndër sy,
Sikur më buzëqesh me hijeshi!
Por me një këndje të tillë të pamjes

Që s'është as në mëngjes të pranverës!
Dhe mban mijra fjalë në mënyrë letrare,
Parashtron shumë tema kryesore!
Me karakter pak të shkujdesur,
Fanatizmin s'e paskësh pasë honepsur!
Ai flet dhe unë ia veshin dhe e dëgjoj,
Pastaj bëj semá dhe vallëzoj...
Për mua, shejhu fitimtar është ai!
Provë për mua, pastrues i shpirtit tim, ai!
Ndalni – thotë – dëgjoni këtu,
Si është e vërteta, nguleni në tru:
“Njerëzit janë si gjymtyrët e një trupi
Sepse thelbi i krijesave njerëzore është po ai!”*

* *Resimli Gazete*, nr. 68, f. 806-807, 19 mars 1314 / 31 mars 1989. Në tekst, dy vargjet e fundit janë lënë persisht si në origjinal:
“Benî âdem a'zâ-yı yek dîgerend” “Ki der âferîneş zi yek gevherend”.

FAHREDIN RAZIU

Fahreddini, emri i të cilit është titulli i poezisë sime,
 Ka shtatëqind vjet që është bërë i zgjedhur parajse.
 N'sa qe marrë me arsim pesëdhjetë-gjashtëdhjetë vjet,
 N'sa pati kapërcyer synimin e urtësisë e të zgjuarsisë,
 Me atë gjenialitet, me atë virtyt thotë: "Sa keq,
 Më në fund, kultura që mora gjatë gjithë jetës,
 Mbetet vetëm sa ç'është natyra ime e shkretë!
 Dhe mbeten pa u kuptuar mijra të vërteta sidomos
 Te toka kthehen këta trupa të vdekshëm, ç'është e vërtetë,
 Pavarësisht nga rruga, po shpirtrat ku shkojnë?
 Njohja njerëzore aq e jashtëzakonshme s'është,
 Në analizë të fundit, ajo mbaron, çështjet s'mbarojnë!
 Vjen vendi që dituria e arsyeshme tek ti të mos ecë,
 Përparimi i shkallëzuar atje është i lidhur me qostek;
 Ah, jeta ime prej shtatëdhjetë e dy vjetësh me radhë
 A mos pandeh se më fali ndonjë dobi, vallë?

* * *

Po ta them unë këtë, s'do të ketë ndonjë ndikim;
 Mendoni eruditin që është mësues në rruzullim!
 Erudit i tillë që të gjitha dijet e atij shekulli,
 Qenë të njohura për të dhe të njohura aq seriozisht,
 Sa në fikh e në tefsir, në logjikë e matematikë, imam,
 Në mjekësi, astronomi, akaid, ndër njerëzit më i lartë!*
 S'pamë te askush si Raziu në çdo shkencë kompetent;
 Njeriu s'mund të arrijë në kaq shumë shkenca kompetencë!
 Dihet se njohja e një profesioni ashtu siç duhet,
 Kërkon një jetë të tërë t'i përkushtohet!
 Ja, prandaj na i mahnit mendjet zotëria ynë;
 Çudi ç'përpyekje, ç'qëndrueshmëri, ç'gjenialitet!

* *Fikhu*: e drejta juridike-fetare islame; *tefsiri*: shkenca e komentit të Kur'anit; *akaid*: shkenca e bazave të besimit islam.



S'e di, a ka nevojë për dëshmitar çështja jonë?
Dhe sikur të ketë! Ç'do të bëhet? S'jemi të dobët,
Janë gjithato vepra autoritare nëpër duar,
Jo vetëm nëpër duar; një shumicë, në kujtesë!
Në këtë botë-biblioketë, *Mefatihü'l-Gajb**
Pa dyshim do të qëndrojë me nder përjetë!
Kjo vepër që tregon forcën e diturisë së tij,
Është e pavdekshme sa dhe teksti qiellor i saj!
Të gjitha konkluzionet si tekst e prerë i ka,
Cili studim i tij mund të kritikohet sot?

* * *

Një ditë, ndërsa Mjeshtri i madh rrinte e qante,
Dikush nga të afërmit e tij kish ardhur dhe
duke e parë me çudi,
Kish pyetur për shkakun pse kishte rënë në mërzi
Dhe shihni se ç'përgjigje kishte marrë nga vetë ai:
"Për një çështje për të cilën po shkruaj
Plot tridhjetë vjet si për një të vërtetë,
Tani mora vesh se ishte ndryshe, pra, paskësja gabuar,
Paskësja folur pa e kuptuar sikur ta kisha kuptuar!
Ja, kështu, u shkatërrua në çast një punë shumëvjeçare!
Si mund të ngushëllohem unë, si mund të rri!
Po për atë që sot duket e drejtë, a ka garanci
Se nesër nuk do të meritojë të hidhet poshtë?
Fahreddini që shëtit nëpër qiej krenar për njohuritë e tij,
Do ta shohë dobësinë kur t'i bjerë hunda për tokë!
Ç'është kjo sjellje, kjo e mbajtur më të madh, o mistrec?
Mos vallë me tri-katër fjalë u bëre dijetar, o kec?
S'pyet as për të madh, as për të vogël, as për të tjerë,
Vetëm sulmon me kritika; ky është, sipas teje, nder?
Pse duhen parë të parët nga të pasmit me këtë sy?
Na duhet pak maturi neve, maturi, maturi!"

* *Mefatihü'l-Gajb* (Çelësat e të Fshehtës), vepër tefsiri e Fahreddin Raziut.

* * *

Unë s'them të kënaqemi me veprat që kemi në dorë,
 T'u bëhemi pengesë novatorëve, atyre që punojnë!
 Njerëzit që përpiqen, me respekt i konsiderojmë;
 Pse? Sepse me ata ne zhvillohemi e përparojmë!
 E dimë ne se me të ndenjtur nuk kapërcehet rrugë,
 Se, ndërsa kaq popuj ecin para, ne s'duhet të mbetemi pas!
 Shihni të parët ç'përpjekje të vlefshme kanë bërë,
 Cila përpjekje është ajo përpjekje që e kanë dhënë?
 Po të tregojmë zell dhe ne si ata, si përfundim,
 Arrijmë te synimi i lartë i qëllimit tonë!
 Po të thoshim se veprat e shkruara nga të parët janë mjaft,
 Do të ishte turp! T'i shtosh ato vepra është virtyt!
 Po të thoshim se të gjitha bibliotekat janë sot plot
 Me gjëra të vjetëruara, pra, lini të kalben,
 Njerëzit me mend do të na thoshin "të keni turp!"
 Ta shkruajmë edhe këtë fjalë të mbetet model!
 O bir, ato s'kalben, mbeten të freskëta gjer në ringjallje;
 Ti kalbesh; dhe kundër kësaj nuk ke të thuash asnjë fjalë!

* * *

Nën shtytjen e shqyrtimit, u largova pak nga tema,
 U detyrova të shkruaj gjërat që di çdo njeri.
 Meqë shumë fjalë u thanë e u thanë, përsëri
 ta kthejmë diskutimin te zotëri e tij, Fahreddini Razi.
 Le t'ia shenjtërojmë shpirtin e ndjerë, t'ia gëzojmë!
 Emrin e tij të lartë t'ia përmendim me respekt,
 Kompetentët mahniten pas famës së kulturës së tij;
 Kë të ka gjetur shembull ty historia te të parët,
 Vetëm në të shkuarën vlerësoheshe, sa keq!
 E ardhmja nuk do të lërë mangësi në respektin për ty,
 Begatia jote do ta ndriçojë botën në çdo kohë,
 Në këto horizonte do të mbetesh i gjallë gjithmonë;



Si mund të ndodhë kaq shumë nëpërkëmbje
Kur amshimi të ka dhënë ty të ardhme?
Je për popullin krenari famësjellëse, Fahreddin!
Allah, Allah, ç'arritje, kjo, e lartë, e shkëlqyer!
Fama jote e pastër do të qarkullojë në lindje
Përsa të vazhdojë qarkullimi i eterit në këtë botë!
Ne jo veç s'mund të arrijmë në pozitën që ke zënë,
Por këtë shumica jonë as që e çon në përfytyrim!
Në kritikën tënde të përkryen pena s'ecën dot;
Edhe ajo më këmbësore se unë, me e pafuqi!
Në asnjë poezi me pasion të gjallë s'ke mundësi
Të hapësh diskutim për të e ta trajtosh në gjerësi!
Pra në vend që të përpiqem t'i numëroj vetitë e tij,
Ta përfundoj fjalën duke thënë "Allahu i dhëntë begati!"*

* *Resimli Gazete*, nr. 71, f. 842-843, 9 prill 1314 / 21 prill 1898.

QIRIU DHE FLUTURA

Më rri në kujtesë ajo natë e hidhur
Kur, duke qarë, një rënkim papritur
Dëgjova nga Flutura e shkretë
Që i thosh qiriut që digjej: “O qiri,
Edhe pse digjem, jam fli për dashuri;
Eshtë me vend kjo djegie me dalldi!
Trupi yt ndriçon konaqet,
Vajtimi yt pse, vallë? Ç’të gjet?

Me ta dëgjuar këtë qiriu në flakë,
Tha: “O ti që fluturon nëpër erë e s’ke haber nga dashuria,
Për mua Shirin ishte dylli vetë,
Si të mos jem në vaj e në zi?
Si i dëshpëruar për ndarjen e Shirinit tim,
A është shumë se qaj si Ferhati?”

Rrebeshi i zjarrit që vrullon nga syri,
U zbehka duke kaluar nga fytyra;
Nga ato lot të zjarrtë, nga ai vajtim prekës
Bëheshin të qarta këto të thëna:

“Ç’është kjo e dhënë pas dashurisë kaq shumë
Që s’ke as durim, as pushon!
Për dashurinë me mend duhet më parë
Dorëzim, mirëkuptim, qëndrueshmëri!
Ç’qëndrueshmëri! Sa keq, ti ikën menjëherë
Nga një rreze e vetme e pavlerë!
Nëse unë digjem në këmbë i tërë,
Ja, shihe pikën ku mblidhen tërë rrezet e mallit
Dhe turpërohu nga këto klithma dhimbjeje!
Kurse ty të digjen vetëm flatra e krahë!
A s’po e sheh që flaka e dashurisë



Po ma e djeg trupin krejtësisht?
Bukuria ime, te ndriçimi i kuvendit është;
Por vuajtja ime, mjerim zemre është!”

Pa u grisur mirë perdja e natës
Një perí e fryu qiriun papritmas;
Thoshte ajo në çastet e fundit të saj, madje,
Nga freskia e natës me një tym sevdaje:

“Ja, kjo është dashuria e çastit të fundit;
Në paça unë dashuri, është e flijimit!
Po qe se do ta mësosh ç’është dashuria,
Eshtë një zjarr nga i cili të shpëton vetëm vdekja!”*

* *Servet-i Fünûn*, vëll. 16, nr. 401, f. 167, 170, 5 Teshrinisani 1314 / 17 nëntor 1898; brenda shkrimit me titull *Bedâyi’ü'l-Acem*.
Përkthim nga Sadiu.

ARIF HIKMET HERCEGOVASI

Shtëpia e rrënuar që i kalon jeta duke u përpjekur,
 Sapo bie nata, mbetet aty ku bie, e këputur.
 S'e di ç'mëngjes ishte kur dola nga shtëpia një herë
 Për të mbledhur kokrrat e përpjekjes sime të mjerë.
 Mjaft male kisha kaluar, mjaft tatëpjeta kisha zbritur,
 Ish bërë mbrëmje, kisha gjetur një vend e isha strukur.
 Përgjithësisht duke qenë përgjumje gjumi im,
 Atë natë s'më ish qasur fare gjumë pranë.
 Një emocion nervoz zemrën po ma shtypte:
 Fantazia një ngjarje në horizont po ma ndjente.
 Mjedisi, nën mbulesën dashurore, kërkuese të natës,
 Me një veshje të zyrtë kish rënë nën prehjen e heshtjes.
 Bota materiale me shpirtin më kishin rënë në harmoni,
 Në atë errësi, imagjinata më ishte bërë zi!
 Drurët, si selvitë, varret të sillnin në kujtesë,
 Tërë pylli gjëmues ishte veç varrezë!
 Ndërsa përrenjtë rridhnin si jeta njerëzore,
 Ndërsa malet që përtej tabut i imagjinoja,
 Klithma e korbit m'u duk sikur më foli mua,
 Në syrin e fantazisë qielli m'u duk i ngushtë si varrezë.
 Qielli, si një botë e mosqenies, i zbrazët krejt,
 Ma tregonte trupin dredha-dredha, të kapërthyer.
 Thashë, Allah, makth është ky apo ç'tjetër, ç'të jetë,
 Për rrënim shpirtëror, çdo kohë gjoja një vit?
 Në batakun e asaj përgjumjeje shumë kohë u pllaqurita,
 Pastaj, me një shtytje instinktive veten mblodha.
 Me shpresën se ndoshta kërkuj dhe gjej bashkëkohës,
 Më bëri t'i përshkoj luginat një pas një si Mexhnuni.
 Kush mund të ndodhej në atë kohë heshtjeje të frikshme
 I rënë në gjumë si Perëndimi dhe Lindja të asaj kohe?
 Vetëm yjet, ato miljarda llamba të përjetshme,
 Duke përkujtuar gjendjen e errësisë që nuk fle



Të shtruar me kandilë të ndriçuar me dritën e përjetshme,
Vështronin me nga një sy mjaft të shkëlqyer!
Dhe rrotulloheshin si flutura nate në liri...
Ç'dritë, ç'tërheqje qe ajo, aman, o Zot!
Isha kredhur unë në atë soditje dëfryese
Dhe kisha arritur gjer në zbardhje pa e kuptuar!
Mjedisi u ndriçua, iu mbyllën sytë gjithë trupave qiellorë,
U bënë shenja të dukshme të fantazisë sime të zhytur.
Pas pak gjithë pjesët e jetës u zgjuan,
Veshja qefinore prej errësire u zhvesh e u asgjësua.
Nisi së pari te trupat ndjeshmëria dhe lëvizja,
E mori ecurinë e vet të ndërprerë veprimtaria.
Edhe unë, duke e braktisur vendin e vetmuar,
Eca vetëm para nga ndjenja ime e natyrshme i drejtuar.

Eh, sikur të mos kisha ecur... Ah, belaja na kish qenë përballë:
Sepse fundi i rrugës një treg i vogël na kish qenë.
Një shpërndarës më doli para dhe, duke marrë gazetën, thashë: "Ta-
mam, të paktën, të merrem me një gjë!"
I hodha një sy faqes së parë dhe pasi pashë
Lajmet politike, kur ktheva faqen tjetër, përnjëherë
Sytë e viktimës së fatkeqësisë u përlotën e u nxinë:
"Morëm vesh se ka vdekur Arif Hikmeti,
Allahu ia rrethoftë shpirtin me mëshirën e Tij!.."
Dy-tri fjali të tilla të njohura të bëra zakon, atë ditë
Qenë derdhur gjithësej për të vetmin njeriun tonë të vlerë...
Ç'lajm i tmerrshëm ky! Arif Hikmeti vdiq?
Ta mbyllë, tashmë, populli, defterin e të parëve!
Ç'amanet i çmuar ishte ai nga të parët ndaj pasuesve;
Ajme, sa keq, që kishte rënë në duar të jopasuesve!
Turpërohu, o popull që një doajen si Hikmeti
E mbyll jetën mes një kuvendi mjerimi!
Rrofshi, o të poshtër, e shkatërruat zotërinë;
E pritët të vdiste duke u lutur të vdiste sa më parë!

A vritet një margaritar i tillë kulture?
 Turpërohu, o ummet i ndjerë, turpërohu për këtë nam!
 Kështu respektohet një trashëgimtar profetësh?
 Do të vijë dita që t'i mësoni këto, që t'i pohoni!
 Perëndimi përmendore ngre për njerëzit e shquar,
 Kurse ne ua shkullim edhe gurin e varrit të mjerëve!
 N'sa njerëzit e shquar në Perëndim numërohen me mijëra
 Dhe vlera e fama u ruhen të mos u cënohen;
 Tek ne edhe i vetmi burrë i përgatitur në njëqind vjet,
 Nuk merr nga ç'meriton asnjë thërrime respekt!
 Një fe si Islami, a kështu duhet të jetë? Ah, sa keq!
 Duke na parë ne, të turpërohet njerëzimi i tërë!
 Lindja e hedh të vdekurin në një gropë harrese,
 Pastaj e vret atë që ia kujton dhe ia përmend emrin!
 Po të vdesë në Perëndim një njeri i shquar,
 Ai gjen në kujtesën e popullit jetën e amshuar.
 Shumica e njerëzve të shquar të vdekur te ne, madje,
 Shkojnë e gjejnë, si veprat e tyre, begati pas vdekjes!
 Njerëzit e aftë që zvarriten e vdesin këtu,
 Shihni se si e vazhdojnë jetën e amshuar atje!
 Orientalistët jua mësojnë juve Lindjen, gjithashtu,
 Të kini turp, të veshura me rroba kukllash, o trajta pa tru!
 Koka nga jashtë ju ngjet me frëngjtë, kjo është e lehtë,
 Por duhet mjeshtëri të brendshmen për t'ua përngjarë...
 Të na thuash neve njerëz është shpifje për njerëzinë,
 Qenie që flasim jemi, vërtet, por nga kafshët vijmë!
 Me mendimin për t'i bërë të ndjerit shërbimet e fundit,
 Zura rrugën, si një endacak, drejt Stambollit!
 Me një gjendje aq të çuditshme sa s'përskruhet,
 Së pari te miku im besnik, Edibi shkova
 Dhe për vdekjen e Hikmetit e lajmërova.
 Ai e kishte ditur para meje, në të vërtetë,
 Me ç'pandehja, e kish kënduar gazetën në mëngjes herët.
 Dy viktima zije ramë n'udhë si bashkudhëtarë,



Zoti mos na e tregoftë dhe një herë një udhëtim të tillë!
S'bëmë bashkë në udhë më tepër se dy fjalë,
Vetëm shkuam me një nxitim me shkak të paqartë.
Unë, i lënduar; ai, më shumë se unë i vrarë e i rrënuar!
Kush kishte fuqi për të bërë fjalë! Që të dy, të rënduar!
Banesa e Hikmetit ishte në Shehzadebashi që ne të dy
E pandehnim të mbushur plot e përplot me vizitorë!
Dhe, kur arritëm, ç'të shihnim: gjithsej aty qenë mbledhur
Pesë burra, pesë a dhjetë lutës dhe dervishë për të shërbyer!
Një ré ma mbështolli trurin atëherë pothua
Dhe nga sytë më rodhën lotët si përrua!
E vumë në supe tabutin gjer te musal-laja,
Pastaj prej aty udhëtuam për në vendin e varrezës.
Në rrugë u bashkuan dhe katër-pesë vetë të tjerë,
Bartësit u bënë njëzet vetë vetëm atëherë!
Kush qenë këta, s'e di, a ka nevojë të numërohen,
Dhe sikur të ketë, mundimi s'e vlen! Sikur të thosha
Se ne qemë më të fuqishmit ndër të pranishmit,
Eja e bëj krahasim se ç'lloj burrash qenë ata që mbeten!
Varrimi i të ndjerit nuk u zgjat aq shumë,
Unë u hoqa që atje me Nejzenin bredhës bashkë.

Letrarët kishin shkruar jetëshkrimin e Hikmetit,
"Edhe ti shkruaj nja dy fjalë" - m'u tha; por me vend,
Që të jenë të denja për nivelin e kulturës së të ndjerit;
Sido që të bëhet, përfytyrimi im i varfër fjalën do ta gjejë!
Aq njeri me vlera të larta qe Arif Hikmeti,
Sa shokun e tij rrallë do ta gjejë ummeti!
I posaçëm për të ishte vendi shumë i shquar që zinte ai,
Ai ishte, në të vërtetë, për ummetin Sadi!
Poezia e tij e zgjedhur e lartë, krejt frymëzim,
Proza e tij, gjithë interpretim i qartë i ajeteve hyjnore.
Edhe pena e tij, si shpatë e zhveshur e të vërtetës,
E nxirrte të vërtetën në shesh kundër gënjeshtërisë!

Herë entuziazmohesha si nej mansur,*
 E njoftonte me zë të lartë kohën për të dhënë shpirtin!
 Ç'ishte, Allah, ajo frymë, ajo frymëmarrje e shenjtë
 Që i jepte shpirtit te “ve nefahna”** jetë,
 Pa le kënaqësia në kuvendin e tij... Ai ishte një botë,
 Një botë e tillë, kujtimi i të cilit mbetet në zemra përjetë!
 Si të ish gojëtar i pashembullt, Arifi nga soj i lartë,
 Na i mbante neve të njëqind hutbet bashkë në një çast!
 Kur na dukej se ish vetë Hazreti Muhjiddini,
 Gjithë *Futuhat**** na i vinte atëherë sugjerimi...
 Na bënte të qanim kur e bënte predikimin prekës,
 Na bënte të qeshnim me një fjalë të vetme
 Kur e thoshte me kuptim të hollë e domethënës...
 E njihnin shumica e letrarëve iranianë,
 E admironin veçanërisht disa arabë.
 Unë nuk kam parë poet që ta njohë si ai
 Letërsinë tonë, dhe nuk shoh tjetër ndër poetët sot!
 Çfarëdo poezie e rrallë që të dilte,
 Mjeshtri atë fund e krye përmendësh e këndonte!
 Sa herë që të bëhej ndonjë diskutim për urtësinë,
 Mendimi i tij gjithmonë mjedisin e kalonte!
 Në nivelin e Ubejdit, madje, ishte në humor,
 Ishte i aftë jashtëzakonisht në bisedë të hollë!
 Na fliste neve për shekujt e kaluar në histori,
 Për veprat me përshkrime magjepsëse në letërsi.
 Parësia e popullit gjallërohej me fjalën e tij të begatë,
 Shoqëria atëherë kthehej në kuvend të lartë.
 U bëmë pesë a dhjetë kuvende të veçuara dhe thashë:
 “Një gjë e tillë është spiritualizmi në Perëndim...”
 Ishte zhvilluesi i të gjitha teorive të zgjedhura të së ardhmes,
 E vërteta i shfaqej atij si në një pasqyrë!

* Lloj i nejit.

** Eshhtë fjala për ajetin kur'anor: (Hixh: 29)

*** Eshhtë fjala për veprën e Muhjiddini Arabiut, *Futuhatu'l-Mekkijje*.



Ja ku *Levami* dhe *Levajih* qëndrojnë në shesh,
Të gjitha portreteve të tij *Saniha*-të i arrijnë dallgë.
Po sa i lartë ai Misbah, sa i shkëlqyer; është e vërtetë

Edhe në i thuhet i katërti i katër parimeve të letërsisë!
Sidomos nuk gjej dot fjalë të them për *Divanin* e tij,
Për njohjen time nuk mund të bëhem kaq krenar!
I kërkuan poetit më të madh arab, Xheririt, një ditë,
Opinion për pesë a dhjetë poezi të shquara;
E parashtron mendimin mbi secilën prej tyre,
Por, kur i erdhi radha Hansa-së, aty qëndron.
Pastaj, kur e pyesin të pranishmit pse heshti,
Xheriri thotë: “Sepse vlerësimi i tij mua s’më takon!”
Edhe për mua e tillë është poezia e tij tani,
Edhe unë, ç’është e drejta, duhet ta di mirë vendin tim!

Thuhet: “Ishte i mirë, i këndshëm, por me karakter
Të lirë; ishte dhe ca i pasjellshëm...” Pritni një herë
Dhe mendohuni se s’është fjalë që thuhet kjo,
Se s’është maturi t’i thuhet i pasjellshëm zotërisë së tij!
Ishte i pasjellshëm; por ndaj cilëve, vallë!
Kush ishin ata egoistë që e kishin bërë të tillë?
A mos po pret ti seriozitet nga njeriu
Që ka rënë mes një populli si ky?
Një popull i tillë që, në e dëgjonte burimin
E urtësisë së tij, e dëgjonte si ninanana një fëmijë!
Një popull i tillë që e mëson përmendësh Ashik Omerin krejt,
Kurse Kur’anin jo, se mërzhitet, por e lexon nga faqja drejt!
Një popull i tillë që i thotë Qoroglluit profet,
Pastaj me mijra të meta u gjen profetëve vetë!
Një popull i tillë që arsimit i thotë bidat,
E respekton injorancën sterrë si traditën profetike!
Një popull i tillë që çdo marrëzi e pandeh për dituri,
Një popull i tillë që përtacinë e njeh për butësi!
Mendoni se, kur mjedisi të jetë në një gjendje të tillë,

A nuk vlerësohet në mënyrë të trashë sjellja e tij?
 Me pak fjalë, edhe unë një ditë ndodhesha tek ai,
 Më duket se Hikmeti po lexonte nga *Saniha*-të.
 Doli dikush dhe, me një mijë gënjeshtër e marrëzi,
 Tha: “Po të jem mërziur unë, ç’do të thotë zotëri e tij?”
 Ai prapë e vazhdoi fjalën me seriozitet...
 Sa keq që i marri nuk pushoi prapë:
 “Mirë, more zotni, por kush i lexon e kush i dëgjon
 Gjithë këto fletë me dhembshuri, dashuri, miqësi!..”
 Dhe, me këtë qëndrim e përcaktoi kulturën poetike...
 Hikmetit i iku dore edhe durimi, edhe qetësia,
 E hapi thesarin e fyerjeve të panjohura gjer aty
 Dhe lëshoi një sërë sharjesh me një gjuhë të butë...
 Ejani, tani, e na thoni, ku ka këtu padrejtësi?
 Po të isha unë, do ta rrihja mirë atë faqezi!
 Ja, ky është Arif Hikmeti nga Hercegovina,
 Dijeni mirë, o ju të mbramë;
 Sa të mirë janë të parët se njihen siç kanë qenë!
 Ah, ne nuk e njohim veten, pa le të parët tanë,
 Eja, përpiquni, fëmijë, t’ju takojë juve ky nder!
 Në këtë rrugë, për të parët tanë ne u lutëm për mëshirë;
 Kurse ju, të paktën, ringjalleni ummetin e ndjerë!..

Arif, ti për ne ishe vetëtimë e urtësisë së Zotit,
 Bota i erdhi ngushtë begatisë së shkëlqimit tënd,
 Prandaj na le ne në errësi të u ngjite në horizont.
 Meqë do të vinte dita që të ndaheshe prej nesh,
 Pse, atëherë na e dogje zemrën në zjarrin tënd?

Ngjitu, më lart ngjitu e plotësoje këtë lartësim,
 Me përkryerjen tënde, pozitën e lartë bëje postin tënd,
 Gjoksin qiellor çaje e ngri atje fushim,
 Dhe bëj para me dinjitetin e shpirtrave të dëshmorëve,
 Shihe dashnorin e lirisë dhe bëji të fala nga ne!



Kurmi yt rri në gjoksin e varrit amanet,
Kujtimi yt rri në kujtesën e diturisë me respekt;
Shpirti yt noton në botën e shpëtimit, o Hikmet!

Ti s'ke për të vdekur, jo, kjo është e vërtetë...
Unë tani po e kuptoj ç'është kënaqësia në virtyt!

Njerëzit e përkryer sot u pakësuan,
Të gjithë ranë sot në një skaj e u harruan.
Shih ç'të marrë sheshin sot e pushtuan!
Frikacakët lëshuan rrënjë ngado e u shtuan!
O Zot! Fundi i kësaj dite të errët a të nesërmes i mbeti?
Në kohë u tërhoqe, o zotëri, nga mesi ynë!
Fundja, s'do qëndroje dot dhe në duhej qëndruar!
Këto horizonte s'mund të qenë për ty vendqëndrim!
Ajme, duke i ditur mirë këto urtësi,
S'e di, ç'është kjo klithmë, ky vajtimi im?

Arif, ti për ne ishe vetëtimë e urtësisë së Zotit,
Bota i erdhi ngushtë begatisë së shkëlqimit tënd,
Prandaj na le ne në errësi të u ngjite në horizont.
Meqë do të vinte dita që të ndaheshe prej nesh,
Pse, atëherë na e dogje zemrën në zjarrin tënd?

27 janar 1904

Pluhuri i këmbëve të njerëzve pjekur,
Mehmed Akif

BISEDË ZEMRE

Prapë po thur vargje... Populli? Ç'farë the?
 Po të të them tani se ç'mendoj,
 Këtyre ëndrrave u lë përjetë lamtumirë,
 Zhduken, tashmë, mes nesh, gjithë shkaqet për grindje.
 I sëmuri u ngjall, kjo punë mbaroi - po thua! Eh, sikur!
 S'mund të ketë të drejtë jete për një popull të tillë të mjerët!
 Thirrja e lirisë që po dëgjojmë, fryma e fundit e tij...
 Ji i sigurt se s'rron kjo çetë barbare
 Në rrëzë të kulturës së Evropës së qytetëruar!
 Ndoshta në atë Arabinë ranishtore të Azisë
 Gjendet varr për një shtet në gjendje kufome!..
 - Në pastë në botë politikë, është kjo, me të vërtetë!
 Dhe Gladstoni i vdekur, madje, e bën të fortë!
 A mos je, ti, or zotni, kopja e tij?
 Sepse në thëniet e atij anglezi plak
 Shpirti i mërzhitur i tërë thënieve tona!
 - Të tjerët le të thonë ç'të duan... Unë jam pesimist, monsher!
 - Po ne nuk të thamë bëhu optimist!.. Por në qoftë se unë
 Ngrihem tani e të them se pse duhet prerë shpresa krejt
 Nga populli i thjeshtë, me ç'argument
 Të logjikshëm mendon të më bindësh mua?
 Pandeh se tani ju duhet t'u lini ëndrrave lamtumirë!
 Po qe se di gjë se ç'po ndodh në vend,
 Nuk duhet të bëhesh i pashpresë se ka për t'u bërë mirë:
 Ç'zemër krenare rreh në gjoksin e popullit!
 Dëgjoje një herë dhe pastaj eja thuaj se ka vdekur!
 E vë të birin para dhe e dërgon ushtar,
 Pastaj kthehet e, pa pushuar, dhuron qetë, dhuron arë!
 E thonë: le blejë populli gjemi! More, po, kini turp
 Kur ta shihni bujarin e pafajshëm të këtij vatani jetim!
 E përpiftë dheu pesimizmin tuaj! Ç'të drejtë keni?
 Sikur është përpjekur me vite për ta bërë njeri



Këtë fis të vetmuar; të gjitha punët i kanë shkuar kot...
Ç'emotione të shtira këto! Ç'zhurmë për asgjë, kjo!
Kjo është rruga e drejtë: Eja edhe ti dhe ec para
E shihe, atëherë, sa shumë do të të vrapojnë pas!
Po të thuash "ky millet s'bëhet njeri!"
Lëreni dhe ju tërë përpjekjen, tërë udhëzimin,
Të fryjë erë e nxehtë e shkretëtirës mbi mendimin e gjithkujt
Dhe të dënohet me vdekje shpirti i shpresës pa lindur ende!
Dy gjëra janë që do t'i japin shtetit jetë të gjatë:
Zelli që s'di të lëshohet dhe shpresë e pafund!
Pesimizmi është më ngjitës se vdekja, t'i rrimë larg,
Të duam të jetojmë, të jetojmë përjetë!*

* *Siratimustakim*, vëll. IV, nr. 81, f. 47, 11 mars 1326 / 24 mars 1910.

HALLQARJE

Ah, n'sa gjithësia është plot e përplot,
 Prapë ti, o i dashuri sa vetë jeta,
 Po hyn nën mbulesën e përulësisë
 Dhe sytë po m'i heq nga vetja.
 Të orientuar nga fytyra jote,
 Mijra karvanë u nisën n'udhëtim.
 Por ato rreshta që s'të linin të shihje,
 Iu bënë pritë karvanit të shikimeve.
 Mbulesa, e jotja, vendimi, i yt,
 Hyr nën mbulim; unë ç'po them?
 Vetëm mua shfaqmu në shikim!
 O ti që ma ke ndaluar botën mua,
 O ti që ma ke bërë pozitë botën mua;
 Lëkundet tek unë frika në shpresim,
 Shihja durimin zemrës në pashpresim.
 Prej kohësh do kisha zgjedhur varr
 Sikur begatia jote të mos ish e ndarë.
 N'sa jeta më ish një barrë e rëndë,
 N'sa kisha shqetësim udhëtimi,
 Ti mua më mbajte, më dhe qetësi.
 Me praninë tënde zemra gjeti ngushëllim!
 Asgjësimi m'u bë gjithmonë si rini,
 Ah, ato vite kur isha miku yt!
 Kur më vijnë ndërmend kohët
 E kaluara në kuvendin tënd,
 Unë klith me zë të lartë!
 Kur më vijnë ndërmend,
 Thashë pa dashur, por ato kurrë
 S'kanë ikur nga zemra e shkretë!
 Po të mos më zbavisnin ato kujtime,
 Unë s'do të qëndroja dot kaq fort!
 O ti që më drejtove të bëhesha njeri,



Që me sjelljen tënde më dhe edukatë!
O ti që më tregove ç'është moral,
Që mijra mësimë më dhe për ngritje!
Ti je për mua mësues që s'ka shok,
Je mësues i dhënë nga i madhi Zot!
Unë jam admirues i qëndrimeve të tua,
Unë të di ty të lartë si fenë time!
Kështu të madhëroj unë gjithherë,
Në daç dëshmitar të drejtë: Zotin ke!
Mjeshtri te unë mos kërko, s'jam i atij rangu
Nëse kërkon respekt për njerëzit, kam shumë,
Kurrë nuk thashë dhe s'them që kam diçka...
Zemra s'më ka gjë të lartë, vetëm prirje ka;
Edhe kjo prirje, madje, në sajen tënde.
Në pastë gjë të kundërt, Zoti e di!
Prirje të lartë ka dhe, për ta provuar,
Prirja ime e brendshme sot është e mjaftuar!
Për prirje të lartë s'jam duke u krenuar,
S'është prirje por nevojë në brendësi!
Duhet ta fitojë të lartën kush është njeri;
Prirja nuk mjafton veçse për një kohë,
Sepse e larta kërkon përpjekje të plotë!
Të mos rrijë ai njeri që kërkon emër;
Vera e qëllimit nuk mbushet kot,
Pas njërës përpjekje vjen përpjekja tjetër!
Po të të jenë zbardhur netët me gjumë,
Nga ato mëngjese nuk ke lehtësim!
Po të të kalojnë ditët me dëfrim
Prirja për të lartën, shqetësim pa vend!
Kush është në pritje për vlerën e lartë,
Duhet t'i kalojë netët me yjet bashkë!
Duhet t'ia pengojë vetes shijet;
Zell duhet, por të jetë i plotë!
Gjithë shpresat e kota nga zemra t'i fshijë,

Qëllimi i krijimit ç'është, ta dijë!
Atë qëllim duhet të përpiqet ta arrijë,
Se jetesa pa qëllim për natyrë t'njeriut është tradhti,
Ta kapë thelbin e inspirimit kudo që të jetë,
Po të jetë nevoja, të zhytet në det!
Hapin e përparimit ta hedhë të fortë,
Male e fusha nga vendi t'i tronditë!
Si rrebeshi i rrëmbyer të vrapoje,
Po të shohë pengesë, ta shembë e kalojë!
Të mos kthehet pas për një gjë të kotë,
Përpjekja e shkul dhe malin e lartë!
Po doli në rrugë, duhet të shkojë para,
Të mos rrijë, të kapërcejë hapësira!
S'ka pse të rrihet kur koha nuk rri,
Këmbehet pa pushim pa të pyetur ty!
Për të ndenjtur e dëfryer po ka vend
Kur shoku yt nuk rri në një vend?
Rrugë nuk ka ku s'ka largësi;
T'u bëftë ty jeta shoku më i mirë!
Kush del në rrugën e qëllimit të lartë,
Të mos rrijë, ose, duke ndenjtur,
Të mos mendojë e thurë qëllime kot!
Udhëtari i rrugës së trimit duhet të jetë trim,
Trimi që është trim, nuk kthehet mbrapsht.
Trim i vërtetë është kush qëndron,
Për rreziqe rrugë e piratë nuk mendon!
Dhe sikur të reshjë belá, zemra të mos dorëzohet,
Të ketë gjoks si mali, të mos lëkundet!
A mos duhet të jetë njeriu i lartë
Si gruaja që i vjen i ëmbël shpirti i ngratë?
Nga jeta e kaluar në shtrat si vetí,
Unë nuk shpresoj aspak dobi.
Për të kuptuar njeriu se bota
Ç'fytyrë të brendshme, vallë, ka,



Syri i kujdesit duhet t'i rrijë hapur;
Kushdo duke fjetur duhet të rrijë zgjuar!
Toka e ngushtë duhet t'i vijë,
Duhet të ngrihet e të fluturojë në qiej!
Tërë qiejt shpirti duhet t'i çajë përtej
Gjersa në pikëlindjen e vërtetë të arrijë!
Bojën e shkrimit ta ketë të dashurin e mendimit,
Ndiriçimi i mendjes t'i jetë parim i dynjasë dhe ahiretit!
Njeriut i thonë ekzemplar i lartë,
Me tërë gjithësinë ardhka i barabartë!
Ja, pra, ky trup i thjeshtë e pa vlerë
Hapësirën kërkon ta kuptojë si është bërë.
Aftësia njohëse e shkëlqyer tek ti
Këto gjëra sigurisht me prova i di,
Enigma vjen e qartë për dijen e tij!
S'kam për qëllim ta lartësoj aftësinë tënde,
Një njeri i tillë unë s'u bëra ende.
Kush jam unë, vetitë kush m'i ka mbledhur?
Ç'është e drejta, s'kam aq guxim!
Të të përshkruash ty, a është e mundur?
Mundet vetëm po të të kem kuptuar!
Nuk gjen rrugë përfytyrimi për ta krahasuar
Personin tënd, o trim që të vërtetën ke kërkuar!
Ja, pra ku dola përsëri nga tema;
Kuptoma gjendjen time që heq nga vetja!
Ti ishe bebja e syrit të shokëve e miqve,
Ti ishe rreze drite në kuvendin e shokëve,
Thuaj pse ike në errësi, o i shtrenjtë,
Kjo ikje nga njerëzit pse duhet të ndodhte?
Kjo fshehje mjafton, më në fund, me kaq,
Pa duku një herë, o dritë, se hallin e kam keq!
I vuajturi dashnor i ndarë ka halle shumë;
Nuk ka njeri që t'i gjejë për hallet shërim!
Kudo që të shoh, më shfaqet një pamje,

Një belá që do të më jepte dhimbje.
 O dita ime e errët si net fatkeqësie,
 I dobët jam, eja më kap për dore!
 Nuk ngopem së pari ty në ëndërr,
 Por vetëm një natë, në qoftë e mundur!
 O strehë e njerëzve të mëdhenj, ku je?
 Cilat net janë vend çlodhjeje për ty?
 Duke qenë ti shpirti që ecën shpejt,
 Tani trupi ka hyrë nën një barrë të rëndë!
 Qysh kur pëlqeve tërheqjen në vetmi,
 Vendosa të bëj edhe unë si ti!
 Të gjitha kujtimet e mia për botën e njëshmërisë,
 Kujtimet e tua, o ti me shprehi hyjnore!
 Hija jote e këndshme duke më ardhur fshehtë,

Ma mbushin shpirtin plot entuziazëm çdo natë!
 Pastaj me atë joshje më kalon dita,
 Syri më bëhet që të mos shohë dot asnjë vend!
 Shih, unë s'di gjë: qenka bërë pranverë,
 E paska bërë tërë horizontin shend!
 Bota është mbuluar nën veshjen e blertë!
 Tokë e qiell kanë një ngjyrë në sy,
 Tërë gjithësia mbushur plot begati!
 Botës i ka ardhur një jetë përsëpari,
 Kur vështrimi e pa natyrën zgjuar,
 Pandeha se agimi i zgjimit kish aguar!
 Qielli është, për dëfrimin e shpirtit, një lloj barre shkëlqimi,
 Toka, brenda një jete të dytë, është plot variacione.
 Në flladin e mëngjesit fryma ka pushtet me frymën e briiri:
 Të fshehtat e ringjalljes janë të dukshme nga çdo anë!
 Në atë kohë që dallgëzon me lule e bar,
 Soditësi e pandeh për të këndshme tërë shkumbë një ujvarë!
 Shih nga e djathta, shih nga e majta, është qëndisje, është bukuri;
 Është kopësht, është begati, është lulishte qiellore;



Janë ujëra të pandërprera, është qoshe burimi parajsore;
Ç'fatbardhë është kush merr pjesë nga kjo begati entuziazmi!
Si të rrijë zemra kur koha është kohë për gëzim përherë:
Është pranverë, pranverë, pranverë, pranverë!*

* *Siratimustakim*, vëll. V, nr. 129, f. 407-408, 10 shkurt 1326 (23 shkurt 1911). Kjo poezi është botuar me pseudonimin *Sadiu*.

KËNGA E LUFTËS

*Dhuratë e revistës islame Sebilurreshad
për ushtarët tanë heronj*

Lërja vatrën Allahut dil në udhë e shko;
Që të shpëtojë vatani, thuaj, *po shkoj ushtar!*
A i takon kujt do një luftë fitimtare si kjo?
Eja, ushtari ynë trim, të qoftë për mbar'!

O trim nga grupi i mbetur pas, mos u vono,
Shoku yt iku, arrije atë dhe u bashko!
Shih se ç'thotë yt atë dëshmor, dëgjo:
"Mos rri, po shko, biri im, të qoftë për mbarë!

Mos rri, po shko, o bir, rrugën të hapur e ke...
Atë krah të papërkulur për luftë përvishe;
Dil në radhë të parë, bajonetën mbërthe!
Fatin e paç të hapur, të qoftë për mbarë!

Bëhu si rrebesh që përfshin ç'të gjejë me furi,
Mos pyet për fusha e male, kapërceji, mos rri!
Të habitet i huaji me entuziazmin tek ti!
Nisu, shko, biri im, të qoftë për mbarë!

Duke u ngjitur lart, fluturo mbi Ballkan
Dhe jepi bullgarit të tërbuar një goditje të rëndë
Të mos marrë guxim kundër osmanliut t'ngrihet në këmbë!
Shko dhe kthehu prapë, biri im, të qoftë për mbarë!
Mos e lër dushmanin t'i shkelë këtë tokë,
Eja, kaloji nën shpatë të poshtërit copë-copë,
Flamuri i tyre i zi të shtrihet përdhe si kufomë!
Nisu biri im hero, të qoftë për mbarë!"

* * *



A e pe ç'është Ballkani, o vëlla, a e kupton?
Vendi i fundit i të dashurve etërve tanë!
Një vizitë deshe t'u bësh, ka kohë që kërkon;
Tani është tamam koha, të qoftë për mbarë!

Çdo burim që buron mbi tokën e Ballkanit,
Është një plagë që kullon gjak pa pushuar;
Zemrën e çdo guri që ta hapësh: varr!
Shih ç'vend i bekuar... Të qoftë për mbarë!

Trazoje një herë borën që mbulon malet:
S'janë bar ato fije, janë flokët e gjyshit tënd!
Vër veshin: era e maleve është zëri i shehidëve!
Luftëtar trim, mos rri, të qoftë për mbarë!

O kalorës fitoreje që niseni për këtë vatan,
Sulmojeni dushmanin të gjithë si luanë!
Zotin ndihmëtar edhe Profetin keni pranë!
Eja, shkoni në luftë, ju qoftë për mbarë!*

* *Sebilurreshad*, vëll. 9, nr. 215, f. 121, 4 Teshrinievvel 1328 / 17 tetor 1912. Kjo poezi është botuar pa nënshkrim. Lufta e Ballkanit kishte filluar më 8 tetor (Eshref Edib, *Mehmed Akif*, vëll. I, f. 649, 1938).

KUSH S'E KA MIZËN NËN KËSULË, TË MOS KRUHET!

Të dashurit me shpirt, mësuesit Fahreddin

Me shpresën gjithmonë të humbur dhe fatin të paktë,
Me dështime të shkoi jeta, o popull, pa parë ditë të bardhë!
Ç'kokë të paqenë paske pasur, ç'fat të mallkuar!
Shpresove një jetë të përjetshme dhe e pive... Por pa shih
Si u bë helm menjëherë ajo që vure para: gota e lirisë!

Ja, si u përmbyska më madhështori qielli i pavarësisë;
Ja, si e shtrika përtokë asgjësimi fisin më të lartë;
Ja, si vdisa përnjëherë shpresa e ushqyer gjashtëqind vjet:
Shihi horizontet, me errësira në ngjyrë asgjësimi plotpërplot...
Ç'prisnim ne e si dole ti, o e nesërmja e ardhmërisë!

Sikur ta shihnim në ëndërr këtë ditë, s'do ta kishim besuar!
Qenka bërë mëngjes, thamë, me të ndjerë një dritë të vetmuar!
Ç'mashtrim: S'qenkësh e vërtetë as sa drita në të zbardhuar!
Një mijë shtresa skëterrore një mbi një vështirë për t'i shpuar!
O Zot, trego një dritë se tashmë me gjithçka jemi turbulluar!

* * *

Por ti o i hutuar, a ke fytyrë të kërkosh nga Zoti ndihmë?
A mund të qajnë sytë që e shohin Librin e Zotit me përçmim?
Fuqia që e ke parë të dobët, pa shihe sot, si të vjen?
A s'thoshe me shpërfillje, shpirti i Kur'anit është në vështirësi?
Po nëse ti mbetesh në vështirësi e qan, kush ta vë veshin ty?
Po, një të nesërme të tillë të shpejtë apokaliptike ti s'e mendoje.
Pati nga ata që të paralajmëruan; ti qeshe! Shumë e dredhoje!
U tërbove keqas, nuk rrije i qetë aspak, pa pushim harboje!
Për të rënin e pafaj, një gropë nga s'mund të dilte gërrmoje;
E gropose moralin, pastaj për kurvëri pornografi shkruaje!"



S'di të turpërohesh, e kuptuam, por nga ky popull ç'ke kërkuar
Që fëlliqësitë i ke quajtur "profesion" e ia ke dhuruar?
Robtë e Zotit i çorientove, po mos ndonjë rrugë u ke treguar?
Po të shohësh diku nder, ku kurvërohet je duke e dërguar;
Njeriun me natyrë të pandershmi, nën krahë je duke e strehuar!

* * *

Mustaqet shpupuritur, mjekra e gdhendur, thonjtë të gjatë;
Surrati i palarë, në syrin e majtë një xham oval, por i qartë;
Mbi zverkun tërë zhyl, një pikë yndyrë: një morr rrëshqet!
Te ky xhentëlmeni osman me kallçina që kërcen si plesht
Nën pantollona të përveshura, s'ka asnjë ndjenjë, vërtet...
Jepi ndjenjën e turpit, o Zot, mundësisht të turpërohet vetë!*

* *Sebilurreshad*, vëll. 9, nr. 222, f. 249, 29 Teshrinisani 1328 / 12 dhjetor 1912.

KUJTIMET E BERLINIT*

Por të poshtërit që e kanë nxjerrë nderin në tellall,
Nuk e kanë gjetur ende gati mjedisin për ndyrësi;

“Forma letrare e kodoshllëkut s’bëri punë
Duhet një filozofi e tillë:
Popullit i duhet mbyllur goja
Që t’i thyejë rregullat morale një e nga një!
Gjërat e shenjta mileti ende s’po i le,
Një “Allah” i vjetëruar qiellin ka pushtuar...
Ai duhet zbritur nga Froni i tij i Lartë,
Që dhe ne të shpëtojmë nga këta hipokritë!
Nuk mund të bësh ç’të duash: duarlidhur je.
Kuptoje rolin ende të tmerrshëm të fanatizmit!
Njerëzit e mëhallës ma përzënë të huajin nga shtëpia...
Po, jeta private ka edhe qehajain e saj!
Ime shoqe paska dalë para vizitorëve me *dekolte*...**
Mirë, ç’e ka prekur këtu komshiun në ndjenja?
Me çfarë ideje e ka dhënë bujaria e natyrës, vallë,
A për ta fshehur atë gjoks të bardhë?
Atë ditë që parimi filozofik “femra është për t’u shijuar”
Do të përgjithësohet, s’do të ketë më ngurrim!
Shkaku i vetëm i prapambetjes është mungesa
E shoqërisë *mondane* në çdo skaj të vendit tim!
Pa të, njeriu qesh me këtë farë “përparim”!
Le ta zëmë se u shtua gjithandej shoqëria *mondane*...
Mashkulli që hyn në jetën erotike ende si fillestar,
Shumë gjëra do të mësojë me shpresën për sukses:
E para, në fillim do të nisë të bëhet *komilfo****,

* Nëntëdhjetë e tetë vargje që mungojnë në *Kujtimet e Berlinit*.

** Në disa botime, këto fjalë të marra nga frëngjishtja dhe të përdorura këtu nga autori me qëllim ironizues për të ashtuquajturën shoqëri *mondane* (shoqëri e lirë e quajtur në turqishte *sosyete*) që imitonte Perëndimin, janë shkruar me të zezë të theksuar, kurse ne po i shkruajmë me korsiv.

*** Njeri i kohës.



Zgjuarsia do t'i hollohet, zelli do t'i shtohet.
Ndoshta një ditë do të mësojë si të vishet...
Punë e lehtë është veshja? Ka ca *sokre* ajo...
Dhe, kur rinia të arrijë t'i përvetësojë këto imtësi,
Do të fillojë të shfaqet konkurrenca në jetë kudo:
*Për ta çarmatosur** femrën që ka robëruar
Përnjëherë pesëmbëdhjetë burra, secili
Do të vrapojë me ankth për të mësuar e fituar
Nga nevoja për t'i ofruar asaj pará e zotësi!
Ç'është ai kapital i Perëndimit? Po bankat plot?
Natyrisht: Sepse i ka ballot plot e përplot!
Sepse a nuk shtohen përpjekjet e meshkujve
Kur femrat e japin veten krejt pas dëfrimeve?
As ne s'do të kishim mbetur siç kemi mbetur,
Këtë parim ekonomik po ta kishim pranuar!
Sa herë i kemi thënë këto, sa herë i kemi shkruar!
Mirëpo, kush do t'i kuptojë? Këta *kokë-borne***
S'mund të mendojnë gjerë, ndryshe çahen menjëherë!
Fjala e parë e tyre: "Allah"; E dyta punë: "fe"!
Betim në ndërgjegjen, Zotin, sheriatin, pastaj!
Po s'e përmbysëm këtë fantazi, ideja jonë s'rron!
Sepse çfarëdo që të bëjë, askush s'e kupton!
Ndërkaq, për shembje nuk mund të vëmë në rrezik,
Qëndrimi i qeverisë është gjithmonë *ekivok****.
Sapo ta shohë mjedisin *entoleran*****, fenë sa s'bën
Do ta mbajë tolerante për ta shpëtuar pozitën e vet.
Në të kundërt, ja të burgos ja të syrgjynos...
Atëherë, duhet të ecim sipas një rruge diplomatike...
Madje edhe kalemi i artistit gjenial në Robert Kolegj
Po të dojë, e jep këtë goditje... Sepse ku ka fuqi

* Në origjinal: dezarme.

** Mendjengushtë.

*** I paqartë, me dy fytyra.

**** Intolerant, fanatik, që s'bën lëshime.

Qeveria të ngrihet e t'i dalë kundër atij?
 Burri i botës, me dy flamurë dhe pse me një direk!
 Po sikur të bëjë naze? Atëherë, e lusim;
 S'ka fytyrë për ta kundërshtuar lutjen, vetëm se,
 E dini, thonë që shumica e gjenive janë *ekscentrikë**!
 Edhe në këtë personazh ka ndonjë dell prej të marri!
 Ç'është? Po jua them... Por mos qeshni: Nderi!
 Ndërkaq, kujdes, zëri i ngrysur i dalë nga këto dy rrokje
 Që kur gjejnë tru të zbrazët i bëjnë të tingëllojnë,
 Të mos e tregojë poetin e dashur të ashpër, pedant.
 Eshtë harmoni e fjalëve ku kapet ai, ndryshe,
 A e pranojnë dot rregullat e nderit natyrën e lirë?
 Kujtoni përshkrimin e Bismarkut për popullin francez;
 Edhe gjendja e këtij, përshkrimi të tij a s'i përngjet:
 'S'është parë element më i çuditshëm se këta;
 Në emër të *liberte*** -së, një *diskur**** nga mëngjesi në darkë..
 Më në fund, që të gjithë rrihi, askush nuk kundërshton,

Nuk thotë se e kuptoi *libertenë*, po rrahja, ç'kuptim ka!
 Pa i sokëllini një herë siç duhet edhe letrarit tonë,
 Ju hapet juve tashmë familja, intime e tij gjithë ç'ka!.."

Kështu thanë e iu drejtuan Kambanarit dhe ai i marrë
 Si të hidhte një enë me urinë,
 U hodhi nga dritarja gjërave të shenjta të popullit,
 Robërve të Zotit dhe vetë Atij
 Idetë e tij të shtrembëruara e të fëlliqura dalëngadalë!
 Dhe u zbraz përtokë një formë aq e ndyrë e mohimit,
 Që, edhe sikur t'i lidhnin veprat me fije të amshimit
 E t'i bënin fshesë, do të ishte e pamundur të pastrohej!
 Shëtite gjithë botën: Perëndimin, Lindjen, gjithandej...
 A ke për të parë një ateizëm kaq të tërbuar

* Në origjinal: eksantrik, që vë në qendër veten, interesin vetiak.

** Liri.

*** Diskutim, fjalim.



Që ta shkelë tokën e qiellin ta poshtërojë?
Llojin e fëlliqur kaq ndyrë të kimit
Njeriu nuk dëshiron ta dëgjojë, jo ta shikojë!
Fëmijët e tuaj fenë e mësojnë në fillim;
Parimi i edukatës suaj: politeizmit t'ia shkulni rrënjët.
Për fëmijët tanë tani ilmihali u bë groposja
E Zotit të Gjallë në gropën e së kaluarës,
Çdo gjë e shenjtë me ilmihalin mori fund!
Të rinjve u jap të drejtë... Sepse tri lopë pa tru
E shkruan dhe e shpërndanë atë lejim mohimi
Që e këputi besimin nga zemra e fëmijëve!
Pastaj e deklaruan se arti nuk do të kushtëzohet
Nga ndjenja e turpit, morali dhe gjërat “absolute”!
Paçavure që syri rrëqethet kur i sheh!*

* Këto vargje-shtesë të poezisë *Kujtime Berlini* futen në pjesën e treguar me pika pas vargut *Zambakë të helmuar që nxehin atmosferën e kurvërisë!* Këto 98 vargje janë botuar në revistën *Sebilurreshad* më 25 gusht 1334 /1918, nr. 367.

“NJERIU JETON NË RAPORT ME AQ SA NDJEN!”

Poetit Eshref

Prej shekujsh “njerëzorja” është një i burgosur,
 Ka shekuj që gjaku-viktimë i Islamit është shpërdorur..
 Pyetmë nëse e shëtita Lindjen dhe ç’pashë; Kudo
 Vatra të shembura, shtete të rrëzuar që kanë mbaruar,
 Kanale të mbushura, mure e bedena të rrafshuar,
 Dinjitete të rëna poshtë, krahë të fuqishëm të burgosur,
 Bele të përkulura, qafa të holluara, gjakëra të mpira,
 Koka pa mendim, zemra pa ndjenjë, ndërgjegje të ndryshkura,
 Xhemaate* më të mpirë se delet para kasapit, të trembura,
 Përlutje, lutje me përvujtni, robërime, poshtërsira,
 Oxhaqe që kanë zënë merimanga, pyje të djegura,
 Ara të pambjella, shtëpi ku ka mbirë bari, drithëra të mykura,
 Imamë pa falës, balle pa sexhde, fytyra të fëlliqura,
 Besimtarë mjeranë që vrasin “për fe” besimtarë,
 Çerdhe pa cicërima, fshatra pa njeri, çati të shembura,
 Mëngjese pa punë, mbrëmje në idenë e të nesërme të varfra...

Qava duke kaluar e shkova, qava dhe kur u ula e pushova,
 Sepse të gjitha këto ishin ç’pashë e ç’vëzhgova;
 Varrezë më ishte bërë rruga, dëshpërim i zgjatur pa mbarim..
 Asnjë dritë e qeshur në qiell,
 Nga toka ngjiten lart qindra mijra dhimbje në zi,
 Horizontet, në qafë të Islamit, një hallkë e kuqe flakë!
 Zinxhirët shtrëngohen, gjokset rënkojnë me ankth,
 Treqind e pesëdhjetë milionë shpirtra të ngjitur në grykë!
 “A e shëtite Lindjen dhe a the, të paktën, vetëm me fjalë,
 Të përpiqesh për ta shpëtuar këtë popull që rënkon i shtrirë?
 Unë qenkam mendjeshkurtër, syverbuar... Mirë,

* Në kuptim të gjerë, grupime shoqërore.



Po ti që i paske sytë në vend e qenke mendjehollë,
Shpjegomë, moj bijë, ç'ke dëgjuar, më thua, ç'ke parë?
Jo, s'ka nevojë as për shpjegim, gjendja është sheshit krejt
Dhe tejet e neveritshme, tejet e shëmtuar!
Në pyetsh pse, e para, askush nuk shqetësohet!
Po, s'më punon mendja, sepse bota ime vetëm qahet...
Nuk dëgjoj zë tjetër ndërsa populli im kërkon ndihmë.
Syri nuk më sheh, vërtet, sepse ndodhem në errësi, në,
Megjithëse besimi im në zemër është dritë e përjetë!
S'verbohen sytë që qajnë, trutë e ndezur nuk mpihen,
Syri që s'njomet, truri që s'ndizet janë krijim i metë!
S'kalohet nga haharisjet ndërsa gjithkahja digjet flakë...
Nga zemra që digjet, ç'kërkon? Pse je e zemëruar?
Nuk qan me mua, pastaj më thua mendjeshkurtër, i verbuar!
Nga kjo pandjeshmëri, njerëzorja të pështiroset, të rrëqethet!
Ah, sikur ta dish se ç'është faqja që s'di të skuqet!
Lëre mësimin, bijë, më parë mëso të ndjehesh e turpëruar!"*

* Kjo poezi që është një variant i parë dhe shumë i ndryshëm i poezisë *Lindja* të librit të shtatë, nuk ndodhet në Safahat. Është vendosur këtu për originalitetin që ka. Botimi i parë i kësaj poezie është në numrin 370 të revistës *Sebilurreshad* të datës 19 shtator 1334 / 1918. Në pjesën e tretë të poezisë, të futur në thonjëza, vihet re se M. Akifi i flet një vajze të re që e ka fyer. Eshref Edibi i cili e pati ribotuar pjesën e tretë duke e vënë titullin *Më parë mëso të kesh turp* sipas idesë së vargut të fundit, e tregon kështu këtë ngjarje në *Sebilurreshad* (vëll. 14, nr. 329, 9 dhjetor 1961): Në Robert Kolegj, një vajzë e zhveshur nga ndjenja kombëtare, pti thënë në një konferencë se "M. Akifi është i verbër e mendjeshkurtër". Atëherë, M. Akifi pati shkruar këtë poezi."

LUTJA E USHTRISË

Nuk mposhtem nga plaga, nga vdekja, jam ushtar;
Nga Pejgamberi më është dhënë titulli “fitimtar”!*
Një lutje kam: Jam gati të jap dhe jetën me qëllim
Që asnjë këmbë armiku të mos shkelë në vendin tim!

Amin! – Të thonë trimat gjithë përnjëherë;
Allahu Ekber! – Dëshmorët në qiell.
Amin! Amin! Allahu Ekber!

Jemi ushtarë turq, brezi ynë: heronj...
Jemi muslimanë që Zotin adhurojmë!
Ata që i quajnë idhujt e tyre për Zot, aman,
Të mos i varin në qafë faltores sime këmbanë!

Amin! – Të thonë trimat gjithë përnjëherë;
Allahu Ekber! – Dëshmorët në qiell.
Amin! Amin! Allahu Ekber!

Kur ushtria ime niset të luftojë për popullin tim,
Çdo ushtar bëhet si luan që bulërin!
Fitorja e arritur me gjak në qiej të jehojë,
Asnjë pikë gjak kot në tokë të mos kullojë!

Amin! – Të thonë trimat gjithë përnjëherë;
Allahu Ekber! – Dëshmorët në qiell.
Amin! Amin! Allahu Ekber! Allahu Ekber!

O Pejgamberi ynë i lartë, ku je?
Dëgjoje emrin nga zëri i kthjelltë në minare!
Eja pranë meje që bota të tronditet
Dhe bajoneta ime shtrembër të mos shihet!

Amin! – Të thonë trimat gjithë përnjëherë;
Allahu Ekber! – Dëshmorët në qiell.
Amin! Amin! Allahu Ekber! Allahu Ekber!**

* Në origjinal: gazi.

** Kjo poezi e shkruar nga M. Akifi në vitet e Luftës për Shpëtimin Kombëtar, 1921-1922, është melodizuar nga Ali Rifat Bej dhe i



ARTISTIT GJENIAL TË LINDJES!*

Prej vitesh rrjedh gjak kujtimi i penzës në gjoksin e malluar;
Eja, o bir i Lindjes së pashpresë, me Lindjen e vet i zemëruar!
Koha e heshtur, hapësira e heshtur, askush nuk duket në shesh,
Eja, o gjeni i padukshëm, arti yt pas teje krejt i vetmuar!
Shpirti i zvenitur i gjithë boshllëkut tënd rënkon zi të thellë,
Kjo kube e shkretë do një klithmë të lartë që të tingëllojë;
Po, të lartë, sa të udit tënd, një klithmë të lartë kërkon;
Eja, o art daudian, trego tinguj nga Briri i Ringjalljes,
Me penzën tënde të zgjohet hapësira e përgjumur e Lindjes,
Ta përmbysë çdo gjë klithma një mijë zërash e çdo teli tënd,
Qëllimet e bëra dhé, të shkunden e të ngrihen nga varri,
Dallgë jete të shpërthejnë nga cipa e shpirtit të mjedisit tënd!
Zemrat të entuziazmohen, entuziazmet të ngjiten te Zoti,
Qiejt të lëkunden nga tufani “Lebbejk”** i fuqisë së Tij!
Eja, o bir i Profetit, me natyrë përtej njerëzore,
Arti i pashpresë e kërkon sot ndihmën edhe prej teje!
Këmbë të shkujdesura shëtisin sot në mjedisin tënd intim,
Zbrit në Lindje, se e sheh ç’gjurmë të huaja ka atje!
S’ka gjë tjetër veç melezësh, të pafismësh, njerëzish të pander!
Ç’kënaqësi e ulët; meloditë bastarde, kryeveprat po ashtu!
Shpirti i fisnikërisë me një mijë ndërprerje është tronditur,
Është rrënuar; zemrat, shkretëtirë, ndjenjat janë venitur!
Kjo shkretëtirë tufane do nga hapësira e artit, që të dridhet,
A mos po ti, gjeniu i Lindjes, je duke pritur ndonjë shi?
Pa plasur udi yt i tmerrshëm një mijë goditje në gjoksin tënd,
Po s’ranë rrufe nga çdo vajtim që spërkat dete,
Këto errësira nuk lëvizin, kjo tokë e përvëlur s’pikon gjak!
E si të pikojë kur kjo hapësirë nuk laget me ato lloj shirash?
Ç’djersë derdhi nga balli Gjyshi yt, ç’u përpoq ai;

është mësuar të gjithë ushtrisë nga oficerët.

* Titulli i plotë i origjinalit: *Të vetmit artist gjenial të Lindjes.*

** *Lebbejk*: urdhëro! Është thirrja që shpreh gatishmërinë e besimtarëve ndaj urdhrit të Zotit.

Ato djersë që, kur u spërkatën, oazet në rërë u derdhën.
Kur gjithë sytë qenë nxirë me mohime, me kafshëri,
Si u lartësua zemra e këtij vendi me një besim hyjnor!
Si shpërthyen nga të gjitha gjokset ndjenja të tilla,
Që nuk mund t'i imagjinonte kuptimi i varfër njerëzor!
Tashmë është koha jote... Eja dhe ti dhe shpërtheje një oaz
Për mijra shpirtra që rënkojnë në shkretëtirë pa shpresë!
Por ai ishte profet... Vërtet, ti s'je profet...
Por ke një art, që është nga shenjat e fuqisë hyjnore, pa dyshim!
Ç'ajete të fuqishme: Në përmendjen e tyre ditët pa ndikim;
Në atë entuziazëm kumtimi, frymëzimi në atë vrullim!
Eja, o biri i Profetit, me natyrë përtej njerëzore,
Me penzën tënde të zgjohet hapësira e përgjumur Lindore!*

24 Rebiulahir 1349

18 qershor 1930

* Janë hasur tre botime të kësaj poezie: 1) në veprën e Eshref Edibit, *Mehmed Akif* (vëll. I, f. 651); 2) në botimin e Omer Riza Dogrul më 1943; 3) në botimin e Taha Toros (*Tarih ve Toplum*, nr. 39, f. 146, mars 1987). Nga shënimet në të tre botimet kuptohet se kjo poezi i është kushtuar Sherif Muhjiddinit.



LETRA E DYTË

O fllad mëngjesor, a kjo është besa jote?
Sepse nuk u kujtove të kalosh nga Hejbelia
Ndërsa vrapoje me velën në fusha e dete!..
Sikur do t'i bëje të fala me shëndet, hë, pra,
Të dashurit të hilvanasve, Abbasit, nga ne!

O fllad mëngjesor, nuk shpëton dot nga ne!
Ne, mirë, por kemi një poet që është i prapë;
I padëgjueshëm, i pëlqen vetja, fjalërendë...
Edhe nëse koha punëve njëqind drejtime u jep,
Ai vetë njuh vetëm një drejtim: hundën e vet!
Thuaji një mijë herë, ai ka të drejtë, s'ndërron,
Në çdo hap rrëshqet, shembet, por paqe s'bën!
Në pastë të rrënuar sot, jo tjetërkush, vetë ai;
Parime të vjetëruara tetëmijëvjeçare në trurin e tij!
Pret që herët a vonë bota të kthehet në këto pikë,
Siç rri kot në errësirë, vërtitet kot në hapësirë
Në kësi kurthesh njeriu a mund të bjerë?
A më i trashë është se bufët e shekullit të njëzetë?
Shih ç'mendje... Edhe mosha, në gjashtëdhjetë!
Mendja në kokë qenka; mosha, pjekuri;
Sa mirë! Sikur s'mjafton me kaq, predikon
Kam-kum, pastaj jep konkluzione në letërsi!
Fantazi - the? Dhe ç'fantazi e marrë:
Artin me anë të moralit do ta vërë në zinxhirë!
Një koketë që lakuriq është më e mirë,
Po të mbulohet për nder, ç'do të thonë pastaj?
Për shkak të artit bën durim natyral!
Edhe sikur si ëndërr ta mbulojë trupin, një tyl!
Një tyl që me mëngjeset, transparent si agim,
Një tyl i qartë sa zemra e ujrave të kulluara,
Një tyl që fijet i ka prej eteri apo prej çfarë:
Duke e mbuluar, ia zbulon krejt trupin e mjerë!

Tashmë rrobaqepësi që do ta masë e presë këtë gjë,
Eshtë kënaqësia estetike, jo endësja që end në vegjë!

O poet që vret kënaqësinë estetike, i marrë!
A u turbullove nga falimentimi i frymëzimit? Sa mirë!
Zvarritu ranishteve, hyr shpellave, ngjitu maleve!
S'ke për të pasur më frymëzim tjetër herë!
Këndo lutje, ujëra me bojë magjibërëse pi,
Prit e përpiqu, por kurrë s'do të të vijë ajo peri!
Por do të të vijnë – festë për shtëpitë – diva me radhë:
Bakalli, kasapi, barnatori, mjeku, kafexhiu,
Berberi, i zoti i shtëpisë, shitësi i bukës, perimeve
Dhe ai i çikërrimave, e do ta shkundë
E hedhë poshtë nga supet borxhin secili nga ta!
Ti do të flasësh për t'ua mbushur mendjen më kot;
Me mikun përballë – një muaj më pas bisedë!
Më kot ato fjalë, ato frymë, ato përpjekje;
Miku s'ka për të të lënë, ata s'do të shkojnë!

O poet i shtirur që për artin zinxhirë mendon!
Ke mall për frymëzim? Mirë, ja ku e ke:
Përballë demonëve më të zgjedhur të ferrit,
Le të kalojnë nga një, dikush qafir, dikush besimtar;

Dhe shikimet të kthehen e të të godasin ty si rrufe,
Shpëto të të shohim, tani, si ke për të shpëtuar!
Kush do të të vrapojë pas klithmës? Kush dëgjon,
Ndërsa tokë e qiej rënkojnë “provë” duke kërkuar?
Nga ihvan's-safa,* dikush borxhli, dikush i dështuar,
Nën kupën e qiellit, as një ndjenjë e vetme, as i mësuar!
Një Pasha të vetëm kam, edhe ai, e pe, ka shkuar,
Si plak që është, në Jakaxhëk ku po dremit i shtruar!

* Bashkësi shpirtërore-etike e filozofike e shfaqur në Basra, në shekulli IV.



Shënim:

O fllad i mëngjesit, s'është ashtu, dëgjomë mua:
Fjalinë e fundit n'e paç shkruar, bëj dhe një shënim
Me dorën tënde; shkruaj ç'do të të them:
Pashait ekzemplar i dytë nuk i gjendet gjithsesi,
Ekzemplar të vetëm e ka nxjerrë atë krijimi;
Tjetër e vërtetë edhe ndreqja, edhe stolisja e tij!
Mbështetja e tij: feja; i pajisur me fuqi fetare;
Ndoshta bie nga pasuria, por vetë nuk bje!
Te Allahu është mbështetur, vetëm atë njeh;
Nuk di çdo të thotë të kapesh për një fije pé!*

16 korrik 1932

* Teksti i këtij fragmenti poetik që është vazhdim i poezisë *Një letër* të libri *Hijet*, ka pasur tre botime: 1) Eshref Edib, *Mehmed Akif*, vëll. I, f. 652, 1938; 2) Hasan Basri Çantaj, *Akifname*, 1956, f. 214-216; 3) Sabit Ajasbejogllu, *Mehmed Akif'in Safahat'ta Bulunmayan Bir şiiri Üzerine*, *Islam Medeniyeti Mecmuası*, viti I, nr. 9, f. 19-23, 15 prill 1968.

FRAGMENTE POETIKE*

Një ditë i rashë tokës pak me kazëm, menjëherë
Më jehoi nga thellësitë ky rënkim i gjallë:
Kujdes! Godit ngadalë se, nën këtë grumbull dhé,
Sikur ta dish, sa kokë flenë, sa sy në ballë!..**

* * *

Një ditë pashë një skllav të blerë për punë
T'i kthehej të zot' e t'i fliste kështu:
Të gjejnë ty shumë sklevër më të mirë se unë,
Por unë nuk gjej dot, ajme, zotëri si ti!***

* * *

U dogja nga ato këngë të bukura,
O bilbil me atë zë hyjnor!
Po ta dëgjonte këtë melodi të pëlyer nga toka,
Davudi***, madje, do të mbetej me gisht në gojë!*****

* * *

Me kujtimet e hidhura zemra copëtohet,
Duke ruajtur në kujtesë ato melodi të natyrës, pranverës!
Ti duhet të vajtosh, por unë të mos dehem;
S'ka kënaqësi tjetër në këtë botë nga ruajtja e jetës!*****

* * *

* Këtë titull e ka përdorur edhe M. Akifi, e përdorin edhe shtëpitë botuese. Në të vërtetë, këtu ka edhe fragmente poetike siç janë strofat e përkthyer nga veprat e Saadiut, edhe poezi origjinale të shkurtra ose të përbëra vetëm prej një strofe.

** *Resimli Gazete*, nr. 69, f. 820, 26 mars 1314 / 7 prill 1898.

*** *Po aty*. Përkthim nga Sadiu.

**** Profeti Davud i shquar për lirikët e tij baritore e të natyrës, që ndryshe quhen edhe psallme. Kur i këndonte lirikët e tij Davudi, e dëgjonin malet, fushat, luginat, ia pëlqenin dhe pastaj u bënë jehonë.

***** *Po aty*, nr. 77, f. 1014, 28 maj 1314 / 9 qershor 1898.

***** *Po aty*. Përkthim nga Sadiu.



Gjithçka që ndjehjet, që thuhet për madhështinë tënde,
Eshtë pandehmë, o Allah që je përtej njohjes njerëzore!
Kuvendi u shpërnda, kurse jeta arriti fundin
Kur ne jemi ende fillestarë, të shtangur nga mahnitja!*

* * *

Ose në këtë botë s'ka besë, që, fundja, s'ka,
Ose gjithë të bijtë e kësaj kohe janë të pabesë!
Kushdo që ta kem mësuar si hidhet shigjeta,
Më pas, një ditë, më ka marrë mua shenjë!**

* * *

Po të arrinte njeriu ta mësonte ç'ka në fshehtësi,**
Për askënd më s'do të kishte qetësi!****

* * *

Edhe në ma gjetsh gjendjen time të denjë për neveri,
Mos e braktis natyrën tënde bujare; ç'nevojë ke ti?*****

* * *

Kur zbardh agimi me frymë lehtësuese, them përherë
Kokulur duke qarë me rënkim:
“A më ke kujtuar vallë, ndonjëherë,
O ti që dikur s'më fshiheshe në përfytyrim?”*****

* * *

* *Po aty*, nr. 82, f. 1075, 2 korrik 1314 / 14 korrik 1898. Përkthim nga Saadiu.

** *Po aty*. Përkthim nga Saadiu.

*** Në botën e padukshme e cila në terminologjinë përkatëse, si dhe në origjinalin e këtij fragmenti, emërtohet me fjalën arabishte *gajb*.

**** *Servet-i Fünûn*, vëll. 16, nr. 399, f. 135, 3 nëntor 1898. Përkthim nga Saadiu, brenda shkrimit me titull *Bedâ'î'ül-Acem*.

***** *Po aty*, nr. 401, f. 170, 17 nëntor 1898. Përkthim nga Saadiu.

***** *Po aty*. Përkthim nga Saadiu.

Mos më bëj më pesimist të bashkimit, o vdekje;
 Eshtë qëllimi im i fundit, të paktën këtë mos ma ço kot!
 Po vjen i dashuri, po ikën shpirti; tani, o Zot,
 Jepmë një çast sigurie dhe në Kiamet mos më ringjall!*

* * *

Mjerimi i mendjes dhe sikur të jetë fundi i rrugës së njohjes,
 Lënia e kërkimit të virtytit kurrë s'gjen pëlqim!
 Njeriut i takon të turpërohet vetë nga injoranca,
 Kurse kohës, të turpërohet për ata që s'japin ndihmë!**

* * *

Kjo, një poezi prekëse që, nga çdo rënkim i saj
 Përplaset mbi veshin e tmerrit kuptimi i jetës që qan;
 Sa keq që, nga më e zgjedhura poezi e jona si kjo,
 Ç'na bien në pjesë, ndjenjat më të dhimbshme janë!***

* * *

O ti botë e besimit mbi Zotin e vërtetë, q'e kalove
 Për hir të Zotit muajin e faljes me luftë e përpjekje;
 Merre kësmetin tënd të pastër nga sunduesi i fuqishëm,
 Mirësitë dhe favoret e Zotit të janë sot hallall!

* * *

Pritja jonë nga froni i lartë hyjnor është kjo:
 Ia bekoftë gjithë njerëzimit bajramin e madh!
 Nga qielli mbi tokë e njëjta hënë duke vështruar,
 Gjithë botën islame ta shohë të gëzuar!****

* Po aty. Përkthim nga Saadiu.

** *Siratimustakim*, vëll. I, nr. 20, f. 312, 29 Kanunievvel 1324 / 11 janar 1909. Përkthim i një strofe nga arabishtja.

*** *Siratimustakim*, vëll. II, nr. 38, f. 181, 14 maj 1325 / 27 maj 1909. Kjo strofë është shkruar nën një poezi me titullin *Sonbahar* (Fundvjeshtë) në emër të revistës, pa nënshkrim.

**** *Siratimustakim*, vëll. 3, nr. 58, f. 81, 29 ramazan 1327 tetor 1325 / 14 tetor 1909. E shkruar me rastin e bajramit të ramazanit, kjo poezi është botuar në faqen e parë të revistës, pa titull dhe pa nënshkrim.



* * *

Për respekt të Emrit të Zotit që do të ngjitet lart
Nga gjoksi i treqind milionëve të një bote të madhe
Që zgjatet nga Lindja gjer në skaj të Perëndimit,
Të qoftë i bekuar bajrami, o bashkësi e vdekur!
Drita e Vërtetë që do ta mbushë sot horizontin me ndriçim,
Shkëlqeftë gjer në ringjallje, mos u shuajttë! Amin! Amin!*

* * *

Eshtë i Shirazit, pije me shëndet!
Por mbaje edhe këtë ndërmend:
Veç duhan për llullë jep sot ajo tokë
Që ka rritur Sadiun vetë!**

* * *

Trupi kënaqet, por shpirti s'merr kënaqësi nga përtacia:
E mira e kësaj bote është të punosh, pastaj të pushosh!
Po qe se dëfrimi s'është punë, por puna është bërë dëfrim,
Domethënë, njeriu e ka lënë jetën në dëfrim!***

* *Siratimustakim*, vëll. 3, nr. 68, f. 241, 10 Dhilhixhe 1327 – 10 Kanunievvel 1325 / 23 dhjetor 1909. E shkruar me rastin e bajramit të kurbanit, kjo poezi është botuar në faqen e parë të revistës, pa titull dhe pa nënshkrim.

** *Siratimustakim*, vëll. 4, nr. 80, f. 28, 4 mars 1326 / 17 mars 1910. Mbi këtë poezi njëstrofëshe pa titull gjenden këta rreshta: "Kisha një shok nga Shirazi i cili një e dy më ngacmonte se toka jonë nuk nxirrk burra të shquar. Një ditë shkrova për humor këto vargje në një letër që ia dërgova si dhuratë bashkë me rreth pesëdhjetë gram duhan Shirazi!"

*** E shkruar pas fotografisë së një shitësi shëtitës nga qyteti Kufe. Nën të është data 21 mars 1905. *Tarih ve Toplum*, nr. 39, f. 146.

NATA E MEVLUDIT

Tokës së Lindjes të mbetur n'errësirë,
Sërish i shpërndave dritë nëpër qiej të tërë;
Një begati e madhe ndodhet tek ti,
Që mijra mëngjese të përgjumur e admirojnë!
O natë e mevludit, sikur e tillë të vazhdoje
Dhe të nesërmen në dritë ta shndërroje!*

* * *

"... ve jevmeidhin jefrahu'l-mu'minune binasril-lah..."

Meqë i pe këto ditë të bukura tani,
O popull i vdekur, do të jetosh në përjetësi!
Ndihma hyjnore të ardhmen do të ta sigurojë;
Shpresa është e fortë sepse premtimi është i fortë!
Në përmasa horizontale dhe vertikale, me entuziazëm,
Ngrihuni t'i bëjmë Krijuesit të lirisë sexhde!***

* * *

O Zot, për hir të këtij ramazani të madhëruar,
Hiqe nga mesi pengesën e bashkimit të penguar;
O Zot, të mos shtypet më ummeti nga kjo përçarje
Që vazhdon me shekuj, të mos mbet' i pashpresuar!
Meqë na dhe neve një shpirt të ri,
O Zot, një frymë e re mbështetjeje të zbresë përsëri!***

* * *

* *Siratimustakim*, vëll. 4, nr. 81, f. 41, Rebiulevvel 1328 / 11 mars 1326. Kjo strofë poetike e shkruar me rastin e Natës së Mevludit të datës 24 mars 1910, është botuar pa nënshkrim në faqen e parë të revistës.

** *Siratimustakim*, vëll. 4, nr. 98, f. 333, 8 korrik 1326 / 21 korrik 1910. Kjo poezi e shkruar më 10 korrik me rastin e përvjetorit të dytë të Reformës Konstitucionale, është botuar pa nënshkrim në faqen e parë të revistës. Në vend të titullit është vënë një fragment nga ajetet 4-5 të sures *Rum* të Kur'anit, kuptimi i të cilit është kështu: "Atë ditë muslimanët do të gjejnë shpëtim me ndihmën e Allahut."

*** *Siratimustakim*, vëll. 5, nr. 105, f. 1, 4 Ramazan 1328 – 26 gusht 1326 / 8 shtator 1910. Kjo poezi e shkruar me rastin e ramazanit, është botuar në faqen e parë të revistës pa nënshkrim dhe pa titull.



Nëse për muslimanët thonë
“Revistë treqind milionë fletësh e lidhur”,
Eshtë feja që e mban shoqërinë në këmbë;
Veç fesë s’ka lidhje tjetër!
O popull që përqafoheni për bajram,
Njerëzit lidhur ç’fije i mban?
Ty të ka rënë në pjesë kjo fe;
Po iku feja, i shkatërruar je!*

* *Siratimustakim*, vëll. 5, nr. 109, f. 71, 2 Shevval 1328 – 23 shtator 1326 / 6 tetor 1910. Kjo poezi e shkruar me rastin e bajramit të ramazanit, është botuar në faqen e parë të revistës pa nënshkrim dhe pa titull.

NATA E MEVLUDIT

Katërmbëdhjetë shekuj më parë barku yt, o natë,
Një dritë qiellndriçuese pati lindur, apo jo!
Pa hape prehrin, ta shohim ç'ke në të...
Të fshehur në gjoks e ke kujtimin e jetimit!
O Zot, i intimitetit tënd Margaritari-Jetim
Mos mbettë gjer në ringjallje ligjërisht jetim! Amin! *

* * *

"... etuhlikuna bima feale's-sufehau minna..."

Ramazani erdhi në kohë këtë vit, lavdi qoftë!
Ai ndoshta i pakëson ca dhimbjet e hequra:
Sëmundje, tërmete, zjarre, trazira, ngushticë buke,
Islamin e shtypin mijra mënxyra të tjera.
"Populli u azdis, prandaj kaq shumë bela..." – Thonë;
A s'ka të paazdisur? A të gjithë agjëruesit, të shfrenuar?
Kushdo që të jetë, mëkatarët, mos i lër pas dore, o Zot!
Ndryshe, një popull të pafajshëm mos e lër ndërkëmbë!**

* * *

Po s'deshe të dëgjosh zë armiku,
Eshtë zë vëllai, zgjohu nga ky zë!
Kur të ngrihet, sheh se qëkuri
Ka perënduar, ai që nuk zgjohet nga ky zë!***

* * *

* *Siratimustakim*, vëll. 6, nr. 132, f. 17, 14 Rebiulevvel 1329 – 3 mars 1327 / 16 mars 1911. Kjo poezi e shkruar me rastin e Natës së Mevludit, është botuar në faqen e parë të revistës pa nënshkrim.

** *Siratimustakim*, vëll. 6, nr. 156, f. 401, 7 Ramazan 1329 – 18 gusht 1327 / 31 gusht 1911. Kjo poezi e shkruar me rastin e muajit të ramazanit, është botuar pa nënshkrim në faqen e parë të revistës. Në vend të titullit është vënë një fragment i ajetit 155 të sures A'raf (7), me këtë kuptim: "A po na zhdok për atë që bënë të marrët nga ne?"

*** Kjo strofë e shkruar nga M. Akifi për gazetën *Zëri* të nxjerrë nga Hasan Basri Çantaj në qytetin Ballëkesir gjatë periudhës 17 tetor 1918 – 13 mars 1919, është vënë si nëntitull i gazetës gjatë kohës së botimit të saj.



O Karesi* faqebardhë e asaj toke të blertë,
Tani, për mijra dëshmorë, varrezë e përgjakur!
Në pastë në botë vend prehjeje të pashkatërruar
Për tët bir të përmalluar për ty, ku është?
Ti që s'ke patur shoqe nën këtë qiell,
Vreshtat e kodrave të tua, përroi i artë në luginë!
O vendi im, çdo gur i të cilit, një tempull besimi,
Patjetër, herët a vonë do bëhesh e imja, dhuratë nga Zoti im!**

* Karesi është emërtimi i asaj kohe i qytetit Ballëkesir.

** Gazeta *Yeni Gün*, 30 qershor 1338 / 1922, Ankara. Është shkruar me rastin e dyvjetorit të pushtimit të qytetit Ballëkesir nga grekët.

URIM

Vendin e Zotit e ka rrethuar dhe, në gjoksin e djegur
 Të besimit, sot prapë rënkon një turmë apokaliptike:
 As në këmbë, as në koka, as në ndërgjegje s'ka
 Shenjë të kësaj bote që mund të quhet "lidhje me të"!
 Oh, një dritë e idealizuar, pa re, e zhveshur krejt,
 Copa e poezisë së pambaruar që pashë,
 Kthehet në dalldí pa qëndruar as për një çast,
 Në përjetësinë e Mëshiruesit është tek kthehet vetë!

Ja, një shfaqje të tillë të uroj edhe unë ty:
 Që kënaqësia jote ndaj Zotit të bëhet e plotë,
 Të të mos bjerë mbi ndjenjat e zemrës
 Që kthehet me besim, as hija më e vogël
 E kësaj bote dhe e përmbajtjes së vet!*

* * *

Sikur të pres një vështrim nga ata sy
 Që s'më shohin fare, mos është shumë?
 Mos thuaj se s'më njeh, se s'jemi parë;
 A s'jam i afërt unë për sytë e tu? **

* * *

Për të gjitha veprat që shkrova, ndërrova mendim;
 Fjala s'ka kuptim; s'mund të gjendet fjalë për kuptim! ***

* * *

O Zot, ti ke tre lloj robsh, kjo është e padyshim;
 Një pjese ia jep të gjitha gjërat me të tepërt mjaft...

* Nga letra me datë 5 korrik 1928 e Mehmed Akifit dërguar Mahir Iz-it. Botues M. Uğur Derman, *Mehmed Akif'ten Mektuplar*, Kubbealtı Akademi Mecmuası, viti i 5-të, nr. 4, tetor 1976, f. 14-15. E është shkruar si urim për Abbas Halim Pashën me rastin e bajramit të kurbanit.

** Një strofë e shkruar nga M. Akifi në rini. Cituar nga Mahir Iz, Eshref Edib, *Mehmed Akif*, vëll. 2, f. 304, 1939.

*** Përkthim nga Hakim Senai. Cituar nga Mahir Iz, Eshref Edib, *Mehmed Akif*, vëll. 2, f. 304, 1939.



Për një pjesë, bujarinë e ke me kursim:
Po të të kërkojë dritë, ta zëmë, i jep naftë!
Ca, të lidhur në derën tënde të mbeten të pangrënë;
Në kërkofshin bukë të shkretët, në çast rrugën u tregon!*

* * *

Ç'urtësi është, o Zot, që s'na ke shkruar
Në pafillim edhe ne si të pasur në falenderim?
A mos të adhuroam shumë me bark zbrazur,
Që u bëmë sot të varfër në durim?***

* * *

Pas shpinës sime është një e shkuar përdhé e shtrirë;
E ardhmja që kam përballë, më e rrënuar se ajo!
Gjendja, sheshit: një shkretëtirë ku nga uji hoqa dorë,
Se s'ka një pikë iluzion*** që të më japë shpresë, jo!****

* * *

Thonë: "Çudi se si katër anglezë e sjellin botën vërdallë!
Gjithsesi, kjo e ka një të fshehtë!" Kurse anglezi thotë:
"Po qe se bijtë e mi të pafismë janë ca gjëra të guximshme,
Bijtë fisnikë janë, mbase, pesëdhjetë herë më guximtarë se ta!"*****

* * *

U ktheva te korbat, vajtojcat e rrënojave
Dhe e pashë këtë vend si parajsë, në vjeshtë..
Po t'ia njihja stinën e trëndafilave, do isha bërë bilbil;
O Zot, ç'do të bëhej po të më sillje më herët?

Gusht 1935

* Tekst i saktësuar nga M. Uğur Derman me të dëgjuar nga Mahir Iz. M. Uğur Derman thotë se M. Iz i recitonte shpesh këto vargje të autorit.

** H. Basri Çantay, *Akif'e Dair Hatıralar*, gazeta Fetih, 27.12.1957.

*** Në origjinal është fjala serab që do të thotë iluzion optik në shkretëtirë, me fjalë të tjera, që emërton dukurinë e reflektimit me anë të reve të pamjeve ujore duke krijuar për udhëtarin përshtypjen e gabuar sikur në perspektivë ka ujë.

**** Revista e përmuajshme *Ayda Bir*, nr. 11, korrik 1936.

***** M.E. Erişirgil, *İslamcı Bir Şairin Romani*, f. 204, 1956. Kjo strofë mund të jetë shkruar në vitet 1923-1925.

VILA ME TRËNDAFILA*

Je vilë me trëndafila, vërtet, po zemrat të gëzuara s'janë.
Qëndrimi im këtu, respekti ndaj së shkuarës, gëzimet s'janë.
A ka në gjoksin tënd të mugët gjurmë nga i dashuri?
O vatër e bleruar, ato kërkohen tek ti, dhomat e tua s'janë!..

4 shtator 1935

* Në original: *Kasr-i Gülşen*, vila e Abbas Halim Pashës.



PAS FOTOGRAFISË SIME

Të gjithë kanë mërguar, asnjëri nga shokët e tu s'janë!
A vetëm ti mbete nga karvani, kështu, larg?
Po pate qëllim ta shtrosh postiqen në rrugë, s'të lënë;
Eja, shih të fshihesh me gjithë hijen tënde e të ikësh vrap!

1935

PORTRETIT TIM

Po e kam zili hijen time që duket e freskët...
Ç'lumturi! Edhe këtë, madje, e kam mangët!
Besoj se edhe për një farë kohe barrën e jetës
Jam i dënuar ta bart pa m'u dridhur gjunjët!
Zgjidhma, tashmë, gjalmën e barrës të bërë nyje,
O Zot, dhe mos ma kurse jote një grusht dhé!*

1935

* Kjo poezi e shkruar pas vdekjes së Abbas Halim Pashës, është botuar në librin e Eshref Edibit (vëll. I, f. 133, 653).

SHTOJCA 2

FOTOALBUM





“O Hapës i dyerve, na i hap dyert e së mirës” - Mbishkrim mbi derën e xhamisë së vjetër të f. Sushicë e Epërme të Pejës, Kosovë, ku qëndron edhe data e ndërtimit të saj sipas kalendarit hixhrij, që përkon me vitet 1855-56, kur Tahir Efendiu kishte vajtur në Turqi.



Xhamia e vjetër, për shërbimet e së cilës Tahir Efendiu në mesin e shek. XIX ishte dërguar për studime në Turqi. Është djegur në luftën e vitit 1999, ndërsa në vitin 2015 është ringritur me ndihmën e TIKA-s.



Këtu kishte qenë shtëpia e familjes së Tahir Efendiut - rrëfen kushëri
Adem Beqa (Mulaj) në Sushicë (vdiq më 09.01.2017)



Kushëri i Mehmed Akifit me Adnan Ismailin (2005).



Në vend të shtëpisë së babait të Mehmed Akifit, Tahir efendiut, tash qëndron një dru i madh me shumë degë.